

ANDREA LLUKANI

**ARTI KISHTAR
NË SHQIPËRI**

(Sipas mbishkrimeve të kishave)

**Botimet “Trifon Xhagjika”
Tiranë, 2014**

Këtë libër ia kushtoj teologut **Theofan Popa**

Redaktor: **Shpëtim Sala**

PARATHËNIE

Libri “Arti kishtar në Shqipëri” bën fjalë për kishat monument kulture duke u mbështetur tek mishkrimet si të vetmet dëshmi autentike, të cilat dëshmojnë për kulturën dhe traditën e popullit shqiptar në shekuj. Ky libër nuk është botim zyrtar i K.O.A.Sh-it, por një përpjekje vetjake e autorit për të nxjerrë në pah vlerat e vërteta të kishave dhe manastireve ortodokse, të cilat kanë qenë vatër e kultivimit të kulturës dhe të traditës sonë kombëtare. Manastiret kanë qenë qendra të mëdha shpirtërore me karakter social. Nëpër manastire ka pasur njerëz të ditur dhe me kulturë. Si qendra të adhurimit kristian, të përhapjes së kulturës bizantine gjatë sundimit osman, manastiret kanë luajtur rol të madh shoqëror për popullsinë vendase. Nëpër manastire ka pasur shkolla djemsh ose vajzash, të cilat funksiononin me shpenzimet e manastirit. Gjithashtu shumë manastire të tjera sponsorizonin shkollat e krahinës. Në disa manastire ka pasur punishte, të cilat zbulonin kodikët, qepnin veshjet e shenja, gdhendnin ikonostasët etj. Manastire të tjerë kanë botuar libra të ndryshëm fetarë, kanë pasur biblioteka të pasura, ose kanë organizuar konferenca. Qendrat monakale kanë zhvilluar aktivitete bamirësie, duke ndihmuar njerëzit në nevojë etj. Në disa manastire ka pasur qendra shëndetësore dhe jetimore. Gjithashtu nëpër manastire është kultivuar arti i pikturimit të ikonave dhe muzika bizantine.

Nëpër kishat e manastireve gjenden mjaft objekte të shenjta me argjend si për shembull: kapakë ungjijsh, potirë të shenjtë, lugë kungimi, kryqe, eksapterë, temjanica, kuti për mbajtjen e lipsanëve të shenjtoreve, artoforë, kolimvithra pagëzimi, etj. Nga mbishkrimet që gjenden të skalitura mbi to vërrejmë se vetëm disa prej tyre kanë shkruar emrin dhe datën e punimit. Mjeshtrat e punimit të këtyre objekteve të shenjta në shumicën e rasteve kanë mbetur anonimë. Por nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ikonostaset e famshme të gdhendura nga dalta e mjeshtrave dhe të lyer me ar, frone episkopale, amvone, psaltirë, si dhe epitafët e famshëm e mbulesat e shenjta të qendisura me fije ari. Në panairot e këtyre manastireve merrnin pjesë shumë pelegrinë të ardhur nga fshatrat përreth. Panairot, përveç rolit shpirtëror të pelegrinazhit, janë frekuentuar edhe nga tregtarët, të cilët shfrytëzonin rastin për të shitur mallrat e tyre. Popullsia në raste panairesh vishej me kostume popullore duke ekspozuar traditat dhe folklorin e zonës.

Manastiret janë ndërtuar kryesisht gjatë kohës së Justinianit në shekullin VI, të Kostandin Pogonit në mesin e shekullit VII dhe të dinastisë së Maqedonëve prej shekullit IX deri në shekullin XI. Këto manastire janë ndërtuar nëpër vende të dukshme, në majë të kodrave, në male, në ishuj etj. Shumë manastire janë rrethuar nga mure të larta prej guri. Brenda mureve kanë qenë qelitë e murgjve. Qendra e çdo manastiri ishte kisha katedrale, e cila në më të shumtën e rasteve ishte me kupolë. Në brendësi të kishave gjejmë afreske, ikonostase, ikona dhe sende të tjera të shenjta me vlerë. Zakonisht pranë katedrales gjendej trapezaria, e cila përbënte vendin e grumbullimit të murgjve për vaktet e ushqimit. Nëpër manastire ka pasur arhondari, në të cilat priteshin pelegrinët. Arhondaritë zakonisht janë ndërtuar pranë portës së manastirit, kanë qenë dhoma me oxhak dhe me stola rreth e qark, të cilat shërbenin për ata që vinin për pelegrinazh në manastir. Duke pasur për bazë arkitekturën dhe kohën e ndërtimit kishat dhe manastiret e Shqipërisë klasifikohen si më poshtë:

1-Arkitektura kishtare paleokristiane (shek. IV-X)

Kishat më të shumta të kësaj kohe janë të tipit të bazilikës triklone me strehë druri. Në tipin e bazilikës triklone bëjnë pjesë këto kisha paleokristiane: 1-”Bazilika e Tepesë” në Elbasan, e ndërtuar në shekullin IV. 2-”Bazilika e Butrintit”, e cila daton në shekullin IV. 3-”Bazilika e Arapajt” në Durrës. 4-”Bazilika e Antigonesë” etj. Gjatë kësaj kohe janë ndërtuar muret rrethuese të Durrësit. Punimet për ndërtimin e tyre kanë nisur në kohën e perandorit Anastas (491-518), i cili e kishte origjinën nga Durrësi.

2-Arkitektura mesjetare (shek. X-XIII).

Në jugun e Shqipërisë kemi ndikime të artit bizantin mesjetar. Nga kishat më të rëndësishme të kësaj kohe janë: kisha e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Peshkëpinë e Sipërme, e cila i përket shekullit X, kisha e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Labovën e Sipërme, që daton në shek X-XI, kisha e “Shën Nikollës” në Mesopotam, kisha e manastirit të “Shën Mërisë” në Apolloni, e cila i përket shekullit XIII, brenda mureve të kështjellës së Beratit janë: kisha e “Trinisë së Shenjtë” dhe kisha e “Vllahernës”, të cilat datojnë në shekullin XIII. Gjithashtu kemi edhe kishën e “Shën Mërisë” në Kosinë të Përmetit, që i përket shekullit XII. Veçoria dalluese e ndërtimit të kishave të kësaj kohe është se ato në shumicën e rasteve janë të tipit me kryq të brendashkruar, ku kubeja mbështetet në katër kolona, por ndeshim edhe një tip tjetër në arkitekturën e ndërtimit të kishave, të cilat janë me kube, që mbështeten në muret anësore duke marrë formën e kryqit në pjesën e brendshme. Në Korçë kemi kishën e “Ristozit” në Mborje, e cila daton në vitin 1390, kishën e “Shën Mëhillit” në Berat etj.

3-Arkitektura pasbizantine (shek. XVI-XIX).

Prej kësaj kohe ka shpëtuar numri më i madh i kishave të Shqipërisë së Jugut. Nga këto kisha mund të veçojmë: “Shën Gjergjin” në Leshnicën e Sipërme në Sarandë (1525), “Shën Dhimitrin” e Poliçanit (1526), katedralen e manastirit të “Profetit Ilia” në Jergucat (1585), katedralen e manastirit të “Shpërfytyrimit” në Çatistë (1581),

katedralet e manastireve të “Zervatit” (1569), “Vanishtës” (1582), “Dhuvianit” (1588), “Goranaxisë” (1600), “Kamenës” (1580), etj. Në shekullin XVII kishat pasbizantine u shtuan. Prej tyre po përmendim: “Shën Gjergjin” në Demas, katedralet e manastireve të “Stegopulit” (1624), “Saraqinishtës” (1630), “Voskopojës” (1632), “Ravenjës”, “Pepelit”, “Drianit”, “Hormovës”, “Kodrës”, “Leshnicës”, “Qeparoit”, “Kakomesë”, “Poliçanit”, “Palasës”, “Himarës”, “Dhërmiut”, “Qeparoit” etj. Në shekujt XIII-XIX kemi bazilikat me kupolë: katedralen e manastirit të “Tërëshënjtës” në Nivan të Gjirokastrës (1702), kishën e “Apostujve Petro dhe Pavël” në Vithkuq të Korçës (1759), kishën e “Shën Kozmait” në Kolkondas (1812), kishën e “Shën e Premtes” në Përmet (1776), të “Tërëshënjtës” në Sopik të Gjirokastrës (1782), kishën e “Profetit Ilia” në Voskopojë (1751) etj.

Gjithashtu episkopët me origjinë shqiptare kanë dhënë kontributin e tyre në ndërtimin e kishave. Në kohën e episkopit të Beratit, Metodit (1736-1751), i cili ishte me origjinë nga Bubullima, u ndërtua kisha e manastirit të “Lindjes së Shën Mërisë” në Ardenicë në vitin 1734. Në kohën e Joasafit të Beratit (1752-1760) u ndërtua kisha e “Shën Gjergjit” në Libofshë në vitin 1776, kisha e “Shën Kollit” në Vanaj në vitin 1777, kisha e “Fjetjes së Shën Marisë” në Bishtqethëm më 1798, kisha e “Shën Todrit” në Kadipashaj në vitin 1801 etj. Në kohën e Joasafit të Ri (1802-1855) janë pikturuar afresket e këtyre kishave: në vitin 1811 në kishën e “Shën Kollit” në Toshkëz, në vitin 1806 në kishën e “Ungjillëzimit” në Kosarë të Beratit, më 1801 në kishën e “Shën Kollit” në Krutjen e Sipërme etj.

4-Shkatërrimi gjatë viteve të diktaturës (1945-1990).

Sipas një dukumenti të Kuvendit Popullor, i cili mban datën 1 janar 1967 Kisha Ortodokse kishte si pasuri të paluajtshme 600 kisha dhe tetë manastire. Persekutimi filloi me reduktimin e numrit të kishave dhe të personelit që shërbente në to. Më 1 janar 1967 funksiononin vetëm pesë kisha, një në Tiranë, një në Durrës, një

në Berat, një në Kavajë, dhe një në Shkodër, ndërsa të tjerat kishin kaluar në pronësi të komiteteve ekzekutive dhe të kooperativave bujqësore. Gjithashtu u reduktua ndjeshëm personeli. Në atë kohë personeli përbëhej nga 194 vetë dhe u reduktua në 10 vetë. Madje udhëzimi ishte që Kisha Ortodokse të ekzistonte vetëm për efekte protokollare me një personel prej tre vetësh (kryetari, një sekretar dhe një person tjetër për shërbime të ndryshme).

Në janar të vitit 1967 organizata e rinisë së shkollës së mesme “Naim Frashëri” në qytetin e Durrësit shpalli nismën: “Të luftojmë deri në fund ideologjinë fetare, besytnitë dhe zakonet prapanike”, ndërsa më 6 shkurt 1967 Enver Hoxha mbajti fjalimin me temë: “Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit”. Menjëherë pas kësaj gazeta “Zëri i popullit” botoi artikullin: “Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë, kundër ideologjisë fetare, paragjykimëve, besytnive dhe zakoneve prapanike”. Pas fjalimit programatik të Enver Hoxhës më 6 shkurt 1967 për ta zhveshur popullin nga besimi fetar dhe për të futur në të botëkuptimin marksist-leninist, filloi fushata për prishjen e kishave. Për shkatërrimin e kishave dërguan nxënësit e shkollave dhe repartet ushtarake. Nën udhëheqjen e aktivistëve fanatikë të organizatave të rinisë dhe sipas udhëzimeve të komiteteve të partisë ata filluan vinin dorë mbi kishat. Klerikët dhe besimtarët kujtuan se shkatërrimi i objekteve të kultit ishte me të vërtetë një nismë e organizatës së rinisë, prandaj filluan të dërgonin letra tek Enver Hoxha, me anën e së cilave kërkonin ndalimin e fushatës shkatërruese. Ata shpresonin se udhëheqësi kryesor i Partisë së Punës do të ndërhynte me autoritetin e tij për të ndaluar barbarizmat që po bëheshin. Si pasojë e përndjekjes u sheshuan rreth 600 kisha ortodokse, ndërsa të tjerat u kthyen në ofiçina mekanike, magazina, stalla, salla kinemaje, vatra kulture apo klube. U shkatërruan me qindra ikona dhe afreske, u dogjën libra liturgjike kishtarë, enët e shenjta u sekuestruan dhe u përvetësuan, veshjet e klerikëve u përdhosën. Kisha iu nënshtroi ikonoklazmës, e cila

ishte hartuar nga inkuizitorët komunistë. Pothuajse të gjitha manastiret u shkatërruan ose u kthyen në reparte ushtarake. Duhet theksuar fakti që nga vlerat artistike dhe arkitektonike që bartnin shumë kisha ortodokse u shpallën Monument Kulture, prandaj i rezistuan kohës.

5-Restaurimi i kishave. Gjatë viteve (1992-2014) me fondet e Kishës Ortodokse Autoqefele të Shqipërisë janë restauruar rreth 70 kisha nga 165 objekte që kanë statusin monument kulture të trashëgimisë kulturore. Me anën e specialistëve të Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore, hartohen projekte restaurimi, të cilat miratohen në organet përkatëse dhe fillon restaurimi në bazë të kritereve që përcakton ligji mbi trashëgiminë kulturore. Për restaurimin e këtyre objekteve Kisha Ortodokse Autoqefele e Shqipërisë ka shpenzuar rreth 8 milion euro. Janë kryer punime të plota restauruese në këto kisha: kisha e “Shën Nikollës” në Grabovë të Gramshit, kisha e manastirit të “Shën Joan Vladimirit” në Elbasan, kisha e “Shën Mërisë” në Leusë të Përmetit, kisha e “Profetit Ilia” në Lekël të Tepelenës, kisha e “Gjithë Shenjtorëve” në Himarë, manastiri i “Shën Dhimitrit” në Qeparo, kisha e “Shën Spiridhonit” në Vuno, kisha e “Hyjlindëses” në Vrahogoranxi, kisha e “Kryeengjëjve” në Bodricë të Gjirokastrës, kisha e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Zervat të Gjirokastrës, kisha e “Shën Spiridhonit” në Berat, manastiri i “Ardenicës”, manastiri i “Shën Kozmait”, kisha e “Shën Gjergjit” në Libofshë, kisha e “Shën Nikollës” në Vanaj, manastiri i “Zvërnecit”, etj.

Janë kryer ndërhyrje restauruese në këto kisha: Nëpër kishat e Voskopojës, kisha e “Kryeengjëjve” në Gjirokastrë, kisha e “Metamorfozës” në Gjirokastrë, kisha e “Shën Athanasit” në Bularat, kisha e së “Tërëshenjtës” në Nivan, manastiri i “Shën Gjergjit” në Sarandë, kisha e “Shën Nikollës” në Dhuvjan të Delvinës, kisha e manastirit të “Stegopulit” në Gjirokastrë, kisha e “Shën Nikollës” në Erind të Gjirokastrës, kisha e së “Tërëshenjtës” në Delvinë, kisha e “Kryeengjëllit Mihal” në Mingul

të Gjirokastrës, kisha e së “Tërëshenjtës” në Labovën e Zhapës, kisha e “Apostujve Pjetër dhe Pavël” në Hoshtevë, kisha e manastirit të “Profetit Ilia” në Vrinë të Sarandës, kisha e “Profetit Ilia” në Bual të Përmetit, “Shën Dhimitri” në Tërbuq të Gjirokastrës, kisha e “Shën Athanasit” në Goranxi, kisha e “Shën Parashqevisë” në Sheper, kisha e manastirit të “Shën Gjergjit” në Çukë të Sarandës, kisha e “Hyrjes së Hyjlindëses” në Bënjë të Përmetit, manastiri i “Fjetjes së Hyjlindëses” në Goranxi, manastiri i “Fjetjes së Hyjlindëses” në Dhuvjan, manastiri i “Kryeengjëjve” në Dervician, kisha e “Shën Athanasit” në Karavasta të Lushnjes, kisha e “Shën Nikollës” në Krutje të Lushnjes, kisha e së “Tërëshenjtës” në Bishtqethëm të Lushnjes etj.

6-Problematika e grabitjes së kishave. Është për të ardhur keq sepse kishat monument kulture shpesh kanë rënë pre e vjedhjeve dhe grabitjeve nga njerëz të papërgjegjshëm. Vjedhësit çmontojnë ose shkulin me dhunë dyert e bukura, pjesë nga amvoni, pjesë nga ikonostasi, pjesë nga fronet dhespotike, ikonat e montuara në ikonostasët e kishave monument kulture dhe ua shesin në tregun e zi matrapazëve ose koleksionistëve të veprave të artit. Gjatë viteve të fundit janë vjedhur dhe dëmtuar këto kisha: Më 19 nëntor 2009 janë vjedhur pjesë të ikonostasit në kishën e “Shën Marisë” në Leusë të Përmetit. Më 4 prill 2011 është vjedhur kambana e kishës së “Shën Gjergjit” në Libofshë të Fierit. Më 10 dhjetor 2007 është vjedhur dera kryesore e ikonostasit të kishës së “Shën Kollit” në Vanaj të Fierit. Gjatë viteve 2010-2011 janë bërë tri vjedhje në kishën e “Shën Marisë” në Zervat të Gjirokastrës ku janë grabitur krejt ikonat e ikonostasit. Më 11 shkurt 2011 është vjedhur gjatë procesit të restaurimit kisha e “Shën e Premtes” në Çetë të Kavajës. Në dhjetor 2007 është zhdukur një pjesë e mirë e ikonostasit të kishës së “Shën Thanasit” në Karavasta të Lushnjës. Më 19 nëntor 2009 është grabitur një ikonë me vlerë shpirtërore nga kisha e “Shën Mërisë” në Bënjë të Përmetit. Më dhjetor 2011 është grabitur për të gjashtën herë kisha e “Shën

Thanasit” në Bularat të Dropullit të Sipërm. Nga ikonostasi 200 vjeçar janë shkukur 27 ikona me vlera historike dhe shpirtërore. Në mars 2012 janë vjedhur dy kambana në kishën “Lindja e Hyjlindëses” në Vokopolë të Beratit. Gjatë procesit të restaurimit në korrik 2012 janë vjedhur dy kisha në Voskopoje. Keqbërësit duke përdorur skelat e restaurimit kanë grabitur kambanën në kishën e “Shën Marisë”. Gjithashtu në kishën e “Shën Thanasit” kanë grabitur disa ikona me vlerë. Më 4 janar 2013 janë dëmtuar disa nga fresket e pikturuar nga Onufri në kishën e “Shën e Premtes” në Valësh të Elbasanit, etj.

Në ditën e Trashëgimisë Kulturore, më 29 shtator 2013 Ministria e Kulturës ka përruar faqen e internetit www.shpetothesarin.com ku mund të denoncohet çfarëdolloj dëmtimi dhe rrënimi që i bëhet monumenteve të kulturës. Ideimi i kësaj faqeje interneti u relizua në sajë të vizionit që kanë drejtuesit e ri të kësaj ministrie duke përmbushur prioritetin që ka qeveria në programin e saj për monumentet e kulturës si vepra të trashëgimisë sonë kulturore. Shqipëria ka qindra kisha dhe manastire të cilët për vlerat artistike dhe kulturore që bartin kanë fituar statusin monument kulture. Këto thesare të trashëgimisë kulturore që na i lanë të parët tanë duhet ti ruajmë dhe tua trashëgojmë brezave që do të vijnë.

Krishtlindje, 2013

KREU I PARË

MITROPOLIA E TIRANËS DHE DURRËSIT

Mitropolia e Durrësit e ka zanafillën nga vitet apostolike. Qyteti i Durrësit ka qenë qendra më e madhe e krishterimit në Iliri. Në kohët e hershme Mitropolia e Durrësit zinte vendin e pestë ndërmjet nëntë mitropolive. Varësia kishtare e Mitropolisë së Durrësit ishte nga Vikariati Romak i Selanikut. Mitropoliti i Selanikut mbante titullin Kryeepiskop dhe varej nga Kisha e Romës. Qendra episkopale e Durrësit ka qenë kisha e “Shën Anargjendëve”, e cila është ndërtuar gjatë viteve të mbretërimit të perandorit Anastas. Në shekullin VIII perandori Leon Izauri e bashkoi Mitropolinë e Durrësit me Patriarkanën Ekumenike të Kostandinopojës. Në këtë kohë Mitropolia e Durrësit zinte vendin e 42-të ndërmjet kishave të Kostandinopojës. Kjo gjendje vazhdoi gjer në shekullin XII kur Mitropolia e Durrësit kaloi në varësinë kishtare të Kryeepiskopatës së Ohrit. Nga viti 1767 deri në vitin 1937 kur u shpall e autoqefalia, Mitropolia e Durrësit ishte në varësinë e Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës. Që nga viti 1923 Mitropoliti i Durrësit mbante titullin: “Mitropolit i Durrësit, Gorës dhe Shpatit, primat dhe ekzark i tërë Ilirisë, i Detit Perëndimit dhe të gjithë Shqipërisë”. Në atë kohë quhej Mitropolia e Durrësit, Tiranës dhe Elbasanit, ndërsa

pas vitit 1929 qendra kaloi në Tiranë që ishte kryeqyteti i Shqipërisë, prandaj u quajt Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Në Tiranë është vendosur edhe Kryeepiskopata e Hirshme. Kryeepiskopi mban titullin: “Kryeepiskop i Tiranës Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë”.

Mitropolitët e Durrësit kanë qenë: Qesari (një nga 70 Apostujt), Asti (98), Eukari (431), Lluka (451), Sizini (692), Niqifori (783), Llukiani (879), Lorenci (1025), Lorenci (1053), Andoni (1143), Kostandin Kavasili (1180), Romanoi (1240), Anonim (1289), Dhanili (1691-1694), Kozmai (1694-1702), Niketa (1740-1749), Anthimi (1749-1760), Neofiti (1760-1761), Mileti (1761-1768), Grigori (1786-1772), Kostanci (1777-1782), Efthimi (1782-1809), Samueli (1809-1821), Krisanthi (1821-1833), Gjerasimi (1833-1837), Anthimi (1837-1844), Anthimi II (1844-1845), Joaniqi (1845-1858), Genadi (1858-1859), Afsenti (1859), Josifi (1859-1867), Visarioni (1867-1899), Prokopi (1899-1906), Joani (1906-1911), Jakovi (1911-1922), Theofan Noli (1923), Visarion Xhuvani (1929-1937), Kristofor Kisi (1937-1948), Paisi Vodica (1948-1966), Damjan Kokoneshi (1966-1967), Anastasi (1992-në vazhdim).¹

KISHAT DHE MANASTIRET

Mitropolia e Tiranës dhe e Durrësit para vitit 1967 kishte 20 enori dhe dy manastire, ndërsa sot Mitropolia e Shenjtë e Tiranës dhe e Durrësit ka këto zëvendësi mitropolitane vendore: Tirana, Durrësi, Shkodra, Kavaja dhe Elbasani. Kishat e kësaj mitropolie sipas qyteteve janë: Në Tiranë: Katedralja “Ngjallja e Krishtit”, kisha e “Shën Prokopit”, kisha e “Ungjillëzimit të Hyjlindëses”, kisha e “Gjithë Shenjtorëve” në Kombinat, kisha e “Metamorfozës” pranë Qendrës Thavor.

¹-Dhimitër Beduli, Mitropolia e Durrësit në Shekuj, Ngjallja, qershor 1993, faqe 7.

Në Durrës: Katedralja “Apostull Pavli dhe Shën Asti”, kisha e “Shën Gjergjit”, kisha e varrezave, manastiri i “Shën Vlashit”, kisha “Apostull Petro dhe Pavli”, në Rrushkull.

Në Kavajë: Kisha e “Shën Nikollës”, kisha e “Shën Nikollës” në Rreth-Greth.

Në Peqin: Kisha e “Apostull Petros dhe Pavlit”.

Në Elbasan: Kisha e “Shën Nikollës”, kisha e “Shën Thanasit”, kisha e “Shën Marisë”, kisha dhe konakët e manastirit të “Shën Joan Vladimirit”, kisha e “Shën Dhimitrit” në Fikas, kisha e “Lindjes së Krishtit” në Cërrik, kisha e “Shën Dhimitrit” në Shtërmën, kisha e “Analipsit” në Gjinar.

Në Librazhd: Kisha e “Tërëshenjtës Mari” në Përrenjas.

Në Gramsh: Kisha e “Metamorfozës së Shpëtimtarit” në Gramsh, kisha e “Shën Nikollës” dhe “Shën Parashqevisë” në Grabovë.

Në Shkodër: Katedralja e “Lindjes së Krishtit”, kisha e “Trinisë së Shenjtë” në Vrakë.

Në Lezhë: Kisha e “Metamorfozës së Shpëtimtarit”.

Në Bulqizë: Kisha e “Shën Parashqevisë” në Klenjë.

KISHAT MONUMENT KULTURE

Kisha e “Shën Premtes” në Çetë të Kavajës, 1963, bazilika e “Shën Mëhillit” në Arapaj të Durrësit, bazilika në “Kodrën e Tepes” në Elbasan, kisha e “Shën Joan Vladimirit” në Elbasan, 1948, kisha e “Shën Kollit” në Shelcan, 1948, kisha e “Shën Premtes” në Valësh, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në lagjen Kala të Elbasanit, 1963, rrënojat e kishës së “Ungjillizimit” në Mjekës, 1970.

KISHAT E MITROPOLISË SË TIRANËS DHE DURRËSIT


KATEDRALJA NGJALLJA E KRISHTIT

Kompleksi i katedrales “Ngjallja e Krishtit”, është ndërtuar në qendër të kryeqytetit, në një truall që u dha në kompensim të truallit të kishës së vjetër katedrale të Tiranës, e cila u shkatërrua nga regjimi ateist më 1967. Ky truall është dhënë gradualisht nga autoritetet shtetërore, pas këmbënguljeve të vazhdueshme të Kryeepiskopit Anastas. Kam qenë i pranishëm në shumë biseda të tilla me personalitete të ndryshme të vendit. Kryeepiskopi ishte shumë i vendosur në kërkesën e tij. Komunitetit ortodoks të Tiranës i duhej një kishë katedrale me parametra bashkëkohorë. Në mbledhjen e Qeverisë, të datës 1 shkurt 2006, u mor vendimi për ti dhuruar Kishës Ortodokse një sipërfaqe toke prej 460 metra katrorë, e cila ishte e nevojshme për plotësimin e truallit.²

Punimet për ndërtimin e kompleksit të katedrales “Ngjallja e Krishtit” kanë filluar në korrik të vitit 2004 dhe përfunduan më 24 qershor 2012, kur u zhvillua ceremonia e përirimit. Koncepti arkitekturor i kishës “Ngjallja e Krishtit” përmban kuptimin e kohës së përjetshme. Kisha mbulohet me kupolë, me diametër të brendshëm 26 m dhe lartësi 23 metra, ndërsa katër masat mbështetëse përfundojnë me mbulesa gjysmëcilindrike. Në ndarjet ndërmjet dritareve të kupolës janë vendosur perimetrikisht 52 elementë dekorativë në relief, ndërsa katër masat mbështetëse dekorohen me basoreliev, me temë siglën dhe kallirin, si simbol i sakrificës dhe pjellorisë. Fasada e kishës formohet nga një hark i madh, i cili të krijon përshtypjen e mikpritjes dhe shiriti i ndritshëm


²-Qeveria jep 460 metra katror tokë për Katedralen e Tiranës, Ngjallja, shkurt 2006, faqe 12.

i qelqtë, në ngjyrë të kaltër, të jep përshtypjen e harkut të ylberit. Muri perëndimor është i veshur me mermer të bardhë dhe në qendër të tij ndodhet hyrja kryesore. Mbi hyrjen kryesore është vendosur një kryq i madh i bronztë, i qarkuar nga dy kallinj, simbol i dashurisë sakrifikuese dhe i përkushtimit. Ikonostasi i gdhendur në mermer të bardhë është realizuar nga skulptori Janis Kirarinis, i ardhur nga Dino. Gdhendjet e tij janë simetrike si në panelet e brezit të poshtëm ashtu dhe në brezat e tjerë zbukurues. Elementi kryesor i përdorur nga artisti është kryqi që shoqërohet dhe disa elemente florealë. Me të njëjtin konceptim janë gdhendur në mermer të bardhë dhe fronti peshkopal brenda absidës dhe ai në sallën ku rrinë besimtarët. Kupola përbrenda është me relief të dekoruar me mozaik, në qendër të të cilit mbizotëron “i Gjithëpushtetshmi”.



Përqark të Gjithëpushtetshmit, dymbëdhjetë rreze të krijojnë ndjesinë e rrezeve të Dritës Hyjnore, e cila nëpërmjet dritareve përçohet në të gjithë qytetin. Në absidë, brenda e hierores gjendet skena “Të gjithë kombet”. Sipër saj gjendet Platitera e

tipit Oranta, e cila paraqitet me duart e hapura ne pozicion lutjeje, por pa Emanuelin në kraharor. Në të dy anët e Platiterës gjenden engjëjt. Nëpër katër harqet që mbajnë kupolën janë pikturuar katër ungjillorët. Mozaikët janë realizuar nga mjeshtri Josif Droboniku. Llambadari qendror është me fletë bronzi, duke krijuar nivele të njëpasnjëshme qirinjsh në formë rrethore dhe gjysmërrethore. Po ashtu, 120 qirinj, të shpërndarë në mënyrë perimetrike, plotësojnë ndriçimin e kishës. Kambaneria ka lartësi 46 metra u dhe përbëhet nga katër llambadha pashke, të cilat simbolizojnë katër ungjillorët që shpallin Ngjalljen. Në të janë vendosur 16 kambana, mbi të cilat një orë katërfaqëshe tregon kohën.³



Pranë Katedrales “Ngjallja e Krishtit” gjendet një kishës të vogël, e cila i kushtohet “Lindjes së Krishtit”. Kishëza është pikturuar në faqen lindore me piktura murale nga ikonografi Kristo Papanikolau. Ky i fundit ka realizuar edhe ikonat e vendosura mbi ikonostasin prej druri të gdhendur. Kishëza është në formën e kryqit me mbulesa prej fletësh bakri. Në pjesën qendrore të nefit para ikonostasit në dysheme ndodhet një dritare rrethore e qelqtë, që shërben për ndriçimin e pagëzimites poshtë saj.

³-Kompleksi i Katedrales së re të Tiranës “Ngjallja e Krishtit”, Selia e Sinodit të Shenjtë dhe Qendra Kulturore, Tiranë 2012, faqe 2-3.

KISHA E UNGJILLËZIMIT TË HYJLINDËSES NË TIRANË

Shenjtërimi i kishës së “Ungjillëzimit të Hyjlindëses” në Tiranë u bë më 21 mars 1965, me pjesëmarrjen e Kryepiskop Paisit, Mitropolitit të Gjirokastrës Damjanit, Mitropolitit të Beratit Qirillit dhe të Episkopit Stefan Lasko. Gjithashtu mernin pjesë ikonom Marko Papajani, ikonom Thanas Grapshi, saqellar Petro Doçi etj. Besimtarët të paraprirë nga klerikët bënë tre litani dhe u futën në kishë, ku u zhvillua shërbesa e shenjtërimin. Projekti i kishës u realizua nga ing. Skënder Luarasi. Kisha u ndërtua nga ndërmarrja “21 Dhjetori” me shpenzimet e shtetit si kompensim i kishës me të njejtin emër që u prish nga plani rregullues i qytetit, sepse mbi truallin e kishës u ngrit hoteli pesëmbëdhjetë katësh. Andromaqi Zengo ka realizuar me mjeshtëri afresket e kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë. Këto afreske janë pikturuar në stilin rus. Në kubënë e kishës është pikturuar “Pantokratori”, katër ungjillorët dhe të katër engjëjt përreth kubesë. Këto afreske janë bërë me shpenzimet e kishës dhe kanë kushtuar 168 000 lekë. E veçanta në afresket e Andromaqi Zengos është se emrat e shenjtoreve janë shkruar shqip.⁴

Mbyllja. Atë Marko Papajani në kujtimet e tij ka shkruar: “Më datën 20 mars 1967 në mbrëmje kisha u mbyll, ndërsa më 7 prill 1967 u rihap duke i kryer rregullisht shërbesat për tu mbyllur përfundimisht më 31 maj 1967”. Kisha u kthye në palestër ku stërviteshin gjimnastët.⁵

Klubi Sportiv “17 Nëntori” për të përmbushur nevojat e tij ka bërë disa shtesa dhe ndryshime në planimetrinë e kishës. Salla kryesore e kishës ishte katandisur si mos më keq nga mosvënia

⁴-Kristofor Beduli, Familja e Agjiografëve Zengo, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9-10.

⁵-Kristofor Beduli, At Marko Papajani dhe shënimet e tij, Neraida, Tiranë 2004, faqe 41-44.

dorë mbi të. Dritaret me xhama të thyer, suva të rrëzuara, çatia pjesërisht e rrënuar dhe lagështira ishte e pranishme kudo. Pluhuri i përzier me lagështirën kishte fëlliqur muret dhe kishte ndotur parketin e dyshemesë. Afresket e pikturuara me mjeshtëri nga motrat Zengo i kishin lyer me një shtresë të trashë gëlqereje që të mos dukeshin, megjithatë lagështira kishte mundur të zbulonte fytyrat e katër ungjillorëve, të cilët qenë pikturuar në harqet që mbanin kubenë e kishës. Llambadarët e mëdhenj qenë dëmtuar, ndërsa ballkoni ku qëndronte kori ishte shndërruar në magazinë. Kambaneria si kullë nuk qe dëmtuar falë propozimit të shefit të Klubit “17 Nëntori”, Lame Konomi, për t’u përdorur nga alpinistët për ngjitje dhe zbritje. Dyshemeja ishte e shtruar e gjitha me parket dhe nëpër mure qenë ngulur ganxha, të cilat shtrëngonin veglat gjimnastikore.

Rihapja. Kisha e “Ungjillëzimit” në Tiranë u rihap më datën 4 mars 1991. Pararendësit e rihapjes së kishës qenë dhjakon Spiro Findiku, Nasi Hobdari dhe Llazar Pjeshkazini. Kisha ishte në një gjendje të mjerueshme si në mjediset e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtmet. Kishte shumë punë për t’u bërë, prandaj u lëshua kushtrimi për ndihmë. Besimtarët që iu përgjigjën të parët thirrjes qenë: Niko Hobdari, Filip Nito, Spiro Vojo, Spiro Bejleri, Petrika Shalësi, Todi Janku, Dhimitraq Kobuzi, Milto Mima, Lekë Tasi, Aleko Dhima, Gazmend Leka, Pavllo Hobdari, Koçi Paci, Minella Mihali, Dhimitraq Kobuzi, Arian Koja, Petrika Trako, Niko Kavaja, Kristaq Tasho, Andrea Llukani, Krisanthi Zoto, Drita Papajani, Llazar Nushi, Prokop Shundi, Leonidha Kllapi, Sandër Çoka, Thoma Valera, Grigor Laçka etj.

Të gjithë emrat u shënuan në ditarin e kishës. Fillimisht u munduam ta sillnim kishën në gjendje të paraqitshme, prandaj puna e parë qenë pastrimet, u hoq parketi i vjetër dhe u bënë mjaft rregullime. Na duhej ikonostasi, i cili kushtonte mjaft, prandaj menduam që me dërrasën e parketit, të përshatur në kuadrate 3X3 metra të bënim një ikonostas të thjeshtë. Gjithashtu ajodhima qe e

sheshuar në një nivel me pjesën tjetër të kishës dhe e mbushëm me zhavor e beton me qëllim që ta ngrinin mbi kuotën e përgjithshme të dyshemesë ashtu siç kishte qenë dikur. Hyrja kryesore e kishës ishte e murosur, prandaj biseduam me shefat e Klubit 17 Nëntori për ta shembur, sepse po afronin pashkët dhe nuk na mbetj shumë kohë. Përveçse përkushtimit vullnetar të besimtarëve që punonin pa shpërblim na duheshin edhe fonde financiare për materialet që nevojiteshin, prandaj u bëmë thirrje të krishterëve që të na ndihmonin me sa mundësi kishin. Menjëherë si në “Paravolinë e vejushës së varfër” shprestarët ortodoksë ofruan atë që kishin për rikonstruksionin e kishës. Ndihma në të holla dhanë: Krisanthi Zoto, Gaqo Bushaka, Petraq Roko, Ollga Karafili, Vasil Loli, Fiodor Prifti, Miti Theodhosi, Luiza Stasoli, Dhimitër Gjika, etj. Të gjitha pengesat u kapërcyen vetëm falë vullnetit dhe përkushtimit të besimtarëve.

Nasi Hobdari dhe dhjakon Spiro Findiku vajtën në “Kinostudio” dhe në “Muzeun Etnografik” ku mund të gjenin materiale të nevojshme për mjediset e kishës. Me ndërmjetësinë e Petraq Ramës takuan drejtorin e “Kinostudios” z. Teodor Laço, i cili si ortodoks që ishte kontribuoi për kthimin e objekteve kishtarë. Froni episkopal ishte dëmtuar, prandaj besimtari Todi Janku u muar me riparimin e tij. Kandilat u pastruan nga Milto Mima dhe Prokop Shundi, por ato që ishin nxirë nga mospërdorimi Llazar Pjeshkazini i shpuri për t’i pastruar te Ndërmarja Artistike “Migjeni”, ku u lanë me acid, u luçduan dhe u llakuan. Atë Gaqo Pjetri kishte në shtëpi një kryq bronxi, të cilin e sollti në kishë. Filip Nito dhe Dhimitër Kobuzi morën përsipër të hapnin 12 gropa, tek të cilat do të vendoseshin shufrat tek udha në mes të kishës aty ku kalojnë priftërinjtë gjatë Hyrjes së Madhe.

Niko Hobdari siguroi kordonin e kuq 40 metërsh, i cili u pre në copa dymetroshe dhe u vendos në shufra nga Thoma Valera dhe Andrea Llukani. Për veshjen e ikonostasit me letër imituese punuan Sandër Çoka dhe Lekë Tasi. Gazmend Leka pikturoi

skenën e “Kryqëzimit të Krishtit”. Ikonat e para që u vendosën në ikonostas i solli dhjakon Spiro Findiku nga shtëpia. Besimtari Koço Zoto solli nga Greqia me shpenzimet e tij, gjashtë kandile për ikonostasin, një temianicë dhe një kryq. Ing. Petrika Shalësi, Spiro Beleri, Vane Mazniku, Qirjo Nikolla u morën me meremetimet e mureve të kishës. Përveç burrave nuk duhet mohuar kontributi i grave shprestare, të cilat pastronin kishën dhe kujdeseshin për gjithçka. Midis tyre mund të veçojmë: Elpiza Xhimitikun, Amalia Maçin, Kristanthi Zoton, Luiza Sastolin, Drita Papajanin, Tefta Kuqen, Tefta Piten, Evanthi Manglaran, Florika Papajanin, dr. Keti Noçka etj.⁶

Liturgjia e parë. Në mëngjesin e 31 marsit 1991 kambana e kishës së “Ungjillëzimit” kumboi gëzueshëm, duke i ftuar të gjithë besimtarët në kishë. Liturgjia hyjnore u kryesua nga atë Gaqo Pjetri, me pjesëmarrjen e dhjak Spiro Findikut dhe kryedhjakon Sotir Kanxherit, zëri i ëmbël i të cilit kumboi përsëri në kishën e “Ungjillëzimit të Hyjlindëses”. Në rolin e kryepsaltit ishte teologu Dhimitër Beduli me psaltët Petro Ketri, Niko Kavaja dhe Kristaq Tasho. Liturgjia Hyjnore u zhvillua në praninë e besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën. Në këtë ditë të shënuar qenë ftuar edhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare, si dhe Trupi Diplomatik i Akredituar në Republikën e Shqipërisë, që u përfaqësua nga Ambasadori i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Rumanisë George Miku etj.⁷

Në liturgjinë hyjnore me rastin e rihapjes së kishës predikimin e mbajti teologu Dhimitër Beduli, dhe në vijim përshëndetën: përfaqësuesi i Komunitetit Bektashian Musa Mara, përfaqësuesi i Komunitetit Mysliman Islam Kadëna, Sekretari për

⁶-Nasi Hobdari, Llazar Pjeshkazini, Lëkë Tasi, Ringjallja e Kishës së Ungjillëzimit në Tiranë, Maluka, Tiranë 2007.

⁷-Nasi Hobdari, Liturgjia e parë Hyjnore, në kishën e shndërruar në palestër, Ngjallja, prill 2006, faqe 9.

problemet fetare të Partisë Demokratike Galip Kallajxhiu dhe Ambasadori Rumun George Miku.⁸

Rikonstruksioni i kishës. Trualli mbi të cilin ishte ndërtuar kisha e “Ungjillëzimit” në Tiranë ishte pronë e Murat Spahiut dhe vëllezërve të tij. Këta të fundit sipërfaqen që zinte kisha e dhuruan si vend i shenjtë që ishte dhe pjesën tjetër e shitën me 172 \$ për metër katror. Fondet për blerjen e kishës u grumbulluan nga Fortlumturia e Tij, Kryeepiskopi Anastas. Më 10 prill 1993 përfundoi shtrimi i kishës së “Ungjillëzimit” me mermer të bardhë. Gjithashtu u shtrua edhe pagëzimorja, e cila ka një vaskë pagëzimi në formën e kryqit të veshur me mermer. Gjithshtu u vendos edhe ikonostasi i paraklisit, ikonat e të cilit u pikturuan nga ikonografi i talentuar Josif Çano. Më 24 mars 1994 në vigjilë të kremtimit të “Ungjillëzimit të Hyjlindëses” Kryeepiskopi Anastas përuroi kambanerinë e kishës, së cilës iu bë një rikonstruksion i plotë dhe u pajis me pesë kambana të reja. Më 20 dhjetor 1995 në Kishën e “Ungjillëzimit të Hyjlindëses” u vendosën ikonostasi i ri, fronti dhespotik dhe amvoni. Ikonat e ikonostasit janë pikturuar nga murgeshat e manastirit të Species në Greqi. Në 24 dhjetor 1996 në hyrje të kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë u vendos një pllakë mermeri, në të cilën shkruhet: “Kisha e Evangjelizmoit. U përtëri tërësisht pas persekutimit dhe u plotësua në vitin 1993-1996 me kujdesin dhe fondet e mbledhura nga Kryeepiskopi i Tiranës dhe gjithë Shqipërisë Anastasi”. Më 18 mars 2002 në ikonostasin e kishës së “Ungjillëzimit” u shtuan edhe katër ikona, të cilat janë punuar me mjeshtëri nga motrat e manastirit të Species. Midis tyre binte në sy ajo e “Shën Kozmait”, ikona e “Anastas Persianit”, ikona e “Shën Astit”, etj.

⁸-Nasi Hobdari, Lekë Tasi, 5-vjetori i Liturgjisë së parë, Ngjallja, prill 2006, faqe 10.

KISHA E SHËN PROKOPIT NË TIRANË

Kisha e Shën Prokopit përfundoi së ndërtuari më 20 maj të vitit 1945. Projekti i kishës u realizua nga ing. Skënder Luarasi. Guri i themelit u vu më 6 prill 1941 nga Kryeepiskopi Kristofor Kisi. Kisha ka qenë e stilit bizantin e punuar me gurë të gdhendur deri në lartësinë dy metra dhe më pas muri vazhdonte me tulla. Kisha ishte 23,5 metra e gjatë dhe 18 metra e gjerë. Dyshemeja e kishës ishte e shtruar me pllaka mermeri të bardhë. Ikonostasi gjithashtu ishte prej mermeri të bardhë dhe korniza fundore me mermer të zi. Ngjitur me kishën ishte shtëpia dykatëshe e famullitarit, e cila përbëhej nga katër dhoma dhe dy salla të mëdha. Përrurimi i kishës u bë më 20 maj 1945 nga Kryeepiskopi Kristofor Kisi.

Mbyllja. Në shënimet e tij atë Marko Papajanit thotë se më 25 maj 1960 në kryesinë e kishës u zhvillua një mbledhje, në të cilën Kryeepiskop Paisi u komunikoi vendimin e qeverisë në lidhje me prishjen e kishës. “...meqenëse në këtë vend tashti i thonë kodra e “Dëshmorëve të Kombit”, vend në të cilin ndodhet edhe kisha, parashikohet që të bëhet një park i madh për kryeqytetin me liqenin artificial, kopshtin zoologjik, ambiente të tjera sportive dhe për dëfrime, hotele, bufera etj....me një fjalë kisha e “Shën Prokopit”, nuk mund të qëndrojë më në atë vend, ku është ndërtuar dhe aq më tepër që do të bëhet më shumë vend dëfrimi dhe hareje, se sa vend faljeje, gjë kjo që e humbet kuptimin e adhurimit e faljes.... “. Më 20 tetor 1960 u hartua akti zyrtar i shpronësimit dhe menjëherë filloi zbrazja e kishës nga orenditë. Të gjitha objektet e shenjta, si ikonat, veshjet klerikale, disko-potirat, triqerët etj, u shpunë në kishën e “Ungjillëzimit të Hyjlindëses”. Froni dhespotik gjithashtu u vendos në kishën e “Ungjillëzimit”. Orenditë e tjera si tavolina, dollapë, karrige etj, u vendosën përkohësisht në dhomën e

shërbyesit, ndërsa një pjesë orendive iu dhurua manastirit të “Shën Vlashit”.⁹

Rihapja. Në ditët e lirisë fetare filluan shërbesat e para të shkallët e kishës së “Shën Prokopit”, e cila vazhdonte të ishte restorant. Për të sensibilizuar opinionin publik për këtë padrejtësi, Kryeepiskopi Anastas më la detyrë që të shkruaja diçka rreth kremtimit të parë të “Shën Prokopit”. Në gazetën “Rilindja Demokratike” të datës 11 korrik 1992, në okelion “Kronikë Fetare” kam shkruar: “Në pasditen e 7 korrikut 1992 grupe besimtarësh drejtoreshin për nga kodrat e liqenit artificial të Tiranës, pikërisht në vendin ku më parë ka qenë Kisha e Shën Prokopit (1941-1967). Nga komuniteti ortodoks i Tiranës, Shën Prokopi festohet në mënyrë të veçantë, sepse ky i shenjtë është zgjedhur si mbrojtës i qytetit të tyre. Ceremonitë fetare i kryesoi Kryeepiskopi i Titranës dhe i gjithë Shqipërisë, Kryehirësia e Tij, Imzot Anastas Janullatos. Merte pjesë edhe drejtori i seminarit teologjik “Ngjallja”, bashkatdhetari ynë nga SHBA, atë Ilia Ketri. Në përfundim të meshës hyjnore të gjithë besimtarët e klerikët me kryehirësinë e tij në krye, sipas një tradite të vjetër bënë litaninë kishtare duke ardhur rrotull kishës së Shën Prokopit dhe duke iu lutur Zotit për mbrojtjen e qytetit të tyre”.¹⁰

Kthimi i kishës ishte motivi i manifestimit të madh të datës 14 mars 1994, që nisi udhën nga kisha e “Ungjillëzimit” për në kishën e “Shën Prokopit”, e cila vazhdonte të ishte restorant. Menjëherë pas liturgjisë hyjnore, të rinjtë ortodoksë me ikona ndër duar të paraprirë nga kryqi, të cilin e mbante Kristi Çuko, me mbështetjen e qindra besimtarëve u ndeshën me policinë në përpjekje për të futur kryqin në kishë, e cila vazhdonte të përdhosej duke qenë vend dëfrimi. Vargu i gjatë i besimtarëve me të mbërritur

⁹-Kristofor Beduli, At Marko Papajani dhe shënimet e tij, Neraida, Tiranë 2004, faqe 55-60.

¹⁰-Andrea Llukani, Kronikë Fetare, Rilindja Demokratike, 11 korrik 1992, faqe 2.

te kisha e “Shën Prokopit” bëri një litani përreth kishës dhe më pas mori pjesë në shërbesën e Bekimit të Ujit, e cila u krye nga atë Jani Trebicka, atë Martin Rici dhe dhjak Sotir Xhaferri. Besimtarët iu lutën Shën Prokopit, i cili është edhe shenjtori mbrojtës i bashkësisë ortodokse të Tiranës me qëllim që tu kthehej kisha. Në fund u lexua një peticion drejtuar autoriteteve qeveritare.¹¹

Autoritetet të shtyrë nga interesa vetjake, nuk dëshironin që ta kthenin kishën, kështu më datën 13 prill 1993, 21 të rinj ortodoksë u futën në argjërime dhe lutje në kishën e “Ungjillëzimit” për të kërkuar kthimin e pronave të kishës. Ata nëpërmjet një komunikate u bënë thirrje të krishterëve dhe gjithë popullit shqiptar: “Të na mbështesni dhe të bashkoheni me ne, në lutjet drejtuar Zotit, Jisu Krisht që t’u ndriçojë mendjen qeveritarëve tanë për të na rikthyer kishat, manastiret, pasuritë dhe pronat tona shekullore, që mbahen akoma të sekuestruara pa të drejtë nga kjo qeveri demokratike. Lusim Zotin së bashku që festën e Pashkëve ta festojmë me rikthimin e të gjitha kishave, manastireve dhe pronave tona”.¹²

Zemrat e ndezura të rinisë ortodokse ishin të ndezura për të kërkuar deri në fund të drejtën e tyre të ligjshme, prandaj ata hynë në kishën e “Ungjillëzimit” për argjërime shpirtërore. Kështu u motivua qëndrimi në kishë, që zgjati disa ditë. Përbërja e të rinjve pjesëmarrës ishte e ndryshme, kishte të rinj nga rinia ortodokse me kryetar Andi Nikollën, nga grupi i Ollgës nën udhëheqjen e Miron Çakos dhe grupimin e tretë e përbënin studentët e teologjisë Artem Cici, Jorgo Papadhollu, Foti Cici dhe Andrea Llukani, të cilët sapo qenë kthyer për pushimet e pashkëve. Gjatë ditëve të argjërimit shpirtëror të rinjtë luteshin vazhdimisht. Këto veprime të studentëve ortodoksë zgjuan vëmendjen e opinionit shqiptar

¹¹-Kristina Hanxhari, Efrosina Noti, Shën Prokopi u përket besimtarëve ortodoks, Ngjallja, mars 1993, faqe 3.

¹²-Të rinjtë ortodoksë kërkojnë kthimin e pronave të kishës, Ngjallja, prill 1993, faqe 6.

dhe qeveritarët qenë të detyruar që të bënin diçka. Lekë Tasi dhe Aleko Dhima shkuan për të dorëzuar komunikatën e të rinjve në zyrën e kryeministrit Aleksandër Meksi, por ishte e pamundur që të hynin. Gjithsesi Aleko Dhima mundi të hynte në zyrën e kryeministrit Meksi, i cili duke e parë që nuk mund ta shtynte më çështjen, përgatiti aty për aty vendimin dhe pasi e firmosi ia dha duke e përgëzuar. Lajmin e gëzueshëm për marrjen e kishës së “Shën Prokopit” e dha Kryeepiskopi Anastas, i cili gjatë predikimit në liturgjinë hyjnore të datës 1 gusht 1993 njoftoi besimtarët, të cilët e pritën me duartrokkitje të nxehta. Me rastin e rimarrjes së kishës së “Shën Prokopit” më 15 gusht 1993 Fortlumturia e Tij, bëri përrurimin duke celebruar Liturgjinë Hyjnore. Në predikimin e Tij, Kryeepiskopi Anastas ndër të tjera tha: “Morëm truallin, por duhet të ngrihet një kishë e bukur më e mirë se çka qenë më parë. Mund të jemi të varfër, por kur jemi të pasur në besim mos u shqetësoni. Le të shohim dhe shumë mrekulli të tjera. Dua të falënderoj të gjithë ata që u përpoqën për këtë ditë”.¹³

PARAKLISI I AMFITEATRIT TË DURRËSIT

Paraklisi i amfiteatrit të Durrësit është ndërtuar në shek. II. Paraklisi është ndërtuar mbi murin e korridoreve të amfiteatrit. Ai ka planimetri katërkëndëshi me një apsidë gjysmëcilindrike dhe me dy dritare të harkuara nga sipër. Muret e paraklisit janë të ndërtuar me gurë dhe tulla. Pranë hyrjes veriore të paraklisit gjendet vaska e pagëzimit. Në paraklisin e amfiteatrit të Durrësit gjenden dy panele mozaiku.¹⁴

¹³-Tiranasi falënderojnë Perëndinë për kishën që iu kthye, Ngjallja, shtator 1993, faqe 3,8.

¹⁴-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 36-37.

Mozaiku i murit jugor ka përmasa 2.25x1.06 metra. Figura kryesore është perandori i Kostandinopojës Aleksandri (912-913), i cili paraqitet i veshur me një dollamë të gjatë deri në fundin e këmbëve. Mbi kryet mban një kurorë mbretërore të stolisur me gurë perlash. Në dorën e majtë mban një glob, si simbol i pushtetit në tokë, ndërsa në dorën e djathtë mban një kryq. Në anën e djathtë të tij gjendet një mbishkrim: “O Zot ndihmo shërbëtorin tënd Aleksandrin”. Mozaiku me skenën e perandorit mund të jetë porositur prej vetë perandorit ose nga paria e qytetit të Durrësit. Anash perandorit paraqiten dy engjëj që mbajnë skeptrat ndër duar. Pranë këmbëve të perandorit paraqitet një burrë dhe një grua, të cilët janë të përkulur ndaj tij. Duke i gjykuar nga veshja ata i përkasin klasës aristokrate.

Mozaiku që gjendet në murin perëndimor ka përmasa 2.25x1.06 metra. Skena përbëhet nga pesë figura, prej të cilave ruhen vetëm tri fragmente. Duke u nisur prej nënshkrimeve paraqitet Shën Sofia dhe Shën Irini, ndërsa shenjti i tretë nuk ka nënshkrim, por dallohet që është figurë burri. Figura e katërt ka qenë një engjëll, ndërsa figura e pestë është një grua. Engjëlli identifikohet prej një flete të ruajtur prej tij, ndërsa gruaja paraqitet shumë e dëmtuar prandaj mbetet e paidentifikuar. Në anën jugore të apsidës gjendet Shën Mëria me foshnjën në duar por është e dëmtuar. Duke u nisur nga përmbajtja dhe niveli artistik i mozaikëve ata datojnë në shek. XI.¹⁵

¹⁵-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 100-108.

BAZILIKA E SHËN MËHILLIT NË ARAPAJ TË DURRËSIT

Bazilika e “Shën Mëhillit” gjendet në fshatin Arapaj të Durrësit. Kisha është një bazilikë trinefëshe dhe daton në shekullin VI. Përmasat e naosit janë 34x19.8 metra. Naosi ka qenë i shtruar me pllaka mermeri. Kisha ka qenë e ndërtuar me mure prej guri dhe rrasa tullash të lidhura me llaç gëlqeror. Nëpër muret e kishës kanë mbetur ende gjurmë të pikturës murale. Përveç mozaikut në kishën e “Shën Mëhillit” gjenden edhe fragmente skulpturash arkitekturore të ndërtimit fillestar. Bazilika e “Shën Mëhillit” në Arapaj u zbulua në vitin 1980 nga gërmimet arkeologjike.¹⁶

Në pjesën jugore të naosit gjendet një mjedis me përmasa 9x6 metra, i cili është i shtruar me dy panele mozaiku shumëngjyrësh. Mozaiku përbëhet nga figura njerëzish, figura nga bota bimore dhe shtazore si dhe figura gjeometrike. Njeri mozaik paraqet një peisazh me dy barinj dhe është i mbushur me kafshë e pemë të ndryshme, ndërsa mozaiku tjetër paraqet eukaristinë të përfytyruar me një kantharis të madh, prej të cilit dalin degë hardhie të mbushura me vile rrushi dhe anash gjenden dy kapronj. Bazilika e “Shën Mëhillit” përmendet nga Ana Komnena kur flet për luftën e bizantinëve kundër normandëve. Në betejën që u zhvillua me 18 tetor të vitit 1081 garda perandorake e Aleks Komnenit u strehua në manastirin e fortifikuar. Pasi fituan betejën me bizantinët normandët e Robert Guiskardit në ikje e sipër i vunë zjarrin bazilikës së “Shën Mëhillit”.¹⁷

¹⁶-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 27-28.

¹⁷-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 19-20.

KISHA E SHËN E PREMTE NË FSHATIN ÇETË TË KAVAJËS

Kisha e “Shën e Premtes” gjendet mbi një kodër në lindje të Kavajës. Kisha gjendet mes kurorave me ullishte të kodrave të Çetës. Kjo kishë për vlerat që mbart është shpallur monument kulture në vitin 1963. Kisha përbëhet nga nartekxi, naosi dhe altari. Në dyshtemenë e kishës gjendet e shtruar me gurë një figurë dielli në formë rrethi. Kisha e “Shën e Premtes” është e ndërtuar sipas stilit romako-gotik. Në faqen e brendshme të murit verior gjenden dy nike, të cilat mbulohen me një hark të ulët. Hyrja për në kishë bëhet nga muri perëndimor. Në anën lindore të kishës kemi apsidën drejtkëndëshe. Muret e apsidës janë ndërtuar me atë teknikë si muret e tjerë, por janë më të skuadruar. Altari ndahej nga naosi me anën e një ikonostasi të drunjtë. Tryeza e Shenjtë është e ndërtuar prej gurësh të lidhur me llaç. Kisha mbulohej nga një çati druri. Mendohet se kisha është ndërtuar rreth shekullit XIII. Mjeshtrit që kanë punuar për ndërtimin e saj duket se nuk e njihnin mirë këtë lloj arkitekture të ndërtimit.¹⁸

Për ndërtimin e kishës në popull ekzistojë gojëdhëna të ndryshme. Dikush thotë se qenë tre kalorës të kryqëzatave, të cilët përshkonin udhën Egnatia drejt Kostandinopojës dhe kaluan natën në kodrën e fshatit Çetë. Natën kishin parë të tre nga një vegim që të mos niseshin për udhë nëse nuk do të ndërtonin një kishë aty ku kaluan natën. Të nesërmen në mëngjes i rrëfyan njëri tjetrit dhe ndërtuan kishën e “Shën e Premtes”. Një gojëdhënë tjetër thotë se një vajzë e re, iu lut të atit ti ndërtonte një kishë, sepse kishte vendosur ti përkushtohej Perëndisë, duke u shërbyer njerëzve në nevojë. Sipas Theofan Popës një gojëdhënë thotë se ktitorët e kishës qenë disa tregtarë me origjinë bullgare. Këtë fakt e vërteton mishkrimi që gjendet i gdhendur në një pllakë guri mbi

¹⁸-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 184-186.

portën perëndimore të kishës: “Jan Milio, konsull dhe Gjika dhe Ruso dhe Petro, vëllezërit e tij, viti 1690, korrik 15”.¹⁹

Ky mbishkrim vërteton se kisha e “Shën e Premtes” ka qenë metoq i Patriarkanës së Ohrit dhe është rindërtuar prej saj në vitin 1690 prej konsullit të Francës, Jan Milio dhe vëllezërve të tij. Afresket e kishës janë realizuar nga vëllezërit Zografi ndërsa 16 ikonat e ikonostasit të kishës janë punuar në vitin 1767 prej Kostandin Shpatarakut. Në ikonën e madhe të Krishtit që gjendet në ikonostasin e kishës është shkruar: “Dora e jerothiakon Kostandinit, nga Shpati, viti prej Krishtit 1767”.²⁰



Në këtë kishë janë bërë shumë shërime, madje edhe në vitet e ndalimit të fesë, njerëzit vinin fshehurazi dhe në shenjë shprestarie ndiznin qirinj. Kjo kishë që i rezistoi shekujve, u dogj nga pakujdesia e dikujt. Flakët dëmtuar çatinë e kishës dhe afresket që qenë pikturuar nëpër muret anësorë. Kanë shpëtuar vetëm afresket që gjenden në altar, por si për ironi të fatit ikonostasi me gjithë ikonat e pikturuara nga Kostandin Shpataraku u zhduk nga kisha para disa vitesh.

¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.21, faqe 59.

²⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.37/b, faqe 64.

BAZILIKA E TEPES NË ELBASAN

Bazilika gjendet në kodrën Tepe në perëndim të Elbasanit. Punimet e gëimit për zbulimin e bazilikës janë realizuar në vitin 1969. Bazilika është trinefëshe. Në anën lindore të bazilikës gjendet altari me apsidën gjysmërrethore. Në shek. V kisha është përshtatur për qimitir. Në këtë kohë u murosën arkadat dhe salla qendrore u shtrua me mozaik. Mjedisi i altarit ndahej me një ikonostas guri të gdhendur. Nefet anësore u kthyen në mjedise për vënien e lipsanëve. Më vonë bazilikës iu shtua një eksonarteks në anën perëndimore, nën dyshemën e të cilit gjendeshin varre me qemer tullash. Në vitin 522 bazilika u rrënuar tërësisht nga tërmeti dhe nuk u rindërtua. Mozaiku i bazilikës së Tepesë shquhet për gërshetimin e elementëve gjeometrikë. Skena e eukaristisë është trajtuar në një sfond gurësh të bardhë. Aty këtu duken gjurmë gjethesh të pikturuara me kubikë tulle të kuq, ndërsa degët e bimës janë pikturuar me gurë të zinj. Rreth katër paneleve të mozaikut gjenden pllaka shtufi, të cilat krijojnë imazhin e një kryqi të hirtë.²¹

KISHA E SHËN MËRISË NË LAGJEN KALA TË ELBASANIT

Kisha e “Shën Marisë” gjendet në lagjen Kala të qytetit të Elbasanit. Kisha ka përmasat 27.70x12.40 metra dhe është bazilikë trinefëshe me tri apside nga lindja. Gjithashtu pjesë përbërëse e kishës janë narteksi dhe gjinekoniti. Kisha e “Shën Marisë” fillimisht është ndërtuar në vitin 1818, por pasi është diegur u rindërtua në vitin 1833. Mbi një pllakë guri të vendosur në apsidë jashtë kishës shkruhet: “U ngrit ky tempull hyjnor i nderuar me emrin e Hyjlindëses në vitin prej Krishtit 1833, duke filluar më 21 janar e

²¹-Sotir Kosta, Uliam Çikopano, Mozaiku i bazilikës paleokristiane në Tepe të Elbasanit, vlerat dhe restaurimi, Monumentet 1/1990 (39), faqe 130-136.

përfundoi më 20 maj. Kjo ngjau në ditët kur ishte peshkop i gjithhirshmi, muzikanti i shumëditur, shenjt i Durrësit, zoti Krisanth dhe në kohën e kujdestarisë së zotit Kostë Nasit, ku nxitës e shkaktar u bë doktori i shkëlqyeshëm zoti.....nga Negadha. Dhe me kontributin dhe shpenzimet e të gjithë të krishterëve të paharruar, që gjenden këtu, të cilët zoti ynë i kujtoftë në mbretëri të qiejve. Amin, 1833 maj 20. Janar 20, 1833”.²²

Teologu Theofan Popa sqaron se mitropoliti që përmendet në mbishkrim ka qenë Krisanth Karmanlisi (1770-1846), i cili ka shkruar metodën e re të paraqitjes së shenjave muzikore duke emërtuar tingujt e muzikës bizantine: Pa, Vu, Ga, Dhi, Qe, Zo, Ni. Metoda e re u miratua nga Patriarkana Ekumenike në vitin 1814. Gjithashtu emri i doktorit nga Negadha është shuar, me vendim të pleqësisë së lagjes së krishterë të kalasë, pasi ai nuk ka qenë nxitës. Shuarja e emrit të tij u bë pasi Krisanthi u transferua. Për ndërtimin e kishës punuan vllahët nga lagja e Shën Kollit. Këtë e vërteton mbishkrimi jashtë apsidës së kishës: “Duhet ditur, pra se kryemjeshtrit që ndërtuan këtë tempull të hirshëm kanë qenë Stefo, Vlashi, Mitro, Zhapa, Gjergj Batani dhe Gjon Prendi, kurse pagesa e punës së tyre ka qenë 60 tallanta”.²³

Gjithashtu rreth apsidës së kishës gjenden edhe katër mbishkrime të tjera, të cilat Theofan Popa i klasifikon në këtë mënyrë: 1-Një këngë kishtare nga libri Orologji i Madh, e cila këndohet më 13 shtator. 2-Pjesë e uratës së fundit të liturgjisë së Gojartit. 3-Kënga e tretë e zbritësores në të kremten e Ipapandisë. 4-Vargu i pestë në Himnin Akathist.²⁴

²²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.52, faqe 69-70.

²³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.53, faqe 70.

²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.54, faqe 70-71.

Ikonostasi i kishës është punuar me torno në vitin 1859 prej mjeshtër Filipit nga Reka e Dibrës. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi derën e bukur: “Ky tempull (ikonostas) u gdhend dhe u tornua në vitin 1859, në kohën e peshkopatit të Joaniqit dhe kur ishte epitrop Dhimitër Andre Kazanxhiu dhe Kostandin Andoni. U varakos më 1868 në vitet e peshkopatit të gjithëhirshmit, shenjtit të Durrësit Z.Z. Visarion, dhe kur ishin epitropë Z.Z. Kostandin Papajani, Jan Xhufka dhe Kostandin Simoni, me dëshirën e devotshme të të gjithë të krishterëve, krishtdashës të Kalasë. Dora e Josifit 1868 në muajin dhjetor, ditë 21”.²⁵ Ikona e madhe e Krishtit që gjendet në ikonostasin e kishës është pikturuar prej Mihal Anagnostit nga Samarina: “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina”.²⁶ Ikona e madhe e Shën Kostandinit dhe Elenës në ikonostasin e kishës është pikturuar prej Nikollës, birit të Mihal Zografit në vitin 1849. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi ikonë: “Dora e Nikollës, birit të Mihalit Zografit, nga Krushova, 1849”.²⁷

Rreth bazamentit të një temjanice prej argjendi është gdhendur ky mbishkrim: “Ky thimjator është i së mbishenjtës Hyjllindëses në Neokastër (Elbasan). E ka dhënë Jani, biri i Markut dhe e ka shkruar me praninë ai dhe e ëma e tij, që perëndia i ndjeftë 1729”.²⁸ Ndërsa rreth bazamentit të një kryqi prej argjendi që vendosej mbi tryezën e shenjtë shkruhet: “Ky kryq i nderuar është i prift Nikollës, birit të Prendit, nga Brodosheshi, 1748 “.²⁹

²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.63, faqe 73.

²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.79, faqe 77.

²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.58, faqe 72.

²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.26, faqe 60.

²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.29, faqe 61.

Një mbishkrim që gjendet i gdhendur në një kuti prej argjendi me reliket e Shën Gjon Vladimirit në kishën e “Shën Mërisë” na bën me dije se kutia është dhuratë nga Anastas Trikupa nga Voskopoja: “Ju dhurua nga i shumënderuari Anastas Trikupa, i mbiquajtur Kozmisk, nga Voskopoja, për kujtim të tij, igumenit të shën Gjon Vladimirit, jeromonakut Theoklitit 1768, maj 22”.³⁰ Potiri i kungimit prej argjendi është punuar nga Jakov Popa në vitin 1780. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet rreth bazamentit të potirit: “Ky potir, që u punua me asprat e kishës është i së mbishenjës së Neokastrës në kohën e epitropit Papa Stilian Nosit. Dora e Apostolit të mbiquajtur Jakovi i vogël, qershor më 1780”.³¹

Në vitin 1934 për të nderuar veprën e Kostandin Kristoforidhit, këtij dietari dhe patrioti të shquar, Kisha Ortodokse i ngriti një bust, i cili është akoma edhe sot në Kishën e “Shën Marisë” në Elbasan.

KISHA E SHËN KOLLIT NË SHELCAN, ELBASAN

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në Shelcan, në krahinën malore të Shpatit në rrethin e Elbasanit. Kisha është bazilikë me përmasa 13.53x6.30 metra e përbërë nga një naos pa shtylla dhe çati me një kulm. Apsidat janë me të çara vertikale në vend të dritareve. Në pranverën e vitit 2000 kam qenë i privilegjuar kur vizitova kishat e krahinës së Shpatit, në rrethin e Elbasanit. Përshtypje të veçantë në kishën e “Shën Kollit” në Shelcan më lanë akresket e pikturuara nga Onufri. Në këtë kishë shërbente shoku im i seminarit atë Pali Qosja, i cili na priti me përzemërsinë që karakterizon shpatarakët. Afresket e kishës janë si më poshtë.

³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.38, faqe 64-65.

³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.40, faqe 65.

- Brezi i parë: dekoracion mandili
- Brezi i dytë: shenjtët paraqiten me trup
- Brezi i tretë: shenjtët paraqiten bust
- Brezi i katërt: skena biblike

Duke hyrë në anën e djathtë të portës paraqiten:1-Shën Kristofori, 2-Shën Marina, 3-Shën Zosima, 4-Maria Egjiptiana, 5-Shën Aleks, 6-Joan Vladimiri, 7-Shën Trifoni, 8-Shën Mërkuri, 9-Shën Minai, 10-Shën Jakobi, 11-Shën Nikita, 12-Shën Parashqevia, 13-Shën Nikolla, 14-Petro i Aleksandrisë.

Duke hyrë në anën e majtë të portës paraqiten:15-Kostandini dhe Helena, 16-Shën Kiriaku, 17-Shën Efthimi, 18-Shën Sava, 19-Shën Andoni, 20-Profeti Ilija, 21-Anargjend Damiani, 22-Anargjend Kozmai, 23-Teodor Tironi, 24-Teodor Stratilati, 25-Shën Prokopi, 26-Shën Nestori, 27-Shën Dhimitri, 28-Shën Gjergji, 29-Kryeengjëlli Mihail.

Paraqitje bust. Sipër derës dhe në anën e djathtë paraqiten:1-Shën Varvara, 2-Teodos Kinovjarku, 3-Pavli i Thjeshtë, 4-Shën Makriani, 5-Joan Kaliviti, 6-Shën Pahomi, 7-Kryeengjëlli Gabriel, 8-Shën Nikita, 9-Shën Aleksandri, 10-Shën Serxhi, 11-Shën Anania, 12-Kryeengjëlli Mikail.

Sipër derës dhe në anën e majtë paraqiten: 13-Shën Ekaterina, 14-Shën Anastasia, 15-Shën Irini, 16-Shën Theopisti, 17-Shën Agapi, 18-Dielli (Ilios), 19-Shën Viktori, 20-Shën Vinçenti, 21-Shën Evgjeni, 22-Shën Mario, 23-Shën Oresti, 24-Shën Afksenti, 25-Shën Julia, 26-Shën Kiriku, 27-Shën Pandelejmoni, 28-Shën Nikolla, 29-Makari i Egjiptit, 30-Dielli (Ilios).

Skena Biblike: 1-Ungjillëzimi i Hyjlindëses, 2-Krishtlindja, 3-Paraqitja në tempull, 4-Pagëzimi, 5-Ngjallja e L Lazarit, 6-Hyrja në Jerusalem, 7-Darka mistike, 8-Shërbimi i tre engjëjve nga Abrahami dhe Sara, 9-Fjetja e Hyjlindëses, 10-Tradhëtia e Judës, 11-Krishti para Pilatit, 12-Kryqëzimi, 13-Vajtimi i grave

miroprurëse, 14-Krishti i shfaqet Maria Magdalenës, 15-Zbritja në had, 16-Analipsi.

Në kishën e “Shën Kollit” gjenden shtatë mbishkrime, të cilat ndahen në dy grupe: 1) mbishkrime që bëjnë fjalë për ikonografin dhe kohën e pikturimit të afreskave dhe 2) mbishkrime me fragmente psalmesh dhe lutjesh liturgjike. Nga mbishkrimet që gjenden në kishë mësohet se ajo është pikturuar së pari në vitin 1554 nga Onufri. Në vitin 1951 një ekspeditë e Institutit të Shkencave, e drejtuar nga teologu Theofan Popa, zbuloi në kishën e Shën Kollit në Shelcan një mbishkrim të Onufrit. Mbishkrimi është shkruar në greqishten bizantine nga dora e mjeshtrit të madh Onufrit dhe gjendet mbi faqen e murit verior të kishës, pranë tryezës së thisiastirit: “Kur të ngresh duart e tua te Perëndia o meshtar i Perëndisë, më përmend edhe mua mëkatarin dhe të paditurin piktor Onufirin”.³²



Kisha e “Shën Kollit” është pikturuar në gjysmën e saj perëndimore prej një piktori anonim në vitin 1625 me shpenzimet e arhondit Haxhi Gjika. “Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “Ky tempull është i atit tonë ndër shenjtorë, shën Kollit, peshkopit të Mirës së Likisë,

³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.7, faqe 52.

çudibërësit. U pikturua me shpenzimet e të shumënderuarit dhe shumë fisnikut arkond, zotit Gjika, sekretar nga qyteti i Elbasanit duke dhënë gjashtëmijë e katërqind aspra për shpëtimin e shpirtit dhe të trupit; dhe perëndia e Nikollës i dhëntë atij dhjetramijë pasuri dhe nëse ndokush do të prishë pikturën, pastë akuzues Shën Kollin, ditën e gjyqit. Në vitin 7133(=1625)”³³

Fakti që kisha është pikturuar në gjysmën e saj perëndimore prej një piktori anonim në vitin 1625 na bën të mendojmë se Onufri nuk e pikturoi të gjithë kishën, por e la punën përgjysmë? Në këtë mbishkrim thuhet se arhondi Haxhi Gjika ofroi 6400 aspra, një shumë e konsiderueshme për kohën. Mbishkrimi përfundon me formulën e mallkimit, me anën e së cilës u bëhet me dije brezave të ardhshëm që të mos i shkatërrojnë afresket e kishës. Kjo është një trashëgimi e artit të Onufrit, por edhe e piktorit anonim që pikturoi gjysmën perëndimore të kishës në vitin 1625.³⁴

Siç e përmendëm edhe mësipër në kishën e “Shën Kollit” në Shelcan gjenden edhe disa mbishkrime me fragmente psalmesh dhe lutjesh liturgjike. Në pjesën e sipërme të ikonostasit prej muri Onufri ka shkruar një lutje nga liturgjia hyjnore e Gojartit: “Në shkëlqimet e shenjtoreve të tu, si do të hyj unë i pavyeri? Se, në gëzofsha të hyj bashkë më nusërore, këmisha më tregon se s’është e dasmës, dhe i lidhur do të nxirrem jashtë nga engjëjt. Spastro o zot ndyrësitë e shpirtit tim dhe shpëtomë si i vetëm i mëshirshëm dhe njeridashës”. Gjithashtu në pjesën e sipërme të faqes lindore të ikonostasit prej muri, Onufri ka shkruar një lutje liturgjike nga libri i Shërbesave të Shenjta: “O zot, perëndia jonë, shpëto popullin tënd dhe bejote trashëgimin tënd; gjithë besnikët e kishës tënde ruaji, shënjtëro ata që dëshirojnë mirësinë e shtëpisë tënde. Ti lavdëroi ata”. Mbi derën e bukur të ikonostasit të kishës Onufri ka

³³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.17, faqe 57.

³⁴-Moikom Zeqo, Mes laokontit dhe Krishtit, Medaur, Tiranë 200, faqe 18-19.

shkruar pjesë nga psalmi 24: “Ngreni ju o sundimtarë tanë dhe lartësohuni, o dyer të përjetshme dhe do të hyjë mbreti i lavdisë, Zot i fortë dhe i fuqishëm në luftë, ky është Mbreti i lavdisë, zot i fuqijve”. Gjithashtu mbi derën veriore të ikonastasis brenda në kungë Onufri ka shkruar një lutje liturgjike nga mesha peshkopale: “O zot, o zot, shtjerë sytë prej qiellit dhe vështro, vizito këtë vreshtë dhe rregulloje atë që e mbolli e djathta jote dhe me birin e njeriut mbi të cilin e mbështete veten tënde”. Rreth apsidës nën skenën e Platiterës në kungë Onufri ka shkruar një lutje liturgjike: “U bë barku yt (o Hyjlindëse) tryezë e shenjtë, që ka bukën qiellore, Krishtin perëndinë tonë, nga e cila kushdo që ha nuk vdes, sikurse ka thënë ati ushqyesi i të gjithëve”.³⁵

KISHA E SHËN E PREMTE NË VALËSH, ELBASAN

Kisha e “Shën e Premtes” gjendet në fshatin Valësh të krahinës së Shpatit në rrethin e Elbasanit. Kisha është bazilikë me përmasa 7x2.50 metra e përbërë nga një naos pa shtylla me çati me një kulm. Apsidat janë me të çara vertikale në vend të dritareve. Kisha është pikturuar nga dora e Onufrit në vitin 1554. Pasi përfundoi së pikturuar afresket e kishës së “Shën Kollit” në Shelcan, dora e Onufrit ka pikturuar afresket e kishës së “Shën e Premtes” në fshatin Valësh të Shpatit. Në mbishkrimin e Shelcanit Onufri ka qenë ende laik, ndërsa në mbishkrimin që gjendet në Valësh ai është dorëzuar prift madje ka marrë edhe ofiqin protopapë që do të thotë prift i parë. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim në greqishten bizantine nga dora e mjeshtrit të madh Onufrit në faqen e murit, në vendin e prothesit: “Kur të ngresh duart e tua nga Perëndia o meshtar i Perëndisë, më përmend dhe mua mëkatarin,

³⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.12, faqe 54.

prift Onufrin, piktorin dhe protopapë të Neokastrës (Elbasanit)”³⁶ Nga mbishkrimi del se Onufri ka qenë klerik, madje me ofiqin “Protopapë” që do të thotë “Prift i parë”. Ky fakt na jep të kuptojmë se detyra kryesore e një kleriku në kishën ortodokse janë shërbesat e shenjta dhe gjatë kohës që i ngelej Onufri merrej me ikonografi. Kisha e “Shën e Premtes” në fshatin Valësh të Shpatit u pikturua me shpenzimet e prift Gjergj Logothesit në vitin 1554. Kjo vërtetohet nga mbishkrimi i pikturuar në pjesën veriore të faqes së murit perëndimor të kishës: “...u shtua nga katundi i valshakëve dhe është pikturuar me shpenzimetdhe fort i devotshmi prift Gjergj i Logothesit ka dhënë e oblla.....(ju) të Neokastrës që e vështroni lutuni për zotërinë që ka dhënë dhuratën, në vitin 7062 (=1554) cikël (të diellit), 12, cikël (të hënës)...”³⁷ Nga mbishkrimi kuptojmë se Gjergj Logothesi ka qenë prifti i kishës së “Shën e Premtes”. Mbishkrimi gjithashtu na bën me dije se ai ka paguar “oblla”, një lloj paraje që përdorej në Bizant. Në vitin 1554 “obllat” kishin dalë nga qarkullimi dhe monedhat që qarkullonin qenë akçe, aspra ose dukate venedikase. Në këtë rast “obllat” nënkuptonin monedhat e kujtesës, pra florinj të trashëguar nga ndonjë thesar i marrë nga Kostandinopoja pas largimit të familjes së Logothesëve. Me këtë sasi “obllash” është paguar puna e Onufrit.³⁸ Në pjesën jugore të faqes së murit perëndimor të kishës gjendet një mbishkrim, i cili na bën me dije së katundi i valshakëve këtë kishë ia kushton dëshmores së madhe Shën e Premtes: “Ky tempul i shenjtë i dëshmores së madhe Shën e Premtes.....me dëshirë të këtij katundi.....26 piktor Onufri... “³⁹

³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.14, faqe 55.

³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.13, faqe 55.

³⁸-Moikom Zeqo, Mes laokontit dhe Krishtit, Medaur, Tiranë 200, faqe 17.

³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.15, faqe 56.

Në pranverën e vitit 2000 kam marrë pjesë në një ekspeditë kërkimore nëpër kishat e krahinës së Shpatit, në rrethin e Elbasanit. Në shoqërinë e mikut tim të përkorë atë Pali Qosja, vizituam kishën e “Shën e Premtes” në fshatin Valësh dhe u mrekulluam nga afresket pikturuar nga dora e protopapë Onufrit. Ndonëse fshati Valësh në Shpat të Elbasanit përbëhet vetëm nga 70 shtëpi në të gjenden dy kisha në një distancë rreth 15 minuta nga njera tjetra, kisha e “Shën Kollit” dhe kisha e “Shën e Premtes”.



Ikonostasi i kishës së “Shën e Premtes” është prej muri të suvatuar me lartësi rreth dy metra. Ai është i pikturuar edhe nga ana e brendshme e altarit. Në murin verior të altarit Onufri ka pikturuar Krishtin, i cili është duke i treguar rrobën e shqyer Pjetrit të Aleksandrisë. Afresket kanë një lidhje harmonike me njera tjetrën. Në anën e majtë të skenës “Krishti në varr” paraqitet kryedhjakon Stefani, i cili vështron Krishtin, ndërsa në anën e djathtë është pikturuar Stiliti që sodit Jisuin. Afresku kryesor i apsidës është Platitera, ndërsa Grigor Teologu është kthyer nga ajo dhe duke hapur pergamenin lëçit himnin falenderues për të. Paraqitja e Grigor Teologut është afresku më i përkryer që ka pikturuar dora e mjeshtrit më të madh të ikonografisë shqiptare protopapë Onufrit.⁴

⁴⁰-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar, 55, Tiranë 2005, faqe 26-27.

MANASTIRET E MITROPOLISË SË TIRANËS DHE TË DURRËSIT

1. Manastiri i Shën Gjon Vladimirit gjendet në perëndim të Elbasanit. Sipas një gojëdhëne kisha është ngritur mbi themelet e kishës së “Trinisë së Shenjtë”, e cila u shemb nga tërmeti. Më 22 maj 1015 u martirizua Gjon Vladimiri dhe u varros në këtë kishë. Varri i tij u bë burim shërimesh për të gjithë ata që shkonin dhe luteshin aty. Në vitin 1381, Karl Topia dhe i biri i tij Gjergji ndërtuan manastirin e “Shën Gjon Vladimirit”. Në një mbishkrim me përmasa 2.20x0.27 metra, që gjendet i gdhendur në gurin e madh arkitra të portalit të derës jugore të kishës thuhet: “Duhet ditur se ky tempull u shemb nga tërmeti, deri në themel, gjatë sundimit dhe në ditët kur zotëronte mbi të gjithë vendin e Albanit i ndrituri Karl Topia i parë, nip dhe prej gjaku i mbretit të Francës. Ky e ndërtoi këtë tempull të gjithënderuar të shën Gjon Vladimirit dhe e ngriti prej themeli deri në mbarim nga besimi dhe zemra e përvëluar. Prej lindjes së Krishtit deri në ndërtimin e tempullit janë vjet 1380 dhe prej krijimit të botës janë vjetë 6890 dhe deri atëherë vjet 22 të zotërimit të tij, indikti 5, cikli i diellit 1, cikli i hënës 14, dhe është ndërtuar tempulli që shikon katër herë më i madh se ka qenë më parë tempulli i vjetër”.⁴¹

Kisha gjendet në anën veriore të manastirit. Ajo është e tipit së bazilikës e ndarë në tri nefe me dy rreshta kolonash. Manastiri është i rrethuar me mure. Në një mbishkrim në serbisht, i cili gjendet mbi gurin e madh të portalit të derës jugore të kishës thuhet: “Këtë kishë të shenjtë të Gjon Vladimirit e ka ndërtuar Karl Topia, Zoti i Arbërit, në të 22-tin vit të zotërimit të tij dhe e mbaroi atë në të 24-tin vit të zotërimit të tij”.⁴²

⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.2, faqe 49-50.

⁴²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.4, faqe 51.

Karl Topia është bërë zot i Shqipërisë së Mesme në vitin 1359. Mbi një gur të murosur në murin jugor të manastirit gjendet stema e Karl Topisë, e cila përbëhet prej një fushe katrore të ndarë në mes, ku janë gdhendur pesë kryqe, nga të cilët ai i mesit përfshihet brenda një rrethi. Sipër gurit është gdhendur përkrenarja, nga e cila derdhen zambakë, që tregojnë lidhjen e princit shqiptar me princat e Francës. Mbi përkrenare shquhen dy luanë me këmbët e para të ngritura lart dhe me gojën e hapur. Kjo stemë ka qenë një gur që vendosej përsipër varrit dhe vërteton se Karl Topia si ktitor i manastirit ka qenë varrosur aty. Guri ka përmasa 0.98x0.68 metra dhe mban këtë mbishkrim: “Këto janë shenjat e zotit të madh Karl Topisë”.⁴³



Në një mbishkrim tjetër të gdhendur mbi një pllakë mermeri me përmasa 50x48 centimetra që gjendet e murosur në anën jugore të kishës shkruhet: “Në vitin e mishërimit të zotit tonë Jesu Krisht 1381, indikti 5, kur zotëronte në Shqipëri shumë i kthjellti princi zoti Karl Topia i parë, prej shtëpisë së Francës, në vitin XXII të zotërimit të tij dhe me të birin e tij shumë të ndriturin, të parëlindurin zotin Gjergj ka ndërtuar këtë kishë”.⁴⁴

⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.5, faqe 52.

⁴⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.3, faqe 50-51.

Mbishkrimet dhe stema vërtetojnë marrëdhëniet e princëve shqiptarë me kishën ortodokse. Në vitin 1741 në Voskopojë është botuar “Akoluthia e Shën Gjon Vladimirit”, ndërsa në shekullin XVIII ikonografi Kostandin Shpataraku e stolisi kishën e manastirit me ikona të një vlere të lartë artistike. Mbi ikonën e Shën Kollit gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Suta, i Xhimxhit Dhespinës, për shpëtimin e shpirtit dhe kujtimin e tij 1795, mars 15”.⁴⁵ Ndërsa mbi ikonën e Shën Thanasit gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, Prend Nishkut dhe bijve të tij, Markut e Athanasit, 1795 prill 20”.⁴⁶ Në ikonën e Shën Gjergjit shkruhet: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Dhimitrit dhe Gjergjit të Prend Gjijungit 1795 prill 10”.⁴⁷ Ndërsa mbi ikonën e Shën Harallambit është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, Mark Athanasit dhe Prend Nishkut, 1795 prill 4”.⁴⁸

Në vitin 1856 brenda oborrit të kishës u ndërtua një pus. Këtë e vërteton një pllakë guri e gdhendur që gjendet mbi faqen e murit në qemer: “Viti 1865 nëntor 8. Ktitor është arkimandriti, igumeni Haxhi Grigori meshtari, Murgesha Magdalena për tu treguar brezave të ardhshëm, kryemjeshtër është Athanasi dhe Stojani”.⁴⁹

Manatiri ka qenë qendër e rëndësishme për shkrimet shqipe. Aty kanë punuar dhe jetuar personalitete të fuqishme të kohës si Dhaskal Todri, Imzot Visarion Xhuvani etj. Në të kremten e shenjtit në manastir bëhej panair i madh, prandaj thirrej paria e disa

⁴⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.44, faqe 66.

⁴⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.45, faqe 67.

⁴⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.46, faqe 67.

⁴⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.47, faqe 67.

⁴⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.61, faqe 72-73.

qyteteve, të cilëve u bëhej një pritje madhështore dhe gostitëshin mirë. Sipas Hahnit panairi bëhej dy herë në vit, më 22 maj dhe më 4 qershor. Panairi zgjaste tri ditë ku pelegrinëve u servirej bukë, ujë, ullinj dhe djathë. Pelegrinët hidhnin ndonjë lek aq sa e kishin taksur. Paratë i mbliidhte kujdestari i manastirit. Në panairin që bëhej në manastirin e Gjon Vladimirit kujdestaria e parë i takonte Durrësit, e dyta Kavajës dhe e treta Tiranës.⁵⁰

Arka ku ruheshin lipsanet e Gjon Vladimirit është grabitur prej çetave të mercenarëve, të cilët luftonin kundër Qose pashës, serasqerit të Manastirit. Grabitësit, pasi hapën varrin e shenjtit morën stolitë prej sermi, sepse koka e Gjon Vladimirit ishte e derdhur në serm. Vite më vonë besimtarët elbasanas i blenë lipsanet e shenjtit kundrejt shumë prej 700 pjastrash. Arka ku ruhen lipsanët është futur në një varr prej guri, mbi të cilin janë skalitur skena nga jeta e shenjtit.⁵¹

Gjithashtu edhe frankët u përpoqën të grabisnin reliket e shenjtit, por dështuan. Gjatë luftës së dytë botërore në vitin 1944 manastiri është djegur. Gjithashtu edhe gjatë viteve të persekutimit ateist manastiri ka pësuar dëmtime. Manastiri i Shën Gjon Vladimirit ka qenë qendër shpirtërore dhe kulturore jo vetëm për rrethin e Elbasanit, por edhe për tërë Mitropolinë e Tiranës dhe Durrësit.⁵²

Pas prishjes së kishave më 1967 manastiri i “Shën Gjon Vladimirit” u kthye në repart ushtarak. Në ato vite dëmtimet qenë nga më mizoret dhe manastiri rrezikonte identitetin. Ndërkohë arka me lipsanet e shenjtit u vendos në kishën e “Shën Mërisë” në lagjen Kala të Elbasanit. Në ditët e para të lirisë fetare mbi rrënojat

⁵⁰-Johan Georg von Hahn, Studime Shqiptare, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë 2007, faqe 233.

⁵¹-Johan Georg von Hahn, Studime Shqiptare, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë 2007, faqe 122.

⁵²-Gentian Joan Stratobërdha, Shën Joan Vladimiri, një kishë tjetër në restaurim, Ngjallja, nëntor 2004, faqe 5-6.


e manastirit filluan të kryheshin ceremonitë fetare, por njerëz të papërgjegjshëm kanë dashur që ta privatizonin. Këmbëngulja e besimtarëve bëri që manastiri të rigjallërohej. Në vitin 1994 kisha e “Shën Mërisë” u zu me forcë nga Nikolla Marku, megjithatë lipsanet e shenjtit nuk u prekën. Me trazirat e vitit 1997 lipsanët e shenjtit rrezikoheshin të grabiteshin, prandaj një grup besimtarësh i kërkuan lipsanët për në panairin që celebruhej në manastirin e “Gjon Vladimirit” dhe prej panairit u transferuan në Tiranë nga protoprezviter Jani Trebicka. Sot lipsanet e Gjon Vladimirit ruhen në kishëzën e Kryepiskopatës së Hirëshme në Tiranë. Në ditën e panairit transferohen për në manastirin e “Gjon Vladimirit” për t’u falur besimtarët. Shërbesa e Gjon Vladimirit (dygjuhëshe shqip dhe greqisht) është ribotuar nga autori i këtij libri në vitin 2012.

2. Manastiri i Shën Vlashit gjendet mbi një kodër në mes të fshatit me të njëjtin emër, në juglindje të Durrësit. Kremton dy herë, më 15 gusht dhe në të kremten e Shën Vlashit më 11 shkurt. Kisha katedrale e manastirit mendohet të jetë ndërtuar në shekullin XVI. Sipas Theofan Popës ikonat e ikonostasit të kishës janë pikturuar nga një piktor anonim. Në ikonën e Shën Vlashit shënohet viti 1696. Po në këtë vit mendohet se janë pikturuar edhe ikonat e tjera të ikonostasit.⁵³ Përreth kishës ekzistonin dy ndërtesa të ndërtuara me donacionet e besimtarëve durrsakë. Njëra ndërtesë prej Vasil Vasës dhe tjetra prej Mihal Kapedanit. Në manastir ndodhej guri i shenjtë mrekullibërës, ku besimtarë të shumtë nga e gjithë Shqipëria vinin e ndiznin qirinj te vendi i shenjtë, me shpresë dhe besim se do t’u lehtësoheshin vuajtjet. Manastiri i “Shën Vlashit” arriti kulmin e lulëzimit të tij në vitet 1920-1930 kur u forcua shumë nga ana ekonomike.⁵⁴ Në vitin 1950 në manastirin e “Shën Vlashit” qenë strehuar 17 murgesha dhe një

⁵³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.24, faqe 60.

⁵⁴-Petraq Jorgoni, Kremtimi i festës së Shën Vlashit në Durrës, Ngjallja, shkurt 1993, faqe 6.

prift rus. Sipas një shkresë që kemi gjetur në Arkivin e Shtetit më 29 maj të vitit 1951 një delegacion i kishës ruse, në përbërje të së cilit qenë peshkopi i Odesës, Nikon dhe ekzarku i Dioqezës së Moskës Pavël Cvetkov, vizitoi manastirin e “Shën Vlashit”, ku u prit për zemërsisht nga murgeshat ruse, të cilat nën udhëheqjen e igumenes Maria këndonin psalmin “Engjëlli thërriste”. Pas tedeumit që u celebrua në kishën e manastirit u shtrua një drekë. Murgeshat ruse e përcollën delegacionin deri në rëzë të kodrës duke psallur kanonet e Pashkës.⁵⁵



Më 27 shkurt të vitit 1967 të rinjtë durrsakë, të nxitur nga Komiteti Qendror i Partisë, duke zbatuar dekretin “Për luftën kundër fesë dhe paragjyqimeve fetare” i vunë kazmën manastirit duke e shkatërruar atë plotësisht. Gjithashtu për ta shuar nga kujtesa e popullit emrin e manastirit, ia ndërruan emrin fshatit nga Shën Vlash në Vrinë. Nga manastiri i vjetër kishin mbetur vetëm gërmadhat e ndërtesës së igumenisë. Në verën e vitit 1993 filloi shtrimi i 1,2 km rrugë, e cila të shpinte në manastir. Më pas filloi restaurimi i ndërtesave të vjetra. Guri i themelit në kishën e manastirit të “Shën Vlashit” u vu më 19 nëntor të vitit 1994 nga Kryepiskopi Anastas. Kisha e manastirit është e tipit monastik,

⁵⁵-Sipas shkresës me Nr. Prot. 6/54, datë 29 maj 1950.

me kryq të brendashkruar dhe ka përmasa 13x 22 metra, me pikën më të lartë 12 metra në kupolë. Hyrja për në kishë është nga ana ballore dhe nga të dy anët nën një arkadë. Kati i poshtëm i kishës përdoret si pagëzimore. Shenjtërimi i kësaj kishë u bë më 2 gusht të vitit 2001.



Banesa e murgjve është dykatëshe, me sipërfaqe 312 metra katrorë për çdo kat. Në katin e sipërm ndodhen 11 qeli murgjish të plotësuar me shërbimet hidrosanitare dhe ato të kuzhinës. Kati i poshtëm përdoret si magazinë dhe garazh. Me ringritjen e manastirit të “Shën Vlashit” u rikonstruktua edhe banesa e igumenit, e cila pas prishjes së manastirit qe përdorur për qëllime të tjera. Sot manastiri i “Shën Vlashit” është qendër e rëndësishme shpirtërore.

KREU I DYTË

MITROPOLIA E BERATIT

Në shekullin V në fronin e Perandorisë Bizantine u ngjit Pulqeria, e motra e Theodhosit të Madh. Ajo u martua me plakun Marcian dhe vizituan qytetin e Antipatreas (Beratin), të cilin e pagëzoi me emrin e saj Pulqeripolis, që do të thotë *qyteti i Pulqerias*. Kjo e fundit ndërtoi manastirin e “Shën Mërisë Vllahernës” dhe krishterimi në Episkopatën e Pulqeripolit filloi të zhvillohej. Në fillimet e shekullit IX Berati u pushtua nga sllavët, të cilët filluan që ta quajnë Beligrad. Kjo vërtetohet nga një letër që papa i Romës Joani XII i dërgon Borisit të bullgarëve duke e vlerësuar Beligradin si një seli të rëndësishme episkopale. Mirëpo me krijimin e Kryeepiskopatës së Ohrit më 1020, Berati kaloi në juridiksionin e kësaj episkopate. Mitropolia e Beratit në vitin 1767 hyri në listën e mitropolive të Kostandinopojës. Mitropolit mbante titullin: “I Përndershmi Mitropolit i Beligradit dhe i Kaninës”. Emrin Berat e mori në vitin 1431, në kohën e pushtimit osman. Pra fillimisht quhej Antipatrea, në vijim Pulqeripolis, Beligrad dhe më në fund Berat. Sipas regjistrit turk të vitit 1431, brenda murreve të kalasë jetonin 227 familje, të cilat numëronin rreth 1500 banorë.¹

¹-Arjan Kaja, Xovani Shyti, Berati, gur i rëndë në historinë e qytetërimit shqiptar, Tema, 26 dhjetor 2007, faqe 12-13.

Sipas radhës kronologjike disa nga Mitropolitët e Beratit kanë qenë: Nektari (1668), Partheni (1683), Ignati (1685), Nektari (1699), Dionisi (1710), Theodhosi (1715-1716), Niqifori (1718-1725), Kozmai (1727-1734), Metodi (1736- 1751), Joasafi (1725-1759), Efttimi i dytë (1761-1763), Partheni (1763-1765), Joasafi përsëri (1765-1767), Ioaniqi (1768-1769), Gjerasimi (1769-1772), Joasafi (1772), Meleti (1800), Joasafi (1802), Anthimi (1855), Vasili (1900), Kaliniku (1909), Ioaqimi (1911), 1911-1923 pa Mitropolit, Kristofor Kisi (1923), Agathangjel Çamçe (1929), Visarion Xhuvani (1941), Kirilli (1949), Ignat Trianti 24 qershor 1992 u bë zgjedhja dhe më 18 korrik 1998 u bë fronëzimi.²

KISHAT DHE MANASTIRET

Mitropolia e Beratit para vitit 1967 kishte 80 enori dhe katër manastire. Mitropolia ka në juridiksion këto zëvendësi episkopale vendore: Berati, Vlora, Fieri, Lushnja. Kishat dhe institucionet fetare e kësaj mitropolie sipas komunave janë:

Në Berat: Mitropolia e Beratit, kisha katedrale e Beratit, kisha e “Shën Timoteut”, kisha e “Shën Elias”, kisha e “Kryeëngjellit Mihail”, kisha e “Shën Marisë”, kisha në Gorisht, kisha e “Shën Dhimitrit”, kisha në Vokopolë.

Në Kuçovë: Kisha e “Ungjillëzimit të Hyjlindësës” në Kozarë.

Në Mallakastër: Bazilika e Ballshit, kisha e “Shpërfytyrimit të Krishtit” në Greshicë.

Në Vlorë: Manastiri i “Shën Marisë” në Zvërnec, kisha e “Shën Joan Teologut” në Zvërnec, kisha e “Shën Todrit”, kisha e “Shën Dhimitrit” në fshatin Dukat, kisha e “Shën Thanasit” në Selenicë, kisha e “Shën Parashqevisë” në Skrofotinë, kisha e “Shën

²-Maksim Çuko, Qytetërimi dhe krishterimi në Myzeqe, Tekno Peper, Tiranë 2004, faqe 42.

Spiridhonit”, kisha e “Pesë Martirëve” në Bestrovë, kisha në fshatin Mëkat, kisha e “Gjithë Shenjtorëve”.

Në Fier: Katedralja e “Shën Gjergjit”, kisha e “Shën Marisë”, kisha e “Shën Nikollës” në Vanaj, kisha e “Shën Kollit”, kisha e “Trinisë së Shenjtë”, kisha e “Kryqit të Shenjtë”, kisha e Gradishtës, kisha e “Shën Spiridonit”, kisha e “Shën Mihalit”, kisha e “Shpërfytyrimit” në fshatin Agim, kisha në Pishporo, kisha e “Shën Kozmait”.

Në Lushnjë: Manastiri “Fjetja e Hyjlindëses” në Ardenicë, kisha e “Shën Marisë”, kisha e “Shën Thanasit”, kisha e “Shën Gjergjit”, kisha e “Shën Mihalit”, kisha e “Shën Kollit”, kisha “Fjetja e Hyjlindëses” në Rrupaj, kisha e “Shën Gjergjit”, kisha e “Shën Marisë”, kisha e “Shën Parashqevisë”.

KISHAT MONUMENT KULTURE

Lushnjë. Manastiri i “Shën Mërisë” në Ardenicë, 1948, kisha e “Shën Thanasit” në Karavasta, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Bishqethëm, 1963, kisha e “Shën Kollit” në Toshkëz, 1963, kisha e “Shën Kollit” në Krutjen e Sipërme, 1963, kisha e “Shën Todrit” në Kadipashaj, 1963.

Fier. Manastiri i “Shën Mërisë” në Pojan, 1963, kisha e “Shën Kozmait” dhe “Shën Mërisë” në Kolkondas, 1963, kisha e “Shën Kollit” në Kurjan, 1963, kisha e “Shën Gjergjit” në Libofshë, 1963, kisha e “Shën Gjergjit” në Strumë, 1970, kisha e “Shën Kollit” në Vanaj, 1963, kisha e “Shën e Premtes” në Hoxharë, 1979, kisha e “Shën e Premtes” në Sop, rrënojat e bazilikës së Ballshit, bazilika A, B, C, D në Bylis.

Berat. Kisha e “Shën Mëhillit”, 1948, kisha e “Shën Triadhës” në kala, 1948, kisha e “Shën Marisë” në Mbreshtan, 1979, kisha e “Shën Marisë Vllahernës” në kala, 1948, kisha e “Ungjillëzimit” në Kozarë, 1963, kisha e “Shën Kollit” në Perondi, 1963, kisha e “Shën Mitrit” në Debranik, 1970,

kisha e “Shën Mitrit” në Poliçan, 1977, kisha e “Shën Todrit” në kala, 1948, katedralja “Fjetja e Shën Mërisë” në kala, 1948.

Vlorë. Manastiri i “Shën Mërisë” në Zvërnec, 1963, kisha e manastirit të “Panaiasë” në Dhërmi, 1963, kisha e manastirit të “Shën Mitrit” në Qeparo, 1963, kisha e “Marmiroit” në Pashaliman, 1963, kisha e “Sergjit dhe Bakut” në Himarë 1963, kisha e “Shën Mërisë së Athalit” në Himarë 1963, kisha e “Gjithë shenjtorëve” në Himarë 1970, kisha e “Shën Spiridhonit” në Vuno, 1963, kisha e “Ipapandisë” në Dhërmi, 1963, kisha e “Shën Mëhillit” në Vuno, 1963, kisha e “Mesodhisë” në Vuno, 1963, rrënojat e kishës së “Shën Stefanit” në Dhërmi, 1963, rrënojat e kishës së “Shën Kollit” në Armen, 1963, rrënojat e kishës së “Shën Ndreut” në Himarë, 1980, rrënojat e kishës së “Shën Gjergjit” në Brataj, 1980, kisha e “Shën Sotirës” në Vuno, 1979.

KISHAT E MITROPOLISË SË BERATIT

BAZILIKA B E BYLISIT

Bazilika B e Bylisit ka qenë kishë peshkopale dhe është ndërtuar gjatë viteve 470-530. Duke u nisur nga përmasat 94x40 metra kisha nxinte një numër të madh besimtarësh. Kisha është ndërtuar më gurë gëlqerorë të lidhur me llaç, ndërsa për ndërtimin e dritareve janë përdorur tullat. Dyshemeja e kishës ka qenë e shtruar me mozaikë të punuar me gurë kubikë dhe copa xhami. Mozaikët janë me motive gjeometrike, bimore, shtazore dhe me figura njerëzore. Midis mozaikëve bie në sy ai ku paraqiten dy peshkatarë. Njëri qëndron më këmbë dhe tërheq rrjetën me peshq dhe tjetri qëndron ulur dhe tërheq kallamin, grepi i të cilit ka zënë një peshk.³

³-Ilirjan Gjika, Bylisi i Ilirisë, Ymeraj, Fier 2011, faqe 29-31.

BAZILIKA E SHËN MËRISË NË BALLSH

Bazilika e Ballshit ka qenë kishë manastiri, së cilës kohë pas kohë i janë shtuar mjedise ndihmëse. Fillimisht bazilika është ndërtuar në shekullin VI dhe ka pasur dy faza rindërtimesh, në shekullin XI dhe në shekullin XII. Kisha katedrale është e tipit bazilikal trenefëshe me narteks dhe eksonarteks. Bazilika ka përmasa 22.50x17.20 metra. Secila nga nefet përfundon me apsida, dy në formë gjysmërrethore, ndërsa ajo e qendrës është trifaqëshe. Brenda absidës gjendet një podium me tri shkallë. Narteksi lidhet me naosin nëpërmjet dy portave, ndërsa një portë e tretë lidhte kishën me paraklisin. Muret e bazilikës janë ndërtuar me gurë të skuadruar të lidhur me llaç të kuqërremtë me breza tullash. Në ndërtimin e bazilikës janë përdorur materiale antike të prura nga kishat e Bylisit.⁴

Gjatë luftës së parë botërore një oficer austriak i quajtur Camillo Prashniker zbuloi në Ballsh të Mallakastrës një mbishkrim në greqishten bizantine të gdhendur në një shtyllë mermeri të lartë 1.60 metra: “U pagëzua sundimtari i Bullgarisë Borisi Car, i quajtur Mihal së bashku me popullin e tij, të dhënë prej Perëndisë në vitin 6374.” Kjo datë është dhënë sipas kalendarit bizantin ku sipas kalendarit të ri Gregorian i përket vitit 866 pas Krishtit.⁵ Pagëzimi i Borisit u bë në një ceremoni madhështore në kishën e Ballshit dhe nuni i tij u bë perandori bizantin Mihali III (842-867) me anën e një përfaqësuesi të tij. Borisi (852-889) mori emrin e nunit të tij, Mihal. Mbi një gur të bardhë gëlqeror me qoshe të rumbullakët gjendet ky mbishkrim: “O zot ndihmo shërbëtorin tënd Pakatianin krijuesdashësin, dhe shërbëtoren tënde Aglainë, porosidashësen

⁴-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 26-27.

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 82, faqe 79.

dhe të përvuajtur. Shën Andre, ndihmo shërbëtoresh tënde Pakatan”.⁶ Anët e gurit janë të zbukuruar me ornamente florale. Në faqen kryesore gjendet një kornizë e gjerë me dhëmbëza dhe një shkop margaritarësh kufizojnë një fushë të ngushtë. Poshtë gjendet një ornament hardhie i stilizuar me dy zogj të vendosur në mënyrë simetrike. Kuptimi i këtij mbishkrimi është: Pakatiano i duke iu lutur Zotit së bashku me gruan e tij Aglaia dhe të bijën Pakta, ia kushtojnë këtë kishë Shën Andreas.⁷

KISHA E KOSTANDINIT DHE ELENES NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Shën Kostandinit dhe Elenës” gjendet në kalanë e Beratit. Kisha është themeluar në vitin 1639 dhe ka përmasa 8.70x7.80 metra. Afresket e kishës janë pikturuar në vitin 1649. Ky fakt vërtetohet prej një mbishkrimi që gjendet mbi faqen e murit verior të kishës: “Është pikturuar shën Kostandini, / viti prej Krishtit 1649 / 1639”.⁸ Mbi një gur jashtë apsidës së kishës është gendur viti 1791 që tregon kohën e rindërtimit të kishës, e cila fillimisht ka qenë një paraklis i thjeshtë dhe është rindërtuar më vonë”.⁹ Mbi ikonën e madhe të Krishtit gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, prift Kristos me të shoqen dhe bijat e tij. Viti prej Krishtit 1604. Dora e Onufër Qipriotit”.¹⁰

⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 277, faqe 144-145.

⁷-Koco Zheku, krishtërimi në Shqipëri gjatë shekujve V-VI, Ngjallja, mars 1994, faqe 9.

⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 103, faqe 92.

⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 164, faqe 111.

¹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.99, faqe 90.

Ndërsa në ikonën e madhe të Shën Mërisë në ikonostas është shkruar: “Lutje e shërbëtores, priftëreshës Konteshë. Amin”.¹¹ Tek ikona e Gjon Pagëzorit gjendet ky mbishkrim: “Një qiell tjetër shoh të stolisur, ikonën tënde të nderuar pararendës i lumtur, të cilën e pikturoi me dëshirë të plotë Andrea, prift gjithashtu dhe ktitor. Dora është e Onufër Qipriotit, viti prej Krishtit 1599, në muajin shtator”.¹²

KISHA E SHËN MITRIT NË LAGJEN VAKËF TË BERATIT

Kisha e “Shën Mitrit” gjendet në lagjen “Vakëf” të Beratit. Mbi portën jugore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili vërteton se kisha është pikturuar në vitin 1607: “Ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar ku faleni është shtëpi perëndie dhe lutjeje, kërkush të mos hyjë këtu me të keq në zemër dhe të marri mallkim në vend të bekimit; u pikturua me kontributin e mëkatarit, prift Dhimitrit dhe ekonomit, famulltar në këtë tempull dhe me shpenzimet e këtij manastiri. Ju duke e lexuar këtë kondeks lutuni dhe mos mallkoni zotëritë. Në vitin 1607, muaj shtator 20”.¹³

Mbi bazamentin e një thimiatori të kishës është shkruar: “Kujto o zot shërbëtorët e tu H. Kiriu dhe Nikollën të birin me gratë dhe fëmijët. Është dhuruar në tempullin e shenjtoreve Mina Viktorit dhe Vicentit, shtator 8-1883”.¹⁴ Ndërsa mbi një kuti lipsanesh gjendet mbishkrimi: “Kjo kuti është e kishës së shenjtë

¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 282, faqe 147.

¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 98, faqe 89-90.

¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 100, faqe 91.

¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 263, faqe 141.

të shën Mërisë së Vodicës. Argjendi është dhuruar nga Haxhi Nauni dhe gruaja e tij. Kujdestar është Kostandin Osmanlliu Dh. K 1896 prill 30”.¹⁵

KISHA E SHËN TODRIT NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Shën Todrit” gjendet në hyrjen e kalasë së Beratit. Kisha është ngritur mbi themelet e një kishe të vjetër rreth shek. XVI. Afreskat e kishës janë pikturuar prej Onufrit. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajatat e mbyllura, të cilat e rrethojnë nga tri anët. Kisha mbulohet nga një çati dyujëshe e mbuluar me tjegulla. Naosi është njënefësh me përmasa të brendshme 9.0x3.60 metra. Muratura e kishës është prej gurësh të lidhur me llaç gëlqereje. Apsida është trifaqëshe dhe e zbukuruar me motive paleokristiane.¹⁶

KISHA E UNGJILLËZIMIT NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Ungjillëzimit” gjendet në kalanë e Beratit. Kisha përbëhet prej narteksit dykatësh, naosit, hajatit dhe paraklisit. Naosi është njënefësh me përmasa të brendshme 12.60x6.0 metra. Altari ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Në anën lindore të hajatit gjendet një paraklis i vogël. Kisha është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Nëpër qoshe gjenden gurë të mëdhenj dhe të gdhendur. Apsida e kishës është shtatëfaqëshe.¹⁷

¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 269, faqe 142.

¹⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 203.

¹⁷-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 203-204.

Mbi ikonën e Ungjillëzimit shkruhet: “Josif Nove. 1779. Dora e Kostë Mozesë”.¹⁸ Fjalët “Josif Nove” gjenden tek gravura mbi mbulesën prej argjendi të ikonës së Ungjillëzimit, ndërsa fjalët e tjera gjenden në breroren prej argjendi të Kryeengjellit Gabriel.

KISHA E SHËN MËRISË SË VLLAHERNËS NË BERAT

Kisha e “Shën Mërisë së Vllahernës” gjendet në anën perëndimore të kalasë së Beratit. Nuk dihet me saktësi koha e ndërtimit të kishës. Gjithashtu këto të dhëna mungojnë edhe për ktitorin dhe ndërtuesit e saj. Kisha përbëhet nga nartekxi, naosi dhe altari. Naosi është i shtruar duke krijuar një vizatim me gurë dhe tulla. Altari përbëhet nga apsida, në të cilën gjendet një dritare. Gjithashtu dy dritare të tjera gjenden në anën e apsidës. Ato janë me harqe dhe shpatulla tullash të shkallëzuara. Apsida dhe muret përfundojnë me kornizë dhëmbësharre. Muret janë punuar me teknikën e kluasonazhit. Prof. Aleksandër Meksi mendon se kisha mund të jetë ndërtuar në fillim të shekullit XIII.¹⁹

Kisha e “Shën Mërisë së Vllahernës” kremton dy herë në vit, më 2 korrik në përkujtim të vendosjes së rrobës së Hyjlindëses në Vllahernë si dhe më 31 gusht në të kremten e vendosjes së brezit të Hyjlindëses. Mbi portën perëndimore të kishës gjendet një mbishkrim, me anën e të cilit mësojmë se kisha është pikturuar nga Nikolla Onufri në vitin 1578: “Ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i së mbishenjtës së lavdëruar zonjës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari të mbiquajtur Vlaherna, është vjetëruar dhe prishur dhe e ka përtëri dhe pikturuar me dëshirë dhe shpenzime i shumëdevotshmi ndër piftërinj at kir Kostandini

¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 149, faqe 107.

¹⁹-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 215-216.

me vëllezërit e tij dhe (ju) që vështroni lutuni për zotërit; dhe piktori (është) Nikolla, biri i Onufrit, viti 7086=1578).²⁰ Gjithashtu mbi faqen e murit verior, pranë nikës së prohesit gjendet një mbishkrim tjetër: “Kur të ngresh duart e tua nga Perëndia o meshtar i Perëndisë, më kujto edhe mua mëkatarin e të paditurin piktor Nikollën. Amin”.²¹ Altari i kishës përveç apsidës ka edhe dy nika në formë konkave. Nika veriore shërben për blatën e hyjshme, ndërsa nika jugore përdoret për ruajtjen e enëve të shenjta. Afresket i përkasin periudhës së dytë pas rindërtimit të kishës. Të gjitha afresket janë pikturuar nga dora e Nikollës, birin të Onufrit në vitin 1587.²²

Mbi derën që të shpie në altar është pikturuar skena e “Krishtit foshnjë” dhe pranë tij gjendet Maria. Më tutje ikonografi Nikolla ka pikturuar skenën “Zbritja në ferr” dhe në thollon mbi tryezën e shenjtë është pikturuar “Shestja”. Në anën jugore të qemerit është pikturuar afresku i “Shën Mërisë në mes të engjëjve dhe apostujve”. Në thellësinë e apsidës gjendet “Shën Mëria e ulur mbi fron duke mbajtur Krishtin në prehër”. Anash Hyjlindëses gjenden dy engjëj në pozicion lutjeje. Nën afreskun e “Shën Mërisë” vjen skena “Kungimi i apostujve”. Në fund të apostujve që kungohen ikonografi ka pikturuar Judën, i cili paraqitet duke u larguar nga kungimi. Në vijim paraqiten hierarkë të ndryshëm si Shën Spiridhoni, Shën Gjermanoi, Kirili i Aleksandrisë etj. Rreth thisiastirit gjenden afreske të ndryshme ku më i spikaturi është “Krishti në varr”. Në naos, në anën lindore të kishës gjenden afresket e Shën Kollit, Shën Thanasit dhe Joan Pagëzorit. Në murin mbi ikonostas janë afresket e katër ungjillorëve, ndërsa nga veriu

²⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 92, faqe 86-87.

²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.93, faqe 93-94.

²²-Fatmir Thaçi, Adrian Devolli, restaurimi dhe vlerat e pikturës murore të kishës Shën Mëri Vllaherna në Berat, Monumentet 2 / 1990 (40), faqe 143.

në jug janë pikturuar skenat: “Vajtimi i Krishtit”, “Ungjillëzimi” dhe “Krishtlindja”. Në tavanin e pjesës jugore të kishës afresket me profetët janë paraqitur deri në gju. Në vijim gjejmë “Përsëndetjen e Shën Mërisë me Elisabetën” dhe pas saj vjen “Ipapandia”. Më tutje kemi afresket “Krishti i shfaqet Thomait”, “Krishti u shfaqet dishepujve”, “Krishti i shfaqet grave miroprurëse” etj. Poshtë tyre vjen brezi i medalioneve ku shenjtoret paraqiten deri në brez. Rreshti i fundit i paraqet afresket e shenjtoreve në të gjithë madhësinë e tyre Kryeengjëlli Mihail, Shën Anastasia, Shën Varvara dhe Shën Parashqevia.



Në mes të murit perëndimor të kishës gjendet një dritare dhe anash saj janë pikturuar profetët, ndërsa poshtë vijnë skenat: “Shpërfytyrimi”, “Ngjallja e Llazarit”, “Hyrja në Jeruzalem” dhe “Darka mistike”. Poshtë këtyre kemi skenat: “Banja e Siloamit”, “Lindja e Shën Mërisë” dhe “Fjetja e Shën Mërisë”. Brezi që pason paraqet medalione shenjtoreësh, ndërsa në brezin e fundit shenjtoret

paraqiten në të gjithë madhësinë e tyre, ndërmjet të cilëve tërheqin vëmendjen katër murgj me skimë të madhe si dhe Teodor Stratilati, Teodor Tironi, Kostandini dhe Elena. Në murin verior të kishës vijon vargu i profetëve, ndërsa poshtë tyre kemi skenat: “Puthja e Judës”, “Kryqëzimi” dhe “Zbritja nga kryqi”. Poshtë tyre janë pikturuar “Krishti në tempull me dijetarët”, “Krishti dhe Samaritania”, “Shërimi i të verbërit” dhe “Pesëdhjetorja”. Nën të gjendet brezi i medalioneve me portretet e shenjtorëve dhe poshtë tij kemi: Shën Pandlejmonin, Anargjendët Kozma dhe Damjan, Shën Gjergjin dhe Shën Dhimitrin. Në pikturimin e skenave biblike dhe të shenjtorëve ikonografi Nikolla përdor një kolorit të ndezur dhe të gjallë. Shenjtorët paraqiten me ngrohtësi dhe gjallëri.²³

KISHA E SHËN KOLLIT NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Shën Kollit” në kalanë e Beratit është një kishë e vogël. Kisha është rënuar dhe më pas është rindërtuar dhe pikturuar në vitin 1591. Ajo ka përmasa 8.60x5.50 metra. Kisha e “Shën Kollit” kremton më 6 dhjetor në të kremten e Shën Nikollës, episkopit të Mirës së Likisë. Një mbishkrim që gjendet mbi portën veriore të kishës na bën me dije se kisha është rindërtuar me shpenzimet e atë Kostandinit dhe të vëllezërve të tij Dhimitër dhe Jan: “Ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë, ndër shenjtorë dhe çudibërës, shën Kollë Mirovlitit është vjetëruar, prishur. E përtëriu dhe e pikturoi me dëshirë e shpenzime i shumëdevotshmi ndër priftërinj, zoti at Kostandini me të vëllezërit e tij Dhimitër dhe Jan për shpëtimin e shpirtit të ktitorëve të tij, amin. Dhe (ju) që vështroni lutuni për zotërinë, viti i Krishtit 1591”.²⁴

²³-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-biznatin shqiptar, 55, faqe 47-53.

²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 95, faqe 88-89.

Kisha është e pajisur me një ikonostas të gdhendur në dru. Ndonëse është një kishë e vogël ikonat e saj janë me vlerë artistike, sepse janë punuar nga Onufër Qiprioti. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet në ikonën e madhe të Shën Kollit në ikonostas: “Nikollë i gjithlavedëruar, shërbëtor i Krishtit...ata që i përulen ikonës tënde me kënaqësi...dhe...falu shpërblim të këndshëm përsa jetojnë, dhe tregohu mbrojtës në gjyqin e ardhshëm. U pikturua në vitin 1594 të Krishtit, në muajin nëntor...Prano o shenjt lutjet e shërbëtorëve të Perëndisë, Komninit bashkë me vëllezërit e tij Andrean dhe Nikollën dhe kushërinjtë e tjerë, dhe që të këndohet i ndjeni ata. Dora e Onufër Qipriotit”.²⁵ Në një ikonë të Shën Mërisë është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, prift Nikollës”.²⁶

Muret e kishës janë të mbuluar me afreske: Në kungë gjenden Platitera dhe në vijim hierarkët e kishës. Në naos pranë tavanit gjendet gjysëmfigurat me profetët, të cilët janë zbukuruar me bisqe e gjethe dushku. Profetët mbajnë në duar fletë pergameni të shpalosura. Brezi tjetër paraqet skenat biblike: “Lindja e Hyjlindëses”, “Marrja e uratës”, “Pagëzimi”, “Puthja e Judës”, “Kryqëzimi”, “Zbritja nga Kryqi”, “Zbritja në ferr”, “Shestja” etj. Brezi i tretë paraqet medalione të martirëve si dhe dy paraqitje të Krishtit në mandil dhe në tjegull. Afresket e kishës së “Shën Kollit” janë tërheqës dhe shpirtërorë.

KISHA E SHËN MËHILLIT NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Shën Mëhillit” gjendet në anën jugore të mureve të kalasë së Beratit. Në anën veriore kisha i është ngjitur shkëmbit. Kisha është e tipit me kryq të brendashkruar me kupolë mbi tambur.

²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 96, faqe 89.

²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 283, faqe 147.

Narteksi është i shtruar me pllaka guri. Naosi është i vogël në formë kryqi. Altari përbëhet nga apsida si dhe dy nike në anën veriore. Në apsidë gjendet një dritare. Muret e kishës janë ndërtuar me teksikën e kluasonazhit. Kisha mendohet të jetë ndërtuar para vitit 1417, sepse në këtë vit Berati u pushtua nga turqit. Nëpër muret e kishës ruhen ende gjurmë të pikturave murale që kanë qenë të pikturuara anë to.²⁷


Kisha e “Shën Mëhillit” kremton dy herë në vit, më 8 nëntor në të kremten e Kryeengjëjve Mikael dhe Gabriel si dhe më 10 korrik në të kremten e Nikodhimit të Beratit. Në këtë kishë para vitit 1967 gjendeshin lipsanet e Nikodhimit të Beratit. Në vitin 1762 lipsanet e shenjtit u vendosën në kishën e “Shën Marisë” në Mangalem. Në kohën e pushtimit fashist italian kisha e “Shën Marisë” u prish, sepse u zgjerua rruga, prandaj lipsanet e shenjtit i shpunë në kishën e “Shën Mëhillit”. Pas prishjes së kishave në vitin 1967 lipsani u shpërbë. Eshtrat i morën besimtarët me shpresë se do tu sillnin fat, ndërsa kokën e shenjtit e mori psalti Lili Thimi Koçi dhe e fshehu në murin e shtëpisë së tij për ta ruajtur nga ndonjë grabitje ose përdhosje e mundshme. Koka e shenjtit ruhet në një kuti prej argjendi, e cila peshon 755 gram. Kutia e argjendit u gdhend nga argjendarët beratas. Më 10 korrik 1991, i biri i Lili Koçit, Llazari e çmurosi kokën e shenjtit dhe e shpuri në kishë për tu falur besimtarët. Çdo 10 korrik koka e Nikodhimit të Beratit dërgohet në kishën e “Shën Mëhillit”, prej Lllazar Koçit, i cili e ruan me fanatizëm në shtëpinë e tij.²⁸

Sipas kumtimit gojor të dr. Thimi Koçit pelegrinë të shumë vijne nga Vithkuqi i Korçës, por edhe nga vise të tjera të Shqipërisë për tu falur me shprestari para kokës së shenjtit të Nikodhimit të Beratit. Shërbesa kushtuar shenjtit u shkrua nga Grigor

²⁷-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 209-211.

²⁸-Abedin Kaja, Jorgji Bendi, Shën Nikodhimi, shenjti i Beratit, Ngjallja, qershor 2007, faqe 9, 10.

Voskopojari në greqisht dhe është shtypur në Akademinë e Voskopojës më 1742. Në shërbesën kushtuar Nikodhimit të Beratit autori zbulon ndjenjat e tij patriotike kundër Perandorisë Osmane. Grigori ka shkruar “Gëzohu, o shqiptar i Shqipërisë sonë të dashur, se Shqipëria është krenare për ty”. Gjithashtu tek përlëshorja Grigori ka shkruar: “Le të lavdërojmë të gjithë oshënarin dhe dëshmorin Nikodhim, mburrjen e Ilirisë”, ndërsa tek shkurtorja e shërbesës thotë: “Mbrotjësini e mrekullueshëm të Beratit”.²⁹



Nismën për të përkthyer në shqip Shërbesën e Nikodhimit të Beratit e ka ndërmarrë Dhimitër Përmeti, por përkthimi i tij nuk mundi të shohë dritën e botimit. Përkthimi i Dhimitër Përmetit ka qarkulluar dorë më dorë nëpër priftërinjtë e brezave të ndryshëm të Beratit. Mua ma dërgoi miku im i përkorë atë Petraq Simsia dhe e ribotova në një botim modest në vitin 2013.

²⁹-Dhimitër Beduli, Shën Nikodhimi i Beratit, Ngjallja, Qershor 1993, faqe 6.

KISHA E FJETJES SË SHËN MËRISË, MUZEU ONUFRI, BERAT

Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” gjendet në kalanë e Beratit. Ajo ka qenë kisha katedrale e Beratit. Pranë saj gjendej ndërtesa e Mitropolisë. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazilikal me dy kupola dhe ka përmasa 20x10,9 metra. Kisha mendohet se është rindërtuar në rrënojat e një kishe të vjetër në vitin 1797. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet i gdhendur mbi gurin portal të kishës: “Viti 1797, muaji mars 9. U përtëri ky tempull i hirshëm i Fjetjes së Hyjlindëses me kontributin e të gjithëhirëshmit dhe të gjithëditurit të Beratit, Zotit Joasaf dhe me mendimin e klerikëve, të arkondëve dhe të gjithë të krishterëve të tjerë dhe të ktitorëve të tij (tempullit), për kujtimin e tyre. Nëse je mik hyr duke u gëzuar, në qoftë se je armik dhe i keq dhe plot me të keqe, ik larg nga kjo portë”.³⁰ Kisha u ndërtua prej kryemjeshtër Themeliut. Mbi një gur ranor të murosur në kolonën e hajatit është shkruar: “U ndërtua ky tempull hyjnor me dorën e kryemjeshtër Themeliut dhe vëllazërisë së tij Zafirit, Kostandinit, Llazarit, Dhimitrit...”.³¹

Mbi portën jugore të kishës është shkruar: “U pikturua kjo ikonë e shën Mërisë me kontributin e të krishterëve, me dorën e Gjergj Jan Çetirit, në kohën e të gjithëhirëshmit, shenjtit të Beratit, zotit Jan dhe arkimandritit të shenjtë, zotit at Dhimitrit dhe të skevofilakut at Josifit dhe Dhimitrit, Andreut, Gjergjit të ..në kohën e kujdestarisë së zotit Athanas Janko Kolës dhe i përjetshëm qoftë kujtimi i tyre. 1860, prill 16”.³²

³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 171, faqe 113.

³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 173, faqe 114.

³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 241, faqe 135.

Ikonostasi i kishës është i gdhendur në dru are dhe është i larë me ar. Joan Çetiri ka realizuar me mjeshtëri ikonat e ikonostasit të kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit, gjithsej 27 ikona të vogla dhe 7 të mëdha. Ikonat kryesore të ikonostasit janë: “Krishti Pandokrator”, “Shën Mëria”, “Joan Pagëzori” dhe “Fjetja e Hyjllindëses”. Mbi ikomën “Fjetja e Hyjllindëses” është shkruar: “U pikturua kjo ikonë me kontributin dhe shpenzimet e Papa Gjergjit, birit të papa Andreut dhe Jorgos, birit të Andreut, në vitin 1814 në muajin mars 20”.³³ Ndërsa mbi ikonën e madhe të “Shën Spiridhonit” gjendet ky mbishkrim: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Stefan Karbunarës, 1812 korrik 19. Dora e Jan Çetirit”.³⁴



Brezi i sipërm përmban ikonat e festave. Tematika e ikonave të tjera është nga Dhiata e Re: “Rrethprerja e Krishtit”, “Burimi Jetëdhënës”, “Mos më prek”, “Pagëzimi i Krishtit”, “Shërimi i të verbërit” etj. Në dyert e bukura të ikonostasit janë të gdhendur dy dragoj dhe në kulmin e derës gjendet një shqiponjë

³³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 202, faqe 123.

³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 196, faqe 121.

me kurorë sipër krerëve. Në derën veriore ikonografi ka pikturuar “Kryeengjëllin Mikael”, ndërsa në atë jugore gjendet “Kryeengjëlli Gabriel”. Sipas dr. Gazmend Mukës ikonat janë pikturuar prej pesë autorëve të ateliesë Çetiri nën drejtimin e Joan Çetirit. Gjergj Prend Çetiri ka pikturuar ikonat “Lindja e Krishtit” dhe “Shpërfytyrimi”. Joan Çetiri ka pikturuar nëntë ikona: “Mos më prek”, “Shërimi i ulokut”, “Gruaja samaritane”, “E diela e të verbërit”, “Burimi jetëdhënës”, “Hyrja në Jeruzalem”, “Rrethprerja”, “Vajtimi i mbivarrshëm” dhe “Pagëzimi i Krishtit”. Ndërsa firmën e Nikolla Gjergj Çetirit e mbajnë 14 ikona: “Lindja e Shën Mërisë”, “Fjetja e Shën Mërisë”, “Lindja e Pagëzorit”, “Mbledhja e apostujve” etj. Naum Çetiri ka pikturuar tri ikona: “Hyrja e Hyjlindës në tempull”, “Pesëdhjetorja” dhe një ikonë tjetër. Gjergj Nikollë Çetiri është autori i katër ikonave: “Ngjallja e Llazarit”, “Prekja e Thomait”, “Shestja” dhe “Gjysëmpendikostia”.³⁵

Në pjesën e poshtme të amvonit gjendet një mbishkrim, i cili vërteton se është gdhendur më 30 qershor të vitit 1849 prej usta Naumit nga Lavdari i Oparit.³⁶ Në kornizën prej druri të ikonës së Shën Mëhillit, pranë amvonit është gdhendur ky mbishkrim: “Në vitin 1850 kujdestar Thanas Pone”.³⁷

Më 27 shkurt të vitit 1986 në ambjentet e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit u vendos “Muzeu Kombëtar Onufri”. Muzeu ka tri salla kryesore, në të cilat janë ekspozuar ikonat më të mira të ikonografëve shqiptarë Onufrit, Nikollës, Onufër Qipriotit, David Selenicës, Kostandin Shpatarakut, Joan

³⁵-Gazmend Muka, Disa konsiderata për kontributin e Çetirëve në ikonat e katedrales “Fjetja e Shën Mërisë” në Berat, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 71-75.

³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 226, faqe 130.

³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 228, faqe 131.

Çetirit dhe të vëllezërve të tij. Muzeu përbëhet nga salla qendrore e kishës nga altari si dhe nga disa mjedise ndihmëse. Gjithashtu në muze janë ekspozuar kapakë ungjilli, kryqe, temjanica si dhe një antimis.³⁸ Mbi antimisin është stampuar mbishkrimi: “U shenjtërua nga Patriku i shumëlumtur dhe i shumëditur i qytetit të shenjtë të Jerusalemit dhe gjithë Palestinës, Zotit Partheni dhe i është dhuruar varrit të gjithëshenjtë dhe jetëdhënës në kohën e shumëlumturit Zotit Joasaf, me kujdesin dhe shpenzimet e gjithëoshënar Zotit Neofit prej Voskopojës, stampuar në këtë qytet prej murgut atë Damaskinoit nga Trika”.³⁹

Kapakët e ungjillit janë prej argjendi të punuar artistikisht. Mbi to është shkruar: “Ky ungjill hyjnor u punua në kohën e Andreut dhe të Janit, bijve të priftit dhe në kohën e Nikollë Anastasit dhe të Kostandinit, bijve të Janit, me kontributin e tyre. Dhe u dhurua në tempullin e gjithnderuar të Fjetjes së Shën Mërisë, 1729 mars 30. Me dorën e Filip Athanasit, voskopojarit”.⁴⁰ Potiri i shenjtë i kishës është prej argjendi i larë me ar. Mbi bazamentin e tij gjendet mbishkrimi: “Potiri është i Mitropolisë së Beratit, punuar në kohën e papa Andresë, nga argjendari Gjergj Episkioti-1757”.⁴¹ Mbi një dorezë argjendi të një kryqi eksapterësh gjendet ky mbishkrim: “Ky kryq është i Nikollë Mihës. Ky kryq i nderuar dhe jetëbërës është i Manastirit të Fjetjes së Shën Mërisë të Peshkopatës...dhe me kontributin.”.⁴²

³⁸-Marita Beci, Disa vrojtme dhe sugjerime mbi gjendjen dhe problemet e ruajtjes së objekteve të restauruar në muzeun “Onufri”, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 109.

³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 279, faqe 146-147.

⁴⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 109, faqe 94

⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 130, faqe 101.

⁴²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 105, faqe 93.

Rreth dorezës prej argjendi të shkoptit peshkopal gjendet mbishkrimi: “Ky skeptër (shkop peshkopal) është i shenjtit të Beratit, zotit Metodit, nga katundi Bubullimë dhe është 90 derhem, në vitin 1745, nga dora e Janko Voskopjarit”.⁴³ Ndërsa në një eksapтер është gdhendur mbishkrimi: “Argjendari, Stergji Dhimitër Goga 1860, qershor 21”. Në një eksapтер tjetër është shkruar: “U përtërinë dy eksapтерat e Fjetjes së Shën Mërisë kujdestar është Mit Zhapa 1860, qershor 21”.⁴⁴ Në hieroren e kishës “Fjetja e Shën Marisë” në Berat ndodhen lipsanët e Gorazhdit dhe të Angjellarit. Shën Gorazhdi ishte nga Moravia, i cili e ushtroi veprimtarinë e tij misionare në Berat ku edhe u martirizua. Lipsanët e shenjtorëve ruhen në dy arka.⁴⁵



⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 123, faqe 99-100.

⁴⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 240, faqe 134-135.

⁴⁵-Kostas Nihoritit, Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve, 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 87-90.

Mbi kapakun prej argjendi të arkës së lipsanëve të Gorazhdit dhe Angjellarit është shkruar: “Në kohën e kujdestarinë së zotit K. Veveçka. Me shpenzimet e kishës katedrale të Fjetjes së shën Mërisë të Kalasë së Beratit, në kohën e peshkopatit të mitropolitit të Beratit, zotit Anthim, viti 1885, nëntor 11. Me dorën e gabriel D. Tiranasis, viti 1885, nëntor 11”.⁴⁶

Gjithashtu një ikonë e kësaj kisha paraqet fjetjen e shenjtorëve sllavë. Ikona i përket ciklit të ikonave të mëdha të ikonostasit të kishës dhe është realizuar nga Joan Çetiri. Në qendër të ikonës paraqiten Gorazhdi dhe Angjellari. Arkitektura e banesave me çati të kuqe, kisha e vendosur në pjesën shkëmbore, lumi dhe ura sipër tij i referohen Beratit, qytetit ku gjenden dhe lipsanet e dy shenjtorëve sllavë.

KISHA E SHËN TRIADHËS NË KALANË E BERATIT

Kisha e “Shën Triadhës” gjendet në murin rrethues jugor të kalasë së Beratit. Kisha është e ndërtuar mbi një shkëmb guri dhe i përket stilit bizantin në formë kryqi të brendashkruar me kube oktagonale. Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe mjedisi i altarit. Narteksi ndriçohet nga tri dritare. Përmes një porte të harkuar nga narteksi kalon në naosin e kishës. Kisha e “Shën Triadhës” është e ndërtuar me gurë duke përfshirë brenda korniza tullash. Sipas prof. Aleksandër Meksit përse i përket arkitekturës bizantine kisha është një monument i arrirë. Nga një mbishkrim që gjendet mbi portën jugore të narteksit mësojmë se kisha është ndërtuar në kohën e sundimit të Andronikut II Paleolog (1282-1328). “U ndërtua prej themeli (ky tempull i Shën Triadhës) me kontributin dhe përpjekjen...e shenjtë të Zotit dhe mbretit tonë...bashkëshortes së tij Zonjës Irenë, në kohën e mbretërimit të

⁴⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 265, faqe 141.

Andronik Paleologut.... “. Menjëherë pas ndërtimit të kishës u pikturuan afresket, të cilat ruhen të dëmtuara. Në mesin e kubesë ruhen vetëm fragmente nga i “Gjithfuqishmi”. Rreth tamburit të kubesë ruhen dymbëdhjetë figura profetësh, Danieli, Solomoni, Isaia, Davidi etj. Përmbi kolonën juglindore të kishës gjendet skena e “Ungjillëzimit të Hyj lindëses”, ndërsa mbi faqen lindore të qemerit jugor gjendet skena “Lindja e Krishtit” me përmasa 2.10x1.55 metra. Mbi faqen e murit jugor, anash dritares gjendet skena “Ikja në Egjipt” dhe nën të gjendet skena “Larja e këmbëve të apostujve” me përmasa 1.98x1.28 metra. Pranë saj ruhet skena “Lutja në Gjetsemani” me përmasa 1.98x1.28 metra. Në faqen perëndimore të qemerit jugor ruhet skena e “Pagëzimit të Krishtit” me përmasa 2.10x1.55 metra. Në faqen jugore të qemerit perëndimor gjendet skena e “Shpërfytyrimit” me përmasa 2.10x1.40 metra, ndërsa në anën veriore të qemerit perëndimor ruhet skena “Ngjallja e Llazarit” me përmasa 2.10x1.40 metra.



Mbi qemerin verior gjendet skena “Hyrja në Jerusalem” me përmasa 2.10x1.60 metra, ndërsa në anën jugore të qemerit lindor ruhet skena e “Darkës Mistike” me përmasa 2.10x1.80 metra. Nën të gjendet skena e “Shestjes” me përmasa 2.40x1.80

metra. Mbi faqen e murit verior gjendet skena “Zbritja nga kryqi” me përmasa 2.63x1.63 metra, ndërsa në anën veriore të qemerit lindur ruhet skena e “Ngjalljes” me përmasa 2.40x1.80 metra.

Në apsidë gjendet “Platitera me Emanuelin ndër duar”, ndërsa në brezin nën të gjendet skena “Kungimi i apostujve” me gjerësi 1.35 metra. Në nikën jugore të kungës gjendet një ndër dhjakonët martirë, ndërsa në harkun që lidh kolonën veriperëndimore me murin verior gjendet në gjysëmfigurë “Shën Nestori”. Në harkun që lidh kolonën me murin perëndimor gjendet në gjysëmfigurë “Shën Gejrgji”, ndërsa në anën e djathtë të portës perëndimore gjendet skena “Ava Zosima duke kunguar Marinë Egjiptiane”. Afresket e kishës së “Shën Triadhës” në kalanë e Beratit i përkasin stilit të rilindjes së artit bizantin.⁴⁷

KISHA E SHËN SPIRIDHONIT NË LAGJEN GORICË TË BERATIT

Kisha e “Shën Spiridhonit” gjendet në lagjen Goricë të Beratit. Kisha është e tipit bazilikë trenfëshe dhe mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1864. Hyrja për në kishë bëhet nga narteksi. Në qemerin e harkuar të derës hyrëse është shkruar: “Kushdo që vjen këtu, unë do ta pranoj me shumë dashuri”. Në një diskos të madh me figurën e Shën Spiridhonit në relief në mesin e kishës gjendet mbishkrimi: “Stergji Gogo 1875”.⁴⁸

Ikonostasi është prej druri me gdhendje. Në të janë vendosur ikonat sipas radhës. Në mbulesën prej argjendi të ikonës së madhe të Shën Spiridhonit është shkruar: “Kjo ikonë u bë me kontribut të përbashkët me blerjen e argjendit, kurse punën grosh 300 e ka dhuruar zonja Agni, e shoqja e zotit Filip nga Lagja

⁴⁷-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 192-203.

⁴⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 257, faqe 139.

Goricë, në qytetin e Beratit, në kohën e peshkopimit të zotit Anthim Aleksudhit, nga Matidhi i Thrakisë, në kohën e kujdestarisë së zotit Naum Ajço. Prej dorës së argjendarit, Gabriel Dh. Buda viti 1883, qershor 28. Me nxitjen e papa Gjergj Varelit, nga katundi Kompot këtu. Er. Arta”.⁴⁹ Në pjesën verilindore të kishës gjenden disa afreske të dëmtuar. Kambaneria është e punuar prej guri dhe gjendet në anën veriore të kishës. Në kapakët prej argjendi të ungjillit të kishës gjendet mbishkrimi: “Me dorën e Petuos Mokrundi me kontributin dhe mbikqyrjen e at Dhimitrit Mani 1755, në kohën e kujdestarisë së zotit Sofronit”.⁵⁰

Rihapja. Më 20 nëntor 1990 një grup besimtarësh të lagjes Goricë të Beratit vendosën ta rihapin kishën e “Shën Spiridhonit”. Një përfaqësi e tyre e përbërë nga Lili Karabina, Zoi Samarxhiu, Palush Pushi, Petraq Thanasi, Petraq Simsia, Vangjush Mile dhe Mikela Oço shkuan për të marrë leje tek sekretari i komitetit të partisë Stathi Kavaja. Në vijim grupi nismëtar shkoi tek shtëpia e kryetares së këshillit popullor të lagjes Ledianë Zhara, e cila pa hezitimin më të vogël ua dha çelësat e kishës. Kisha e Shën Spiridhonit ishte kthyer në depo, ku magazinoheshin materiale ndërtimi, kazma, lopata, çimento, gëlqere, rërë, trarë etj. Në pjesët anësore të kishës qenë vendosur rafte, në të cilat kultivohej krimbi i mëndafshit. Binarët e skelave kishin dëmtuar afresket e kishës.

Sapo morën çelësat nismëtarët filluan pastrimin e kishës. Nismën e mori Mikela Oço, i cili u pasua nga Pirro Angjeliu, Dhimitër Topi, Peçi Musha, Ilia Angjeliu, Vangjeli Bojaxhiu, Eftali Përroi, Pandi Shulla, Kela Baboçi etj. Grupi nismëtar vendosi që kisha të rihapej më 12 dhjetor të vitit 1990 ditën kur kremtonte Shën Spiridhoni, por duheshin ende shumë materiale, të cilat do të mundësonin funksionimin e kishës. Besimtarët filluan të ofronin

⁴⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 261, faqe 140-141.

⁵⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 129, faqe 101.

atë çka kishte shpëtuar nga përndjekja e egër ateiste. Palush Pushi dhuroi ikonën e “Darkës Mistike”, ndërsa Petraq Simsia kishte ruajtur kryqin e kishës së “Shën Spiridhonit”. Grupi nismëtar kontaktoi me dhjakun Vangjel Xoxe, i cili e pranoi ftesën. Menjëherë me kontributin financiar të besimtarëve u blenë pëlhurat e duhura dhe rrobaqepësi Sotiraq Tapia qepi stolinë e dhjakut. Por që të celeburohej Liturgjia Hyjnore nevojiteshin disko-potirët e shenjtë. Këto u siguruan nga besimtari Jorgji Naço, i cili i kishte ruajtur me shprestarin për vite me radhë, sepse babai i tij Fone Naço, kishte qenë epitröp i kishës së Shën Spiridhonit. Të shenjtat i shpunë në kishë dhe ia treguan dhjak Vangjelit, i cili shprehu keqardhjen duke thënë se këto nuk mjaftonin. Duhej patjetër antimisi i shenjtë. Mellani Naço e kishte fshehur antimisin e kishës së Shën Spiridhonit në sëndukun ku kishte rrobat e pajës. Dhjak Vangjeli me Zoi Samarxhiun shkuan në shtëpinë e psaltit Ilia Thimi Koçi, i cili u dhuroi ungjillin dhe apostullin.



Më 22 dhjetor 1990 besimtarët kishin mbushur kishën e “Shën Spiridhonit” në lagjen “Goricë” të Beratit, madje në këtë ditë të shënuar kishte pjesëmarrës edhe të feve të tjera. Të gjithë prisnin me padurim të fillonte Liturgjia Hyjnore, por dhjak Vangjel Xoxe doli tek dera e bukur dhe tha: “Unë jam dhjak dhe nuk më

lejohet të celebroj Liturgjinë Hyjnore, por kërkoj miratimin tuaj”. Në vijim ai pyeti besimtarët e pranishëm në kishë: “a jam i denjë”, “a jam i denjë”, “a jam i denjë” dhe ata iu përgjigjën njëzëri “i denjë”, “i denjë”, “i denjë”. Atëhere dhjakon Vangjel Xoxe filloi të lëçiste litanitë e meshës hyjnore. Meqenëse dhjakon Vangjeli duhej të dorëzohej në gradën priftërore, grupi nismëtar vendosi që ai të shkonte në Athinë. Në qershor 1991 një grup besimtarësh Vangjel Çapi, Palush Pushi, Petraq Simsia dhe Petraq Thanasi shkuan në manastirin “Pendeli” në Athinë. Më 25 qershor 1991 u krye dorëzimi i dhjak Vangjelit në prift nga Ekzarku Anastas. Përveç përfaqësisë së ardhur nga Berati qenë të pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm i K.O.A.Sh-it Aleko Dhima dhe kryetari i shoqatës “Mbajtësit e Kryqit”, Sotir Babuli.⁵¹

KISHA E SHËN KOLLIT NË PERONDI, BERAT

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në fshatin Perondi të Beratit. Kisha është bazilikë trinefëshe dhe përbëhet nga nartekusi, naosi dhe mjedisi i altarit. Muratura e kishës është e ndërtuar me tulla dhe gurë të lidhur me llaç të kuqërremtë dhe copa tullash të shtypura. Muret përfundojnë me një kornizë të dyfishtë tullash në formë dhëmbësharre. Apsida e kishës është pesëfaqëshe.⁵² Kisha e “Shën Kollit” mendohet të jetë ndërtuar në shek. XIII. Kunga ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi druri të gdhendur në vitin 1785. Kjo datë është e gdhendur nën kryqin e madh të ikonostasit të kishës. Gjithashtu në xhamin e një dritareje të katit të dytë nga ana veriore e kishës është shkruar viti 1785.⁵³

⁵¹-Ilia Zaka, Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtarë në Berat, Berat 2009, faqe 13-24.

⁵²-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 152-154.

⁵³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 160, faqe 110.

Ikonostasi është prej dru arre dhe ka përmasa 10x4 metra. Pjesa fundore e ikonostasit formohet nga 12 kolona të mëdha, të cilat krijojnë 11 hapësira, prej të cilave 3 i zënë dyert, ndërsa 8 hapësira janë me ikonat e mëdha. Në pjesën e sipërme të ikonostasit gjendet dy radhë me ikona të vogla.⁵⁴

Gjatë restaurimit që është bërë në vitin 1785 është riparuar muri verior i kishës, gjithashtu është vendosur tavani prej dërrase. Pas restaurimit të bërë në vitin 1970 nga Instituti i Monumenteve pasi u hoq tavani u zbulua përmbi apsidë skena “Vizioni i profetit Daniel”. Gjithashtu në kishë gjenden edhe dy figura shenjtorësh, të cilët janë pikturuar mbi harqet e kambanerisë jashtë portës perëndimore. Në skenën “Vizioni i profetit Daniel” shquhen pesëmbëdhjetë frone, të cilat janë vendosur njëri pas tjetrit në formë gjysmërrethore. Dy fronet e mesit janë më të mëdha se të tjerët. I pari është fronti i etimasisë mbi të cilin janë pikturuar kryqi, sfungjeri, shtiza dhe gozhdët që tregojnë pësimet e Krishtit. Në fronin tjetër paraqitet një plak i moçëm, i cili quhet “i vjetri i ditëve” dhe simbolizon Jezu Krishtin. Fronet e vendosura në gjysmërrethi të krijojnë idenë e një mjedisi gjykate. Në sfondin shkëmbor që rrethohet prej froneve paraqitet profeti Daniel i shtrirë duke fjetur dhe një engjëll i kërrusur drejt tij. Prapa froneve paraqiten dymbëdhjete figura engjëjsh, secili me një skifter pranë. Përmbi dy fronet e mëdhenj të skenës gjendet e pikturuar një si enë me një rrobë të shpalosur mbi të. Në linja të përgjithshme kjo skenë përfytyron një vizion të profetit Daniel. Ikonofrafi këtë e lidh me gjyqin e fundit ku thuhet se dymbëdhjetë dishepujt do të rrinë mbi dymbëdhjetë frone për të gjykuar dymbëdhjetë fiset e Izraelit (Matheu 19, 28).⁵⁵

⁵⁴-Besim Tabaku, Ikonombartësi i kishave të Perondisë dhe katedrales së Beratit, vlerat dhe ndërhyrjet restauruese, Monumentet 2 / 1990 (40), faqe 171.

⁵⁵-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 204-209.

KISHA E SHËN PJETRIT DHE PAVLIT NË ZHYMË TË MYZEQESË

Mbi portën veriore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili tregon kohën e pikturimit të kishës: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i apostujve të shenjtë të lavdëruar Pjetrit dhe Pavlit, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit dhe mitropolitit të Beratit, zotit Anthim, në kohën e priftërimit të Janit, me kontributin dhe në kohën e kujdestarisë së Tushit, dhe Naumit, Mihalit, me dorën e Dhimitrit dhe Harallambit, nga qyteti Samarinë, 1864, shkurt 27. Marku, Stefani dhe Theodhori dhe Gjergji”.⁵⁶ Mbishkrimi gjendet mbi ikonën e madhe të Shën Mërisë në ikonostas: “U pikturua kjo ikonë me kontributin dhe shpenzimet e epitropit Mihal Stavro. I qoftë ndihmë. Me dorën e Gjergj Çetirit, 1811 janar 30”.⁵⁷

KISHA E SHËN KOLLIT NË KRUTJEN E SIPËRME

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në Krutjen e Sipërme të rrethit të Lushnjës dhe është ndërtuar në vitin 1804. Naosi është i tipit bazilikal trenfësh me përmasa 18x9 metra. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajatet që e rrethojnë nga të tri anët. Naosi ndriçohet nga dritare të mëdha, të cilat janë hapur në pjesën e sipërme të mureve verior dhe jugor. Kambaneria e kishës është ndërtuar në vitin 1924 dhe gjendet në pjesën perëndimore të kishës. Apsida është ndërtuar nga blloqe të mëdhenj gurësh të latuar. Ajo zbukurohet prej disa nikesh të harkuara nga sipër. Muratura e apsidës mbyllet nga një kornizë tullash të vendosura në formë

⁵⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 246, faqe 137.

⁵⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 191, faqe 119.

dhëmbësh sharre.⁵⁸ Kisha e “Shën Kollit” në Krutjen e Sipërme është pikturuar më 17 shkurt të vitit 1811 nga Nikollë Çetiri. Mbi portën jugore brenda kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1811 dhe u përfundua në muajin shkurt 17, me dorën e Nikollë Çetirit, në kohën e të gjithrëshmit, mitropolit të Beratit, zotit, zotit, Joasaf, nga katundi Bubullimë në kohën kur ishin famulltarë priftërinjtë Athanas i Markut, në kohën e kujdestarisë së Vasilit dhe Manit dhe të subashëve Haxhi Dako dhe të (pleqëve) prezent Zekë Çilit, Nas Kuqit, Gjergjit, Ndon Martirit, Meços, Naum Barhiut, Rist Kurtit, Naum Gjiks, Kostandin Saulit, Kostë Gjinarakut, Gjik Prendit, Mark Gjilit, Todo Muços, Stas Lekos dhe Gjergjit të Papajt dhe në vazhdim të tjerëve, burrave dhe grave, të cilët i kujtoftë, zoti ynë Jezu Krisht në Mbretëri të qiejve për shpenzimet dhe kontributin dhe përpjekjet me anë të ndërmjetësimeve të shën Kollit. Amin, amin, amin”.⁵⁹

Ikonostasi i kishës është me gdhendje dhe i lyer me ar. Nën kryqin e ikonostasit është gdhendur viti 1821 që sipas Theofan Popës mendohet të jetë viti i gdhendjes së ikonostasit.⁶⁰ Ikonat janë punuar nga Naum Çetiri në vitin 1821. Mbi ikonën e madhe të Shën Mërisë në ikonostas gjendet mbishkrimi: “1821. U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Gjergjit, Naumit, Nikollës, Anastasit, Janit, Aleks Çabalaqit dhe të bijve, me dorën time të Naum Çetirit”.⁶¹ Në ikonën e madhe të Joan Pagëzorit gjendet mbishkrimi: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Thoma Donit dhe birit të

⁵⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 225-228.

⁵⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 193, faqe 119-120.

⁶⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 207, faqe 124.

⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 208, faqe 124.

tij Gjergjit. Me dorën e Naum Çetirit”.⁶² Mbi ikonën e kryeengjëljeve në ikonostas gjendet mbishkrimi: “U pikturua kjo ikonë me kontributin dhe shpenzimet e Martir Çokut dhe të birit të tij Gjergjit dhe të shoqëruesve. I përjetshëm kujtimi i tyre-1824”.⁶³ Ikona e Shën Illiut në ikonostas është pikturuar në vitin 1824: “Viti 1824. U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Nas Avram Kuqit dhe të bijve të tij, që janë Trifoni dhe Gjergji”.⁶⁴

Kisha ka përmasa të mëdha dhe u shërben tri fshatrave të Myzeqesë: Krutje e Sipërme, Fier i Ri dhe Kadiaj. Një enori relativisht e madhe me rreth 900 familje të krishtera. Pranë kishës gjenden varrezat e fshatit. Më ka rënë rasti të shkoj disa herë, sepse në to prehet në paqe miku im më i mirë teologu Maksim Çuko. Në vitin 2002 kjo kishë u restaurua me fondet e Kishës Ortodokse. Kosto e punimeve kap shifrën e 17.550 dollarëve. U riparua çatia e kishës duke u zëvendësuar tjegullat, u bë pastrimi i pjesës përëndimore dhe kullimi i ujërave etj. Punimet u realizuan nga një firmë ndërtimi vendase me president Ing. J. Basha.⁶⁵

KISHA E SHËN THANASIT NË KARAVASTA

Kisha e “Shën Thanasit” në Karavasta është ndërtuar në vitin 1778 dhe është kishë e tipit bazilikal me përmasa 20x10 metra. Kisha është e ndarë me kolona me tri nefe. Ikonostasi është i gdhendur në dru dhe ndan ambientin e altarit. Naosi rrethohet nga

⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 221, faqe 128.

⁶³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 210, faqe 124.

⁶⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 211, faqe 124-125.

⁶⁵-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 195-197.

të tri anët me hajate. Në qoshen veriperëndimore ka një kthinë, e cila përdorej si pagëzimore. Kisha është e suvatuar nga jashtë. Apsida është e ndërtuar prej blloqe të mëdhenj guri dhe është lënë e pasuvatuar. Ajo zbukurohet nga shtatë nike të harkuara nga sipër. Në kornizën e apsidës janë përdorur detaje dekorative të mara nga Apolonia. Kisha është pikturuar në vitin 1797 nga Gjergj dhe Joan Çetiri nga Grabova. Vëllezërit Çetiri kanë pikturuar ikonat e ikonostasit dhe afresket e kishës. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës: “U pikturua ky tempull në kohën e të gjithirshmit, shenjtit të Beratit zotit, zotit Joasaf, në kohën e kujdestarisë së Mitro Dukas. Me dorën e Gjergj dhe të Joanit, vëllezërve nga qyteti Grabovë 1797, në muajin shkurt 20”.⁶⁶

Në përgatitjen e ikonave të ikonostasit të kishës së “Shën Thanasit” në Karavasta vëllezërit Çetiri kanë përdorur tematikën e miniaturës. Në ikonën e madhe të Krishtit ata kanë përfshirë miniaturat e apostujve. Në ikonën e madhe të Shën Mërisë kanë futur disa miniatura të profetëve. Në ikonën e shenjtit të kishës, Shën Thanasit kanë futur disa miniatura me skena nga jeta e tij. Gjithashtu ata kanë pikturuar “Krishtin me tri fytyra”, skenë që e hasim edhe tek Kostandin Shpataraku në Manastitin e Ardenicës. Ikonat e brezit të sipërm të ikonostasit janë: “Lindja e Krishtit”, “Darka mistike”, “Puthja e Judës”, “Ungjillëzimi”, “Fjetja e Shën Mërisë” si dhe disa skena nga “Himni Akathist”.

Në kishën e “Shën Thanasit” në Karavasta kemi të pikturuara afreske me skena nga Dhiata e Vjetër: “Krijimi i Adamit”, “Krijimi i Evës nga brinja e Adamit”, “Mëkati i protoplastëve”, “Dëbimi nga parajsja”, “Vrasja e Abelit”, “Përmbytja e Noes”, “Shitja e Josifit”, “Ngasja e Josifit”, “Josifi i shpjegon ëndrën faraonit”, “Josifi përshëndetet me vëllezërit”, “Jakovi në Egjipt”, “Sakrifica e Abrahamit” etj. Në brezin e madh të kishës ikonografët Çetiri ndërmjet skenave me hierarkët, apostujt

⁶⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 170, faqe 113.

e martirët kanë pikturuar Nikodhimin e Beratit dhe Joan Vladimirin. Afresku më i bukur është ai i “Gjyqit të fundit”, skenë që e hasim të pikturuar nga vëllezërit Zografi nëpër kisha e tjera si për shembull në manastirin e “Ardenicës” dhe në kishën e “Shën Gjergjit” në Libofshë.

Kisha e “Shën Thanasit” në Karavasta gjatë vitit 1999 është restauruar me fondet e Kishës Ortodokse. Punimet restauruese kapën shifrat 55.000 dollarë. Realizimi i punimeve u krye nga specialistët e Institutit të Monumenteve me drejtues Ing. G. Samimin në bashkëpunim me firmën ndërtuese “Elira” me president Sotiraq Kolën. U kryen këto punime restauruese: riparimi i çatisë së kishës, riparimi i mureve, pastrimi nga dherat përreth mureve të kishës për të shmangur lagështirën etj.⁶⁷

KISHA FJETJA E SHËN MËRISË NË BISHTQETHËM, LUSHNJE

Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” gjendet në fshatin Bishtqethëm të Lushnjes. Sipas gojëdhënave kisha është ndërtuar në shekullin XII. Më pas rreth viteve 1600 u rrafshua deri në themel nga turqit dhe u rindërtua pas një shekulli në vitin 1700. Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” është bazilikë trinefëshe me tavan. Ajo ka përmasat 17.50x8.60 metra dhe përbëhet nga naosi e hajatet që e rrethojnë nga të tri anët. Çatia e kishës është e mbuluar me tjegulla. Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” në Bishtqethëm është pikturuar më 20 tetor të vitit 1798 nga dora e Joan Çetirit. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën jugore brenda kishës. “U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1798 dhe u përfundua në muajin tetor 20, me dorën e Jan Çetirit nga qyteti Grabovë, në kohën e gjithërrshmit Mitropolitit të Beratit, zotit Joasaf dhe të priftërinjve prezent, Simonit, Petrit, Kostandinit dhe të subashëve

⁶⁷-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 193-194.

Apostoli Mile Sagjinit, Mile Bita Suti Selekut, Simon Kolia, Kostandin Gjonit, Gjergj Elos, Kosta Nushit, Birdufit, Dimo dhe Niko Niçarit, Simoni Subashit dhe Sotir Kolës dhe në vazhdim, të këtyre i kujtoftë zoti ynë Jezu Krisht në mbretëri të qiejve”.⁶⁸

Ikonostasi i kishës është prej druri me gdhendje. Nën kryqin e ikonostasit është gdhendur viti 1827 që sipas Theofan Popës duhet të jetë data e gdhendjes së ikonostasit.⁶⁹

Ikona e madhe e Krishtit që gjendet në ikonostas është pikturuar nga Naum Çetiri në vitin 1829: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Spiro Bushit, Josif Shtambarit dhe vëllait të tij Petushit. I përjetshëm kujtimi i tyre. Me dorën e Naum Çetirit 1829, prill 1”.⁷⁰

Në vitin 1849 kisha u pajis me amvon. Kjo jepet në mbishkrimin që gjendet në kolonën e amvonit: “U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1849 dhe u përfundua në muajin prill 25, me dorën e Gjergj Nikollë Çetirit dhe nipit të tij Ndinit, nga qyteti Grabovë, në kohën e të shumëhirshmit mitropolitit të Beratit, zotit Joasaf dhe të priftërinjve prezent, at Vasilit dhe at Athanasit dhe at Janit dhe kujdestarit të saj Mark Rombos, subashëve pleqve Koli Athanasit, Stas Ndrezkas, Avram Milos, Josif Dodo Gjinit, Stas Kuqit, Sirofe Çorrit, Naum Zikut, Ndine Dakës, Postol Veliojas, Nas Pinas, ristan Dreçkës, Kostandin Kondos, Mihal Davidit, Trifon Tolit, Sotir Dreçkës, Gidhon Halilit, Mihal Kondakçiu, Pali Gugës, Stefan...”.⁷¹ Rreth një kambane që gjendet

⁶⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 174, faqe 114.

⁶⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 215, faqe 125.

⁷⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 216, faqe 125-126.

⁷¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 225, faqe 129-130.

në kambanerinë e kishës është shkruar: “1859. Me dorën e Gjergjit dhe Vasilit Caraplanitëve nga Janina”.⁷²

Më 25 mars të vitit 1863 janë pikturuar kolonat e kishës. Ky fakt vërtetohet me anën e mbishkrimit që gjendet mbi një kolonë të kishës: “U pikturuan kolonat dhe u la tempulli dhe kujdestar ishte Josif Gjini dhe i biri i tij Trifon Gjini dhe famullitar Papa Jani, bijtë e pleqve Kola dhe priftëresha Lena”.⁷³

Në vitin 1987 kjo kishë iu nënshtrua procesit të restaurimit nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës, ndërsa në vitin 2002 Kisha Fjetja e Shën Mërisë në Bishtqethëm u restaurua me fondet e Kishës Ortodokse. Kosto e punimeve kap shifrën e 10.000 dollarëve. Punimet u realizuan nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës nën drejtimin e Ing. G. Samimit.⁷⁴

KISHA E SHËN GJERGJIT NË LIBOFSHË

Kisha e “Shën Gjergjit” gjendet në Libofshë të Fierit. Kisha përbëhet nga naosi, i rrethuar në tri anën prej hajateve si dhe nga kambaneria. Naosi i kishës ka përmasat 16.30x9.20 metra dhe është i mbuluar me një tavan druri të gdhendur. Gjithashtu edhe ikonostasi është prej druri të gdhendur. Kisha është e ndërtuar prej gurësh shtufi të lidhur me llaç e gëlqereje. Apsida është e ndërtuar me blloqe guri dhe zbukurohet nga shtatë nike të harkuara nga sipër.

⁷²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 237, faqe 134.

⁷³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 244, faqe 135-136.

⁷⁴-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 195-197.

Në anën lindore të muraturës së kishës gjenden dekoracione antike, të cilat mendohet se janë marrë nga Apolonia.⁷⁵

Kisha e “Shën Gjergjit” në Libofshë të Fierit është ndërtuar në vitin 1776. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet i gdhendur mbi portat e kishës: “Në vitin shpëtimtar 1776 u rindërtua ky tempull hyjnor i dëshmorit të madh, të lavdëruar shën Gjergj tropeofor. U pikturua në vitin 1782 në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit dhe të shumëditurit mitropolit të Beratit, zotit, Joasaf, me kontriburtin dhe shpenzimet e të gjithhirshmit e të shumëditurit igumenit të Ardenicës, zotit Kliment, dhe të muzikantit të shumëditur igumenit zotit Manasi, të priftërinjve zotit Mihail Kartofilakut, zotit Papa Nikollës, zotit Papa Vasilit, zotit Papa Thanasit, zotit Papa Petre, zotit Papa Kristi dhe të subashëve zotit Nako Bushi, Gjergj Athanasit, Andresë Sem Danës, Filip Gjeçit, Nas Vasilit, Doke Llukës, Pjetrit të Dhimitrit, Sotir Subashit, Pashkos, Semit të Rrapit, Stavre Gjatës dhe të burrave të tjerë dhe të grave, të cilët ti meritoi zoti perëndi (për) mbretërinë e qiejve. I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre. Në muajin mars (10), Bush Dane dhe Kosta Kandilapti”.⁷⁶ Kisha është pikturuar në vitin 1782 prej Kostandin dhe Terpo Zografit. Mbi portën veriore brenda naosit të kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua kjo kishë me dorën e Kostandinit dhe birit të tij Terpos nga qyteti Korçë”.⁷⁷

Në absidë ikonografët kanë pikturuar “Platiterën” dhe anash saj ëngjejt, skenën “Kungimi i Apostujve” dhe “Etërit e Kishës”. Nga shenjtorët e pikturuar kemi këta: Pavli e Pjetri, Prokopi, Nestori, Damjani e Kozmai etj. Në faqen perëndimore të kishës gjendet skena “Fjetja e Shën Mërisë”, e cila dominon në

⁷⁵-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 209-214.

⁷⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 138, faqe 103-104.

⁷⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 157, faqe 109-110.

gjithë fasadën. Poshtë saj gjenden “Kryeëngjëlli Mihail” me shpatën në dorë, “Kostandini dhe Elena” etj. Në faqen veriore të kishës gjenden skenat: “Kryqëzimi”, “Ngjallja” dhe në fund “Mrekullitë e Krishtit pas Ngjalljes”, ndërsa në faqen perëndimore të narteksit gjendet scena e “Gjyqit të fundit”.

Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1805. Kjo datë gjendet e gdhendur në dru nën kryqin e ikonostasit të kishës.⁷⁸ Sipas Theofan Popës ikonat e ikonostasit janë punuar nga një piktor anonim me shpenzimet e besimtarëve. Ikona e Krishtit është pikturuar me shpenzimet e Dokos dhe Jakos në maj të vitit 1808: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Dokos dhe Jakos, vëllait të tij dhe për kujtim të babës së tij. I përjetshëm kujtimi i tyre, 1808 maj”.⁷⁹ Ndërsa ikona e Shën Mërisë u pikturua me shpenzimet e Sotir Nas Vaziut: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Sotir Nas Vaziut dhe të vëllezërve të tij dhe të dajës së tij, Gjergjit dhe Kostandinit kushuririt të tij të parë”.⁸⁰ Ikona e Shën Gjergjit që është edhe shenjt i kishës është pikturuar në vitin 1808. Këtë e vërteton mbishkrimi i gdhendur mbi ikonë: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e mari Subashit dhe të Petrit të Gjergj Todhrit dhe daja i Filipit dhe të vëllait të tij Naumit dhe Filipi dhe i nipi Jani dhe i biri i tij Thanasi, nga katundi Libofshë. I përjetshëm kujtimi i tyre 1808”.⁸¹ Në ikonën e madhe të Shën Kollit gjendet mbishkrimi: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e katundit Çifligu i Madh. I përjetshëm kujtimi i tyre-1808 prill”.⁸²

⁷⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 181, faqe 117.

⁷⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 186, faqe 118.

⁸⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 187, faqe 118.

⁸¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 189, faqe 119.

⁸²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 184, faqe 118.

Ikona e Shën Spiridhonit është pikturuar me shpenzimet e katundit Metaj. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi i gdhendur në ikonë: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e katundit Metani (Metaj) i përjetshëm kujtimi i tyre”.⁸³ Në ikonën e Kryeengjejeve kemi këtë mbishkrim: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e katundit Rrethi dhe Dhimo Bohiko. I përjetshëm kujtimi i tyre, 1808 prill”.⁸⁴ Ikona e Shën Thanasit është pikturuar me shpenzimet e Janko Dimos dhe bitrit të tij Anastasit: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Janko Dimo dhe Anastasit, birit të tij. I përjetshëm kujtimi i tyre 1808, maj 10”.⁸⁵ Ikonostasi i kishës është varakosur në vitin 1817. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi derën e bukur të ikonostasit: “Anastasi i Jan Timos dhe Kostë Duka u lye me varak, ky ikonostas në kohën e peshkopatit të shenjtit të Beratit zotit, Joasaf, me kontributin dhe shpenzimet e Dhimitrit..Thanasit dhe Papa Stasit...viti 1817, dora e Nikollës”.⁸⁶ Pas fronit peshkopal gjendet një mbishkrim i shkruar mbi dërrasë: “Ky fron u pikturua në kohën e të gjithirshmit mitropolitit, shenjtit të Beratit Joasaf. Me dorën e Naumit dhe Gjergj Çetirit 1831, dhjetor 20, dhe me kujdesin e Stefan Gjeçit dhe epitropit Koçi Dino dhe atyre që u gjendën...”.⁸⁷ Tek një kabanë të kabanerisë gjendet mbishkrimi: “1875. Është e kishës së shën Gjergjit të katundit Libofshë, Kazaja e Beratit”.⁸⁸

⁸³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 185, faqe 118.

⁸⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 188, faqe 118-119.

⁸⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 190, faqe 119.

⁸⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 206, faqe 124.

⁸⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 217, faqe 126.

⁸⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 256, faqe 139.

Kisha e Shën Gjergjit në Libofshë të Fierit në vitin 1963 është shpallur monument kulture. Pranë kishë gjenden varrezat e fshatit. Në vitin 1968 u shkatërrua kambaneria dhe kisha u kthye në magazinë të një reparti ushtarak. Gjatë viteve 1996-1998 kisha e “Shën Gjergjit” në Libofshë u restaurua me fondet e Kishës Ortodokse. Punimet u përqendruan kryesisht në forcimin e muraturës së kishës. U bë rikonstruksioni i kambanerisë. U riparua çatia e kishës dhe u bënë instalime të reja elektrike dhe hidrosanitare. Gjithashtu u restauruan pikturat murale dhe u bë pastrimi nga dherat i mjedisit rreth kishës etj. Kosto e punimeve kap shifrën e 75.000 dollarëve. Studimi për restaurimin e kishës u realizua nga Reshat Gega, ndërsa punimet u realizuan nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës nën drejtimin e Ing. G. Samimit. Punimet për restaurimin e afreskeve u kryen nga nga specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës nën drejtimin e S. Mihalçka. Mbikqyrësi i punimeve nga ana e Kishës Ortodokse ishte arkitekt restaurator atë Teologu.⁸⁹

KISHA E SHËN KOLLIT NË VANAJ TË MYZEQESË

Kisha e “Shën Kollit” në Vanaj të Myzeqesë gjendet në majën e një kodre dhe është ndërtuar në vitin 1777. Kisha është bazilikë me tavan me përmasat 13.50x7.60 metra. Ajo përbëhet nga naosi dhe hajatat që e rrethojnë atë nga tri anët. Hyrjet për në naos janë në anën jugore dhe perëndimore. Dyshemeja është e shtruar me pllaka guri në formë drejtkëndëshe, ndërsa çatia e kishës është e mbuluar me tjegulla. Kisha është e ndërtuar me gurë shtufi të lidhur me llaç balte, ndërsa shpatullat e dritareve janë ndërtuar me blloqe gurësh të skuadruar. Apsida e kishës është shtatëfaqëshe me nike të harkuara dhe me dekoracione antike. Kisha e “Shën

⁸⁹-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 195-197.

Kollit” në Vanaj të Myzeqesë është pikturuar nga vëllezërit grabovarë Gjergj dhe Joan Çetiri në vitin 1795. Mbi portën jugore brenda kishës gjendet mbishkrimi i cili tregon kohën e ndërtimit dhe të pikturimit. “U ndërtua prej themeli ky tempull i Shën Kollit më 1777, pastaj u pikturua më 1795, dhjetor 16, në kohën e të gjithëhërshmit Mitropolitit, shenjtit të Beratit, zotit, Joasaf, prej fshatit Bubullimë, në kohën kur ishte famulltar Papa Dhimitri i Ristanit, Í asi, Petro, mbikqyrësi Í aum Juka, me shpenzimet e vendasve. Mundimi dhe piktura është e Gjergjit dhe Janit, vëllezërve nga fshati Grabovë”.⁹⁰ Gjithashtu mbi portën perëndimore jashtë kishës është shkruar: “U pikturua ky tempull me dorën e Gjergjit dhe të Janit, vëllezërve nga qyteti i Grabovës. 1795 dhejetor 15”.⁹¹

Në kishën “Shën Kollit” në Vanaj të Myzeqesë kemi të pikturuara afreske me skena nga Dhiata e Vjetër: “Krijimi i Adamit”, “Krijimi i Evës”, “Mëkati i protoplastëve”, “Dëbimi nga parajsja”, “Vrasja e Abelit”, “Përmytja e Noes”, “Shitja e Josifit”, “Ngasja e Josifit”, “Josifi i shpjegon ëndrën faraonit”, “Jakovi në Egjipt”, “Sakrifica e Abrahamit” etj. Në fasadën perëndimore të kishës paraqitet skena e “Gjyqit të fundit”. Në brezin e madh të shenjtorëve më këmbë ikonografët Çetiri ndërmjet skenave me hierarkët, apostujt e martirët kanë pikturuar Nikodhimin e Beratit dhe Joan Vladimirin. Është për tu theksuar se piktorët grabovarë Çetiri kanë zbukuruar me afreske edhe ambjentet e jashtme të kishës. Afresku më i spikatur është ai i Shën Kollit, që është shenjtji, të cilit i kushtohet kisha. Shën Kolli paraqitet me veshje hieratike, stihar, fellon dhe epigonat. Pranë kokës së shenjtit nga ana e djathtë është pikturuar Krishti dhe në të majtën paraqitet Shën Mëria. Ky afresk është nga punët më të përkryera të vëllezërve Çetiri.

⁹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 144, faqe 105-106.

⁹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 169, faqe 166.

Ikonostasi dhe amvoni i kishës janë prej druri të gdhendur me cilësi të lartë artistike. Tavani është prej druri të ngjyrosur. Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1811. Kjo datë është e gdhendur në dru nën kryqin e ikonostasit të kishës.⁹² Ikonat e ikonostasit të kishës së “Shën Kollit” në Vanaj të Myzeqesë janë pikturuar prej Kostandin Zografit. Ikonat renditen sipas radhës në ikonostas. Në ikonën e madhe të Shën Mërisë në ikonostas gjendet mbishkrimi: “Lutje shërbëtorëve të perëndisë, prift Nikollës dhe e të vëllait Kostandinit”.⁹³ Në ikonën e Joan Pagëzorit është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Ristan Subashit”.⁹⁴ Në ikonën e madhe të Kryeengjëjve në ikonostasin e kishës së Shën Kollit në Vanaj gjendet një mbishkrim, i cili vërteton se ikonat janë pikturuar nga Kostandin Zografi: “Me dorën e Kostandinit, nga Korça në vitin 1781, gusht 19”.⁹⁵ Rreth një kambane është shkruar: “1859. Me dorën e Gjergjit dhe të Vasilit të Janit Caraplanitëve në Janinë. Është e Shën Kollit në Vanaj, kujdestar është Trifon Avrami dhe Naumi i Thimit, me kujdesin e Nikollë Kostës, Anastas Dhimitër Argovasis”.⁹⁶ Tek një kabanë tjetër është shkruar: “Papa Profiri, Trifon Mertikas kushuri i parë i Naum Efthimit dhe të bijtë Athanasi, Dhimitri, Nikolla 1874. Depozitë bronzi C.I.Myler, Trieste”.⁹⁷

⁹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 192, faqe 119.

⁹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 280, faqe 147.

⁹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 284, faqe 148.

⁹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 151, faqe 107-108.

⁹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 238, faqe 134.

⁹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 253, faqe 249-250.

Kisha e “Shën Kollit” në Vanaj të Myzeqesë gjatë viteve 1998-1999 është restauruar me fondet e Kishës Ortodokse. Punimet restauruese kapën shifrat 72.000 dollarë. Realizimi i punimeve u krye nga specialistët e Institutit të Monumenteve me drejtues Ing. G. Samimin. U kryen këto punime restauruese: riparimi i çatisë së kishës, riparimi i mureve, sistemi elektrik, pastrimi nga dherat përreth mureve të kishës etj.⁹⁸

KISHA E SHËN GJERGJIT NË FIER

Kisha e vjetër e “Shën Gjergjit” u ndërtua në vitin 1782 nga një grup ndërtuesish. Kisha kishte përmasat 26x20 m dhe përbëhej nga salla tri nefëshe, pagëzimet dhe dy portikë. Në vitin 1923 në vend të kambanerisë së vjetër u ngrit kambaneria e re. Kisha e “Shën Gjergjit” ishte zbukuruar me afreske të pikturuara prej Joan Çetirit, në vitin 1782. Punimet për ndërtimin e kishës së “Shën Gjergjit” janë drejtuar nga kryemjeshtri Gega. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet në pjesën e jashtme të apsidës: “Në vitin 1782 e ka ndërtuar që nga fillimi kryemjeshtri Gega. I përjetshëm kujtimi”.⁹⁹ Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1786. Kjo datë është e gdhendur nën kryqin e ikonostasit të kishës”.¹⁰⁰ Ikonat e ikonostasit janë punuar nga Joan Çetiri. Mbi ikonën e Krishtit në ikonostas gjendet mbishkrimi: “1798 shkurt 16. Me dorën e Jan Çetirit, nga qyteti Grabovë”.¹⁰¹

⁹⁸-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 127-130.

⁹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 153, faqe 108.

¹⁰⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 162, faqe 111.

¹⁰¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 172, faqe 114.

Kjo kishë u ka shërbyer besimtarëve për 185 vjet derisa u shkatërrua plotësisht më 23 prill të vitit 1967, në kohën që filloi ndalimi i fesë nga regjimi ateist. Në vitin 1992 në një cep të truallit ku më parë gjendej kisha e vjetër, për të plotësuar nevojat e komunitetit ortodoks u ndërtua një kishë e përkohshme me elementë parafabrikat, ndërsa më 12 janar të vitit 1997 Fortlumturia e Tij, Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Anastasi kreu shërbesën e vendosjes së gurit të themelit të kishës së re katedrale. Kisha është e tipit bazilikë dhe zë një sipërfaqe ndërtimi rreth 1000 metra katrorë, me lartësi në kupolë 23 metra dhe me kambaneri 30 metra të lartë.



Kisha e re u projektua që të ishte sa më e ngjashme me kishën e vjetër. Punimet ndërtimore i kreu firma vendase “Tris” me administratorë Anastas Pone, Sotiraq Kola, Arqile Gjata dhe

Artur Dafa. Teknik i punimeve ka qenë Nikolla Subashi. Liturgjia e parë në katedralen e re është celebruar më 22 prill 2007 dhe pas dy vjetësh më 14 maj të vitit 2009 u krye shenjtërimi i kishës. Shërbesa e shenjtërimit u kryesua prej Fortlumturisë së Tij, Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Anastasit, me pjesëmarrjen e Mitropolitit të Beratit, Imzot Ignatit, Episkop Nikollës, Episkop Andonit, klerikëve të kishës atë Ilia Bitës, atë Dhimitër Loshit etj.

Kohët e fundit në qytetin e Fierit ka mbirë si “kërpudhat pas shiut” një “Shoqatë e Intelektualëve Ortodoksë”, kryetar i së cilës është Z. Harrilla Koliçi. Kjo shoqatë me anën e disa prononcimeve në shtypin e shkruar ka ngjallur indinjatën e besimtarëve ortodoksë fierakë. Me anën e disa hipotezave qesharake Z. Koliçi dhe pasuesit e tij, pretendojnë se në themelet e kishës së Shën Gjergjit janë vendosur disa tuba inoksi 60 cm dhe në brendësi të tyre gjenden fletë alumini me shkrime greke. Me këtë rast dua të qartësoj Z. Koliçi se pretendimi i tij është i pavërtetë. Sipas tipikosë që zbatohet në Kishën Ortodokse në gurin e themelit të çdo kisha duhet të jetë ky mbishkrim: “Me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Kjo Kishë u themelua për nder dhe kujtim të Shën (aksh) me dorën e Hirësisë së Tij, Peshkopit (aksh), në ditën (aksh) të muajit (aksh) të motit (aksh) pas lindjes së Zotit Jesu Krisht”.¹⁰²

Gjithashtu Llazar Çuko, me cilësinë e koordinatorit të zyrës teknike pranë Mitropolisë së Beratit deklaroi se në themelet e kësaj kisha është vendosur vetëm guri i themelit me mbishkrimin përkatës në gjuhën shqipe dhe jo tuba inoksi me fletë alumini siç pretendon Z. Koliçi dhe intelektualët që e pasojnë atë.

¹⁰²-Uratore e Kishës Ortodokse, e përktheu Imzot Fan S. Noli, Boston, Mass. 1941, faqe 364-365.

KISHA E SHËN NIKOLLËS NË KURJAN TË FIERIT

Kisha e “Shën Nikollës” gjendet mbi një kodër në fshatin Kurjan të rrethit të Fierit. Kisha është e ndërtuar me muraturë me tulla të kuqe dhe gurë të skuadruar tek qoshet. Është kishë e stilit bizantin dhe përbëhet nga naosi dhe narteksi. Kisha mendohet të jetë ndërtuar në shekullin e XIV. Kupola është shembur dhe sot është zëvendësuar nga një çati prej druri dhe tjegullash. Po kështu, kishës i mungon edhe portiku që ndodhej në anën perëndimore të saj, si dhe dy portikë të tjerë të vegjël që mbulonin portat veriore dhe jugore të naosit. Kanë mbetur vetëm bazamentet dhe disa kapitele antike te stilit dorik.¹⁰³



Në vitin 1956 gjatë punës kërkimore të një ekspedite të Universitetit të Tiranës u zbulua se afresket e kishës së Kurjanit janë pikturuar në vitin 1578. Nga një mbishkrim që gjendet mbi suva në nikën e prothesit në kungë mësojmë se afresket e kishës janë pikturuar nga Nikolla Onufri dhe ndihmësi i tij Joani: “Kur të ngresh duart para Perëndisë o meshtar i Perëndisë, më përmend

¹⁰³-Aleksandër Meksi, Arkitektura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1983, faqe 176.

dhe mua mëkatarin, dhe të paditurin Janin dhe Nikollën. Lutuni për zotëritë. Amni”.¹⁰⁴ Gjatë pikturimit të afreskeve të kishës ikonografët janë ndikuar nga piktura e Pojanit. Në këtë kishë gjendet skena e “Kungimit të Marisë egjiptiane nga jerondi Zosima”. Këtë skenë e hasim më parë në Pojan. Afresket e kishës së Kurjanit janë të stilit bizantin. Tek to shihen gjithashtu tendenca të traditës vendase. Fragmentet e afreskave të kishës së “Shën Nikollës” në Krujan kanë ngjashmëri me ata të trapezarisë së manastirit të Pojanit. Tek të dy këto kisha hasim motivin e imitacionit të pllakave prej mermeri në formë këndëdrejtë.¹⁰⁵ Në prill të vitit 1782 kisha është restauruar. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim i gdhendur në gur në portën perëndimore të kishës: “Viti 1782. Prill”.¹⁰⁶ Kisha e “Shën Nikollës” së Krujanit në vitin 1963 u shpall monument kulture.

KISHA E SHËN TODRIT NË KADIPASHAJ

Kisha e “Shën Todrit” gjendet në fshatin Kadipashaj të Myzeqesë. Naosi është i tipit bazilikal me përmasa të brendshme 14x8.40 metra. Kisha mbulohet nga një tavan druri. Alatari i kishës ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Narteksi gjendet në anën perëndimore të kishës dhe është dykatësh. Një palë shkallë prej druri shërbejnë për tu ngjitur tek gjinekoniti. Kambaneria gjendet në anën perëndimore të kishës. Muratura e kishës është prej guri dhe më pas vijon me rulla. Apsida është me blloqe guri të latuar dhe zbukurohet nga disa nike të harkuara.

¹⁰⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.94, faqe 88.

¹⁰⁵-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar, 55, faqe 142.

¹⁰⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 156, faqe 109.

Muratura e apsidës përfundon me një kornizë tullash në formë dhëmbë sharre.¹⁰⁷ Kisha është ndërtuar në mars të vitit 1800. Kjo datë gjendet mbi portën perëndimore në narteksin e kishës.¹⁰⁸ Kisha e “Shën Todrit” në Kadipashaj është pikturuar prej Joan Çetirit dhe nipit të tij Nikollës në vitin 1801. Mbi portën perëndimore brenda kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1801 dhe u përfundua në muajin janar 15, me dorën e Jan Çetirit dhe nipit të tij Nikollës nga qyteti Grabovë, në kohën e të shumëhirshmit Mitropolitit të Beratit, zotit Joasaf dhe të priftërinjve që gjendeshin dhe subash ishte Kostë Nushi dhe në vazhdim të këtyre, të cilët i kujtoftë zoti ynë, Jesu Krisht në mbretërinë e qiejve”.¹⁰⁹

KISHA E SHËN GJERGJIT NË STRUMË TË MYZEQESË

Kisha e “Shën Gjergjit” përbëhet nga naosi dhe hajatat. Naosi është njënefësh me përmasa të brendshme 14.0x5.50 metra. Kisha mbulohet nga një tavan druri. Alatari i kishës ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi pre druri të gdhendur. Kambaneria gjendet në anën perëndimore të kishës, mbi portën hyrëse. Muratura e kishës është prej guri. Apsida ka muraturë të thjeshtë dhe përfundon me një kornizë.¹¹⁰

Kisha e “Shën Gjergjit” është pikturuar prej Joan Çetirit dhe nipit të tij Nikollës, në vitin 1801. Mbi portën perëndimore

¹⁰⁷-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 220-223.

¹⁰⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 175, faqe 115.

¹⁰⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 177, faqe 115-116.

¹¹⁰-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 223-224.

brenda kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1801 dhe u përfundua në muajin tetor 5, me dorën e Jan Çetirit dhe Nikollës, nipit të tij, nga qyteti Grabovë, në kohën e të gjithirshmit Mitropolitit të Beratit, zotit Joasaf dhe prift Llazarit ekonomit dhe në vazhdim të tjetër, të cilët i kujtoftë zoti ynë, Jesu Krisht në mbretërinë e qiejve”.¹¹¹

KISHA E SHËN KOLLIT NË TOSHKËZ TË MYZEQESË

Kisha e “Shën Kollit” është ndërtuar në vitin 1811. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajatat, të cilat e rrethojnë nga tri anët. Naosi është njënefësh dhe i mbuluar me çati druri. Kambaneria gjendet në pjesën perëndimore të saj. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me laç gëlqereje. Më pas është suvatuar me një shtresë të hollë laçi. Apsida është ndërtuar me gurë të skalitur, të qarkuar me tulla. Në pjesën e sipërme përfundon me një kornizë me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre.¹¹¹ Kisha e “Shën Kollit” është pikturuar prej vëllezërve Çetiri në vitin 1811. Mbi portën perëndimore jashtë naosit gjendet mbishkrimi: “Në vitin 1811 u pikturua ky tempull dhe thisiaster (kunga) i hirshëm dhe eksonarteksi me shpenzimet e të krishterëve, që banojnë në këtë famulli, në kohën e peshkopatit të peshkopit të shenjtë të Beratit Joasafit të ri, dhe në kohën e priftërimin të zotit, Papa Kostandin Darça grabovarit, në kohën e kujdestarisë së tij, me dorën e Jan Çetirit dhe Naumit, birit të tij”.¹¹³ Naosi ndahet me altarin me anën

¹¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 176, faqe 115.

¹¹²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 228-229.

¹¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 194, faqe 120.

e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Mbi kryqin e ikonostasit shkruhet viti 1813, i cili tregon kohën e gdhendjes së ikonostasit.¹¹⁴

KISHA E MARMIROIT NË ORIKUM TË VLORËS

Kisha e “Marmiroit” gjendet mbi një kodrinë të Orikumit rreth dy orë nga Dukati. Kisha mendohet të jetë ndërtuar në shekullin XII-XIII dhe është kishë e stilit biznatin në formë kryqi të brendashkruar në një kube cilindrike. Kisha e “Marmiroit” përbëhet nga naosi në formë kryqi dhe narteksi, i cili është i rrënuar në anën perëndimore.



Në apsidën e kishës gjendet një dritare e vogël. Kisha është ndërtuar me gurë të çrregullt dhe me copa tjegullash të vendosura ndërmjet tyre. Kisha ka qenë e pikturuar e gjitha, por nëpër mure kanë mbetur vetëm fragmente të afreskeve të dikurshëm. Nëpër pikturat murale të mbetura nuk mund të identifikohet shenji të

¹¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 199, faqe 122.

cilit i është kushtuar kisha. Kisha e “Marmiroit” është shpallur monument kulture në vitin 1963. Në faqen e murit jugor përmbi portë gjenden skena “Lindja e Krishtit”, prej së cilës ka shpëtuar vetëm figura e Josifit dhe një grua me një send në dorë. Në murin verior pranë portës gjendet figura e një shenjti.¹¹⁵

BAZILIKA E MESAPLIKUT

Bazilika e Mesaplikut gjendet në vendin e quajtur “Bregu i kishës” në kodrën e Smokthinës në Vlorë. Gërmimet për zbulimin e bazilikës janë kryer në vitin 1979. Bazilika është trinefëshe dhe ka përmasa 13.80x11.0 metra. Muret janë ndërtuar me gurë të çrregullt të lidhur me llaç të bollshëm. Dyshemeja e naosit ka qenë e shtruar me mozaik me motive gjeometrike, bimore dhe shtazore. Bazilika daton në shek. VI. Mozaiku i Mesaplikut u zbulua në vitin 1979 nga arkeologu Damian Komata. Mozaiku ka përmasa 230x349 cm dhe përbëhet prej gurësh të vegjël kubikë duke krijuar figura zoomorfe: zogj dhe peshq, të cilët janë ndërthurur më rrathë dhe motive bimore siç janë lulet dhe frutat, ku nuk mungojnë edhe mollët e dardhat. Nga pjesët e ruajtura të tij mund të veçojmë atë të aniatës jugore e cila përbëhet nga shtatë medalionë tetëkëndësh. Figura kryesore në mozaik është ajo e një burri. Ai paraqitet në profil duke buzëqeshur dhe në kokë mban një kësulë me antenë, në të cilën është lidhur një kordele dyshe. Dy kordelet prapa kokës i japin atij atributin e perandorit të përbotshëm. Përpara fytyrës së personit është shkruar një frazë e vendosur në formë kolone që lexohet APARKEAS, i cili mendohet të ketë qenë emri i kthitorit të mozaikut. Në vitin 1981 mozaiku është vendosur në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.¹¹⁶

¹¹⁵-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 178-179.

¹¹⁶-Moikom Zeqo, Kulti gnostik i Aparkeas-Abraksas, Albanopol, Tiranë 2009, faqe 3-5.

MANASTIRET E MITROPOLISË SË BERATIT

1. Manastiri i Ardenicës ngrihet mbi një kodrinë që dominon fshatin Kolonjë të Myzeqesë. Mbi portën e hyrjes është data 1 maj 1477, që mendohet të jetë data e ndërtimit. Ka pasur një bibliotekë të pasur dhe një shkollë të mesme, gjithashtu ka qenë në gjendje të mirë ekonomike. Kisha e manastirit i është kushtuar “Lindjes së Shën Marisë” dhe kremton më 8 shtator. Ardenicë ka kuptimin *burim uji*. Ai rrethohet nga mure guri të larta. Hyrja për në manastir është nga ana lindore nëpërmjet një porte me qemerë. Oborri është i shtruar me kalldrëm. Hajatet janë dykatëshe dhe shërbejnë si qeli për murgjit. Kati përdhes përdorej si hambar për bereqetin. Në mjediset e manastirit gjendet një mulli për prodhimin e vajit të ullirit. Manastiri i ka fillimet veta në shekullin X me kishëzën e “Shën Triadhës”, e cila ka përmasa të brendshme 5.15x3.06 metra.¹¹⁷

Manastiri i Ardenicës ka disa faza ndërtimi. Formën si manastir e ka marrë në shekujt XIII-XIV, në kohën e Despotatit të Epirit. Kisha e “Lindjes së Hyjlindëses” mendohet t’i ketë fillimet e saj në shekujt XV-XVI. Nektar Tërpo Voskopojari ka nënshkruar në një gravurë në manastirin e Ardenicës. Në të është shkruar një lutje e shkurtër drejtuar Hyjlindëses në katër gjuhë, greqisht, latinisht, arumanisht dhe shqip. Gravura ka këtë tekst në shqip të shkruar me alfabetin grek: “Virgjin Mamë eperëndis uro prë nee fajtorëte”. Në gravurë paraqitet Shën Mëria me Krishtin e vogël ndër duar. Ajo daton në vitin 1731 dhe poshtë saj është nënshkrimi i hieromonak Nektarit. Në atë kohë Nektar Tërpo Voskopojari ishte igumeni i manastirit të Ardenicës. Gjithashtu mendohet që në fund të shekullit XVII manastiri të jetë shkatërruar. Forma e sotme e tij i përket një rindërtimi të shekullit XVIII. Në këtë shekull

¹¹⁷-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 207-209.

janë rindërtuar kisha e “Lindjes së Hyjlindëses”, kishëza e “Shën Triadhës”, si edhe pjesë të tjera të manastirit. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet në një pllakë guri mbi faqen e jashtme të murit jugor të kishës së “Shën Triadhës”: “U përtërinë prej themeli godinat përquark në kohën kur ishte peshkop i Beratit Joasafi dhe në kohën e igumenëve K.L.M. dhe Manasiut, Jerotheut, Jakovit, Theodhosit, Danielit, Theoklitit, Dionisit, Joanikit dhe murgut Kirillit dhe dhiakon Anastasit, kujtoji o zot në mbretërinë tënde”.¹¹⁸



Ky mbishkrim na bën me dije se manastiri është rindërtuar më 1 maj të vitit 1778. Gjithashtu në murin jugor të kishës së “Shën Triadhës” gjendet një mbishkrim tjetër: “U rindërtua prej themeli godinat përreth, në kohën e peshkopatit të Beratit zotit Vasilit në kohën e kujdestarisë të ekonom Kristo Leshit, të këshilltarëve Spiro Gjinit, Jakov Bozdos, Nikollë Gjergjit dhe prift Markut, prej mjeshtërve nga Dibra Sali dhe Sa...Pramt. Grigor Ziu”.¹¹⁹

¹¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 148, faqe 106-107.

¹¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 274, faqe 144.

Fama dhe emri i madh i manastirit bënë që ai të krijonte një bibliotekë shumë të pasur, e cila fatkeqësisht u dogj në vitin 1932. Biblioteka ndodhej në të majtë sapo hyn në manastir dhe thuhet që ishte e para në Shqipëri në atë kohë. Aty gjendeshin mijëra vëllime, të cilat qenë vepra të rralla të kulturës dhe të identitetit të popullit shqiptar dokumente me vlera të çmueshme historike, duke përfshirë edhe një pjesë të korrespondencës së Ali pashë Tepelenës. Pas djegies së bibliotekës nuk kemi njoftime për ekzistencën e ndonjë vëllazërie murgjërORE në manastir, i cili administrohej nga laikë dhe shërbesat i kryente zakonisht një prift i martuar. Ndër administratorët përmendet Luc Bozdo, i cili ka meremetuar qelitë e dhomat e djegura.¹²⁰

Manastiri “Lindja e Shën Marisë” në Ardenicë zë një sipërfaqe prej 2500 metra katrorë dhe ka pasur në pronësi: 1-toka bujqësore 1900 dynymë, 2-kullota 1504 dynymë, 3-korije 397 dynymë, 4-livadhe 576 dynymë, 5-pyje rreth manastirit 20 dynymë, 6-drurë frutorë 3 dynymë, 7-rrënjë ullinj 1050 copë etj.¹²¹

Rrebeshi ateist i vitit 1967 solli një grup të rinjsh nga Fieri për ta shkatërruar manastirin, por ai u mbrojt prej Imzot Irine Banushit, i cili ndodhej i internuar në Ardenicë. Ai u foli gjimnazistëve: “Historia nuk do të na e falë. Ky manastir nuk ka vetëm vlera fetare për kombin tonë, por edhe historike, pasi në 10 maj të vitit 1451 në manastir janë kurorëzuar heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti me Donikën”. Të rinjtë dhe mësuesit e tyre u bindën dhe manastiri shpëtoi. Vendosja e repartit ushtarak në të i solli mjaft dëme. Përsëri me ndërhyrjen e Imzot Irineut, manastiri u shpall monument kulture në mbrotjen e shtetit. Meritë ka edhe teologu Theofan Popa, i cili në atë kohë punonte në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe kontribuoi mjaft për ruajtjen e

¹²⁰-Pan. Manastiret kryesorë të Dhioqezës së Beratit, Jeta Kristiane, Tiranë 1943, faqe 175-178.

¹²¹-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, tetor 1996, faqe 3.

kishave. Rreth vitit 1988-89 manastiri u hap si qendër turistike, ku kisha shërbente si muze, ndërsa godinat rrethuese të tij si bar, restorant, hotel, madje edhe disko. Kjo situatë vazhdoi deri të “Enjten e Madhe” të Pashkëve të vitit 1996, kur manastiri u mor prej Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe shërben si një fidanishte për jetën murgjërore.

Kisha “Lindja e Shën Marisë” u ringrit mbi themelet e kishës së vjetër. Punimet për rindërtimin e kishës nisën më 10 maj të vitit 1743. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet i gdhendur në një pllakë të murosur në murin lindor jashtë kishës: “U rindërtua ky tempull prej themeli në kohën e peshkopatit të Mitropolitit të shenjtë, zotit Metodit, nga katundi Bubullimë dhe në kohën kur ishin igumenët Neofiti dhe Andoni - ktitorët”.¹²²



Gjithashtu një mbishkrim tjetër që gjendet mbi portën perëndimore brenda naosit të kishës na vërteton se rindërtimi i kishës ka përfunduar më 20 shkurt të vitit 1744. “U ndërtua ky tempull i hirshëm në kohën e të gjithirshmit, mitropolitit të beratit, zotit Metodit dhe igumen Andonit, jeromonakëve Pankratit,

¹²²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 115, faqe 96-97.

Klimentit, Vikentit, Manasiut, Mitrofanit, jerodiakonëve Josifit dhe jerotheut, murgjërve Vasilit, Theoklitit, Kozmait, Joakimit, të cilët për mundimet e tyre fitofshin mbretërinë e qiejvve. Viti i ekonomisë së mishëruar 1744, në muajin shkurt 20”.¹²³ Kisha është bazilikë trinefëshe dhe përbëhet nga naosi, nartekxi dhe kulla e kambanerisë. Naosi ka përmasa 24.35x10.80 metra dhe ndriçohet prej dritareve që gjenden në pjesën e sipërme të mureve verior, jugor dhe lindor. Muratura e kishës përbëhet nga gurë shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Afresket janë pikturuar nga vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe datojnë në vitin 1744. Kjo shikohet në një mbishkrim mbi portën perëndimore brenda naosit: “Me dorën e vëllezërve Kostandin e Athanas, nga qyteti i Korçës”.¹²⁴ Përveç afreskeve me skena biblike të bie në sy Joan Kukuzeli, i cili ishte me origjinë nga Durrësi. Duhet theksuar se është i vetmi afresk që i kushtohet këtij shenjt, që hodhi bazat e muzikës bizantine.

Një autor tjetër shqiptar, Kostandin Shpataraku, ka pikturuar ikonat e lëvizshme të ikonostasit, të cilat datojnë vitin 1744. Në një pllakë guri në hierore gjendet mbishkrimi, i cili vërteton se gdhendjet e ikonostasit, amvonit dhe fronit dhespotik janë realizuar nga një grup gdhendësish nga Dibra e Madhe (Golloborda). Amvoni është i skalitur dhe i stolitur me ikona, të cilat paraqesin shenjtorët në këmbë. Në portën e amvonit është ikona e Shën Mihailit. Ikonostasi që ndan hieroren nga naosi është i gdhendur në dru arre. Simbolika e gdhendjeve që zbukurojnë ikonostasin është marrë nga bota bimore dhe shtazore. Përmasat e ikonostasit janë 8.75 m gjatësi dhe 4.5 m lartësi. Në qendër të ikonostasit është kryqi i gdhendur, në të cilin ikonografi Kostandin Shpataraku ka pikturuar me shije të hollë artistike skenën e “Kryqezimit”. Në dyert e bukura janë pikturuar ikona e

¹²³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 117, faqe 96-97.

¹²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 118, faqe 98.

“Kryeengjëllit Gabriel” dhe e “Shën Mërisë” me përmasat 115 me 75 cm. Djathtas ndodhet “Krishti në Fron” me përmasa 116 me 74 cm, ndërsa në të majtë gjendet “Shën Mëria në Fron” me po ato përmasa. Në vijim renditen ikonat “Lindja e Shën Mërisë” me përmasa 116 me 74 cm, “Joan Pagëzori” me përmasa 106 me 46 cm, “Shën Kolli në Fron” me përmasa 116 me 77 cm, “Joan Teologu” me përmasa 114 me 74 cm, “Mbledhja e Kryeengjejve” me përmasa 115 me 74 cm.



Në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostas gjendet mbishkrimi: “Me shpenzimet e esnafit të bashkëpunuesve të Voskopojës. Prej Krishtit 1744. Dora e jerothiakon Kostandinit nga Shpati”.¹²⁵ Ndërsa në ikonën e Shën Mërisë gjenden mbishkrimi: “Prej Krishtit 1744. Me shpenzimet e bakejve të Voskopojës”.¹²⁶ Mbi ikonën e Gjon Vladimirit gjendet mbishkrimi: “Mbret i Shqipërisë, Gjon Vladimir... mua shërbëtorit të Ardenicës, Andonit në vitin prej Krishtit 1739. Dora e jerothiakon Kostandinit

¹²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 120, faqe 98-99.

¹²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 119, faqe 98.

nga Shpati”.¹²⁷ Ikonat e vogla janë të përmasave 43 me 34 cm dhe paraqesin aspekte nga jeta e Krishtit dhe e Shën Mërisë. Ndër to mund të përmendim: “Ungjillëzimi”, “Lindja e Shën Mërisë”, “Lindja e Krishtit”, “Lindja e Pagëzorit”, “Kryqëzimi i Krishtit”, “Pendikostia”, “Shërimi i të paralizuarit”, “Hyrja e Shën Mërisë në Tempull”, “Shërimi i të verbërit”, “E diela e Samaritanes”, “Shestja”, “Mos më prek”, “Shpërfytyrimi”, “Rrethprerja”, “Mbledhja e Apostujve” etj. Në ikonën “Lindja e Shën Mërisë” gjendet mbishkrimi: “Me shpenzimet e esnafit të tregtarëve çikërrimadh të Voskopojës”.¹²⁸ Mbi ikonostasin e kishës varen katër kandila të mëdhenj prej argjendi të cilat mbajnë datat: 1725, 1740, 1745, 1756.¹²⁹ Mbishkrimi që gjendet mbi kapakët prej argjendi të Ungjillit daton në vitin 1745. “Ky ungjill është i Manastirit të Hyjëlidësës të mbiquajtur Ardenica, viti 1745”.¹³⁰ Në muajin shkurt të vitit 1754 është ndërtuar hajati i kishës. Kjo vërtetohet me anën e një mbishkrimi të gdhendur në gur mbi harkun e parë të kolonës së hajatit perëndimor të kishës.¹³¹ Artofori është punuar prej argjendi me ornamente vegjetale në relief. Mbishkrimi që gjendet në të vërteton se është punuar në gusht të vitit 1813: “Viti 1813, gusht. Ky artofor është i Manastirit të shenjtë të Ardenicës dhe është bërë me shpenzimet dhe të dalurat e igumenit të shenjtë të Zotit Daniel. Me dorën e Postolit, birit të Jakovit elbasanasit”.¹³²

¹²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 114, faqe 96.

¹²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 119, faqe 98.

¹²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 122, faqe 99.

¹³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 121, faqe 99.

¹³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 128, faqe 101.

¹³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 198, faqe 122.

Fatkeqësisht ky artofor me vlerë për trashëgiminë tonë kulturore është grabitur nga njerëz keqbërës dhe gjendet në një muze të Athinës.

2. Manastiri i Pojanit gjendet pranë qytetit antik të Apolonisë. Manastiri i është kushtuar “Fjetjes së Shën Marisë” dhe kremton më 15 gusht. Mund të themi se manastiri ka qenë qendër e rëndësishme kishtare. Ndërhyrja e fundit në konakët e manastirit është bërë rreth viteve 1916-1918 nga misionet luftarake austro-italiane, ndërsa në vitin 1960 manastiri u kthye në muze arkeologjik dhe u ndalua kryerja e riteve fetare.¹³³ Ky manastir ka qenë në gjendje të mirë ekonomike. Manastiri “Fjetja e Shën Mërisë” në Pojan ka pasur në pronësi të tij: 1-tokë bujqësore 530 dynym, 2-livadhe e kullota 170 dynym, 3-rrënjë ulliri 300 copë.¹³⁴

Kisha e Fjetjes së Hyjlindëses është e tipit me kryq, i brendashkruar me kupolë. Kisha përbëhet nga eksonarteksi, narteksi, naosi dhe altari. Në anën veriore të kishës gjendet një paraklis i vogël. Naosi ndahet me altarin nëpërmjet një ikonostasi prej druri të gdhendur. Muratura e kishës përbëhet prej dy brezash. Në brezin e parë janë përdorur blloqe masive prej guri, të cilat janë nxjerrë nga rrënojat antike të Apollonisë, ndërsa brezi i sipërm është ndërtuar me tulla. Muret përfundojnë me korniza tullash në formë dhëmbësharre. Gjatë rindërtimit të çatisë së kishës, në anën jugore është vendosur një pllakë me një shqiponjë dhe anash saj një kryq. Apsida e kishës është pesëfaqëshe, ndërsa tamburi është dymbëdhjetëfaqësh. Arkitektura e kishës është e tipit kryeqytetas. Kjo tregon për një lidhje të arkitekturës së Pojanit me atë të Kostandinopojës.¹³⁵

¹³³-Koço Zheku, Kisha e Shën Marisë në Manastirin e Apolonisë, Ngjallja, mars 1997, faqe 10.

¹³⁴-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.

¹³⁵-Aleksandër Meksi, Arkitektura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1983, faqe 222-226.

Në vitin 1778 mbi murin perëndimor të narteksit u ngrit kambaneria, ktitor i së cilës ka qenë igumeni Joasaf. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi: “Ktitori është igumen Joasafi 1778”.¹³⁶ Rreth një pagëzimore prej guri, e cila gjendej në narteksin e kishës është shkruar: “U ngrit dhe u ndërtua kjo kupë guri me kontributin, shpenzimet e Stefan Protoprezviterit dhe Anastas Protoprezviterit, mjeshtër Gjergji”.¹³⁷



Kisha mendohet të jetë ndërtuar gjatë viteve 1272-1282, gjatë viteve të sundimit të perandorit Mihail Paleologut dhe të birit Andronikut II Paleolog. Gjatë viteve që përmendëm më sipër të dy perandorët atë dhe bir kanë sunduar së bashku. Një nga ktitorët kryesorë ka qenë perandori Andronik Paleologu II (1282-1328) piktura e familjes së të cilit ndodhet edhe sot në brendësi të narteksit të kishës. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi fasadën e eksonarteksit të kishës mbi kokën e Andronik Paleologut:

¹³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 146, faqe 106.

¹³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 285, faqe 148.

“Androniku besnik në Krishtin, perëndinë, mbret i bizantinëve, Komnen, Angjel Duka Paleologu”.¹³⁸ Gjithashtu edhe mbishkrimi që gjendet mbi kokën e Mihail Paleologut përmend të njejtin fakt: “Kostandini i ri, Komnen, dukë, Angjel Paleologu, si krishtdashës dhe murgdashës i vërtetë”.¹³⁹ Në brendësi të kishës ruhen disa copëza afreskesh. Në eksonarteksin e kishës gjendet afresku me përmasa 1.32x3.330 metra, në të cilin paraqitet perandori i Kostandinopojës Mihail VIII Paleologu me familjen e tij. Majtas perandorit paraqitet gruaja e tij dhe midis tyre paraqitet djali Androniku II Paleolog. Mihaili dhe Androniku kanë veshur stoli dhe mbi kryet kanë kurora perandorake, fakt ky që tregon se gjatë ndërtimit dhe pikturimit të kishës (ndërmjet viteve 1272-1282) ata kanë qenë bashkësundimtarë. Djathtas perandorit Mihail paraqitet Shën Mëria, me maketin e kishës në duar dhe me faqe të kthyer nga ai që tregon se perandori i ka dhuruar asaj tempullin. Perandori Mihail paraqitet me veshje ceremoniale perandorake të rëndë. Ky afresk e identifikon perandorin Mihail si ktitor të rindërtimit të kishës së “Shën Marisë”, por edhe si ktitor të afreskeve të kishës. Në faqen e rrafshët të nikes së prothesit gjendet skena e “Zbritjes nga Kryqi”, e cila paraqet Krishtin të sapozbritur prej kryqit. Pranë Krishtit paraqitet Shën Mëria dhe një engjëll. Në këtë kishë vetëm këto dy afreske të dëmtuara kanë mundur ti rezistojnë kohës.¹⁴⁰ Të dy afreskët janë me vlera artistike, ndonëse ndryshojnë nga stili i punimit. Ky fakt vërteton se afreskët janë punuar në kohë të ndryshme dhe nga ikonografë të ndryshëm.¹⁴¹

¹³⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 86, faqe 82.

¹³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 87, faqe 82.

¹⁴⁰-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 164-168.

¹⁴¹-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar, 55, faqe 93

Në vitin 1762 ikonat e ikonostasit të kishës janë ritokuar, gjë e cila vërtetohet me anën e një mbishkrimi mbi ikonën e Shën Mërisë: “U pikturua për së dyti më 1762”.¹⁴² Ikonat e ikonostasit janë ritokuar prej Dhimitrit: “Me dorën time të piktor Dhimitrit, birit të piktor Nikollës nga katundi...Me kontributin e zotit, zotit Konstandin, arkondit”.¹⁴³

Trapezaria e manastirit gjendet në anën perëndimore të manastirit. Trapezaria ka një sipërfaqe prej 70 metrash. Muratura përbëhet nga dy breza: pjesa e poshtme është e ndërtuar me gurë të mëdhenj dhe tulla ndërmjet tyre, ndërsa pjesa e sipërme është ndërtuar me kluasonazh me dy tulla vertikale. Apsidat janë trifaqëshe dhe në pjesën e poshtme janë njëlloj me muret, ndërsa pjesa e sipërme e tyre është e ndërtuar me tulla. Në secilën faqe kanë nga një nike të shkallëzuar me harqe tullash. Trapezaria është restauruar në vitin 1962.¹⁴⁴

Pjesa më e madhe e mureve të brendshëm të trapezarisë është e pikturuar me afreske. E veçanta është se skenat biblike nuk nisin me ciklin e fastave të mëdha, gjithashtu nuk radhiten sipas kronologjisë, por janë dhënë vetëm disa skena nga Dhiata e Re, disa murgj dhe martirë, pra ashtu siç e ka kërkuar porositësi, ose si ka preferuar ikonografi. Mbi faqen e murit perëndimor paraqitet skena “Larja e këmbëve të Krishtit nga gruaja mëkatare”. Në këtë skenë ndonëse të dëmtuar paraqitet Krishti, gruaja mëkatare dhe katër persona të tjerë. Krishti paraqitet duke bekuar gruan mëkatare të gjunjëzuar para tij. Skena “Dasma në Kanë” ruhet në gjendje të mirë. Sipër apsidës gjendet skena “Lutja në Gjetsimani”, në të cilën Krishti paraqitet duke u lutur. Nën këtë

¹⁴²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 132, faqe 102.

¹⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 133, faqe 102.

¹⁴⁴-Aleksandër Meksi, Arkitektura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1983, faqe 227-228.

skenë vjen brezi me shenjtorë në medalione dhe në vijim brezi me shenjtorë më këmbë. Në faqen e murit lindor paraqitet skena “Krishti duke predikuar në sinagogë”. Sipër apsidës gjendet një skenë e paidentifikuar. Nga kjo skenë ruhen vetëm tri fragmente figurash me brerore. Nën to gjendet brezi ku shenjtorët paraqiten me medalione, por për shkak të mungesës së nënshkrimeve nuk mund të identifikohen. Nën to gjendet brezi me shenjtorë në këmbë. Në faqen e murit jugor gjendet një skenë shumë e dëmtuar dhe e paidentifikuar. Nën të gjendet “Deisis” dhe majtas saj “Larja e këmbëve të apostujve”. Në anën e djathtë gjendet skena “Krishti mëson apostujt mbi përlulësinë”. Nën të djathtë të apsidës gjendet skena “Profeti Ilia në mal”, ndërsa majtas “Ava Zosima kungon Marinë Egjiptiane”. Nën profetin Ilia gjendet “Shën Damaskini”.¹⁴⁵

3.Manastiri i Kolkondasit. Ky manastir është ngritur në shekullin XVIII dhe i është kushtuar Shën Kozmait. Konakët e manastirit kanë qenë dykatësh. Kati i poshtëm përdorej si magazinë, ndërsa në katin e sipërm gjendeshin rreth 60 qeli, tek të cilat banonin murgjit dhe ata që shërbenin në manastir. Gjithashtu disa nga qelitë qenë përshtatur për të fjetur pelegrinët që vinin në manastir. Konakët e manastirit kanë qenë në formë U-je, duke e rrethuar kishën nga të tri anët. Manastiri ka qenë në gjendje të mirë ekonomike. Në të ka pasur shkollë dhe bibliotekë. Në shkollën e manastirit studionin rreth 100 nxënës, të cilët gjenin strehë në konakët e manastirit. Kisha është bazilikë trinefëshe me përmasa 18.50x10 metra. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç dhe gëlqere. Muret përfundojnë me korniza prej guri të gdhendura. Tamburi është tetëfaqësh dhe i suvatuar, ndërsa apsida lindore është shtatëfaqëshe dhe me dekoracione. Hyrja kryesore e kishës gjendet në anën veriore. Gjithashtu ka një portë në anën perëndimore. Planimetria e kishës së “Shën Kozmait” është në

¹⁴⁵-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 180-183.

formë kryqi të jashtëshkruar.¹⁴⁶ Kisha e manastirit të “Shën Kozmait” është ndërtuar ndërmjet viteve 1813-1814 me porosi të Ali pashë Tepelenës. Kur ky i fundit hyri në Berat iu kujtua murgu Kozma, prandaj thirri Mitropolitin e Beratit Joasaf II, të cilin e urdhëroi të bënte transferimin e lipsanit të shenjtit dhe të ndërtonte manastirin në kujtim të tij. Mbi portën veriore të kishës gjendet një mbishkrim i gdhendur në gur. “Në vitin 1814, maj 22. U ndërtua ky tempull i Shën Kozmait në kohën e të gjithirshmit mitropolit të Beratit, zotit Joasaf, në kohën e igumenit të hirshëm gjithoshënar Theoklitit në kohën e kujdestarisë së zotit Nikollë, Dhimitrit dhe Haxhi Jankut dhe të Protosingjel Parthenit, me përpjekjet dhe mundimet e të gjithë të krishterëve të devotshëm klerikë e laikë. Në1817.....Kozma me mbikqyrjen e të birit Kapedan Kostës, nga katundi Furkë, e parkia e shenjtit të Vellasë”.¹⁴⁷


Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1835. Kjo datë është e gdhendur në dru nën kryqin e ikonostasit.¹⁴⁸ Në gdhendjet e ikonostasit ka motive gjeometrike, bimore dhe zoomorfe. Ikonat e mëdha janë 10, ndërsa ikonat e vogla të festave 19. Ikonostasi dhe ikonat që gjenden në të nuk janë të kategorisë së parë përsa u përket vlerave artistike. Mbi një proskinitar është vendosur një gravurë e derdhur në plumb, tek e cila në qendër gjendet Shën Kozmai dhe anash janë pikturuar skena nga jeta e tij. Gravura është e pikturuar nga mjeshtri Kalinikos në vitin 1829. Mbi derën e altarit gjendet një shqiponjë e gdhendur në dru, ndërsa mbi frontonin e kambanerisë është skalitur në gur një portret gruaje. Gurëgdhendësit në këtë rast kanë portretizuar Vasiliqinë, të shoqen

¹⁴⁶-Stilian Adhami, Ansambli historik dhe arkitektonik-artistik i Kolkondasit-Fier, Monumentet, nr. 2 / 1985 (30), faqe 73-76.

¹⁴⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 201, faqe 122-123.

¹⁴⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 220, faqe 128.

e Ali pashë Tepelenës.¹⁴⁹ Mbi një gur të gdhendur në kambaneri gjendet mbishkrimi: “U ndërtua...i kambanave të shën Kozmait dhe në kohën e kujdestarisë së Sakellarit at Petros, me dorën e Pashtro Gjergjit”.¹⁵⁰ Në apsidë jashtë kishës gjendet një mbishkrim që bën fjalë për Ali pashën. “U ndërtua nga themelet ky tempull hyjnor e i hirshëm me nxitjen e të shumëlartit, Vezir Ali pashës nga Tepelena”.¹⁵¹



Sipas gojëdhënës rreth vitit 1775 gjatë udhëtimeve misionare për të predikuar krishtërimin Shën Kozmai vajti në Tepelenë, ku u gjeti strehë tek sarajet e Hankos, së ëmës së Ali pashë Tepelenës. Të nesërmen murgu Kozma e mori djaloshin Ali dhe u ngjitën në malin e Leklit. Aty murgu Kozma i kishte parashikuar të ardhmen Ali pashait: “Se do të bëhej shumë i dëgjuar, një pasha i madh dhe do të sundote gjithë Shqipërinë, do të nënshtronte Prevezën, Pargën dhe Sulin. Në fund do të shkonte

¹⁴⁹-Stilian Adhami, Ansambli historik dhe arkitektonik-artistik i Kolkondasit-Fier, Monumentet, nr. 2 / 1985 (30), faqe 78.

¹⁵⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 272, faqe 143.

¹⁵¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 275, faqe 144.

me mjekrën e kuqe në Stamboll”. Madje murgu Kozma e këshilloi Aliun që të pajtohej me leklilotët dhe hormovitët.¹⁵² Por pashai nuk e pati kuptuar frazën e fundit: “me mjekrën e kuqe në Stamboll”, e cila parashikonte fundin e tij tragjik. Ai nuk mundi ta kuptonte që turqit do ta vrisnin dhe kokën e prerë me mjekrën e gjakosur do t’ia shpinin Sulltanit. Pas disa vitesh, kur Ali pashai po shihte që profecitë e murgut Kozma po realizoheshin, lidhi miqësi me të. Për miqësinë e Ali pashait me murgun Kozma ka dy letra, të cilat janë botuar nga Mitropoliti i Beratit Anthim Aleksudhi.¹⁵³

Letra e parë: “Ju rumë të nahijes së Beratit, myzeqarë dhe vllahë grabovarë, katunde dhe çifligje, ju lajmëroj se ja ku vura një epitrop që të ndreqë manastirin e plakut Kozma; ndihmova edhe unë me aspra e të ndihmoni edhe ju si t’iu thotë dhespoti, me qëllim që të ndreqet ky manastir. Për ata që nuk do të japin ndihmën e tyre do të më mbetet hatëri dhe pastaj do t’i paguajnë dyfish. Sikundër ju urdhëroj ashtu të bëni pas këtij vendimi. Gjirokastër, më 12 shtator 1813”.

Letra e dytë: “Hair duvaxhitë e mi Mitropolit i Beratit Kolë Mitro dhe Haxhi Janko. Ju përshëndes dhe ju kallëzoj se i mora vesh sa më shkruani dhe u informova me anë të igumenit. U gëzova shumë që u kujdesët për plakun Kozma. Ja tek po vinë aty igumeni dhe Nikolla bashkë me kryemjeshtrin dhe të vini të ndreqni edhe kullat e manastirit, i cili të bëhet më i mirë nga të gjitha manastiret. Me ardhjen time aty dëshiroj ta gjej të mbaruar. Pra, të kujdeseni të gjithë që ta ndreqni dhe të gjithë rumët e Beratit, të mëdhenj dhe të vegjël, të ndihmojnë. Po i shkruaj edhe Ibrahim Arapit t’ju ndihmojë në çdo kohë e në çdo punë. Të bëni si ju shkruaj. Ju përshëndes. Në Janinë më 12 shtator 1814”.

¹⁵²-Pan. Monastiret kryesorë të Dhioqezës së Beratit, Koleksioni i revistave “Jeta Kristiane”, Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë (1940-1944), faqe 240.

¹⁵³-Anthim Aleksudhi, Përshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit, Korfuz 1868, faqe 82.

Sundimtari i Beratit, Ahmet Kurt Pasha e lejoi murgun Kozma të predikonte dhe të hapte shkolla në rrethinat e Myzeqesë. Murgu Kozma i përshkoi ato fshatra dy herë, në vitin 1777 dhe më 1779. Kur pashai i Beratit mësoi se murgu Kozma kishte miqësi me Ali pashë Tepelenën, urdhëroi që ta vrisnin më 24 gusht 1779 dhe trupin e tij e hodhën në lumin Seman. Lipsani i tij u gjend pranë fshatit Kolkondas, ku u varros në narteksin e kishës së “Shën Mërisë” dhe vite më vonë për nder të tij u ngrit manastiri. Me urdhër të Ali pashë Tepelenës lipsanit të shenjtit iu vendos një kokë e florinjte. Ali pashai e porositi në Venecia kokën e florinjte, e cila u punua prej mjeshtrit Nicholas Clykys. Lipsani i plotë i shenjtit u vendos në arkën e posaçme. Në vitin 1918 një arkeolog austriak e përvetësoi kokën e florinjte, për ta shpënë në Vienë.¹⁵⁴



Në vitin 1942 pranë kishës u ndërtua një paraklis ku u vunë reliket e Shën Kozmait dhe një arkë me lipsanin e tij. Arka me lipsanin e shenjtit u ruajt e paprekur deri në vitin 1984, kur u vizitua prej një turisti grek, të quajtur Taqis Kristopulos. Ky i fundit pasi fotografoi lipsanin pa kokë të shenjtit e bëri problem qeveritar. Ky incident detyroi Institutin e Monumenteve që lipsanet e Shën

¹⁵⁴-Mystehak Xhemali, Koka e florinjte e Shën Kozmait në Lushnjë, Albania, 5 maj 2007, faqe 22.

Kozmait të vendoseshin në një arkë të re. Dora e djathtë u vu në një enë qelqi në formë katrore. Gjithashtu kur u mësua se më 1987 do të vinte një delegacion grek, kisha u pastrua nga ferrat dhe u shtrua rruga. Delegacioni kryesohej nga Karolos Papulias, në atë kohë ministër i Jashtëm, Melina Mërkuri, ministre e Kulturës dhe dy ministra të tjerë. Melina ishte shtrirë barkas që nga dera e kishës deri tek arka me lipsanin e shenjtit, duke e puthur me shprestarin. Pas vizitës gazetarët grekë pyetën ish-ministrin e jashtëm të Shqipërisë Reiz Malilen: -Përse mungon koka e shenjtit? Reizi si ateist që ishte u shtang nga pyetja, por Papulias i nxori nga situata duke thënë: “Koka prehet atje ku duhet të prehet”.¹⁵⁵


Pas prishjes së kishave më 1967 arkën me lipsanet e Shën Kozmait i shpunë në Muzeun e Fierit. Sipas Robert Elsie kujdestari i muzeut i ka shitur lipsanet e shenjtit. Gjithashtu pjesë nga lipsanet e Shën Kozmait gjenden në Mitropolinë e Athinës.¹⁵⁶ Pjesa e mbetur nga lipsanet e Shën Kozmait sot gjendet në kishëzën e Kryepiskopatës së Hirshme. Në raste festash ose agripnish ato u serviren besimtarëve për t’u falur. Shërbesa e Shën Kozmait u përkthye në vitin 1931 nga Kryepiskop Kristofor Kisi “Jetëshkrimi dhe akolluthia e dëshmorit të ri dhe isapostullit Shën Kozma” dhe është ribotuar nga autori i këtij libri në vitin 2013. Manastiri i Shën Kozmait përpara reformës agrare ka pasur këto pasuri: 1-toka bujqësore 405 dynymë, 2-tokë pyll 185 dynymë, 3-livadhe e kullota 3404 dynymë, rrënjë ulliri 150. Gjithashtu pasuri të tjera të manastirit janë: lipsani i Shën Kozmait, librat liturgjikë si dhe arkivi i manastirit, ikonat dhe orenditë e tjera, si edhe vula e manastirit, e cila daton në vitin 1921.¹⁵⁷

¹⁵⁵-Ferdinand Dervishi, Shën Kozmai, Si u zbuluan në Fier eshtrat e shenjtit grek, Gazeta Shqiptare, 10 prill 2007, faqe 20-21.

¹⁵⁶-Robert Elsie Olzheim, Shenjtorët e krishterë në Shqipëri, Tempulli Nr. 12, Kotti, Korçë 2007, faqe 71-91.

¹⁵⁷-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.

4. Manastiri i Zvërnecit gjendet në veriperëndim të qytetit të Vlorës, midis Kepit të Triportit dhe fshatit Zvërnec. Me shtrirje në Lagunën e Nartës, në një ishull piktoresk me selvi të latra manastiri të befason me pamjen e tij. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjllindëses”. Kisha është e tipit me kryq dhe kupolë. Në dyshemenë e naosit të kishës mbi një pllakë prej guri gëlqeror me përmasa 1.87x0.67 metra gjendet një mbishkrim: “Këtu prehet Kondos Karanxhas, burrë fisnik me preardhje prej një fisi fisnik, degë tepër fisnike”.¹⁵⁸ Mbishkrimi është vendosur në një fushë të sheshtë të rrethuar prej dy pilastrash korintikë dhe një harku në profil. Nën mbishkrimin është gdhendur një kafkë njeriu e rrethuar ng anj ëgjarpër të kurorëzuar prej dy kockash. Ana Komnena përmend një dukë që quhej Argiros Karanxhas, i cili u dërgua nga Kostandinopoja në Durrës. Gjithashtu pas apsidës së kishës “Fjetja e Hyjllindëses” gjenden disa varre të krishtera, prej të cilëve më i spikaturi është varri i Marigo Pozios, e cila qëndisi flamurin kuq e zi me shkabën dykrenare që u valëvit prej Ismail Qemalit në vitin 1912 në Vlorë.¹⁵⁹



Ishulli i Zvërnecit lidhet me tokën me urë druri 280 m të gjatë, e cila u ndërtua në vitin 1998 me fondet e Kishës Ortodokse.

¹⁵⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 278, faqe 144-145.

¹⁵⁹-Ilirjan Gjika, Manastiri i Shën Mërisë së Zvërnecit, Fjala, 23-30 janar 2005, faqe 18.

5. Manastiri i Shën Trifonit gjendet në Sheqishtë të Myzeqesë. Mbi murin jugor jashtë kishës gjendet mbishkrimi: “Në vitin 1804 mars 25. Ishte kujdestar Llazar Imstari. Me dorën e mjeshtrit Kostandin S. Koliçi ndërtoi gjithë kishën dhe ikonostasin e kishës së shën Trifonit në Sheqishtë. Jan Çanga”.¹⁶⁰ Kisha e manastirit i kushtohet “Hyrjes së Hyjlindëses në Tempull” dhe ka përfunduar së ndërtuari më 5 maj të vitit 1851. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi një pllakë guri mbi murin jugor të kishës: “Viti 1851 maj 5. Tempulli i Shën Trifonit u ndërtua në ditët e dhespotit të shenjtë, zotit Joasaf, në kohën e kujdestarisë së Çiçit të Hotovës dhe David Nanës, me dorën e mjeshtër Naum Miçës, Paris Kalavarës. Mbikqyrësi i mjeshtërve Anastas Xhalasa nga kalaja e Beratit”.¹⁶¹ Në apsidën jashtë kishës së “Hyrjes së Hyjlindëses në Tempull” gjendet ky mbishkrim: “1855 më 19 maj. Në ditët e Kostandinës, kujdestar Vasilit, Tase Paftalit, Taka Çega mjeshtri. E shkrova (unë) Kosta”.¹⁶² Dëshmori Trifon i Sheqishtës përmendet nëpër sinaksarët e kishës se është kapur dhe varur mbi një shelg në vitin 313 pas Krishtit. Manastiri i “Shën Trifonit” kremton më 14 korrik. Një mbishkrim që gjendet mbi portën e mauzoleumit të Shën Trifonit, në anën veriore të kishës na bën me dije për kohën e gjetjes së lipsaneve të shenjtit: “Gjetja ka ndodhur më 19 qershor të vitit 1847”.¹⁶³ Lipsani i shenjtit është ruajtur në manastir deri në vitin 1967.

¹⁶⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 178, faqe 116.

¹⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 229, faqe 131-3-132.

¹⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 234, faqe 133.

¹⁶³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 224, faqe 128-129.

KREU I TRETË

MITROPOLIA E KORÇËS

Korça është një qytet relativisht i ri. Gjon Muzaka në dorëshkrimin “Historia dhe gjenealogjia e Derës së Muzakajve” e përmend Korçën si një kështjellë që ekzistonte aty nga fundi i shek. XIII. Sipas Nuçi Naçit, Korça kishte dy lagje të mëdha, Varoshin ku banonin të krishterët dhe Kasabajnë ku banonin myslimanët. Lagja e Varoshit ndahej në dy pjesë, në Varoshin e Sipërm, që kishte tetë mëhalla, të Panços, Manos, Mantos, Qiros, Barçit, mëhallën e re dhe atë të Kalasë, ndërsa Varoshi i Poshtëm kishte mëhallën e Shën Mërisë. Megjithatë tregu ishte i përbashkët si për të krishterët ashtu edhe për myslimanët.¹

Përpara sundimit osman Korça ka qenë një qytet i vogël. Në një akt kishtar të shekullit XIV Korça përmendet si Episkopatë e Mitropolisë së Selasforit dhe nga pikëpamja e juridiksionit kishtar varej nga Patriarkana e Ohrit deri në vitin 1767. Zhvillimin e qytetit e ndihmoi pozicioni i favorshëm gjeografik, si qendër në rrugën tregtare që lidhte Maqedoninë me Epirin. Kështu në shek. XVII Korça u bë qendër e rëndësishme episkopale, mbasi patriku i Ohrit

¹-Vepror Hasani, Dy lagjet e para Varosh e Kasaba me tetë mëhallat, Metropol, 15 mars 2007, faqe 16.

e ngriti atë në shkallën e Mitropolisë. Mitropolia e Korçës i ka fillimet në shekullin XVII. Kisha e “Fjetjes së Hyjllindëses” në lagjen Varosh i Poshtëm, që konsiderohej si kisha më e vjetër e Korçës ka qenë manastir për kallogjerët. Ajo kohë mbas kohe është djegur dhe bashkësia me shpenzimet e veta e ka rindërtuar. Patriku i Ohrit Joasaf në vitin 1752 i ka dhuruar kësaj kishe një shtëpi me oborr. Kisha katedrale “Burimi Jetëdhënës” ka filluar të ndërtohet në vitin 1707. Për të ngritur këtë tempull ka punuar i gjithë populli i Varoshit. Ktitorët e saj ishin Marko Vasili, Haxhi Koçi dhe Shamo, të cilët, përveç ndihmave financiare dhe materiale, janë përpjekur për të nxjerrë fermanin nga Stambolli. Pranë kishës u ndërtua edhe mitropolia në ditët e kryepriutit Neofit nga Gjirokastra më 15 korrik të vitit 1857. Mitropoliti Neofit pasi u mor vesh me tregtarët korçarë themeloi *Arkën për arsimin*, e cila quhej Llaso. Më 12 nëntor 1876 u hartua rregullorja e arkës popullore Llaso, i cili përbëhej nga 12 nene dhe 5 kapituj.²

Kryetar i Llasos ishte vetë Mitropoliti Neofit Gjirokastriti, i cili çdo vit në të kremten e *Tre Hierarkëve* lexonte emrat e dhuruesve. Sipas rregullores përmendeshin të gjithë dhuruesit, pavarësisht nga shuma që patën ofruar. Nga dhuruesit mund të kujtojmë Dhimitër Çikën, i cili ka ofruar 8.000 lira angleze, Vangjel Kriston me 3.000 lira, Kostandin Filipin me 1.600 lira, Jorgo Noskun me 5.000 lira franceze etj. Më 20 gusht të vitit 1894 Mitropolia e Korçës u dogj. Më pas ajo u rindërtua prej Thoma Adhamit në vitin 1896. Ky i fundit ishte tregtar me origjinë nga Vithkuqi. Dhuruesi kryesor ka qenë Jovan Banga, i cili ka lindur në Korçë në vitin 1814. Në moshën 19-vjeçare ai emigroi në Egjipt dhe u vendos në Kajro. Fillimisht ushtroi zanatin e rrobaqepësit dhe më pas u muar me kultivimin e sipërfaqeve të mëdha tokash. Me punën e tij Jovan Banga grumbulloi pasuri të madhe, të cilën më 1889 me anën e një prokure të posaçme ia dorëzoi për

²-Mihal Sonellari, Një traditë, e cila jeton së bashku me qytetin, Ngjallja, mars 2005, faqe 4.

administrim qeverisë greke. Sipas prokurës një fond kaloi në ndërtimin e spitalit “Vangjelismos” të Athinës, një pjesë e parave për mirëmbajtjen e gjmnazit të Korçës, një pjesë tjetër u përdor për arsimimin e të rinjve korçarë në Universitetin e Athinës etj. Me një pjesë të parave u çel seminari “Jovan Banga” në qytetin e Korçës.³

Ndërtesa e Mitropolisë vazhdoi të funksionojë deri në vitin 1967 kur u sekuestrua. Në vitet 1988-1989 ndërtesës iu bë një rikonstruksion, sepse përdorej si shkollë ku përgatiteshin kuadrot e Partisë së Punës. Ndërsa në vitet 1995-1996 Mitropolisë së Korçës iu bë rikonstruksion tërësor me fondet e grumbulluara nga Kryeepiskopi Anastas.⁴

Që nga viti 1922 deri në vitin 1929 qendra e Kryeepiskopatës ka qenë në Korçë. Mitropolitët e Korçës kanë qenë: Josifi (1500), Timoteu (1566), Gavriili (1572), Neofiti (1624-1628), Ignati (1668), Partheni (1670-1676), Makari (1691-1693), Danieli (1694-1709), Joasafi (1709-1719), Nikifori (1746-1752), Makari (1752-1756), Dionisi (1757-1766), Genadi (1766-1779), Joakimi (1779-1790), Kostandini (1790-1798), Joasafi (1798-1816), Meleti (1816-1827), Visarioni (1827-1835), Kirili (1835-1845), Neofiti (1845-1874), Dorotheu (1874-1885), Filotheu (1885-1893), Grigori (1893), Anthimi (1893-1894), Krisanthi (1894-1895), Gjervasi (1895-1902), Foti (1902-1906), Gjermanosi (1910-1918), Visarion Xhuvani (1929), Evlogjio (1937-1939), Pasi (1948), Filotheu (1952), Kristodhuli (1992), Joani (1998 e në vazhdim). Mitropolia e Korçës para vitit 1967 kishte 110 enori dhe shtatë manastire.

³-Alma Gjermani, Dhuruesit korçarë të shek. XIX, Tempulli, Nr. 13, Korçë 2008, faqe 18-20.

⁴-Arben Gjata, Mitropolia e Korçës dhe ndërtesa e saj, Ngjallja, Tetor 2002, faqe 4.

KISHAT DHE MANASTIRET

Mitropolia e Shenjtë e Korçës përbëhet nga këto zëvendësi episkopale vendore: Korça, Kolonja, Leskoviku, Pogradeci. Kishat e kësaj mitropolie sipas komunave janë:

Në Korçë: Katedralja “Ngjallja e Krishtit”, Mitropolia e Korçës, kisha e “Shën Sotirit”, kisha e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Drenovë, kisha e “Shpërfytyrimit” në Polenë, kisha e “Trinisë së Shenjtë”, kisha në fshatin Pendavinjë, kisha në fshatin Çiflik, kisha e “Shën Mihalit” në Liqenas, kisha e “Shën Mihalit” në Gostivisht.

Në Devoll: Kisha e “Shën Parashqevisë” në Bilisht.

Në Kolonjë: Kisha e “Ngjalljes së Krishtit”, kisha e “Fjetjes të Hyjlindëses” në Ersekë, kisha e “Profetit Ilia”, kisha në fshatin Bezhan.

Në Pogradec: Katedralja “Ngjallja e Krishtit”, kisha e “Shën Thanasit”, kisha në Lin.

KISHAT MONUMENT KULTURE

Korçë. Manastiri i “Shën Prodhromit” në Voskopojë, 1948, kisha e Manastirit të “Shën Marisë” në Lubonjë, 1963, kisha e “Shën Thanasit” në Voskopojë, 1948, kisha e “Shën Mëhillit” në Voskopojë, 1948, kisha e “Shën Kollit” në Voskopojë, 1948, kisha e “Shën Marisë” në Voskopojë, 1948, kisha e “Shën Jovanit” në Boboshticë, 1963, kisha e “Shën Mitrit” në Boboshticë, 1963, shpella e Maligradit, kisha e “Ristozi” në Mborje, 1948, kisha e “Shën Gjergjit” në Shipckë, 1963, kisha e “Shën Triadhës” në Lavdar të Oparit, 1963, kisha e “Shën Mitrit” në Bezmisht, 1970, kisha e “Shën Marisë” në Vithkuq, 1963, kisha e “Shën Mëhillit” në Vithkuq, 1963, kisha e “Shën Gjergjit” në Dardhë, 1970, shpella e “Shën Marisë” në Bezmisht, 1963, kisha e “Shëndëlliut” në Voskopojë, 1963.

Pogradec. Manastiri “Shën Marenës” në Llëngë, 1948, rrënojat e kishës paleokristiane dhe mozaikët në Lin, 1973, rrënojat e kishës Bizantine në Lin, 1973.

KISHAT E MITROPOLISË SË KORÇËS

KISHA E BURIMIT JETËDHËNËS

Kisha e “Burimit Jetëdhënës” është ndërtuar në vitin 1707. Në pjesën veriore të murit perëndimor të kishës gjendet mbishkrimi: “Ky tempull i Burimit Jetëdhënës u ndërtua në vitin shpëtimtar 1707, në kohën kur ishte peshkop i gjithhirshmi mitropolit i Korçës dhe i Selasforit Joasafi, në kohën e kujdestarisë së ktitorëve të saj Markut, Haxhi Kostës dhe Siamit. Piktoret Kostandini dhe Athanasi e kanë pikturuar atë në vitin 1120”.⁵



Në Kodikun e Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit gjejmë emrin e Dhimitër Kolecit, i cili në vitin 1756 ka gdhendur me mjeshtëri ikonostasin e kishës “Burimi Jetëdhënës” në qytetin e

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 329, faqe 165-166.

Korçës. Dhimitër Koleci është nga fshati Mariani i Oparit. Ai ka guxuar të gdhendë ikonostasin e parë tip “rrokoko” në Shqipëri. Në gdhendjet e tij tregon forcën e daltës në lëvizjet helikoidale të gjetheve të lisit si dhe realizimin e përkryer të figurave njerëzore të shenjtoreëve.⁶ Në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Lutje e Athanas Zografit. U pikturua prej dorës së tij më 1752”.⁷ Në ikonën e Sinodit të Parë Ekumenik që gjendet prapa frontit peshkopal është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, esnafit të shën Kostandinit 1756”.⁸

KISHA E SHËN GJERGJIT NË KORÇË

Kisha e “Shën Gjergjit” ka qenë në vendin ku gjendet sot biblioteka e qytetit. Nuk dihet me saktësi koha e ndërtimit të saj, por dihet që i ka fillimet nga vitet e mesjetës së hershme.



⁶-Fatbardha Shkupi, Mjeshtër shqiptarë, dekoratorë që kanë opunuar në Bullgari, Maqedoni dhe në Shqipëri, Monumentet 2002, faqe 75.

⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 356, faqe 178.

⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 370, faqe 182.

Në vitin 1881 korçarët pasi prishën kishën e vjetër filluan ndërtimin e kishës së re. Punimet ecën mirë por sapo përfundoi gjysma e mureve disa turkoshakë u ankuan tek Porta e Lartë në Stamboll se të krishterët korçarë nuk po ndëronin kishë por një kështjellë. Porta e Lartë menjëherë i pezulloi ndërtimet dhe dërgoi në Korçë arkitektë për të vërtetuar nëse të krishterët po ndërtonin kishë apo kështjellë. Pas verifikimit u dha fermani sulltanor për vazhdimin e punimeve të kishës. Projekti i kishës së “Shën Gjergjit” u realizua nga mjeshtri Naum Trasha, i cili e kishte origjinën nga Opari, ndërsa bamirësi Anastas Lakçe financoi ndërtimin e kishës. Muret e kishës u ndërtuan prej blloqe të mëdhenj guri, të cilët lidheshin me njeri-tjetrin me plumb. Kisha përfundosi së ndërtuari në vitin 1905. Mbi portën e brendshme ishte vendosur një pllakë e madhe, në të cilën shkruhej emri i ktitorit dhe viti i ndërtimit. Ikonat dhe afresket e kishës u pikturuar prej disa ikonografëve korçarë nga Dardha, Hoçishti dhe Ziçishti. Ikonostasi ishte prej druri me gdhendje. Mbi ikonën e madhe të Shën Mërisë në ikonostasin e kishës është shkruar viti 1790.⁹


Në këtë kishë më 1914 atë Josif Qirici mbajti meshën e parë në gjuhën shqipe. Kori i kishës gjithashtu këndonte në gjuhën shqipe. Në kishën e “Shën Gjergjit” në Korçë më 24 nëntor të vitit 1923 Imzot Jerotheu dhe Imzot Kristofori dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin. Menjëherë pas dorëzimit, Imzot Theofani u shpall “Mitropolit të Durrësit, Gorës e Shpatit, primat dhe Eksark të tërë Ilirisë, detit të Perëndimit dhe gjithë Shqipërisë”. Gjithashtu u zgjodh kryetar i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Hirësia e Tij, Jerotheu u shpall Mitropolit i Korçës dhe Hirësia e Tij, Kristofori, Mitropolit i Beratit. Ky Sinod, i cili nuk u pranua nga Patriarkana Ekumenike vazhdoi të funksionojë deri në trazirat e vitit 1924 kur Imzot Theofani u detyrua të largohej nga Shqipëria. Është për të ardhur keq që në

⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 387, faqe 186.

vitin 1967 kjo kishë u rrafshua krejt për të shuar kujtesën historike të saj. Blloqet e mëdhenj prej guri u përdorën për ndërtimin e pallatit të sportit të qytetit.¹⁰

KISHA E PROFETIT ILIA NË KORÇË

Kisha e “Profetit Ilia” gjendet në verilindje të Korçës. Sipas të dhënave që jep Kodiku i Mitropolisë së Korçës kisha është rindërtuar në vitin 1847 me iniciativën e Mitropolitit të Korçës Neofitit. Kodiku na bën me dije se shpenzimet për rindërtimin e kishës u mbuluan nga epitetri Kristo Godia. Për të rindërtuar kishën ndihma ofruan edhe korçarët që banonin në Egjipt.



Epitetri Ilo Grameno filloi mbjelljen e pemëve në kodrën e Shëndëllisë. Muret e kishës u ndërtuan prej guri. Në anën veriore të kishës u ngrit kambaneria. Gjatë viteve 1937-1938, në kohën kur Mitropolit i Korçës ishte Imzot Kurilla kisha e vjetër u prish

¹⁰-Arben Gjata, Kisha e Shën Gjergjit, Tempulli Nr. 8, Korçë 2003, faqe10-15.

për tu ndërtuar kisha e re. Në atë kohë në kishën e “Profetit Ilia” shërbente atë Stavro Kanxheri. Kisha e re u ndërtua me gurë. Në vitin 1967, në kohën që filloi prishja e kishave, pensionistët e qytetit ndërhyjnë në organet përkatëse me qëllim që kisha të mos prishej, por të ndryshonte destinacionin. Kështu kisha e “Profetit Ilia” u përshtat në klub për pensionistët e qytetit. Në vitin 1970 në hieroren e kishës u vendosën makineritë e telekomit. Në ditët e lirisë fetare në vitin 1991 në këtë kishë u kremtua pashka e parë pas 25 vjet ndërprerje të lirisë së besimit. Shërbesa e Ngjalljes u celebrua nga klerikët e mbijetuar atë Kristo Raci dhe atë Kosta Kotnani. Më 17 mars të vitit 1991 në Kishën e “Shën Dëllisë” u zhvillua mbledhja, në të cilën u themelua shoqata “Mbajtësit e Kryqit”. Nismëtarët qenë Sotir Bambuli, Dhimitra Cico, Berta Dhimitri, Grigor Mulla, Jani Trebicka etj. Në këtë mbledhje historike kishte pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria, të cilët gjetën mikpritjen e familjeve ortodokse korçare. Këshilli kishtar i kishës, i përbërë nga atë Sotiraq Dinka, Naum Tërova, Kristaq Zisi dhe Arben Gjata pas shumë përpjekjesh arriti që në vitin 2003 të largonte nga ambientet e kishës makineritë e telekomit. Menjëherë filloi rikonstruksioni i kishës. Projekti u realizua nga arkitekti Raqi Themeli. Fondet për rikonstruksionin i përballoi Mitropolia e Korçës. Më 20 korrik 2003 në ditën që kremtonte shenjti u bë përirimi i kishës nga Mitropoliti i Korçës, Imzot Joani. Ikonostasi i kishës u dhurua nga Xhorxh Shamata.¹¹

KISHA E SHËN E PREMTES NË VOSKOPOJË

Kisha e “Shën e Premtes” është kisha më e hershme e Voskopojës. Mendohet se është ndërtuar në vitin 1378. Sipas legjendës që qarkullon edhe sot e kësaj dite, nga pleqtë e moçëm

¹¹-Arben Gjata, Kisha e Profetit Ilia, Tempulli Nr. 10, Korçë 2005, faqe 14-17.

thuhet: “Disa barinj endacakë, duke kërkuar kullota të begata për bagëtitë e tyre gjetën një luginë pranë fushës së Korçës. Në vjeshtë kur do të largoheshin me kopetë e tyre, ata bënë një zjarr të madh, të cilin e gjetën ende të ndezur kur u kthyen në pranverë. Në vendin e zjarrit vendosën të ngrinin kishëzën e “Shën e Premtes”. Në fillim vetëm verën kalonin në atë vend, por kur u shtuan shumë dhe nuk mund të vërtiteshin sa andej-këtej, ata provuan të lënë një plak në një kolibe, me ushqimet që i nevojiteshin dhe ai dimëroi për bukuri. Atëherë u vendosën përfundimisht”. Banorët e parë mendohen të jenë banorët e shpërngulur fillimisht nga qyteti Voskop i vendosur në rrëzën e poshtme të fushës së Korçës, i rrënuar nga dyndjet osmane të shekullit XIV. Ata prenë shkurret dhe ndërtuan kishën e parë të “Shën e Premtes”. Shtimi më pas i kësaj popullsie u bë me njerëz të tjerë që donin t’i shpëtonin islamizimit. Mbi portën e kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Theodor Gjergj Koisorës”.¹²

Kisha e “Shën e Premtes” është e stilit bizantin dhe përbëhet nga narteksi, naosi dhe pjesa e altarit. Muri i kishës është prej gurë shtufi dhe llaç argjilor. Dyshemeja e kishës ka qenë e shtruar me plloça guri, ndërsa tavani ka qenë me dërrasë të ngjyrosur. Vite më vonë dy dritaret e kishës u mbyllën, sepse në krah të saj u ndërtua kisha e “Shën Dionisit”. Nga afresket e kishës më i bukuri është ai që i kushtohet Shën e Premtes. Afresku mendohet se është pikturuar në shekullin XIV. Një afresk tjetër i dëmtuar nga koha paraqet kandarin romak me thesin e miellit si simbol i drejtësisë. Brenda në altarin e kishës është shkruar në greqishten bizantine fjala *Í é éá* (Nika) që do të thotë fitimtar. Afresket e kishës janë ruajtur deti në vitin 1970. Kisha është rikonstruktuar vite me vonë nga Lazi Miti Lera. Në anën verilindore të kishës gjenden varrezat e vjetra të fshatit.¹³

¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 510, faqe 215.

¹³-Dhori Falo, Tragjedia e një qyteti, Kotti, Korçë 1998, faqe 6, 8, 103, 106.

KISHA E FJETJES SË HYJLINDËSES NË VOSKOPOJË

Kisha “Fjetja e Hyjlindëses” ka qenë kisha katedrale e Voskopojes. Naosi është i tipit bazilikal trenefësh me thollo me përmasa 38x15.30 metra. Kisha është ndërtuar me gurë të skuadruar të lidhur me llaç gëlqereje. Apsida e kishës përbëhet nga disa nike të harkuara nga sipër. Sipër tyre ka dekoracione me tulla të vendosura në formë kurrizi peshku. Kisha ka përfunduar së ndërtuari më 25 shkurt të vitit 1712.



Mjeshttrat që kanë punuar për ndërtimin e kishës qenë Theodhori, Anagnosti dhe Steriani nga Agrafa. Këtë e vërteton mbishkrimi i pikturuar mbi portën perëndimore të kishës: “U ndërtua dhe pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i Fjetjes së mbishenjtës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin e prift Kostandinit dhe ekonomit prift Llazarit, me shpenzimet e arkondëve të shumënderuar dhe të të gjithë të krishterëve: Adam Papadhimitër Prendit, Adam Dhimitrit, Gjergj Llazarit, Kostandin Zibus, Dhimitër Vretos, Gjergjit, Gjergj

Ambarit, Gjergj Papadhanilit, Kristo Nikollë Fllenxës, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit e të gjithdimit, Mitropolitit të Korçës, Zotit Daniel të ndjerit, u përfundua me dorën tonë, të shërbëtorëve më të vegjël Theodorit, Anagnostit, Sterianit nga Agrafa, në vitin prej Krishtit 1712, në muajin shkurt 25”.¹⁴

Në portën perëndimore gjendet skena “Fjetja e Shën Mërisë”, që është afresku më i bukur i kishës. Shën Mëria paraqitet e shtrirë në shtratin mortor e rrethuar prej apostujve të kërrusur, mes të cilëve është edhe Krishti. Në apsidën e kungës gjendet Platitera si dhe skena e “Burimit Jetëdhënës”. Në faqen e murit jugor të kishës dhe deri në faqen e murit perëndimor gjenden 24 afresket që i kushtohen “Himnit Akathist”. Çdo skenë nga “Himni Akathist” shoqërohet me vargjet përkatëse. Në vijim kemi skenat “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, “Përshëndetja e Marisë me Elisabetën”, “Dyshimi i Josifit”, “Lindja e Krishtit”, “Udhëtimi i magëve” etj. Në këtë kishë katedrale nuk mungojnë edhe skenat nga Dhiata e Vjetër: “Perëndia i shfaqet Moisiut”, “Moisiu merr 10 porositë”, “Sakrifica e Abrahamit”, “Vrasja e Abelit”, “Tre djemtë në furrë” etj. Në tholot e dy nefeve janë paraqitur të drejtët e Dhiatës së Vjetër Noe dhe Loti. Me medalione janë pikturuar patrikët dhe mbretërit e Dhiatës së Vjetër. Në kishën “Fjetja e Hyjlindëses” në Voskopojë paraqiten edhe disa skena të rralla si për shembull: “Shorti i apostujve”, “Vrasja e Stefanit”, “Vizioni i Pjetrit” etj. Në ciklin e shenjtoreve paraqiten apostujt, oshënarët dhe martirët: Ky cikël përmban nëntë skena nga jeta e Joan Pagëzorit: “Zaharisë i shfaqet engjëlli”, “Zaharia përshëndet Elisabetën”, “Lindja e Joanit”, “Elisabetën e ndjekin ushtarët”, “Joani në shkretëtirë”, “Joani para Irodit”, “Prerja e kokës së Joanit” etj. Në këtë kishë katedrale paraqiten katër skena nga jeta e Shën e Premtes si dhe skena të martirizimit të shenjtoreve.

¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 326, faqe 164-165.

Ikonat e ikonostasit janë pikturuar prej dorës së jeromonak Kostandinit. Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostas është shkruar: “Dora e jeromonak Kostandinit”.¹⁵ Mbi ikonën e Shën Gjergjit dhe ikonën e Shën Mitrit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Ne rekrutohemi për mbretin e fuqive dhe në qoftë se na vini në zjarr e në mundime, nuk do të mohojmë fuqinë e trinisë. Dora e jeromonak Kostandinit, prej Krishtit 1703”.¹⁶ Gjithashtu në këtë kishë kemi mbishkrime me përmbajtje të teksteve liturgjike. Mbi portën jugore në brendësi të kishës gjendet ky mbishkrim me përmbajtje nga kënga e III e zbritësorës së të krenmtës së Ipapandisë: “O zot mbështetja e atyreve që kanë besim në ty, mbështete kishën, të cilën e ndërtova me gjakun tënd të çmuar”.¹⁷ Në vitin 1887 është ndërtuar kambaneria e kishës nga mjeshttrat Niko, Koli dhe Anastas Veria. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet i gdhendur në një pllakë guri mbi portën e kambanerisë: “Kjo kambaneri u ndërtua në kohën e kujdestarisë së Dhimitër E. Balaurit, në kohëne Naum N. Stergjias, me shpenzimet e kishës, më 1887, korrik 15”.¹⁸ Gjithashtu mbi portën jugore të kambanerisë është shkruar: “Mjeshtrit janë Niko Koli e Anastas Verin”.¹⁹ Mbi portën jugore jashtë kishës gjendet mbishkrimi: “Në qoftë se je mik hyr duke u gëzuar, nëse je armik dhe i urryer plot me dinakëri (të keqe) larg, larg, ik nga kjo derë”.²⁰ Ky mbishkrim nuk ekziston më sepse në tetor të vitit 1944 çatia e hajatit të kishës u dogj nga gjermanët.

¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 300, faqe 155-156.

¹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 323, faqe 163-164.

¹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 327, faqe 165.

¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 478, faqe 209.

¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 489, faqe 211.

²⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 328, faqe 165.

KISHA E SHËN KOLLIT NË VOSKOPOJË

Kisha e “Shën Kollit” është monumenti më i plotë ndër pesë bazilikat e Voskopojës. Kisha është e tipit bazilikal me tre nefe me përmasa 33x17 metra dhe përbëhet nga naosi, narteksti, hajati dhe kambaneria. Hajati gjendet në anën jugore të kishës dhe mbështetet mbi kollona guri. Kisha e “Shën Kollit” mbulohet nga një çati dyujëshe me rasa guri. Muret e kishës janë me gurë të latuar të lidhur me llaç dhe gëlqere. Apsida përbëhet nga një varg nikesh të harkuara nga sipër dhe përfundon me një kornizë tullash të vendosura në formë kurriz peshku. Kisha e “Shën Kollit” në Voskopojë ka filluar së ndërtuari në qershor të vitit 1721 dhe ka përfunduar më 19 shtator 1722.



Në faqen e jashtme të murit të kishës mbi një kolonë të hajatit gjendet mbishkrimi i shkruar me me copa tjegullash: “Në vitin 1721 fillimi në muajin qershor 19”.²¹ Pikturat janë realizuar prej David Selenicasit, i ndihmuar nga nxënësit e tij Kostandinit dhe Kristos. Kisha ka përfunduar së pikturuari në muajin tetor të

²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 330, faqe 166.

vitit 1726. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet mbi faqen e murit perëndimor ndërmjet dy dritareve: “Ky tempull i këndshëm para perëndisë i shën Kollit i ndërtuar vonë nga lindja e perëndisë 1721, në muajin qershor mori përfundim të lumtur në 19 të muajit shtator më 1722 të vitit shpëtimtar. Kunga u pikturua në mënyrë shembullore me shpenzimet e të krishterëve shprestarë të rrethit, tani për tani u pikturua (në mënyrë) madhështore përshtatshmërisht rreth e përqark naosit përgjithësisht me dorën e të shumëditurit dhe me furçën e hollë të gjithoshënarit Z.Z. David Selenicasit dhe me shoqërimin e Kostandinit e të Kristos, me dhurimin e bollshën të të hollave të zotit Haxhi Jorgjit, që mbaroi jetën e lumtur. Në kohën kur ishte kryepeshkop në Ohër dhe në Selasfor i shumëlumuri Z.Z. Joasaf, në kohën e kujdestarisë së kujdestarit, zotit Papa Nikollës....Tetor 18 në vitin 1726 të mishërimit të ekonomisë së mishërueshme të shpëtimtarit tonë”.²²



Ktitori i kishës Haxhi Jorgji, i cili është përjetësuar në murin jugor të kishës. Ai paraqitet i veshur me xhybe duke mbajtur maketin e kishës në dorë, të cilin ia dhuron Shën Kollit. Mbi skenën e ktitorit, pranë portës jugore të kishës gjendet ky mbishkrim:

²²Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 331, faqe 166-167.

“Dashurova o zot, mirëhiersinë e shtëpisë tënde o zot, mos e humb shpirtin tim bashkë me mëkatarët”.²³ Afresket e hajatit të kishës së “Shën Kollit” në Voskopojë janë pikturuar në vitin 1750 prej Kostandin dhe Athanas Zografit. Kjo e dhënë jepet në mbishkrimin që gjendet mbi portën jugore jashtë kishës: “U pikturua ky hajat më 1750, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit dhe të gjithndriturit mitropolitit të Korçës zotit Nikiforit, me dorën e Kostandin dhe Athanasit nga qyteti i Korçës, gusht 23”.²⁴ Ndërmjet skenave biblike në afresket e hajatit bie në sy një mbishkrim i pikturuar në skenën “Tre djemtë në furrë të Babilonës”: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, maneti dhe Thanas Filipi”. Ndërsa në afreskun e “Shën Julitës dhe Kiriakut” po në hajatin e kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë Kostandin dhe Athanas Zografi”.²⁵

Mbi ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Në vitin 1743”.²⁶ Kjo pjesë e ikonostasit është e gdhendur me ornamente me relief të lehtë. Ikonostasi i kishës përbëhet prej shumë pjesësh ikonostasësh të ndryshëm. Froni peshkopal dhe amvoni i kishës janë gdhendur në vitin 1758 prej mjeshtrit Andon nga Korfuzi: “Ky fron, së bashku me amvonin u stolis në vitin 1758, në kohën kur ishte mbikqyrës i gjithhirshmi, shenjti i Durrësit zoti Neofit dhe të kujdestarisë së zotit Athanas Gostit dhe me shpenzimet e kësaj kishë të shën Kollit dhe me dorën time të Andon Korfjatit për kujtim të përjetshëm”.²⁷

²³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 342, faqe 172-173.

²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 352, faqe 176

²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 353, faqe 176.

²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 344, faqe 173.

²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 359, faqe 179.

Mbishkrimi i mësipërm gjendet i gdhendur mbi një pllakë sadefti në fronon peshkopal të kishës. Hyrja për në kishë bëhet nga kambaneria, e cila është ndërtuar në vitin 1936. Gjatë tërmetit që ra në vitin 1960 kisha e “Shën Kollit” pësoi dëmtime serioze, prandaj u restaurua në vitin 1962.

Kapakët e Ungjillit të Kishës së Shën Kollit në Voskopojë kanë një rëndësi të madhe historike, sepse tregojnë vendin e punimit si edhe emrat e autorëve. Mbi kapakët prej argjendi gjendet ky mbishkrim: “U përtëri ky ungjill i shën Kollit, në Voskopojë, në kohën e të shumëhirshmit të Durrësit, zotit Neofit Haxhikostës, në kohën e epitropëve, ndër priftërinj Jan Kostës notarit dhe Gjergj Kostë Mames 1756. Me shpenzimet e dhuruesve të devotshëm të kësaj famullie. Puna me mirëhijesi është e vëllezërve Filip dhe e Argjir të Athanas Gostit, që të shpëtojnë në qetësi”.²⁸

Në pjesën anësore, që lidh kapakët e zbukuruar me shumë motive të bukura, ndodhen edhe dy ndërprerje të lëmuara, ku janë shkruar në gjuhën greke dy shënime. Prej tyre del se libri i shenjtë dhe kapakët e tij janë punuar në Voskopojë nga vëllezërit Filip dhe Argjir Thanasi në vitin 1756. Kapakët e ungjillit janë punuar me teknikat e rrahjes e të gdhendjes, të derdhjes, si edhe me përdorimin e mjaft veglave që krijoheshin nga vetë zejtarët për zbukurimin e objekteve kishtare. Vendin kryesor në mesin e kapakëve e zënë skenat e “Zbritjes së Krishtit në Had” dhe “Kryqëzimi i Krishtit”. Të katër anët e kapakëve kufizohen me korniza të zbukuruara me zymbylë barakë që janë realizuar me instrumentin e tipit të stampës. Në anën e majtë dhe të djathtë të skenës “Kryqëzimi i Krishtit” janë paraqitur Shën Nikolla dhe Shën Thanasi. Të dy shenjtorët paraqiten në këmbë me ungjij ndër duar. Zbukurimi i kapakëve të ungjillit të kishës së “Shën Kollit” dëshmon se ai është kryer nga mjeshtra që kanë pasur një kulturë të lartë

²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 358, faqe 178-789.

artistike. Kjo duket në krijimin e galerisë së karaktereve, numri i të cilëve arrin në mbi 60 portrete të shenjta të punuara në përmasa shumë të vogla. Gjatësia e figurave të sjella në kapakët e ungjillit ndryshon nga 2 deri në 14 cm, ndërsa kokat janë të punuara deri në madhësinë prej 4 mm. Libra të tillë të zbukuruar me kaq mjeshtëri tregojnë për kulturën e lartë të besimtarëve ortodoksë si dhe shprestarinë ndaj besimit të tyre.

KISHA E SHËN THANASIT NË VOSKOPOJË

Kisha e “Shën Thanasit” gjendet në pjesën verilindore të Voskopojës. Kisha është bazilikë trinefëshe me thollo dhe ka përmasat 20.25x15.4 metra. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajati. Kisha e “Shën Thanasit” në Voskopojë është ndërtuar në vitin 1724. Këtë e jep mbishkrimi që gjendet mbi një pllakë guri mbi dritaren e apsidës: “U ndërtua tempulli hyjnor i shën Thanasit, në vitin 1724”.²⁹ Kjo bazilikë i kushtohet patrikut të Aleksandrisë Athanasit të Madh dhe kremton më 18 janar. Kisha u ndërtua me kontributin e banorëve të lagjes Skameli. Këtë fakt e jep mbishkrimi që gjendet pranë portës jugore të kishës: “U ndërtua dhe u themelua që nga themeli ky tempull i gjithëhirshëm dhe i famshëm i atit tonë ndër shenjtorë, Athanasit të Aleksandrisë, me kontributin, me shpenzimet shumë të rënda dhe të kujdesit të proesteve shumë të nderuar e të zgjedhur si dhe të arkondëve dhe të ktitorëve të lagjes Skameli dhe të krishterëve të devotshëm, kur ishte patrik shumë i lumturi, kryepeshkop i Justinianës së parë të Ohrit zoti, zoti Joasaf, në vitin 7232 (=1724), indikti 2. Ndërtuesi Androniku i ndërtoi një tendë Izraelit të ri që ti mësonte grigjës në mënyrë të gjithditur ligjin e Krishtit të shkruar nga perëndia”.³⁰

²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 338, faqe 171.

³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 336, faqe 168-170.

Një mbishkrim që gjendet i gdhendur mbi një kryq të murosur në kolonën e dytë të hajatit na bën me dije për ndërtuesit e kishës: “Mjeshtrat ishin nga fshati Krimi, kryemjeshtrit ishin Androniku dhe Mihali, Pavli, Manthoja, Kosta”.³¹ Afresket e kishës u pikturuan nga vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi. Kisha përfundoi së pikturuari më 25 tetor të vitit 1744. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i atit tonë ndër shenjtorë, dhe kryepeshkopit të Aleksandrisë, Athanasit, në kohën kur ishte patrik i shumëlumturi dhe i shumënderuar, kryepeshkop zoti, zoti Joasaf, me kontributin e zotit Kostë Gjikes, në kohën e kujdestarisë së zotit Vrusi Sofronit, me shpenzimet e arkondëve të shumënderuar dhe të krishterëve të tjerë të kësaj lagje Skameli, në vitin 1744, në muajin tetor 25. Me dorën e vëllezërve Kostandin dhe Athanasit, nga qyteti i Korçës”.³²



Mbi faqen e murit verior të kishës pranë afreskut të Shën Mërkurit gjendet mbishkrimi, i cili daton më 1722 dhe tregon ata që kanë porositur afreskun: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë,

³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 340, faqe 172.

³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.345, faqe 173-174.

Dhimitër Mihalit dhe Gjergj Kadesit”.³³ Gjithashtu mbi një pllakë guri të murosur pranë portës jugore të kishës gjendet një mbishkrim me përmbajtje biblike dhe liturgjike: “Ejani tek unë sa jeni, të lodhur e të ngarkuar dhe unë do tju mbroj juve. Mësoni prej meje, sepse jam i butë edhe i përvuajtur në zemër edhe keni për të gjetur të prejtur shpirtrat tuaj, sepse atë që vjen tek unë nuk kam me e nxjerrë jashtë, sepse nuk kam ardhur të thërras të drejtët, por mëkatarët për pendim –1724. I përjetshëm kujtimi, gjithmonë të përkujtueshëm dhe të lumturve, ktitorëve të tij manastiri të shenjtë dhe atyre që sjellin pemë dhe punojnë mirë në të”.³⁴

Në këtë kishë gjendet një skenë interesante, e cila paraqet një besimtar duke dalë nga kisha pa përfunduar liturgjia hyjnore. Mbishkrimi thotë: “Çdo besimtar i krishterë që nuk qëndron deri në fund të liturgjisë dhe del jashtë, aty e pret djalli, që i merr shpirtin dhe përfundon në ferr”. Skena është pikturuar në vitin 1745 prej Kostandin dhe Athanas Zografit.³⁵

Pasi përfunduan pikturimin e kishës vëllezërit Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi u morën me pikturimin e hajatit, të cilin e përfunduan më 28 qershor të vitit 1745. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës: “U pikturua ky hajat më 1745 në kohën e kujdestarisë së zotit Vrusi Sofronit, me dorën e vëllezërve Kostandin dhe Athanasit, në muajin qershor 28”.³⁶ Në skenën “Shtatë kupat e zemërimit të Perëndisë” vëllezërit Zografi kanë shkruar: “Lutja e zotit Janko Kuisorës”,

³³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 334, faqe 168.

³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 337, faqe 170.

³⁵-Kliti Kallamata, Rreth tipareve të reja të programit ikonografik në pikturën murale të shek. XVIII, 2000 vjet art dhe kulturë kristiane në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 263.

³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 346, faqe 174.

ndërsa në skenën “Helmimi i ujërave” lexojmë: “Lutje e zotit Theodor Papa, Gjergj Mandukës”.³⁷ Hajati është i hapur në një harkadë me gjashtë hapësira, të cilat ndahen nga kolonat e gurit. Në hayat gjendet dekoracione të shumta me tulla, tjegulla duke formuar kryqe, korniza në formë kurriz peshku etj.³⁸ Në faqen e murit mbi kolonat e hayatit gjendet një mbishkrim i shkruar me copa tjegullash të murosurat: “Fillimi i tempullit u bë në muajin qershor dhe në vitin 1724”.³⁹ Gjithashtu në murin mbi harqet e hayatit të kishës gjenden disa mbishkrime të punuar me copa tjegullash e tullash: “Kujdestaria e Theodor Argjirit. Kontribues prift Kostandin Papika. Kontribues Thanas Dhimitri”.⁴⁰ Mbishkrimi i fundit është gdhendur mbi një kryq të punuar prej guri gëlqeror dhe daton më 1724.

KISHA Ë SHËN MËHILLIT NË VOSKOPOJË

Kisha e “Shën Mëhillit” gjendet në pjesën jugperëndimore të Voskopojës. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Përmasat e brendshme të kishës janë 20.80x9.70 metra. Muratura e kishës është me gurë të latuar. Apsida gjithashtu është punuar me gurë të gdhendur dhe përmban disa nike të harkuara dhe përfundon me një kornizë prej guri të gdhendur.⁴¹

³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 347, faqe 174.

³⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 73-76.

³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 335, faqe 168.

⁴⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 339, faqe 171-172.

⁴¹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 70-71.

Kisha e “Shën Mëhillit” është pikturuar në vitin 1722. Mbi portën perëndimore brenda kishës gjendet mbishkrimi: “U ndërtua prej themeli ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i kryestrategëve të gjithëmëdhenj Mihael e Gabriel dhe të gjithë fuqive qiellore pa trup ... me dorën dhe u pikturua me shpenzimet e arkondëve të shumënderuar dhe shumëfisnikë dhe të krishterëve të lagjes së shën Illiut, dhe me kontributin e epitropëve të shumëdevodshëm të priftit....Nikollë në kohën e kryepeshkopit të shumëlumturit Z.Z. Joasaf, në vitin 1722”.⁴² Mbi faqen e murit verior të kishës, pranë afreskut të Shën Nikitës është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, Mihalit të Janit dhe Mohas dhe Dhimitrit dhe janit Bibiani 1725”.⁴³

KISHA E PROFETIT ILIA NË VOSKOPOJË

Kisha e “Profetit Ilia” gjendet mbi një breg në perëndim të Voskopojës. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajati. Në arkadën e këtij të fundit gjenden dekoracione të krijuara nga alternimi i gurëve. Naosi është i tipit bazilikal dhe ka përmasa të brendshme 18.20x9.50 metra. Kisha është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje.⁴⁴ Kisha është ndërtuar në vitin 1759. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi i gdhendur mbi një gur jashtë apsidës së kishës: “Viti 1759”.⁴⁵ Kambaneria është ndërtuar në vitin 1890. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën e kambanerisë së kishës:

⁴²-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 333, faqe 167-168.

⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 341, faqe 172.

⁴⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 77-78.

⁴⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 360, faqe 180.

“Kjo kambaneri u ndërtua me shpenzimet dhe marrëveshjen e voskopojarëve dhe oparakëve (anëtarëve) të shoqërisë, për të ndihmuar të vobektit me kryetar Kriston, me mbikqyrjen e Kristos, në muajin shtator 1890”.⁴⁶

KISHA E SHËN MËRISË NË VITHKUQ TË KORÇËS

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në anën e djathtë të fshatit, mbi pjerrësinë e kodrës dhe mendohet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XVII. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit njënefësh me kupolë dhe ka përmasa 7.90x4.80 metra. Muratura e kishës është me gurë smërçi. Çatia e kishës është me tre kullime uji. Apsida është ndërtuar me gurë të skuadruar dhe përbëhet nga shtatë nike, të cilat përfundojnë me harqe.

Ikonostasi i kishës është gdhendur nga dy mjeshtër shqiptarë të ardhur nga Kosturi dhe Kolonja. Ai është punuar në dru plepi të veshur me shtresë allçie e shkumsi të gatuar me të bardhë vezësh dhe është lyer me ar. Ikonostasi ka përmasa 5.602.86 metra. Në ikonostas janë vendosur tetë ikona të mëdha si dhe dy rreshta me ikona të vogla. Në rreshtin e parë gjenden 17 ikona, ndërsa në rreshtin e dytë gjendet 12 ikona të vogla. Mbi to qëndrojnë dragonjtë me kryqin e madh. Dera e bukur e ikonostasit përbëhet prej dy kanatësh, secili prej tyre është i ndarë në tri pjesë. Ajo është e stolisur me bistakë rrushi dhe zymbyla. Në të dy anët janë gdhendur pëllumba, të cilët çukisin kokrra rrushi, ndërsa zymbylat rrethohen me dredhëza të gjethëzuara. Në mesin e derës gjendet kryqi i gdhendur.⁴⁷

⁴⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 480, faqe 210.

⁴⁷-Fatbardha Shkupi, Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX, Monumentet 2 / 1983 (26), faqe 124-126.

KISHA E SHËN MËHILLIT NË VITHKUQ TË KORÇËS

Kisha e “Shën Mëhillit” gjendet në Vithkuq të Korçës. Kisha ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1682. Mbi portën jugore në brendësi të kishës gjendet mbishkrimi: “U ndërtua prej themeli në vitin 1682 dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i taksiarkëve të mëdhenj Mihael e Gabriel, me shpenzimet e të krishterëve që gjenden në këtë qytet dhe me kontributin, përpjekjet dhe mundimet e prift Stavrit, ekonom dhe epitrop, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit mitropolitit të Kosturit, zotit Krisanth, në kohën kur ishin famullitarë priftërinjtë e shumëdevotshëm, në vitin 1728, tetor 1”⁴⁸.

Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazilikal trenefësh dhe ka përmasa të brendshme 15.5x9.5 metra. Muratura e kishës është me blloqe prej guri shmërç. Nartekxi është shtuar më vonë. Në narteks gjenden radhë kolonash prej guri. Nartekxi mbulohet nga një çati druri. Në anën lindore të kishës gjendet apsida, e cila përfundon me një kornizë me gurë të gdhendur. Ikonostasi është prej druri të gdhendur dhe ka përmasa 9.10x4.90 metra, ndërsa lartësia deri tek kryqi arrin në 0.90 metra. Në qendër të ikonoostasit gjendet dera e bukur, e cila përbëhet nga dy kanatë, në secilin prej tyre gjenden katër ikona, dy poshtë, një në mes dhe një sipër. Në derën e bukur janë skalitur fazanë që çukisin kokrrra rushi. Gjithashtu janë skalitur zambakë dhe gjethe lëpjeta të lakuara. Në derën anësore është gdhendur një ballzinë baroke që paraqet tufëza gjethesh të ndërthurura me fletë tërfilli dhe fazanë të vendosur përballë njëri tjetrit pranë pemës së jetës. Pas tyre gjenden dy fazanë të tjerë me kryet e kthyer, që përpiqen të çukisin kokrrat e rushit. Në mesin e pemës së jetës lakohen dy bistakë, të cilët ngrihen mbi dy zambakë. Sipër dyerve janë

⁴⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 313, faqe 161.

gdhendur dredhka të fuqishme, gjarpërinj, boçe pishe, tulipanë, tërfil, lëpjeta, fazanë etj. Në mes tyre paraqiten dy dragonj përballë njeri tjetrit me flatra të hapura, të cilët ruajnë pemën e jetës. Të gjitha zbukurimet janë të lyera me varak.⁴⁹

Në ikonostas gjenden dhjetë ikona të mëdha dhe dy rreshta me ikonat e vogla. Rreshti i parë përmban 32 ikona dhe rreshti i dytë 31. Mbi to gjendet kryqi i madh, i cili është zbukuruar me pesë lulonja si rreze në tri krahët dhe dy antefiksa të ngulur anë gojën e dragjonjve, të cilët trupëzohen në bishtin e dy përbindëshve që mbajnë kryqin. Ikonat e ikonostasit janë punuar në vitin 1712 nga mjeshtërit Qirko dhe Panajoti. Në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Jani Malesu”.⁵⁰ Në faqen e parë të ungjillit të kishës gjendet mbishkrimi: “Në vitin 1823 tetor 25 Vithkuq. Simbas ungjillit vjen zemërimi i perëndisë nga të pabesët. Në këtë vit u prish ky vend i famshëm që quhet Vithkuq dhe u bë çdo gjë shkretëtirë”.⁵¹

Mbi faqen e hajatit jugor të kishës ka qenë një mbishkrim, i cili sot nuk ekziston më, mbasi ka rënë me gjithë suva: “1828 korrik 13. Unë Dhaskal Kostaq Cepi erdha nga Berati dhe e gjeta fshatin të rrënuar, të shkretë, shtëpitë të prishura dhe unë i pamerituari i pashë të gjitha shtëpitë pa njerëz, por unë dhe ju të mjerë e të shkretë pësua mjerimin, dhe cilido që u ndal dhe e prishi fshatin, të kenë mallkimin që i bënë kishat dhe manastiret e shkretë, por ti o zot kij mëshirë për ne mëkatarët dhe...paligësitë tona....ki mëshirë për ne o zot, ashtu si më krijove me duartë e tu,

⁴⁹-Fatbardha Shkupi, Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX, Monumentet 2 / 1983 (26), faqe 126-128.

⁵⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 314, faqe 161.

⁵¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 423, faqe 196-197.

dhe unë do të mëshiroj të gjithë të krishterët, të gjallë e të vdekur, dhe në këtë fshatin tonë të vijnë ata që janë në vende të huaja, kur të vijnë të gjithë këtu...dhe të lavdërojnë ty, të vetmin perëndinë tonë të vërtetë. I mëshirshëm je ti, o perëndia jonë, simbas mëshirës tënde të madhe ardhëm këtu ..menjëherë...dhe kushton...së bashku me të vëlanë e tij dhe pamë shtëpitë e prishura dhe psherëtimë. O perëndi, perëndia jonë i qiellit dhe i dheut bëj mëshirë për të gjithë të krishterët mëkatarë, që të vijnë të gjithë të krishterët të mblidhen këtu në atdheun e tyre dhe të lavdërojnë ty o zoti im dhe të thonë mëshirona o zot, dhe kij mëshirë. I përvuajturi Dhaskal Kostandin Cepi i shkrova ai që do, të gjallë të më ndjejë si mëkatar që jam, vëllain tim më fal”.⁵²



Në anën veriore të kishës gjenden varrezat e fshatit, tek të cila bie në sy një kryq i madh, të cilin vendasit e quajnë “Varri i Pagëzimit”. Dikur Mihal Grameno ishte i sëmurë nga turbekulozi dhe qëndroi ca kohë në Vithkuq. Gjatë qëndrimit në fshat e preku thellë një ngjarje e dhimbshme dhe shkroi librin “Varri i Pagëzimit”. Sipas gojëdhënës një baba i krishterë donte të pagëzonte djalin e parëlindur. Shkon tek prifti dhe iu lut që uratat ti lëçiste në gjuhën

⁵²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 428, faqe 198-199.

shqipe. Prifti i fshatit i tha se duhet të kishte miratimin e Mitropolitit të Korçës. Ishte dimër i acartë dhe foshnja e porsalindur nuk mundi të mbijetonte, por vdiq tek pragu i kishës. Pas tij vdiqën e ëma dhe gjyshërit dhe më pas babai. I varrosën në një varr, të përbashkët, prandaj u quajt “Varri i Pagëzimit”.⁵³

KISHA E ANARGJENDËVE KOZMA DHE DAMIANO NË VITHKUQ TË KORÇËS

Kisha e “Shën Kozmait dhe Damianit” gjendet rreth 20 metra jashtë murit rrethues të manastirit të “Shën Pjetrit dhe Pavlit” në Vithkuq. Në katin e sipërm të kishës gjendet faltorja, ndërsa kati i poshtëm është përdorur si qimitir. Katet lidhen ndërmjet tyre me anën e shkallëve. Kisha ka muraturë të rregullt prej guri pa dekoracione. Hyrja për në kishë bëhet nga ana perëndimore. Pranë hyrjes nga ana e majtë një palë shkallë të çojnë në qimitir. Kisha mbulohet nga një çati dy ujëse. Kisha e “Anargjendëve Kozma dhe Damian” është ndërtuar në vitin 1736. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën e kishës: “Viti prej Krishtit 1736. Është ndërtuar që prej themeli ky manastir i nderuar i Anargjirëve të shenjtë, Kozmajt e Damjanojt, në kohën kur ishte peshkop i gjithhirshmi dhe i gjithdituri mitropoliti i shenjtë i Kosturit, zoti, zoti Krisanth, në kohën kur ishte igumen i gjithhirshmi dhe i shumënderuari zoti Metodi me kontributin e murgut Jan Haxhiut nga Ajdhonohori, afër Serës. Është pikturuar me shpenzimet e arkondëve të shumënderuar, zotit Siropulit nga Ajdhonori dhe zotit Panajot Denisit nga Vithkuqi, për kujtim të përjetshëm të tyre 1750 maj 18, me dorën e Kostandinit e Athanasit nga Korça”.⁵⁴ Ambienti i altarit ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të

⁵³-Fatos Baxhaku, Në Vithkuq për Shën Gjergj, Shqip, 28 prill 2009, faqe 24-25.

⁵⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 354, faqe 176-177.

gdhendur, ikonat e të cilit janë pikturuar prej Kostandin Shpatarakut. Mbi derën e bukur të ikonostasit është shkruar: “Lutja e shërbëtorit të perëndisë, zotit Siropulo nga Aidhonohori, afër Serës”.⁵⁵ Ndërsa mbi ikonën e Krishtit në ikonostas gjendet mbishkrimi: “Dora e jerodhiakon Kostandinit nga Shpati, viti prej Krishtit 1748”.⁵⁶ Mbi ikonën e anargjendëve Kozma dhe Damian që gjendet në ikonostasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorit të shumëdevotshëm të perëndisë, zotiti haxhi Janit, prift nga Aidhonohori, afër Serës”.⁵⁷

KISHA E UNGJILLËZIMIT NË VITHKUQ TË KORÇËS

Kisha e “Ungjillëzimit” gjendet në fshatin Vithkuq të Korçës. Naosi i kishës është njënefësh me përmasa të brendshme 8.0x5.0 metra. Muratura e kishës përbëhet nga gurë gëlqerorë dhe shmërçi, të përforcuar me breza druri. Çatia e kishës është me rrasa guri. Apsida është e punuar me blloqe të rregullt me gur shmërçi dhe e zbukuruar me nike të harkuara. Mbi apsidë gjendet një nike, e cila mbante ikonën e Ungjillëzimit të Hyjlindëses.⁵⁸ Ikonat e ikonostasit të kishës janë të pikturuara nga i njëjti piktor. Mbi derën e bukur të ikonostasit të kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë, Tani Kini, 1684”.⁵⁹ Ndërsa mbi ikonën e Shën Mërisë në ikonostas është shkruar: “Në vitin prej

⁵⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 350, faqe 175.

⁵⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 349, faqe 175.

⁵⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 351, faqe 175.

⁵⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 55.

⁵⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.292, faqe 152-153

ekonomisë së mishërueme të Jisu Krishtit, 1685”.⁶⁰ Mbi ikonën e Joan Pagëzorit në ikonostasin e kishës kemi këtë mbishkrim: “me dorën e mësues Kostandinit”.⁶¹ Një mbishkrim që gjendet mbi fasadën e pikturuar të kishës tregon kohën dhe ktitoren e pikturimit të skenës “Gjyqi i fundit”: “Lutje e shërbëtores së perëndisë, murgeshës Joana, viti 1696 në muajin qershor 6”.⁶²

KISHA E SHËN GJERGJIT NË VITHKUQ TË KORÇËS

Kisha e “Shën Gjergjit” gjendet në Vithkuq të Korçës. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazilikal trinefësh dhe ka përmasa të brendshme 12x9.80 metra. Muratura e kishës përbëhet nga blloqe të rregullta gur shmerçi, të cilat përforcohen me breza druri. Çatia e kishës mbulohet nga plloça guri. Kisha e “Shën Gjergjit” mendohet të jetë ndërtuar në shekullin XVIII.⁶³

Mbi një ikonë të Shën Mërisë në ikonostasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “.... ikona e zonjës Hyjllindëses mbas pikturimit të nderuar në tempullin e madh të shpërfytyrimit afër Nikolicës. Jan Niça i Gjergj papastefanit, për kujtimin e tij. Në vitin prej krijimit të botës 7169 (=1661), në muajin janar”.⁶⁴ Mbi ikonën e Joan Pagëzorit në ikonostas është shkruar: “Lutje e

⁶⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 316, faqe 162.

⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 317, faqe 162.

⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 321, faqe 163.

⁶³-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 55-56.

⁶⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 310, faqe 160.

shërbëtorit të perëndisë, Marko Tele, 1685”.⁶⁵ Në ikonën e Taksiarkëve gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë të esnafit të bajejve të Korçës, viti 1767, mars 27”.⁶⁶ Në një ikonë të Shën Mërisë kundrejt fronit peshkopal gjendet mbishkrimi: “Kujto o zot, shpirtin e shërbëtores së perëndisë Tiela”.⁶⁷ Në ikonën e Pandokratorit në fronin peshkopal të kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Kosta së bashku me të shoqen e tij Kalinë dhe fëmijët....viti...”.⁶⁸

KISHA E RISTOZIT NË MBORJE TË KORÇËS

Kisha e “Ristozit” gjendet rrëzë malit të Moravës, në Mborje të Korçës. Kisha është bizantine në formë kryqi të brendashkruar. Pjesët përbërëse të kishës janë kunga dhe naosi, apsida e të cilit nga pjesa e jashtme është trifaqëshe. Tryeza e shenjtë është e murosur në murin e apsidës. Muratura e kishës është me gurë të papunuar si dhe me copa tjegullash të vendosura ndërmjet gurëve. Tamburi i kishës është tetëfaqësh dhe i ndëtuar me tulla. Në tambur gjenden katër dritare dhe katër nike. Kisha ka përmasa 9.70x4.75 metra. Mbishkrimi që gjendet në faqen e murit jugor të kishës na bën me dije se ktitori i kishës është peshkopi Nimfon. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim, i cili gjendet në faqen e murit jugor pranë portretit të ktitorit: “Peshkopi i shenjtë dhe

⁶⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 318, faqe 162.

⁶⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 372, faqe 183.

⁶⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 509, faqe 215.

⁶⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.514, faqe 217.

ktitori, zoti Nimfon”.⁶⁹ Kisha e “Ristozit” është ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1389. Ky fakt vërtetohet me anën e mbishkrimit që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “U ngrit (ndërtua) që nga themeli me përpjekje dhe mundim, ky tempull hyjnor e i gjithënderuar i zotit tonë, Jezu Krisht jetëdhënës dhe u pikturua prej ktitorit peshkopit të gjithhirshëm zotit Nimfon, në kohën e zotërimit të Amiralit, vëllezërit e gjithlumtur sebastokroatë Jani dhe i gjithlarti despoti, zoti Theodhori, viti 6898 (=1389) nëntor 13”.⁷⁰ Sipas mbishkrimeve vërtetojmë se pikturimi i kishës filloi më 31 mars, me mbarimin e ndërtimit dhe përfundoi më 13 nëntor të vitit 1389.



Peshkopi Nimfon e ndërtoi këtë kishë për ata njerëz që duan të shpëtojnë. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi murin jugor të kishës: “O mbret i pafillim, Krishti im, Logos, prano lutjen time të mjerë, i përvuajtur peshkop Nimfoni mbaj tempullin hyjnor me dëshirë, e kam ndërtuar në fillim që nga themeli dhe me përpjekje deri më 31 mars. Ata që duan të shpëtojnë liriye prej

⁶⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.292, faqe 152-153.

⁷⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 290, faqe 151-152.

shumë mëkateve”.⁷¹ Afresket e kishës së “Ristožit” në Mborje të Korçës janë të ritokuara, megjithatë tematika e skenave biblike nuk është ndryshuar. Në apsidë gjendet Platitera. Në murin e apsidës janë hierarkët e mëdhenj Vasili i Madh, Joan Gojarti, Athanasi i Aleksandrisë dhe Grigor Teologu. Në brezin e sipërm mbi apsidë gjendet skena e “Gjyqit të fundit” dhe anash saj “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”. Brenda nikës së prothesit gjendet Shën Stefani, ndërsa në niken jugore Roman Melodiozi. Në anën jugore të apsidës janë pikturuar Klementi i Aleksandrisë, Andrea i Kretës, Ignat Hyjmbajtësi dhe Joan Damaskini. Në qoshtet që mbajnë tamburin e kubesë gjenden katër ungjillorët duke shkruar ungjillin.

Mbi qemerin jugor gjendet skena “Lindja e Krishtit” me përmasa 1.87x100 metra. Pas saj radhitet “Tradhëtia e Judës” dhe në brezin e fundit gjendet skena “Deisis”. Pas kësaj vjen figura e ktitorit, peshkop Nimfonit, i cili mban në dorë maketin e kishës. Në brezin e sipërm të faqes veriore gjendet skena “Ngjallja e L Lazarit” dhe nën të “Kryqëzimi i Krishtit”. Në vijim skena “Miroprurëset tek varri”, si dhe pikturat e Teodor Tironit, Teodor Stratilatit dhe anargjendët Kozma dhe Damjan. Në faqen e murit perëndimor gjenden Davidi, Solomoni, skenat e “Lindjes së Krishtit” dhe e “Lindjes së Pagëzorit”. Nën to gjendet skena “Fjetja e Hyjlindëses” me përmasa 2.05x1.42 metra. Nga e majta gjendet skena e “Mohinit të Pjetrit”, ndërsa nga e djathta gjendet skena e “Hyrrjes së Hyjlindëses në Tempull”. Nën to poshtë pikturuar “Shën Kostandin dhe Elena” dhe në anën jugore Shën e Premtja dhe Shën Matrona. Përgjatë naosit paraqiten 23 figura të plota shenjtorësh. Pjesa më e madhe e afreskeve janë të dëmtuara dhe janë ritokuar. Duhet theksuar se rreth shek. XVI-XVII kishës iu shtua një hajat me strehë në anën perëndimore, i cili u pikturua më vonë.⁷²

⁷¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 291, faqe 152.

⁷²-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 220-223.

KISHA E SHËN GJERGJIT NË DARDHË TË KORÇËS

Kisha e “Shën Gjergjit” gjendet në fshatin turistik të Dardhës. Kisha është bazilikë trinefëshe dhe ka filluar së ndërtuari më 16 korrik të vitit 1838. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës: “Ky tempull i famshëm u fillua për tu ndërtuar më 16 korrik 1838”.⁷³ Ndërsa mbi portën veriore është shkruar: “1838. U ndërtua siç e sheh ky tempull i gjithënderuar i Shën Gjergjit, në Dardhë 16 korrik”.⁷⁴

Mbi ikonën e Krishtit në ikonostas është shkruar: “U pikturua kjo ikonë e nderuar me dorën e Kostandin Zografit, nga Dardha, 1825 maj 20”.⁷⁵ Gjithashtu në ikonë e Krishtit është shkruar: “Me dorën e agjiograf Kostandin Dardharit, nga eparkia e Kosturit, 1831 nëntor 15”.⁷⁶ Mbi ikonën e Shën Gjergjit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua kjo ikonë e nderuar me kontributin e shpenzimet e Rufo Zdrulit, me dorën e Gjergjit, dikur Gjergj Zografit nga katundi i Larit 1808”.⁷⁷ Mbi ikonën e Shën Mitrit gjendet ky mbishkrim: “Dora e Theor P. Ilia nga katundi Dardhë 1887”.⁷⁸ Në ikonën e vogël të Shën Mërisë në prosqinitarin e kishës është shkruar: “Dora e Anastas Ballmaçit

⁷³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 438, faqe 201-202.

⁷⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 438, faqe 201-202.

⁷⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 425, faqe 197.

⁷⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 433, faqe 200.

⁷⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 401, faqe 191.

⁷⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 477, faqe 209.

1882 dhjetor 6”.⁷⁹ Në bazamentin e potirit të kishës është gdhendur: “1896-Me dorën e N.K dhe Naum G. Më 14 gusht”.⁸⁰

KISHA E SHËN MITRIT NË BOBOSHTICË TË KORÇËS

Kisha e “Shën Mitrit” gjendet në perëndim të fshatit Boboshticë të Korçës. Kisha është njënefëshe me apsidë trifaqëshe. Muratura e kishës është me gurë ranorë të lidhur me llaç gëlqereje si dhe me copa tjegullash të vendosura ndërmjet gurëve. Muret e kishës janë të pikturuar me afreske të cilat po i analizojmë. Në apsidë gjendet “Shën Mëria” ndenjtur mbi një fron pa mbështetëse duke mbajtur Krishtin në pëqi dhe anash saj janë pikturuar dy engjëj të pëkulur nga ajo në pozicion lutjeje. Nën pikturën e Shën Mërisë gjendet brezi me tematikë liturgjike, jerarkët e kishës Shën Vasili i Madh, Joan Gojarti, Grigor Teologu, Joan Përdëllimttari, Athanasi i Aleksandrisë, dhe Grigor Çudibërësi. Ky i fundit është kthyer nga altari. Në murin jugor të apsidës gjendet Klimi i Aleksandrisë. Në anën veriore të apsidës, në nikën e prothesit gjendet Shën Stefani. Sipër në apsidë gjendet “Shestja”, ndërsa nën të gjendet skena e “Ungjillëzimit”.

Mbi faqen e murit perëndimor dallohen tri skena, dy prej të cilave janë shumë të dëmtuara, ndërsa skena e tretë është “Krishti papa Pilatit”. Nën to mbi portë gjendet skena “Fjetja e Hyjlindëses”. Në anën veriore të portës gjenden “Shën Kostandini dhe Elena”, ndërsa në anën jugore të portës afresket janë zhdukur. Në fasadën perëndimore të kishës në narteks, mbi nikën e harkuar ng asipër gjendet “Shën Mëria” në gjysmëfigurë me Krishtin në duar. Në anën veriore të portës gjendet skena “Pagëzimi i Krishtit”, ndërsa

⁷⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 468, faqe 207.

⁸⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 485, faqe 210-211.

në anën jugore janë disa afreskë të dëmtuar dhe të paightifikuar. Nëpër faqet e hyrjen në naos gjenden Shën e Premtja dhe Shën Varvara. Këto janë afresket që ruhen në gjendje të mirë në kishën e “Shën Mitrit” në Boboshticë të Korçës. Përsa u përket skenave të tjera të pikturës kishtare ato janë të dëmtuara dhe të paightifikuara.⁸¹

KISHA E SHËN MËRISË NË LUBONJË TË KOLONJËS

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Kisha është bazilikë trinefshe me përmasa 14.75x11 metra. Muratura e ndërtimit të kishës është prej gurësh të lidhur me llaç gëlqereje dhe me copa tjegullash ndërmjet gurëve, të vendosura në mënyrë të çrregullt. Apsida e kishës është trifaqëshe. Mbi faqen perëndimore të kishës gjendet mbishkrimi: “Ka qenë ndërtuar për herë të parë që nga kohërat e vjetra ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i së mbishenjtës Hyjlindëse Mari, prej themeli në vitin 1015 me kontributin e priftërinjve të shumëdevotshëm dhe të shquar Papa Kostandini, Papa Llukës, Papa Theodorit. Në vitin 1806 është rrafshuar prapë (u përtëri) që nga themeli dhe u zgjerua sikurse shihet dhe në vazhdim u pikturua më 1806 me kontributin e priftit të shumëdevotshëm Papa Dhimitër Stoit dhe Gjergj Gjudit, me shpenzimet e katundarëve, të katundit Lubonjë, Papa Andoni. I përjetshëm kujtimi. Me dorën e piktor Terpos, birit të Kostandinit, nga Korça, më 7 tetor”.⁸²

Në brezin e fundit pas “Platiterës” gjenden hierarkët e mëdhenj të kishës: Joan Gojarti, Vasili i Madh, Athanasi i Madh, Silvestri i Romës si dhe dy etër të tjerë të paightifikuar. Etërit

⁸¹-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 157-159.

⁸²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 398, faqe 190.

paraqiten me qëndrim sikur janë duke shkuar drejt mesit të apsidës. Ata kanë veshur amfie hieratike me fellone dhe omoforë të bardhë të stolisur me kryqe të zeza. Ata mbajnë epigonate të stolisur.⁸³

KISHA E SHËN MËRISË NË BARMASH TË KOLONJËS

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në hyrje të fshatit Barmash të Kolonjës. Kisha përbëhet nga naosi, nartekso dhe hajati. Naosi është njënefësh dhe ka përmasa të brendshme 11.30x4.60 metra. Hajati zgjatet në faqen jugore të kishës. Muratura e kishës përbëhet nga gurë të papërpunuar të lidhur ndërmjet tyre me llaç gëlqereje. Muratura e hajatit është me gurë të lidhur me baltë dhe është e përforcuar me breza druri. Apsida e kishës është trifaqëshe.⁸⁴

Kisha është pikturuar në vitin 1616. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet i pikturuar mbi faqen e murit verior të kishës: “U pikturua ky tempull i gjithnderuar i së mbishënjtës, zonjës sonë Hyjllindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari me kontributin përpjekjet dhe shpenzimet ...të priftit zotit Andrea....në kohën kur ishte peshkop...të mitropolitit të Kosturit zotit, zotit, David, në vitin 1616”.⁸⁵ Mbi ikonën e Shën Triadhës në ikonostas është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë prift Kostandinit, Kostës, Vasilit, Janit, Stefanit dhe Peços dhe të prindërve”.⁸⁶

⁸³-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 109-111.

⁸⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 83-84.

⁸⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 303, faqe 157.

⁸⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 383, faqe 185.

KISHA E SHËN KOLLIT NË SHALËS TË KOLONJËS

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në fshatin Shalës të Kolonjës. Kisha ka përmasa 22x12 metra dhe është ndërtuar më 1 gusht të vitit 1859. Kjo datë është gdhendur në një gur mbi portën e kishës.⁸⁷ Ikonat e ikonostasit të kishës janë pikturuar në vitit 1769 nga një piktor anonim. Në ikonën e Shën Mërisë dhe të Joan Pagëzorit është shkruar viti 1769”.⁸⁸ Gjithashtu mbi ikonën e Joan Pagëzorit është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Mihailit, birit të Dhimës nga katundi Shalësi 1769 prill 7”.⁸⁹ Mbi ikonën e Shën Kollit gjendet mbishkrimi: “Dora e Jan i denjë”.⁹⁰

KISHA E SHËN MËHILLIT NË SHALËS TË KOLONJËS

Kisha e “Shën Mëhillit” gjendet në fshatin Shalës të Kolonjës. Kisha ka përmasa të brendshme 9.80x5.0 metra. Muratura e kishës përbëhet nga gurë shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Qoshet janë punuar me gurë të mëdhenj dhe të latuar. Harku dhe shpatullat e portës janë ndërtuar me gurë shtufi të gdhendur. Dritaret e kishës janë drejtkëndëshe. Mbi to janë vendosur arkitrarë guri dhe mbi ta gjenden harqe shkarkuese. Çatia e kishës është triujëshe e mbuluar me rrasa guri.⁹¹

⁸⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, N.446, faqe 203.

⁸⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 373, faqe 183.

⁸⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 374, faqe 183.

⁹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 497, faqe 212-213.

⁹¹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 84-85.

Kisha e “Shën Mëhillit” është ndërtuar në vitin 1415 dhe është rindërtuar në vitin 1810. Këto dy data gjenden të gdhendura mbi një pllakë pranë portës veriore të kishës”.⁹² Mbi portën perëndimore të kishës gjendet mbishkrimi: “U ngrit dhe u ndreq nga gërmadhat....ky tempull i gjithnderuar i arkistrategut kryeengjell Mihael me kontributin dhe shpenzimet dhe të prishurat e të krishterëve ortodoksë të devotshëm...të peshkopit të Korçës, zotit, zotit Neofit...Nikollës.... “.⁹³ Një kambanë të kishës së “Shën Mëhillit” daton në vitin 1813.⁹⁴

KISHA E SHËN MËRISË NË CERCKË TË KOLONJËS

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Cerckë të Kolonjës. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe mjedisi i altarit. Kisha është një paraklis me përmasa 6.55x5.26 metra. Naosi i kishës mbulohet me çati dyujëse. Muratura është me gurë të papërpunuar të lidhur me llaç gëlqereje. Muret e kishës janë të zbukuruara me tulla dhe gurë të vendosur në formë kurrizpeshku, pjerrtas dhe vertikalisht. Kisha mendohet të jetë ndërtuar në shek. XI.⁹⁵

Muret e brendshme të kishë janë të stolitura me piktura murale prej një piktori anonim. Në apsidën e murit lindor gjendet skena e “Shestjes”, e cila është e dëmtuar. Në apsidë gjendet “Platitera” e tipit oranta. Nën të gjendet brezi i hierarkëve, prej të cilëve dallojmë Shën Vasilin dhe Shën Grigor Teologun. Në niken

⁹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 404, faqe 192.

⁹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 506, faqe 214.

⁹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 411, faqe 194.

⁹⁵-Aleksandër Mexsi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 149-150.

e prothesit gjendet Shën Stefani, kurse përmbi të paraqitet një hierark pa nënshkrim që mund të jetë Joan Përdëllimtari. Në anën jugore të apsidës gjendet Roman Melodiozi. Nëpër tri faqet e tjera të mureve të kishës gjenden tri breza me piktura murale. Në brezin e sipërm jepen skena e festave të mëdha, brezi i mesit është me medalione shenjtorësh e martirësh, ndërsa brezi i fundit me shenjtorë dhe martirë me paraqitje më këmbë.

Duke u nisur nga kunga kemi skenën e “Lindjes së Krishtit”, prej së cilës kanë mbetur vetëm fragmente. Në vijim është skena e “Ipapandisë” me përmasa 1.66x1.22 metra. Pas saj vjen skena “Ngjallja e Llazarit” me përmasa 2x1.30 metra. Në faqen e murit perëndimor është një skenë e dëmtuar dhe menjëherë pas saj vjen skena e “Fjetjes së Hyjllindëses”. Në vijim gjendet skena e “Kryqëzimit të Krishtit” e kështu me radhë. Në faqen e murit verior gjendet skena e “Shpërfytyrimit”, ndërsa po në faqen e murit verior në kungë gjendet skena e “Ngjalljes së Krishtit”.

Brezi i dytë përmban paraqitjen e shenjtorëve në medalione me përmasa 0.45x0.47 metra. Duke filluar nga muri jugor paraqiten: Profeti Abakum, Shën Nikita dhe dy shenjtorë të paidentifikuar. Në faqen e murit perëndimor paraqiten: Shën Vikenti, Shën Minai si dhe gjashtë shenjtorë të tjerë të paidentifikuar. Në faqen e murit verior janë: Shën Artemi, Solomoni dhe dy piktura të paidentifikuara. Në faqen e murit lindor paraqitet Apostull Pjetri.

Në brezin e fundit shenjtorët paraqiten më këmbë. Duke filluar nga muri jugor kemi: Shën Kolli, Athanasi i Aleksandrisë, Shën Gjergji dhe Shën Dhimitri. Në murin perëndimor gjenden Simeon Stiliti dhe Shën Mëhilli me përmasa 1.72x1.40 metra. Mbi portën perëndimore paraqitet një mbishkrim dhe menjëherë pas tij vjen Shën Kostandini dhe Elena me përmasa 1.58x1.40 metra. Në faqen e murit verior gjendet skena ku paraqiten Teodor Tironi dhe Teodor Staratili me përmasa 1.58x1.11 metra. Pranë nikes së prothesit gjendet skena “Vizioni i Pjetrit të Aleksandrisë”.

Brezat me skena ndahen prej një brezi të ngushtë horizontal të stolisur me motivin e palmetave, ndërsa nën brezin e fundit kemi një brez dekorativ rreth 60 centimetra, në të cilin janë pikturuar shqiponja dykrenare dhe me motivin e zemrave të stilizuara. Në pikturat murale të kishës së “Shën Mërisë” në Cerçkë ikonografi nuk ka respektuar rendin kronologjik të skenave. Ikonostasi i kishës ka qenë prej druri të gdhendur, por nuk është ruajtur. I kanë shpëtuar kohës vetëm dy ikona të mëdha të ikonostasit edhe ato të dëmtuara.⁹⁶

KISHA E SHËN MITRIT NË BEZMISHT TË PRESPËS

Kisha e “Shën Mitrit” gjendet në fshatin Bezmisht të Prespës së Madhe. Kisha është njënëfëshe, me apsidë trifaqëshe dhe mendohet të jetë ndërtuar gjatë shekullit XIV. Apsida e kishës është me punime dekorative me një brez prej dy rreshta tullash të vendosura horizontalisht si dhe me nga një tullë në formë medalioni në mes dy faqeve anësore. Tryeza e shenjtë është e lidhur në murin e apsidës. Muratura e kishës është ndërtuar me teknikën e kluasonazhit me dy tulla vertikale ndërmjet gurëve dhe dy radhë tullash horizontale.⁹⁷

Kisha është e pikturuar me afreske vetëm në faqen e murit lindor. Në nikën e vogël mbi portën perëndimore jashtë gjendet skena e Shën Mitrit. Në apsidën e kishës gjendet “Platitera” e tipit Oranta, e cila paraqitet me duart e hapura në pozicion lutjeje, por pa Emanuelin në kraharor. Nën të vjen brezi me hierarkët e kishës: Vasili i Madh, Kirili i Aleksandrisë, Joan Gojarti dhe një hierark i pidentifikuar. Në nikën e prothesit gjendet Shën Stefani dhe majtas

⁹⁶-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 135-138.

⁹⁷-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 178.

tij një skenë e pidentifikuar. Në nikën jugore gjendet Romano Melodiozi. Anash apsidës gjendet skena e “Ungjillëzimit”, ndërsa në nikën mbi portën perëndimore gjendet skena e “Shën Mitrit mbi kalë duke vrrarë Lineun”.⁹⁸ Në nikën e prothesit gjendet një mbishkrim në gjuhën sllave me shkronja cirilike: “Prano o zot lutjen e shërbëtorit tënd, zotit Dragan me shoqërinë”.⁹⁹

KISHA E SHËN THANASIT NË LLËNGË TË POGRADECIT

Kisha e “Shën Thanasit” gjendet në fshatin Llëngë të Pogradecit. Kisha ka përmasa 12x8.25 metra dhe është bazilikë njënefëshe me tri apside anash. Ikonat e kishës së “Shën Thanasit” janë pikturuar nga Kostandin Shpataraku. Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Dora e jeromonak Kostandinit me kontributin dhe dëshirën e prift Nikollës...ekonomit. Prej Krishtit 1694”.¹⁰⁰

Gjithashtu sipas Theofan Popës, Kostandin Shpataraku ka nënshkruar edhe katër ikonat e tjera të mëdha të ikonostasit të kishës: ikonën e Shën Mërisë, ikonën e Joan Pagëzorit, ikonën e Shën Thanasit që është edhe shenjt i kishës, si dhe ikonën e Shën Mitrit. Në faqen e përparme të proskinitarit të kishës së Shën Thanasit gjendet i gdhendur viti 1717. Proskinitari është prej druri të gdhendur rreth 1.50 metra i lartë.¹⁰¹ Kisha e “Shën Thanasit” është rindërtuar në vitin 1752. Mbi portën perëndimore brenda

⁹⁸-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 118-119.

⁹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.516, faqe 217.

¹⁰⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 23, faqe 60.

¹⁰¹-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 25, faqe 60.

kishës gjendet mbishkrimi përkatës: “U ngrit dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë ndër shenjtorët, Athanasit të Madh, patrikut të Aleksandrisë, me kontributin dhe të ekonomit prift Nikollës dhe të pleqve zotit Dhimitër, zotit Nikolla, zotit Llazar dhe zotit Kiona, me përpjekjet dhe shpenzimet e të gjithë të krishterëve, të priftërinjve që kryejnë shërbesat e hirshme, prift Gjergjit, prift Mihalit dhe Llazarit, Gjergjit, Postolit, Kostës, Janos, Nikos, Kostës, Tinos. Në kohën e peshkopatit, të peshkopit zotit Arsen Vako. Me dorën time, të piktorit të përvojatur Dhimitrit, birit të Nikollë Zografit, nga katundi Linotopi, që i shërbeu murgëshës Zinovia”.¹⁰²

Mjeshtër Sotir Tima ka punuar kryqin prej argjendi, i cili përdorej gjatë pagëzimit. Rreth bazamentit të kryqit shkruhet: “Ky kryq është i manastirit të shën Thanasit, të qytetit Lunge (Llëngë). Mjeshtër Sotir Tima”.¹⁰³ Kjo kishë është prishur gjatë luftës Italo-Greke. Vite më vonë në truallin e kishës është ndërtuar shkolla e fshatit Llëngë.



¹⁰²-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 20, faqe 58.

¹⁰³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 78, faqe 77

MANASTIRET E MITROPOLISË SË KORÇËS

1. Manastiri i Prodhromit gjendet në veri të Voskopojës. Në vitin 1630, papa Joani pasi mbeti i ve vendosi që të asketonte në vendin ku sot gjendet manastiri. Iniciativën për ndërtimin e manastirit e ndërmori arkondi Gjergji Guço Milingjeri në vitin 1632 dhe pas dy vjetësh punë ndërtuese më 14 korrik të vitit 1634 u përfundua kisha me ambientet përkatëse nga kushëriri i tij Mihal Milingjeri. Igumen i manastirit në atë kohë ishte Andon Shipska.



Manastiri u ndërtua në vitin 1632 dhe u pikturua më vitin 1659. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim i pikturuar mbi suva lart portës perëndimore brenda naosit: “U rindërtua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar me kontributin dhe shpenzimet e të shumënderuarit dhe të shumë fisnikut arkondit, zotit Gjergji Guço, në vitin 7140=1632. U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i shenjtit të lavdëruar profet dhe pararendësit dhe pagëzor Joanit, me igumen zotin Andon, jeromonak, dhe me

shpenzimet e të shumënderuarit dhe të shumëfisnisikut arkond, zotit Mihail, biri i të ndjerit Kostë, për shpirtin e tij dhe të bashkëshortes dhe fëmijëve të tij, në kohën e peshkopatit të shumëlumturit kryepeshkop të shumëshenjtës Justinianës së parë të Ohrit, zoti Egnati, në vitin 1659”.¹⁰⁴ Mbi një ikonë guri të Shën Mërisë është shkruar: “Kujto o zot shërbëtorin e perëndisë, Kristo Çevrençin, gruan e tij Kostinën, Marjon 1762”.¹⁰⁵

Manastiri i “Prodhromit” ka qenë në gjendje të mirë ekonomike dhe një qendër e rëndësishme shpirtërore për ortodoksët e rrethit të Korçës. Manastiri gjendet në një vend piktoresk mes pyllit të pishave rreth dy orë larg nga fshati. Ky manastir i është kushtuar Joan Pagëzorit dhe kremtonte më 24 qershor në ditën e lindjes së shenjtit. Në këtë ditë të shënuar zhvillohej një panair i madh, ku pelegrinët e shumtë mikpriteshin nga personeli i manastirit. Dy gra të moshuara nënë Tana dhe nënë Qyrana mbanin çelësat e dhomave të manastirit. Vinin qindra njerëz të sëmure e të gjymtuar pa dallim feje, të cilët pasi flinin një natë në kishën e manastirit gdhiheshin të shëruar dhe të çliruar. Kisha e manastirit është e stilit bizantin me tre apside dhe një kube të ngritur mbi çati. Kambaneria ka qenë ngjitur me kishën. Nga ana perëndimore, veriore dhe jugore kisha e manastirit të “Prodhromit” rrethohej me ndërtesa dykatëshe. Në katin e parë gjendeshin qilarët e bagëtive si dhe depot me ushqimin e tyre, ndërsa në katin e dytë gjendeshin qelitë e manastirit, të cilat strehonin igumenin, priftërinjtë, dhjakonët, barinjtë, karvanexhinjtë si dhe shërbyeset e manastirit. Një pjesë e këtyre të fundit qëndronin përjetë në vakkëf dhe varroseshin pranë manastirit. Në anën veriore të manastirit gjendej guzhina dhe një oxhak i madh ngrohte miqtë. Në të priteshin dhe përcilleshin pelegrinët që vizitonin manastirin. Pasi hanin dhe

¹⁰⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 306, faqe 158-159.

¹⁰⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 363, faqe 180.

pinin në dhomën e oxhakut pelegrinët përcilleshin për në dhomat e fjetjes, të cilat qenë të caktuara sipas rëndësisë së miqve. Fillimisht kishin përparësi dhespotlerët dhe më pas ata që kishin një pozitë të lartë shoqërore. Në anën lindore afërsisht 50 metra larg kishës gjendej një burim me ujë të rrjedhshëm e të ftohtë, i cili derdhej në një govatë prej guri.¹⁰⁶

Gjatë viteve të luftës kisha e “Joan Pagëzorit” është djegur, prandaj me gjithë restaurimet e pjesshme që i qenë bërë ndër vite ishte në gjendje kritike. Prandaj duke parë rëndësinë e saj monumentale u restaurua plotësisht në vitin 2011 me fondet e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Për të realizuar restaurimin u shpenzuan 3.978.240 lekë. U realizua përforcimi i themeleve më beton, qepja e muraturës, ndryshimi i brezave të drurit të djegur, qepja e qemerëve dhe e kupolave, muratuara e dëmtuar si dhe u bë rikonstruksioni i çatisë.¹⁰⁷

2. Manastiri i Shën Pjetrit dhe Pavlit gjendet mbi një kodër në verilindje të fshatit Vithkuq. Nga godinat e manastirit ka mbetur vetëm kisha e “Shën Pjetrit dhe Pavlit”, sepse konakët e manastirit janë shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Konakët e manastirit kanë qenë dy dhe tri katëshe dhe shtriheshin në tri anët e oborrit të brendshëm. Në mesin e konakëve gjendej një oborr i brendshëm, i cili kishte sipërfaqe rreth 200 metra katrore. Anash tij në formën e shkronjës “U” gjendeshin rreth 40 qeli banimi. Konakët qenë trikatësh. Arkadat e katit të dytë qenë prej druri. Në katin e dytë të konakëve gjendej biblioteka. Sipas Ilo Mitkë Qafëzezit në bibliotekën e manastirit ruheshin dorëshkrime me vlerë rreth historisë së Korçës dhe Voskopojës. Kisha përbëhet nga naosi dhe një portik përpara hyrjes kryesore. Kisha është e tipit bazilikë trinefëshe me kupolë dhe ka përmasa 16.10x10.50

¹⁰⁶-Dhori Falo, Tragjedia e një qyteti, Kotti, Korçë 1998, faqe 112-113.

¹⁰⁷-Gentjan Stratobërdha, Ndërhyrje të plota restauruese në kishën e manastirit të Shën Prodhromit në Voskopojë të Korçës, Ngjallja, shtator 2011, faqe 12.

metra. Ajo u ndërtua rreth vitit 1759-1764 prej kryemjeshtrit Gjikë Lena dhe mjeshtërit ndërtues Dhimo Dukasi, Hari Venetiku, Dine Krekasi, Mërkur Saraqi, Zoto Lihasi, Bitri Maxhari, Vaso Sumbulla, Kule Deti dhe Pepo Rredhi.¹⁰⁸

Kisha është pikturuar në vitin 1764 prej piktorëve Kostandin e Athanas Zografi. Për pikturimin e kishës u shpenzuan rreth 700 grosh, të cilat i solli nga Hungaria igumeni i manastirit Tarasi. Mbi portën veriore brenda kishës gjendet një mbishkrim, i cili vërteton kohën e pikturimit të kishës: “U ndërtua prej themeli, ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i Apostujve të shenjt dhe u pikturua...të krishterëve. Në kohën e gjithoshënarit murgut. Me dorën e Kostandin dhe Athanasit, nga Korça, në vitin 1764”.¹⁰⁹



Ikonostasi i kishës u gdhend me shpenzimet e tregtarëve voskopjarë dhe ka kushtuar rreth 600 grosh. Ai është është punuar me teknikën e gdhendjes së rrafshtë në dru dhe ka përmasa 9x4.90

¹⁰⁸-Aleko Papakozma, Manastiri i Shën Pjetër e Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit, Monumentet 1 / 1983 (25), faqe 77-85.

¹⁰⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 367, faqe 181.

metra. Në të gjenden motive floreale, laike si dhe skena nga jeta e fshatit. Zbukurimet janë të daltuara thellë dhe i përkasin stilit rokoko. Në mesin e ikonostasit gjendet dyert e bukura, tek të cilat gjenden dhjetë ikona. Rreth ikonave degëzohen bisqe me dredhëza helika që shtjellohen rreth dy krerëve skifteri. Sipër ikonave gjenden dy krerë shqiponjash të qarkuara prej dhjetë zoqve që çukisin kokrrat në drejtime të ndryshme. Dyert kufizohen me një buzinë, tek e cila gjenden zogj, dy minj arre dhe dy koka grifonësh të egërsuar që vështrojnë nga ata. Mbi harkun e dyerve paraqiten dy engjëj, të cilët sjellin kishën si dhuratë, ndërsa përkrah tyre dy luanë luftojnë kundër dy hidrave. Sipër tyre paraqiten zogj duke fluturuar të rrethuar nga dredhkat dhe hardhitë.¹¹⁰

Ikonostasi u gdhend në vitin 1773 prej Dhimitër Kolecit. Mbi portën e bukur të ikonostasit është shkruar: “U verakos në vitin 1773”.¹¹¹ Në ikonostasin e kishës gjenden dhjetë ikona të mëdha dhe 17 ikona të vogla. Në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Lutja ime, e shërbëtorit të përvuajtur të perëndisë, jeromonak Tarasit, igumenit dhe arkimandritit, viti 1762, shkurt 14”.¹¹² Mbi një ikonë të Shën Mërisë gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë ... Jese .. dhe të Davidit. Dora e Kostandin jeromonakut 1710”.¹¹³ Mbi ikonën e madhe të kryeengjëjve gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, Demirit dhe Avlonës, viti 1762 nga

¹¹⁰-Fatbardha Shkupi, Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX, Monumentet 2 / 1983 (26), faqe 130-140.

¹¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 375, faqe 183-184.

¹¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 365, faqe 181.

¹¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 324, faqe 164.

katundi Drenovë”.¹¹⁴ Gjithashtu në ikonën e madhe të Kryeengjëjve është shkruar: “Me dorën e Kostandinit, nga Korça në vitin 1774, shkurt 10”.¹¹⁵ Në breroren e ikonës së Shën Triadhës gjendet mbishkrimi: “Kjo brerore e Hyjlindëses u dhurua në manastirin e kryeengjëjve në Vithkuq nga prift Kozmaj. Qoftë për kujtim të tij të përjetshëm. Me dorën e Panajotit, të Petro Haxhi Roilit 1763”.¹¹⁶

Froni dhespotik është punuar me teknikën e gdhendjes në relief. Froni përbëhet prej tre pjesësh. Mbi fron gjendet një shtatore gjashtëkëndore me tufëza trëndafili, të kufizuara prej shtyllëzash me gjethe. Pjesa ballore e fronit përbëhet nga tre harqe të zbukuruar me gjethëza. Mbi ballzinat e harqeve janë gdhendur tre metope trëndafilash. Shtatorja e fronit mbështetet mbi katër shtylla cilindrike, tek të cilat janë gdhendur lule, zogj që çukasin dhe kafshë të ndryshme. Në krahët e fronit dhespotik janë gdhendur tufëza gjethesh, të cilat lakohen rreth lafshës së një shqiponje që është duke mbajtur në sqep një tufë me trëndafila. Froni dhespotik mbështetet mbi dy luanë.¹¹⁷ Në ikonën e Krishtit në fronin peshkopal të kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorit tënd o zot, Haxhi Thanasit. Dora e Kostandin jeromonakut – 1710”.¹¹⁸ Gjithashtu mbi një ikonë të Shën Mërisë është shkruar: “Me dorën e Vasil Frashtanit 1819. Kujto o zot, perëndi, shërbëtoren tënde Dhespinë Fugën si dhe Marinë”.¹¹⁹

¹¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 364, faqe 180.

¹¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 377, faqe 184.

¹¹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 366, faqe 181.

¹¹⁷-Fatbardha Shkupi, Zbukurimorja e ndërtimitarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX, Monumentet 2 / 1983 (26), faqe 138.

¹¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 325, faqe 164.

¹¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 421, faqe 196.

Manastiri ka pasur rreth 40 konakë, 500 kokë dhen, 25 dyqane në Korçë etj. Gjithashtu ka pasur ullishta në Vlorë. Në pronësi të manastirit ka qenë mulliri i fshatit. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 400 lira në vit.¹²⁰

3. Manastiri i Shën Kollit në Boboshticë: Kisha e “Shën Kollit” është bërë e re në vitin 1501 pas Krishtit. Sipas të dhënave që na jep Kodiku i Madh i Mitropolisë së Korçës vërtetohet se më 24 qershor të vitit 1728 delegatët e fshatrave vakëf të Mirahot Ilias beut u mbledhën në manastirin e “Shën Kollit” të Boboshticës. Në këtë mbledhje morën pjesë klerikë, tregtarë dhe zanatçinj. Mbledhja vendosi që fshatarët të organizoheshin në bazë të traditave të zonës. Mbi rozetën e gurtë të dyshemesë së kishës është shënuar “në vitin 1686”, që mendohet të jetë datë e rindërtimit të kishës.¹²¹

Mbi një ikonë të madhe të Krishtit është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Jan Gjonit dhe me kontributin e Angjelina Mihit”.¹²² Kjo ikonë tani gjendet në muzeun e Tiranës.

4. Manastiri i Shën Mërisë në Boboshticë. Afresket e kishës janë pikturuar në vitin 1829 prej Mihalit nga Magarova. Në apsidën e kishës është shkruar emri i piktorit që ka pikturuar afresket e kishës: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Vangjelit. Dora e Mihalit nga katundi Magarovë, në vitin 1829, tetor 10”.¹²³

Nën kryqin e ikonostasit të kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje shërbëtorit të perëndisë, Eftimit të Gjergj Pisoderasit. Lutje

¹²⁰-Aleko Papakozma, Manastiri i Shën Pjetër e Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit, Monumentet 1 / 1983 (25), faqe 77-85.

¹²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 367, faqe 181.

¹²²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.507, faqe 214-215.

¹²³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 430, faqe 199.

esnafit të hanxhive, Janit, Kostandinit dhe Jan Telit të Dhimitrit, 1829”.¹²⁴ Mbi ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të të perëndisë Gjergjit, prift Anastasit, Naumit, Vangjelit dhe Stefanit nga fshati Katund 1826”.¹²⁵

5. Manastiri i Kamenicës afër fshatit Kamenicë i është kushtuar Shën Kollit. Mbi ikonën e Shën Mitrit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me shpenzimet e K. Dhimitrit e N. Tezhës, në Korçë 1864. Piktori Jan A., nga Dardha”.¹²⁶

6. Manastiri i Shën Elias është mbi një kodër dominuese të fshatit Hoçisht të Devollit. Ai është ngritur nga fillimi i shekullit XIX dhe ka qenë në gjendje të mirë ekonomike. Mbi portën jugore të kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua dhe u ndërtua ky tempull i hirshëm nga zbulesa hyjnore me shpenzimet e të shumëlumturit Mojsi Nikollajeviqit nga Prizreni, i cili adoptoi dhe pagëzoi jeromonak Meletin, dhe e vuri trashëgimtar. Ky ndërtoi dhe gjinekonitin dhe banesat e bollshme së bashku me murgeshën...hallën e Meletit, që ishte motër e adoptuar e Mojsiut të përmendur, të cilët...plaka dhe igumenia që kishin bërë të holla që prej moshës së re. U ndërtua në vitin 1817, me dorën e Margaritit prej Volos të Malit Perian”.¹²⁷ Ikonat e ikonostasit të kishës janë pikturuar prej Margarit Makriniotit në vitin 1817. Nëpër ikona është shkruar: “Dora e Margarit Makriniotit 1817”.¹²⁸ Në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e

¹²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 429, faqe 199.

¹²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 426, faqe 197.

¹²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 450, faqe 204.

¹²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 471, faqe 195.

¹²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 418, faqe 195.

shërbëtorit të perëndisë, Vangjel Terpinin...me dorën e agjiograf Kostandin Dardharit, nga eparkia e Kosturit 1834”.¹²⁹

7. Manastiri i Llëngës në rrethin e Pogradecit i është kushtuar Shën Marenës. Rreth viteve 1750 fshati Llëngë ka pasur 10000 banorë, të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e manastirit. Banorët e Llëngës janë arumunë dhe kanë pasur lidhje me banorët e Voskopojës. Manastiri zë një sipërfaqe të madhe toke, e cila fillon nga livadhet e Mujazeve. Kisha mendohet se është ndërtuar në vitin 1660 dhe është rindërtuar më 1754. Kisha është e stilit bazilikë njënëfshe me përmasa 11.85x6.75 metra. Kisha është e pikturuar me afreske, ku më i spikaturi është ai që i kushtohet martirizimit të Shën Marenës. Afresket janë pikturuar në vitin 1754 nga Kostandin Shpataraku. Mbi portën perëndimore të naosit brenda kishës është shkruar: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i dëshmores së madhe të Krishtit, shën Marinës, me ndihmën e të gjithë të krishterëve, të esnafëve, të mjeshtërve, të rrobaqepësve, të kasapëve dhe të karvaneve të vegjël e të mëdhenj, që gjenden në qytetin Llëngë, me përpjekjet dhe shpenzimet e të shumëdevotshmit prift Gerasimit dhe mbikqyrsit të këtij manastiri të shenjtë, me kujdesin dhe kontributin e të shumëndershmit, kryetarit Gjergj Nikollë Manit, së bashku me pleqtë që e pasonin atë, emrat e të cilëve së bashku dhe të peshkopit dhe të priftërinjve gjenden në tempullin hyjnor të shën Gjergjit, në mes të qytetit, si të ekspozuara për ata që do ti lexojnë. U përfundua në vitin prej Krishtit 1754, muaji tetor 2”.¹³⁰ Me anën e një mbishkrimi tjetër mësojmë së kunga e kishës është pikturuar me shpenzimet e Kostë Nirrës: “Kjo kungë hyjnore dhe e hirshme e pikturuar me shpenzimet e Kostës, birit të Mark Nirrës, për shpëtimin e shpirtit të tij dhe të prindërve”.¹³¹

¹²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 435, faqe 200-201.

¹³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 34, faqe 62-63.

¹³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.35, faqe 63-64.

Mbishkrimi është shkruar me dorën e Kostandin Shpatarakut dhe gjendet në faqen e murit lindor, mbi nikën e prothesit. Në portën perëndimore të narteksit të kishës është shkruar: “Do të hyj në shtëpinë tënde, do të adhuroj në kishën e shenjtëruar tënden, me frikën tënde, zot, më hiq udhën në drejtësinë tënde për punë të armiqve të mi. Drejto përpara teje udhën time”.¹³² Gjithashtu peneli i Kostandin Shpatarakut ka pikturuar një pjesë të ikonave që gjenden në ikonostasin e kishës. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës: “Prej Krishtit 1755, dora e jerodhiakon Kostandinit”.¹³³ Gjithashtu ikonografi Shpataraku në ikonën e Shën Thanasit ka lënë këtë mbishkrim: “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Gjergj Manit”.¹³⁴ Mbi gurin arkitra të portës jugore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili tregon kohën e ndërtimit të strehës së hajatit jugor: “E ndërtoi at Sotiri (Ropa) 1832”.¹³⁵ E kremtja e Shën Marenës është më 17 korrik, por me kalendarin e vjetër i bie që të festohet më 30 korrik. Në panairin që zhvillohet me këtë rast vijnë shumë besimtarë, kryesisht njerëz që kanë probleme shëndetësore dhe kalojnë natën në kishë me besimin që Shën Marena do t’u japë shërim. Në pjesën perëndimore të kishës ndodhet një burim me ujë të kthjellët, me të cilin besimtarët lajnë fytyrën dhe mbushin shishe me ajazëm, ndërsa në pjesën juglindore të manastirit gjendet shpella e Shën Marenës. Klerikët që kanë shërbyer në kishën e Shën Marenës kanë qenë vendas nga fshati Llëngë: papa Jorgji, papa Kostandin Kokoneshi, papa Qirill Gegprifti, atë Dhimitër Kokoneshi etj. Mbrapa kishës gjenden konakët e vjetër të manastirit. Me prishjen e kishave në vitin 1967 në mjediset e manastirit u vendos një repart ushtarak dhe vite më vonë zyrat e ndërmarrjes pyjore.¹³⁶

¹³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.36, faqe 64.

¹³³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 32, faqe 62.

¹³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 33, faqe 62.

¹³⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.51, faqe 68.

¹³⁶-Gjergji Gusho, Mbi përhapjen e krishtëritimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit, Pogradec 2000, faqe 111-118.

KREU I KATËRT

MITROPOLIA E GJIROKASTRËS

Episkopata e Drinopojës e ka pasur rezidencën në qytetin e vjetër të Drinopojës, i cili gjendej ndërmjet fshatrave Goricë dhe Terihat të Dropullit të sotëm. Kisha katedrale e kësaj episkopate i ishte kushtuar “Metamorfozës së Shpëtimtarit”. Episkopi i Drinopojës, Ypati në vitin 516, ka marrë pjesë aktive në Sinodin lokal të Epirit. Rreth vitit 516 qyteti i madh i Drinopojës u shkatërrua prej sulmeve të gotëve dhe qendra episkopale kaloi në Kladianë dhe më vonë në Kardhiq. Kisha katedrale ishte ajo e “Shën Kollit”, në manastirin e Cepos. Kjo kishë u ndërtua në vitin 668 nga perandori Kostandin Pogonati. Më 1395 Gjon Yenevisi e transferoi qendrën episkopale në Gjirokastrë ku gjendet edhe sot.¹

Në korrik të vitit 1835 episkopata e Drinopojës me anën e një vendimi patriarkal u kthye në mitropoli. Në juridiksionin e kësaj mitropolie vihen edhe episkopata e Delvinës dhe ajo e Himarës. Mitropoliti i parë ka qenë Imzot Paisi, i cili mbante titullin: “Mitropolit i Drinopojës, Delvinës dhe Himarës”. Në rendin e mitropolive të Patriarkanës Ekumenike, Mitropolia e Drinopojës, Delvinës dhe Himarës radhitej e 64-ta. Më 1922 kur u shpall

¹-Dhimitër Beduli, Dioqeza e Gjirokastrës, Ngjallja, dhjetor 2006, faqe 9.

autoqefalia e K.O.A.Sh-it, kjo mitropoli zbriti në rang episkopate me titullin: “Episkopata e Drinopojës, Delvinës dhe Himarës”.² Në vitin 1937, pas dhënies së Tomusit të autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë, dy mitropolitë u bënë episkopata, kurse episkopata e tretë, ajo e Gjirokastrës u formua nga ndarja e Mitropolisë së Drinopolit. Mitropolitët e Drinopojës (Gjirokastrës) kanë qenë: Theodhosi (432), Joaniqi (432), Jakovi (432-440), Anania (440-445), Eftiki (449-451), Ipati (523-559), Ignati (559-568), Nikodhimi (568-590), Sosipatri (590-640), Kozmai (754-787), Vasili (822), Thomai (1229), Simeoni (1510-1526), Makari (1565), Jakovi (1587-1595), Neofiti (1604), Mateu (1614-1621), Kalisti (1630-1636), Gavriili (1637-1638), Sofjanoi (1672-1700), Mitrofani (1752-1760), Dositheu (1760-1799), Gavriili (1799-1827), Joakimi (1828-1835), Pais Bizantini (1835), Neofit Kekezi (1835-1841), Nikodhimos Ankris (1841-1848), Pandelejmoni (1848-1867), Grigori (1867-1899), Lukas Petridis (1899-1909), Vasil Papakristu (1909-1929), Thanas Ambrozi (1929-1937), Panteileimon Kotoko (1937-1952), Damjan Kokoneshi (1952-1966), Aleksandër Kalpakidhi (1992-1998), Kryepiskopi Anastas, me cilësinë e mbikëqyrësit të Mitropolisë së Gjirokastrës (1998-2006), Dhimitër Sinaiti 11 nëntor 2006 e në vazhdim. Mitropolia e Gjirokastrës para vitit 1967 kishte 120 enori dhe 50 manastire.

KISHAT DHE MANASTIRET

Mitropolia e Shenjtë e Gjirokastrës përbëhet prej këtyre zëvendësive episkopale vendore: Gjirokastra, Pogoni, Delvina, Saranda, Himara dhe Përmeti. Kishat dhe institucionet fetare e kësaj mitropolie sipas komunave janë:

Në Gjirokastrë: Kisha katedrale e Gjirokastrës, Mitropolia e Gjirokastrës, Kisha e “Fjetja e Hyjlindëses” në Vrahogoranzi,

²-Dhimitër Beduli, Dioqeza e Gjirokastrës, Ngjallja, janar 2007, faqe 10.

kisha e “Kryeengjëjve”, kisha e “Shën Kozmait” në Vrisera, kisha në Kakavijë.

Në Tepelenë: Kisha e “Profetit Ilia” në Lekël, kisha në Memaliaj, kisha në Tepelenë.

Në Përmet: Kisha e “Shën Parashqevisë”, kisha “Shën Nikollës”, kisha e “Shën Marisë” në Leusë, kisha e “Ungjillëzimit” në Këlcyrë.

Në Delvinë: Kisha e “Ungjillëzimit”.

Në Sarandë: Manastiri i “Shën Gjergjit” në Çukë, kisha e “Shën Vasilit”, kisha e “Ngjalljes së Krishtit” në Ksamil, kisha e “Shën Harallambit”.

Në Himarë: Kisha e “Gjithë Shenjtorëve”, manastiri i “Shën Dhimitrit” në Qeparo, kisha e “Shën Spiridonit” në Vuno.

KISHAT MONUMENT KULTURE

Gjirokastrë. Manastiri i “Shën Qirjakut dhe Julitës” në Dhuvjan, 1963, manastiri i “Shën Mërisë” në Goranxi, 1963, manastiri i “Ungjillëzimit” në Vanishtë, 1963, kisha e Manastirit të “Shpërfytyrimit” në Mingul, 1963, kisha e manastirit të “Shpërfytyrimit” në Çatistë të Pogonit, 1963, kisha e manastirit të “Shën Triadhës” në Pepel, 1963, kisha e manastirit të “Shën Ilias” në Jergucat, 1963, kisha e manastirit të “Shën Mërisë Spilesë” në Tranoshisht, 1970, kisha e manastirit të “Shën Mërisë” në Koshovicë, 1977, kisha e manastirit të “Shën Mëhillit” në Nivan, 1977, kisha e “Profet Ilias” në Stegopull, 1963, kisha e “Shën Mërisë së Drianos” në Zervat, 1963, kisha “Fjetja e Shën Mërisë” në Sopik, 1963, kisha “Fjetja e Shën Mërisë” në Zervat, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Labovën e Kryqit, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Peshkëpinë e Sipërme, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Vrahogoranxi, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Dervican, 1970, kisha e “Shën Mëhillit” në Mingul, 1963, kisha e “Shën Mëhillit” 1963, kisha e “Shën Kollit” në Dhuvjan, 1963,

kisha e “Shën Kollit” në Saraqinisht, 1963, kisha e “Shën Gjergjit” në Nokovë, 1963, kisha e “Shën Thanasit” në Poliçan, 1963, kisha e “Shën Thanasit” në Selo, 1977, kisha e “Shën e Premtes” në Selckë, 1970, kisha e “Mezhanit” në Poliçan, 1963, kisha paleokristiane e Manastirit në Nepravishtë, 1973, kisha e “Shpërfytyrimit” 1963, kisha e “Apostujve të Shenjtë” në Hoshtevë, 1977, rrënojat e kishës së “Shën Anës” në Derviçan, 1963, rrënojat e bazilikës paleokristiane në Goricë, 1977, kisha e “Shën e Premtes” në Hllomo, Kisha e “Shën Mërisë” në Skore.

Përmet. Kisha e “Shën Premtes” 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Leusë, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Seran, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Kosinë, 1963, kisha e “Shën Sotirit” në Tremishtë, 1970, kisha e “Shën Mërisë” në Bënjë, 1970, kisha e “Shën Mërisë” në Okdunan, 1970, kisha e “Shën Dëllisë” në Buhal,

Sarandë. Manastiri “Shën Gjergjit” në Demë, 1963, manastiri “Shën Mërisë” në Krorëz, 1963, manastiri “Shën Mërisë” në Kakome, 1963, rrënojat e manastirit të “40 Shenjtorëve”, 1970, kisha e manastirit të “Shën Kollit” në Mesopotam, 1948, kisha e manastirit të “Shën Kollit” në Dhivër, 1963, kisha e manastirit të “Shën Mërisë” në Mavrodhivri, Dhivër, 1963, kisha e manastirit të “Shën Thanasit” në Leshnicën e Poshtme, 1963, kisha e manastirit të “Shën Triadhës” në Kardhikaq, 1970, kisha e manastirit të “Shën Mërisë” në Kameno, 1970, kisha e manastirit të “Shën Mërisë së Krimanovës” në Piqer, 1963, kisha e “Shën Mërisë” në Melçan, 1970, kisha e “Shën Thanasit” në Pecë, 1970, kulla e manastirit “Theollogos” në Cerkovinë, 1979, kisha e “Shën Gjergjit” në Leshnicën e Sipërme, 1963, kisha e “Shën Kollit” në Dhrovjanin e Sipërm, 1970, kisha e “Shën Thanasit” në Sopik, 1963, rrënojat e kishës në Çiflik, 1977, rrënojat e kishës së Kamenicës Palavli, 1970, kisha e “Shën Janit” në Delvinë 2002.

KISHAT E MITROPOLISË SË GJIROKASTRËS

KISHA E SHËN MËHILLIT NË LAGJEN VAROSH TË GJIROKASTRËS

Kisha e “Shën Mëhillit” është ndërtuar në vitin 1777. Pas diegjes që pësoi më 1828 kisha u rindërtua në vitin 1883. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën jugore të kishës: “U ndërtua prej themeli më 1777, u dogj më 1828, u përtëri më 1833”.³ Kisha është e tipit bazilikal dhe ka përmasa 23.20x13.30 metra. Ambienti i altarit ka tri apside të nxjerra jashtë. Apsida qendrore përbëhet nga disa nike të cekta të punuara me gurë të gdhendur. Mbi to kalon një kornizë prej guri ku alternohen radhë të drejta me radhë në formë dhëmbësh sharre. Çatia e kishës është dyujëse dhe e mbuluar me rrasa guri. Muratura është me gurë shtresorë me vendosje të rregult.⁴ Mbi ikonën e Shën e Premtes gjendet mbishkrimi: “Piktor Petro kryepsalt i Mitropolisë së Janinës 1841 qershor 5”.⁵ Gjithashtu mbi ikonën e Shën Gjergjit është shkruar: “Me dorën e Nikollës dhe Mattheut, vëllait të tij. Lutje e shërbëtorit të perëndisë Dhimitër Koiza Nano, 1842”.⁶ Mbi një pllakë druri në amvonin e kishës gjendet një mbishkrim, i cili tregon mjeshtrin dhe kohën e gdhendjes së amvonit: “Ktitori i amvonit, zoti Mitro Fandi, 1842”.⁷

³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 606, faqe 247.

⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 152-153.

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 713, faqe 273.

⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 715, faqe 273.

⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 716, faqe 273.

KISHA E SHËN SOTIRIT NË LAGJEN PAZAR I VJETËR TË GJIROKASTRËS

Kisha e “Shën Sotirit” është ndërtuar në vitin 1784. Kisha është e tipit bazilikë trinefëshe dhe ka përmasa të brendshme 15.75x12.10 metra. Kisha përbëhet nga naosi, altari dhe narteksti. Ambienti i altarit ndahet me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Kisha ka tri apsida, të cilat janë zbukuruar me nike dhe përfundojnë me korniza guri të vendosura në formë dhëmbësh sharre, të alternuara me radhë të drejta. Çatia e kishës është me rrasa guri. Muratura është me gurë shtresorë të vendosur me detaje të shumta gurësh të gdhendur.⁸

Mbi një pllakë bronxi të vendosur mbi faqen e murit perëndimor të kishës gjendet mbishkrimi: “O vështues, këto dy kisha, të Pandokratorit dhe e Taksiarkëve u ndërtuan me mirëdashjen e perëndisë që nga themeli dhe në mënyrë madhështore sikurse i shikon, me shpenzimet e përbashkëta të krishterëve të këtij qyteti, Gjirokastrë, në kohën e shumë perëndidashësit peshkopit, zotit Dositheut, viti shpëtimtar – 1776, në muajin qershor 1”.⁹

Ikonostasi i kishës dhe është hijerëndë, i zbukuruar me motive të florës dhe të faunës. Mbi tri ikonat e mëdha atë të Krishtit, të Shën Mërisë dhe të Kryeengjëjve në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Dora e Jan Athanas Kapesovitit”.¹⁰ Mbi një ikonë të Shën Gjergjit të Janinës është shkruar: “Me dorën e Mattheut Dh. nga Samarina 1864, mars 12”.¹¹

⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 123-126.

⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 606, faqe 246.

¹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.774, faqe 285.

¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.739, faqe 278.

KISHA E KRYEENGJËJVE NË GJIROKASTËR

Kisha e “Kryeengjëjve” gjendet në lagjen “18 shtatori” të Gjirokastrës. Në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “U përtëri ikonostasi me shpenzimet e zotit Jorgaq Anastasit nga Gjirokastra”, ndërsa në ikonën e Shën Mërisë në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “1833 dhe i përjetshëm kujtimi, zonja Zoica dhe Vasiliqi e Paraskevës, nga Gjjirokastra”.¹²

Mbi kapakët prej argjendi të ungjillit të kishës gjendet mbishkrimi: “I është dhuruar kishës së Kryeengjëjve në Gjirokastrë, nga vëllezërit Gjergji dhe Pano të Anastasit 1813 maj”.¹³

KISHA E SHËN MËRISË NË LABOVËN E KRYQIT


Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në mesin e fshatit Labovë. Kisha i është kushtuar “Lindjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 8 shtator. Sipas një mbishkrimi që gjendet rreth pjesës së poshtme të timbanit të kubesë kisha është ndërtuar në vitin 551. Kisha është e tipit në formë kryqi me një kube cilindrike. Nga ana e jashtme është e zbukuruar me dekoracione tullash. Ktitor i kishës është perandori bizantin Justiniani I. Këtë e vërteton mbishkrimi rreth pjesës së poshtme të timbanit të kubesë: “Ky tempull i gjithnderuar dhe hyjnor i së mbishenjtës Hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari u ndërtua (në) vitin 551 me shpenzimet e Justinianit, mbretit të madh dhe (u meremetua) me kontributin e epítrop Kostandinit të këtij katundi, Labovë (në vitin) 1806, mars”.¹⁴

¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 709, faqe 271-272.

¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 682, faqe 266.

¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 518, faqe 219.

Në qendër të kupolës së kishës është pikturuar “Pandokratori” dhe poshtë tij scena me “Liturgjinë e engjëjve”. Në harkadën perëndimore përballë me ikonostasin gjendet scena “Deisis”, e cila daton në shek. XII. Në harqet e brendshme të harkadave gjenden skenat: “Zbritja nga Kryqi”, “Krishti para Pilatit”, “Fjetja e Hyjlindëses”, “Vënia e kurorës me gjemba” etj. Të gjitha skenat e sipërpërmendura janë të dëmtuara nga lagështira dhe datojnë në shek. XIII. Në qendër të harkadës veriore gjendet scena e “Trinisë së Shenjtë”, ndërsa në apsidën e kishës gjendet “Platitera”, e cila paraqitet me krahët e hapura dhe Krishin në prehër.¹⁵



Kisha e “Shën Mërisë” në Labovën e Kryqit është meremetuar disa herë. Një restaurim asaj i është bërë në vitin 1776 nga papa Zoto. Apsida qendrore dhe ato anësore të kishës janë rrënuar dhe janë rindërtuar në vitin 1776. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet i gdhendur në mesin e apsidës jashtë kishës: “Jezu Krishti fiton, viti 1776, papa Zoto”.¹⁶

¹⁵-Gazmend Muka, Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, Albas, Tiranë 2013, faqe 74-75.

¹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.604, faqe 246.

Mjedisi i altarit ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Në qendër të ikonostasit madhështor gjenden dyert e bukura dhe sipër tyre është gdhendur një shqiponjë dykrenore. Mbi dyert e bukura të ikonostasit gjendet skena “Darka mistike”. Ikonat e mëdha të ikonostasit janë: ikona e “Krishtit”, e “Shën Mërisë”, “Joan Pagëzori”, “Lindja e Hyjlindëses”, “Tre hierarkët”, “Shën Parashqevia”, “Shën Kolli” etj. Në pjesën e sipërme të ikonostasit gjenden 12 ikonat e vogla: “Pagëzimi”, “Krishtlindja”, “Mandili i shënjtë”, “Hyrja e Krishtit në Tempull”, “Hyrja e Hyjlindëses në tempull”, “Lindja e Hyjlindëses”, “Trinia e Shenjtë”, “Ngjallja e Llazarit”, “Shërimi i të verbërit”, “Shpërfytyrimi”, “Pendikostia” dhe “Kryqi i Shenjtë”. Ikona e fundit tregon si u gjet kryqi ku u kryqëzua Krishti prej Elenës, nënës së Kostandinit të Madh. Kjo ikonë është vendosur jashtë programit standard ikonografik të paraqitjes së festave kryesore. Vendosja e ikonës ka për qëllim të kujtojë se në këtë kishë ekziston një pjesë nga Kryqi i Shënjtë, mbi të cilin është kryqëzuar Krishti. Ikonat e vogla të ikonostasit datojnë në shek. XIX, por fatkeqësisht janë grabitur menjëherë pas restaurimit në vitin 2002. Në këtë kishë gjendet një ikonë e “Krishtit Pandokrator”, anash së cilës paraqiten 12 skena që paraqesin udhën e kryqit: “Në malin e ulla”, “Vizioni i Abrahamit”, “Larja e këmbëve”, “Puthja e Judës”, “Krishti përpara Kajafës”, “Krishti para Pilatit”, “Larja e duarve të Pilatit”, “Vendosja e kurorës me gjemba”, “Etja e Krishtit”, “Mbajtja e kryqit”, “Kryqëzimi” dhe “Zbritja nga kryqi”.¹⁷

Ikonostasi i gdhendur në dru, me harlisjen e tij të krijon përshtypjen e një pjergulle. Në të janë skalitur pjergulla dhe bistakë rrushit dhe zogjtë që çukisin mbi to. Ikonostasi është gdhendur prej Kostë Tunit nga Meçova në vitin 1805. Meçova është një fshat vllahësh afër Janinës. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim i gdhendur në dru mbi portën jugore të ikonostasit: “Viti 1805 gusht

¹⁷-Gazmend Muka, Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, Albas, Tiranë 2013, faqe 99-103.

26 në kohën e epitripot Kristo Papaqirisit me dorën e Kostë Tunit Meçovitit”.¹⁸

Në kishën e “Shën Mërisë” në Labovën e Kryqit gjendet një copëz druri nga kryqi i Krishtit, e cila është sjellë në vitin 559 prej Kostandinit nga Labova, i cili ishte bashkëpunëtor i ngushtë i perandorit Justinian. Copëza prej kryqit të shenjtë peshonte rreth 152 gramë dhe ishte vendosur brenda një kutie druri të punuar hollë dhe të dy anët mbylleshin me tetë kapëse prej argjendi. Kryqi i Labovës përfaqëson një relikuar të shenjtë, që mban brenda tij kutinë me një copëz të kryqit të kryqëzimit të Krishtit. Ai është punuar me argjend dhe në të dy anët paraqet skena ikonografike të gdhendura. Në njerën anë paraqitet skena e “Pagëzimit”, ndërsa në anën tjetër skena e “Kryqëzimit”. Në katër anët e kësaj skene janë punuar me mjeshtëri imazhet simbolike të katër ungjillorëve. Sipër kryqit paraqitet ungjillor Joani, nëpërmjet figurës së shqiponjës. Djathtas paraqitet ungjillor Marku, nëpërmjet figurës së luanit, ndërsa majtas ungjillor Matheu, me simbolin e njeriut. Figura e fundit është ajo e ungjillor Llukës, e cila paraqitet me simbolikën e kaut. Fatkeqësisht në vitin 1989 kryqi është grabitur nga persona të cilët dëshironin të fshinin nga memorija historike kishën në të cilën gjendej copëza prej kryqit të shenjtë mbi të cilin u kryqëzua Krishti.¹⁹

Tamburi i kishës përbëhet nga dy breza të zbukuruar. Në brezin e poshtëm gjenden katër dritare që këmbehen me katër nike, të cilat janë me dy radhë tullash të shkallëzuara. Brezi i sipërm i tamburit përbëhet nga breza tullash të vendosura në formë zigzake. Mbi të gjendet një kornizë e dyfishtë tullash të vendosur në formë dhëmbësharre. Sipas prof. Aleksandër Meksit e parë në aspektin e vlerave arkitektonike kisha është monument i arrirë.

¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 666, faqe 262.

¹⁹-Gazmend Muka, Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, Albas, Tiranë 2013, faqe 106-116.

Duke gjykuar në tërësi vlerat arkitekturore të këtij monumenti, si ato të brendësisë dhe të anës së jashtme kisha bart vlera arkitektonike të dorës së parë.²⁰

KISHA SHËN KOLLIT NË SARAQINISHT TË LUNXHËRISË

Kisha “Shën Kollit” gjendet në Saraqinisht të Lunxhërisë. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe eksonartekxi. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 8.0x6.8 metra. Kisha është e ndërtuar me gurë shtufi. Tamburi është tetëfaqësh dhe i suvatuar. Kisha është ndërtuar në vitin 1630 dhe është pikturuar prej Mihal Linotopit me të birin Kostandinin dhe nxënësin e tij Nikollën. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës: “U ndërtua që nga themeli dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i atit tonë ndër shenjtorë, Nikollës çudibërësit me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e priftërinjve të shumënderuar dhe pleqve të Saraqinishtës, për shpëtimin e shpirtit, në kohën e peshkopimit të shumë perëndidashësit, peshkopit të Drinopojës, zotit Kalist, me dorën e Mihal Zografit me të birin e tij Kostandinin dhe Nikollën – katundi Linotopi në vitin 7138 (=1630)”.²¹

Me interes në këtë kishë është cikli i afreskeve që i kushtohen Shën Kollit, emrin e të cilit mban kisha. Afresku i Shën Kollit gjendet në murin jugor afër ikonostasit. Shën Kolli paraqitet si kryeprift i moshuar dhe qëndron në fron madhështor duke bekuar me dorën e djathtë dhe duke mbajtur një ungjill në dorën e majtë.

²⁰-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 233-235.

²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.556, faqe 232-233.

Pas shpinës së tij, majtas paraqitet Krishti, ndërsa djathtas Hyjlindësja, e cila po i ofron omoforin.²²

Cikli ikonografik paraqet skena nga jeta e shenjtit, të cilat janë realizuar nga ngjarjet që na jep sinaksari i tij. Tematika e afreskeve është nga ngjarjet e jetës së shenjtit të shkruar prej Simeon Metafrastit në mineon e Dhjetorit. Afresket e ciklit të Shën Kollit janë: “Lindja e shenjtit”, “Jeta e tij në fëmijëri”, “Betimi i priftërisë”, “Skenat e mrekullive”, “Burgosja”, “Pjesëmarrja në Sinodin I Ekumenik” dhe “Fjetja e shenjtit”.

1-Në skenën e parë paraqitet “Lindja e shenjtit”. Nëna e tij gjendet e shtrirë në shtrat dhe për të kujdesen pesë shërbëtores. Majtas saj gjendet banja, ndërsa djathtas gjendet shenjt i mbi një shkallë të drunjte. Ky afresk titullohet: “Lindja e Shën Nikollës”.

2-Skena e dytë paraqet një tryezë të madhe, në të cilën janë ulur tre fëmijë me libra të hapur. Mësuesi që gjendet i ulur mbi një fron mirëpret me dorë të hapur ardhjen e Nikollës në shkollë. Skena titullohet: “Shën Nikolla shkon tek mësuesi”.

3-Në skenën e tretë shenjt i paraqitet në momentin e dorëzimit dhjak, prift dhe episkop. Shenjt i paraqitet në mesin e afreskut duke u përkulur përpara episkopit që do ta dorëzojë atë në dhjak. Nikolla ka veshur stiharin dhe shoqërohet nga tre dhiakë të tjerë. Mbishkrimi thotë: “Shën Nikolla dorëzohet dhiak”.

4-Në skenën e katërt shenjt i paraqitet në moshë më të madhe dhe ka veshur stiharin, petrahilin dhe fellonin. Këto veshje klerikale i përkasin priftit. Shenjt i mer ungjillin prej episkopit që e dorëzon në gradën priftërore. Afresku titullohet: “Shën Nikolla dorëzohet prift”.

5-Skena e pestë paraqet dorëzimin e shenjtit ne episkop. Ai paraqitet i përkulur duke marrë bekimin nga episkopi që e dorëzon. Mbishkrimi na bën me dije: “Shën Nikolla dorëzohet episkop”.

²²-Omofori simbolizon lëkurën e deles së humbur, të cilën Krishti e gjeti dhe e solli përsëri në tufë. Omofori kujton episkopin që të kërkojë delet e humbura dhe t'i bashkojë me grigjën e kishës.

6-Skena e gjashtë paraqet disa mrekulli të shenjtit. Ai paraqitet fillimisht duke iu gjendur një babai të varfër. Në momentin që është duke fjetur shenjt i vendos atij një qese me flori për të bërë pajën e vajzave. Në episodin e dytë tri vajzat paraqiten duke fjetur, ndërsa babai vështron nga shenjt, i cili po i hedh qesen e tretë me flori. Babai paraqitet duke e falënderuar shenjtin. Afresku titullohet: “Shën Nikolla i hedh flori babait të farfër”.



7-Në skenën e shtatë shenjt paraqitet duke shpëtuar një anije, e cila ishte duke udhëtuar drejt Jeruzalemit. Në këtë skenë paraqitet një anije me vela dhe njerëz të shumtë që vozitnin. Shenjt paraqitet duke u lutur në mes tyre, ndërsa djalli është pikturuar duke prerë litarët e velave të anijes. Mbishkrimi na bën me dije: “Shën Nikolla duke shkuar në Jeruzalem”.

8-Skena e tetë e paraqet shenjtin hipur mbi një anije me vela duke u kthyer në vendin e tij. Vështrimi i shenjtit është nga qielli në pozicion lutjeje. Në skenë paraqiten katër detarë, të cilët nuk e kishin mbajtur fjalën për ta shpënë shenjtin në vendin e kërkuar dhe tashmë janë penduar. Në anët e afreskut paraqiten dy qytete. Shenjti zbriti në Patara prandaj afresku titullohet: “Shën Nikolla u kthye në Patara”.

9-Në skenat që pasojnë shenjti tashmë është episkop në qytetin e Mirës së Likisë. Shenjti paraqitet në burg. Dy ushtarë i rrinë anash, kurse shenjti paraqitet në bust pas një dritareje të vogël. Afresku titullohet: “Shën Nikolla në burg”.

10-Në skenën e dhjetë shenjti paraqitet duke shkatërruar tempullin e Artemisë. Në njerën skenë shenjti paraqitet duke prerë drurin e djajve, ndërsa në skenën tjetër ai lutet përballë tempullit. Mbishkrimi thotë: “Shën Nikolla shkatërron tempujt e idhujve”.

11-Në skenën e njëmbëdhjetë shenjti gjendet në Sinodin I Ekumenik. Ai paraqitet duke debatuar me heretikun Arios. Shën Nikolla është i rreptë dhe qortues. Heretiku Arios paraqitet me duart e shtrira përpara. Më pas shenjti e godet me shuplakë Ariosin dhe përfundon në burg. Pranë tij gjendet Krishti, i cili i zgjat ungjillin dhe Hyj lindësja i ofron omoforin. Afresku titullohet: “Shën Nikolla godet Ariosin”.

12-Në skenën e dymbëdhjetë paraqitet një akt bamirësie i Shën Nikollës. Ai shpëton qytetin e Mirës nga zia e bukës që kishte rënë në atë kohë. Shenjti paraqitet duke i ofruar tri monedha të argjendta tregtarit të anijes që ta çojë grurin në Mira të Likisë. Afresku ka mbishkrimin: “Shën Nikolla i ofron monedhat kapitenit të anijes”.

13-Skena e trembëdhjetë bën fjalë për tre të burgosur të pafajshëm, të cilët kanë ulur kokat para xhelatit. Shenjti i shpëton ata. Nga qoshja e afreskut paraqitet Shën Nikolla me një shpatë dhe xhelati duke e parë i habitur. Mbishkrimi thotë: “Shën Nikolla çliroi tre të dënuarit”.

14-Në skenën e katërbëdhjetë paraqitet lirimi i tre gjeneralëve. Kjo skenë ka lidhje me atë që përshkruhet më sipër. Tre gjeneralët paraqiten duke qëndruar në burg, ndërsa shenjti duke shkuar tek perandori Kostandin për ti kërkuar lirin e tyre.

15-Skena e pesëmbëdhjetë paraqet fjetjen e shenjtit. Në qendër të afreskut paraqitet Shën Nikolla në shtratin e vdekjes dhe rreth tij qëndrojnë shumë episkopë, priftërinj, murgjër etj. Shenjti paraqitet me veshjet e shenjta.

16-Në skenën e gjashtëmbëdhjetë përshkruhet një mrekulli, e cila ka ngjarë pas fjetjes së shenjtit. Skena paraqet një anije të mbushur me njerëz, e cila duke lundruar është përfshirë nga flakët. Fatmirësisht ndodh mrekullia dhe anija shpëton. Cikli ikonografik me skena nga jeta e shenjtit ka zëvendësuar ciklin e Himnit Akathist. Kjo është bërë për të nderuar Shën Nikollën, emrin e të cilit mban kisha.²³ Mbi portën e narteksit të kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, prift Efstathit bashkë me bashkëshorten e tij Mile dhe të birin e tij, priftin Bir me bashkëshorten e tij Aleksandrën dhe të bijtë e tij. Amin. Në vitin 1625, muaj shtator 7”.²⁴ Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1630 dhe ikonat janë punuar prej Mihalit dhe Kostandinit nga Linotopi. Ky ikonostas përmban motive të farkëtuara, motive në relief dhe motive të praruara. Në ikonën e Pagëzorit është shënuar viti 1638. Në ikonën e Shën Mërisë dhe në ikonën e Joan Pagëzorit gjendet mbishkrimi: “Lutje e Zisit të Naqes”.²⁵ Ndërsa në ikonën e Shën Kollit është shkruar: “Lutje e Stefanit të Naqes”.²⁶

²³-Maria Skavara, Cikli ikonografik i jetës së Shën Kollit në Saraqinishtë të Lunxhërisë, 2000 vjet art dhe kulturë në Shqipëri, Tiranë 2003, fq 235-239.

²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.551, faqe 231.

²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 794, 795, faqe 290.

²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.796, faqe 290.

Kryqi sipër ikonostasit ruhet në gjendje të mirë. Bie në sy motivi me shqiponjën me dy krerë që gjendet në njerin prej parapetëve të ikonostasit.²⁷

KISHA SHËN MËHILLIT NË MINGUL TË LUNXHËRISË

Kisha e “Shën Mëhillit” gjendet në Mingul të Lunxhërisë. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është bazilikë me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 8.20x7.80 metra. Ambienti i altarit ndahet prej një ikonastasi druri të gdhendur. Dyshemeja e kishës është e shtruar me pllaka guri të bardhë. Muratura është ndërtuar me gurë shtufi, të vendosur në mënyrë të çrregullt. Tamburi është cilindrik dhe i suvatuar. Muret e kishës janë të zhveshur nga punimet dekorative.²⁸

Mbi faqen e murit verior të kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua dhe u stolis ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i Taksiarlëve të gjithmëdhenj Mikaelit dhe Gabrielit me kontributin e zotit Andrio Sevi, në kohën e peshkopatit të shumë perëndidashësit të Drinopojës, zotit Lositheut nga Mecova, dora e K..”²⁹ Ikonat e ikonostasit të kishës janë pikturuar prej një piktori anonim në vitin 1788. Ky fakt vërtetohet prej një mbishkrimi që gjendet në ikonën e Apostujve në ikonostasin e kishës: “Në vitin 1788..”³⁰

²⁷-Triantafillos Siulis, Ikonostaset e gdhendura në dru në kishat dhe kishëzat e krahinave jugore të kishës ortodokse, botuar në 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 309.


²⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 147-148.

²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 780, faqe 286.

³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 624, faqe 253.

KISHA E SHËN GJERGJIT NË LESHNICËN E SIPËRME

Kisha e “Shën Gjergjit” gjendet në Leshnicën e Sipërme të Sarandës. Hyrja për në kishë bëhet në anën perëndimore. Kisha është e mbuluar me çati prej druri pa tavan, ndërsa dysHEMEJA është e shtruar me plloça guri. Çatia është e mbuluar me rrasa guri. Ambienti i altarit ndahet nga një ikonostas prej druri. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Kisha e “Shën Gjergjit” është ndërtuar në një terren të pjerrët. Pamja e jashtme e kishës është e varfër dhe e zhveshur nga punimet dekorative.³¹




Kisha e “Shën Gjergjit” në Leshnicën e Sipërme është një paraklis me përmasa 9.75x5.85 metra dhe është pikturuar në vitin 1525 prej ikonografit Ilia Longoviti nga fshati Longo i Dropullit të Sipërm. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim mbi portën perëndimore të kishës: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i dëshmorit të madh Shën Gjergjit bukurmundës dhe çudibërës, me kontributin, përpjekjen dhe shpenzimet e ktitorëve

³¹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 156-157.

të manastirit të përmendur dhe të bashkëshortëve dhe të bijve të tyre at Gjergjit dhe at Nikollës, Janit, Gjergjit dhe Dhimitrit të Papadhateve, në vitin 7 mijë e 33 (=1525)".³²

KISHA E SHËN MËRISË NË VLLAHOGORANXI

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Vllahogoranxi. Kisha është e tipit bazilikë me kupolë me përmasa 7.50x6.80 metra dhe përbëhet nga naosi dhe narteksti. Naosi lidhet me nartekstin në anën perëndimore. Kisha është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Nëpër qoshet e mureve gjenden blloqe gurësh të mëdhenj. Mbi portën perëndimore të kishës gjenden dekoracione antike. Tamburi i kishës përbëhet nga disa nike të shkallëzuara dhe të harkuara në pjesën e poshtme. Fushat e nikeve janë zbukuruar me dekoracione me tulla. Gjithashtu në pjesën e sipërme të tamburit gjendet një kornizë tullash në formë sharre.



³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 803, faqe 293-294.

Kulla e kambanerisë gjendet në anën jugperëndimore të kishës. Kambaneria është ndërtuar në vitin 1874.³³ Altari i kishës ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi druri të gdhendur. Kisha e “Shën Mërisë” në Vllahogoranxi është pikturuar në vitin 1622 nga Onufër Qiprioti dhe Alivizi. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi faqen e murit jugor të kishës. Mbishkrimi është i dëmtuar nga rënia e suvasë. “U pikturua....i Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës....zotit.....të këtij manastiri....me mundimet dhe shpenzimet eOnufët Qipriotit dhe Aliviziu...1622”.³⁴

Sipas Dhorka Dhamos afresket e pikturuar nga Onufër Qiprioti në kishën e “Shën Mërisë” në Vllahogoranxi janë në ekuilibër. Ka një marrëveshje të heshtur në mes të afreskeve me njolla të plota të kuqe, të verdha, të gjelbëra, okër dhe të kaltra dhe botës së brendshme të figurave pa shpërthime dramatike si ato të mësuesit të tij Onufrit.³⁵

KISHA E SHËN MITRIT NË POLIÇAN TË POGONIT

Kisha e “Shën Mitrit” gjendet në fshatin Poliçan të Pogonit. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi në anën perëndimore. Naosi ka përmasa të brendshme 4.60x2.60 dhe është i mbuluar me çati druri pa tavan. Apsida e kishës është në formë gjysmërrethore. Muratura është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Çatia e kishës është dyujëse dhe është e mbuluar me rrasa guri.³⁶

³³-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 123-126.

³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 547, faqe 229.

³⁵-Dhorka Dhamo, Piktura murale e mesjetës në Shqipëri, Tiranë 1974, faqe 15-16.

³⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 97-98

Mbi portën perëndimore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili na bën me dije se kisha është rindërtuar dhe pikturuar në vitin 1526: “U përtëri dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i dëshmorit të madh të shën Mitrit Morovlit, me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e at Qiriakut dhe të vëllait të tij Gjeorgopullit dhe të Gjergjit të Papa Vasilit dhe Gjergjit të Logothesit, dhe në kohën e peshkopatit të peshkopit të Dhrinopojës, shumë perëndidashës, zotit Simeon, në vitin 7034 (=1526) cikli i diellit 14, prill 20”.³⁷



Në kishën e “Shën Mitrit” pikturat murale ruhen në gjendje të mirë. Mbi mbishkrimin gjenden dy skena “Fjetja e Shën Mërisë” dhe “Hyrja e Krishtit në Jeruzalem”, e cila është dëmtuar. Në murin

³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 522, faqe 220-221.

verior kemi skenat “Kryqëzimi i Krishtit”, “Zbritja e Krishtit nga Kryqi”, “Guri i varrit” dhe “Ngjallja e Krishtit”. Në apsidën e altarit paraqitet skena e “Shestjes”, ndërsa në murin e anës jugore duke filluar nga hyrja e kishës paraqiten skena e “Shpërfytyrimit të Krishtit”, “Ipapandia” dhe “Lindja e Krishtit”. Nën skenën e “Ipapandisë” gjendet “Deisis”, ndërsa nën skenën e “Lindjes së Krishtit” paraqiten Shën Spiridhoni dhe Shën Elefteri.³⁸

Në anën e jashtme të derës së kishës së Shën Mitrit është shkruar: “Mbështetja e atyre që shpresojnë tek ty, forco o zot kishës që e ndërtove me gjakun tënd të çmuar viti 7046 (=1538) “. ³⁹ Në këtë kishë janë pikturuar rreth 32 afreske. Përsa i përket vendosjes së tyre i paraqet në mbrojtjen e temës së doktoraturës Jorgos Jakumis: “Analipsi”, “Shën Lefteri”, “Nëna e Perëndisë”, “Krishti në fron”, “Joan Pararendësi”, “Kryeengjëlli Mihail”, “Shën Kostandini”, “Shën Elena”, “Shën Varvara”, “Shën Gjergji”, “Shën Dhimitri”, “Zbritja në had”, “Kryqëzimi”, “Fjetja e Hyjlindëses”, “Emanueli”, “Ngjallja e Llazarit”, “Shpërfytyrimi”, “Shën Nikita”, “Ipapandia”, “Lindja e Krishtit” etj.⁴⁰

KISHA E SHËN THANASIT TË MAZHARIT NË POGON

Kisha e “Shën Thanasit” është e tipit bazilikë me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 6.40x3.90 metra. Kisha është ndërtuar në vitin 1513. Kjo vërtetohet me anën e një mbishkrimi që gjendet mbi portën e kishës: “...ky tempull i Athanasit të madh

³⁸-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 8-9.

³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 523, faqe 221.

⁴⁰-Jorgos Jakumis, Dhio proima metavizantina mnimia kai o zografikos tous dhiakosmoa, Ionanina 2003-4, selidha 36-37.

në vitin 1513 m..”⁴¹ Muratura e kishës është ndërtuar prej guri të bardhë të lidhur me llaç rëre dhe gëlqere. Muret e jashtme janë të zhveshur nga elementët dekorativë, ndërsa muret e brendshme janë pikturuar me afreske, të cilat janë sipas preferencës së ikonografit dhe pa sistem. Në murin e anës së majtë që ndan altarin gjendet skena “Deisis”. Brenda në altar nga e majta paraqiten ungjillor Matheu, ndërsa nga e djathta paraqitet ungjillor Joani. Në apsidë gjendet “Platitera” dhe nën të një mbishkrim që nuk dallohet mirë. Në murin nga ana veriore gjenden Shën Kostandini dhe Elena, Shën Marena, Shën Teodor Tironi dhe Shën Gjergji. Të gjithë këta shenjtorë paraqiten më këmbë. Sipër tyre gjendet skena “Zbritja e Krishtit nga Kryqi”. Në murin perëndimor paraqiten Shën Kolli, Shën e Premtja, Shën Anastasi dhe Shën Varvara. Në kubenë e kishës gjendet “Pandokratori”. Nëpër harqet dhe shtyllat paraqiten shenjtorë në medalione, ndër të cilët dallohet Shën Zotikos, Shën Androniku, Shën Qirjako etj. Afresket e kësaj kisha janë punuar mirë dhe kanë vlera artistike.⁴²



⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 521, faqe 220.

⁴²-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 7.

Në këtë kishë janë pikturuar rreth 100 afreske, të cilat i paraqet në mbrojtjen e temës së doktoraturës Jorgos Jakumis: “Platitera”, “Joan Gojarti”, “Vasili i Madh”, “Grigori i Nisës”, “Pararendësi”, “Shën Dhimitri”, “Shën Varvara”, “Anastasia Farmakolitaria”, “Shën Parashqevia”, “Shën Kirili”, “Kostandini dhe Elena”, “Shën Marina”, “Teodor Tironi”, “Shën Gjergji”, “Shën Stefani”, “Joan Përdëllimtari”, “Analipsi”, “Ipapandia”, “Lindja”, “Shën Kozmai”, “Fjetja e Hyjlindëses”, “Shën Damiani”, “Zbritja në had”, “Petro i Aleksandrisë”, “Shën Oresti”, “Shën Afksenti”, “Shën Arseni”, “Shën Julita”, “Shën Niqifori”, “Shën Porfiri”, “Shën Androniku”, “Shën Kiriku”, “Shën Trifoni”, “Shën Evdhoqimi”, “Shën Zotiku”, “Joan Damaskini”, “Shën Fotini”, “Shën Nikita”, “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, “Pagëzimi”, “Shpërfytyrimi”, “Kryqëzimi”, “Ungjillori Lluka”, “Shamia e Shenjtë”, “Ungjillor Mateu”, “Ungjillor Joani”, “Ungjillor Marku”, “Profetët Jona dhe Isaia”, “Profetët Abakum dhe Samuil”, “Pandokratori”, “Shën Vlashi”, “Shën Theodhosi”, “Profeti Sofronia” etj.⁴³

KISHA FJETJA E SHËN MËRISË NË SOPIK TË POGONIT

Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” është kisha kryesore e fshatit Sopik të Pogonit. Kisha është bazilikë e ndërtuar me mur të gurtë të lidhur me llaç dhe gëlqereje. Çatia e kishës është e mbuluar me plloça guri. Kisha ka përmasat 33x13 metra dhe përbëhet nga narteksi, naosi dhe altari. Kisha e “Fjetja e Shën Mërisë” së Pogonit është pikturuar rreth viteve 1920-1921 nga ikonografi Theodhos Jusi nga Hllomoja. Në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” së Pogonit gjendet një mbishkrim, i cili bën fjalë se suvatimi i kishës është bërë me shpenzimet e tre priftërinje, që u vranë nga Ali Toska në

⁴³-Jorgos Jakumis, Dhio proima metavizantina mnimia kai o zografikos tous dhiakosmoa, Ionanina 2003-4, selidha 76-77.

Kakollako në vitin 1778: “Filloi të suvatohet kjo kishë e mrekullueshme më 11 janar. U përfundua më 4 maj me kontributin e priftërinjve të shumënderuar Papa Kostandinit, Papa Panajotit dhe Papa Janit, të cilët i vrau Ali Toska, në Kakollako, maj 14, 1778”. Ky mbishkrim gjendet i pikturuar mbi portën jugore të kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në Sopik të Pogonit. Sipas gojëdhënës të tre priftërinjtë u vranë nga Ali Toska për shkak se kishin strehuar në kishë Ali pashë Tepelenën dhe e kanë shpëtuar duke e nxjerrë jashtë rrethimit, brenda një voze.⁴⁴

Sipas Dhimitër Bedulit këtë fakt e përmend edhe Aravatinoi në librin e tij “Historia e Ali pashë Tepelenës” në faqen 22-23. Aravatinoi pohon se Ali pashë Tepelena gjendej i rrethuar prej ushtrisë së Ahmet Kurt Pashës dhe ka shpëtuar në sajë të ndihmës që i ofroi Papa Jani nga Sopiku. Vetëm se Dhimitër Beduli thotë se tre priftërinjtë u vranë më 14 maj të vitit 1779, madje populli u ka ngritur një këngë, e cila këndohet dhe kërcëhet në çdo festë të fshatit. Ali pasha u premtoi sopiqtëve se do tu ndërtonte një kishë me një ikonostas madhështor për nder të tre priftërinjve të vararë. Ikonostasi i kishës është i gdhendur në dru arre dhe është punuar me shumë mjeshtëri nga Nikolla Dibrani nga fshati Megarova i Manastirit. Ikonostasi ka gjatësi 13 metra dhe është i stolisur me kombinime të bukura. Çdo shtyllë e ikonostasit fillon me një vazo, prej së cilës del një degë hardhie. Mbi degët e gdhendura gjenden zogj dhe pëllumba duke çukitur degët dhe me kokrra rrushi në gojë. Nën kryqin e drunjtë mbi ikonostas gjenden dy dragonj. Në vijim gjendet skena Darka Mistike. Mbi derën e bukur dy engjëj mbajnë mitrën episkopale, ndërsa dy engjëj të tjerë shikojnë me gëzim. Ikonostasi përfundoi në vitin 1832.⁴⁵

⁴⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 597, faqe 244.

⁴⁵-Fatbardha Shkupi, Mjeshtër shqiptarë, dekoratorë që kanë opunuar në Bullgari, Maqedoni dhe në Shqipëri, Monumentet 2002, faqe 91.

Mbi fronin peshkopal të kishës është shkruar viti 1832, i cili tregon kohën e gdhendjes së fronit peshkopal dhe të ikonostasit të kishës”.⁴⁶ Mbi ikonën e Kryeengjëjve në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me kontributin e zotërinjve, vëllezërve Anagnosti Papa Dhimitrit, Gjergjit të dikurshëm, Apostolit, Dhimitrit, Panajotit, Ljaliut, Dhimitrit, Papa Kostës, eksarkut Spiridhonit dhe Saqellarit Apostol, Primiqirit Panajotit, Saqellar Theodorit të Janit, 1836 mars 11 Prevezë. Dora e Spiridhonit, prift Gavz, dhmt Vel”.⁴⁷

Gjithashtu edhe ikonat e tjera të mëdha të ikonostasit janë punuar në vitin 1836 ne Prevezë të Greqisë prej një piktori anonim. Bën përjashtim vetëm një ikonë çudibërëse e Shën Mërisë, e cila ka një histori interesante. Sipas gojëdhënës një njeri nga Sopiku duke kullotur bagëtitë humbi pelën në pyllin në afërsi ku gjendet sot kisha. Kur u kthye vitin tjetër e gjeti pelën së bashku me mëzin e saj duke kullotur dhe pranë saj një ikonë e Shën Mërisë. Atëherë në atë vend u ngrit një shtyllë prej guri me kamare dhe u vendos ikona. Një ditë tek po kalonte në atë vend Ali pashë Tepelena vuri re sikur Shën Mëria e ndiqte me sy ngado që shkonte. Atëherë pyeti shoqëruesin e tij Jani Konomin: “Përse, or bir, më shikon kështu kjo zonjë e juaj? Jani i tha: Diçka kërkon nga ty. Dhe Ali pashë Tepelena pyeti: Çfarë kërkon nga unë? Jani iu përgjigj: Kërkon ti bësh shtëpinë sepse është pa shtëpi. Ali pashë Tepelena urdhëroi që menjëherë të ndërtohej kisha. Ikona çudibërëse sipër veshjes me argjend ka një mbishkrim “Me kujdesin e zotit Anagnost Ikonomit Papa Janit 1836”.⁴⁸ Gjithashtu mbi mbulesën prej argjendi të ikonës është shkruar: “U përfundua ikona me shpenzimet e kishës

⁴⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 708, faqe 271.

⁴⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 712, faqe 272.

⁴⁸-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 21-22.

që ka kujtimin e Fjetjes së Hyjlindëses në katundin Sopik, Vaso Papadhimo. U pikturua ikona e shënjtë e së mbishenjtës zonjës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonë Virgjëreshës Mari, në ditët e ekonomit të quajtur me emrin Papa Jan, përgjegjës i vilajetit, dhe të tjerëv ekrerë të vendit, Jorgji Konomit, Anagnost ikonomit, Kalinik murgut, kujdestarit të kishës Papa Kristos, ekonom Papa Kristos, Gjinos, Gjorgj Thimi Ekzarkut, bir i Papa Kostë Kriskit, Cara danitëve vëllezërve Kristo e Vasil viti 1808, Papa Kristo rrëfenjësi, murgesha Krisanthi”.⁴⁹ Mbi një kandil të madh prej argjendi është shkruar: “Vasil Adhami Dhiamanti 1793”.⁵⁰ Mbi një triqer prej argjendi është shkruar: “Viti 1773. Ktitorët Haris Stefani i Haris Dhimitrit me dorën e Eftiastit të Soto Stiljanit”.⁵¹ Rreth bazamentit të një kryqi gjendet ky mbishkrim: “Kryqi është pronë e së mbishenjtës Hyjlindëse së Sopikut 1794”.⁵²

KISHA E SHËN KOLLIT TË SELANIT NË POGON

Sipas teologut Dhimitër Beduli kisha e “Shën Kollit të Selanit” në Pogon ka qenë një paraklis shumë e vjetër dhe e pikturuar e tëra. Doktor Zeri, plak nga fshati tregon se përveç afreskeve me karakter fetar, ka pasur në pronaos dhe shënime të ndryshme, për ngjarje historike, sidomos në lidhje me veprimtarinë e Ali pashë Tepelenës. Mjerisht kjo kishë është prishur më 1929

⁴⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 670, faqe 264.

⁵⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 636, faqe 255.

⁵¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 600, faqe 245.

⁵²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 637, faqe 255.

prej një farë H. Dupi, për ta ribërë të re në mënyrë që ti përmendej emri.⁵³

Në kishën e “Shën Kollit” në Selani të Sopikut në Pogon gjendet një mbishkrim, i cili përmend emrin e Ali pashë Tepelenës: “Viti 1785 e shkruajti Papa Dhimo kur erdhi dhe meshoi bashkë me Papa Thanasin dhe ishte edhe.....në dërstile dhe i nipi Kristoja, në atë kohë ishte dhe Ali Pasha me Veliun të nisur për në Janinë me tre mijë dhetë shtunën e madhe, prill 19. Ky mbishkrim është shkruar në murin e kishës së Shën Kollit”.⁵⁴ Gjithashtu në murin e kësaj kishe gjendet ky mbishkrim: “Në kohën kur erdhi prift Jani me jero dhjakon Efthimin, të birin e Papa Dhimës dhe meshoi këtu, atëherë vdiq dhe Dhiko Llazo, u verbua në dërstile të Gjushit dhe vdiq në vitin 1786, prill 20”.⁵⁵

Në murin e kishës është shkruar: “1786-Vetë jero dhjakoni i Papa Dhimës e shkruajti që të më ndejë. 1786 prill 20. Në kohën kur erdhi i biri i Papa Dhimës dhe meshoi bashkë me Papa Janin e Koços dhe i biri i Papa Dhimës Efthimi, ishte atëherë edhe jero dhjakoni, i cili atëherë ishte dhe mësues në Sopik, kur vdiq djali”.⁵⁶ Në murin e kishës gjendet e shkruar: “1787 mars 21. Më kujtohet kur erdhi Papa Jani i Papa Qirkut kur ishte me Ali bej Fastanin dhe vrau Ali be Koxhabash (kryetar) në të gjithë vilajetin”.⁵⁷ Në murin e kishës gjendej ky mbishkrim: “Më 12 maj, në kohën kur vdiq Panajot Zhupa, në Vonicë, kushdo që të vijë të

⁵³-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 25-26.

⁵⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 616, faqe 250-251.

⁵⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 619, faqe 251.

⁵⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 620, faqe 251-252.

⁵⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 623, faqe 252.

meshojë këtu në shën Kollë, në Seljani ta kujtojë. E shkruaj unë Thanas Zhupa, viti 1800”.⁵⁸ Po në kishën e “Shën Kollit” në Selani të Sopikut në Pogon gjendet një mbishkrim, i cili përmend marrjen e Sulit nga Ali pashë Tepelena: “1803 dhjetor 3. Kujtohem kur morën Sulin, vezir Ali Pasha, atëherë kishte dërguar në Sul dhe Zison, të birin e Papa Janit, ekonomit bashkë me argatët nga të gjitha vilajetet. Ishte me 600 argatë dhe i dërgoi Veli Pasha brenda në Kungj me beun që të nxireshin kallogjerin ku ishin mbylur brenda dhe atëhere i vu zjarr barotit Foto Xhavella atje ku bisedonte Zisoja me kallogjerin dhe e dogji brenda bashkë me Kir Ziso bashkë me kallogjerin, ishte edhe Kristoja i Qirixhi Thanasit me Zison dhe u dogj ai brenda së bashku me efendinë e tij dhe kushdo që të meshojë këtu t’i përmendi dhe ka pagën prej perëndisë”. Ky mbishkrim është shkruar në murrin e kishës së Shën Kollit.⁵⁹ Në murin e kishës së “Shën Kollit” është shkruar: “1807 dhjetor 20. Kujtohem kur shkoi Gjergji i Papa Janit në Prevezë me sopikasit dhe me 120 argatë nga vilajeti. Nxorën hunjtë për kalanë dhe bënë shtatë muaj dhe në qershor erdhën. Atëherë ishte dhe Anagnosti, vëlla i Trogjirit, në vilajet me ekonomin dhe e mblodhën pklonin (lloj takse). U sëmur Anagnosti derisa erdhi në rrezik dhe me dashjen e perëndisë së shenjtë shpëtoi”.⁶⁰

KISHA E SHËN E PREMTES NË HLLOMO TË POGONIT

Kisha e “Shën e Premtes” është ndërtuar në vitin 1855. Ktitor i kishës është Panajot Pando, i cili me pëlqimin e fshatit prishi kishën e vjetër dhe rindërtoi të renë. Skicat e kishës u

⁵⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 653, faqe 259.

⁵⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 661, faqe 261.

⁶⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 669, faqe 263.

përpunuan nga usta Jorgji nga fshati Vurbjan dhe për ndërtimin e kishës kanë punuar rreth 90 ustallarë. Kisha ka kushtuar rreth 5000 lira dhe përfundoi së ndërtuari në vitin 1858. Pasi përfundoi kisha Panajot Pando u dhuroi ustallarëve shtatë pjata të mbushura me lira përveç hakut të punës. Kisha ka përmasa 20x15 metra. Çatia e kishës ka qenë e mbuluar me plloça prej guri, ndërsa në vitin 1920 u mbulua me tjegulla marsejeze. Sipas dy mbishkrimeve që gjenden, e para mbi portalin e portës jogore dhe e dyta mbi faqen e jashtme të murit jugor vërtetohet se kisha është ndërtuar në vitet 1856-1857.⁶¹

Kisha është pjesërisht e pikturuar prej piktorëve Stavro dhe Theodhos Jusit nga Hllomoja. Në kubënë e altarit gjendet “Trinia e Shenjtë”, ndërsa në kubënë tjetër gjendet “Pandokratori”, nën të paraqiten engjëj dhe në vijim skena të ndryshme nga jeta e Krishtit. Në katër qoshet e kolonave mbajtëse paraqiten katër ungjillorët, ndërsa në kubënë e tretë gjendet “Platitera”. Nën të paraqiten profetët e vegjël dhe nën ta profetët e mëdhenj. Nëpër harqet e kishës paraqiten shenjtorë të ndryshëm. Altari i kishës përbëhet nga tre apside. Në apsidën e mesit gjendet “Platitera me Krishtin në mes”. Nën të paraqiten “Dymbëdhjetë apostujt me Krishtin në mes”. Nën skenën e apostujve paraqiten hierarkët dhe dy dhiakonë më këmbë. Në proskomidhi gjendet skena “Zbritja nga Kryqi” dhe anash saj është pikturuar Roman Melodiozi etj.

Ikonostasi i kishës është gdhendur në vitin 1859 prej mjeshtrë Dhimitrit nga fshati Hionadhes. Ky i fundit është shpërblyer me 5000 lira. Mbi derën e bukur të ikonostasit është skalitur viti 1859, i cili tregon kohën e gdhendjes.⁶² Ikonat e mëdha të ikonostasit, ajo e Krishtit, Shën Mërisë, Joan Pagëzorit dhe Shën e Premtes janë pikturuar nga një ikonograf rus në vitin 1858.

⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 729, faqe 276.

⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 731, faqe 276-277.

Në ikonën e Krishtit gjendet mbishkrimi: “P.A.Brozgallov viti 1858”.⁶³ Mbi ikonën e Ipapandisë është shkruar: “Punë e Dhimosten Zografit 1875”.⁶⁴ Në ikonën e Shën Artemit gjendet mbishkrimi: “Punë e Filip Nikolaidhit 1863”.⁶⁵ Mbi ikonën e Burimit Jetëdhënës është shkruar: “Me dorën e Petros 1849”.⁶⁶ Në pjesën jugore të altarit gjendet një paraklis, në të cilin është vendosur një ikonë e Shën Mërisë. Ikona quhet “Hiri i Madh” dhe është e veshur me argjend. E veçanta e kësaj ikone është se Shën Mëria e mban Krishtin nga ana e kundërt. Në anën e poshtme të ikonës gjendet mbishkrimi: “Me shpenzimet e Qirjakos dhe kontributin e arkimandritit”.⁶⁷

Ikona ka një histori interesante. Fillimisht ka qenë në pronësi të manastirit të Shën Harallambit në Etoli Akarni të Greqisë. Murgjit e manastirit bashkëpunuan me kryengritësit grekë prandaj Ali pashë Tepelena urdhëroi shkatërrimin e manastirit. Ndërkohë murgjit u shpërndanë ku të mundnin. Një mur i quajtur Dionis mori me vete ikonën e Shën Mërisë. Udhës u kap nga njerëzit e Ali pashës dhe u burgos në Janinë. Me ndërhyrjen e Vasiliqisë, gruas së Ali pashës u lirua nga burgu dhe vajti në Stamboll ku filloi të mblidhte ndihma për të rimëkëmbur manastirin. Patriarkana e ndaloi të mblidhte ndihma dhe ia mori ikonën çudibërëse. Me ndihmën e Ambasadës Angleze, murgu Dionis arriti që ta merrte përsëri ikonën. Pas vdekjes së murgut Dionis ikonën e mori Ambasada Angleze, prej së cilës e blenë emigrantët hllomjotë dhe

⁶³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 730, faqe 276.

⁶⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 759, faqe 282.

⁶⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 742, faqe 279.

⁶⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 720, faqe 274-275.

⁶⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 798, faqe 290-291.

e dërguan në fshatin e tyre më 1830.⁶⁸ Gjithashtu rreth bazamentit të poririt të shenjtë është shkruar: “U punua me shpenzimet e kësaj ikone të së mbishenjtës Hyjlindëse të Hllomosë, në kohën e kujdestarisë së Nikollë Haxhiut, me dorën ..e Gjergj Jan Mecovitit”.⁶⁹ Mbi shandanin prej bronzi të kishë gjendet një mbishkrim: “Për kujtim të Argjirës së Panajot Dh. Sterjopullit e dhuruan me devotshmëri bijtë Kostandini dhe Aleksandri, mars 1852”.⁷⁰

KISHA E LINDJES SË SHËN MËRISË NË SKORE TË POGONIT

Kisha e “Lindjes së Shën Mërisë” gjendet në fshatin Skore të Pogonit. Kisha është ndërtuar në vitin 1793. Në harkun e hyrjes veriore të kishës është skalitur një shqiponjë dykrenore me një kryq sipër saj. Anash gjenden dy luanë që qëndrojnë me këmbët e pasme dhe dy këndeza në fund. Gjithashtu është gdhendur viti i ndërtimit të kishës 1793. Në mbishkrim është shkruar: “Qipriano-1793”.⁷¹

Kisha është bazilikë dhe ka përmasa 20x10 metra. Muratura e kishës është prej guri të lidhur me llaç gëlqereje. Çatia e kishës mbulohet me ploça guri. Ikonostasi i kishës është gdhendur me nivel të lartë artistik. Në ikonostas janë gdhendur vazo me lule, engjëj gjashtëkrahësh, zogj, drerë, dragonj etj. Dhjetë pëllumba gjenden në pjesën e sipërme të ikonostasit dhe mbajnë nëpër qepat e tyre varëset e kandileve. Gjithashtu dhjetë pëllumba të tjerë janë

⁶⁸-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 34-36.

⁶⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 771, faqe 284.

⁷⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 722, faqe 275.

⁷¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 634, faqe 255.

gdhendur në pjesën e mesit të ikonostasit. Ikonostasi, fronti dhespotik dhe amvoni janë gdhendur prej një mjeshtri nga Konica në vitin 1832. Kjo datë është skalitur në amvonin e kishës. Froni peshkopal mbështetet mbi dy luanë. Gdhendjet vijoje me degë hardhish të ngarkuara me rrush. Në katër qoshet janë skalitur pëllumba dhe sipër një kurorë. Ikonat e mëdha të ikonostasit të kishës janë ripunuar prej priftit të fshatit atë Qirjakos, i cili ka qenë ikonograf. Ikonat e vogla, që paraqesin festat dhespotike janë 25, por nuk e kanë ndonjë shënim për kohën e punimit të tyre.⁷²

Gjithashtu në këtë kishë gjenden edhe mjaft ikona, që janë sjellë prej dhuruesve të ndryshëm. Në ikonën e Krishtit në narteksin e kishës është shkruar: “Me shpenzimet e shërbëtorëve të perëndisë, Marthës murgeshë, Sinklitinës murgeshë për kujtim të tyre dhe të prindërve 1847 dhjetor 18. Piktur Petro Gjeorgjiadhi, Protosingjel i Mitropolisë së Janinës”.⁷³ Në ikonën e Shën Mërisë në narteksin e kishës gjendet mbishkrimi: “Me dorën e Stefan M. Zografit. Më 1871 maj 8, nga Fjonjati”.⁷⁴ Në ikonën e Shën Trifonit gjendet ky mbishkrim: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë të esnafëve të bekuar të bakçevanëve dhe të kontribuesve në vendin e tyre. Dora e Filotheut, më 20 shtator 1859”.⁷⁵ Në ikonën e Shën Efimisë është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë. Dora e Dhimitër Nikollës fjonjatasit nga eparkia e shenjtit të Vellasë, 1870 nëntor”.⁷⁶ Mbi

⁷²-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 14-15.

⁷³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.719, faqe 274.

⁷⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.752, faqe 280-281.

⁷⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.734, faqe 277.

⁷⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.747, faqe 280.

një kuti lipsanësh, e cila ka të gravuar Shën Triadhën gjendet ky mbishkrim: “Dora e piktor Zaharisë, nga Furna 1829”.⁷⁷

KISHA E SHËN THANASIT NË PESHTAN TË TEPELENËS

Kisha e “Shën Thanasit” gjendej anën në perëndimore të fshatit Peshtan dhe është ndërtuar në vitin 1870. Kisha është ndërtuar me gurë të zi, të gdhendur e të lidhur me llaç gëlqereje. Dyshemeja e kishës ishte e shtruar me pllaka të zeza prej guri. Kisha mbulohej nga një çati me trarë. Kisha, hajati dha kambaneria qenë të mbulluara me ploça të zeza guri. Në mesin e kishës varej një shandan i madh, nën të cilin gjendej një pllakë e bardhë që tregonte qendrën e kishës. Naosi ndahej nga altari me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Mbi ikonostas qenë gdhendur 12 pëllumba me krahët e hapur, në sqepin e secilit varej nga një kandil. Për të ndezur kandilat dhe qirinjtë e shandanit përdorej një shkallë druri. Në anën jugore të ikonostasit gjendej psaltiri.



Në Peshtan kanë qenë psaltë; Lekë Gjoka, Risto Kume, Gole Mërtiri, Koço Llukani (Mësues i Merituar), Janaq Kora, Gaço

⁷⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.706, faqe 271.

Çami, Pole Kume, Koço Fështi etj. Të gjithë kanë qenë njerëz të nderuar dhe të respektuar në fshat.⁷⁸ Gjithashtu edhe fronti episkopal ishte prej druri të gdhendur. Në murin verior dhe atë jugor të kishës qenë vendosur frone druri të lartë për tu ulur besimtarët. Gjinekoniti me përmasa 6x6 metra gjendej në pjesën fundore të kishës. Hajati me përmasa 14x4 metra gjendej në anën veriore të kishës dhe ishte i shtruar me pllaka guri. Kambaneria ishte tetë metra e lartë dhe mbi të gjendeshin dy kambana. Në njërën prej tyre ishte fiksuar një zinxhir, ndërsa në tjetrën një litar. Këta vareshin nga ana e pasme e kambanerisë dhe shërbenin për tu rënë kambanave. Në verilindje të kambanerisë mbi një degë vidhi varej toka, e cila binte në kohën që dilte kisha. Kambana e madhe kishte ardhur nga Kostandinopoja, ndërsa kambana e vogël është punuar në Korçë. Në të gjendet ky mbishkrim: “Industria shqiptare. Korçë. Spiro V. Naçe. Kambana e katundit Peshtan, Tepelenë 17.04.1938”. Në pjesën e sipërme të kambanës gjenden të gdhendur dhjetë engjëj krahëhapur. Poshtë tyre Krishti i kryqëzuar dhe dy nga gratë miroprurëse që e vajtonin. Në vijim gjendet Shën Mëria me Krishtin në prehër. Pas prishjet së kishave kambanat u zhdukën. Me këmbënguljen e besimtarëve në vitin 1995 u gjet vetëm kambana e vogël, e cila sot ruhet në shtëpinë e besimtarit të devotshëm Llukan Stavro.⁷⁹ Pas lejimit të ushtrimit të fesë në vitin 1990, shumë peshtanakë, u lidhën me kishën ortodokse duke ndjekur seminare e shkolla teologjike dhe duke qenë ortodoksë aktivë në ringjalljen e kësaj kishe nga rrënojat. Bashkë me këtë ringjallje shpirtërore, në të ardhmen lutemi me gjithë shpirt që dhëntë Perëndia për rikonstruksionin e njerës prej kishave të fshatit tonë, me qëllim që kjo traditë t’u përcillet brezave.⁸⁰

⁷⁸-Llukan Stavro, Plagët e Krishtit i puth çdo ditë, Gjirokastër 2006, faqe 3.

⁷⁹-Llukan Stavro, Vasil Rrapi, Toponimet e Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2009, faqe 29-37.

⁸⁰-Andrea Llukani, Erion Prifti, Peshtani, rrënjë të thella në traditën ortodokse, Ngjallja, qershor 2001, faqe 10.

KISHA E SHËN KOLLIT NË PESHTAN TË TEPELENËS

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në fshatin Peshtan të Tepelenës. Kisha ka përmasa 8x4.50 metra dhe është e stilit bizantin. Kjo kishë është ndërtuar në vitin 1142 dhe është rindërtuar në vitin 1861. Kjo vërtetohet me anën e një mbishkrimi të gdhendur mbi një pllakë guri mbi portën veriore të kishës: “Ndërtimi i parë në vitin 1142, ndërtimi i ri në vitin 1861”.⁸¹ Në librin e teologot Theofan Popa “Mbishkrime të kishave në Shqipëri”, në faqen 35 : Mbishkrimi i ndërtimit të kishës së Shën Kollit në Peshtan i përket shekullit të XVIII. Ky mbishkrim gjendet i shkruar me tulla të murosurat, në faqen e murit verior të kishës së Shën Kollit. Sipas përkthimit të Theofan Popës na jepet: “Shën Kolli i Peshtanit”. Kisha e Shën Kollit gjendet në mal, ndërmjet katundit Peshtan dhe kalasë së Malëshovës.⁸² Në kishën e Shën Kollit ka shërbyer kleriku i devodshëm atë Nine Fështi. Ky i fundit ka emigruar në Sofje të Bullgarisë. Gjatë viteve të qëndrimit në Sofje u antarësua në shoqërinë patriotike “Për shkronjat shqipe”. Pasi u kthye nga emigracioni u vesh prift dhe filloi predikimet në gjuhën shqipe. Mitropoliti i Korçës e paralajmëroi që të hiqte dorë, por prifti patriot vazhdonte punën për përhapjen e gjuhës shqipe. Atëherë Mitropoliti vendosi ta takonte në Tepelenë dhe atë Nine Fështi bëri sikur iu bind kërkesës së tij, por përpara se Mitropoliti të mbërrinte në Korçë, postieri kishte sjellë një pako për të, brenda së cilës qenë rrasoja dhe mjekra e rruar e Nine Fështit. Mbi pako ishte shkruar: “Merrini mjekrën dhe paçavuren tuaj. Shqipja na është më e dhimbsur”. Mitropoliti i Korçës e mallkoi dhe e shkishëroi priftin patriot.⁸³

⁸¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 499, faqe 204.

⁸²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, nr. 500, faqe 213.

⁸³-Simo Tyto, Baba Dhame Peshtani, Tema, Tiranë 2001, faqe 60.

Në këtë kishë historike gjatë muajit maj në kohë thatësire, mblihdeshin besimtarët nga e gjithë krahina dhe luteshin që të binte shi. Kisha kremtonte më 6 dhjetor në të kremten e Shën Nikollës zhvilohej panairi me pjesëmarrjen e banorëve nga e gjithë krahina. Gjatë panairove kishte shumë gjallëri, sepse grumbulloheshin edhe besimtarë nga trevat e tjera duke shkëmbyer kulturën dhe traditat. Dita e panairit pritej me padurim nga popullsia për arsye se përveç adhurimit të shenjtorit në Liturgjinë Hyjnore, tek oborri i kishës zhvillohej aktivitet tregtar dhe më pas vijonte gostia e madhe kolektive.

KISHA E SHËN THANASIT NË LEKËL TË TEPELENËS

Kisha e “Shën Thanasit” gjendet në fshatin Lekël të Tepelenës. Mbi një pllakë guri mbi murin e kishës është shkruar data e ndërtimit: “Në vitin 1774 u ndërtua më 1774”.⁸⁴ Mbi një ikonë të Shën Gjergjit dhe të Shën Mitrit është shkruar: “1811 shtator 4”.⁸⁵ Në këtë kishë ka shërbyer kleriku martir atë Gjergj Suli, i cili ka lindur më 12 mars 1893 në fshatin Lekël të Tepelenës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa arsimin e mesëm e përfundoi në gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Në 3 prill të vitit 1912 emigroi në Amerikë. Më 1917 u rekrutua në ushtrinë amerikane. Atë Gjergji prej vitit 1919 ka qenë veprimtar i shquar i Shoqërisë “Vatra” dhe kishte miqësi të ngushtë me Imzot Theofanin. Më 9 qershor 1929 u dorëzua klerik prej Platonit, peshkopit rus të Nju Jorkut. Atë Gjergji shërbeu si famulltar i kishës së “Shën Ellias” në Jamestovn. Më 8 dhjetor 1929 u transferua në kishën e “Shën Kollit” në Southbridge ku organizoi korin e kishës dhe shkollat e katekizmit. Më 1 tetor 1930

⁸⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.601, faqe 245.

⁸⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 679, faqe 266.

Peshkopata e emëroi famulltar në kishën e “Shën Pjetrit dhe Pavlit” në Filadelfia. Në vitin 1934 u kthye në Shqipëri, për të mbajtur lidhjet midis Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe asaj të diasporës. Gjithashtu shërbeu si klerik në fshatrat e zonës: Lekël, Labovë, Tërbuq, Hundkuq, Kodër, Peshtan etj. Vendosja e regjimit komunist e vuri në shënjestër edhe atë Gjergjin, sepse kishte qenë në Amerikë dhe mbante korrespondencë me patriotët shqiptarë të diasporës. Atë e arrestuan më 27 dhjetor të vitit 1946 me akuzën: “Bashkëpunëtor i anglo-amerikanëve dhe kundërshtar i regjimit”. Në gjyqin që u bë në 14 janar të vitit 1947 atë Gjergji u dënua me pushkatim. Xhelatët e kuq u habitën nga qëndrimi i atë Gjergjit, i cili e dorëzoi shpirtin te Perëndia duke bërë shenjë e kryqit.⁸⁶

KISHA E SHËN MËRISË NË KOSINË TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet sipër një kodre në fshatin Kosinë të Përmetit. Kisha është në formë kryqi me kube dhe ka përmasa 11x7.50 metra. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe mjedisi i altarit. Tamburi cilindrik është i ndërtuar me tulla. Në të këmbëhen dritare me nike të harkuara, të cilat janë me tulla të shkallëzuara. Tamburi përfundon me një frize prej tullash të vendosura në formë dhëmbë sharre. Faqet e mureve janë të ndërtuara me gurë dhe tulla. Gurët e papunuar janë të vendosur në formë të çrregullt. Muret janë të stolisura me motive zbukuruese. Muratura e kishës është e tipit të kluasonazhit dhe i përket shek. XII.⁸⁷ Në një tullë të rumbullakët të murosur në murin lindor përmbi apsidën e kishës gjendet viti 800, 200, 700”.⁸⁸

⁸⁶-Llukan Stavro, atë Gjergj Suli, martir i Kishës sonë Orthodhokse, Ngjallja, janar 1999, faqe 9.

⁸⁷-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 159-161.

⁸⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 293, faqe 153.

Ikonostasi i kishës është i gdhendur në dru. Mbi ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me dorën e Nikollë Postenalit, 1829 maj 16”.⁸⁹ Kambaneria e kishës është ndërtuar në vitin 1868. Mbi një gur të kambanerisë është gdhendur viti 1868.⁹⁰

KISHA E SHËN E PREMTES NË PËRMET

Kisha e “Shën e Premtes” gjendet në jugperëndim të qytetit. Kisha ka përfunduar së ndërtuari më 20 prill të vitit 1776. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim i shkallitur rreth një guri të rumbullakët ranor, i cili gjendet në hajatin e kishës: “Ilia Hirësi. 1776 prill 20 u ndërtua ky tempull me shpenzimet e të gjithë shokëve. Nxitja dhe ktitori ka qenë Leondi, ekonomi, papa Celo. Dhe Fili dhe epitrop Leonti”.⁹¹



Prej këtij mbishkrimi mësojmë se kryemjeshtër në ndërtimin e kishës ka qenë Ilia Kristo, ndërsa ktitor ka qenë i ekonom Leonti.

⁸⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 431, faqe 199.

⁹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 453, faqe 205.

⁹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.378, faqe 184.

Kisha është e tipit bazilikë me tre nefe me përmasat 12x16 metra dhe përbëhet nga naosi, narteksi, altari dhe hajati. Kisha mbulohet me çati dyujëse me rrasa guri. Muratura e kishës është prej grurë shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Apsida e kishës është shtatëfaqëshe dhe është punuar me gurë të skuadruar dhe me nike me harqe tullash. Kisha është pikturuar në vitin 1808 nga Terpo Zografi.⁹² Mbi faqen e murit perëndimor brenda naosit të kishës është shkruar: “U pikturua ky tempull i shën e Premtes, me shpenzimet e të krishterëve, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit, shenjtit të Korçës, zotit Joasaf, në kohën kur ishte famullitar Saqelari Kir Pano dhe kartofilaks Kir Papa Zoto, kur ishte kujdestar zoti Dhimitër Stefani, në vitin 1808 shtator. Me dorën e Terpo Zografit birit të Kostandin Zografit, nga Korça”.⁹³

Afresket gjenden në faqet anësore të naosit, me brezin e madh të shenjtorëve, brezin e madalioneve dhe mbulojnë harqet, qemerët dhe kupolat e kishës. Skenat biblike janë nga Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re. Këto skena fillojnë me “Krijimin e Adamit”, “Krijimi i Evës nga brinja e Adamit”, “Dëbimi nga parajsa” etj. Këto afreske janë të mbushura me motive nga bota bimore. Ambienti i altarit ndahet me naosin me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Ikonostasi është gdhendur nga mjeshtër Dhimitri nga Konica. Mbi ikonën e Shën Naumit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Me dorën dhe lutjen e Nikollë Gugës 1750”.⁹⁴

Në vitin 1964 kisha e “Shën e Premtes” është përmbytur prej përroit që kalon aty pranë. Uji i përzier me baltë shpërtheu derën jogperëndimore të narteksit dhe mbushi naosin deri në lartësinë tre metra, duke shkaktuar dëme të mëdha në pikturën murale të kishës. Punimet për kullimin e ujërave filluan në vitin

⁹²-Stilian Adhami, Përmeti dhe përmetarët në faqet e historisë, Tiranë 2001, faqe 148-150.

⁹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 400, faqe 191.

⁹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 355, faqe 177.

1967. Më pas u restaurua narteksi dhe naosi. Gjithashtu muralet e kishës janë restauruar edhe në vitet 1981-1982.⁹⁵

KISHA E SHËN MËRISË SË PAZARIT NË PËRMET


Kisha e “Shën Mërisë së Pazarit” gjendet në qendër të Përmetit. Kisha i është kushtuar “Lindjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 8 shtator. Ka qenë kishë e tipit të bazilikës me kupolë dhe kishte një kambaneri. Muratura e kishës përbëhej nga blloqe të bardhë guri, të cilët lidhen me njeri tjetrin me një shtresë të hollë gëlqereje. Kisha mbulohej nga një çati dyujse. Kisha kishte përmasa 20x14 metra. Kjo kishë është ndërtuar rreth vitit 1600 pranë pazarit dhe u shërbënte zejtarëve dhe tregtarëve përmetarë. Themelet e kishës u hodhën nga përmetari Zoto Loli. Në vitin 1814 kisha u pikturua prej Paskal Trandafilit me interesimin e Janaq Prevezhanit. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi: “Ndhimmo shërbëtorin e zotit Janaq Prevezhani 1814”.⁹⁶

Gjatë viteve të kryepiftërisë së Mitropolitit të Korçës Meletit (1816-1827) kisha u zgjerua me kontributet e mbledhura nga banorët përmetarë. Por me kalimin e viteve, kisha nuk mund ti plotësonte nevojat e komunitetit ortodoks të qytetit prandaj përmetarët donin të ndërtonin një kishë më të madhe. Punimet për ndërtimin e kishës së re kanë filluar në vitin 1929. Në vitet 1930 pasi u mbaruan fondet e mbledhura për ndërtimin e kishës, ajo mbeti vetëm si karabina, me dysHEME të pashtruar dhe mure të pasuvatuar. Gjatë Luftës II Botërore kisha pësoi shumë dëmtime nga bombardimet. Në 16 nëntor të vitit 1962 qyeti i Përmetit u përmbyt dhe bashkë me të edhe kisha. Në vitin 1963 mbi karabinanë e kishës u ndërtua Pallati i Kulturës së qytetit të Përmetit.

⁹⁵-Stilian Adhami, Përmeti dhe përmetarët në faqet e historisë, Tiranë 2001, faqe 152.

⁹⁶-Stilian Adhami, Përmeti dhe përmetarët në faqet e historisë, Tiranë 2001, faqe 147.

Në ceremoninë e inagurimit ka marrë pjesë edhe Kryeepiskopi Pais Vodica.⁹⁷ Muret mbajtës të kishës deri në një farë lartësie u ruajtën të paprekura, por u shkatërrua pjesa e sipërme e tyre. U mbyllën dritaret dhe hyrjet ekzistuese të kishës dhe u hapën dritare dhe hyrje të reja. Pjesa që u prish nga muret e kishës u shtua rreth dy metra me tulla të kuqe. Megjithë ndërhyrjet kanë mbetur format origjinale të ndërtimit të kishës. Në lartësinë e murit perëndimor mund të shquhet forma e kambanerisë. Muret e kishës janë të ndryshëm nga ata të Pallatit të Kulturës si nga gjerësia ashtu edhe nga materialet e përdorur për ndërtimin e tyre. Gjithashtu edhe ekzistenca e harkut të pjesës lindore të kishës përbën faktin kryesor të ruajtjes së skeletit të kishës me gjithë transformimet e bëra.⁹⁸



Në vitin 2001 kisha iu kthye komunitetit ortodoks dhe filluan të celebropen ceremonitë fetare. Më pas autoritetet vendore donin që ajo të kthehej në gjendjen e mëparshme, pra në shtëpi kulturore të qytetit. Pasi vijuan një sërë procesesh gjyqësore, gjatë të cilave herë e fitonte kisha e herë bashkia. Më 16 gusht 2013 në kishën e “Shën Mërisë” së Përmetit u bë një sakrilegj. Përmbaruesit të mbështetur nga policia private hynë në kishë dhe hoqën ikonat,

⁹⁷-Apostol Kotani, Ndërtimi i Pallatit të Kulturës me miratimin e mitropolitit të qytetit dhe të këshillit kishtar, Sot 1 nëntor 2013, faqe 12.

⁹⁸-Kostandinos Gjakumis, Joan Stratobërdha, Kisha e Lindjes së Hyjlindëses tek Pazari i Përmetit, Tempulli, Nr. 9, Korçë, 2004,faqe 27.

grumbulluan enët e shenjta dhe ungjillin, ndërsa kryqin e rrëzuan nga kambaneria. Të gjitha këto i hodhën në një makinë që përdorej për hedhjen e mbeturinave të Bashkisë.

KISHA E SHËN KOLLIT NË PËRMET

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në qytetin e Përmetit. Kisha është ndërtuar në vitin 1747. Kjo datë gjendet e gdhendur mbi murin e kungës, jashtë kishës së “Shën Kollit” në Përmet.⁹⁹ Në vitin 1930 kisha pësoi një diegie, e cila zhduku plotësisht ikonostasin prej druri të gdhendur. Vitet e fundit kjo kishës është rindërtuar dhe është pajisur me ikonostasin e kishës së Ogdunanit. Gjithashtu prej kësaj kishe është marrë edhe froni dhespotik. Në anën perëndimore të kishës kanë qenë disa konakë, të cilët shërbenin si seli e mitropolisë. Aty qëndronte Mitropoliti i Korçës, i cili dy muaj në vit vinte të meshonte nëpër kishat e Përmetit. Dihet që vite më parë kishat e Përmetit vareshin nga Mitropolia e Korçës.

Pranë kishës gjenden disa varre, midis të cilëve shquhet ai i atë Stathi Melanit dhe varri i Mitropolitit të Korçës Dorotheut, i cili u mbyt në Vjosë. Më 8 maj të vitit 1875 Mitropoliti i Korçës, Dorothe Evelpidhi u mbyt në Vjosë. Trupi i tij u gjet pas një jave në fshatin Peshtan. Imzot Dorotheu kishte vendosur që Pashkët e atij viti t’i celebronte në fshatrat e Përmetit, por nuk mundi që ta realizonte misionin e tij. Ndërsa po kthehej për në Përmet, e zuri një shi i stuhishëm dhe i pafuqishëm që t’i rezistonte rrymës u mbyt në Vjosë. Besimtarët menjëherë e përjetësuan në vargje: Në përrua të Velçishtit / Seç u mbyt veqil i Krishtit / N’atë përrua të shkretë / Seç u mbyt veqili vetë / Atje ku s’kishte asnjë pulë / U mbyt goxha dhespot me vulë. Lipsani i tij u varros në hieroren e

⁹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.348, faqe 175.

Kishës së “Shën Kollit” në Përmet. Imzot Dhorotheu përpara se të bëhej Mitropolit i Korçës ka pasur një funksion shumë të rëndësishëm atë të Protosingjelit të Madh të Patriarkanës Ekumenike.¹⁰⁰

KISHA E SHËN KOLLIT NË LIPË TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në fshatin Lipë të Përmetit. Kisha është bazilikë trinefëshe me përmasa 19x11.12 metra. Mbi një pllakë guri ranor të murosur në faqen e jashtme të murit verior të kishës gjendet mbishkrimi: “Në vitin 1786 prill 30. U përtëri ky tempull i manastirit të Shën Kollit me shpenzimet e katundit. Në kohën e ...at...Loli...mjeshtrit..Stefan, Mitro”.¹⁰¹

Naosi ndahet nga mjedisi i altarit nga një ikonostas druri të gdhendur. Mbi faqen e jashtme të murit verior, nën figurën e Shën Spiridhonit gjendet mbishkrimi: “O zot, mbështetja e atyre që kanë besim në ty, mbështete kishën, të cilën e ndërtove me gjakun tënd të çmuar”.¹⁰² Muratura e kishës është me gurë shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Mbi portën veriore të kishës është shkruar: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë ndër shenjtorë Nikollë çudibërësit, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit zotit Kostandin, në kohën kur ishte prift zoti Qiriako, kontribues dhe kujdestarë Kristodhul Angjelin Dhiamandi, Haxhiu, viti 1795”.¹⁰³ Duke u nisur nga intrerpretimi i mbishkrimit

¹⁰⁰-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 221-222.

¹⁰¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.384, faqe 185-186.

¹⁰²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.392, faqe 188.

¹⁰³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.391, faqe 187-188.

vërtetohet se Kristodhul Angjeli ka qenë ai që ka financuar pikturimin e muraleve të kishës në vitin 1795.

KISHA E SHËN KOSTANDINIT DHE ELENËS NË OGREN TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Kostandinit dhe Elenës” gjendet në fshatin Ogren të Përmetit. Kisha ka madhësi 15x9 metra dhe është ndërtuar më 20 shtator të vitit 1859. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “Ky tempull u ndërtua, më 1859 shtator 20”.¹⁰⁴ Një pjesë të ikonave të mëdha të ikonostasit të kishës janë punuar prej Mihail dhe Kostandin Zografit. Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Dora e zotit Mihail dhe Kostandin Zografit, në Fjonjat, më 1859 shtator 14”.¹⁰⁵ Në ikonën e Shën Mërisë në ikonostasin e kishës është shkruar: “1823. Me dorën e Dhimitër Harislogu”.¹⁰⁶ Mbi ikonën e madhe të Shën Kostandinit dhe Elenës gjendet mbishkrimi: “Dora e zotit Mihail dhe Kostandin Zografit, në Fjonjat, më 1859 shtator 14”.¹⁰⁷ Mbi ikonën e Shën Joan Vladimirit gjendet mbishkrimi: “Dora e Kostandin Ingelsit, viti 1865 dhjetor 23”.¹⁰⁸ Ikonat e kryeengjajve në ikonostasin e kishës janë punuar prej A.N.Ballamaçit. Mbi ikonën e kryeengjellit Gabriel është shkruar: “Me dorën e A.N.Ballamaçit 1885 shtator 13”.¹⁰⁹

¹⁰⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.447, faqe 203.

¹⁰⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.445, faqe 203.

¹⁰⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.424, faqe 197.

¹⁰⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.455, faqe 205.

¹⁰⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.451, faqe 204.

¹⁰⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.474, faqe 208.

KISHA E SHËN KOLLIT NË ARGOVË TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Kollit” gjendet në fshatin Argovë të Përmetit. Sipas gojëdhënës kjo kishë është ndërtuar me ndërmjetësinë e Vasiliqisë, të shoqes së Ali pashë Tepelenës. Kisha e “Shën Kollit” është ndërtuar në vitin 1812. Kjo datë gjendet e murosur në portën veriore të kishës”.¹¹⁰ Kisha e “Shën Kollit” është bazilikë njënefëshe me kube hemisferike me përmasa 12x6.50 metra. Kisha është pikturuar prej Nikollë Postenalit në vitin 1812. Mbi ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishë është shkruar: “Me dorën e Nikollë Postenalit 1812”.¹¹¹

KISHA E SHËN MËRISË NË LEUSË TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Leusë të Përmetit. Kisha i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 15 gusht. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazikal me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 18.20x14.20 metra. Në anën jugore të kishës gjendet një paraklis. Kupola e kishës ngrihet mbi një tambur të lartë. Apsida është rrethore dhe ka dy nike atë të blatës së hyjëshme dhe të diakonikonit. Nartekxi i kishës është dykatësh. Muratura e kishës është me gurë shtufi e lidhur me llaç gëlqereje dhe e zhveshur nga elementët dekorativë.¹¹² Kisha është ndërtuar në vitin 1812. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën veriore brenda

¹¹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.407, faqe 192.

¹¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 422, faqe 419.

¹¹²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 93-96.

kishës: “U ndërtua nga themeli dhe u pikturua ky tempull i gjithnderuar dhe hyjnor i së mbishenjtës së lavdëruar zonjës sonë Hyjlindëse së Eleusës me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të krishterëve krishtdashës dhe të devotshëm të këtij katundi të quajtur Leusë, që shpëtohet prej Perëndisë, në kohën kur ishte peshkop i gjithhirshmi, mitropoliti i Korçës dhe i Përmetit zoti, zoti Joasaf nga Fjonjati, në vitin shpëtimtar 1812, prill 18”.¹¹³ Gjithashtu mbi portën veriore jashtë kishës gjendet mbishkrimi: “Unë jam dera, në se ndokush hyn me anën time, do të shpëtojë”.¹¹⁴



Ikonostasi është prej druri arre të gdhendur me një mjeshtëri të lartë artistike. Thellësia e gdhendjeve arrin deri në shtatë centimetra. Nëpër kolonat e ikonostasit janë gdhendur motive të stilizuara të hardhisë të kacaviren gjatë trungut të drurit. Ikona e madhe e Joan Pagëzorit në ikonostasin e kishës daton në vitin 1778. Kjo ikonë është pikturuar nga një piktor anonim. Punë të tij janë edhe ikona e madhe e Krishtit, e Shën Mërisë, e Shën

¹¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 408, faqe 192-193.

¹¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 409, faqe 193.

Mëhillit dhe ikona e Shën Spiridhonit.¹¹⁵ Mbi mbulesën prej argjendi të ikonës së Shën Mërisë gjendet ky mbishkrim: “Iu dhurua së mbishenjtës Hyj lindëse Eleusa për shpëtimin e shpirtit, me shpenzimet e shumëfisnikut administrator të kishave zotit Kir Mihallaqit, Jan Çali dhe nga atdheu Pogoniani i vjetër, nga katundi Ostanica. Venetio Diamanti, 1764 prill 18”.¹¹⁶ Në ikonën e Fjetjes së Shën Mërisë në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me dorën e Kostandin Ingelsit, në Kostandinopojë, 1815 qershor 8”.¹¹⁷ Në epitafin e kishës është qendisur ky mbishkrim: “Eon (2) dhe prindërit 1789 Panajoti, bashkëshortja, prindërit, fëmijët, Anastasi, Dhiamjanda, Anastas Simo dhe të gjithë në katund. Nikolla I. Prindërit fëmijët e Kasianisë”.¹¹⁸ E gjithë kisha është e veshur me piktura murale. Në skenën “Adami dhe Eva” figurat trajtohen si të gjalla përmes një mjedisi baritor. Skena më e arrirë është “Fjetja e Hyj lindëses”, e cila shquhet për ndjeshmërinë e lartë artistike.¹¹⁹

KISHA E SHËN THANASIT NË LESHICË TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Thanasit” gjendet në fshatin Leshicë të Përmetit. Kisha është bazilikë njënefëshe me një kube të lartë cilindrike. Kisha e “Shën Thanasit” është ndërtuar në vitin 1812. Në faqen e jashtme të murit lindor të kishës gjendet mbishkrimi:

¹¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 380, faqe 185.

¹¹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 369, faqe 182.

¹¹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 443, faqe 203.

¹¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 386, faqe 186.

¹¹⁹-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 139-142.

“1812. Lutje e shërbëtorit të perëndisë Papa Kostandin”.¹²⁰ Ikonat e ikonostasit janë pikturuar prej ikonografit Petro Postenali. Mbi ikonën e Shën Mërisë gjendet mbishkrimi: “1815 shtator. Me dorën e Petro Postenalit”.¹²¹ Mbi ikonën e Joan Pagëzorit është shkruar: “1816 mars 8. Ktitor (themelues) Kosta”.¹²²

KISHA E SHËN ILIUT NË BUHAL TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Iliut” gjendet në fshatin Buhal të Përmetit pranë lumit Vjosë. Kisha është njënefëshe dhe ka përmasa 21.15x9.95 metra. Kjo kishë përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati. Në vitin 1814 kisha ka pësuar një ristrukturim rrënjësor, ku për të zmadhur naosin është prishur muri perëndimor. Muratura e ndërtimit të kishës është e ndërtuar me gurë shtufi. Në të ka tulla të vëna në mënyrë të rregullt. Apsida është trifaqëshe. Në anën jugore të saj tullat janë të vendosura zig-zag.¹²³

Mbi portën jugore brenda kishës gjendet ky mbishkrim: “Në vitin 1814 u ndërtua nga themeli ky tempull i gjithnderuar në kohën e kujdestarisë së shumënderuarit, zotit Kristo Tasi, në 1850 u pikturua në kohën kur ishte peshkop i gjithhirshmi, zoti Neofiti dhe kujdestar arkimandrit Agathangjeli dhe në kohën kur ishte famulltar prift Gjergji dhe në kohën e kujdestarisë së vëllezërve Vangjelit e të Ilisë Efthimit. U pikturua me dorën e Zikut, Nikollas dhe Kostandinit, vëllezërve nga eparkia e shenjtit të Vellasë 1850

¹²⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.406, faqe 192.

¹²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, N.410, faqe 193.

¹²²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 416, faqe 195.

¹²³-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 145.

janar 31”.¹²⁴ Pikturat murale në kishën e “Shën Iliut” zënë gjithë pjesën e brendshme, faqet anësore, kolonat, harqet etj. Afresket janë pikturuar në dy faza. Gjatë fazës së parë që i përket shek. XI, është pikturuar faqet veriore dhe perëndimore të kishës, ndërsa gjatë fazës së dytë, që i përket shek. XVIII është pikturuar pjesa e brendshme e naosit. Afresku më i veçantë në këtë kishë është një burrë i cili ka veshur kostum kombëtar me fustanellë.¹²⁵

KISHA Ë SHËN SOTIRIT NË TREMISHT TË PËRMETIT

Kisha e “Shën Sotirit” është ndërtuar në vitin 1560. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati. Naosi ka përmasa të brendshme 5.10x2.40 metra. Kisha mbulohet nga një çati druri pa tavan. Hajati gjendet përgjatë pjesës jugore të kishës. Muratura e kishës është me gurë shtufi të lidhur me llaç gëlqereje. Hajati i kishës mbulohet me një çati dyujëshe. Mbi portën perëndimore brenda kishës gjendet mbishkrimi: “Në qoftë se je mik hyrë duke u gëzuar, në qoftë se je armik e urrejtës dhe mbushur me dinakëri (trë keqe), larg, larg ik nga kjo portë e daljes. U ndërtua që nga themeli ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i shpërftyrimit të zotit, zotit perëndisë dhe shpëtimtarit tonë Jezu Krisht, me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të shumënderuarit... Viti 7068 (=1560) “. ¹²⁶ Mbi faqen e murit lindor të kishës ndërmjet prothesit dhe apsidës qendrore në kungë është shkrua: “Stefani qëndron në radhën e parë të dhiakonëve dhe martirëve si edhe predikues...shëmbëllor dhe ... me shkrimin tënd lutjet... “ ¹²⁷

¹²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 413, faqe 194.

¹²⁵-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 133-134.

¹²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 295, faqe 153-154.

¹²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 296, faqe 154.

Mbi pjesën jugore të faqes së murit lindor në kungën e kishës gjendet mbishkrimi: “Unë duke qenë vetë gjallë jam dritë e botës. Të vini të ndriçoheni dhe të ushqeheni prej meje. Kushdo që shqyen rroben e nderuar tënden o fjalë, do të prishet si i zhveshur nga lavdia hyjnore”.¹²⁸

BAZILIKA DHE PAGËZIMORJA E BUTRINTIT

Bazilika e Butrintit është një monument i krishterimit të hershëm. Ajo është bazilikë trinefëshe me përmasa 20.15x18.33 metra dhe është ndërtuar në shekullin VI pas Krishtit. Ruhen gati të plota muret rrethore dhe dyshemeja e shtruar me pllaka guri. Bazilika e Butrintit është i vetmi monument, i cili ka mbërritur deri në ditët tona me mure të ruajtura pothuajse në tërë lartësinë e tyre. Mjedisi i altarit ndahej me anën e një ikonostasi, prej të cilit ruhet vetëm një fragment i kolonës. Në gjendjen fillestare pjesa e altarit ka qenë e shtruar me mozaik me motive gjeometrike. Në anën lindore mjedisi i altarit përfundon me një apsidë pesëfaqëshe. Në bazilikë hyhej nga disa dyer, por hyrja kryesore është ajo që gjendet në nefin qendror. Hyrja mbulohej me një hark të dyfishtë tullash. Dyshemeja e nefevë të bazilikës është shtruar me pllaka të mëdha prej guri gëlqeror. Në mesin e nefit qendror gjenden dy bazamente, mbi të cilat mbështetej amvoni i bazilikës. Muratura e bazilikës është me gurë në formë drejtkëndëshi, ndërsa në pjesën e poshtme ka një brez me pesë rreshta tullash. Nga ana e jashtme bazilika ka mure të thjeshta, por në brendësi dyshemeja është e shtruar me mozaik.¹²⁹

Pagëzimet e Butrintit është një monument i periudhës së hershme të krishterimit në viset shqiptare dhe përbëhet nga

¹²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 297, faqe 154.

¹²⁹-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 21-23.

salla e pagëzimit dhe nga një sallë ndihmëse në anën veriore të saj. Të dy mjediset janë të shtruara me mozaikë. Pagëzimetorja është në formë rrethore me diametër 13,5 metra e brendashkruar në një kuadrat me dy rrethë kolonash graniti. Figurat e mozaikut janë me motive zoomorfe, bimore dhe gjeometrike. Këto figura janë vendosur në 96 medalione dhe në shtatë rrethë bashkëqendrorë që ndërpriten nga skena e eukaristisë, e cila përfytyrohet me një kantar të madh të mbushur me degë hardhie, anash të cilit qëndrojnë dy pallonj, ndërsa poshtë tij zogj që çukisin vilet e rrushit. Mbi këtë skenë gjendet skena e pagëzimit. Pagëzimetorja dhe mozaikët e saj mendohet të jenë ndërtuar nga mesi i shekullit VI. Edhe salla që gjendet nga ana veriore është e shtruar me mozaikë me figura shtazore dhe gjeometrike. Ajo ka formë drejtkëndëshe dhe mendohet të jetë ndërtuar pak më vonë se pagëzimetorja. Këta mozaikë kanë vlera të veçanta për historinë e krishterimit dhe janë vepra të përsosura të artit kishtar.¹³⁰

KISHA E SHËN THANASIT NË PECA TË SARANDËS

Kisha e “Shën Thanasit” është një kishë e vogël, e cila ka përmasa të brendshme 5.80x3.50 metra. Kisha është bazilikë njënefëshe me tavan. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, ndërsa çatia është e mbuluar me rrasa guri. Ambienti i altarit ndahet me një ikonostas të ndërtuar me mur guri. Apsida e kishës është rrethore.¹³¹

Kisha është ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1525. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi murin perëndimor të kishës: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i

¹³⁰-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 22,23.

¹³¹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 106.

gjithnderuar i atit tonë ndër shenjtore Athanasit të Aleksandrisë cudibërësit, me kontributin, mundimin dhe shpenzimet e ktitorëve të Pecas së përmendur dhe të besnikëve (të famullisë) dhe të priftit Papa Dhimitrit dhe të bijve të tyre secili simbas fuqisë së tij. Në vitin shtatëmjë e 33 (=1525). Me dorën time të Ilia Llongovitit”.¹³²

KISHA E SHËN MËRISË NË PECA TË SARANDËS

Kisha e “Shën Mërisë” është njënefëshe dhe ka përmasa të brendshme 9.10x4.40 metra. Muratura e kishës është me gurë pak të përpunuar, ndërsa qoshet janë punuar me gurë të latuar. Apsida është pesëfaqëshe dhe është punuar me gurë të gdhendur. Gjithashtu përmban elementë dekorativë.¹³³

Kisha e “Shën Mërisë” është ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1770. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull hyjnor e i hirshëm i Hyrjes në Kishë të së mbibekuarës, së lavdëruarës zonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari të Hyrjes së Hyjlindëses të katundit Peca, në kohën e shumëkrishtdashësit dhe të shumëditurit zotit, Kir Dositheut të peshkopatës së shumëshenjtë, të Drinopojës dhe të Gjirokastrës dhe të priftërinjve prezent prift Panajotit, prift Gjergjit, prift Nikollës dhe të proestëve prezent Athanas Dhiamandit, Thanasit, mërtirit, zotit Gixho, Kristo Dhimitër Nikës, Margarit Nikës, zotit Spiro Thanos dhe të tjerëve, viti prej Adamit 7278, viti prej Krishtit 1770 dhe me dorën time të mëkatarit prift Janit, nga jashtë Janinës dhe me të bijtë e tij, u përfundua në muajin shkurt 10”.¹³⁴

¹³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 804, faqe 294.

¹³³-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 175.

¹³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 829, faqe 304.

KISHA E SHËN SPIRIDHONIT NË VUNO

Kisha e “Shën Spiridhonit” gjendet në lagjen e poshtme të fshatit Vuno. Rreth saj gjendet edhe dy ndërtesa të tjera. Godina e shkollës dhe ndërtesa e administratës kishtare. Kisha është bazilikë dhe ka përmasa të brendshme 19.80x11.40 metra. Në anën perëndimore të kishës gjendet hajati në formë katrore. Muratura është me gurë dhe e suvatuar. Qoshet e mureve dhe shpatullat e dyerve e dritareve janë punuar me gurë të gdhendur. Ndërtesa e administratës kishtare është dykatëshe dhe gjendet në anën jugore të kishës. Ndërsa godina e shkollës gjendet në anën lindore të saj.¹³⁵

Sipas një gojësdhëne kjo kishë është ndërtuar me nismën e Shën Kozmait me materialet e mbetura nga një vapor i mbytur. Kisha është ndërtuar në vitin 1778. Kjo vërtetohet me anën e një mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore brenda kishës: “1778- Në muajin shkurt u rindërtua që nga themeli ky tempull i shumëhyjshëm dhe në muajin shkurt 1784 u stolis me të gjitha, me harxhet dhe shpenzimet e përbashkëta të katundit dhe në kohën e peshkopatit të shumë perëndidashësit Joaniqit, shenjtit të Himarës dhe Delvinës. Kujdestaria në atë kohë ka qenë nga i njejtë katund, Vuno sikurse shihet më qartë në librin e përbashkët të shkollës dhe të këtij manastiri. U pikturua prej Janit nga eparkia e Drinopojës dhe e Gjirokastrës”.¹³⁶ Në ikonën e Krishtit që gjendet në ikonostasin prej muri të kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e Shërbëtorit të perëndisë, Janit të Sakut”.¹³⁷

¹³⁵-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 197-198.

¹³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 834, faqe 306.

¹³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 842, faqe 308.

Ndërsa në ikonën e Shën Mërisë është shkruar: “Lutje e shërbëtores së perëndisë, Lule Dhima, në vitin 1783”.¹³⁸ Në ikonën e Kryeengjellit Mikael në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Janit të Sakut”.¹³⁹ Ndërsa mbi faqen e murit jugor pranë portës së kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Polimerit të Piros”.¹⁴⁰

KISHA E SHËN MËRISË NË QEPARO

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Qeparo të Himarës. Emri i kryemjeshtrit që ka ndërtuar kishën gjendet tek një mbishkrim jashtë portës jugore të kishës: “1796. Usta Koti shkruajti”.¹⁴¹ Ndërsa mbi një gur në anën e sipërme të murit verior jashtë kishës është shkruar: “Papa Zaho 1796”.¹⁴² Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Dhuratë e shërbëtorit të perëndisë, Gjikë Pasi 1798”.¹⁴³ Në ikonën e Shën Mërisë që gjendet në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “1851, maj 10. Lutje e shërbëtorit të perëndisë, prift Spiros, i cili dhuroi për shpirtin e tet 200 grosh për tempullin, për kujtim të tij dhe të prindërve”.¹⁴⁴

¹³⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 843, faqe 308-309.

¹³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 841, faqe 308.

¹⁴⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 840, faqe 308.

¹⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 854, faqe 312.

¹⁴²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 855, faqe 312.

¹⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 858, faqe 314.

¹⁴⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 880, faqe 320-321.

Sipas një gojëdhëne 2000 groshët që dhuroi për ndërtimin e ikonostasit të kishës prift Spirua i kishte marrë si zhdëmtim për vrasjen e të birit. Kambaneria e kishës është ndërtuar në vitin 1867 dhe ka një lartësi prej 27 metrash. Mbi portën e kambanerisë gjendet një mbishkrim i gdhendur në gur: “U ndërtua më 1867”.¹⁴⁵

KISHA E SHËN MËRISË NË MALÇAN

Kisha e “Shën Mërisë” gjendet në fshatin Malçan. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi është në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 6.60x5.90 metra. Muratuara e kishës është e ndërtuar me gurë dhe është veshur me një shtresë llaçi. Janë lënë të pambuluar qoshet e kishës, të cilat janë punuar me gurë të mëdhenj dhe të latuar. Muratura përfundon me një kornizë në formë dhëmbësharre. Tamburi i kishës përmban dymbëdhjetë nike dhe dritare të mbuluara me harqe tullash. Mbi to gjendet një friz i rrafshët i dekoruar me copa tjegullash. Duke u nisur nga karakteri i dekoracioneve të tamburit mendohet që kisha të jetë ndërtuar rreth shek. XVII.¹⁴⁶

Ambienti i altarit ndahet nga një ikonostas druri, i cili është gdhendur në vitin 1822. Këtë fakt e vërtetom mbishkrimi që gjendet mbi ikonostas: “U përtërinë dhe u pikturuan ikonat e nderuara dhe ikonostasi me kontributin e zotit Papa Panos dhe zotit Kristo Çika, epitropëve, në vitin 1822 gusht 10. Me dorën time të Dhimitrit nga Stariçani”.¹⁴⁷

¹⁴⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 882, faqe 321.

¹⁴⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 158-159.

¹⁴⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 870, faqe 318.

KISHA E SHËN STEFANIT NË DHËRMI

Kisha e “Shën Stefanit” gjendet në juglindje të Dhërmiut. Fillimisht ka qenë një bazilikë trinefëshe, mbi rrënojat e së cilës është ndërtuar paraklisi i sotëm, i cili ka përmasa 21x10 metra. Paraklisi u ngrit duke përdorur pjesë të apsidës së vjetër. Pjesa që ruhet nga kisha e vjetër përbëhet nga muri lindor dhe apsida gjysmëcilindrike. Muratura e apsidës është me gurë lumi të lidhur me llaç gëlqereje. Nëpër fugaturat ndërmjet gurëve gjenden edhe copa tjegullash. Duke u nisur nga struktura e ndërtimit të mureve kjo kishë është ndërtuar gjatë shekujve XI-XII.¹⁴⁸

Mbishkrimi pa datë që gjendet në ikonostasin prej muri të kishës na bën me dije se afresket janë pikturuar prej Mihalit dhe Kostandinit: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i hirshëm në emër të shën Stefanit, dëshmorit të parë dhe me kujdesin e kontribuesit, zotit Pano Gjomara. U pikturua me dorën e Mihalit dhe të Kostandinit nga eparkia e shenjtit të Vellasë”.¹⁴⁹

Në faqen e brendshme të apsidës ruhen dy afreskë, i Shën Stefanit dhe i Shën Mitrit, ndërsa në pjesën veriore të apsidës gjendet Shën Spiridhoni. Teologu Theofan Popa sqaron se sipas radhitjes së shenjtëve nëpër skenat e afreskeve Shën Stefani dhe Shën Mitri nuk duhet të qenë pikturuar në apsidën e kishës. Pas rrënimit të kishës së vjetër nga piratët vendasit nuk e ndërtuan më atë kishë, por rrethuan kungën dhe e mbuluan në formë paraklisi. Prandaj në apsidë kanë pikturuar Shën Stefanin, shenjtin të cilit i kushtohet kisha dhe pranë tij Shën Mitrin, kulti i të cilit ka qenë i përhapur në vend. Ndërsa Shën Spiridhoni është pikturuar shumë më vonë. Shën Stefani paraqitet më këmbë dhe është i veshur me

¹⁴⁸-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave në Shqipëri, Uegen, Tiranë 2004, faqe 155.

¹⁴⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 905, faqe 325.

një stihar të bardhë dhe të gjerë, ndërsa Shën Mitri ruhet vetëm si bust. Duke u nisur nga analiza e dy afreskeve që përmendëm më sipër arrijmë në përfundimin se ata janë pikturuar në dekadat e para të shekullit XIII.¹⁵⁰

KISHA E SHËN GJERGJIT TË KUDHËSIT NË HIMARË

Kisha e “Shën Gjergjit” gjendet në Kudhës të bregdetit të Himarës. Mbi potirin e kishës gjendet një mbishkrim, i cili na bën me dije se Papa Zaho ka qenë prifti i Kuçit. Ai vuajti dënimin për dy vjet në burgun e Janinës në kohën e fushatës së Ali pashë Tepelenës për islamizimin e popullsisë së krishterë. Sapo u lirua nga burgu Papa Zaho shkoi në Kuç dhe e gjeti atë të islamizuar, prandaj u vendos në fshatin Kudhës, ku dorëzoi shpirtin tek Perëndia në vitin 1848. Mbi potirin e shenjtë gjendet mbishkrimi: “Ky potir u bë për këtë kishë, Papa Zaho katundi Kudhës, peshkopi i gjithhirshëm Vonga 1826. Nga dora ime e të përvuajturit, mjeshtër Gjoka”.¹⁵¹

¹⁵⁰-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 150-156.

¹⁵¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 873, faqe 318-319.

MANASTIRET E MITROPOLISË SË GJIROKASTRËS

1. Manastiri i Spilesë, gjendet midis fshatrave Qesarat e Saraqinishtë të Lunxhërisë. Manastiri është themeluar në shekullin XVI. Ka një shpellë në një vend të rrezikshëm, brenda të cilës ndodhej një kishëz e vjetër. Ka marrë këtë emër sepse në shpellën që gjendet në shkëmb është zbuluar një ikonë mrekullibërëse e Shën Marisë. Të ardhurat e manastirit kanë qenë 200 lira në vit. Kisha e manastirit i është kushtuar “Lindjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 8 shtator. Prej manastirit ka shpëtuar në gjendje të mirë vetëm kisha, e cila është e tipit në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 7.40x6.20 metra. Kisha është e suvatuar nga jashtë. Tamburi është tetëfaqësh dhe përfundon me një kornizë të përbërë nga tri radhë tullash në formë dhëmbësh sharre. Apsida është pesëfaqëshe me nike të vogla në secilën faqe mbi të cilat kalon një kornizë tullash në formë dhëmbësh sharre.¹⁵²

Një mbishkrim që gjendet mbi portën e narteksit vërteton se kisha është ndërtuar në vitin 1634, në kohën e peshkopimit të zotit Kalist dhe me kontributin e jeromonakëve Konstandin dhe Joasaf. Gjithashtu afresket e kishës janë pikturuar nga Mihal Linotopi në vitin 1634: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i së mbishenjtës zonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari dhe në kohën e peshkopatit të shumë perëndidashës peshkopit Zotit Kalist dhe me kontributin përpjekjet dhe shpenzimet e fortshënuarve ndër jeromonakët Kostandinit dhe Joasafit dhe të shumënderuarve e shumëfisnikëve arkondëve...u përfundua në muajin gusht 3, me dorën e Mihalit, në vitin 7142 (=1634)”.¹⁵³

¹⁵²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 145-147.

¹⁵³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.559, faqe 234.

Narteksi i kishës është ndërtuar në vitin 1659 prej një piktori anonim dhe me kontributin e arkondit Joan. Në një mbishkrim mbi portën e narteksit thuhet se ky i fundit u ndërtua dhe u pikturua me kontributin e arhondit Joan, kur ishte igumen Zoti Parthen në vitin 1659. “U ndërtua dhe u pikturua ky narteks hyjnor me kontriburin dhe shpenzimet e arkondit shumëfisnik, zotit Joan, në kohën kur ishte igumen zoti Parthen, viti 7167 (=1659)”.¹⁵⁴

Sipas Konstantinos Giakuomis, i cili e ka vizituar kishën në vitin 1997, ikonostasi ndahej në tri zona, më e ulëta prej të cilave mbarte panele të lugëta në formë trëndafil të brendashkruar në rombe tetëbrinjësh, me anët e sipërme dhe të poshtme në formë harku. Në të katërta këndet panelet dekorative mbartin zbukurime floreale. Në zonën e dytë, shtyllat zbukurohen me elementë bimorë, në anët e të cilave formohen bimë kacavjerrëse. Pjesa e epërme e shtyllave kurorëzohet me pseudokapitele. Në pjesën mbi shtyllat bien në sy guaskat e gdhendura, të cilat rrethojnë një lule në qendrën e tyre dhe mbështeten në korniza të skalitura në formë bime kacavjerrëse me lule në qendër. Në panelet e lugëta të ikonostasit janë pikturuar profetët: Isaia, Abakumi, Danieli, Moisiu, Davidi, Solomoni, Jezekieli dhe Jeremia. Pesë nga profetët mbajnë në duar rrotulla të shkruara me tekste që lidhen me Shën Mërinë, ndërsa tre të tjerët me Krishtin.

Në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e igumen jeromonak Kostandinit 1784”.¹⁵⁵ Mbi ikonën e Joan Pagëzorit është shkruar: “Viti 7131 (=1623) prill 1”.¹⁵⁶ Mbi mbulesën prej argjendi të ikonës së Shën Mërisë është shkruar: “Kjo ikonë e shenjtë Spileotisa që gjendet në Spile është

¹⁵⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.564, faqe 236.

¹⁵⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.615, faqe 250.

¹⁵⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.549, faqe 230.

bërë me kontributin e etërve, igumenë Nathanailit dhe Grigorit dhe Kostandinit arkondët të nderuar që kontribuan..zoti Koço dhe zoti Qirici Sikriatas me dorën e Theodhor Linotopasit 1765 korrik 10”.¹⁵⁷ Në një ikonë të Krishtit gjithashtu është shkruar: “Në kohën e igumenit, jeromonak Kostandinit. Me shpenzimet e jeromonak Serafin Korfjatit. Në vitin 1791 qershor 18”.¹⁵⁸ Në një ikonë me shumë shenjtore është shkruar: “Të shërbëtorëve të perëndisë Dhimitër Dedës nga Dhoksati, Vasil Canes nga Stegopulli, më 1828”.¹⁵⁹ Rreth potirit të kishës është shkruar: “Kujto o zot shpirtin e shërbëtorit tënd Gjonit dhe të prindërve të tij Saulit dhe Anthisë”.¹⁶⁰

Mbi një pllakë prej guri në murin e kambanerisë është shkruar: “1796 maj 20. Igumen Damjanoj”.¹⁶¹ Manastiri ka pasur një bibliotekë të pasur. Manastiri i Spilesë është preferuar për grumbullimet e banorëve, të cilët në drejtimin e igumenit diskutonin për çështjet që i shqetësonin. Në një ikonë të dëmtuar të Shën Kollit në shpellën e manastirit është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Tilit të Papa-dukës, nga katundi Hormovë, i Rëzës së Tepelenës në vitin 1788”.¹⁶²

Në kolonën e djathtë në kungë të kishës gjendet një mbishkrim, i cili na bën me dije ditën që ka fjetur igumeni i

¹⁵⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.591, faqe 243.

¹⁵⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 632, faqe 254.

¹⁵⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.704, faqe 271.

¹⁶⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 791, faqe 289.

¹⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 642, faqe 256.

¹⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 625, faqe 253.

manastirit: “Viti 1769 dhjetor 28, ditë e diel, u prehë igumeni i ndjerë zoti Nathanaili, jeromonak, Zoti ta prehë”.¹⁶³ Në muret e manastirit gjendet këto shënime rreth klerikëve që kanë shërbyer në manastir: “1799 Papa Thanasi, famullitar nga Skoreja. Papa Andoni, famullitar në kohën e vitit 1800. 1819 Papa Thanasi nga Poliçani, famullitar i Manastirit të hirshëm të Spilesë. 1821 maj 19. Për kujtim unë Mosku, i biri i Qirixhiut, Muçja nga Poliçani”.¹⁶⁴ Mbi një pllakë të murosur në murin e kishës është shkruar: “1817 Igumen Anthimi”.¹⁶⁵

2. Manastiri i Profetit Ilia në Stegopul gjendet në veri të fshatit Stegopul të Lunxhërisë. Të ardhurat vjetore të tij kanë qenë 100 lira. Kisha i është kushtuar “Profetit Ilia” dhe kremton më 20 korrik. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksit. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë triapsidal dhe ka me përmasa 6,60x3,60 metra. Kisha është ndërtuar në vitin 1624 me kontributin e jeromonakëve Makarios dhe Joakim. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim mbi portën e narteksit të kishës: “Ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar është i profetit të lavdëruar shën Lli Thesbitit, ngritur dhe ndërtuar prej themeli me kontributin, përpjekjen dhe shpenzimet e jeromonakëve Makarit dhe Joakimit-1624 viti. Më vonë, në vitin 1672 u stolis dhe u zbukurua nga arkondi i shumënderuar, zoti Guma dha ati i tij Qiriaku dhe bashkëshortja e arkondit, për shpëtimin e shpirtit të tij dhe në kohën kur ishte igumen i shumënderuari jeromonak Grigori. Në kohën e të shumëhërshmit ish-mitropolitit të Janinës, zotit Kalinikut dhe të vëllëzërve Dhimitrit dhe Gjergjit. Në muajin maj 14-1671”.¹⁶⁶

¹⁶³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.594, faqe 244.

¹⁶⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 652, faqe 258-259.

¹⁶⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 692, faqe 268.

¹⁶⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.550, faqe 230.

Një mbishkrim tjetër që gjendet mbi portën e brendshme bën fjalë për pikturimin e kishës prej Kostandin Linotopit dhe nxënësit të tij Nikollës. Kisha ka përfunduar së pikturuari më 19 qershor të vitit 1653. Mbi portën perëndimore brenda naosit të kishës është shkruar: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i profetit të shenjtë të lavdëruar dhe perëndidashës Ilia Thesbitit me përpjekjet, mundimet dhe shpenzimet e shumënderuarit, zotit Joakim dhe bashkë me mua vëllezërit jeromonakët Danieli, Grigori, Kalisti. Kontribuan arkondët shumë fisnikë, zoti Gjergji i Nanit, Jan Dragoja nga katundi Sarakinishta dhe u pikturua me dorën time të Kostandinit birit të Mihalit nga katundi Linotopi dhe nxënësit e tij Nikollës. Përfundoi në muajin qershor 19, prej Krishtit 1653, prej Adamit 7161”.¹⁶⁷ Mbi një mbishkrim që gjendet në Ungjillin e Kishës së Profetit Ilia lexojmë: “I Dhionis Katilianit 1554”.¹⁶⁸

3. Manastiri i Profetit Ilia në Jorgucat është themeluar në shekullin XII dhe është nga më të vjetrit prej manastireve të Dropullit. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 400 lira turke. Manastiri feston më 20 korrik dhe ka pasur 800 hektarë tokë e luadhe. Kisha përbëhet nga naosi, narteksit dhe hajati. Naosi është njënefësh me tri apside dhe ka përmasa të brendshme 5.40x3.60 metra. Kisha është e ndërtuar me gurë shtresorë me radhitje të rregullt dhe përfundon me një kornizë prej gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.¹⁶⁹

Nga një mbishkrim në portën e brendshme vërtetohet se kisha e manastirit të “Shën Ilias” është ndërtuar dhe pikturuar më parë në vitin 1588 nga dora e murgut Niqifor: “Viti 7092 (=1588) u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i profet Ilisë me ¹⁶⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.561, faqe 235.

¹⁶⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë, 1998, nr. 524, faqe 221.

¹⁶⁹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 106-108.

dorën e murgut Niqiforit, në kohën kur ishte igumen zoti..”¹⁷⁰ Afresket u pikturuan në vitin 1617 nga dora e Mihal Linotopit nga Kosturi. Këtë e vërteton mbishkrimi në portën perëndimore të kishës: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull i gjithnderuar dhe narteks në kohën kur ishte igumen ndër oshënarë jeromonak zoti Simeoni, viti 7125 (=1617), dhe me dorën e mëkatarit Mihail nga katundi Linotopi i Kosturit”.¹⁷¹

Diçka interesante në këtë manastir është së në Blatën e Hyjshme të naosit përmenden këta emra hierarkësh: Joakim, Neofit, Jeremi, Mathe, Kalist, Gavril, Rafael dhe në vijim janë rreth 60 emra hieromonakësh. Manastiri ka pasur lipsanë shenjtorësh të: Shën Ermolaut, Shën Harallambit, Shën Prokopit, Shën Pandejmonit etj. Manastiri i “Profetit Ilia” mbështeste shkollat e zonës me 50 lira çdo muaj.¹⁷²

4. Manastiri i Drianos në Zervat ka qenë një nga më të mëdhenjtë në krahinën e Dropullit. Quhet i Drianos nga lisat e shumtë që mbullonin zonën përreth. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Shën Mërisë” dhe kremton më 15 gusht. Manastiri ka qenë në gjendje të mirë ekonomike. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 300 lira turke, gjithashtu zotëronte 600 hektarë tokë bujqësore. Këto të ardhura dhe toka siguroheshin nëpërmjet dhurimeve të ndryshme që bëheshin në atë kohë.

Mbi prothesin në kungën e kishës është shkruar: “Për prift Janin, Nikollën dhe Zafiren 1715, e ka dhuruar (afiorosë) protopapë, zoti Papa Jani, ara 35 dynym dhe i shkroi emrat e tyre në pllakë, dhe kushdo që ti shesi dhe të mos i përmendi të ketë

¹⁷⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.530, faqe 223.

¹⁷¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.540, faqe 226-227.

¹⁷²-Mihail G. Triou, H Eklisia sto Anatoliko Iliriko kai tin Albania, Thesaloniki 1999, selidha 90-92

mallkimin e Shën Mërisë dhe ekskomunikimin nga ana e peshkopit, Amin”.¹⁷³ Kisha ka formë kryqi me kupolë me përmasa të brendshme 7.20x5.80 metra. Kisha përbëhet nga naosi, narteksti dhe hajati. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë. Hajati gjendet në anën perëndimore të kishës dhe është shtuar më vonë. Çatia e kishës është e mbuluar me rrasa guri. Hyrja për në manastir bëhet nëpërmjet portës, e cila është punuar me gurë të gdhendur. Në anën lindore të kishës gjendet kambaneria. Ndërtesat e manastirit janë ndërtuar me gurë shtresorë të vendosur në radhë të rregullta dhe përmbajnë elementë dekorativë.¹⁷⁴

Kisha e “Fjetjes së Shën Marisë” u ndërtua në vitin 1569. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet në krye të kolonës së mesit në hyrje të kishës: “Viti 7077 (=1569) u ndërtuan kolonat me dorën e murgut Kalist”.¹⁷⁵ Gjithashtu në hyrje të kishës gjendet mbishkrimi: “Jeromonak Neofiti mëkatar si asnjë njeri 7136 (=1628)”.¹⁷⁶

Ambienti i altarit ndahet me një ikonostas prej druri. Në një mbishkrim pa datë që gjendet në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Lutje e jeromonak Josifit”.¹⁷⁷ Mbi një mbulesë argjendi të ikonës së Shën Mërisë është shkruar: “Jeromonak Partheni 1777”.¹⁷⁸ Gjithashtu mbi mbulesën e argjendit të kësaj ikone të Shën Mërisë kemi këtë mbishkrim: “U vesh me

¹⁷³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.575, faqe 239.

¹⁷⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 110-112.

¹⁷⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 526, faqe 222.

¹⁷⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.543, faqe 228.

¹⁷⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.784, faqe 288.

¹⁷⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.608, faqe 247.

argjend kjo ikonë e shenjtë me shpenzimet dhe harxhet e jeromonak Parthenit”.¹⁷⁹ Narteksi është pikturuar në vitin 1583. Kuzhina e manastirit është ndërtuar në vitin 1775. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim i gdhendur një gur mbi portën e kuzhinës.¹⁸⁰ Në faqen e jashtme të apsidës së kishës është gdhendur viti 1656.¹⁸¹

Një mbishkrim me interes është ai që gjendet në anën e djathtë të kolonës së mesit të kishës, i cili bën fjalë për një borxh që kishte marrë manastiri: “Në vitin 1650 erdhëm nga Moldavia, unë Papa Dositheu, igumeni i shën Gjergjit dhe Papa Dionisi dhe u malë borxhin 4 mijë aspra. Dhe kush të marrë borxh tani e tutje të jetë i ekskomunikuar prej atit dh ebirit dhe shpirtit të shenjtë, të ketë dhe shën Mërinë kundërshtarë dhe luftuese. Amin”.¹⁸²

Nëpër mbishkrimet e ndryshme që gjenden në këtë kishë kemi emrat e prftërinjve, dhiakonëve si dhe disa nga datat që janë dorëzuar. Një mbishkrim që gjendet në të hyrë të kishës në të djathtë të shtyllës së mesit na bën me dije se më 31 maj të vitit 1629 është dorëzuar në dhjakon Jani: “Viti 7136 (=1628) u dorëzua dhiakon Jani, maj 31 viti 7137 (=1629)”.¹⁸³ Gjithashtu një mbishkrim tjetër, i cili gjendet në anën e djathtë të kolonës së mesit në eksonarteksin e kishës bën fjalë se në janar të vitit 1630 është dorëzuar Papa Simoni: “U dorëzua Papa Simoni në muajin janar, viti 7138 (=1630)”.¹⁸⁴ Në anën e djathtë të kolonës së mesit

¹⁷⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.800, faqe 291.

¹⁸⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.602, faqe 246.

¹⁸¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.562, faqe 235.

¹⁸²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.560, faqe 234.

¹⁸³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 555, faqe 233.

¹⁸⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 557, faqe 233.

është shkruar: “Ditën e festës së Ipapandisë unë u bëra dhiakon 1675”.¹⁸⁵ Gjithashtu po në kolonë gjendet mbishkrimi: “Danieli, jeromonak dhe mëkatari 1702”.¹⁸⁶ Në shtyllën e majtë të kungës është shkruar: “Jeromonak Metodi Korfjati 1796”.¹⁸⁷ Mbi shtyllën e majtë të kungës gjithashtu është shkruar: “1800 Jeromonak Grigori”.¹⁸⁸ Në anën e djathtë të kolonës së mesit është shkruar: “Unë Jani u bëra jerodhiakon viti 1804 mars 11. Jeromonak Dionisi, jeromonak Joakimi, jeromonak Zaharia, jeromonak Anania, jeromonak Krisanthi, jeromonak Beniamin”.¹⁸⁹

Nëpër të shenjtat e kishës gjenden mbishkrime të ndryshme, të cilat përmendin dhuruesin dhe datën kur janë dhuruar. Rreth bazamentit të një potiri të larë me ar është shkruar: “Cari i shumëdevotshëm i gjithë Moskosisë Mihail Theodoroçki i dhurova diskopotirin Manastirit të nderuar të Fjetjes së Hyj lindëses në vendin e quajtur Driano, për shpëtimin e shpirtit tim”.¹⁹⁰ Në anën e djathtë të kolonës së mesit në eksonarteks gjendet një mbishkrim: “U përfundua kryqi i nderuar në muajin gusht 16 me shpenzimet e të gjithirshmit Mitropolitit të Beratit, zotit Elefther dhe me dorën time të Nikollës, nga katundi Fterë 7138 (=1629)”.¹⁹¹ Mbi një antimis të kishës është shkruar: “U meshua dhe u shenjtërua prej

¹⁸⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 571, faqe 238.

¹⁸⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 573, faqe 238-239.

¹⁸⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 645, faqe 257.

¹⁸⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 655, faqe 259-260.

¹⁸⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 665, faqe 262.

¹⁹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.785, faqe 288.

¹⁹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.558, faqe 233-234.

të gjithhirshmit, mitropolitit të Fortshenjtes Mitropolisë...tzave? Zotit, zotit Gedeon, në kohën kur ishte i gjithhirshmi, zoti Doisteu. Me dorën time të Apostolit nga Athina. Viti prej Krishtit 1659, në muajin mars 25”.¹⁹² Rreth buzëve të një kryqi prej argjendi gjendet mbishkrimi: “Ky kryq hyjnor dhe i gjithnderuar u bë me shpenzimet e Theoklitit të mëparshëm dhe ia dhuruan kësaj kishe të Fjetjes së Shën Mërisë së Drianos, për kujtim të tij dhe të prindërve, prift Qirjakut dhe Kristos 1672”.¹⁹³ Gjithashtu mbi një kryq të vogël është shkruar: “Me shpenzimet e shërbëtores së perëndisë, Anastasias u përfundua kryqi i nderuar 1685”.¹⁹⁴



Në një kandil të madh prej argjendei gjendet mbishkrimi: “Jeromonak Damjanoj në Hyjë lindësen e Drianos dhe Anastasi i Papajt 1739”.¹⁹⁵ Mbi një mbulesë lipsanash gjendet mbishkrimi: “I shën Minajt të Kalkeladhit, në vitin 1728 është i së mbishenjtës

¹⁹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.565, faqe 236.

¹⁹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.570, faqe 238.

¹⁹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 572, faqe 238.

¹⁹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 582, faqe 240-241.

Hyjllindëse me kontributin e jeromonak Meletit, me dorën e Jan Deshos”.¹⁹⁶ Gjithashtu mbi një mbulesë prej lipsanësh argjendi është shkruar: “Lipsani i Minajt të Kaliqeladhit në vitin 1734 Jan Kiriçoredhos Saraqinishta 1734. Me kontributin e Ananiut, jeromonakut të Dhrinopojës”.¹⁹⁷ Rreth bazamentit të një triqeri gjendet mbishkrimi: “Me kontributin dhe shpenzimet e jeromonak Gabrielit 1764. Nga Manastiri Zervat”.¹⁹⁸ Mbi bazamentin e një thimiatori është shkruar emri i gdhendësit Nedhio: “Jon Brikoja e bëri thimiatorin dhe ia dhuroi (afierosi) atë shën Thanasit viti 1651. Nedhio argjendari 1771”.¹⁹⁹ Rreth bazamentit të një thimiatori prej argjendi është shkruar: “Stamati, shërbëtor i Krishtit për babën Stas Krathes i dhuroi thimiatorin Shën Mërisë”.²⁰⁰ Mbi një kuti lipsanash është shkruar: “Kjo kuti e Manastirit të shenjtë e të hirshëm të së mbishenjtës Hyjllindëses të quajtur Driano, eparhia e Gjirokastrës, igumen Jakovi”.²⁰¹ Mbi një faqe të kamalecit prej druri të psaltit është punuar me petëza sadeфи: “I së mbishenjtës Hyjllindëses / Jeromonak Avreki”.²⁰² Ndërsa në faqen tjetër të kamalecit është shkruar: “Ziso Dhimo dhe Qirici Qiraca”.²⁰³

¹⁹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 576, faqe 239.

¹⁹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 578, faqe 240.

¹⁹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 590, faqe 243.

¹⁹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 595, faqe 244.

²⁰⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 783, faqe 287-288.

²⁰¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 797, faqe 290.

²⁰²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 772, faqe 284.

²⁰³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.773, faqe 284-285.

Gjithashtu në faqen e kamalecit të psalltit kemi këtë mbishkrim: “Dora e petro Postenalit”.²⁰⁴

5. Manastiri i Pepelit gjendet mbi kodrën e fshatit Pepel. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Triadhës”. Manastiri ka pasur të ardhura vjetore 500 lira. Pjesa më e madhe e të ardhurave është siguruar nga ndihmat vullnetare të besimtarëve të dioqezës. Kisha është ndërtuar më 1750. Kjo vërtetohet nga mbishkrimi i gjendur mbi një pllakë guri mbi murin lindor jashtë kishës: “1750 Theofili-Trinia e Shënjtë”.²⁰⁵ Theofili mund të ketë qenë kryemjeshtri që ka ndërtuar kishën. Nga manastiri kanë mbetur kisha dhe dy konakë. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi ka formë drejtkëndëshi dhe ka përmasa të brendshme 7.85x5.90 metra. Çatia e kishës është e mbuluar me rrasa guri.



Muratura është me gurë shtresorë dhe mbyllet me një kornizë guri. Ndërtesa që gjendet në anën jugore të manastirit është dykatëshe dhe përbëhet nga hajati i hapur me një arkadë prej guri në katin përdhes, si dhe çardhakun me shtylla dryri në

²⁰⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.775, faqe 285.

²⁰⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.583, faqe 241.

katin e sipërm. Ndërtesa tjetër është dykatëshe e ndërtuar në vitin 1843. Nëpërmjet hajatit të saj bëhet hyrja për në manastir. Porta hyrëse përbëhet nga një hark i punuar me gurë të gdhendur. Blloqet e gurit janë me motive dekorative të gdhendura në relief të cekët. Sheshi përpara portës së manastirit është i shkruar me kalldrëm.²⁰⁶

Në një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore të naosit vërtetojmë se kisha e manastirit të Shën Triadhës është pikturuar në vitin 1754 prej ikonografit Adam nga Theotoqi: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i Trinisë së shenjtë të njëqenshme dhe jëtëbërëse dhe së pandarë, dhe me shpenzimet mundimet e gjithëoshënarit dhe igumenit jeromonak Filotheut, në kohën e episkopatit të peshkopit të Drinopojës Mitrofanit në vitin sundimtar 1754. Me dorën time të Adamit të përvuajtur e mëkatar, nga katundi Theotoqi”.²⁰⁷

Ambienti i altarit ndahet me një ikonostas druri. Mbi mbulesën prej argjendi të ikonës së Shën Triadhës është shkruar: “Kjo ikonë e Shën Triadhës, nga katundi Pepel i Dropullit është bërë me kontributin dhe ndihmën e zotit Qirici Dhiamandit nga Gjyrokastira, në kohën kur ishte igumen zoti Zaharia, me dorën e Nikollë Pondiqit dhe birit të tij Kostandinin nga Kalariti 1815, mars 5”.²⁰⁸ Në ikonën e Shën Mëhillit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: “Me kontributin e të lavdishmit...Hasan Lil..(në) ndihmë 1878 mahalla Dunavaces”.²⁰⁹ Sipas Theofan Popës mëhalla Dunavat gjendet në Gjyrokastër. Pranë portretit të igumenit mbi pjesën jugore të murit perëndimor të kishës është shkruar:

²⁰⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 135-139.

²⁰⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.584, faqe 241.

²⁰⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 686, faqe 267.

²⁰⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.763, faqe 282-283.

“Jeromonak Filotheu, igumeni i këtij manastiri”.²¹⁰ Mbi hyrjen e narteksit gjendet kambaneria. Mbi një gur të murosur në murin e kambanerisë është shkruar viti 1821.²¹¹

6. Manastiri i Koshovicës gjendet në zonën e Dropullit. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 15 gusht. Manastiri siguron të ardhura vjetore 40 lira. Kisha është në formë kryqi me kupolë, triapsidal dhe ka përmasa të brendshme 6.50x4.50 metra. Narteksi gjendet në anën perëndimore të naosit. Muratura e kishës është me gurë shtresorë dhe përfundon me një kornizë të thjeshtë guri. Godinat e manastirit qarkojnë kishën në anën veriore dhe perëndimore. Godina që gjendet në anën veriore është dykatëshe. Kati i sipërm përdorej për banim, ndërsa kati i poshtëm përdorej si katua.²¹² Kisha e “Fjetjes së Hyjlindëses” daton në vitin 1669. Kjo datë gjendet në ikonën “Fjetja e Shën Marisë” dhe në pikturën murale të kubesë së kishës.²¹³

7. Manastiri i Kryeengjëjve gjendet në fshatin Derviçan të Dropullit. Kisha katedrale e manastirit ruhet në gjendje shumë të mirë. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 100 lira. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë, triapsidal dhe ka përmasa të brendshme 6.90x3.80 metra. Narteksi i kishës është dykatësh. Kambaneria ngrihet mbi frontonin e murit perëndimor të kishës. Muratura e ndërtimit të kishës është me gurë shtresorë të vendosur në radhë të rregullta dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Çatia e kishës mbulohet me rrasa

²¹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 777, faqe 285.

²¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 700, faqe 270.

²¹²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 126-127.

²¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, N. 569, faqe 238.

guri.²¹⁴ Në hyrje të kishës së manastirit paraqitet themeluesi bashkë me mbishkrimin përkatës. Pranë portretit të igumen Makarit mbi portën e naosit të kishës është shkruar: “Ky duke qenë kujdestar në 1846 e deri sot dhe me anë të kujdesit të tij e lartësoi këtë kishë të shenjtë nga e mosqena në të qenme dhe e pajisi atë me pasuri të tundshme e të patundshme, dhe ata që e vështrojnë lutuni dhe ndjeni atë. 1869 qershor 21. Dora e Z.M.G. katund S. Igumen Arkimandrit Makari”.²¹⁵ Mbishkrimi që gjendet mbi portën veriore të manastirit tregon kohën e ndërtimit të mureve rrethuese: “1856 shtator 16”.²¹⁶



Kisha e manastirit ka përfunduar së pikturuar më 3 qershor të vitit 1869 prej Zisi Mihalit dhe e Gjergjit nga katundi Samarinë. Kjo vërtetohet prej një mbishkrimi i pikturuar në apsidë në kungën e kishës: “Nga igumen arkimandrit Makari i Manastirit të hirshëm të Taksiarkëve dhe me shpenzimet e të ndierit Gjergj Ndrichos

²¹⁴-Pirro Thomo, *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut*, Tiranë 1998, faqe 131-134.

²¹⁵-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 718, faqe 274.

²¹⁶-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 727, faqe 276.

Derviçanasit, 1869 qershor 3. Dora e Zisi Mihalit dhe e Gjergjit nga katundi Samarinë”.²¹⁷ Mbi ikonën e Shën Gjergjit të Janinës është shkruar: “1864 nëntor 7. Me dorën e A. Dham (janë) Kristo Samaritanit”.²¹⁸ Mbi portën e narteksit të kishës është shkruar: “U pikturua dhe u stolis ky narteks i shenjtë i tempullit të hirshëm dhe të gjithënderuar të kryeengjëlve të gjithmëdhenj Mihaelit dhe Gabrielit, me kontributin e gjithoshënarit igumenit zotit Kir Joaqim”.²¹⁹

Muret e manstirit janë rrënuar, ndërsa qelitë e murgjve janë në gjendje të mirë. Në afërsi të manstirit gjendet paraklisi i “Burimit Jetëdhënës”. Në manastirin e “Kryeengjëlve” në Derviçan u celebrua liturgjia e parë pas persekutimit në Krishtlindjet e vitit 1990. Liturgjinë hyjnore e mbajti atë Mihal Dako, i cili ishte dorëzuar në gradën priftërore në vitin 1959 prej Mitropolitit të Gjirokastrës Damianit. Atë Mihal Dako i përkiste brezit të klerikëve që mbijetuan pas persekutimit ateist. Ndonëse në moshë të thyer ai iu përkushtua tërësisht shërbesave fetare derisa dorëzoi shpirtin te Perëndia më 9 mars të vitit 1998.


8. Manastiri i Ravenës gjendet në fshatin Goranxi. Manastiri i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindësës” dhe kremton më 15 gusht. Të ardhurat vjetore të manstirit kanë qenë 150 lira. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe eksonarteksi. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë triapsidal dhe ka përmasa të brendshme 6.80x5.60 metra. Kisha është ndërtuar me gurë shtresorë të vendosur në mënyrë të rregullt. Tamburi i kishës është tetëfaqësh dhe i zbukuruar. Gjithashtu edhe korniza nën çati përbëhet me radhë në formë dhëmbësh të alternuara me radhë të

²¹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 743, faqe 279.

²¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 740, faqe 278.

²¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 786, faqe 288.

drejta.²²⁰ Kisha është ndërtuar në vitin 1600 prej hieromonakut Kristofor. Këtë e vërteton një mbishkrim i gdhendur në gur mbi portën perëndimore brenda narteksit: “Mbretëreshë e të gjithë profetëve, e quajtur fidanë e Joakimit dhe Anës shterpë, që u bëre e denjë të dëgjoje zërin e engjëllit që thoshte: gëzohu ti o e gëzuar prej gjithpushtetësit, vajzë, virgjëreshë dhe nënë, prano lutjen prej meje shërbëtorit tënd jeromonak Kristoforit, që ndërtoi tempullin tënd me dëshirë, viti i lindjes të Krishtit 1600”.²²¹



Mbi apsidën gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Hjokë Quriakut, nga katundi Mashkullorë”.²²² Mbi një vulë prej druri është shkruar: “Vula e së mbishenjtës Hyjlindëse, e mbiquajtur e ravenias, mbi katundin Goranxi 1622”.²²³

²⁰⁰-Pirro Thomo, *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut*, Tiranë 1998, faqe 120-122.

²²¹-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 533, faqe 224.

²²²-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 545, faqe 229.

²²³-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 546, faqe 229.

9. Manastiri i Ungjillëzimit në Vanishtë të Dropullit.

Kisha e manastirit i është kushtuar “Ungjillëzimit të Hyjlindëses” dhe kremton më 25 mars. Kisha e “Ungjillëzimit” është e vendosur në qendër të manastirit, ndërsa konakët gjenden në anën jugure. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë triapsidal dhe ka përmasa të brendshme 6.60x3.70 metra. Kisha është e ndërtuar me gurë shtresorë me vendosje të rregullt. Në anën perëndimore gjendet hajati, i cili mbulohet me çati druri pa tavan. Tamburi i kishës është tetëfaqësh dhe i zbukuruar. Muratura e tamburit është me radhë gurësh të alternuar me radhë tullash dhe përfundon me një kornizë të përbërë prej katër radhë tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Apsida kryesore është trefaqëshe dhe përmban nike me harqe tullash.²²⁴

Kisha e “Ungjillëzimit” është e ndërtuar në vitin 1582. Këtë e vërteton mbishkrimi i gdhendur mbi një tullë të murosur në apsidë jashtë kishës.²²⁵ Mbi portën perëndimore, në narteksin e kishës gjendet ky mbishkrim: “U pikturua dhe u stolis kjo shtëpi e hyjshme dhe e gjithënderuar e së mbishenjtës, së lavdëruar dhe gjithmonë virgjëreshës mari, me shpenzimet e zotit Mihal Dhimitrit nga qyteti Gjirokastër, në kohën e peshkopatit të peshkopit shumë perëndidashës të Drinopojës, zotit Mitrofan, në kohën kur ishte igumen jeromonak Joakimi dhe jeromonak Nikodhimi, jeromonak Danieli, jerodhiakon Niqifori, me dorën time të mëkatar Janit në katundin Qestorat-1758”.²²⁶ Sipas mbishkrimit kuptojmë se narteksi i kishës është pikturuar fillimisht prej ikonograf Janit nga katundi Qestorat në vitin 1758, por afresket e tij nuk shquhen për cilësi të lartë artistike, prandaj afresket e dy zonave të para të

²²⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 114-115.

²²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 527, faqe 222.

²²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 586, faqe 242.

narteksit i ka pikturuar Mihaili nga Linotopi në vitin 1617. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi portën e narteksit të kishës: “...në kohën e peshkopatit shumë perëndidashësit Mattheut të Janinës, pikturuar me dorën time të mëkatarit Mihail nga Linotopi i Kosturit, viti 7125 (=1617), Janiqi Dhakon”.²²⁷ Gjithashtu Mihail Linotopi ka realizuar skenën “Gjyqi i fundit” në murin lindor të pjesës së eksonarteksit. Në kthinën këndore ai ka realizuar me mjeshtëri skenën “Tallja”, ku figura kryesore është Krishti, i cili paraqitet i veshur me mantel dhe mbi kryet i kanë vënë një kurorë me gjemba. Pranë tij paraqiten çifutët duke e tallur dhe përbri Krishtit paraqitet një ndërtesë me ballinë, e cila tregon pallatin e Pilatit. Gjashtë muzikantë të ndarë tre e nga tre luajnë në daulle, lahutë, llautë, zumare dhe llullak. Përballë Krishtit qëndrojnë dy djem, të cilët i përulen Atij në shenjë nderimi, ndërsa dy valltarë janë duke kërcyer duke tundur shaminë. Në pikturimin e kishës së manastirit të Vanishtës, Mihail Linotopi ka përdorur karakteristikat e shkollës epirote.²²⁸

10. Manastiri i Dhuvjanit gjendet në jugperëndim të fshatit Dhuvjan të Dropullit. Manastiri është ndërtuar më vitin 1089 prej igumenit Gadiqi. Manastri feston më 14 korrik, në të kremten e Shën Julitës, sepse në manastir gjendej kafka e Shën Julitës. Kisha e “Shën Qirjakut dhe e Julitës” ka formë kryqi me kupolë të përmasave 10.60x6.50 metra dhe është ndërtuar në vitin 1588. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi gurin arkitra të portës perëndimore të narteksit të kishës:” “Viti 7096 (=1588), qershor 1”.²²⁹ Gjithashtu mbi portën e narteksit të kishës

²²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 542, faqe 228.

²²⁸-Kostandinos Jakumis, Veprimtaria e piktorëve nga Linotopi në viset e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 211-212.

²²⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 531, faqe 223.

gjendet një mbishkrim, i cili tregon se kisha është pikturuar në vitin 1595: “U pikturua piktura e hyjshme dhe e gjithënderuar e narteksit me kontributin dhe ndihmën e gjithoshënarit, jeromonakut, zotit Jakov dhe Zotos, vëllait të tij nga Kardhiqi, në vitin 7130 (=1595). Skenat e pikturuara janë përtërirë nën kujdesin e igumen Gjerasimit dhe nën mbikqyrjen e kujdestarit, Papa Margaritit më 1873-janar 10”.²³⁰ Mbi ikonën e Shën Joan Pagëzorit është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, jeromonak Nikitës 1736”.²³¹ Rreth një potiri të kishës është shkruar: “Këtë potir e ka dhuruar Gjushku dhe gruaja Kiraca, në manastirin e shën Mërisë të Dhuvjanit 1660”.²³²

Konakët e manastirit janë ndërtuar më vonë se kisha dhe rrethojë kishën nga anët veriore, perëndimore dhe jugore. Ata janë dykatësh dhe vetëm kati i sipërm banohej nga murgjit, ndërsa kati i poshtëm përdorej për katua. Në qoshen perëndimore të kishës gjendet kambanorja. Afresket e manastirit datojnë në vitin 1594. Prej igumenëve të manastirit mund të përmendim: Ambrozin (1582), Parthenin (1640), atë Qirjakon (1729), Nikitën (1736), atë Athanasin (1748). Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 180 lira turke. Manastiri i Dhuvjanit ka mbështetur popullsinë e fshatrave përreth. Për shkollat e Dhuvjanit ofronte çdo muaj 20 lira turke. Që prej vitit 1858 manastiri ka pasur një punishte për prodhimin e basmave. Manastiri ka shërbyer edhe si institucion arsimor pasi nga viti 1858 deri më 1885 aty ka qenë shkolla e parë femërore, ku përveç shkrimit dhe këndimit vazhonte u mësohej qëndistaria. Për vlerat artistike që ka manastiri është shpallur monument kulture. Në 14 korrik të vitit 2006 një banor i fshatit

²³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 532, faqe 223-224.

²³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 580, faqe 240.

²³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 566, faqe 236.

Vllasi Papavllasi duke gërmuar në kopështin e tij gjeti një kuti lipsanësh prej argjendi me madhësi 30 x 20 cm. Kutia e lipsanëve në mes ka një kryq. Duke e hapur gjenden emrat e gjashtë shenjtorëve si dhe vendet ku qenë ruajtur copëza nga lipsanet e tyre. Qenë gdhendur emrat e Shën Julitës, Shën Theodor Stratilatit, Shën Joan Gojëartit, Shën Harallambit, Shën Elefterit dhe të Shën Polikorpit. Poshtë emrave të tre shenjtorëve të parë gjenden copëza të vogla lipsanesh rreth 2 deri më 3 centimetra të fiksuara, ndërsa vendet e lipsaneve të tre shenjtorëve të tjerë janë bosh. Kutinë me lipsane e ka fshehur prifti i fshatit papa Vllasi në vitin 1967, atëhere kur u prishën kishat. Në vitin 1997 nga manastiri u vodhën disa ikona me vlerë si dhe kafka e Shën Julitës.²³³ Në vitin 2003 manastiri është restauruar me fondet e Kishës Ortodokse, të cilat kapën shifrat rreth 45.500 dollarë. Fillimisht u shtrua rruga që të shpie në manastir dhe më pas u bënë ndërhyrje restauruese.

11. Manastiri i Cepos në afërsi të fshatit Kardhiq të Gjirokastrës është themeluar së pari në kohën e perandorit Justinian. Më vonë më 1799 manastiri u rindërtua prej Andronik Komnenit (1183-1185). Manastiri në kohën e lulëzimit të tij ka pasur toka, vreshta, pyje, luadhe etj. Gjithashtu ka pasur lipsanë shenjtorësh dhe veshje klerikësh të stilit rus. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 250 lira turke. Për një kohë (1185-1318) ka qenë qendër e mitropolisë së Gjirokastrës. Manastiri i është kushtuar Shën Kollit dhe feston më 6 dhjetor. Kisha ka përmasa 25x17 metra. Në një pllakë guri ranor të murosur në anën e majtë të portës jugore gjendet ky mbishkrim: “U rindërtua ky tempull hyjnor kur ishte peshkop Gabrieli, ndihma ka qenë e kufitarëve të Humelicës, Mashkullorës, Manastirit, esnafit të Kardhiqit 1799, me dorën e Igisit (ose Paisit) “. ²³⁴

²³³-Engjëll Serjani, Ethet mistike të një zbulimi, Shqip, 4 gusht 2007, faqe 42-43.

²³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 651, faqe 258.

Igumenët e manastirit kanë qenë: Nektari, Joasafi (1500), Stergios (1776), Krisanthi (1788), Gavriili (1789), Jeremia (1809), Aleksi (1818), Grigori (1824), Neofiti (1857). Manastiri i Cepos ka qenë i respektueshëm nga popullsia vendase sepse aty janë bërë shumë shërime. Të sëmurët vinin nga vise të ndryshme në ditën e panairit dhe laheshin me ujin që buronte prej manastirit. Në jugperëndim të manastirit kanë qenë skitet e asketëve.



Në një kabanë është shkruar: “Dhuratë e një të krishteri, nga Epiri në Manastirin e shën Kollit, në Gurin e epërm të Kardhiqit. Mjeshtri që e bëri Harallamb Mikeleti 1804”²³⁵

12. Manastiri i Shën Thanasit është afër fshatit Poliçan të Pogonit dhe është themeluar në shekullin IV. Manastiri gjendet rreth 15 minuta duke ecur më këmbë në pjesën veriore të fshatit. Është metoq i një manastiri tjetër më të vjetër, i “Shën Marisë së Bordecit” dhe i është kushtuar Shën Thanasit. Të ardhurat vjetore kanë qenë 50 lira. Kisha është në formë kryqi me kupolë të ndërtuar përpara vitit 1601. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje dhe përfundon me një kornizë tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Apsida është e ndërtuar me gurë shmërçi, ndërsa tamburi i kishës është tetëfaqësh. Kisha ka gjatësi

²³⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 664, faqe 262.

12 metra dhe gjerësi 8 metra. Kubeja e kishës është ndërtuar me tulla dhe ka tetë dritare, prej të cilave vetëm katër janë për ndriçim. Kubeja mbështetet në katër shtylla të lidhura me harqe. Manastiri ka pasur një bibliotekë të pasur me dorëshkrime, e cila ka funksionuar deri në vitin 1880.²³⁶ Në një mbishkrim që gjendet në afreskun e Shën Mërisë është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, jeromonak Dhamaskinoit viti 7109 (=1601)”.²³⁷ Ky mbishkrim vërteton se kisha u pikturua në vitin 1601 nga jeromonaku Dhamaskin, prandaj ajo duhet të jetë ndërtuar përpara këtij viti. Në apsidën e kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Dhimitër Rota dhe e shoqja”.²³⁸ Ikonastasi është prej druri pa ndonjë rëndësi të veçantë. Në ikonastasin e kishës është shkruar: “Lufto o zot, ata që duan shkretimin e këtij manastiri të hirshëm, në vitin shpëtimtar 1628 maj 22”.²³⁹ Gjithashtu edhe ikonat janë punuar me motive popullore. E veçanta e këtij manastiri është se deri në vitin 1945 në hieroren e tij kanë qenë lipsanet e Sofianoit të Pogonit, i cili ka fjetur më 26 nëntor të vitit 1711. Lipsani i tij u varros në hieroren e kishës së manastirit. Igumeni i manastirit, hieromonaku Krisant, porositi një arkë prej argjendi, ku u vendosën lipsanet e shenjtit. Rreth një kusie prej bakri është shkruar: “Manastiri i Poliçanit 1786”.²⁴⁰ Mbi një kryq prej argjendi është shkruar: “Igumen Haxhi Anthimi 91856). Me dorën e Athanas Gadu”.²⁴¹

²³⁶-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Tiranë 1996, faqe 6.

²³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 534, faqe 224-225.

²³⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 770, faqe 284.

²³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 554, faqe 232.

²⁴⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 621, faqe 252.

²⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 728, faqe 276.

13. Manastiri i Shën Sotirit të Çatistës është larg gjysmë ore në perëndim të fshatit Çatistë të Pogonit. Të ardhurat vjetore kanë qenë 100 lira. Manastiri i është kushtuar “Shpërftyrimin të Krishtit” ose “Shën Sotirit”. Vendi ku është ngritur manastiri ka qenë kullotë në pronësinë e një familjeje vllahe. Dhimitër Papadhati i ka falur manastirit shumë toka dhe njihet si ktitor. Data e themelimit të manastirit mendohet të jetë viti 1520. Kisha e manastirit është e ndërtuar me gurë të bardhë dhe ka përmasat 16 x 3 metra. Dyshemeja e kishës është e shtruar me pllaka guri, ndërsa çatia është e mbuluar me rasa guri.²⁴² Kisha e manastirit është njënefëshe me tre apside dhe është ndërtuar në vitin 1626. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim të gdhendur portën e narteksit: “U ndërtua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i perëndisë dhe shpëtimtarit tonë, Jezu Krisht me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të gjithhirshmëve, mitropolitëve Jakovit të Zihnonit, Daniel Nevrokopit. Punuar nga dora e piktor Mihal nga katundi Linotopi i Kosturit, shumë të voglit dhe mëkatar, përfundoi në muajin tetor 28. E shkrova në vitin 7135 (=1626)”.²⁴³ Ndërsa në faqen e jashtme të murit jugor të kishës gjendet një mbishkrim i shkruar me copa tullash: “I Zihnonit mitropoli Jakovi”.²⁴⁴

Nga një mbishkrim tjetër që gjendet në një afresk jepet se kisha është pikturuar në vitin 1735 nga ikonografi Mihal Linotopi me kontributin e Mitropolitëve Jakovit të Zihnonëve dhe të Danielit të Nenokopit. Kisha është tërësisht e pikturuar me afreske, madje edhe hajati. Ikonografi Mihal Linotopi ka punuar me mjeshtëri të lartë artistike. Sapo hyn në hajatin e kishës ndeshesh me skenën “Ardhja e Dytë e Krishtit”, e cila zë gjithë faqen e murit të hyrjes

²⁴²-Dhimitër Beduli, Kishë dhe kulturë, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006. faqe 88-92.

²⁴³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.552, faqe 231-232.

²⁴⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 553, faqe 232.

së pronaosit. Figura kryesore e kësaj skene është Krishti, i cili paraqitet i rrethuar nga një re e ndritshme. Djathtas Krishtit qëndron Hyjllindësja dhe gjashtë apostuj duke u lutur, ndërsa nga e majta paraqitet një shenjt që nuk dallohet mirë dhe gjashtë apostuj e tjerë duke u lutur. Nën Krishtin paraqiten engjëj, një tavolinë mbi të cilën gjendet një kryq dhe nën të paraqiten disa buste idhujsh. Djathtas kemi paraqitjet me medalione, vallet e hierarkëve, të dëshmorëve, të virgjëreshave, të grave etj, ndërsa majtas paraqitet një engjëll, i cili me anën e një shpate zjarri zbon mëkatarët. Sipër në kubënë e kishës paraqitet Pandokratori me njerën dorë duke mbajtur ungjillin dhe me tjetrën duke bekuar. Nën Pandokratorin gjenden engjëj duke fluturuar dhe nën ta shenjtorë dhe engjëj të tjerë duke mbajtur në duar lambadha, kryqe etj. Nën ta paraqiten në këmbë profetët Solomon, David, Daniel etj. Nën ta vijon brezi i shenjtorëve që paraqiten ne medalione. Në të katër qoshet e kolonave që mbajnë kupolën paraqiten katër ungjillorët. Mbi hyrjen sipër paraqitet skena “Ikja e Shën Mërisë në Egjipt” si dhe skena “Hyrja e foshnjës në tempull”. Nën to gjendet skena “Vdekja e Efrem Sirianit” si dhe skena të ndryshme nga jeta e këtij shenjti. Në gjysmën e sipërme të harqeve paraqiten pjesë nga “Himni Akathist”, ndërsa në pjesën e jashtme të harqeve paraqiten të pikturuar më këmbë Shën Efrosina, Shën Akaqi, Shën Onufri, Shën Davidi i Selanikut dhe Shën Zosima duke kunguar Marinë Egjiptiane. Skenat vijojnë me Shën Savën, Shën Andonin dhe Shën Efthimin. Në katedralos mbi hyrjen e brendshme gjendet skena “Fjetja e Shën Mërisë”. Në të dy anët e hyrjes paraqiten Shën Pjetri dhe Shën Pavli. Pranë tyre gjendet Shën Oresti si dhe një shenjt tjetër, i cili nuk dallohet mirë. Sipër Krishtit në një sfond paraqitet një kryq i mbyllur në rreth dhe brenda tij është shkruar: “Çdo frymë le të lavdërojë Zotin. Lavdërojeni Zotin prej qiejve”. Përçark paraqiten dhjetë medalione me engjëj dhe shenjtorë, të cilët nuk dallohen mirë. Në faqen e murit verior paraqitet Shën Kostandini dhe Shën Elena, Shën Kolli etj, ndërsa në faqen e murit

jugor paraqiten Shën Simoni, Shën Moki etj. Në apsidë paraqitet Platitera në pozicion lutjeje duke patur Krishtin në një mandil katror dhe anash dy engjëj. Nën të paraqiten disa hierarkë pjesërisht të dëmtuar.²⁴⁵ Ikonostasi është i skalitur, në të ka pesë ikona të mëdha dhe nëntë të vogla me festat dhespotike. Ikonat e pikturuara nga Onufër Qiprioti datojnë në vitin 1614. Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Mbret i atyre që mbretërojnë dhe zot i atyre që zotërojnë dhe kryejerark i madh, gjykatës i drejtë. Lutje e Jakovit, mitropolitit të Zihnës. Dora e Onufër Qipriotit 1615, Krishti”.²⁴⁶ Në fundin e ikonës së Shën Mërisë me Krishtin në krahë është mbishkrimi: “Një qiell tjetër shoh të stolisur ikonën tënde të nderuar o Hyjlindëse, të cilën e pikturoi me dëshirën shumë të pastër meshtar jeromonak Gabrieli. Dora është e Onufër Qipriotit, në kohën e peshkopatit të gjithshenjtit, peshkop Mattheut të Drinopojës, dhe në kohën kur ishte igumen jeromonak Kalisti, në vitin prej Krishtit 1614. Lavdëroj perëndinë, i cili jep fund për çdo gjë që gabojmë rastësisht ndonjë ditë; gjykoni o bari, sepse edhe unë duke qenë i vdekur lavdëroj perëndinë që jep fundin. Këtë e pikturoi mëkatar Onufri”.²⁴⁷ Në ikonën e Joan Pagëzorit është shkruar: “Viti 7131 (=1623) prill 30”.²⁴⁸ Mbi ikonën e Shpërfytyrimit të Krishtit në ikonastasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e Danielit, mitropolitit të Nevrokopit, viti 1615 prej Krishtit. Dora e onufër Qipriotit”.²⁴⁹

²⁴⁵-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Tiranë 1996, faqe 28-30.

²⁴⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 538, faqe 226.

²⁴⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 537, faqe 225-226.

²⁴⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 548, faqe 230.

²⁴⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 539, faqe 226.

Mbi një kuti pipsanash është shkruar: “1818 dhjetor 10. Kutia me lipsanat e shenjta është e manastirit të Çatistës së Vilajetit Paleopogoniani. Igumen jeromonak Grigori, dhuratë e ktitorëve Gjergj Anagnosti, Papa Jan Konomit nga Sopiku, Qirko Ziso, Jorgji Lala. Punimi i argjendit i Gjergj Jan Aleksit”.²⁵⁰ Mbi një kryq prej argjendi është shkruar: “Ky kryq i nderuar dhe jetëbërës është i Manastirit të quajtur i Shpëtimtarit tonë Pandokrator, afër Satithas (Çatistës) me kontributin e fortëshënuarit jeromonak Simeonit. U bë me dorën time të Stavro Mellanit, në Delvinë”.²⁵¹ Në metoqin e manastirit të Çatistës ka qenë një shkollë për përgatitjen e katekistëve dhe psaltëve. Në vitin 1815 në pjesën perëndimore të kishës u ngrit kambaneria.

14. Manastiri i Shën Sotirit gjendet në Drenovë të Mingulit në krahinën e Lunxhërisë në Gjirokastrë. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shpërftyrimit” dhe kremton më 6 gusht. Kisha është në formë kryqi me tri apside dhe ka përmasa 13.60x6.50 metra. Mbi portën perëndimore gjendet një mbishkrim, i cili na bën me dije se kisha është ndërtuar në vitin 1666: “Ky tempull i gjithnderuar dhe hyjnor i nderuar me emrin e zotit dhe perëndisë dhe shpëtimtarit tonë Jezu Krisht u ndërtua prej themeli e pikturoi dhe e stolisi simbas mirëdashjes së perëndisë sikurse e shihni, me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të shumëndershmit zotit Petro dhe Tetos dhe Sava dhe Toska, dhe Teta Toska, Tefa jeromonak Beniaminit, jeromonak Neofitit. Me dorën e Dhimitrit dhe Gjergjit në vitin 1666”.²⁵² Në faqen e murit të prothesit të kishës është shkruar: “Kujto o zot prindërit e piktorëve të kësaj kishe, Muhuilin dhe Zogën. Dora e Dhimitër

²⁵⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 693, faqe 268-269.

²⁵¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 799, faqe 291.

²⁵²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 567, faqe 236-237.

Jorgjit, Janit”²⁵³ Në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “Me kontributin dhe shpenzimet e jeromonak Arsenit dhe igumenit, nga qyteti Bodrishtë. Në vitin 1803. Dora ime e mëkatar Vasilit dhe vetëshkruesit”²⁵⁴ Në ikonën e Shën Mërisë gjendet ky mbishkrim: “Me kontributin dhe shpenzimet e jeromonak Arsenit dhe igumenit të këtij Manastiri të shenjtë. Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Sevo Kirushi, nga Erindi me të bijtë e tij”²⁵⁵ Mbi ikonën e Shën Triadhës është shkruar:”Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Nikollë Koço Stejës, nga Sinkriati 1803”²⁵⁶ Mbi një kandil të kishës është shkruar: “Milto, Vitu, Kostë Andrea nga katundi Nokovë e dhuruan në Manastirin e Shpërfytyrimit 1794”²⁵⁷

15. Manastiri i Demës është një orë larg në jugperëndim të Sarandës. Kisha i është kushtuar “Shën Gjergjit”. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 120 lira. Manastiri i “Shën Gjergjit” ngrihet në lartësinë e një kodre në rripin e ngushtë të tokës, i cili ndan detin Jon me Liqenin e Butrintit në Gadishullin e Ksamilit. Rrethimi i manastirit përbëhet nga një mur guri, në të cilin janë hapur shumë frëngji. Kisha mendohet të jetë ndërtuar aty nga fundi i shekullit XVII dhe fillimet e shekullit XVIII. Naosi është njënefësh me ka përmasa të brendshme 8.20x5.40 metra. Ambienti i altarit ndahet nga një ikonostas prej muri. Muratura e kishës është e veshur me një shtresë llaçi gëlqeror. Janë lënë pa u suvatuar vetëm

²⁵³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 787, faqe 288-281.

²⁵⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 660, faqe 261.

²⁵⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 788, faqe 289.

²⁵⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 663, faqe 261.

²⁵⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 639, faqe 256.

kornizat që përfundojnë muraturën.²⁵⁸ Pas vitit 1967 ky manastir ka shërbyer si repart ushtarak. Gjatë këtyre viteve janë dëmtuar pikturat murale të kishës. Pjesa e mbetur e afreskeve mbi ikonostas u restaurua plotësisht në vitin 2007 me fondet e Kishës Ortodokse.²⁵⁹

16. Manastiri i Kakomesë gjendet në bregdet të Nivicës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjllindëses” dhe feston më 15 gusht. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 180 lira. Kisha e manastirit është ndërtuar në brendësi të gjirit të Kakomesë në breg të detit Jon. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajati në anën perëndimore. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë tripsidal dhe ka përmasa të brendshme 6.80x3.70 metra. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje.



Muret përfundojnë me korniza prej guri. Çatia e kishës është e mbuluar me tjegulla. Nga manastiri i kanë qëndruar kohës kisha dhe dy godina, të cilat janë në gjendje të rrënuar. Në pjesën lindore të manastirit ngrihet një kullë trekatëshe. Dy katet e sipërme kanë qenë për banim, ndërsa kati i poshtëm ka shërbyer si depo. Në pjesën veriore të manastirit gjendet një ndërtesë dykatëshe, ku

²⁵⁸-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 177-180.

²⁵⁹-Gentian Stratobërdha, Restorohehet piktura murale e Manastirit të Shën Gjergjit të Demës, Ngjallja, shkurt 2012, faqe11.

qenë dhomat e banimit të personelit të manastirit. Kjo ndërtesë përmban elementë të shumtë dekorativë të realizuar me gurë të gdhendur. Manastiri është i rrethuar me mure të lartë.²⁶⁰ Nga një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore, brenda naosit të kishës vërtetohet se afresket janë punuar nga dora e Mihalit nga Zerma në vitin 1672: “U pikturua ky tempull hujnor dhe i gjithnderuar i së mbibekuarës, së lavdëruarës zonjës sonë Hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin e gjithoshënarit igumenit, zotit Papa Mantheut me suitën e tij, në vitin 1672-7180 dhe në kohën e peshkopatit të shumë perëndidashësit zotit Serafim, dora ime e mëkatar Mihalit, piktor nga katundi Zerma”.²⁶¹ Mbi portën e narteksit, jashtë kishës është shkruar: “Hapna portën e kuptueshme me anën e arsyes, që është e mbyllur, hapna portat e simpatosë ti që linde fjalën e mirëkuptueshme, që me anën e lutjeve tuaja shumëkëmbëngulëse të zbutësh fjalën e fortmirë që të fali zgjidhjen e mëkateve të të vdekurve jashtë portës, të vë ty o nënë, jepna shpëtimin e ndritshëm...1672”.²⁶² Gjëja më me vlerë në manastir është një ungjill prej pergameni, brenda të cilit janë katër ungjijtë dhe në fund ka shkurtore e sinaksarë. Faqet e ungjillit janë zbukuruar me mikrografi. Manastiri çdo muaj ka ndihmuar me 30 lira shkollën e Nivicës.

17. Manastiri i Shën Mërisë në Korëz gjendet mbi një breg shkëmbor në afërsi të Sarandës. Nga ndërtimet e manastirit i ka rezistuar kohës vetëm kisha, kulla si dhe një ndërtesë me çardak. Kisha është në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 7.90x4.40 metra. Çatia e kishës është dyujëse dhe mbulohet me rrasa guri. Muret e kishës janë me gurë të lidhur me llaç gëlqereje.

²⁶⁰-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 181-184.

²⁶¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 813, faqe 298-299.

²⁶²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 814, faqe 299.

Muratura përfundon me një kornizë guri. Apsida dhe tamburi i kishës janë të suvatuar. Ndërtesa dykatëshe me çardak është ndërtuar në vitin 1762. Oborri i manastirit është shtruar me plloça.²⁶³ Kisha është pikturuar në vitin 1672. Ambienti i altarit ndahet nga një ikonostas të ndërtuar me mur guri. Në frontonin e murit përendimor ngrihet kambaneria. Rreth kambanës së manastirit është shkruar: “Për kujtim të ushtarëve vullnetarë shqiptarë të mbretit të të dy Sicilive që ranë, nga katundi Lukovë. Muzinë 1813 prej meje Raponci”.²⁶⁴ Ky mbishkrim vërtetë faktin historik që repartet shqiptare himariote kanë shërbyer në ushtrinë e Fedinandit të Napolit, mbretit të të dy Sicilive.

18. Manastiri i Krimanovës gjendet në fshatin Piqeras. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 100 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindëses” dhe feston më 15 gusht. Kisha është e tipit bazilikë me kube me përmasa të brendshme 8.30x4.60 metra. Muratura e kishës është me gurë dhe më pas është suvatuar kur është bërë ndonjë riparim.²⁶⁵ Kisha është e ngritur në një lartësi që dominon fshatin Piqeras. Ajo është ndërtuar në vitin 1672. Kjo vërtetohet nga një datë e gdhendur në një gur të murosur mbi portën jugore të kishës.²⁶⁶ Mbi një potir prej argjendi është shkruar: “Shkolla e shën Katerinës”.²⁶⁷

19. Manastiri i Mesopotamit gjendet në fshatin Mesopotam të Sarandës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Kollit” dhe kremton më 6 dhjetor. Ky manastir është themeluar në

²⁶³-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 185-189.

²⁶⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 851, faqe 311-312.

²⁶⁵-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 189-190.

²⁶⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 812, faqe 298.

²⁶⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 902, faqe 325.

shekullin XI, në kohën e Kostandin Monomakut (1042-1054) mbi një tempull të vjetër pagan. Manastiri i Mesopotamit ka qenë në varësi të Patriarkanës së Kostandinopojës. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 80 lira. Manastiri është i rrethuar prej një muri të lartë të ndërtuar me gurë. Kisha e manastirit është ndërtuar me tulla dhe me materiale që janë marrë nga ndërtesa antike. Gjithashtu është e zbukuruar me afreske dhe me mozaikë. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe mjedisi i altarit. Muratura e kishës përbëhet nga tri breza. Ai i poshtmi është prej gurësh të mëdhenj gëlqerorë dhe të skuadruar. Brezi i mesëm është ndërtuar me tulla dhe me gurë çmersi, ndërsa ai i sipërm është ndërtuar me tulla të holla dhe përfundon me një kornizë në formë dhëmbësharre.²⁶⁸

Një mbishkrim që është gdhendur mbi një pllakë guri të murosur në kolonën e madhe verilindore të kishës tregon se kisha është restauruar më 20 janar të vitit 1793 prej papa Thanasit nga fshati Rokadhes: “1792, janar 20. Papa Thanasi i Papa Panos, katundi Rakadhes”.²⁶⁹ Dyshemeja e kishës është e shtruar me pllaka të mëdha prej guri gëlqeror të vendosura estetikisht duke formuar figura gjeometrike. Gjithashtu në dyshemenë e narteksit gjendet një vizatim, i cili përbëhet nga tri rombe në mes dhe dy kuadrate anash. Mbi majat e rombeve janë gdhendur tri lule zambaku. Dyshemeja e portikut është si ajo e naosit. Në pjesën veriore gjenden tri panela mozaiku. Paneli i parë ka përmasa 80x80 centimetra dhe përbëhet nga një sfond i bardhë, në të cilin janë vizatuar katër gjela duke parë njëri-tjetrin. Në panelin e dytë me përmasa 100x90 centimetra, paraqitet një dragua me krahë të hapur, i cili është figuruar me gurë të bardhë me konture të kuqe. Në murin verior paraqitet një derr i egër dhe pas tij një qen, i cili është duke sulmuar derrin. Në brezin e poshtëm të murit lindor

²⁶⁸-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Urgen, Tiranë 2004, faqe 235-236.

²⁶⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.847, faqe 309-310.

paraqiten një shqiponjë, dy dragonj dhe një luan.²⁷⁰ Një mbishkrim i gdhendur mbi ikonostasin e kishës vërteton se është gdhendur në vitin 1892: “Forcoje këtë manastir të shenjtë, vepër e të shquarit igumen Efthim Papanikollës. Muzinë 1892. Stavro dhe Nikollë Mara, Kosta”.²⁷¹ Kisha e “Shën Kollit” ka formë katërkëndëshi këndëdrejtë. Në të gjenden katër kube me madhësi 18.30x11.30 metra.

20. Manastiri i Qeparoit gjendet në fshatin Qeparo të Himarës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Mitrit” dhe kremton më 26 tetor. Të ardhura vjetore të manastirit kanë qenë 30 lira. Naosi është në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 7.50x4.60 metra. E veçanta e kësaj kisha janë dekoracionet me tulla të vendosura në formë sharre.²⁷² Kisha e manastirit është ndërtuar në vitin 1760. Kjo datë gjendet e gdhendur mbi një gur, në anën e djathtë të portës perëndimore të kishës.²⁷³



²⁷⁰-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Urgen, Tiranë 2004, faqe 237-238.

²⁷¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.895, faqe 323-324.

²⁷²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 192-193.

²⁷³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 827, faqe 304.

Konakët e manastirit janë ndërtuar në vitin 1811. Kjo datë është e gdhendur mbi një gur në njerin prej harqeve të konakëve të manastirit.²⁷⁴ Mbi një kuti lipsanësh është shkruar: “Kjo kuti e lipsanave të shenjta është e shën Kollit të Manastirit të hirshëm të Palernës. Me shpenzimet e igumenit, zotit jeromonak Krisanthit 1800. Nako Kriekoka Theodori”.²⁷⁵ Ambjenti i altarit ndahet me një ikonostas druri. Në mjediset e kishës ka qenë edhe shkolla, si dhe godinat ndihmëse. Manastiri është restauruar vitet e fundit me fondet e Kishës Ortodokse. Konkretisht janë kryer këto punime: 1-Restaurimi i kishës dhe i konakëve. 2-Shtesë në anën perëndimore të kishës. 3-Sistemimi i territorit brenda dhe jashtë manastirit etj.²⁷⁶

21. Manastiri i Atales gjendet në verilindje të Himarës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Shën Marisë” dhe feston më 15 gusht. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 20 lira. Manastiri është ngritur në malin e Atalit rreth dy orë larg nga lagjia Spile e Himarës. Kisha është e tipit bazilikal me tre nefe dhe ka përmasa të brendshme 10.10x5.10 metra. Muratura e kishës është e rregullt me qoshe dhe korniza të punuara me gurë të latuar. Çatia e kishës është dyujëse dhe e mbuluar me tjegulla. Apsida është punuar me gurë të latuar dhe përfundon me një kornizë guri. Nga ndërtimet e manastirit ka mbetur një godinë dykatëshe e rrënuar, kati i poshtëm i së cilës ka shërbyer për katua, ndërsa ai i sipërm për banim.²⁷⁷ Kisha është ndërtuar në vitin 1759. Ky fakt vërtetohet me anën e një mbishkrimi që gjendet mbi portën perëndimore brenda kishës: “U ndërtua prej themeli dhe u pikturua

²⁷⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.864, faqe 316.

²⁷⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 862, faqe 314-315.

²⁷⁶-Joan Stratobërdha, Kontribut i madh i Kishës për trashëgiminë kulturore kombëtare, Ngjallja, qershor 2003, faqe 6-7.

²⁷⁷-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 194-196.

ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i Fjetjes së mbishënjtës, zonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin, përpjekjen, mundimin dhe shpenzimet e murgeshës Zaharisë në kohën e peshkopit shumë perëndidashës zotit, zotit Joaniqit të Himarës e Delvinës, me dorën time të mëkatar Vasilit, nga katundi Sinkriati. U përfundua në vitin 1795, prill 10”.²⁷⁸ Në skenën “Ava Sisoj para varrit të Aleksandrit të Madh” është shkruar: “Duke të parë ty o varr trëmbem nga pamja jote dhe derdh lot si shi, që pikojnë nga zemra, sjell ndër mend borxhin që është për të gjithë si do të kalojë deri në fund, obobo nga kjo o i pavdekshëm kush mund të shpëtojë ty. Ava Sisoj-Mbreti Aleksandër”.²⁷⁹ Ambienti i altarit ndahet nga një ikonostas prej muri.

22. Manastiri i Shën Athanasit gjendet në fshatin Muzinë të Sarandës. Në nikën e prothesit, në kungë të kishës gjendet ky mbishkrim: “U përtëri dhe u pikturua ky tempull hyjnor i gjithnderuar i atit tonë Athanasit dhe Kirillit, patrikëve të Aleksandrisë, me kontributin, përpjekjet, mundimet dhe shpenzimet e arkondëve shumëfisnikë të Muzinës, në kohën e peshkopatit të zotit Matheut Famulltar i këtij manastiri (ishte) papa Andrea i Dedës (1623-1731). Zoti Martiri i ka dhuruar shën Athanasit, për tu pikturuar aspra dy mijë për shpëtimin e shpirtit. Për kujtim të prindërve dhe të vetes. Amin”.²⁸⁰

23. Manastiri i Panaisë gjendet në Dhërmi të Himarës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Lindjes së Shën Mërisë” dhe kremton më 8 shtator. Kisha është bazilikë njënefëshe dhe ka përmasa 18.48x8 metra. Mbi faqen e murit verior, në kungë të kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Guzos

²⁷⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 848, faqe 310.

²⁷⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 849, faqe 310-311.

²⁸⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 808, faqe 295-296.

dhe gruas e fëmijëve të tyre. Amin. 1576”.²⁸¹ Në portretin e Shën Kozmait në faqen e murit verior të kishës është shkruar: “Asket Kozmai që martizoi në një vend të huaj të quajtur Mujali me 24 gusht, viti 1779”.²⁸² Kisha është pikturuar në prill të vitit 1781. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet në faqen perëndimore të kolonës jogore të kishës: “U pikturua ky tempull i gjithnderuar i së mbishënjtës, zonjës sonë hyjlindëse dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin e...në kohën e peshkopatit të peshkopit të gjithhirshëm zotit Joaniqit të Himarës dhe Delvinës, në prill të vitit 1781”.²⁸³ Mbi faqen e brendshme të timbanit të kubesë së kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë, zotit Kristofor Bëxhili dhe të vëllait të tij Dhimitrit, bashkë me fëmijët e tij”.²⁸⁴

24. Manastiri i Agjelasit gjendet në Leshnicën e Sipërme të rrethit të Delvinës. Të ardhurat vjetore manastiri i ka pasur 80 lira. Manastiri i është kushtuar “Ipapandisë”. Themeluesi i këtij manastiri është hieromonaku Agjelasti, nga fshati Luvina i Dropullit të Sipërm. Ky i fundit pasi braktisi manastirin e Drianos u strehua në manastirin e Agjelasit, për më tepër qetësi shpirtërore dhe asketizëm. Quhej Agjelasti, sepse që nga dita që kishte përqafuar jetën monakale nuk kishte qeshur më. Agjelasit në gjuhën greke do të thotë: ai që nuk qesh kurrë. Prej një mbishkrimi mësojmë se manastiri i Agjelasit është themeluar në vitin 1525. Nga ky mbishkrim kemi ktitorët e manastirit, të cilët janë: Papa Jorgji, Papa Nikolla dhe Dhimitri e Joani. Kisha është pikturuar më 30 shtator të vitit 1799 prej Vasilit nga Sikriati. Këtë e vërteton

²⁸¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 805, faqe 294.

²⁸²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.836, faqe 307.

²⁸³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 837, faqe 307.

²⁸⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 906, faqe 326.

mbishkrimi që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “U pikturua ky tempull i gjithnderuar i zotit tonë Jezu Krisht me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e gjithoshënarit, igumen jeromonak Avakumit, në kohën e peshkopatit shumë perëndidashësit të Drinopojës dhe të Gjirokastrës, në kohën e kujdestarisë të shumënderuarit zoti, zoti Jan Thanasit nga katundi Dhrovjani. Me dorën time të mëkatar Vasilit të Janit, nga katundi Sikiriati, në vitin 1799, shtator 30”²⁸⁵

Mbi portën e narteksit të kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë jeromonak Gjerasimit 1682”.²⁸⁶ Gjithashtu mbi portën e narteksit të kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutja e shërbëtorëve të perëndisë, murgut Janiqit 1682”.²⁸⁷ Pranë portës së narteksit të kishës është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë, jaromonak Dionisit 1682”.²⁸⁸ Mbi ikonën e madhe të Ipapandisë është shkruar viti 1791.²⁸⁹ Nga një dorëshkrim prej 24 faqesh, i cili daton më 1828, kemi shumë të dhëna për lëndët e mësimdhënies në shkollën e manastirit, ku mësohej lutja, jepeshin të dhëna gjeografike, njohuri enciklopedike etj. Igumenët e manastirit kanë qenë: Agjelasti, Qirili, Dometi, Abakumi, Dionisi, Grigori, Visarioni, Paisi dhe Anastasi.²⁹⁰

25. Manastiri i Gjermanoit në Leshnicën e Poshtme të rrethit të Delvinës është themeluar në shek. XVIII. Ktitor i

²⁸⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 859, faqe 314.

²⁸⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.818, faqe 300.

²⁸⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 819, faqe 300-301.

²⁸⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.820, faqe 301.

²⁸⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 846, faqe 309.

²⁹⁰-Mihail G. Triou, H Eklisia sto Anatoliko Iliriko kai tin Albania, Thesaloniki 1999, selidha 84-87.

manastirit është hirodhjakoni Daniel, i cili ishte me origjinë nga Leshnica. Më vonë mbi rrënojat e manastirit të vjetër murgu Gjermano ndërtoi manastirin, që mori emrin e ktitorit. Kisha e manastirit të Gjermanoit i është kushtuar “Shën Athanasit”, prandaj festonte më 18 janar dhe më 2 maj. Igumenë të manastirit kanë qenë: Grigori, Visarioni, Paisi, Zaharia etj. Të ardhura vjetore të manastirit kanë qenë 100 lira. Gjithashtu që nga viti 1890 në manastir ka funksionuar një shkollë fillore, e cila mbulonte nevojat e fshatrave përreth. Manastiri ka ndihmuar shkollën e Leshnicës së Poshtme me nga 10 lira çdo muaj.

Kisha e manastirit është ndërtuar në vitin 1797 dhe u pikturua në vitin 1801. Mbi portën jugore brenda kishës gjendet ky mbishkrim: “Ky tempull i gjithnderuar dhe hyjnor i atit tonë ndër shenjtorë shën Thanasit të madh i Manastirit të Gjermanoit u stolis dhe u zbukurua me shpenzimet e etërve të tij, me mbikqyrjen e Krisanthis jeromonakut dhe igumenit të tij. Në kohën e peshkopit tonë të Dronopojës Kir Gabriel, të etërve prezent dhe jeromonakë të Dhionisit, Zakheut, Meletit, Joaniqit, Papa Qirjaqi dhe Zosima më 1801 muaji qershor 28. Me dorën time të Llazarit nga Ano Sudhena së bashku me nxënësit e mi Llazarin dhe Gjergjin. Më 1797 u bënë themelet e këtij tempulli”.²⁹¹ Mbi portën e narteksit të kishës është shkruar: “Ky tempull i gjithnderuar u ndërtua prej themeli me mbikqyrjen e jeromonak dhe igumen Krisanthis më 1797, korrik 24”.²⁹² Pranë kokës së portretit të jerodhiakon Danielit, ktitorit në faqen perëndimore të naosit të kishës është shkruar: “O at shumëmadh, bir dhe shpirt që ruan gjithshka vetëm me ...adhuruesit e tu që i nderon madhënoi me lavdi dhe nëpërmjet atyre shlyej mëkatet e mëkatarëve dhe me ndërmjetësimet e shërbëtorit tënd, atit Athanasit të madh, jerarkut dhe të drejtit,

²⁹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 856, faqe 313.

²⁹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 857, faqe 313-314.

dhe oshënarit jepi faljen e mëkateve dhiakon Danielit që të kërkon nxehtësisht me psherëtimë dhe dhimbje se ndërtoi në mënyrë të shkëlqyeshme dhe stolisi madhërisht këtë tempull të lavdishëm bashkë me të tjerët. Qoftë i pranuar o Trini e gjithmonhymnueme, qoftë i lumtur shpëtimi shpirtëror i atyreve dhe i prindërve tanë, jerothiakon Danieli ai që është prej këndeje dhe që është drejtor i shkollës në Bukluresht dhe me harxhet dhe shpenzimet e tij. Data e themelimit dhe e pikturimit, 1801 korrik 10”.²⁹³ Në ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me dorën time të pamerituarit Llazar nga Ano Sudhesa e Zagorisë, me kontributin e igumen Parthenit”.²⁹⁴

26. Manastiri i Joan Teologut gjendet në fshatin Cercovicë të Sarandës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Joan Teologut”. Si ktitor i manastirit përmendet hieromonak Grigori. Në vitin 1471 manastiri u dogj dhe u rindërtua në vitin 1478 me kujdestarinë e hieromonak Gjerasimit, i cili ishte me origjinë nga Dervicani. Vite më vonë më 1843 u rindërtua tërësisht me fondet e hieromonak Arsenit nga Vllahia. Manastiri i Teologos ka pasur toka, ullishta etj. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 200 lira turke. Në vitin 1876 në manastir ka pasur shkollë për fëmijët e zonës përreth. Manastiri u shkatërrua në vitin 1878 me kryengritjen e Lëkurësit. Kisha e manastirit është rindërtuar në vitin 1883. Kjo datë gjendet e gdhendur në mur, mbi portën perëndimore jashtë kishës”.²⁹⁵ Rindërtimi i kishës është bërë prej mjeshtrit Kola Kostandin Zhapo. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet i gdhendur mbi një gur mbi murin përëndimor të kishës:

²⁹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 863, faqe 315.

²⁹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 903, faqe 325.

²⁹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.892, faqe 323.

“1883 Mjeshtri Kola Konstandin Zhapo”.²⁹⁶ Mbi një kuti lipsanash prej argjendi është shkruar: “U punua prej argjendi me shpenzimet e manastirit në vitin 1779 në kohën e igumenit, jeromonak Theofanit, grosh 400”.²⁹⁷ Mbi kryqin e madh prej argjendi gjendet mbishkrimi: “Me kontributin dhe shpenzimet e murgut Krisanth Pelagrinit, Evgjenit dhe Kalinikut jeromonakëve të Manastirit të Jan Theologut të Malçanit, 1829, mars 15”.²⁹⁸ Mbi një kuti të vogël lipsanësh është shkruar: “Kjo kuti është e Manastirit të shenjtë e të gjithënderuar të Teologut, eparkia e Delvinës. Me dorën e jeromonakëve igumenit, zotit Kalinik, Zotit Evgjenit, 1832”.²⁹⁹ Mbi një kuti tjetër lipsanash gjendet mbishkrimi: “Kjo kuti është e manastirit të nderuar dhe të gjithënderuar të Jan Teologut, të eparkisë së Delvinës. Është punuar prej jeromonakut, Zotit Kalinik në vitin 1837, prill 10”.³⁰⁰ Mbi bzamentin e një kryqi të madh prej argjendi është shkruar: “Me kontributin dhe shpenzimet e murgut Krisanth pelegrinit, Evgjenit, Kalinikut, jeromonakëve të Manastirit të shën Joan Teologut, Malçan 1869, mars 15”.³⁰¹

27-Manastiri i Piruit gjendet në fshatin Sirakot të Sarandës. Kisha i është kushtuar “Fjetjës së Shën Mërisë” dhe kremton më 15 gusht. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 50 lira. Kisha e manastirit ka përmasa 16.5x5.70 metra. Brenda portës perëndimore të kishës gjendet ky mbishkrim: “Ky tempull

²⁹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 893, faqe 323.

²⁹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 835, faqe 306-307.

²⁹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 875, faqe 320.

²⁹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 877, faqe 320

³⁰⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 878, faqe 320.

³⁰¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 883, faqe 321.

hyjnor dhe i gjithnderuar i Fjetjes së mbishenjtës nonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari i mbiquajtui i Piruit u pikturua me kontributin dhe shpenzimet e jeromonakëve të shumëndevotshëm Zaktheut nga manastiri i katunës dhe Zaharisë nga Manastiri i Pepelit, në kohën kur ishte igumen i fortshënuari murg Veniamini nga Dhendrovjani. Me dorën time të përvuajturit Vasil Apostolit nga katundi Frastana të Pogonianisë së vjetër. Në vitin 1820, qershor 10. Ikonom Papa Kiriako Efthimiadhi”.³⁰²

28. Manastiri i 40 shenjtorëve gjendet mbi qytetin e Sarandës. Manastiri i “40 Shenjtorëve” e ka pasur kulmin e zhvillimit në shekullin VI. Gjatë viteve të mbretërimit të perandorit Justinian, manastiri ka pasur disa faza rindërtimi. Kisha e manastirit ka qenë bazilikë trinefëshe me përmasa 37.40x24 metra. Muret anësore të kishës kanë qenë të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Muret e kishës janë rrënuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në faqen e murit perëndimor në gërmadhat e manastirit gjendet një mbishkrim i shkruar me tulla: “....ndihmo shërbëtorin tënd Qiriako”.³⁰³

Në vitin 320, në Sebasti të Armenisë u martirizuan 40 shenjtorë. Ata ishin ushtarë nga vende të ndryshme, por në të njëjtin repart. Vite më vonë reliket e 40 martirëve nga Sebastia u sollën në Sarandë dhe u vendosën në qimitirin e kishës së 40 shenjtorëve. Emrat e 40 martirëve janë: Kirion, Klaud, Domn, Sevirian, Eftik, Kirill, Theudhul, Vikrat, Agiu, Isik, Evnoik, Meliton, Ilia, Aleksandër, Saqerdon, Ual, Prisik, Hudhion, Irakli, Ekdhiq, Joan, Filoktimon, Flavio, Ksanth, Valer, Nikolla, Athanas, Theofil, Lisimak, Gai, Klaud, Smarad, Sisin, Leont, Aet, Akaq, Domet, Gorgon, Julian dhe Agall. Manastiri i 40 shenjtorëve ka qenë vend pelegrinazhi. Prej këtij manastiri e ka marrë emrin qyteti i Sarandës.

³⁰²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.868, faqe 317-318.

³⁰³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 901, faqe 325.

Kisha e manastirit duhet të jetë financuar nga pesë dhurues, të cilët kanë lënë mbishkrimet e shkruara me pllaka të kuqe tullash si dhe me copa vazosh të thyera të vendosura në fasadën perëndimore, në murin verior dhe në apsidë.³⁰⁴

29. Manastiri i Shën Todhrit gjendet në jugindje të Dhërmiut të Himarës. Manastiri është ndërtuar në shekullin XVII. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 25 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Todhrit”. Mbi faqen e murit verior të kishës është shkruar: “Me dorën e Dhimitrit të Nikollës dhe Anastasit të Mihail Zografit, nga katundi Fjonjati, eparkia e Konicës 1882”.³⁰⁵ Sipas Theofan Popës ky mbishkrim i referohet ripikturimit të kishës, sepse nën të dallohen edhe dy shtresa të tjera me piktura më të hershme.

30. Manastiri i Dhivrovunit, gjendet në malin mbi fshatin Dhivër të Delvinës. Manastiri ka pasur të ardhura vjetore 180 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjllindëses” dhe feston më 15 gusht. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazilikal dhe ka përmasa të brendshme 7.30x4.80 metra. Hajati është i mbuluar prej një çatie druri pa tavan. Muratura e kishës është me gurë me fugaturat e mbushur me llaç gëlqereje. Çatia e kishës është dyujëse. Apsida është trifaqëshe me nike të gjata dhe të harkuara nga sipër.³⁰⁶ Kisha është pikturuar në 10 tetor të vitit 1603 nga Mihali dhe Kostandini nga fshati Gramoz. Ky fakt vërtetohet me anën e një mbishkrimi që gjendet mbi portën perëndimore brenda kishës: “U ndërtua dhe u ripikturua ky tempull hyjnor e gjithnderuar i së mbishenjtës, së lavdëruar zonjës sonë Hyjllindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari e mbiqujtur e Vodicës,

³⁰⁴-Gazmend Muka, Bazilika që i dha emrin Sarandës, Monumentet 2002, faqe 15.

³⁰⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 889, faqe 322.

³⁰⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 157-158.

në kohërat e të gjithshenjtit dhe patrikut ekumenik zotit Rafael, me përpjekjet dhe mundimet e gjithshenarit jeromonak, zotit Jakov dhe murgut Germanojt dhe jeromonak Parthenit dhe jeromonak Sofronit, jeromonakët e monakë të tjerë që mundohen, në vitin 7712 (=1603) në muajin tetor 10, me dorën time të Mihalit dhe Kostandinit nga Gramozi”.³⁰⁷ Përmendja e emrit të patrikut ekumenik në mbishkrimin e mësipërm vërteton faktin se Manastiri i Dhivrovunit ka qenë metoq i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës. Gjithashtu ikonografët që pikturuan kishën Mihali dhe Kostandini qenë nga fshati Gramoz, i cili gjendet mbi malin Gramoz por në pjesën greke. Ikonostasi i kishës është prej druri të gdhendur dhe është punuar në vitin 1680. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi: “U përfundua ky kryq i nderuar dhe ky ikonostas i nderuar që prej fillimit me kontributin dhe shpenzimet dhe për shpëtimin në kohën e gjithshenarit dhe igumenit, zotit Kostandin Dositheut, kusarit bestar në vitin 1680-7188 dhe të tjerët. Në muajin tetor 9”.³⁰⁸ Mbi një ikonë të ikonostasit është shkruar: “Lutje e shërbëtorëve të perëndisë murgeshës Damjanisë dhe Stasinisë dhe murgeshës Kristinës”.³⁰⁹

31. Manastiri i Dhivrit gjendet në juglindje të fshatit Dhivër të Delvinës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Kollit” dhe kremton me 6 dhjetor. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 30 lira. Nga rrënojat e manastirit ka mbetur kisha dhe një konak dykatësh, i cili mendohet të jetë ndërtuar më vonë. Kisha përbëhet nga naosi dhe nartekxi. Naosi është njënefësh me tri apside dhe ka përmasa të brendshme 7.60x2.70 metra. Nartekxi gjendet në anën perëndimore dhe mendohet të jetë shtuar më vonë. Nartekxi

³⁰⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 807, faqe 295.

³⁰⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.817, faqe 300.

³⁰⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.909, faqe 326-327.

ka formë katërkëndëshi dhe lidhet me naosin me anën e një hapërise të harkuar. Narteksi mbulohet nga një çati druri dyujëse. Muratura e naosit është ndërtuar me gurë. Kishës i bashkangjitet konaku dykatësh, ku kati përdhes shërbente për katoje, ndërsa në katin e sipërm qenë qelitë e mugjve.³¹⁰ Kisha është ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1796. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi faqen e murit verior të kishës: “1796-U ndërtua prej themeli dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i atit tonë ndër shenjtorë shën Kollit, kryepeshkopit të Mirës së Likisë çudibërësit, me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e të shumënderuarit prift Qiriakut, në kohën e peshkopatit të peshkopit shumë perëndidashës të Drinopojës dhe Gjirokastrës, zotit Dosithej. Me dorën e Vasilit nga katundi Sikriati”.³¹¹



Mbi ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Me kontributin dhe shpenzimet e murgut Zaharisë, viti 1796”.³¹² Ndërsa në ikonën e Shën Kollit në prosqinitarin e kishës gjendet

³¹⁰-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 160-162.

³¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 851, faqe 311-312.

³¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 852, faqe 312.

mbishkrimi: “Me dorën time mëkatar Vasilit, nga katundi Sikrikati”.³¹³ Mbi një ikonë të Shën Gjergjit gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Gjeorgo Voto 1679”.³¹⁴ Pranë portreteve të igumenëve të pikturuar në murin jugor të kishës gjendet këto mbishkrime: “Igumeni i manastirit, jeromonak Kalestri. Igumeni i Theologut, jeromonak Stefani”.³¹⁵

32. Manastiri i Kamenës gjendet midis Delvinës dhe fshatit Kakodhiq. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindëses” dhe kremton më 15 gusht. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 300 lira. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dha hajati. Naosi është në formë kryqi me kupolë dhe ka përmasa të brendshme 7.30x6.20 metra. Muratura e kishës është me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Muret përfundojnë me korniza prej tullash të vendosur anë formë dhëmbësh sharre. Kambaneria është punuar me gurë të gdhendur. Porta e jashtme e manastirit përmban elementë të shumta arkitektonike dhe dekorative.³¹⁶ Kisha e manastirit është ndërtuar në vitin 1580. Kjo vërtetohet nga mbishkrimi i një pllake guri të vendosur mbi portën e saj.³¹⁷ Gjithashtu një mbishkrim tjetër që gjendet mbi portën perëndimore të kishës na njeh me kohën e pikturimit të afreskeve, nga dora e Mihalit nga fshati Zermë në vitin 1662: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i së gjithbekuarës, së lavdëruarës zonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontributin e gjithoshënarit dhe igumenit zotit, zotit Theofan dhe atit zotit

³¹³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 853, faqe 312.

³¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 816, faqe 300.

³¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 904, faqe 325.

³¹⁶-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 166-167.

³¹⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 806, faqe 294-295.

Dhionis me gjithë suitën e tyre, dhe në kohën e peshkopatit të peshkopit shumë perëndidashës zotit, zotit Serafim, në vitin 7170-1662, indikti 15, në muajin shtator 20, me dorën time të mëkatar Mihalit, piktor nga katundi Zerma e Greqisë”.³¹⁸ Vite më vonë ikonografi Mihal e pasuroi kishën me afreske të tjera duke pikturuar narteksin në vitin 1674. Mbi portën e narteksit, brenda kishës është shkruar: “Hapna portën e kuptueshme me anën e arsyes që është e mbyllur, hapna portat e zimpatisë ti që linde fjalën e mirëkuptueshme, që me anën e lutjeve tuaja shumëkëmbëngulëse të zbutësh fjalën e fortmirë, që të fali zgjidhjen e mëkateve të të vdekurve. U pikturua narteksi hyjnor me kontributin e gjithoshënarit igumenit zotit, zotit Theofan, si dhe jeromonakut të drejtë Dionis, në vitin 1674-7172. Me dorën time të mëkatar Mihalit, piktor nga katundi Zerma”.³¹⁹

Konakët e manastirit janë ndërtuar në vitin 1815 prej disa mjeshtërve nga Pirsojani. Mbi një pllakë guri që gjendet e murosur në murin e konakëve është shkruar: “Në kohën kur u ndërtua manastiri, viti 1815 janar 20, ishte igumen Papa Pano nga Sopiku dhe famulltar Papa Vasili nga Finiqi...Margariti Papa...nga Kakodhiqi dhe igumenin e meritoi e gjithë shenjta dhe e mbaroi...me fuqinë e shën Mërisë dhe mjeshtrit ishin nga Pirsojani...”.³²⁰ Mbi portën e manastirit gjendet ky mbishkrim: “Partheni 1820, Paisi. Mjeshtrit nga Pirsojani 1819”.³²¹ Igumenët e manastirit kanë qenë: Joasafi 1630, Athanasi 1710, Sofroni 1736, Papa Pano 1813, Paisi 1816, Paisi 1831, Agathangjeli 1851. Kisha

³¹⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 810, faqe 296-297.

³¹⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 815, faqe 299-300.

³²⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 867, faqe 317.

³²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 869, faqe 318.

mbulohej me çati druri pa tavan. Në vulën e manastirit kemi këtë mbishkrim: “1032 Fjetja e së Mbishenjhtës Hyjlindëses së Kamenos, pranë Delvinës”. Ky mbishkrim gjendet rreth një vule metalike me gjithë skenën e Fjetjes së Shën Marisë.³²² Mbi një faqe muri pranë skenës Darka Mistike është shkruar: “Mbeturinat e copave të bukëve ti bekosh që të hanë të huajt, të vobegtit, të uritur mos lerë”.³²³

33. Manastiri i Kardhikaqit gjendet në anën veriore të fshatit Kardhikaq dhe i është kushtuar “Shën Triadhës”. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 70 lira. Kisha e manastirit përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi është njënefësh dhe ka përmasa të brendshme 7.0x3.90 metra. Kisha është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Muratura e kishës përfundon me një kornizë të hollë prej guri. Apsida e kishës është e zbukuruar me një sërë harqesh me tulla, ndërsa në pjesën e sipërme përfundon me një kornizë me gurë të gdhendur.³²⁴ Kisha është piktuar në vitin 1827. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore të kishës: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i hirshëm me emrin e shën Triadhës, në kohën e peshkopit shumë perëndidashës, zotit Paisit dhe igumen Janit, priftërinjtë kujdestarë ishin të shumënderuarit Kostandin dhe Gjergj Kristo Kanaçi dhe Nikolla dhe Gjergj Panajoti dhe katundarët që ndodheshin: Joti, Demira, Loli, Llambro, Kondiko... Thano..Inos, Jani, Tasi, Nasi, Llambro. U pikturua me dorën e Gjergjit dhe Zikos, birit të tij fjonatas nga eparkia e shenjtit të Vellasë-1827 korrik 5”.³²⁵

³²²-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 802, faqe 293.

³²³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 908, faqe 326.

³²⁴-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 173-175.

³²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 874, faqe 319.

34. Manastiri i Nivanit gjendet midis fshatrave Nivan e Nderan në Zagori të Gjirokastrës. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qënë 100 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Kryeenjgëjve” dhe feston më 8 nëntor. Mbi portën perëndimore të kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua dhe u stolis ky tempull hyjnor i Taksiarkëve të mëdhenj Miael dhe Gabriel dhe gjithëfuqive pa trup me kontributin dhe shpenzimet e arkondëve të shumënderuar në kohën e epitropisë së zotit...Gjonit në kohën e mbikqyrjes të ...zotit Papa Gjergjit me përpjekjet dhe shpenzimet e Pili Dedes, në kohën e peshkopatit të shumë perëndidashësit dhe të fortshenjtit, zotit, zotit Dositheut të Drinopojës dhe të Gjirokastrës nga katundi Mecovë, me dorën e Janit me të birin e tij, nga katundi Sikiriati, viti 1779, korrik 28”.³²⁶

Tek ikonat e Krishtit dhe e Shën Mëhillit në ikonostasin e kishës është shkruar: “Data 1779. Dhuratë e shërbëtorit të perëndisë Vasa”.³²⁷ Në ikonën e Shën Mërisë gjejmë këtë mbishkrim: “Lutje e shërbëtores së perëndisë Angjelinës”.³²⁸ Mbi një kuti lipsanësh gjendet mbishkrimi: “1772. Kjo kuti e shenjtë është pjesë e shën varvarës. U ndërtua nga Papa Jorgj Llavrioti Zmirneasi”.³²⁹*Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 599, faqe 245.* Rreth bazamentit të një potiri prej argjendi është shkruar: “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Qiros nga Sheperi dhe Dtefan Dhimitrit, viti 1775”.³³⁰ Gjithashtu rreth një kutie lipsanash prej argjendi është shkruar: “Është i Taksiarkut Mihail, me dorën e shumë të voglit Stefanit

³²⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 612, faqe 249-250.

³²⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 612, faqe 250.

³²⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 793, faqe 290.

³³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 603, faqe 246.

nga katundi Arza 1788, prill 14. Ju dhurua tempullit nga prifti i shumëdevotshëm dhe ekonomi i Nivanit Skevi. Prift Tilo, prift Qirko, Dede Kusta, Jani Qendro”.³³¹ Mbi një ungjill është shkruar: “Ky ungjill është i Manastirit të Kryeengjëjve në Nivan, në kohën kur ishte igumen jeromonak Serafimi 1812. Zoti Dhimitri dhe Kristodhuli, vëllai i argjendarit”.³³² Rreth potirit të kishës është shkruar: “Ky disko-potir i shenjt i Manastirit të nderuar e gjithënderuar të Mëhillit të katundit Nivan është ndërtuar me kontributin e epitropit dhe igumenit Serafim shumë të voglit, dhjetor 1819”.³³³ Mbi një pllakë guri të murosur në murin e kambanerisë është shkruar: “U ndërtua kambaneria në kohën e gjithëshënarit igumenit, shumë të voglit Serafin me shpenzimet e Kostandin Gjokë Dhimos, me përpjekjet e Jan Dhimës, 1808”.³³⁴

35. Manastiri i Hoshtevës është në një pozicion të bukur të malit në fshatin Hoshtevë në Zagori. Kisha i është kushtuar “Shën Sotirit” dhe festonte më 6 gusht ditën e Shpërftyrimin. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 60 lira. Kisha ka përmasa 7.50x2.5 metra. Mbi portën brenda kishës gjendet mbishkrimi: “U pikturua dhe u stolis ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i zotit tonë Jezu Krisht me kontributin, mundimet dhe shpenzimet e katundit Hoshtevë, të vegjël e të mëdhenj, vend i huaj, botë e huaj, pashë të huaj që nuk pranojnë të huaj, viti 7177 (=1669)”.³³⁵

³³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 626, faqe 253.

³³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 680, faqe 266.

³³³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 697, faqe 269.

³³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 672, faqe 264.

³³⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 568, faqe 237-238.

36. Manastiri i Hormovës në fshatin Hormovë të Tepelenës është ndërtuar në shek. XVII. Manastiri ka pasur të ardhura vjetore 50 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Kollit” dhe festonte më 6 dhjetor. Në një ikonë të Shën Mërisë, e cila gjendet në ikonostasin e kishës së është shkruar: “Lutje e Janit dhe vetëshkrues...bijve të tij nga katundi Sikriati. Viti 1782 gusht 15”.³³⁶ Mbi ikonën e Joan Pagëzorit gjendet mbishkrimi: “1791 janar 5”.³³⁷

37. Manastiri i Tërbuqit është ndërtuar më 1864. Këtë e vërtetojmë me anën e një mbishkrimi mbi portën jugore të manastirit, i cili thotë: “Arkitekt Filip Jorgjiu Konicë, katundi Kostandini. Me shpenzimet e Vangjel Zhapës-1864”.³³⁸ Manastiri i Shën Mërisë në Tërbuq të Rëzës në rrethin e Tepelenës ka pasur të ardhura vjetore 100 lira. Kisha i është kushtuar Fjetjes së Hyjllindëses dhe festonte më 15 gusht. Kisha ka madhësi 12x7 metra. Mbi një kuti lipsanash, e cila daton më 1766 gjendet i shkruar emri i Jorgo Kaliviotit, që mendohet se ka qenë mjeshtri që ka punuar kutinë: “E jeromonak Anthimit, nga Vilica viti 1766. Jorgo Kalivioti”.³³⁹

38. Manastiri i Kodrës në rrethin e Përmetit i është kushtuar “Fjetjes së Shën Marisë”. Ai është ngritur në shek. XVI. Kisha është bazilikë një nefëshe me mbulesë cilindrike, me një apsidë cilindrike me madhësi 8x5 m. Në një mbishkrim që gjendet i pikturuar mbi suva, në portën perëndimore të kishës, është dhënë: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i

³³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 614, faqe 250.

³³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 631, faqe 254.

³³⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.738, faqe 278.

³³⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 592, faqe 243.

së mbishenjtës, zonjës sonë Hyjlindëses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari, me kontrubutin, përpjekjet dhe shpenzimet e arkondëve të shumënderuar të dragotasve, dhe kur ishte famulltar i shumëdevotshmi Gole, nga Leka 7105 (=1597)". Fjala e fundit nga Leka e ka kuptimin nga Lekli. Mendojmë se ky toponim është përkujtim në trevat shqiptare i figurës së shquar historike të Aleksandrit të Madh.³⁴⁰

39. Manastiri i Frashtanit, mbi një kodër të fshatit Frashtan të Dropullit. Manastiri është ndërtuar gjatë shek. XVI dhe ka pasur të ardhura vjetore 30 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar "Burimit Jetëdhënës". Mbi portën jashtë manastirit gjendet i shkruar viti 1814. Kjo datë duhet të tregojë kohën e ndërtimit ose të rindërtimit të kishës".³⁴¹

40. Manastiri i Konckës në fshatin Konckë të Zagorisë. I është kushtuar "Fjetjes së Shën Marisë" më 15 gusht. Të ardhurat vjetore i ka pasur 40 lira.

41. Manastiri Stavridhit gjendet në verilindje të fshatit Dhërmi të Himarës. Manastiri është themeluar në shek. XVI. Të ardhurat vjetore manastiri i ka pasur 25 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar "Burimit Jetëdhënës".

42. Manastiri i Zhejit është në fshatin Zhej të Zagorisë dhe i është kushtuar Burimit Jetëdhënës. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 50 lira.

43. Manastiri i Shën Janit gjendet gjysmë ore në perëndim të Palasës së Himarës dhe është ndërtuar në shek. XVI. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 30 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar "Joan Pagëzorit".

44. Manastiri i Skutarit gjendet në verilindje të fshatit Vuno të Himarës është themeluar më 1700 pas Krishtit. Kisha e

³⁴⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 298, faqe 155.

³⁴¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 683, faqe 266.

manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Shën Marisë”. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 20 lira.

45. Manastiri i Bubullimës gjendet në lagjen Lates të fshatit Vuno të Himarës. Kisha e manastirit i është kushtuar “Joan Pagëzorit”. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 20 lira.

46. Manastiri Vasiliko gjendet në juglindje të Dhërmiut dhe është ndërtuar në shek. XVI. Të ardhurat vjetore manastiri i ka pasur 30 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Ipapandisë” dhe feston më 2 shkurt.

47. Manastiri i Kostarit është pikturuar më 1775 pas Krishtit. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 30 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Shën Mërisë” dhe feston më 15 gusht.

48. Manastiri i Akrorizës gjendet në bregdet midis fshatrave Nivicë e Shën Vasil. Manastiri është themeluar në shek. XIII. Të ardhurat vjetore manastiri i ka pasur 50 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Gjergjit”.

49. Manastiri i Shën Vasilit gjendet në fshatin Shën Vasil. Të ardhurat vjetore manastiri i ka pasur 80 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Vasilit”.

50. Manastiri i Voloterit është afër fshatit Nivicë. Manastiri është ngritur në shek. XVIII. Të ardhura vjetore të manastirit kanë qenë 50 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Gjergjit”.

51. Manastiri i Erindit gjendet në fshatin Erind dhe është ndërtuar në shek. XVI. Manastiri ka pasur të ardhura vjetore 40 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shën Thanasit”.

52. Manastiri i Gjatit gjendet pranë fshatit Gjat. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 20 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Fjetjes së Hyjlindëses” dhe feston më 15 gusht.

53. Manastiri i Nokovës gjendet midis fshatrave Nokovë e Mingul të Lunxhërisë. Manastiri është ngritur gjatë XVIII. Të ardhurat vjetore të manastirit kanë qenë 80 lira. Kisha e manastirit i është kushtuar “Shpërfytyrimin” dhe feston më 6 gusht.³⁴²

³⁴²-Manastiret e Mitropolisë së Hirëshme të Gjirokastrës, Ngjallja, shtator 1993, faqe 4,5.

KREU I PESTË


SHPELLAT EREMITE

Shpellat e eremitëve janë në shpate malesh ose nëpër shkëmbinj të thepisur, gjë që e bën të vështirë ngjitjen në to. Në Shqipëri janë rreth 13 të tilla, të cilat i kanë qëndruar kohës. Pozicioni i tyre gjeografik ka bërë që të mbeten të padëmtuara. Asketët që kanë jetuar nëpër shpella, i kanë zbukuruar me afreske dhe ikona, që përbëjnë kryevepra të artit kristian. Këto shpella përbëhen nga paraklisi ku asketi lutej vazhdimisht dhe nga vendi i banimit, zakonisht një kthinë me përmasa të vogla. Asketët bënin jetë shumë të thjeshtë. Pjesën më të madhe të kohës ia kushtonin shërbesave dhe lutjeve. Detyra e parë e një murgu ortodoks është lutja dhe pikërisht duke u lutur ai shpreson t'u shërbejë të tjerëve. Zakonisht asketët nga përrulësia nuk i shkruanin emrat në ikona dhe piktura murale.

SHPELLA E SHËN MËRISË NË LIQENIN E PRESPËS

Shpella e “Shën Mërisë” në Liqenin e Prespës ndodhet në ujdhesën e Maligradit. Ajo përbëhet nga dy zgavra shkëmbore, me një lartësi prej 3 dhe 20 metrash nga niveli i ujit të liqenit.

Paraklisi është bazilikë njënefëshe me përmasa 3.30x4.60 metra. Zgavra e sipërme ka qenë qelia e eremitit dhe është e mbyllur vetëm me një mur, në të cilin gjenden dera dhe dritarja. Paraklisi me qelinë lidhen me anën e një korridori të ngushtë, në fundin e të cilit janë shkallët. Muret nga ana veriore dhe perëndimore të paraklisit janë shkëmbore, ndërsa muret lindore dhe jugore janë ndërtuar me gurë ranor dhe baltë. Hyrja për në kishë bëhet nëpërmjet një porte druri të gdhendur në murin perëndimor.



Paraklisi përbëhet nga hierorja dhe naosi, që ndahen me një ikonostas druri të gdhendur. Qelia e eremitit ka një derë që të nxjerr mbi një ballkon druri, prej ku duket pamja e liqenit. Paraklisi është ndërtuar në vitin 1345 dhe është rindërtuar më 1369 nga Kesar Novaku. Në fillim kisha ka qenë e ulët dhe mbulohej nga një çati dyujëse, e cila mbështetej mbi një strukturë druri. Muratura ka qenë me gurë të papërpunuar të lidhur me baltë. Në fazën e

dytë të ndërtimit muret u ngritën dhe kisha u mbulua me qemer më të lartë. Muratura është lidhur me llaç gëlqereje dhe me tulla.¹ Afresket i përkasin viteve 1345-1369 dhe janë pikturuar nga ikonografë anonimë. Sipërfaqja e brendshme e kishës mbulohet nga afresket që i përkasin vitit 1345. Afresket janë porositur nga ktitori Bojko. Në kungë gjendet skena e “Shestjes”. Mbi apsidë “Platitera” dhe nën të “Mistagogjia”. Anash apsidës gjendet skena e “Ungjillëzimit” dhe në vijim “Shën Stefani” në niken e prothesit. Dhiakon Laurenti në niken e diakonikonit ndërsa në brezin e fundit të apsidës gjenden etërit e mëdhenj të kishës të veshur me fellonë e stiharë dhe duke mbajtur secili ungjillin ndër duar. Në brezin e fundit të faqes së murit verior gjenden Anargjendët Kozma e Damjan, Shën Mëhilli dhe Shën Mitri. Skena më interesante është “Shestia”, e cila është pikturuar sipas Veprave të Apostujve Kreu 1, vargjet 9-14.² Përreth apsidës në kungën e kishës gjendet mbishkrimi: “Lutje e shërbëtorit të perëndisë Bojkut dhe Evdhoksisë shumë fisnike dhe të bijve të saj. Kunga është pikturuar prej tyre në vitin 6853 (=1345)”.³

Afresket që gjenden në shtojcën e kishës si dhe ata jashtë kishës, në pjesën e sipërme të fasadës perëndimore përmby niken e portës janë porositur nga ktitori Kesar Novaku në vitin 1369. Tematika e afreskeve përmby skena të festave të mëdha si dhe figura shenjtorësh e martirësh: “Lindja e Krishtit”, “Ipapandia”, “Pagëzimi i Krishtit”, “Ngjallja e L Lazarit”, “Hyrja në Jeruzalem”, “Deisis”, “Krishti para Kajafës”, “Krishti para Pilatit”, “Tallja e Krishtit”, “Ruga e Kryqit”. Në brezin e poshtëm gjenden skenat: “Fjetja e Shën Mërisë”, “Kryqëzimi i Krishtit”, “Guri”, “Ngjallja”.

¹-Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004, faqe 195.

²-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 21-.213.

³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 286, faqe 149.

Nën këto skena gjenden medalionet e shenjtoreve dhe të martirëve në gjysëmfigurë.⁴ Mbi pjesën jugore të faqes së murit perëndimor gjendet mbishkrimi: “U ngrit prej themeli dhe me përpjekje e mundime ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i së mbishenjtës zonjës sonë Hyjlindëse dhe u pikturua prej zotit të tij të gjithlumtur Kesar Novakut, në kohën kur ishte igumen Jonaj, në kohën e sundimit të gjithlartit Kral Velikashinit dhe të kryesimit peshkopal të kryepeshkopatës së Justinianës së parë, viti 6877. (=1369).⁵ Pranë portreteve të personave të pikturuar në fasadën e kishës gjenden këto mbishkrime: “I gjithlumuri kesar Novaku. Shumë fisnikja Kesarisa, zonja Kali. Shumëfisnikja zonja Mari, bija e tij. I gjithlumturi Amirali, biri i tij”.⁶ Mbi faqen e brendshme të murit jugor të kishës është shkruar: “Këtë shtëpi ati e ndërtoi, këtë shtëpi biri e përforcoi, këtë shtëpi shpirti i shënjtë e përtëriu, ai që ndriçon dhe përforcon dhe shenjtëron shpirtet tona”.⁷ Ky mbishkrim vërtet është pa datë, por duke u mbështetur në mënyrën e shkrimit daton më 1369. Mbi dyert e bukur atë ikonostasit gjendet ky mbishkrim: “Viti 7112 (=1604). Lutje e shërbëtorit të perëndisë, Prodanit”.⁸ Mbi portën perëndimore jashtë kishës gjendet ky mbishkrim: “U ndërtua prej themeli dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i Hyjlindëses me kontributin....në vitin 7115 (=1606) në muajin dhjetor 30”.⁹

⁴-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 216.

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 287, faqe 150.

⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 289, faqe 151.

⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 288, faqe 150.

⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 299, faqe 155.

⁹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 301, faqe 156.

SHPELLA E UNGJILLËZIMIT NË LIQENIN E PRESPËS

Shpella e “Ungjillëzimit” në Liqenin e Prespës gjendet në lartësinë 20 metra mbi një shkëmb të thepisur në anën perëndimore. Në shpellë ngjitesh me anën e shkallëve të drunjta, të cilat varen pingul mbi bregun e liqenit. Prej andej ngjitesh përsëri me anën e shkallëve të drurit mbi një çardhak prej dërrase të mbështetur në shkëmb, në anën lindore të të cilit ndodhet paraklisi i Ungjillëzimit ose Ballashtoja në gjuhën e vjetër sllave, ndërsa në atë veriore gjendet qelia e asketit. Muret e shpellës janë ndërtuar me gurë të paskalitur, tulla të holla dhe tjegulla, llaç gëlqeror dhe breza druri. Paraklisi i përkët shek. XII. Ikonostasi që ndan hieroren nga naosi është prej dru dëllinje ku janë gdhendur zbukurime të ndryshme nga bota bimore. Në dyert e bukura të ikonostasit është pikturuar ikona e Ungjillëzimit. Ikonostasi prej druri është ngjyrosur në ngjyrë të zezë. Në paraklisin e Ungjillëzimit kanë shpëtuar në gjendje të mirë edhe disa afreske, të cilat i përkasin shekullit të XII. Mbi sipërfaqen e murit të jashtëm perëndimor, përmbi deriçkën e paraklisit gjenden dy piktura murale: Krishti gjykatës i drejtë me përmasa 1.70x0.60 metra dhe nën të Ungjillëzimi. Skena e Krishtit Gjykatës i drejtë paraqet Krishtin duke ndenjtur në një fron me duar të hapura dhe duke treguar shenjët e gozhdëve në pëllëmbë. Krishti është stolitur me veshje vishnje dhe me hiton blu në vishnje. Përrreth fronit qëndrojnë engjëjt.¹⁰

SHPELLA E SHËN MËRISË NË GLLUBOKO TË PRESPËS

Shpella e “Shën Mërisë” në Glluboko gjendet në bregun verior të Liqenit të Prespës, në lindje të katundit Bezmisht. Shpella

¹⁰-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 146-147.

ka dy zgavra natyrore. Njera është paraklisi dhe tjetra ka qenë banesa e eremitit. Paraklisi ka përmasa 3.17x2.10 metra dhe i përket shekullit XIII. Faqet perëndimore dhe veriore janë shkëmbore, ndërsa faqet lindore dhe jugore janë prej muresh të ndërtuar me gurë ranorë, të lidhur me baltë. Hyrja për në paraklis bëhet me anën e një dere në anën perëndimore të murit jugor. Kunga e paraklisit ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të stolisur me motive gjeometrike. Në nikën e rrafshtë të harkuar nga sipër gjendet “Shën Mëria e tipit Oranta”, ndërsa poshtë në faqen e jashtme të paraklisit mbi një nikë tjetër është pikturuar “Shën Mëris Glikofilusa”. Nën pikturën e Shën Mërisë, pranë portës së shpellës gjendet një mbishkrim: “U pikturua kjo portë hyjnore e së mbilavdëruarës Hyjlindëses nga mëkatar Partheni dhe nga e gjithë shoqëria jonë. Perëndia i ndjeftë priftërinjtë që të parë iu përpoqën me të gjitha forcat pa u lodhur. Me dorën e Aleksit, gjithashtu nxënës i Jan Zografit”.¹¹



Në mbishkrimin që ndodhet mbi portën jugore të shpellës kemi: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i së mbishenjtës Hyjlindëses që nga themeli me përpjekjet dhe

¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.511, faqe 215-216.

shpenzimet e gjithoshënarit murg Parthenit, në kohën kur ishte igumen gjithoshënar, jeromonak Paisi, ktitori”.¹² Nga ky mbishkrim del se eremit Partheni ka asketuar në shpellë dhe e ka ngritur vetë atë që nga themeli. Gjithashtu Partheni ka bërë edhe pikturat murale të shpellës me ndihmën materiale që i ka dhënë ktitor Paisi. Ky i fundit ka qenë igumen i ndonjë manastiri aty pranë, në juridiksionin e të cilit ishte murg Partheni. Nëpër faqet e suvatuara të shkëmbit gjendet akreske. Në apsidë paraqitet Platitera e tipit Oranta në gjysmëfigurë pa Emanuelin. Anash apsidës gjendet skena e “Ungjillëzimit”, ndërsa në faqen e murit jugor në kungje skena e “Lindjes së Krishtit”. Në anën veriore gjendet skena e “Ipapandisë”, ndërsa në murin jugor skena e “Pagëzimit të Krishtit”. Viojnë skenat “Ngjallja e Llazarit”, “Kryqëzimi i Krishtit”, “Vajtimi i mbivarrshëm”, “Guri”, “Ngjallja” dhe “Shestja”. Në brezin e poshtëm paraqiten shenjtoret: Në nikën e prothesit është Shën Stefani dhe në nikën e dhiakonikonit Roman Melodiozi. Në faqet anësore gjenden: Joan Gojarti, Vasili i Madh, Shën e Diela, Shën Kostandini dhe Elena, Shën e Premtja, Shën Aleksandri, Shën Mitri, Shën Gjergji, Shën Kolli, Shën Nestori dhe Shën Prokopi.¹³


SHELLA E ARANGJELIT TË TRESTENIKUT NË PUSTEC

Shpella e “Arangjelit të Trestenikut” gjendet në bregun jugor të Liqenit të Prespës, në vendin e quajtur Trestenik rreth tetë kilometra larg nga fshati Pustec. Në një faqe shkëmbore rreth 20 metra nga niveli i liqenit ndodhen dy zgavra, të cilat komunikojnë midis tyre. Zgavra e poshtme ka shërbyer si qeli për asketin, ndërsa ajo e sipërme ka qenë paraklis me përmasat 2.50

¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 513, faqe 216-217.

¹³-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 169-171.

me 2.30 metra. Muret janë prej gurësh të pagdhundur të lidhur me llaç dhe baltë. Faqja lindore është e suvatuar dhe e pikturuar me afreske. Në faqen e shkëmbit ndërmjet tryezës së shenjtë dhe prothesit gjendet mbishkrimi: “Kujto o Zot shpirtin e shërbëtorit të Perëndisë, Jeromonak Visarit”.¹⁴ Ky i fundit mendohet të ketë qenë ai që ka asketuar në shpellë. Nga afresket mund të veçojmë atë të Platiterës, Vasilin e Madh, Joan Gojartin, Kryedhjakon Stefanin, Simeon Stilitin etj, të cilët janë pikturuar në faqen lindore të shpellës. Në apsidë gjendet Platitera me Emanuelin në kraharor.



Skena përfshihet brenda një brezi të bardhë në formë patkoi dhe ka përmasa 0.43x0.30 metra. Platitera është e tipit Oranta dhe paraqitet deri më gju. Ajo mban duart e hapura në pozicion lutjeje. Nën të gjendet brezi me skenën liturgjike “Melizmosin”, ku paraqitet Krishti me përmasa 0.63x0.54 metra. Ai qëndron i shtrirë përpara potirit të shenjtë dhe është i mbuluar me një pëlhurë

¹⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 512, faqe 216.

të kuqe të çelët. Kjo skenë simbolizon të shenjtat. Në anë të tryezës paraqiten dy engjëj me eksapterë në dorë. Engjëjt janë stolisur me stiharë të bardhë. Anash tyre gjenden dy hierarkët Vasili i Madh dhe Joan Gojarti. Hierarkët paraqiten me fellonë të bardhë me kryqe të zeza, mbajnë epitrailë në ngjyrë të kuqe dhe mbi supe omoforë të bardhë me kryqe të zezë. Përreth apsidës së paraklisit është pikturuar një brez i gjerë dekorativ. Mbi nikën e prothesit paraqitet Kryedhiakon Stefani, i veshur me stihar të bardhë. Në dorën e djathtë mban një temianicë dhe në të majtën mban artoforin e kishës. Ndërmjet nikës së prothesit dhe asaj të altarit gjendet Simeon Stiliti, i veshur me sqimë murgërore dhe duke mbajtur një kryq në dorën e djathtë. Mbi portën e zgavrës së poshtme, e cila ka qenë qelia e eremitit, brenda një nike të rrëfshat të harkuar nga sipër gjendet “Shën Mëria e tipit Odigitria”, e cila paraqitet duke mbajtur Krishtin foshnje në krahun e majtë. Odigitria është e veshur me mafor vishnje të errët. Gjithashtu edhe Krishti foshnjë paraqitet me hitonin në ngjyrë më të çelët. Duke u nisur nga përkrimi analitik i pikturës murale të paraklisit të “Arkangjelit” mund të themi se i përket shekullit XII.¹⁵

SHPELLA E LETMIT TË ÇERMENIKËS

Shpella e Letmit të Çermenikës ndodhet në një lartësi prej 300 metrash në faqen jugore të shkëmbit të Letmit mbi lagjen Koshorisht në Çermenikë. Paraklisi i është kushtuar “Shën Mërisë” dhe daton në shekullin XI. Shpella është një zgavër shkëmbore me përmasa 7x5 metra. Tavani i shpellës është mjaft i lartë dhe i suvatuar. Në të gjenden dy piktura murale brenda dy medalionesh të mëdha. Tek njëra gjendet Pandokratori dhe tek tjetra Platitera. Mbi maforin e hapur të Platiterës gjendet skena e familjes

¹⁵-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 112-115.

perandorake, e cila ka porositur pikturën. Ndërsa ndërmjet brerores dhe krahut të djathtë të Platiterës është shkruar: “U pikturua ky tempull hyjnor i së mbishenjtës Hyjlindëses, me dorën time të Stanos”.¹⁶ Pandokratori përfshihet brenda një medalioni, i cili paraqitet me qëndrimin frontal duke bekuar me dorën e djathtë dhe me ungjillin në të majtën. Ai është veshur me himation blu të çelët dhe hiton të kuqërremtë. Rreth kokës së tij gjendet një brerore e madhe ari, e kryqëzuar në dy linja horizontale dhe vertikale duke formuar kryqin. Platitera është e tipit Oranta dhe paraqitet në gjysmëfigurë, me duart e hapura dhe me qëndrim lutës. Ajo është e stolisur me mafor të kuq të çelët, i cili ka tri yje, nga një mbi shpatulla dhe një mbi ballë. Yjet simbolizojnë virgjërinë e Platiterës. Emaueli gjendet mbi kraharonin e Platiterës dhe paraqitet duke bekuar me dorën e djathtë dhe me një rrotull në dorën e majtë, e cila simbolizon misionin e predikimit hhyjnor. Ai është veshur me stihar të bardhë të stolisur me pika në ngjyrë të kuqërremtë.

Mbi maforën e Platiterës është pikturuar në miniaturë familja e ktitorit, e cila përbëhet nga tetë persona. Në qëndër qëndron kryefamiljari dhe përpara tij tre bijtë njëri pas tjetrit. E shoqja dhe tre bijat qëndrojnë pas tij. Personi që paraqitet në krahun e majtë të Platiterës është shumë i dëmtuar. Kryefamiljari mban në duar maketin e paraklisit, ndërsa personazhet e tjerë paraqiten në pozicion lutjeje. Ndonëse ende nuk dihet se cili ka qenë ktitori i paraklisit, por duke u nisur nga veshja luksoze ka të ngjarë të ketë qenë ndonjë sundues feudal vendas.¹⁷

¹⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 77, faqe 77.

¹⁷-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 94-96

SHEPELLA E SHËN GJERGJIT NË DHIVËR TË DELVINËS

Shpella e “Shën Gjergjit” gjendet në pjesën veriore të fshatit Dhivër të Delvinës. Kisha është ndërtuar në një faqe shkëmbi dhe përbëhet nga një zgavër natyrore e rrethuar me mur. Çatia e kishës mbulohet pjesërisht prej shkëmbit dhe pjesa e mbetur me plloça dhe tjegulla. Dera që hyn në kishë gjendet në anën veriore. Kisha ndriçohet nga dy dritare dhe përbëhet nga pronaosi dhe naosi. Përmasat e kishës janë 5x2 metra. Kjo kishë ka shërbyer si paraklis për eremitët që kanë jetuar përreth. Faqet e mureve dhe ato shkëmbore janë të suvatuara dhe të pikturuara me afreske. Paraklisi përbëhet nga naosi me përmasa 4.35x2.00 metra dhe narteksi me përmasa 5.40x0.45 metra. Në kungën e madhe nika e prothesit është e gdhendur në shkëmb dhe ka përmasa 0.54x0.45 metra. Afresket e kishës janë pikturuar nga ikonografë anonimë. Eremitët ikonografë qenë njerëz të pëulur, prandaj si të tillë nuk e vinin emrin e tyre mbi afreske. Në narteks gjenden këto afreske: skena “Fjetja e Hyjlindëses” me përmasa 1.00x0.56 metra, “Shën Gjergji duke shpëtuar të bijën e mbretit” me përmasa 0.70x0.22 metra, “Pantokratori”, i cili paraqitet si gjysmëfigurë, Teodor Tironi dhe Teodor Stratilati gjithashtu paraqiten në gjysmëfigurë. Në faqen e murit që ndan narteksin nga naosi gjendet skena “Deisis”. Në naos gjenden afresket: mbi hyrjen gjendet skena “Guri” me përmasa 1.00x0.65 metra. Në këtë skenë biblike figurat e grave miropurëse janë fshirë nga mesi e sipër. Ndërsa engjëllit që qëndron mbi gur i ruhet vetëm dora që u tregon varrin grave miropurëse. Në të djathtë të gjendet skena e “Ngjalljes” me përmasa 1.00x1.00 metra. Mbi faqen lindore të shkëmbit gjendet skena e “Shpërftyrimit” me përmasa 1.00x0.70 metra. Djathtas saj gjendet skena “I drejti i ditëve”, në të cilën paraqitet një plak me duar të hapura, i cili simbolizon Krishtin. Majtas gjendet skena e “Ungjillëzimit” ku paraqitet Gabrieli duke i dhënë lajmin e mirë Hyjlindëses. Në faqen

jugore të shkëmbit gjendet “Shestja” me përmasa 2.60x1.80 metra. Nën këtë skenë biblike gjendet scena “Shpëtimtari” me përmasa 1.10x0.82 metra. Në faqen e murit perëndimor të kishës gjendet skena “Fjetja e Shën Mërisë” me përmasa 1.62x1.30 metra. Një skenë të tillë e ndeshim edhe në narteksin e kishës, por me përmasa më të vogla. Në kungën e madhe gjenden pesë figura hierarkësh, të cilët kanë veshje hierartike me fellonë dhe omoforë të bardhë. Në gjendje të mirë ruhen Shën Athansai dhe Silvestri i Romës. Platitera është e ritokuar, ndërsa dy engjëj që paraqiten anash saj janë të zbehtë. Në nikën e prothesit paraqitet Shën Stefani. Në kungën e vogël gjenden Simeon Stiliti dhe Danieli. Pranë tryezës së shenjtë gjenden apostull Jakovi dhe Vasili i Madh. Pranë tyre gjenden Shën Kozmai dhe profeti Ilija. Në brezin e dytë të faqes së shkëmbit lindor gjenden kryeengjëjt Mihael dhe Gabriel.¹⁸



Në faqen që ndan naosin me kungën e vogël gjendet afresku i të “Gjithëpushtetshmit”, i cili e paraqet Krishtin duke bekuar me dorën e djathtë dhe duke mbajtur ungjillin në dorën e majtë. Ky afresk mendohet të jetë i shekullit XVII. Mbishkrimi që gjendet poshtë afreskut thotë: “Lutja e shërbëtorit tënd prift Theodorit dhe bashkëshortes e fëmijëve të tij”.

¹⁸-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 85-93

SHPELLA E URAKËS NË QAFË THANË

Shpella e Urakës gjendet pranë fshatit Urakë të Qafë Thanës. Është një shpellë natyrore, e cila përbëhet prej një zgavre të madhe dhe sipër saj ka një kthinë të vogël, e cila ka qenë qelia e eremitit. Nga ana jugore shpella qarkohen nga një mur gëlqeror prej rëre të trashë. Shpella ndriçohet nga dy dritare të vogla. Zgavra e madhe ka shërbyer si kishë. Prej një korridori të ngushtë mund të ngjitesh në qelinë e eremitit, e cila është e shtruar me dërrasa. Nga afresket e shellës së Urakës kanë mbetur vetëm disa fragmente. Mbi faqen lindore të shkëmbit gjendet afresku “Fjetja e Hyjlindëses”, i cili ka pësuar dëmtime. Nga skena “Fjetja e Hyjlindëses” ruhet figura e Krishtit foshnjë të mbështjellë në duar që simbolizon shpirtin e Shën Mërisë. Anash tij paraqiten dy portrete engjëjsh, ndërsa paranë trupit të shtrirë e të vdekur të Shën Mërisë gjenden fragmente me figurat e apostujve. Në mesin e skenës paraqitet Krishti me qëndrim frontal, i stolisur me veshje vishnje dhe hiton të kaltër. Brerorja që gjendet mbi të kryqëzohet prej dy linjash vertikale dhe horizontale duke formuar një kryq. Në të djathtë të gjendet afresku i Shën Ilisë, i cili paraqitet duke mbajtur një rulo të hapur në dorën e majtë. Veshja e tij është ngjyrë blu të errët dhe hotini i gjelbër. Afresket e “Shpellës së Urakës” mendohet të jenë pikturuar rreth shekullit XII.¹⁹

SHPELLA E KALIVAÇIT NË TEPELENË

Shpella e Kalivaçit gjendet përballë fshatit Derëz të Tepelenës. Shpella është një zgavër e hapur dhe përbëhet nga altari dhe prothesi. Pranë shpellës gjenden disa zgavra shkëmborë, të

¹⁹-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 116-117.

cilat banoreshin nga eremitët. Në Shpellën e Kalivaçit gjenden disa afreske. Mbi altar është pikturuar Platitera, në gjysmëfigurë duke mbajtur Emanuelin në kraharor. Platitera paraqitet e veshur me maforën ngjyrë vishnje me pala të errëta, ndërsa Emanueli me veshje të bardha në krem. Në anën e djathtë Platiterës gjendet një engjëll, ndërsa në anën e majtë paraqitet figura e një murgu të përkulur paksa dhe me duart e shtrira në pozicion lutjeje. Këto figura paraqiten në një sfond ngjyrë gri në të gjelbër ulliri. Në niken e prothesit gjendet afresku i Shën Stefanit, të cilit i duket vetëm brerorja e artë dhe orari që i varet nga supet, i stolisur me linja të kryqëzuara. Afresket e Shpellës së Kalivaçit mendohet të jenë pikturuar rreth shekullit XIV.²⁰

SHPELLA E SHËN MARENËS

Shpella e “Shën Marenës” gjendet në afërsi të Konispolit, në jug të Butrintit. Mb grykën e Bogazit në faqen jugore të malit Milet. Ajo përbëhet nga një zgavër e madhe shkëmbore me përmasa 8x4 metra. Faqet e shkëmbit janë të suvatuara me llaç gëlqeror dhe të pikturuara, por të dëmtuara nga kripërat gëlqerore. Mbi faqen lindore të shkëmbit gjendet skena “I vjetri i ditëve”, në të cilën paraqitetnjë plak i moçëm me mjekër e me flokë të thinjur, i stolisur me veshje shumë të gjera dhe me qëndrim frontal. Në kraharorin e plakur është pikturuar një foshnjë dhe në pëqi të tij një burrë lakuriq. Të tri figurat e paraqitura rrethohen nga tri brerore të kryqëzuara dhe përfytyrojnë Krishtin. Plaku i moçëm është personi i dytë i Trinisë së Shenjtë, foshnja në kraharorin e plakut është Emanueli, ndërsa figura e tretë përfytyron sakrifikimin e Krishtit të vdekur. Në pikturat perëndimore paraqitet i vdekur në pëqi të Shën Mërisë në skenën “Pieta” që do të thotë mëshirë. Gjithashtu në faqen lindore të shkëmbit gjendet i pikturuar një

²⁰-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 115.

hierark, i cili paraqitet më këmbë me qëndrim frontal. Ai është duke bekuar me dorën e djathtë dhe duke mbajtur engjëllin në të majtën. Hierarku ka veshur një fellon ngjyrë vishnje të errët dhe stihar e omofor me kryqe të zeza. Afresket e “Shpellës së Shën Marenës” mendohet të jenë pikturuar rreth shekullit XII.²¹

SHPELLA E SINJËS NË BERAT

Në brendësinë e një guve shkëmbore pranë fshatit Sinjë të Beratit gjendet kishëza e “Fjetjes së Hyjlindëses”. Kisha është e ndërtuar me mur guri dhe ka përmasa 7x3 metra. Hyrja për në naos bëhet nga një portë e vogël. Rolin e çatisë e luan shkëmbi i pjerrët, ndërsa apsida e kishës krijohet prej dy mureve të vegjël. Sipas një mbishkrimi që gjendet në shpellë kisha është pikturuar në vitin 1292. Në apsidë është pikturuar Platitera, ndërsa në vendin më të dukshëm gjendet skena e “Fjetjes së Hyjlindëses”. Poshtë Platiterës gjendet katër hierarkët e kishës. Majtas apsidës është pikturuar një murg, i cili mban një temjanicë në dorë. Ky mendohet të jetë ktitori i kishës.²²

²¹-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006, faqe 122-124.

²²-Fatmir Thaçi, të dhëna rreth pikturës murale në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” në Sinjë, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 158.

KREU I GJASHTË

ARTI I IKONOGRAFISË NË SHQIPËRI

Arti i ikonografisë në Shqipëri e arriti kulmin e lulëzimit rreth shekujve XII dhe XVIII. Këtë e vërtetojnë afresket dhe ikonat e shumta, të cilat i kanë rezistuar kohës dhe kanë mbërritur deri në ditët tona. Ikonografia është arti i pikturimit të afreskëve dhe ikonave të lëvizshme. Ikonografia lindi, triumfoi dhe u zhvillua bashkë me krishtërimin. Fjala ikonë vjen nga fjala greke “ἰκόνις” që do të thotë “figuroj”. Ikonat pikturohen mbi dërrasë dhe më pas vendosen në ikonastas sipas një renditje të caktuar. Arti bizantin i pikturimit të ikonave i nënshtrohej rreptësisht kanoneve të kishës. Ikonografit nuk i lejohej të ndryshonte përmbajtjen dhe rregullat që përcaktonin kanonet e shenjta dhe tradita e kishës. Fytyrat e shenjtorëve që paraqiteshin nëpër ikona shprehin asketizëm dhe përlulesi. Shenjtorët kanë qenë mjerëz që kreshmonin, luteshin dhe bënin jetë të pastër duke iu përkushtuar Perëndisë.

Ikonat e lëvizshme paraqesin skena nga Bibla ose potrete shenjtorësh dhe pikturohen në dru qiparisi ose pishe. Në vitet e persekutimeve të kishës, ikonat ishin të pakta dhe mbaheshin në fshehtësi nëpër shtëpitë dhe katakombet e të krishterëve, por në kohën e Kostandinit të Madh, kur krishterimi u shpall si fe e lirë, ikonat u shtuan duke zbukuruar muret e shtëpive dhe të kishave.

Kisha kurdoherë ka mësuar se ikonat duhet vetëm të nderohen, domethënë ndaj tyre të krishterët duhet të tregojnë nderim të thellë, por jo të adhurohen, sepse adhurimi i takon vetëm Perëndisë. Ky nderim i kushtohet personit, që përfaqëson ikona dhe jo imazhit dhe materialit, nga i cili është bërë ikona. Mjaft ikona të lëvizshme kanë pikturuar vëllezërit Zografi. Ikonat e ikonostasit të kishës “Burimi Jetëdhënës” në Korçë, të kishës së “Shën Kollit” në Vanaj të Myzeqesë etj. Gjithashtu Onufri ka pikturuar mjaft ikona të lëvizshme, nga të cilat mund të veçojmë ato të kishës “Vangjelista” dhe të “Shën Mitrit” në kalanë e Beratit. Në kompozicionin e ikonave bizantine Onufri ruan me fanatizëm traditën bizantine dhe kanonet e kishës.

Pikturat murale i kemi dy llojesh: a) *afresket* (al fresco) që pikturohen mbi suva të njomë dhe b) *al secco* të cilat pikturohen mbi suva të thatë. Afresket pikturohen mbi suva të njomë sepse vetëm me këtë mënyrë mund të realizohet kjo teknikë. Ngjyrat depërtojnë thellë në suva dhe bëhen një me të. Kjo është një mënyrë e vështirë, e cila kërkon që ikonografi të jetë me përvojë dhe i shkathët, sepse nëse thahet suvaja nuk është e lehtë të bëhen korrigjime. Ana pozitive e kësaj teknike është se ngjyrat depërtojnë tek njera-tjetra dhe rrezistojnë në shekuj.

Bizantinët nuk preferonin *al secco* domethënë pikturën mbi suva të thatë, sepse vepra të tilla nuk i rezistonin kohës. Të gjitha pikturat murale që kanë mbërritur deri në ditët tona janë afreske. Nga afresket më të vjetra mund të përmendim ato të shekullit XII në kishën e “Shën Stefanit” në Dhërmi ku paraqiten Shën Dhimitri dhe Shën Stefani. Gjithashtu në kishën e Rubikut paraqiten Apostujt duke u kunguar. Afreske të shekullit XIV kanë shpëtuar në kishën e “Shën Marisë” në Maligrad, në kishën “Shën Mëria Vllaherna” në Berat, në atë të “Shën Thanasit” po në Berat etj.¹

¹-Theofan Popa, Piktura e vjetër e popullit tonë, Ngjallja, gusht 1995, faqe 10.

Në periudhën pasbiznatine afreskët më të hershën janë ata të kishës së “Shën Gjergjit” në Leshnicën e Sipërme dhe të kishës së “Shën Thanasit” në Peca, të cilat datojnë më 1525. Ikonografi Ilia Llongoviti me origjinë nga fshati Llongo i Dropullit në vitin 1525 ka pikturuar kishën e “Shën Thanasit” në Peca të Sarandës dhe kishën e “Shën Gjergjit” në Leshnicën e Sipërme. Në vitin 1554 në kishat e Shpatit shfaqet talenti i ikonografit të shquar Onufrit. Ai ka pikturuar kishën e “Shën Kollit” në Shelcan, kishën e “Shën e Premtes” në Valësh, kishën e “Shën Todrit” të kalanë e Beratit etj. I biri i Onufrit, Nikolla ka pikturuar në vitin 1578 kishën e “Shën Mërisë Vllahernës” në kalanë e Beratit. Gjithashtu së bashku Joanin ka pikturuar kishën e “Shën Kollit” në Kurjan të Fierit. Në kishën e “Shën Mërisë Vllahernës” në kalanë e Beratit ka pikturuar edhe ikonografi Onufër Qiprioti. Në vitin 1622 në bashkëpunim me ikonografin Alivizi Foka ka pikturuar afresket e kishës së “Shën Mërisë” së Vllahogoranxisë. Në vitet 1614, 1615 Onufër Qiprioti ka pikturuar tre ikona të manastirit të Çatistës në Gjirokastrë. Mihail Linotopi në vitin 1617 ka pikturuar kishën e “Profetit Ilia” në Jorgucat, gjithashtu po në këtë vit ka pikturuar muralet e kishës së “Ungjillëzimit” në manastirin e Vanishtës. Në vitin 1630 Mihail Linotopi bashkë me të birin Kostandinin dhe Nikollën kanë pikturuar afreskët e kishës së “Shën Kollit” në Saraqinishtë, ndërsa Kostandini dhe Nikolla më 1653 kanë pikturuar muralet e kishës së “Profetit Ilia” në Stegopull. Ikonograf Mihali nga Zerma në vitin 1662 ka pikturuar afreskët e manastirit të “Shën Mërisë” së Kamenos dhe më 1672 muralet e kishës së “Shën Mërisë” në manastirin e Kakomesë. Piktoret Theodhori, Anagnosti dhe Steriani nga Agrafa në vitin 1712 kanë pikturuar muralet e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në Voskopoje. Sipas mbishkrimeve kishtare ikonograf Adhami nga Theotoqi në vitin 1754 ka pikturuar kishën e manastirit të “Shën Triadhës” së Pepelit. Gjithashtu në vitin 1754 Kostandin Shpataraku ka pikturuar kishën e manastirit të “Shën Marenës” në Llëngë të Pogradecit.

Në vitin 1744 vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi kanë pikturuar afreskat e kishës së manastirit të “Shën Mërisë” së Ardenicës. Gjithashtu më 1744 kanë pikturuar kishën e “Shën Thanasit” në Voskopojë dhe më 1750 hajatin e kishës së “Shën Kollit” në Voskopojë. Në vitin 1750 kishën e “Anargjendëve Kozma dhe Damjan” në Vithkuq të Korçës. Më 1764 manastirin e “Shën Pjetrit dhe Pavlit” në Vithkuq. Më 1782 Kostandini bashkë me Terpon kanë pikturuar kishën e “Shën Gjergjit” në Libofshë. Ikonografët e familjes Çetiri e kanë ushtruar aktivitetin e tyre kryesisht në kishat e Myzeqesë. Aktiviteti i tyre daton prej vitit 1762 deri më 1853, duke stolisur rreth 12 kisha nga bregdeti i Karavastasë deri në Berat. Ata kanë pikturuar afresket e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit, si dhe nëpër fshatrat e Myzeqesë: Karavasta, Toshkëz, Krutje e Sipërme, Fier, Vanaj, Strumë, Bishtqethëm, Kadipashaj etj. Në vitin 1726 ikonografi David Selenicasi ka pikturuar muralet e kishës së “Shën Kollit” në Voskopojë. Gjatë pikturimit të afreskeve ka pasur si ndihmësa Kostandinin dhe Kriston.²

SHKOLLA E BERATIT

Në shekullin XVI Berati ka qenë qendra më e madhe e artit mesjetar shqiptar. Shkolla ikonografike e Beratit mbështetet mbi frymën artistike të mjeshtrit të madh të ikonografisë shqiptare **Protopapë Onufri** nga Neokastra (Elbasani). Kjo shkollë luajti rol të rëndësishëm në artin ikonografik shqiptar gjatë shekujve XVI-XVII, me pasuesit e Onufrit nga të cilët u shquan biri i Onufrit, Nikolla me bashkëpunëtorin e tij Joanin, Onufër Qiprioti si dhe shumë ikonografë të tjerë të cilët preferuan të mbeten anonimë. Disa studiues si për shembull Theofan Popa, Moikom Zeqo,

²-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998, faqe 254-256.

Dhorka Dhamo etj e identifikojnë Onufrin si përfaqësues të shkollës së Beratit.³ Shumica e afreskeve murale që janë zbuluar deri më sot në vendin tonë ruajnë anonimatin. Ky fakt na bën të mendojmë se autorët e tyre kanë qenë murgj të thjeshtë, të cilët kanë punuar jo për të lënë emër, por për lavdi të Perëndisë. Përfaqësuesi më i rëndësishëm i shkollës beratase është Onufër Neokastriti. Pasuesit e tij në punimet e tyre janë ndikuar shumë nga ai por pa arritur në lartësitë e mjeshtërisë së Onufrit. Nuk dihet me saktësi data e lindjes së Onufrit, por mendohet të jetë nga Elbasani dhe të ketë qenë prift i martuar. Rreth mjedisit familjar të tij të dhënat janë të pakta. Njihet vetëm i biri Nikolla, i cili mësoi artin e ikonografisë prej babait të tij. Onufri ka qenë klerik duke mbajtur ofiqin “Protopapë” që do të thotë “Prift i parë “. Ky fakt na jep të kuptojmë se detyra kryesore e një kleriku në kishën ortodokse janë shërbesat e shenjta dhe gjatë kohës që i ngelej Onufri merej me ikonografi. Nuk dihet se cili episkop ortodoks e ka dorëzuar Onufrin prift dhe cili i ka dhënë ofiqin Protopapë, por vetëm një gjë është e qartë se ai ka ushtruar aktivitetin në shekullin XVI.



Në vitin 1951 një ekspeditë e Institutit të Shkencave, e drejtuar nga teologu Theofan Popa, zbuloi në kishën e “Shën

³-Avenir Sadikaj, Onufri dhe shtegëtimi i shpirtit bizantin në Europë, Gazeta Shqiptare, 25 gusht 2001, faqe 12-13.

Kollit” në Shelcan (fshat i krahinës së Shpatit në rrethin e Elbasanit) një mbishkrim të Onufrit.⁴ Mbishkrimi është shkruar në greqishten bizantine nga dora e mjeshtrit të madh Onufri dhe gjendet mbi faqen e murit verior të kishës, pranë tryezës së thisiastirit. Teksti i mbishkrimit është përkthyer nga Theofan Popa: “Kur të ngresh duart e tua te Perëndia o meshtar i Perëndisë, më përmend edhe mua mëkatarin dhe të paditurin piktor Onufirin”.⁵ Përmbajtja e këtij mbishkrimi na lë të kuptojmë se Onufri në atë kohë nuk ishte dorëzuar ende klerik, sepse i lutet meshtarit që ta kujtojë gjatë përgatitjes së dhuratave të shenjtëruara. Mendohet se ky mbishkrim duhet të jetë shkruar përpara vitit 1554, sepse duke u nisur nga mbishkrimi tjetër i Onufrit në kishën e “Shën e Premtes” në fshatin Valësh të krahinës së Shpatit kemi edhe këtë shtojcë:”..... më përmend edhe mua mëkatarin, prift Onufirin, piktorin dhe Protopapë të Neokastrës”.⁶

Një mbishkrim tjetër po në këtë kishë jep vitin 1554, i cili na bën të mendojmë se Onufri ka lindur dhe jetuar në shekullin e XVI.⁷ Onufri veprimtarinë e tij nuk e zhvilloi vetëm nëpër kishat e Shpatit dhe të Beratit, por e shtriu edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Në afresket e kishës së “Apostujve të Shenjtë” në Kostur gjejmë këtë mbishkrim të shkruar nga dora e Onufrit: “U pikturua prej Onufrit të ardhur kohët e fundit nga qyteti i shkëlqyer i Beratit”. Afresket datojnë rreth vitit 1547.⁸ Gjithashtu Onufri ka pikturuar ikonat murale edhe në manastirin e Sepçes në Shkup, kishën e “Metamorfozës” në manastirin e Zërzes etj.⁹

⁴-Theofan Popa, Onufri dhe biri i tij Nikolla, Ngjallja, shtator 1995, faqe 9.

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 7, faqe 52.

⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 14, faqe 55.

⁷-Moikom Zeqo, Onufri, Tiranë 1998, faqe 40.

⁸-Dhorka Dharmo, Piktura e mesjetës në Shqipëri, Tiranë 1974, faqe 14.

⁹-Adriana Peçi, Onufri, Dokumentar, Shekulli, 27 shkurt 2002, faqe 21.



Onufri përveç pikturave murale ka bërë edhe mjaft ikona të lëvizshme, nga të cilat mund të veçojmë ato të kishës “Vangjelista” dhe të “Shën Mitrit” në kalanë e Beratit. Në kompozicionin e ikonave bizantine Onufri ruan me fanatizëm traditën bizantine dhe kanonet e kishës. Ikonat e tij paraqesin pasazhe biblike, si “Lindja e Krishtit”, “Hyrja e Shën Mërisë në Tempull”, “Shpërfytyrimi” etj.¹⁰

Onufri ka qenë prift i martuar e ka patur edhe fëmijë, nga të cilët vetëm njëri është bërë i njohur. Ai është **Nikolla**, i cili ka vazhduar traditën e familjes. Këtë e vërteton një mbishkrim që është shkruar nga vetë dora e Nikollës mbi portën perëndimore brenda kishës së “Shën Mërisë Vllaherna” në Berat. “Piktori është Nikolla, biri i Onufrit, viti 7086 sipas kalendarit bizantin dhe 1578 sipas atij gregorian. Mund të mendojmë se në vitin 1756 Onufri nuk jetonte më dhe biri i tij Nikolla del si vazhduesi i veprës së mjeshtrit të madh të ikonografisë. Gjithashtu në Kurjan të Fierit në kishën e “Shën Kollit” teologu Theofan Popa ka zbuluar edhe

¹⁰-Theofan Popa, Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1974, faqe 12,13.

një mbishkrim tjetër, në të cilin biri i Onufrit Nikolla ka pikturuar kishën duke pasur si ndihmës një ikonograf tjetër Joanin. “Kur të ngresh duart para Perëndisë, o meshtar i Perëndisë, më përmend edhe mua mëkatarin dhe të paditurin Joanin dhe Nikollën”.¹¹

Nikolla është ikonografi i dytë më në zë i shkollës ikonografike të Beratit që ka pikturuar këto kisha: atë të “Shën Kollit” në Kurjan të Fierit, kishën e “Shën Marisë Vllaherna” në Berat, afresket e kishës së “Shën Gjergjit” në Arbanas të Bullgarisë etj. Një ikonograf tjetër që përfaqëson me dinjitet shkollën e Beratit është edhe **Onufër Qiprioti**, i cili ishte me prejardhje greke, por aktivitetin e tij e zhvilloi nëpër kishat e Beratit. Onufër Qiprioti ka lindur në Qipro dhe vite më vonë e gjejmë në Venedik. Në Berat mendohet se ka ardhur në vitin 1591 kur ishte në moshën 40-vjeçare. Në fillim ka pikturuar afresket në kishën e “Shën Kollit”. Një nga veprat e talentit të spikatur të Onufër Qipriotit është edhe ikona e madhe e Krishtit në Kishën e “Shën Mërisë Vllaherna” në Berat. Gjithashtu ka pikturuar edhe dyert e bukura të kësaj kisha. Në kishën e “Shën Triadhës” në Berat peneli i tij ka pikturuar ikonën e Shën Gjergjit, e cila mban mbishkrimin: “Pikturuar nga dora e Onufër Qipriotit”. Në një mbishkrim tjetër që gjendet në ikonën e Shën Kollit në kishën e “Shën Gjergjit” në kala të Beratit thuhet: “...U pikturua nga dora e Onufër Qipriotit”.¹²

Në vitin 1622 ai ka pikturuar afresket e kishës së Vrahogoranxisë. Onufër Qiprioti shquhet edhe për pikturat murale, nga të cilat vlera të veçanta kanë ato të kishës së “Shën Kollit” në kala të Beratit, të manastirit të Çatistes në Gjirokastër etj. Onufër Qiprioti mendohet të ketë fjetur në vitin 1634 në moshën 63-vjeçare.¹³

¹¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 94, faqe 88.

¹²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 96, faqe 89.

¹³-Elsa Demo, Çështë ky Qipriot, Shekulli, 15 prill 2004, faqe 18-19.

Ndikimi i kulturës së Shkollës ikonografike të Beratit, përfaqësuar me dinjitet nga Onufri dhe pasuesit e tij, arriti deri në shekullin XVIII. Kishat e kalasë së Beratit u kthyen në atelie ku mjeshtrat e mëdhenj të ikonografisë shqiptare ushtruan artin bizantin mesjetar. Tek ata vihet re edhe një dukuri tjetër, që mjeshtërinë e talentin e tyre nuk e shkrinë për të pikturuar katedralet madhështore, por kanë parapëlqyer kishat e vogla të katundeve të Shpatit.



Në vitet që pasojnë ikonografia pësoi një rënie të ndjeshme, sepse munguan mjeshtrat e vërtetë që do ta vazhdonin atë traditë që lanë Onufri, biri i tij Nikolla, Onufër Qiprioti si dhe shumë ikonografë të tjerë murgj, të cilët mbetën anonimë. Mungesa e emrave të tjerë ndoshta është e lidhur me pushtimin osman, kur nisi të kthejnë me forcë popullsia në muhamedane, si dhe nuk lejohej ndërtimi i kishave të reja. Por shekulli XVIII solli një rilindje të pikturës murale të stilit bizantin prej ikonografëve të mëdhenj të shkollës së Korçës.

SHKOLLA IKONOGRAFIKE KORÇARE

Ikonografët e Shkollës së Korçës e ushtruan aktivitetin e tyre në shekujt XVII-XIX-të. Prej tyre më i talentuari është **David Selenicasi**, i cili e kishte preardhjen nga Selenica e Kolonjës.¹⁴ Krijmtaria e David Selenicasit u shfaq në Voskopojë, kur në vitin 1726 ai pikturoi kishën e “Shën Kollit”. Këtë e vërteton edhe mbishkrimi që gjendet mbi faqen e murit perëndimor në kishën e “Shën Kollit” në Voskopojë: “Ky tempull i këndshëm para Perëndisë i Shën Kollit i ndërtuar vonë nga lindja e Perëndisë 1721, në muajin qershor, mori përfundim të lumtur më 19 të muajit shtator 1722 të vitit shpëtimtar. Kunga u pikturua me dorën e të shumëditurit David Selenicasi dhe me shoqërimin e Kostandinit e të Kristos, me dhurimin e bollshëm të të hollave të zotit Haxhi Jorgji, që mbaroi jetën e lumtur. Në kohën kur ishte kryepiskop në Ohër dhe Selasfor shumë i dituri Joasaf...”.¹⁵



¹⁴-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, tetor 1995, faqe 11.

¹⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 331, faqe 16.

Të dhënat e këtij mbishkrimi vërtetojnë se ikonografin David Selenicasi në pikturimin e kishës e kanë ndihmuar Kostandini dhe Kristo dhe të tre së bashku i përfunduan pikturat murale më 18 tetor 1726. Sipas teologut Theofan Popa Kostandini dhe Kristo mund të ishin kushërinj ose bashkëfshatarë të David Selenicasit, sepse në atë kohë mjeshtrat merrnin si çirakë njerëz nga fisi i tyre. Gjithashtu edhe nga mënyra e pikturimit mund t'i veçojmë afresket e punuara prej dorës së Davidit me ato të Kostandinit e Kristos. Këta të fundit përsa i përket shkallës së mjeshhtërisë nuk e kanë arritur dot nivelin e ustait të tyre.

Tematika e afreskeve të pikturuara nga David Selenicasi është marrë kryesisht nga Dhiata e Re, por përveç skenave kryesore, si p.sh. “Lindja e Krishtit”, “Pagëzimi”, “Ngjallja” ose “Lindja e Shën Mërisë” “Ungjillëzimi”, “Fjetja e Shën Mërisë” etj, ikonografi ka pikturuar edhe skena të rralla të marra nga tradita e kishës, ndër të cilat mund të veçojmë: “Këshilltar i mrekullueshëm” në të cilën paraqitet Krishti me fletë si engjëll, piktura murale “Therja e foshnjave në Betlehem”, skena e “Ungjillorit Lluka duke pikturuar ikonën e parë të Shën Mërisë” etj.

Gjithashtu në nefin jugor të kishës, ikonografi ka pikturuar disa nga mrekullitë dhe veprat njeridashëse të Shën Kollit, emrin e të cilit mban edhe kisha, si p. sh. “Shën Kolli duke shpëtuar një njeri, i cili ka rënë prej varkës në det”, “Shën Kolli duke shpëtuar tre të dënuar me vdekje”, “Shërimi i barinjve të verbër”, “Shën Kolli ndihmon një fukara që të martojë vajzat” etj.¹⁶ Skenë interesante e David Selenicasit është edhe “Mbërthimi i Shën Pjetrit në Kryq”, që siç e dimë nga tradita e kishës e kryqëzuan me kokë poshtë. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe portretin e ktitorit të kishës së Shën Kollit, Haxhi Jorgji, i cili i ofron Shën Kollit maketin e kishës. Haxhi Jorgji ishte tregtar i pasur dhe paraqitet i

¹⁶-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, tetor 1995, faqe 11.

veshur me kostum voskopojar.¹⁷ Pasi ushtroi aktivitetin e tij ikonografik në Shqipëri, vite më vonë David Selenicasi ka pikturuar në Malin Athos afresket e kishës “Kukuzelica” në manastirin e Lavrës. Afresket e kësaj kisha janë të vitit 1715. Më 1727 ai ka pikturuar kishën e “Shën Prodhromit” në Kostur. Këto janë disa copëza nga mozaiku i larmishëm i krijmtarisë së mjeshtrit të ikonografisë dhe përfaqësuesi kryesor i shkollës korçare, David Selenicasi, i cili duke iu përmbajtur kanoneve të kishës dhe traditës, në pikturën e tij futi edhe elemente etnografike dhe jetësore.

IKONOGRAFËT E FAMILJES ZOGRAFI

Përfaqësues të denjë të Shkollës Korçare të ikonografisë janë edhe piktorët e familjes Zografi, të cilët ishin nga Potkozhani i Mokrës. Këta mjeshtra mendohet se e kanë filluar aktivitetin e tyre në vitin 1744. Në punimet e tyre përveç traditës vendase paraqesin ndikime nga ikonografia e Malit Athos, si dhe prirje drejt stilit barok. Vëllezërit ikonografë Kostandin dhe Athanas Zografi mbiemrin e parë të familjes së tyre e kanë patur Vako. Më vonë për arsye se ata ushtronin zanatin e piktorit morën mbiemrin Zografi. Ata kanë pasur veprimtarinë më të madhe nga të gjithë ikonografët e tjerë shqiptarë të mesjetës në pikturimin e ikonave të lëvizshme dhe të afreskeve murale. Krijimtaria e tyre i përket kohës nga viti 1741 deri në 1783. Data e lindjes dhe e fjetjes së tyre nuk dihet. Vëllezërit Zografi kanë qenë ikonografë të talentuar. Përveç talentit të pikturimit ata zotëronin njohuri teologjike në dogmatikë, histori kisha, patrologji, liturgjikë etj, gjë që është pasqyruar edhe në veprat e tyre. Sipas Theofan Popës, Kostandini ka qenë shumë i njohur në Malin e Shenjtë. Kjo vërtetohet nga afresket e pikturuara prej tij në manastiret e Malit të Shenjtë, ku

¹⁷-Dhorka Dhamo, Piktura murale mesjetare shqiptare, Tiranë 1974, faqe 57

ka nënshkruar “Kostandin shqiptari”, ndërsa në Shqipëri ai përdorte “Zografi nga Korça”. Në krijimtarinë e tyre këta piktorë kanë pasqyruar shumë tema nga jeta e martirëve të kishës, duke theksuar më tepër ata shenjtorë që kanë përhapur ungjillin në Shqipëri. Ndër ta mund të veçojmë Shën Joan Kukuzelin, Shën Gjon Vladimirin, Shën Naumin etj. Vëllezërit Zografi kanë pikturuar në vitin 1720 katedralen “Burimi Jetëdhënës” në Korçë, kishën “Lindja e Hyjlindëses” në manastirin e Ardenicës në 1744, kishën e “Shën Thanasit” në Voskopojë më 1745, kishën e “Dymbëdhjetë Apostujve” dhe kishën e “Anargjirëve” në vitin 1752 në Voskopojë etj.¹⁸



Ikonografët korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi kanë udhëtuar tri herë drejt Greqisë, ku kanë pikturuar kishat e Malit të Shenjtë. Herën e parë ata kanë qëndruar nga viti 1755 deri në 1757, ndërsa gjatë udhëtimit të dytë prej 1765-1766 dhe të tretën herë në vitin 1783. Pikturat e tyre janë në Skitin e Shën Anës, të cilat kanë datën 1755, në Skitin sllav Bllagovica në vitin 1757, në kishën e manastirit të “Shën Filotheut” më 1765 si dhe të manastirit të Krisopotamit në vitin 1783. Gjithashtu tek pikturat murale të

¹⁸-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, dhjetor 1995, faqe 8.

vëllezërve Zografi gjejmë “Shkallën e Joanit”, të cilën nuk e kemi parë tek piktorët e tjerë mesjetarë të Shqipërisë. Në krijimtarinë e tyre nuk mungojnë edhe skenat apokaliptike, si p.sh.”Ardhja e Dytë e Krishtit” etj. Në vitet e fundit të aktivitetit Kostandini ka punuar së bashku me djalin e tij Tërpon në kishën e “Shën Gjergjit” në Libofshë në vitin 1782.¹⁹

Tërpo Zografi mendohet të ketë lindur rreth vitit 1760 në qytetin e Korçës. Aktiviteti i tij në fushën e ikonografisë është i madh. Në mars të vitit 1782 ka pikturuar afresket e kishës së “Shën Gjergjit” në Libofshë të Fierit. Në shtator të vitit 1729 ka pikturuar afresket e kishës së “Shën Kostandinit dhe Helenës” në Kondas të Beratit. Në muajin mars të vitit 1729 pikturon po në Berat afresket e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” të fshatit Vodice. Më vonë ai ka ushtruar aktivitetin e tij në Korçë, ku më 1804 ka pikturuar ikonat e kishës së “Shën Gjergjit” në Plasë, ndërsa në vitin 1806 pikturon afresket e kishës së “Shën Marisë” në Lubonjë të Korçës.



Gjithashtu në vitin 1806 ka pikturuar afresket e paraklisit të manastirit të “Shën Naumit”. Në 1807 ka pikturuar ikonën e

¹⁹-Kristofor Naslazi, Kristaq Balli, Ndhimesa e piktorëve korçarë në artin mesjetar shqiptar, Tempulli, Nr. 2, Korçë 2000, faqe 41.

Shën Gjergjit në kishën e “Shën Kollit” në Skrime, ndërsa më 1818 ikonat e ikonostasit në kishën e “Shën Kostandinit” në Drenovë. Po atë vit ai ka pikturuar afresket e kishës së “Shën e Premtes” në Përmet dhe një vit më vonë më 1819 ka pikturuar ikonën e Krishtit në kishën e “Shën Kollit” në fshatin Zhej të Zagorisë. Pasi ushtroi aktivitetin e tij 37-vjeçar Tërpo Zografi fjeti më 1835.²⁰

Efthim Zografi ishte i biri i Athanasit, emrin e të cilit e mbajnë dy ikona që datojnë më 13 mars 1800 dhe gjenden në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë.

KOSTANDIN SHPATARAKU

Kostandin Shpataraku. Sikurse dëshmon edhe mbiemri i tij, origjinën e ka nga Shpati i Elbasanit. Kjo vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet në ikonën e Krishtit në kishën e “Anargjendëve të Shenjtë Kozma e Damjan” në manastirin e “Shën Pjetrit” në Vithkuq të Korçës. Në të thuhet: “Dora e Jerodhjakon Kostandinit nga Shpati, viti prej Krishtit 1748”.²¹ Rreth vendlindjes së ikonografit Kostandin Shpataraku kemi njoftime të ndryshme. Disa mendojnë se e ka preardhjen nga fshati Vlash, ndërsa disa të tjerë thonë se është nga Pashtreshi i Shpatit. Datat e lindjes dhe të fjetjes së këtij murgu të devotshëm të kishës ortodokse nuk dihen. Kostandin Shpataraku ka qenë ikonograf i talentuar në pikturimin e ikonave. Mendohet se përpara se të bëhej murg, ai e ka pasur emrin Nikodhim. Pas qethjes murg dhe dorëzimit dhjak ai e mori emrin Kostandin. Zakonisht në traditën ortodokse ata që përqafojnë jetën monakale e ndryshojnë emrin e tyre. Ikona e parë e pikturuar prej tij është e vitit 1736 dhe gjendet në manastirin e “Shën Gjon Vladimirit”. Në Arkivin Qendror të Shtetit ka dokumente, të cilat

²⁰-Nedai Thëllimi, Tërpo Zografi, Tempulli, Nr. 3, Korçë 2001, faqe 82-83.

²¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 349, faqe 199.

vërtetojnë se Kostandin Shpataraku ka pikturuar ikonat e manastirit të “Shën Gjon Vladimirit” në Elbasan, por me djegien e kishës më 14 mars 1944 ato u shkrumuan.²² Po në Elbasan, në Kodikun e Kishës së “Shën Kollit” është edhe emri i ikonografit Kostandin Shpataraku. Aktiviteti i tij në pikturimin e ikonave është mjaft i dendur. Kështu në vitin 1767 ka pikturuar ikonat e ikonostasit të kishës së “Shën e Premtes” në Kavajë. Gjithashtu tri ikona të ikonostasit të manastirit të “Ardenicës” kanë mbishkrimin se janë punuar nga dora e Kostandin Shpatarakut. Vepra e këtij ikonografi të talentuar të kishës ortodokse filloi të studiohej për herë të parë nga teologu i pasionuar Theofan Popa në vitin 1954. Gjatë kërkimeve nëpër kishat e Shqipërisë është vërtetuar se jerodhiakon Kostandin Shpataraku ka qenë i specializuar vetëm për punimin e ikonave të lëvizshme. Deri më sot nuk është zbuluar ndonjë afresk i pikturuar prej tij.

IKONOGRAFËT E FAMILJES ÇETIRI

Origjina e familjes Çetiri është nga Grabova dhe mbiemri i tyre fillestar ka qenë Katro. Sipas disa dëshmimeve të teologut Theofan Popa, Çetirët kanë qenë vllahë. Çetirët ndonëse qenë ikonografë autodidaktë, ata për më shumë se 100 vjet kanë pikturuar kisha, ikonostase, etj. Arti i ikonografisë u trashëgua nga babai tek i biri dhe nga i biri tek nipi. Përfaqësuesi më i rëndësishëm i ikonografëve të familjes Çetiri është Joani, por edhe pjestarët e tjerë të kësaj familjeje janë marrë me artin e ikonografisë, ndër të cilët mund të përmendim vëllain e Joanit, Gjergj Çetirin, Naumin të birin e Joanit, nipin e tij Nikollën, i cili ka pasur një djalë Gjergjin e dytë. Çetirët kanë qenë piktorë ambulantë, të cilët endeshin fshat më fshat dhe pikturonin afreskë, ikona të lëvizshme,


²²-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, dhjetor 1995, faqe 8.

orendi të gdhendura etj. Aktiviteti i tyre daton prej vitit 1762 deri më 1853, duke stolisur rreth 12 kisha nga bregdeti i Karavastasë deri në Berat. Ata kanë pikturuar afresket e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit, si dhe nëpër fshatrat e Myzeqesë: Karavasta, Toshkëz, Krutje e Sipërme, Fier, Vanaj, Strumë, Bishtqethëm, Kadipashaj etj. Joani dhe i vëllai Gjergji kanë qenë bashkëkohës të Kostandin dhe Athanas Zografit. Ata kanë pikturuar afresket e kishës së “Shën Kollit” në Vanaj, ndërsa vëllezërit Zografi ikonat e ikonostasit të kishës. Tematika e tyre është mjaft e pasur dhe e larmishme, ku përveç skenave nga Dhiata e Re ata kanë përdorur edhe mjaft pasazhe nga Dhiata e Vjetër, si p.sh. “Mëkati i Adamit dhe i Evës”, “Dëbimi nga Parajsa”, “Shitja e Josifit” etj. Në ikonografinë e tyre gjejmë edhe disa murale nga “Himni Akathist”. Ikonografët grabovarë të familjes Çetiri kanë pikturuar edhe shenjtorët që kanë vepruar në Shqipëri, prej të cilëve Shën Nikodhimin e Beratit, Shën Gjon Vladimirin etj.

Vëllezërit Çetiri kanë pikturuar këto kisha: 1-kishën e “Hyrjes në tempull të Hyjlindëses” në Kolkondas, e cila është pikturuar në vitin 1782 nga Joani. 2-kishën e “Shën Kollit” në Vanaj, e cila është pikturuar më 1795 prej Gjergjit dhe Joanit. 3-kishën e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Bishtqethëm, që u pikturua më 1798 prej Joanit. 4-kishën e “Shën Gjergjit” në Fier është pikturuar më 1798 nga Joani. 5-kishën e “Shën Theodorëve” në Kadipashaj, e cila u pikturua më 1801 prej Joanit. 6-kishën e “Shën Gjergjit” në Strumë, të cilën e kanë pikturuar Joani dhe Nikolla më 1801. 7-kishën e “Shën Athanasit” në Vodicë, të cilën e kanë pikturuar Joani dhe Naumi më 1806. 8-kishën e “Fjetjes së Hyjlindëses” në Kozare, e cila është pikturuar më 1806 prej Joanit dhe Naumit. 9-kishën e “Apostujve Pjetër dhe Pavël” në Zhymë, e cila është pikturuar më 1811 prej Gjergjit. 10-kishën e “Shën Nikollës” në Krutje, të cilën e pikturoi Nikolla më 1811. 11-kishën e “Shën Kollit” në Toshkëz, e cila është pikturuar prej Joanit dhe Naumit në vitin 1813. 12-kishën e “Shën Kollit” në Paftal, të cilën

e kanë pikturuar Gjergji II dhe Koli më 1898. 13-narteksin e kishës së Bubullimës, i cili është pikturuar më 1853 prej Gjergjit III.²³

Emrin e **Joan Çetirit** për herë të parë e ndeshim te njëra prej ikonave të vogla që vendosen përmbi ikonostas e titulluar “Rrethprerja e Krishtit”, në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” në Berat. Në mbishkrimin e saj shkruhet: “Në vitin 1812 nga dora e Joan Çetirit”, ndërsa në ikonën e madhe të Shën Spiridhonit kemi: “U pikturua kjo ikonë me shpenzimet e Stefan Karbunarës, më 19 korrik 1812 nga dora e Joan Çetirit”.²⁴



Joan Çetiri ka realizuar me mjeshtëri ikonat e ikonostasit të kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit, gjithsej 27 ikona të vogla dhe 7 të mëdha. Tematika e ikonave është nga Dhiata e Re: “Rrethprerja e Krishtit”, “Burimi Jetëdhënës”, “Mos

²³-Jorgos Jakumis, Piktorët Çetiri në Myzeqe, Berat 2003, faqe 15.

²⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 196, faqe 121.

më prek”, “Pagëzimi i Krishtit”, “Shërimi i të verbërit” etj. Emrin e Joan Çetirit e gjejmë edhe tek ikona e madhe e Krishtit në ikonostasin e kishës së Shën Gjergjit në Fier, e cila daton më 20 tetor 1798. Gjithashtu në kishën e “Shën Kollit” në Toshkëz në ikonën “Shën Mëria me Krishtin mbi fron” të pikturuar në vitin 1813 gjejmë mbishkrimin e Joanit.

Nikolla Çetiri në fillimet e tij ka punuar bashkë me Joanin. Kështu sipas një mbishkrimi që gjendet në një afresk të kishës së “Shën Todrit” në Kadipashaj vërtetohet se pikturat murale janë realizuar prej ikonografëve grabovarë Nikolla dhe Joan Çetiri në vitin 1807. Ndërsa nga një mbishkrim që gjendet në portën e jugut të kishës së “Shën Kollit” në Krutjen e Sipërme vërtetohet se në vitin 1811 ikonografi Nikolla e ka pikturuar i vetëm këtë kishë.²⁵

Nikolla ishte nipi i Joanit, megjithatë ata kanë punuar përsëri së bashku në vitin 1801, kanë realizuar afresket e kishës së “Shën Gjergjit” në Strumë të Fierit. Kjo vërtetohet prej mbishkrimit që kanë lënë në një afresk ku thuhet se autorët janë Joani dhe nipi i tij Nikolla. I ati i Nikollës, Gjergji i parë, ka pikturuar kishën e “Shën Mitrit” në Mazhaj të Myzeqesë në vitin 1775. Në ikonostasin e kishës tek ikona e madhe e Krishtit gjendet mbishkrimi se autori është **Gjergj Prend Çetiri**. Ndërsa në një mbishkrim tjetër të gjetur në kishën e “Shën Vlashit” në Vlorë më 1792 vërtetohet që Joan dhe Gjergj Çetiri kanë pikturuar ikonat. Gjithashtu në bashkëpunim këta vëllezër kanë realizuar pikturat murale të kishës së “Shën Thanasit” në Karavasta më 1797. I biri i Nikollës **Gjergji i dytë** ka pikturuar më 1856 ikonat e mëdha të ikonostasit të kishës së “Shën Minait” në Gradishtë. Ndërsa në vitin 1866 ka realizuar me mjeshtëri ikonat e vogla të ikonostasit të kishës së “Shën Kollit” në Grabovë. Në ikonostasin e kishës së “Shën e Dielës” në Nartë, tek ikona e “Tre Hierarkëve”, e cila daton më 1835, gjendet mbishkrimi i Gjergjit dhe i Naumit. Siç e kemi përmendur edhe më sipër Naumi ishte i biri i Joanit, i cili në fillimet e aktivitetit të

²⁵-Gazmend Muka, Art’thënia bizantine tek Çetirët, Tiranë 1999, faqe 86.

tij si ikonograf ka punuar së bashku me të atin, prej të cilit ka mësuar edhe ikonografinë. Në një mbishkrim që gjendet në kishën e “Shën Kollit” në Toshkëz të Myzeqesë, thuhet se afresket e kësaj kishe janë realizuar nga Joan dhe Naum Çetiri në vitin 1813. Vite më vonë Naum Çetiri ka punuar ikonat e mëdha në kishën e “Shën Kollit” në Krutjen e Sipërme, ndërsa në vitin 1829 ai ka pikturuar afresket e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në Bishtqethëm të Myzeqesë.²⁶

Afreskët që pikturuan Çetirët u rigjallëruan nga një frymë e re duke u çliruar nga standartet strikte të ikonografisë bizantine. Rreptësia e trajtave me të cilët pikturoheshin afreskët bizantinë, tek Çetirët u zëvendësua nga bukuria laike dhe intimiteti. Burim frymëzimi për Çetirët qenë: 1-motivet nga jeta e përditshme e popullit, duke u distancuar nga mënyra bizantine e paraqitjes së skenave. Karakteristikë e punëve të tyre qenë aspektet e jetës së përditshme me orenditë e shtëpisë, me veglat muzikore të panairëve, stolitë që përdornin gratë për zbulurim etj. E parë në këtë këndvështrim piktuarat e tyre u bënë më të kuptueshme për popullin besimtar. 2-arti perëndimor i Rilindjes. 3-përvoja nga udhëtimet jashtë shtetit. Në skenën e një prej mrekullive të Shën Kollit paraqitet një anije, udhëtarët e së cilës janë evropianë me kapele me strehë rumbullake. Madje mes tyre pasqyrohet edhe një udhëtare femër, e cila është veshur me elegancë dhe mban në krye një kapele të stilit perëndimor. Gjithsesi Çetirët nuk e humbën karakterin bizantin të traditës kishtarë në pikturimin e afreskeve, por ata qenë të guximshëm në veprat e tyre duke futur traditën perëndimore. Çetirët konsiderohen ikonografët e parë laikë, të cilët shkrinë artin bizantin me traditën popullore. Për ta konkretizuar këtë fakt po e ilustruam me disa shembuj: Shën Gjergji i pikturuar nga Çetirët nuk paraqitet i hipur në kalë, por ka veshjet e një arhondi vendas: bastun, gunë, tunikë të stolisur dhe

²⁶-Gazmend Muka, Art’thënia bizantine tek Çetirët, Tiranë 1999, faqe 89-90.

mantel të shndritshëmm. Gjithashtu me veshje të tilla paraqitet edhe Nikodhimi. Shenjtoret femra si Ekaterina, Parashqevia etj, paraqiten të veshura dhe të stolisura me vathë, me tunikë të bukur dhe me shtat të dredhur e plot gjallëri. Ekaterina e Kozarës paraqitet e zbukuruar me vathë. Në skenat e tyre gjejmë grupe muzikore, të cilët luajnë veglat muzikore vendase. Tek skena e “Fshikullimit të Krishtit”, paraqitet një grup muzikor, i cili u bie daulleve që të poshtërohet Krishti. Ky grup ngjan me grupet e vogla muzikore myzeqare, madje edhe kapelet, veshjet, shkopinjtë, veglat muzikore janë marrë nga tradita vendase. Skena më e përkryer e tyre ka qenë “Ardhja e dytë e Krishtit”, e cila paraqitet në murin lindor të narteksit. Kjo skenë i referohet ditës në të cilën Perëndia do të gjykojë njerëzit. Zakonisht kjo skenë ka përmasa të mëdha mbi 30 metra, sepse përmban rreth 100 personazhe. Në pjesën e sipërme të skenës gjendet Krishti brenda një ylberi rrethor. Anash tij qëndrojnë Hyjlindësja dhe Pagëzori. Në vijim paraqiten të ulur në fron dishepujt. Nën këmbët e Krishtit rrjedh lumi i zjarrtë, i cili buron nga Ferri. Brenda në të enden shpirtrat e njerëzve mëkatarë, ndërsa në të djathtë në tokë gjendet vendi ku rrinë të vdekurit dhe presin për tu gjykuar. Në anën e djathtë të Krishtit gjenden të drejtët, shenjtorët, oshënarët, të cilët përgatiten për të shkuar në parajsën qiellore.²⁷

IKONOGRAFËT DARDHARË

Nga plejada e ikonografëve dardharë mund të veçojmë 24 prej tyre, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në zbukurimin e kishave ortodokse. Në Muzeun e Artit Mesjetar të Korçës ruhen ende 270 ikona, të cilat janë punuar nga mjeshtrit dardharë. Prej tyre mund të përzgjedhim: Vangjel Zengon, Sotir Keren, Grigor Zdrulin etj. Ikonografët dardharë kanë punuar jo vetëm nëpër kishat e qytetit të tyre, por edhe në Amerikë, Greqi, Rumani e

²⁷-Jorgos Jakumis, Piktorët Çetiri në Myzeqe, Berat 2003, faqe 17-39.

gjetkë. Më i spikaturi prej tyre ka qenë **Vangjel Zengo** (1875-1941), i cili e mësoi artin e ikonografisë në Malin Athos, në atelienë e Grigor Zdrulit. Vangjeli shquhet si ikonografi më cilësor dhe prodhimtar. Firmën e tij mbajnë 180 ikona, të cilat gjenden në Muzeun e Artit Mesjetar. Ai ka punuar ikonat e kishave të “Shën Gjergjit”, “Shën Triadhës”, katedralen e Korçës etj. Një ikonograf tjetër nga Dardha është **Efthim Zengo** (1890-1940), i cili e mësoi artin e ikonografisë prej të vëllait Vangjelit. Të dy së bashku kanë punuar për zbukurimin e kishës së “Shën Gjergjit” në Dardhë. Në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë nëntë ikona janë pikturuar nga dora e Efthimit. Gjithashtu ai ka bashkëpunuar me ikonografë të tjerë dardharë në pikturimin e kishës së “Shën Gjergjit” në Korçë. **Niko Zengo** e zhvilloi aktivitetin e tij në Boston, ku emigroi në vitin 1910. Afresket e punuara prej tij janë në kryekishën e “Shën Gjergjit”. Dy fotografi prej punimeve të tij ndodhen në Muzeun e Artit Mesjetar, të cilat janë dhuruar prej Kryekancelarit të “Shën Gjergjit”, atë Artur Liolinit gjatë vizitës që bëri në qytetin e Korçës. Njëra prej fotografive paraqet afreskun e “Krishtit si Kryeprift” dhe tjetra skenën “Gjykatësi i Drejtë” që është pikturuar në kubënë e kishës.

Andromaqi Zengo ka lindur në vitin 1913 në Korçë. Artin e ikonografisë e mësoi nga i ati Vangjeli. Së bashku kanë pikturuar kishën e “Shën Mërisë” në Korçë në vitin 1928 dhe më 1930 kishën e “Shën Kollit” në Hoçisht. Më vonë Andromaqi studioi në Akademinë e Arteve të Bukura të Athinës. Gjatë pushimeve të verës ajo ka punuar për zbukurimin e kishave. Kështu në vitin 1933 ajo pajisi me ikona kishën e “Shën Triadhës”. Në vitet 1929-1945 Andromaqi Zengo ka pikturuar në pesë kisha në rrethin e Korçës. Në vitin 1960 ajo ka punuar ikonat e kishës së Palasës në rrethin e Vlorës.²⁸ Në vitet 1964-1965 Andromaqi Zengo ka realizuar me mjeshtëri afresket e kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë.

²⁸-Kristaq Balli, Kristofor Naslazi, Gjurmime rreth një plejade piktorësh dardharë të mesjetës së vonë, Monumentet 2 / 1991, faqe 23-24.

Këto afreske janë pikturuar në stilin rus. Në kubënë e kishës është pikturuar Pantokratori, katër Ungjillorët dhe të katër engjëjt përreth kubesë. Këto afreske janë bërë me shpenzimet e kishës dhe kanë kushtuar 168 000 lekë. E veçanta në afresket e Andromaqi Zengos është se emrat e shenjtorëve janë shkruar shqip.²⁹

IKONOGRAFËT NGA LINOTOPI

Linotopi është një fshat i banuar prej vllhësh dhe gjendet në një luginë të Gramozit pranë Kosturit. Ikonografët nga Linotopi me atelietë e tyre të lëvizshme ftoheshin nga arkondë vendas për të pikturuar afreske dhe ikona të lëvizshme. Ikonografët nga Linotopi kryesisht e zhvilluan aktivitetin e tyre nëpër kishat dhe manastiret e Shqipërisë. Në bazë të mbishkrimeve kishtare janë tetë kisha dhe manastire të Shqipërisë, të cilët janë pikturuar nga peneli i ikonografëve nga Linotopi.

1-Fillimisht ata kanë pikturuar kishën e manastirit të “Profetit Ilia” në Jergucat. Në bazë të mbishkrimeve kisha është pikturuar në vitin 1586 prej murgut Niqifor, ndërsa narteksi i kishës më 1617 prej Mihail nga Linotopi: “U ndërtua dhe u pikturua ky tempull i gjithnderuar dhe narteks në kohën kur ishte igumen ndër oshënarë jeromonak zoti Simeoni, viti 7125 (=1617), dhe me dorën e mëkatarit Mihail nga katundi Linotopi i Kosturit”.³⁰

2-Gjithashtu ikonografi Mihail ka pikturuar në vitin 1617 kishën e “Ungjillëzimit” në manastirin e Vanishtës. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim që gjendet mbi portën e narteksit të kishës.³¹ Narteksi i kishës është pikturuar fillimisht prej ikonograf

²⁹-Kristofor Beduli, Familja e Agjiografëve Zengo, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9-10.

³⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 540, faqe 226-227.

³¹-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 542, faqe 228.

Janit nga katundi Qestorat në vitin 1758, por afresket e tij nuk shquhen për cilësi të lartë artistike. Prandaj afresket e dy zonave të para të narteksit i ka pikturuar Mihaili nga Linotopi. Gjithashtu ka realizuar skenën “Gjyqi i fundit” në murin lindor të pjesës së eksonarteksit. Në kthinën këndore ai ka relizuar me mjeshtëri skenën “Tallja”, ku figura kryesore është Krishti, i cili paraqitet i veshur me mantel dhe mbi kryet i kanë vënë një kurorë me gjemba. Pranë tij paraqiten çifutët duke e tallur dhe përbri Krishtit paraqitet një ndërtesë me ballinë, e cila tregon pallatin e Pilatit.

3-Më 28 tetor të vitit 1626 ikonografi Mihail nga Linotopi ka pikturuar naosin dhe narteksin e kishës së manastirit të “Shën Sotirit” në Çatistë të Pogonit. Kjo vërtetohet nga një mbishkrim të gdhendur portën e narteksit.³² Skenat më të realizuara janë ajo e “Kryqëzimit” dhe “Fjetja e Efrem Sirianit”.

4-Në vitin 1630 ikonografi Mihail bashkë me të birin Kostandin dhe njëfarë Nikolla kanë pikturuar naosin e kishës së “Shën Kollit” në Saraqinishtë të Lunxhërisë. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet mbi portën jugore të kishës.³³ Skenat më të realizuara janë ajo e “Shën Kollit”, që është edhe shenja mbrojtës si dhe skena e “Mikpritjes së Abrahamit”.

5-Në vitin 1632 ikonografi Nikolla nga Linotopi ka pikturuar kishën e “Shën Kollit” në Melan të Përmetit. Kjo vërtetohet me anën e mbishkrimit që gjendet mbi portën e Kishës: “Me dorën e Nikollës nga fshati Linotopi”.³⁴

6-Ikonografi Mihail më 3 gusht të vitit 1634 ka pikturuar kishën e manastirit të Spilesë në Lunxhëri. Këtë e vërteton një

³²-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 552, faqe 231-232.

³³-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 556, faqe 232-233.

³⁴-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 305, faqe 158.

mbishkrim që gjendet mbi portën e narteksit.³⁵ Me pikturimin e kësaj kishe ikonografi Mihail e mbylli karrierën e tij. Në murin perëndimor të kishës gjendet skena e “Shën Pjetrit”. Gjithashtu paraqitje e realizuar bukur është edhe “Shën Maria e tipit Pamakaristos”, e cila është pikturuar në murin jugor. Ndërsa në murin perëndimor të naosit gjendet “Shën Kolli nga Meçova”.

7-Më 19 qershor të vitit 1653 Kostandin Linotopi dhe nxënësi i tij Nikolla kanë pikturuar kishën e manastirit të “Profetit Ilia” në Stegopull. Këtë e vërteton një mbishkrim që gjendet mbi portën perëndimore brenda naosit të kishës.³⁶

8-Kisha e fundit që ka pikturuar njëfarë ikonografi Dhimitër nga Linotopi është “Shën Thanasi” i Mokrës në vitin 1752. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi portën perëndimore brenda kishës.³⁷ Emri i Dhimitrit është i fundit në listën e ikonografëve nga Linotopi.

Ikonografët nga Linotopi në stilin e tyre të pikturimit kanë përdorur një sërë burimesh. Ata kanë përdorur si modele elemente vendase të jetës së përditshme si bulla e dropullitëve ose kalldrëmi epirot tek pikturat e “Akathistit” në Jergucat. Gjithashtu ata janë ndikuar edhe nga piktura perëndimore. Rasti më tipik është ai i “Shën Kristoforit të Saraqinishtës”, i cili mbështetet në një degë duke përshkuar lumin, subjekti i të cilit mund të jetë ndikim nga ndonjë gravurë italiane.³⁸

³⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 559, faqe 234.

³⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr. 561, faqe 235.

³⁷-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.20, faqe 58.

³⁸-Kostandinos Jakumis, Veprimtaria e piktorëve nga Linotopi në viset e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 209-216.

IKONOGRAFË BASHKËKOHORË


Ikonografi Herald Mateo Pojani ka përfunduar Akademinë e Arteve të Bukura në vitin 2000, në degën pikturë monumentale, afresk. Gjatë këtyre viteve ka pikturuar shumë afreske dhe ikona të lëvizshme. Mateo Pojani pikturon sipas stilit të shkollës Maqedonase të pikturës dhe asaj të Kretës.



Pikturat e tij janë me bojra tempera që përgatiten me vezë e me uthull, me sfond floriri, aseko, beze në mur, beze në dru etj. Ikonografi Mateo Pojani ka pikturuar rreth pesëdhjetë ikona të lëvizshme në dru. Gjithsesi pasioni i tij janë afresket. Në Akademinë Teologjike të Shën Vlashit në Durrës ka pikturuar: 1) “Mikpritja e Abrahamit” në sallën e ngrënies, pikturë murale me sipërfaqe 14.36 m². 2) Pikturë murale triptik “Zoti Krisht, Hyjlindësja, Shën Vlasi” në korridorin e shkollës, me përmasa secila 1.5x66 cm. 3) Pikturë murale “Më e gjerë se qiejt” (Platitera) në absidën e kishës së shkollës me përmasa 2.5x2 metra. 4) Ikonat e krahut të djathtë të ikonostasit, në kishën e manastirit të Shën Vlashit. Në kishën e Ugjillëzimit në Tiranë ka pikturuar: 1) Pikturë murale në

nikën e agjiodhimës, “Përlësia e Tejskajshme”, me përmasa 2.5x1 metra. 2) Pikturë murale “Trinia e Shenjtë” në klasën e katekizmit me përmasa 1.5x1.8 metra. 3) Pikturë në telajo “Trinia e Shenjtë” e vendosur në murin e agjiodhimës me përmasa 110x95 cm. Në kishën katedrale të “Apostull Pavlit” në Durrës ka pikturuar “Platiterën” në absidën e agjiodhimës, me përmasa 6x3.5 metra. Ikonografi Mateo Pojani ka marrë pjesë në shumë ekzpozita brenda dhe jashtë vendit.

Mozaïçisti Eduart Sinaj ka lindur më 29 qershor të vitit 1966 në Tiranë. Pasi përfundoi Liceun Artistik “Jordan Misja”, në vitin 1985 filloi punë pranë Qendrës së Realizimit të veprave të Artit, në Tiranë, në sektorin e mozaikëve artistikë, nën drejtimin e mjeshtrit Agim Nebiu. Gjatë këtyre viteve ka realizuar shumë mozaikë të ndryshëm. Në vitin 1994, Eduart Sinaj çeli studion e tij të mozaikëve. Në vitin 1997 u specializua për mozaikët bizantinë në Salerno, të Italisë. Në fundin e vitit 1997 filloi punë pranë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, në sektorin e mozaikëve bizantinë.



Mozaïçisti Eduart Sinaj ka realizuar shumë mozaikë në fasada dhe dysheme të kishave ortodokse, ndër të cilat mund të

përmendim: 1) Mozaikun e përmasave 280x330 cm, në kishën e “Shën Gjergjit” në Fier. 2) Mozaikun e “Shën Astit” me përmasa 200x130 cm në kishën e “Shën Pavlit” në Durrës. 3) Mozaikun rrethor Ø 150 cm në kishën “Ungjillëzimi i Hyjlindëses” në Tiranë. 4) Mozaikun “Trinia e Shenjtë” me përmasa 230x120 cm në kishën ortodokse të Vrakës në Shkodër etj. Gjithashtu Eduart Sinaj ka punuar mozaikë për dyshemetë e shumë kishave ortodokse, prej të cilëve mund të veçojmë: 1) Dyshemenë e kishës së Libofshës në Fier, me përmasa 150x150 cm. 2) Dyshemenë e kishës së Elbasanit, me përmasa 180x180 cm. 3) Dyshemenë e kishës së Bestrovës në Vlorë, me përmasa 150x150 cm. 4) Dyshemenë e kishës së Kuçovës, me përmasa 180x180 cm. Për të reklamuar punët e tij mozaikë Eduart Sinaj në vitin 2008 ka botuar buletin “Studio Sinaj, realizim, projektim i mozaikëve artistikë” dhe në vitin 2009 ka publikuar faqen e internetit mozaikartistik.com, me anën e së cilës është bërë i njohur brenda dhe jashtë vendit.

Ikonografi Josif Çano ka lindur në Tiranë më 21 gusht të vitit 1970. Gjatë viteve 1984-1988 kreu Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë, ndërsa në vitet 1998-1993 ka studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura, në degën e pikturës në tekstil. Në vitin 1994 është specializuar në Malin Athos, në Greqi për pikturën bizantine. Gjatë viteve 1994-1997 ka punuar si piktor i lirë. Në vitin 1997 u emërua përgjegjës i studios së ikonografisë pranë kompleksit “Nazaret” të K.O.A.Sh-it. Në Kishën Ortodokse të Kavajës ka realizuar afresket; “Platiterën dhe kungimin e apostujve”. Më 10 prill të vitit 1993 ikonografi Josif Çano ka realizuar ikonat e ikonostasit të pagëzimore në kishën e “Ungjillëzimit” në Tiranë. Josif Çano shquhet në pikturimin e ikonave të lëvizshme prej të cilave mund të përmendim: Ikonën e Krishtit, ikonën e Shën Mërisë, Ngjallja, Krishtlindja, Kryeengjëlli Gabriel, Kryeengjëlli Mihail, Joan Pagëzori, Shën Prokopi, Ungjillëzimi, Shën Kostandini, Shën Vasili i Madh etj. Për punët e tij Josif Çano është vlerësuar nga ikonografë të shquar.

KREU I SHTATË

MIKROGRAFITË NË SHQIPËRI

Mikrografitë (vizatimet e vogla) janë të dhënat më të vjetra të shkrimeve kishtarë në Shqipëri. Prej tyre mund të veçojmë mikrografitë e kodikëve të famshëm të Beratit. Shumica e mikrografive i përkasin kohës midis shekujve VI dhe XIV. Ato dallohen për bukurinë e krisografisë (shkrimin me ar) në pergamenë. Koleksioni i kodikëve të Shqipërisë përbën një pasuri të çmueshme të letërsisë së krishterë sepse kodikët kronologjikisht datojnë që nga shekulli VI e deri në shekullin XVIII, pra janë shkruar gjatë 13 shekujve. Kodikët e Shqipërisë përmbajnë: ungjill, apostuj, agjiografi, patrologji, mineo, psaltirë, libra liturgjike, libra të së drejtës kanonike etj.¹

KODIKËT

Kodikët janë objektet më të vjetra dhe më origjinale që vërtetojnë për kulturën e traditën e lashtë të popullit tonë ndër shekuj. Kodikët janë libra me shkrime të shenjta agjiografike dhe jetë shenjtorësh. Kodikët konsiderohen si dëshmitë më të hershme të historisë së shkrimit nëpër trevat shqiptare. Rëndësia shkencore e të dhënave historike që përmbajnë kodikët kishtarë lidhet me

¹-Shaban Sinani, Kështjella e virtutit, Tiranë 2001, faqe 22, 35.

prejardhjen shqiptare. Zbulimi i kodikëve vërteton qartë se Kisha Ortodokse ka qenë djepi i kultivimit dhe i ruajtjes së kulturës kombëtare.² Në Arkivin Qendror të Shtetit ndodhen 100 kodikë të plotë, por ky nuk është numër i saktë, sepse kërkimet e viteve të fundit kanë nxjerrë mjaft kodikë të rinj, që ruhen nëpër bibliotekat familjare. Të gjithë këta të marrë së bashku e pasurojnë gjeografinë e shpërndarjes së tyre. Përsa i përket përmbajtjes, kodikët janë një kompleks vlerash shpirtërore.³ Kodikët u shkruan kryesisht prej shekujve VI-XVIII. Pothuajse të gjithë përfaqësojnë dorëshkrime me përmbajtje biblike, liturgjike, jetë shenjtorësh dhe histori kishe.



Në kodikët e shek. XII e këndeja ka edhe të dhëna etnografike. Gjithashtu në Arkivin Qendror të Shtetit ndodhen edhe 17 kodikë të dëmtuar, të cilët janë vetëm fragmentarë. Kodikët janë të larmishëm e ndryshojnë ndërmjet tyre: Kodiku i shek. VI është shkruar me shkronja kapitale, me argjend të shkrirë në

²-Liljana Bërxolli, Kodikët thesarë të kulturës Shqiptare, Fletëpalosja e Drejtorisë të Përgjithshme të Arkivave, botuar me sponsorizimin e K.O.A.Sh, Tiranë 1999.

³-Dhimitër Dishnica, Kodikët thesarë të vjetra të trashëgimisë bizantine, Ngjallja, mars 1998, faqe 9-10.

pergamenë të purpurtë. Kodiku i shek. IX është shkruar me shkronja të vogla ari. Kodikë të tjerë të shekujve të mëvonshëm janë të shkruar me shkronja ngjyrë kafe, initiale ari, në pergamenë ose në letër. Gjuha me të cilën janë shkruar kodikët është greqishtja e vjetër ose latinishtja si edhe pak sllavishte e vjetër. Kaligrafia prej ari e argjendi është shoqëruar edhe me silueta figurinash me motive lulesh, vinjeta në formë katërkëndëshi, me shpezë të stilizuar jashtë vinjetave etj.⁴

Ka kodikë ku çdo faqe paraqet diçka të veçantë. I tillë është një nga kodikët e Beratit, ku në çdo faqe *Kanonet e Eusebit* janë stolitur me skema gjeometrike, kolona e fusha të pikturuara me lule të stilizuara. Kapakët e këtyre librave janë kryesisht prej dërrase, të veshur me lëkurë ose me pëlhurë kadife të stampuar me pamje ungjillore, me motive lineare të pasuara me lule dhe me gjethe të stilizuara. Arkivi Qendror i Shtetit disponon një katalog me rreth 200 faqe dorëshkrim, ku përshkruhet përmbajtja e çdonjërit prej kodikëve. Ky katalog është hartuar nga teologu i apasionuar Theofan Popa.⁵

Për praninë e kodikëve në trevat shqiptare njoftimin e parë e ka dhënë Episkopi i Beratit Anthim Aleksudhi në gjysmën e dytë të shek. XIX, në vitin 1868, në librin “Përshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit”, botuar në Korfuz më 1868. Në vitin 1885 erdhi në Shqipëri studiuesi francez Pjer Batiffoli. Gjatë vizitës së tij nëpër kishat ortodokse të Beratit ai mbeti i mahnitur kur zbuloi kodikët. Batiffoli gjeti tre kodikë kristografikë të stilit bizantin të shkruar me ar dhe me argjend, ndërkohë kur në mbarë botën numëroheshin jo më shumë se 12 të tillë. Batiffoli u njoh vetëm me një pjesë të kodikëve, për të cilët hartoi një katalog në formën e një biografie të shkurtër të librave. Në këtë katalog


⁴-Theofan Popa, Pasaporta të kodikëve të fondit 888, dorëshkrim 160 faqe, ruhet pranë AQSh.

⁵-Liljana Bërxolli, Vlera e Kodikëve mesjetarë dhe puna për evidentimin e tyre, revista Arkivi Shqiptar 1999, faqe 63-71.

Batiffoli ka nënvizuar: “Nuk m’u lejua veçse një inventar i shkurtër, kam përshtypjen dhe s’jam aspak i sigurt të kem parë gjithçka”. Ndër kodikët më të njohur, që përmend Batiffoli në katalogun e tij, janë “Codex purpurus Beratinus Ø”, vepër e shek. VI dhe “Codex aureus Anthimi”.⁶

KODIKU I PURPURT I BERATIT

Më i rëndësishmi dhe më i famshmi prej kodikëve është ai që njihet me emrin “Codex purpurus Beratinus Ø” (Kodiku i purpurt nga Berati), i cili është nga kodikët më të vjetër në botë. Kodiku përfaqëson një dorëshkrim (ekzemplar i vetëm origjinal) që përbëhet nga 190 fletë pergamenësh të ngjyer në të kuqe të theksuar (të purpurt) dhe përmban dy ungjij, sipas Markut dhe sipas Matheut.



“Kodiku i purpurt i Beratit” u shkrua në një kohë kur ende nuk ishte vendosur se cilët do të ishin librat kanonikë të Dhiatës së Re, prandaj ky dorëshkrim ka disa shmangie dhe mospërputhje nga teksti origjinal. Gjithashtu sipas Batiffolit, Ungjilli sipas Mateut ndodhet ndërmjet faqeve 1-120, ndërsa faqet që vijojnë i përkasin

⁶-Theofan Popa, Katalogu i kodikëve që ruhen në AQSh, dorëshkrim 140 faqe, Tiranë 1883-1985.

Ungjillit sipas Markut. Në kohën që e vëzhgoi Batiffoli, kodikut i mungonin Ungjilli sipas Lukës dhe Ungjilli sipas Joanit. Për herë të parë “Kodiku i Purpurt i Beratit” përmendet në “Diptikët e kishës së Shën Gjergjit”, e cila ndodhej brenda kalasë së Beratit. Ky kodik është shkruar me shkronja argjendi të tretur, me përjashtim të disa (fjalëve e shprehjeve) që janë me shkronja të arta në pergamenë. Me shkronja ari janë shkruar emri i Perëndisë, emri i Krishtit dhe shenja e kryqit. Kodiku daton në shekullin VI dhe është shkruar nga murgj vendas. “Codex purpureus Beratinus Ø” për vlerat kulturore që mbart është regjistruar në Programin e Unesco-s “Memoire du Monde”.⁷



Kodiku i purpurt i Beratit “Codex purpureus Beratinus Ø” ka rëndësi të madhe për historinë e krishterimit e për historinë e traditës së shkrimit, sepse është ruajtur në gjendje të lexueshme për 15 shekuj me radhë. Kapaku i kodikut është metalik e i zbukuruar me figura biblike, ndërsa teksti është në greqishten e vjetër. Në kapak gjenden Shën Mëria dhe Joan Pagëzori. Kodiku ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit Fondi 488. Kodiku i purpurt i Beratit “Codex purpureus Beratinus Ø” bën pjesë te variantet më të vjetra të dorëshkrimeve biblike. Shkronja Ø tregon radhën që ai zë në vargun e dorëshkrimeve të lashta biblike.⁸

⁷-Shaban Sinani, Codex Purpureus Beratinus në regjistrin e Memoire du monde, Kërkim, Nr. 4, Tiranë 2010, faqe 39-49.

⁸-Theofan Popa, Restaurimi i kodikëve të Beratit, Nëntori, nr.4, 1972.

KODIKU I ARTË

Kodiku i dytë për nga rëndësia dhe vjetërsia është ai me emrin *Kodiku i artë* “Codex aureus Anthimi”. Anthim Aleksudhi ka qenë Mitropolit i Beratit (1855-1887).⁹ Ndryshon nga i pari sepse ky kodik është shkruar në pergamen me shkronja ari të tretur. Si vëllim kodiku i artë është më i madh e përmban 413 fletë. Në të përfshihen të katër ungjijtë (sipas Mateut, Markut, Llukës e Joanit). Ku kodik i takon shek. IX dhe është i shkruar me shkronja të një tipi të ri, të rrumbullakët dhe me bishta, të quajtur korsiv minuskul. Edhe ky kodik është shkruar në greqishten e vjetër.¹⁰

SI U ZBULUAN KODIKËT E BERATIT

Studiuesi francez Pjer Batiffoli gjatë vizitës nëpër kishat e Beratit në vitin 1865 mbeti i mahnitur nga zbulimi i disa kodikëve të vjetër kishtarë. Nga kodikët më të njohur, për të cilët na flet Batiffoli, është Codex purpurus Beratius Ø, vepër e shek. VI, si dhe Codex aureus Anthimi, që i përket shekullit IX. Si u bë e mundur që ky kodik të mbërrinte deri në ditët tona? Atdheu ynë, Shqipëria, gjithmonë ka qenë në fokusin e pushtimeve nga armiqtë e ndryshëm. Luftërat e panumërta kanë sjellë gjithnjë me vete përndjekje e shkatërrime, si edhe grabitjen e vlerave kulturore.

⁹-Anthim Aleksudhi ka lindur në vitin 1824 në Madhito. Më 22 shkurt të vitit 1855 u hirotonis mitropolit i Beratit. Në këtë post qëndroi deri në vitin 1887 ku u transferua si mitropolit i Amaksias. Këtë fron e mbajti deri në vitin 1908. Vdiq më 11 shkurt të vitit 1909 në Kostandinopojë. Anthim Aleksudhi ka botuar disa libra prej të cilëve mund të përmendim: “Një vështrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit, Korfuz 1868” dhe “Katalog i kodikëve që ndodhen në kishën e kalasë së Mitropolisë së Beratit, 1900”.

¹⁰-Kosta Naçi, Rreth vendlindjes së dorëshkrimeve mesjetare të Shqipërisë, Shkenca dhe jeta, nr.127, janar 1991, faqe 34-35.

Në vitin 1356 serbët dogjën Beratin, që ishte një nga qendrat kryesore të zhvillimit të Arbërit dhe të Kishës Ortodokse. Në këtë kohë të vështirë meshtari Skuripeqi së bashku me murgun Theodhulos ngarkuan në 27 thasë kodikët e shenjtë kishtarë dhe i fshehën, me qëllim që kultura shqiptare të mos dëmtohej dhe të grabitej e që ky komb të mos mbetet pa traditë e histori.¹¹

Gjatë Luftës I Botërore austriakët që pushtuan Beratin dhe rrethinat e tij përdorën të gjitha mjetet, që nga premtimet joshëse dhe deri te kërcënimet kundër epitropëve të kalasë, për të treguar vendin e fshehtë. Kështu që këto vepra të shenjta mbijetuan në saje të njerëzve shpresëtarë e patriotë. Kjo histori e thjeshtë por heroike është përsëritur sa e sa herë nëpër shekuj, ku të huaj të tjerë herë nën petkun e mikut e herë me kërcënimin e armëve, u përpoqën t'i grabisin këto thesare të popullit tonë. Në të gjitha këto raste shpresëtarja e popullit ortodoks i doli për zot duke i ruajtur si dritën e syve këta libra të shenjtë, ashtu siç ka ruajtur edhe thesaret e tjera që përbëjnë identitetin tonë kombëtar.¹²

Deri në pushtimin e Shqipërisë nga italianët fashistë, kodikët e Beratit u paraqiteshin besimtarëve vetëm një herë në vit, në të kremten e Joan Pagëzorit. Më vonë ata u ruajtën në fshehtësi nga kleri dhe epitropët e kishave të Beratit. Kodikët e Beratit janë zbuluar shumë vonë, në gjysmën e dytë të shekullit XX. Zbuluesi i tyre është psalti i qytetit të Beratit, Nasi Papavli. Zbulimi i tyre u bë në këto rrethana: Nasi ishte djalë prifti dhe çdo të dielë shoqëronte të atin kur ngjitej në lagjen kala për të meshuar në kishën e “Shën Trinisë”, për ta ndihmuar dhe për të mësuar të psalte. Kur djali u rrit dhe ishte në moshë madhore, një ditë pas meshës, kur kisha ishte e boshatisur nga besimtarët, i ati e thirri brenda në hierore dhe i tha se do t'i tregonte një sekret të

¹¹-Thimi Çollaku, Kodikët shqiptarë - thesare unikale të kulturës kombëtare, Rilindja javore, 26 janar - 2 dhjetor 1995.

¹²-Thimi Çollaku, Kodikët - pronësi e patjetërsueshme kulturore kombëtare, Rilindja Javore, 14-26 janar 1996.

rëndësishëm. Ai i tregoi një kapak pranë Tryezës së Shenjtë dhe i tha që ta hiqte. Para syve të djalit u duk në errësirë një gropë e thellë. Aty i tha i ati, janë fshehur dy libra me vlerë të madhe, të cilët të huajt janë përpjekur t'i shtien në dorë. Pasi i ati vdiq, Nasi mori rrugën e kurbetit dhe shkoi në Amerikë për të siguruar jetesën e familjes. Pas shumë vjetësh u kthye në atdhe. Thonë se amanetin s'e tret dheu dhe Nasit i rëndonte shumë amaneti i të atit, por nuk shihte asnjë rrugëdalje.

Në vitin 1956 Nasi u transferua familjarisht në Tiranë dhe u krijuan kushte për ta ndjekur problemin, megjithatë nuk e pati të lehtë sepse përmbajtja e librave ishte fetare dhe regjimi ishte ateist. Më në fund guxoi dhe trokiti në Institutin e Shkencave ku kërkoi takim me prof. Aleks Budën, i cili i premtoi se do të interesohej dhe do ta njoftonte. Në takimin tjetër prof. Aleks Buda i tha se çështjen ia kishte referuar Degës së Brendshme të Beratit, kishte shkuar edhe vetë në Berat, por përgjigje nuk kishte marrë. Siç duket epitropët nuk kishin besim tek autoritetet komuniste. Pësëmbëdhjetë vjet me radhë Nasi, çdo dy javë shkonte në Institutin e Shkencave për të marrë ndonjë përgjigje. Më në fund vëllimet u gjetën dhe vetëm atëherë Nasi mësoi se dy librat aq të kërkuar nga të huajt ishin kodikët e shekujve të hershëm me vlerë të rrallë historike. Prof. Aleks Buda botoi një artikull në gazetën “Zëri i Popullit” për rëndësinë e kodikëve të Beratit, ku ka shprehur njëkohësisht konsideratën e tij të veçantë për familjen e Nasi Papapavlit.¹³

RESTAURIMI I KODIKËVE

Me interesimin e prof. Aleks Budës u bë e mundur që kodikët të restauroheshin në Kinë. U deshën plot tre vjet që të nënshkruhej marrëveshja midis Komitetit Qendror të PPSH-së dhe

¹³-Teodor Papapavli & Maksim Çuko, Si u zbuluan Kodikët e Beratit, Ngjallja, tetor 1999, faqe 9-10.

Akademisë së Shkencave të Kinës. Kështu më 18 mars të vitit 1971 “Kodiku i Purpurt i Beratit” dhe “Kodiku i Artë i Anthimit” udhëtuan drejt Pekinit për t’iu nënshtruar restaurimit. Kodikët me vlerë iu besuan Sanije Marës, e cila kishte 30-vjet që punonte në Arkivin Qendror të Shtetit, në sektorin e restaurimit, si dhe Reshat Alisë, vëllait të Ramiz Alisë.¹⁴

Me të mbërritur në Pekin u bë përcaktimi i gjendjes fizike dhe kimike të materialit nga i cili përbëheshin kodikët. Kinezët mbetën të befasuar dhe shprehën shqetësimin e tyre: “Deri tani nuk kemi patur asnjë rast të tillë. Kemi restauruar objekte në dru, në gurë, në mermer, në hekur, por asnjëherë në një material të tillë ku janë derdhur shkronja ari dhe argjendi”. Specialistët kinezë thanë se kodikët duhej të kishin ardhur për restaurim menjëherë pas zbulimit të tyre, ashtu siç qenë të lagur, sepse restaurimi do të ishte më i lehtë. Ndërsa gjendja e tyre, pasi kishin kaluar tre vjet, ishte kritike. Puna për restaurimin e kodikëve filloi më 4 prill 1971. Kodikët e rrallë u lagën përsëri me qëllim që të kryhej restaurimi i tyre. Puna për të sjellë kodikët në gjendjen e mëparshme duhej që të përfundonte patjetër përpara muajit nëntor, në mënyrë që për Kongresin e PPSH-së, i cili mbahej në datën 8 nëntor, ata të qenë restauruar. Kështu pas një pune intensive kinezët më 1 nëntor të vitit 1971 ua dorëzuan përfaqësuesve shqiptarë kodikët e restauruar plotësisht. “Kodiku i Purpurt i Beratit” nga një dorëshkrim me 190 faqe, u kthye në nëntë volume me nga 20 faqe. Gjithashtu e njëjta punë u bë edhe për “Kodikun e Artë të Anthimit”. Kodikët u sistemuan në nëntë arka duke u ambalazhar më së miri. Më 31 dhjetor të vitit 1971 kodikët, pas një pune gjashtë mujore për restaurimin e tyre, mbërritën në portin e Durrësit me anijen “Vlora”.¹⁵

¹⁴-Fiqiri Sejdiaj, Misioni i vëllait të Ramiz Alisë në Kinë për Kodikët shqiptarë të krishtërimit”, Panorama, 29 dhjetor 2003, faqe 12-13.

¹⁵-Fiqiri Sejdiaj, Për Kodikët shqiptarë kinezët angazhuan dhjetëra ushtarë të armatosur dhe tren special, Panorama, 30 dhjetor 2003, faqe 12-13.

ÇFARË PËRMBAJNË KODIKËT E SHQIPËRISË

Kodikët që kanë mbërritur deri në ditët e sotme janë të shumtë e të larmishëm. Ata janë shkruar në fletë pergameni e në fletë letre. Në 10 kodikët e punuar në fletë pergameni shkronjat janë me ar dhe argjend të derdhur, të cilat janë plotësuar me miniatura e vinjeta ari dhe argjendi. Ndërsa 35 kodikë të tjerë të punuar me fletë pergameni janë të shkruara vetëm me bojë.



Në kodikët me përmbajtje teologjike përfshihen tekste biblike, liturgjike dhe agjiologjike, por krahas tyre gjejmë edhe kodikë me muzikë kishtarë bizantine, si p.sh. muzikën e kompozuar nga kryepsalt Joani i kishës së Tiranës etj. Nëpër kodikë përmenden emrat e qyteteve dhe fshatrave shqiptare, si dhe ngjarje të caktuara historike. Në kodikun e manastirit të “Shën Kozmait” përmenden 86 emra fshatrash, nga të cilët 74 gjenden edhe sot në afërsi të këtij vendi. Në kodikun nr.4 të Beratit bëhet fjalë për një tërmet të madh që ka rënë në 8 mars 1551: “në mesnatë duke u gëdhirë e diela ra tërmeti i madh, u çanë kisha dhe ranë shtëpitë, u hap toka dhe kështjella e Tepelenës ra e gjitha, u vranë 300 shpirt...”. Në

mjaft kodikë gjejmë emrin e kopjuesit, kohën e përfundimit të dorëshkrimit, vendin e punës, emrin e personit që kishte paguar për përgatitjen etj. Këto dëshmi edhe pse janë fragmentare, tregojnë, se në këto qendra kishtare apo manastire janë kopjuar kodikë të porositur nga paria feudale apo kishtare dhe që shkruheshin prej vendasve. Si shembull mund të sjellim kodikun nr.50 të Beratit, ku në anëshkrimin e tij tregohet për shkruesin Theodhor, të cilin e kishte ngarkuar sundimtari i kësaj treve Theodhor Muzaka për ta përfunduar sa më shpejt. Kjo ishte arsyeja që shkruesi i lartpërmendur u mbyll në kalanë e Skraparit për ta mbaruar në kohën e duhur. Në Kodik thuhet: “U shkrua me dorën e të përvuajturit Theodorit, që ishte Dukë dhe Logothe i Beratit, pranë Theodhor Muzakës. Tani qëndron i burgosur në kalanë e Skraparit. Kushdo që ta lexojë të më kuptojë dhe të lutet për mua të mjerin, sepse e shkruajta me vuajtje të mëdha”. Kodiku daton në vitin 1411. Po në vitin 1411 është shkruar dhe një kodik tjetër. Në kodik thuhet: “U shkrua dhe u përfundua ky psaltir me kontributin dhe shpenzimet e të nderuarit Jeromonak dhe Arkimandritit Maksim dhe iu dorëzua Manastirit të Shenjtë të Virgjëreshës Mari në Berzhehdë, për përdorim të brendshëm në atë Kishë të Perëndisë. Kushdo që e nxjerr jashtë kishës këtë psaltir do të ketë kundërshtar të përjetshëm Hyjlindësen”.

Në kodikun nr. 13 gjejmë emrin e Filip Anastasit nga Voskopoja dhe daton më 30 mars 1729. Ai është porositur nga Papa Johani, Nikolla Anastasi dhe bijtë. Në të shkruhet: “U shkrua Eksodhistikoni me dorën e më të voglit ndër meshëtarët, Prift Nikollës Voskopoje”. Në shënimet e kodikut nr. 91, i cili mban datën 4 shtator 1756, gjejmë emrin e Episkopit të Beratit Joasafit, i cili thotë: “U shkrua kjo Kristoithi me dorën e Joasafit të Beratit”. Më pas na informon se Kristoithia na është përkthyer nga gjuha latine në gjuhën greke nga i dituri Andon Bizantini, profesor në shkollën e Kostandinit. Në një kodik tjetër mësohet: “Ky libër është i Shën Marisë Evangjeliste, e shkrova unë Jeromonak

Simeoni”. Diku tjetër thuhet: “Libri u shkrua nga Theodhor Gramatia dhe iu dha Gjergjit të Madh”, datë 1438. Këtu bëhet fjalë për Gjergj Arianitin. Në një kodik tjetër është shkruar: “Këto u shkruan me dorën e Theodhor Haxhifilipit, me shpenzimet e të shumënderuarve Athanas Niçiotit dhe Gjergji Naum Pavlit”.¹⁶ Në kodikun e kishës së “Shën Prodhromit” flitet për kuvendin e korporatës së bakejve. Ky kodik i përket shek. XVIII. Në të ndeshen shumë aspekte të aktivitetit të esnafëve, që përbëjnë bazën e zhvillimit ekonomik të qyteteve mesjetare shqiptare. Në kodikun 103 ka të dhëna për Principatën e Arbërit, një nga shtetet e para feudale në trojet arbërore. Ato janë datuar prej Dimitrit në vitin 1226 dhe janë dorëshkruar për manastirin e “Shën Andreas” afër Krujës, kryeqendra e shtetit të Arbërit në atë kohë. Ai përmban disa epigrame të Dimitrit të Arbërit, Kryezot i Principatës së Arbërit që ishte i pari mbret shqiptar i mesjetës. Një vend të rëndësishëm nëpër kodikët zënë edhe kronikat për principatat feudale të Ali pashë Tepelenës dhe të Bushatllinjve të Shkodrës. Kështu në kodikun e manastirit të “Shën Kozmait” flitet për marrëdhëniet e Shën Kozmait me Ali pashë Tepelenën dhe me sundimtarin e Beratit Ahmet Kurt Pasha, si dhe lidhjet dhe kontradiktat midis tyre. Në kodikun e Beratit të vitit 1845 gjejmë kronikat arsimore të kohës së Kosta Beratit dhe të Ibrahim Pashës në vitin 1803. Në kodikun e kishës së “Shën Prokopit” të Tiranës gjejmë të dhëna rreth zhvillimit kulturor, shoqëror, arsimor e fetar të bashkësisë ortodokse të qytetit, duke filluar që nga viti 1818 e këtej. Ky kodik përfshin një periudhë 100-vjeçare. Kjo vërtetohet nga shënimi i fundit, i cili daton më 31-12-1922. Disa nga aspektet që trajton ky kodik janë: formimi i bashkësisë ortodokse jashtë qytetit, vendosja në qytet, ndërtimi i kishës së “Shën Prokopit”, organizimi esnafor, intelektualët e parë, marrëdhëniet shoqërore, veshjet, zakonet etj.¹⁷

¹⁶-Liljana Bërzhholli, Kodikët thesare të kulturës shqiptare, Tiranë 1999.

¹⁷-Dhimitër Beduli, Kodiku i kishës së Shën Prokopit të Tiranës, Tiranë 1997, faqe 6.

KODIKU I MADH I MITROPOLISË SË KORÇËS DHE SELASFORIT

Ky kodik është një trashëgim shumë i çmueshmëm dhe fillon me 25 vjetët e fundit të shek. XVII kur Parthini, Patriku i Ohrit dhe Kryeepiskopi i Korçës e pajisi Mitropolinë e këtij qyteti me një kodik, i cili mban titullin “Kodik i fort të Shenjtës dhe Perëndimbrotjës Mitropoli të Korçës dhe Selasforit”. Kodiku i Korçës është një thesar të dhënash që përfshijnë shek. XVII-XX. Ai i përket kohës kur dioqeza e Korçës përfshihej në Patriarkanën e Ohrit, si edhe kohës kur Mitropolia e Korçës hyri në juridiksionin e Patriarkanës së Kostandinopojës. Fletët e kodikut janë prej letre të bardhë, të trashë e pa vija, vetëm një akt është shkruar në gjuhën turke, kurse të gjithë shkrimet e tjera janë në gjuhën greke. Nëpër faqe të ndryshme të kodikut gjuha greke është ndikuar nga sintaksa e gjuhës shqipe, pasi ata që e kanë shkruar kodikun kanë qenë shqiptarë me pak shkollë dhe nuk e kanë ditur mirë gjuhën greke. Në tekste shihet redaktimi i dorës së disa artizanëve të njohur, si p.sh. Theodor Kavalioti, Dhaskal Tërpo Marku e Dhaskal Kostë Cepi.

Kodikun është konsideruar si një regjistër i traditave të vendit, i halleve dhe i problemeve të kohës. Këtë kodik e kanë shfrytëzuar për të argumentuar veprat e tyre Nuçi Naçi, Mihal Grameno etj, enciklopedistë e studiues të huaj, si p.sh. Jani Lambrinidhi, Heinrich Gelzer, Evlogjio Kurilla etj. Kodiku i Mitropolisë së Korçës jep të dhëna për arkën popullore, e cila quhej “Llaso”. Këtë arkë e kishin krijuar vetë anëtarët e bashkësisë dhe paratë që grumbulloheshin përdoreshin për nevoja publike, si për shembull shkolla, ndërtime të ndryshme etj. Arka popullore “Llaso” filloi që të organizohej në vitin 1849. Donacione të fuqishme kanë dhënë emigrantët korçarë nga Amerika, Misiri etj. Gjithashtu nëpër fletët e kodikut gjejmë të dhëna për funksionimin e gjykatave shpirtërore, të cilat funksiononin vetëm për disa çështje

të caktuara të bashkësisë ortodokse, si për shembull për probleme që kishin të bënin me disiplinën fetare, për divorcet etj. Gjykata shpirtërore ka gjykuar edhe mjaft çështje në lidhje me trashëgimitë dhe donacionet.


Nga të dhënat që na jep Kodiku i Mitropolisë së Korçës mësojmë se zanatçinjtë e qytetit kanë qenë të organizuar nëpër esnafe, nga të cilët mund të përmendim atë të kasapëve, opingarëve etj. Këto esnafe shpesh mblihdeshin në Mitropolinë e qytetit për të diskutuar për probleme të ndryshme. Kodiku jep informacione të bollshme për zhvillimin e arsimit në qytetin e Korçës. Në vitin 1724 bashkësia ortodokse e Varoshit filloi fushatën për grumbullimin e fondeve, të cilat do të përdorëshin për arsimin. Ndihma në të holla dhanë Vithkuqi, Voskopoja, Boboshtica etj. Në vitin 1873 u çelën disa kopshte për fëmijët ortodoksë nga shoqëria “Vëllazëria e miqve të të varfërve”. Me donacionet që janë shënuar në kodik, besimtarët korçarë e kanë pajisur katedralen e Mitropolisë me një ikonostas madhështor të punuar në dru are dhe të zbukuruar me motive të ndryshme. Kodiku i Madh i Mitropolisë së Korçës jep mjaft të dhëna për historinë e artizanatit kishtar.¹⁸

KODIKU I KORÇËS NR.93

Kodiku i Korçës Nr. 93 u shkrua në fletë pergameni në fillim të shekullit X. Kodiku përbëhet prej 308 fletësh me përmasa 153x129 mm. Teksti i katër ungjijve është shkruar në pergamenë të hollë ngjyrë të bardhë. Fletët 12, 92, 141, 225 përmbajnë miniaturat e katër ungjillorëve. Sinaksari dhe Menologu janë shkruar në pergamenë jo të njëjta me atë të ungjijve. Këto së bashku me fletët e miniaturave të katër ungjillorëve janë shtuar

¹⁸-Akademia e shkencave, Materiale Dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shekullit XVIII- fillimi i shekullit XX, (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), Vëll. II, Tiranë 1981.

më vonë në kodik. Sipërfaqja e shkruar e tekstit të ungjijve është në formë kryqi me përmasa 105x75 mm. Kodiku i Korçës Nr. 93 është shkruar me shkrim germëvogël të tipit Boulette. Kodikun e kanë shkruar tre kodikshkrues të panjohur në dy periudha kohore. Kodikshkruesi kryesor ka shkruar katër ungjijtë rreth gjysmës së parë të shekullit X. Pjesa e mbetur është shkruar rreth shekullit XIII. Teksti i ungjillit është shkruar me bojë kafe, ndërsa për titujt e kapitujve dhe gërmat nistore kodikshkruesi ka përdorur bojë të artë dhe të kuqe. Tabelat e kapitujve janë shkruar me bojë të purpurtë. Kodiku i Korçës Nr. 93 u punua në punishtet libërshkruese të Kostandinopojës rreth viteve të mbretërimit të Kostandinit VII Profirogjenitit. Kapakët e kodikut janë prej druri të veshur me lëkurë kafe, në të cilën janë stampuar shirita dekorativë me motive floreale.



Kodiku i Korçës Nr. 93 është pjesë e koleksionit të dorëshkrimeve bizantine që ruhen në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Promovimi i botimit faksimile të Kodikut të Korçës Nr. 93 u bë më 16 dhjetor 2012 në mjediset e Qendrës Kulturore pranë katedrales “Ngjallja” në Tiranë. Ky botim faksimile është i pari në

historinë e botimeve dokumentare në Shqipëri. Për përgatitjen e këtij botimi luksoz punuan historiani-paleograf Andi Rëmbeci dhe paleografi Sokol Çunga, të mbështetur nga dy ndër personalitetet më të shquara të paleografisë bizantine Agamemnon Celikas dhe Joan Vitalioti. Botimi i Kodikut të Korçës Nr. 93 u mundësua me kontributin e Shoqërisë Biblike Ndërkonfesionale të Shqipërisë, të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.¹⁹

KODIKU I MANASTIRIT TË SHËN PRODHROMIT

Kodiku i manastirit të “Shën Prodhromit” u shkrua në vitin 1779 prej peshkopit të Gorës, Mihalit nga Shipska. Ky i fundit ka shfrytëzuar të dhënat e një kodiku më të hershëm. Në vitin 1939 ish Mitropolti i Beratit Joakim Martiniani e botoi tekstin e kodikut të manastirit të “Shën Prodhromit” në Athinë: “Kontribute në historinë e Voskopojës. Manastiri i Shënjtë i Shën Prodhromit sipas Kodikut të tij (1630-1875) “.



¹⁹-Andi Rëmbeci, Sokol Çunga, Kodiku i Korçës Nr. 93, katërrungjillëshi bizantin i shek. X, kërkim Nr. 10, Tiranë 2013, faqe 79-88.

Kodiku i manastirit të “Shën Prodhromit” na jep të dhëna rreth krijimit të manastirit, ngjarjet historike si dhe hierarkëve që kanë shërbyer në këtë manastir të shenjtë. Nëpërmjet kodikut njihemi gjithashtu me shkaktarët e shkatërrimit të parë të Voskopojës si dhe me përjetimin e shkatërrimit nga popullsia vendave. Të gjitha këto të dhëna të rëndësishme vijnë deri në ditët tona vetëm në sajë të botimit të ish Mitropolitit të Beratit Joakim Martinianit.²⁰

Sipas prof. Pëllumb Xhufit kodiku i manastirit të “Shën Prodhromit” në Voskopojë në vitin 1913 ka pësuar dëmtime nga prifti i divizionit të V Kallimachos, i cili ka bërë disa shënime me tendenca nacionaliste në faqen e fundit të kodikut. Në vitin 1943 pas zjarrit që ra në mjesditet e manastirit kodiku origjinal u dogj. Duke u mbështetur në botimin e Joakim Martinianit, historiani Pëllumb Xhufi në vitin 2010 e ka përkthyer “Kodikun e Manastirit të Shën Prodhromit” dhe e ka botuar në fundin e librit “Shekulli i Voskopojës”.²¹

²⁰-Joakim Martiniani ka lindur në Voskopojë, më 1875. Studimet e larta i ndoqi në shkollën teologjike të Halkit. Në vitin 1903 u dorëzua dhjak në kishën patriarkale të Shën Gjergjit, nga Patriku Ekumenik Joakimi III. Më 4 korrik të vitit 1911 Joakim Martiniani u zgjodh mitropolit i Beratit, ndërsa ceremonia e fronëzimit u celebrua më 10 korrik 1911. Sapo mbërriti në Berat, mitropoliti Joakim ngriti një shkollë hierartike në manastirin e Ardenicës. Në Vlorë ngriti shtypshkronjën, ku botonte një gazetë të përjavshme. Mitropoliti Joakim inventarizoi pasuritë e paluajtshme të manastireve. Me interesimin e tij u restaurua manastiri i Zvërnecit. Gjithashtu ndërtoi një bibliotekë të pasur në mitropolinë e Beratit, e cila u dogj më 14 shtator të vitit 1913. Në vitin 1920 vajti në Korfuz dhe nuk e jeluan të kthehej në mitropolinë e tij.-Dr. Dion Tushi, Joakim Martiniani, Kërkim, Nr. 6, Tiranë 2010, faqe 59-62.

²¹-Pëllumb Xhufi, Shekulli i Voskopojës, Tiranë 2010, faqe 348-392 teksti në greqishten bizantine dhe faqe 393-432 përkthimi në shqip.

KREU I TETË

IKONOSTASËT

Nëpër kishat ortodokse ikonostasi, fronti peshkopal dhe amvoni janë vepra arti, të cilat në shumicën e rasteve janë gdhendur nga mjeshtra anonimë. Ikonostaset i kemi dy llojesh prej druri ose prej muri. Në ikonostas vendosen ikonat e shenjta sipas një rregulli të caktuar. Ikonat e ikonostasisit i ndajmë në të mëdha dhe të vogla. Në vendosjen e ikonave të mëdha ndiqet ky rregull: gjithmonë në qendër të ikonostasisit vihen ikona e Krishtit dhe e Shën Mërisë me Krishtin ndër duar. Në krah tyre vendosen Joan Pagëzori nga njëra anë dhe ikona e Shenjtit të Kishës nga ana tjetër. Mbi dyert e veriut dhe të jugut vendosen Kryeengjëjt Mihail dhe Gabriel. Ikonat e vogla që vendosen në pjesën e sipërme të ikonostasisit janë me tematikë nga të kremtet kryesore të Krishtit dhe të Shën Mërisë. Në qendër të ikonostasisit vendoset kryqi mbi të cilin është pikturuar Krishti i kryqëzuar.¹

Zakonisht ikonostaset e gdhendur në dru i lyenin me bojë ari. Disa nga mjeshtrat e gdhendjes së drurit kanë preferuar të mbeten anonimë. Kjo vërtetohet nga disa ikonostase, të cilët kanë të shënuar vetëm datën e punimit dhe jo emrin e gdhendësit, si

¹-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, nëntor 1995, faqe 8.

p.sh. ikonostasi i kishës së Shën Kollit në Krutjen e Sipërme, i punuar në vitin 1821, ikonostasi i kishës së Shën Kollit në Vanaj më 1811 etj. Disa nga ikonostaset me vlera të mëdha artistike që i kanë qëndruar kohës janë:

1-Ikonostasi i katedrales “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit, i cili është gdhendur në dru are dhe është i larë me ar. Joan Çetiri ka realizuar me mjeshtëri ikonat e ikonostasit të kishës, gjithsej 27 ikona të vogla dhe 7 të mëdha. Në dyert e bukura të ikonostasit janë të gdhendur dy dragoj dhe në kulmin e derës gjendet një shqiponjë me kurorë sipër krerëve.



2-Gdhendjet e ikonostasit, amvonit dhe fronit dhespotik të kishës së Lindjes së Shën Marisë në Manastirin e Ardenicës janë realizuar nga një grup gdhendësish nga Dibra e Madhe (Golloborda). Ikonostasi është i gdhendur në dru arre. Simbolika e gdhendjeve është marrë nga bota bimore dhe shtazore. Përmasat e Ikonostasit janë 8.75 m gjatësi dhe 4.5 m lartësi. Në qendër të ikonostasit është kryqi i gdhendur, në të cilin ikonografi Kostandin Shpataraku ka pikturuar me shije të hollë artistike skenën e kryqëzimit.

3-Ikonostasi i kishës së Shën Mërisë në Labovën e Kryqit është prej druri të gdhendur, i cili me harlisjen e tij të krijon përshtypjen e një pjergulle. Në të janë skalitur pjergulla dhe bistakë

rrushi dhe zogjtë që çukisin mbi to. Ikonostasi është gdhendur prej Kostë Tunit nga Meçova në vitin 1805. Në qendër të ikonostasit madhështor gjenden dyert e bukura dhe sipër tyre është gdhendur një shqiponjë dykrenore. Në pjesën e sipërme të ikonostasit gjenden 12 ikonat e vogla. Ikona e fundit tregon si u gjet kryqi ku u kryqëzua Krishti prej Elenës, nënës së Kostandinit të Madh. Kjo ikonë është vendosur jashtë programit standard ikonografik të paraqitjes së festave kryesore. Vendosja e ikonës ka për qëllim të kujtojë se në këtë kishë ekziston një pjesë nga Kryqi i Shënjtë, mbi të cilin është kryqëzuar Krishti.²

4- Ikonostasi i kishës së Shën Mërisë në Sopik të Pogonit është i gdhendur në dru arre dhe është punuar me shumë mjeshtëri nga Nikolla nga fshati Magarova i Manastirit. Ikonostasi ka gjatësi 13 metra dhe është i stolisur me kombinime të bukura. Çdo shtyllë e ikonostasit fillon me një vazo, prej së cilës del një degë hardhie. Mbi degët e gdhendura gjenden zogj dhe pëllumba duke çukitur degët dhe me kokrra rrushi në gojë. Nën kryqin e drunjtë mbi ikonostas gjenden dy dragonj.³

5-Ikonostasi i kishës së Shën e Premtes në Hllomo të Pogonit është gdhendur në vitin 1859 prej mjeshtër Dhimitrit nga fshati Hionadhes. Ky i fundit është shpërblyer me 5000 lira.⁴

6-Ikonostasi i kishës së Shën Mërisë në Leusë të Përmetit është prej druri arre të gdhendur me një mjeshtëri të lartë artistike. Thellësia e gdhendjeve arrin deri në shtatë centimetra. Nëpër kolonat e ikonostasit janë gdhendur motive të stilizuara të hardhisë të kacaviren gjatë trungut të drurit. Ikona e madhe e Joan Pagëzorit në ikonostasin e kishës daton në vitin 1778. Kjo ikonë është

²-Gazmend Muka, Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, Albas, Tiranë 2013, faqe 99-103.

³-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 21-22.

⁴-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996, faqe 34-36.

pikturuar nga një piktor anonim. Punë të tij janë edhe ikona e madhe e Krishtit, e Shën Mërisë, e Shën Mëhillit dhe ikona e Shën Spiridhonit.⁵

7- Ikonostasi i kishës së Lindjes së Hyjllindëses në Manastirin e Spilesë, sipas studiuesit Konstantinos Giakuomis, i cili e ka vizituar kishën në vitin 1997, ndahej në tri zona, më e ulëta prej të cilave mbarte panele të lugëta në formë trëndafili të brendashkruar në rombe tetëbrinjësh, me anët e sipërme dhe të poshtme në formë harku. Në të katërta këndet panelet dekorative mbartin zbukurime floreale. Në zonën e dytë, shtyllat zbukurohen me elementë bimore, në anët e të cilave formohen bime kacavjerrëse. Pjesa e epërme e shtyllave kurorëzohet me pseudokapitele. Në pjesën mbi shtyllat bien në sy guaskat e gdhendura, të cilat rrethojnë një lule në qendrën e tyre dhe mbështeten në korniza të skalitura në formë bime kacavjerrëse me lule në qendër. Në panelet e lugëta të ikonostasis janë pikturuar profetët: Isaia, Abakumi, Danieli, Moisiu, Davidi, Solomoni, Jezekieli dhe Jeremia. Pesë nga profetët mbajnë në duar rrotulla të shkruara me tekste që lidhen me Shën Mërinë, ndërsa tre të tjerët me Krishtin. Në ikonën e Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet ky mbishkrim: “Lutje e igumen jeromonak Kostandinit 1784”.⁶

8-Në Kodikun e Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit gjejmë emrin e Dhimitrër Kolecit, i cili në vitin 1756 ka gdhendur me mjeshtëri ikonostasin e kishës “Burimi Jetëdhënës” në qytetin e Korçës. Dhimitër Koleci është nga fshati Mariani i Oparit. Ai ka guxuar të gdhendë ikonostasin e parë tip “rokoko” në Shqipëri. Në gdhendjet e tij tregon forcën e daltës në lëvizjet helikoidale të

⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 380, faqe 185.

⁶-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.615, faqe 250.

gjetheve të lisit si dhe realizimin e përkryer të figurave njerëzore të shenjtoreve.⁷

Nëpër kishat e vjetra të Shqipërisë ruhen rreth 50 ikonostase të gdhendura nga duart e arta të mjeshtrove vendas. Nga mbishkrimet ato datojnë ndërmjet shekujve XVIII-XIX. Nga mjeshtrot e gdhendjes së ikonostaseve mund të veçojmë: Usta Naumin nga Lavdari i Oparit, i cili në vitin 1849 ka punuar ikonostasin e kishës “Fjetja e Shën Mërisë” në Berat, Andon Korfuziotin, që ka gdhendur në vitin 1758 ikonostasin e kishës së Shën Kollit në Voskopojë, Kostë Tumi Meçovitin, i cili në vitin 1805 ka punuar ikonostasin e kishës së Shën Mërisë në Labovë të Kryqit, gdhendësin Mitro Fandi, i cili më 1842 ka punuar ikonostasin e kishës së Shën Mëhillit në Gjirokastrë, Dhimitri nga Konica ka punuar ikonostasin e kishës së Shën e Premtes në Përmet etj.⁸



Dalta e Andon Qerqiriotit ka gdhendur amvonin dhe fronin episkopal të kishës së Shën Kollit në Voskopojë më 1758. Disa ikonostasë janë punuar me tornu, mund të veçonim atë të kishës

⁷-Fatbardha Shkupi, Mjeshtër shqiptarë, dekoratorë që kanë opunuar në Bullgari, Maqedoni dhe në Shqipëri, Monumentet 2002, faqe 75.

⁸-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, faqe 18.

së Shën Mërisë në Elbasan.⁹ Sipas teologut Theofan Popa ikonostasin e kësaj kisha e ka punuar mjeshtrë Filipi nga Reka e Dibrës. Në mbishkrimin që gjendet mbi derën e bukur shkruhet: “Ky tempull u gdhend dhe u tornua në vitin 1859, në kohën e peshkopatit Joaniqi dhe kur ishte epitrop Dhimitër Andre Kazanxhiu dhe Kostandin Andoni. U varakos në 1868 në vitet e peshkopatit të gjithhirshmit, Shenjtit të Durrësit Z.Z. Visarion dhe kur ishin epitropë Z.Z. Kostandin Papajani, Jan Xhufka dhe Kostandin Simoni me dëshirën e devotshme të të gjithë të krishterëve krishtdashës të kalasë. Dora e Josifit 1868 në muajin dhjetor ditë 21”.¹⁰

Mjeshtrat drugdhendës të familjes Basho janë Rako me të bijtë Ilirin dhe Vasilin. Historia e gdhendjeve në dru të tyre fillon në vitin 1993, me “Dyert e Bukura” të ikonostasit të kishës “Fjetja e Shën Marisë” në qytetin e Pogradecit. Vite më vonë ata gdhendën edhe ikonostasin e kësaj kisha. Në vitet 1996-1997 Rako dhe Ilir Basho gdhendën ikonostasin e kishës së manastirit të Shën Vlashit në qytetin e Durrësit. Ndërsa ndërmjet viteve 1998-1999 të tre drugdhendësit e familjes Basho kanë punuar ikonostasin e kishës “Ngjallja e Krishtit” në qytetin e Pogradecit. Në vitin 1999 filluan punën për gdhendjen e ikonostasit të kishëzës së Akademisë Teologjike në Shën Vlash.¹¹ Ikonostasi i kishës së Shën e Premtes në Valësh të Shpatit është prej muri të suvatuar me lartësi rreth dy metra. Ai është i pikturuar edhe nga ana e brendshme e altarit.¹²

⁹-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e jugut, Tiranë 1998, faqe 257.


¹⁰-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr.63, faqe 73.

¹¹-Gjergji Gusho, Mbi përhapjen e krishterimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit, Pogradec 2000, faqe 73.

¹²-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar, 55, Tiranë 2005, faqe 26-27.

IKONA E KRISHTIT

Krishti është paraqitur në ikonë me lavdinë e Tij qiellore. I veshur me rroba të kuqe nga brenda dhe me tunikën ngjyrë blu, Krishti paraqitet duke mbajtur Ungjillin në njerën dorë dhe duke bekuar me dorën tjetër. Ungjilli i Shenjtë tregon se Jisu Krishti ishte mësues për gjithë njerëzimin. Gërmat ICXC që gjenden në pjesën e sipërme të ikonës janë gërmat e para të emrit Jisu Krisht në greqisht, të cilat të përkthyer në shqip mund të shkruhen JSKR. “Jisu” është emri që iu dha Mesias në ditën e tetë pas lindjes, atëhere kur iu bë rrethprerja. Jisui e mori emrin prej qiellit kur ëngjëlli njoftoi Josifin (Marku 1: 20-21). Emri Jisu në kohët e mëparshme ishte përdorur tek fëmijët, por më vonë për nderim të Zotit Krisht nuk u përdor më.



“Krisht” është titulli që do të thotë “i lyer”. Në kohët e hershme me vaj lyeshin: Kryepriifti, mbreti dhe profetët. Davidi profetizonte në psalmet kristologjike: “Unë u leva me vaj si të

gjithë mbretërit, kurse ti o Krishti im, do të lyhesh me vaj nga vetë Perëndia dhe ky vaj do të jetë Shpirti i Shenjtë”. Rroba e brendshme që ka veshur Krishti është në ngjyrë të kuqe, ndërsa ajo e jashtme në ngjyrë blu. Gërmat që gjenden në kurorën kanë kuptimin “AI QË ËSHTË” ose e përkthyer në shqip mund të shkruhen “JAM”. Ky është emri që Zoti i tregoi Moisiut në Malin e Horebit. Në gjuhën Hebraike nuk ekziston folja (jam) dhe kur hebrenjtë donin të thonin (ky është Krishti) ata ishin të detyruar të thonin (Jisu Krishti) dhe me këtë kuptonin se Jisui është Krishti. Emri Jisu Krisht për të krishterët hebrej ishte një thënie që tregonte besimin e tyre. Kur thonin Jisu ata nënkuptonin një person, dhe kur thonin Krisht nënkuptonin Perëndinë.¹³

IKONA E HYJLINDËSES

Në ikonografinë ortodokse Hyjlindësja paraqitet bashkë me Krishtin foshnjë. Me dorën e saj të djathtë ajo tregon të Birin duke na thënë: “Ja Shpëtimtari, Mesia që prisnit”. Foshnja Krisht mban në dorë një pergamen, i cili simbolizon misionin e shpëtimit të botës. Në vellon e Hyjlindësës paraqiten disa yje, të cilët tregojnë virgjërinë e saj të përhershme. Rroba e saj e sipërme, velloja dhe rroba e brendshme janë në ngjyrë blu, ndërsa veshjet e Krishtit janë ngjyrë ari. Nga Sinodi III Ekumenik (Efes 431) dhe Sinodi IV Ekumenik (Kalqedoni 451) nderimi i Hyjlindësës nga ana e kishës u bë dogmë zyrtare dhe njihet si nëna e Perëndisë. Etërit e Shenjtë e vendosën Hyjlindësen në vendin e dytë mbas Trinisë së Shenjtë. Kisha jonë që nga shekulli IV ka përcaktuar shumë festa kushtuar Hyjlindësës në kalendarin kishtar. 1-Të zënët e Shën Anës, nënës së Hyjlindësës, më 9 dhjetor. 2-Lindja e Hyjlindësës, më 8 shtator. 3-Hyrja në kishë e Shën Marisë, më 21 nëntor. 4-Ungjillëzimi i Hyjlindësës, më 25 mars. 5-Meshë për Shën Marinë,

¹³-Jorgos Galitis, Shënimet e Seminarit Teologjik, Durrës 1992, faqe 6.

më 26 dhjetor. 6-Fjetja e Shën Marisë, më 15 gusht. Përveç këtyre festave, në nderimin e Hyjlindëses është përcaktuar edhe dita e mërkurë. Gjithashtu kemi më 2 korrik kremtojmë vendosjen në Vllahernë e rrobës së çmuar të Shën Marisë si edhe më 31 gusht kremtojmë vendosjen e brezit të Shën Marisë.



Kemi gjithashtu edhe pesë javët e kreshmëve të mëdha ku psallim Përhëndetjet e Hyjlindëses, ose Himnin Akathist.

UNGJILLËZIMI I HYJLINDËSES (Lluka 1, 24-38)

Në ikonën e Ungjillëzimit paraqitet Hyjlindësja dhe kryeengjëlli Gabriel në të majtë. Hyjlindësja në dorën e majtë mban një lëmshe prej leshi me simbolikën: Ashtu si delet japin leshin e tyre për të veshur njerëzit, kështu edhe Hyjlindësja dha gjakun e mishin e saj për ta veshur Jisuin me natyrën njerëzore. Pergamini që ndodhet në qendër na kujton profecinë e Isaias: “Virgjëresha do të lindë djalë”. E kremtja e Ungjillëzimit të Hyjlindëses festohet

më 25 mars, pra nëntë muaj përpara Krishtlindjeve. Në të kremtojmë lajmin e mirë që kryeengjëlli Gabriel i dha Hyjllindëses. *“Në muajin e gjashtë, engjëlli Gabriel u dërgua nga Perëndia në një qytet të Galilesë, që quhej Nazaret, te një e virgjër, që ishte fejuar me një njeri që quhej Josif, nga shtëpia e Davidit; dhe emri i virgjërshës ishte Maria. Dhe engjëlli hyri te ajo dhe tha: “Gëzohu, o hirëplotë, Zoti është bashkë me ty; e bekuar je ti në mes të grave”.* E kremtja e Ungjillëzimit bie në periudhën e kreshmëve, prandaj mënyra e kremtimit ndryshon nga viti në vit, në varësi të ditës që bie.¹⁴

IKONA E LINDJES (Lluka 2, 1-20)

E Tërëshenjta, kur shkoi në Betlehem së bashku me Josifin, për të bërë regjistrimin, rrugës ajo lindi djalë. Të parëlindurin e mbështolli me rripa stofi dhe e shtriu në një grazhd, i cili paraqitet në ikonë brenda një shpellë të errët. Ikonografi e paraqet shpellën të errët në ikonë, për të simbolizuar errësirën që kishte mbuluar botën e atëhershme, të nxirë nga mëkati.



¹⁴-Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vol 2, faqe 195-197.

Brenda grazhdit paraqitet foshnja, e mbështjellë me rripa stofi dhe e ndriçuar nga drita e yllit. Brenda në shpellë pas grazhdit në ikonë gjendet një ka dhe një gomar. Ikonografi në këtë rast është i frymëzuar nga profecia e Isaisë: “Kau e njeh pronarin e tij, edhe gomari grazhdin e pronarit të tij, por, Izraeli nuk do ta kuptojë se kujt i takon”.

Përveç paraqitjeve ëngjëllore dhe njerëzore, në ikonë shfaqen pasazhe nga bota bimore dhe e kafshëve, me simbolikën, se të gjitha krijesat duhet të gëzohen për lindjen e Shpëtimtarit. Hyjlindësja, si nëna e Perëndisë zë një vend qendror në ikonë. Atë e shohim jashtë shpellës, të gjuhëzuar e me duart e kryqëzuara, duke iu falur foshnjës. Falja e saj na jep të kuptojmë se edhe Hyjlindësja i falet Krishtit. Qëndrimi i Hyjlindëses është i lirshëm, për të pranuar mungesën e dhimbjeve, e vazhdimisht tregon për lindjen e virgjër dhe për origjinën hyjnore të foshnjës. Në ikonë paraqiten engjëjt dhe magët. Njeri nga engjëjt, sipas tregimit të Biblës është duke u njoftuar barinjve ngjarjen e gëzueshme të lindjes. Engjëjt e tjerë, duke parë yllin lavdërojnë: “Lavdi Perëndisë në më të lartat”. Në pjesën e sipërme të ikonës, në të djathtë të shpellës paraqiten tre magët, që i sjellin dhuratat Krishtit të porsalindur. Magët përfaqësojnë idhujtarët, ndërsa barinjtë botën judaike. Magët jepen në ikonë në moshë të ndryshme e me këtë na japin të kuptojmë se Krishti, i cili është “Drita e vërtetë”, erdhi të ndriçojë mbarë njerëzimin, pavarësisht nga mosha. Në pjesën e poshtme të ikonës, majtas paraqitet Josifi, duke u menduar. Kjo pamje e fytyrës na tregon jo vetëm dramën e tij personale, por edhe të gjithë gjinisë njerëzore për të kuptuar e pranuar njerëzimin e Perëndisë.¹⁵

¹⁵-Andrea Llukani, Ikona e lindjes, Ngjallja, dhjetor 1998, faqe 6.

IKONA E IPAPANDISË


Figurat kryesore në ikonë janë plaku Simeon duke mbajtur ndër duar foshnjën dhe Hyjlindësja. Momenti qendror është “takimi i Mesisë, takimi i Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re” dhe ky “takim” ndodhi në tempull përballë altarit. Josifi paraqitet duke mbajtur në dorë dy pëllumba, të cilët simbolizojnë kishën e Izraelit dhe kishën e paganëve. Pas Hyjlindësës paraqitet profeteshja Ana, e cila mban në dorë një pergamen të shkruar si simboli i profetit. Ligji i Moisiut parashikonte nëse fëmija i parëlindur ishte djalë, i duhej kushtuar Perëndisë dhe dyzetë ditë pas lindjes duhej që të shkonte në tempull, ku e ëma merrte uratën e pastrimit, duke blatur dy pëllumba ose turtuj dhe fëmija i kushtohej Zotit. Kështu vepruan Josifi dhe Hyjlindësja. Në Jerusalem në atë kohë jetonte një njeri që quhej Simeon. Plaku i drejtë Simeon ishte nga Jerusalemi. Shpirti i Shenjtë i kishte zbuluar atij, se nuk do të vdiste pa e parë Krishtin. Ky lajm i gëzuar e mbajti me shpresë dhe kurajo deri në moshë të thyer. Kështu 40-ditë pas lindjes së Krishtit, Shpirti i Shenjtë e njoftoi se ëndrra e tij u realizua. Simeoni i drejtë, u nis për të shkuar në tempull, i mbushur me ngazëllim duke pritur bekimin për të cilin e kishte denjësuar Perëndia. Pasi mori foshnjën në krahë tha: *“Tani, o Zot, lëre shërbëtorin tënd të vdesë në paqe sipas fjalës tate, sepse sytë i mi e panë shpëtimin tënd që e përgatite përpara gjithë popujve, dritën për të ndriçuar kombet”*.

Nuk kaloi shumë kohë dhe Simeoni dorëzoi në paqe shpirtin e tij tek Perëndia. Tradita e Shenjtë thotë se plaku Simeon ishte një prej shtatëdhjetë përkthyesve të Dhiatës së Vjetër dhe Perëndia e kishte mbajtur në jetë 350 vjet, për të pritur Mesian. Falenderimi dhe lavdërimi i tij drejtuar Perëndisë mbetet i pavdekshëm sepse është përjetësuar në shërbesat e kishës. Përshëndetja e Simeonit ishte përfaqësimi i gjithë burrave të shenjtë, të cilët jetuan para Krishtit me shpresën e ardhjes së Shpëtimtarit. Maria dhe Josifi e sollën Jisuin në tempull, ku u bekua nga plaku

Simeon. Shpëtimtari u njoh prej profeteshës Ana. Në përshkrimin që i bën Ungjillori Lluca, kjo ditë njihet ndryshe si “Takimi” sepse Krishti takoi popullin e tij në prani të plakut Simeon dhe profeteshës Ana, e cila ishte nga fisi Asirëve, pasi kishte mbetur e ve pas shtatë vjetësh martesë ajo iu detikua Perëndisë duke gjetur ngushëllimin tek lutja dhe kreshma. Për këtë përkushtim Shpirti i Shenjtë i dha aftësi të profetizojë duke u bërë e denjë të shikojë foshnjën e sapolindur të Virgjëreshës Mari. Plaku Simeon dhe profetesa Ana kishin vite që e prisnin Shpëtimtarin dhe tani e takuan atë. Menjëherë Simeoni shpërtheu në lutje: “O Zot, tani lëre shërbëtorin tënd të largohet në paqe sepse sytë e mi panë shpëtimin”. Dyert në qendër tregojnë hyrjen për në shenjtërore që është edhe pjesa më e shenjtë e Tempullit.¹⁶

IKONA E PAGËZIMIT

Krishti është figura qendrore në ikonë dhe paraqitet duke u pagëzuar në ujërat e lumit Jordan. Mbi kryet e Tij gjendet Shpirti i Shenjtë në formën e një pëllumbi, ndërsa engjëjt në pjesën e djathtë të ikonës janë duke adhuruar Trininë e Shenjtë.



¹⁶-Ikona e Ipapandisë, Ngjallja, shkurt 1994, faqe 4.

Jisui erdhi nga Galileja në Jordan për t' u pagëzuar tek Joani, i cili e dëshmoi duke thënë: “E pashë Frymën duke zbritur nga qielli si një pëllumb dhe ndenji mbi të”. Unë e njihja, por ai që më dërgoj të pagëztoj me ujë më tha “Ai mbi të cilin do të shikosh se zbret Fryma dhe qëndron mbi të, është ai që pagëzton me Frymën e Shenjtë.” (Joani 1, 32-33). Jordani është lumi i shenjtë i Palestinës, i cili buron nga liqeni i Galilesë dhe derdhet në Detin e Vdekur. Vepra kryesore e Joanit ishte parapërgatitja e popullit për ardhjen e Mesisë. Për këtë ai quhet pararendësi i Krishtit. Këtë e bëri realitet me anën e predikimit të tij. Pararendësi i ftonë njerëzit të pendoheshin e të pagëzoheshin, si parakusht për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë. Pendohuni, sepse Mbretëria e Qiejve është e afërt predikonte Joani.¹⁷

Profeti Isaia prej vitesh kishte profetizuar se është një zë që buçet në shkretëtirë. Në shkretëtirë Pararendësi u kultivua shpirtërisht. Për thjeshtësinë, varfërinë e jetës asketike të Joanit na thotë ungjillor Matheu: Vishej me një rrobë leshi të devesë dhe me një brez lëkure në bel. Ai ushqehet me karkaleca dhe mjaltë” (Mateu 3:4). Predikimi i Pararendësit i përkiste interesave mbarënjëzore: “Ai që ka dy tunika le t’i ndajë me atë që s’ka dhe që ka të hajë le të veprojë kështu” (Luka 3:11). Mjaft njerëz i dëgjonin predikimet e tij dhe pagëzoheshin në lumin Jordan, duke rrëfyer mëkatet e tyre. Pagëzimi i Pararendësit, ishte parapërgatitja për ardhjen e Mesisë. “Unë po ju pagëztoj me ujë për pendim, por ai që vjen pas meje është më i fortë se unë dhe unë nuk jam i denjë as t’i mbaj sandalet e tij, ai do t’u pagëzojë me Frymën e Shenjtë” (Mateu 3:11).

¹⁷-P. Paskos, Shenjtorët miqtë e Perëndisë, Athinë 1995, faqe 86-88.

IKONA E SHPËRFYTYRIMIT

Vendin kryesor në ikonën e Shpërfytyrimit e zë Krishti, i cili paraqitet veshur me të bardha dhe i rrethuar me një aureolë, e cila tregon shkëlqimin e dritës që buron prej Tij. Jisui i udhëhoqi dishepujt e tij në një mal të lartë dhe u tregoi lavdinë hyjnore. Ashtu si Theofania edhe Metamorfoza është një e kremte drite. Metamorfoza është zbulimi i Trinisë së Shenjtë. Në malin Tabor ashtu si në pagëzimin e shenjtë në Jordan, Ati flet nga qiejt duke dëshmuar birin hyjnor, Krishtin. Në këtë ngjarje është i pranishëm edhe Shpirti i Shenjtë, jo si një pëllumb, por në formën e një drite verbuese që rrethon Krishtin dhe hedh dritë mbi gjithë malin. Kjo është drita e Shpirtit të Shenjtë. Shpërfytyrimi ndodhi 40 ditë pas vuajtjeve të Krishtit. Ai e zgjodhi këtë moment të veçantë që t'u shfaqte dishepujve diçka nga lavdia e Tij hyjnore, me qëllim që të bëhej gati të duronte vuajtjet mbi kryq, veçse kisha jonë e kremton këtë ngjarje më 6 gusht.

Shpërfytyrimi paraqet potencialin e plotë të natyrës njerëzore dhe lavdinë, e cila do të mbulohet përsëri nga hiri i Perëndisë. Tre dishepujt, Petro, Jakovi dhe Joani u bënë dëshmitarë të lavdisë së Krishtit. Ata e panë fytyrën e Tij të ndriçonte si diell. Paraqitja e tyre në ikonë është e tillë që nuk mund ta përballojnë dot dritën Hyjnore. apostull Petro paraqitet në anën e majtë të ikonës i gjunjësuar. Në qendër tregohet apostull Joani, i cili bie duke i kthyer kurrizin dritës, ndërsa apostull Jakovi largohet nga drita, duke parë Krishtin. Këto tre qëndrime të ndryshme të apostujve tregojnë se ata e panë lavdinë e Perëndisë nga tre këndvështrime të ndryshme.

Krishti iu shfaq dishepujve në malin Tabor jo si një shërbëtor, por në formën e Perëndisë, si personi i tretë i Trinisë së Shenjtë. Ky trupëzim mbetet i pandashëm nga natyra e tij hyjnore, e cila është e përbashkët me Atin dhe Shpirtin e Shenjtë. Shfaqja e hyjnisë së Krishtit është njëkohësisht një theofani e trinisë: “Ati

me anën e zërit dëshmoi Birin e tij të dashur, ndërsa Shpirti i Shenjtë u ndriçua bashkë me të me anën e resë së shndritshme”. Apostujt pasi dëgjuan zërin e Atit dhe panë renë e ndritshme, ranë në gjunjë, ndërsa Krishti gjatë shpërfytyrimit qëndronte në majë të malit duke folur me Moisiun dhe Ilian. Moisiu paraqitet në pjesën e djathtë të ikonës dhe mban ndër duar dhjetë urdhërimet që mori në Malin Sinai, ndërsa profeti Ilija paraqitet në anën e majtë. Të dy profetët e kishin nga një vizion prej Perëndisë: Moisiu në malin e Sinit, ndërsa Ilija në Karmel. Moisiu përfaqëson të vdekurit, ndërsa Ilija që u mor në qiell nga një karrocë e zjartë përfaqëson të gjallët. Krishti në malin Tabor na paraqitet si Zot i të vdekurve dhe i të gjallëve duke na dhënë karakterin eskatologjik të Shpërfytyrimit. Apostujt në ditën e Shpërfytyrimit e panë lavdinë e Krishtit dhe shijuan gëzimin e Parajsës. Zoti me Shpërfytyrimin e tij në malin Tabor, na hapi rrugën dhe na e shtoi habinë se si do të mbërrijmë në shembëlltoren e Perëndisë. Këtë na e thonë edhe lumërimet: “Të lumur janë ata që kanë zemër të pastër, sepse ata do të shohin Perëndinë”.¹⁸

NGJALLJA E LLAZARIT

Figura kryesore e ikonës është Shën Llazari, i cili paraqitet në skajin e djathtë, në hyrje të varrit i mbështjellë me savanin e varrimit. Vëllai i Marisë dhe i Martës, Llazari që sëmurë dhe dergjej në shtrat, prandaj motrat i dërguan fjalë Jisuit: “Zot, ai që ti e do shumë është i sëmurë”. Kur arriti Jisui, pa se Llazari kishte katër ditë në varr. Marta i tha Jisuit: “Zot, po të ishe këtu, im vëlla nuk do të kishte vdekur.” Dhe Jisui i tha: “Yt vëlla do të ngjallet.” Pasi tha këto thirri me zë të lartë: “Llazar, eja jashtë!” Krishti paraqitet në ikonë duke urdhëruar Llazarin të dali nga varri, ndërsa motrat e Llazarit, Maria dhe Marta tregohen të gënjëzuara duke iu lutur Zotit. Në sfondin e ikonës tregohen muret e Jerusalemit, ku Krishti do të hynte me triumf të nesërmen.

¹⁸-Shpërfytyrimi i Zotit, Ngjallja, gusht 1994, faqe 6.

Megjithëse Krishti u kishte folur shumë herë dishepujve për pësimet e tij, ata frikësoheshin. Për këtë arsye, ndërsa po afroheshin ditët e pësimeve dhe do të ngrihej Kryqi i Tij, Krishti ngjalli Llazarin në mënyrë që t'i bënte të ditur nxënësve të tij me vepra se Kryqi dhe vdekja nuk janë prova të dobësisë. Me anë të ngjalljes së Llazarit Jisui i bindi të pranishmit se ka pushtet mbi vdekjen dhe në prag të kryqëzimit të Tij, shpërndau frikën e nxënësve duke u treguar se atë që bëri për Llazarin do ta bëjë edhe për veten e tij. Me këto donte të tregonte se asnjëherë nuk e la natyrën njerëzore të Tij, por vepronte herë si njeri e herë si Perëndi. Krishti do të pësonte si njeri për shpëtimin e njerëzve, por që të mos tregojë kjo si tregues i dobësisë, sjell në jetë Llazarin e vdekur. Ai e ngjalli Llazarin, ndërsa të pranishëm ishin dhe judenjtë, për tu bërë dëshmitarë të mrekullisë. Më e mahnitshmja është se Jisui nuk tha: “Llazar, ringjallu!”, por tha: “Llazar, eja jashtë!” për t'u mësuar të pranishmve se: Ai është Perëndia i të gjallëve dhe jo i të vdekurve, për të mësuar se asgjë s'mund të pengojë rrugën e Perëndisë dhe se edhe të vdekurit i binden.

HYRJA NË JERUSALEM

Krishti paraqitet në ikonë duke hyrë në Jeruzalem i hypur në një kriç gomari. Në lindje gomari konsiderohej si një kafshë e dobishme që përdorej për punë të ndryshme në kohë qetësie. Në Dhiatën e Vjetër përmendet se e përdorin princërit e mbretërit. Kur një princ shkonte për luftë, hipte në një kalë të fuqishëm, ndërsa kur shkonte diçka paqësore ulej në shpinën e gomarit. Krishti jo pa qëllim e zgjodhi këtë kafshë, për të treguar se nuk përfaqësonte luftëtarin ose pushtuesin, siç e imagjinonin judenjtë Mesian, por ai ishte një mbret paqësor. Këtë e kishte profetizuar profeti Zaharia: “Mos kini frikë o bijtë e Sionit! Sepse mbreti juaj po vjen mbi një kërraç gomari” (Joani 12,15).

“Hosana, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit” (Joani 12,13). Me madhështi ishte hyrja triumfale e Krishtit në Jeruzalem. Mrekullia e ngjalljes së Llazarit që u bë një ditë më parë, kishte zgjuar kureshtjen e judenjve, të cilët të pushtuar nga entuziazmi i kësaj mrekullie vrapuan ta shihnin me sytë e tyre. Në ikonë judenjtë paraqiten në anën e djathtë, ndërsa dishepujt e Krishtit në anën e majtë. Krishti duke ardhur në Jeruzalem në mënyrë triumfale, kërkon që t’i japi mesazhin popullit hebre: “Pendohuni se po afrohet Mbretëria e Qejjeve”. Në sfondin e ikonës paraqitet qyteti i Jerusalemit me ndërtesat dhe muret, ku në thellësi shquhet tempulli.



Mijëra njerëz e presin atë me degë palmash nëpër duar e duke i shtruar udhën. Degët e palmave janë simbole të fitores dhe të gëzimit. Judenjtë e kishin për zakon që kur prisnin njerëz të mëdhenj ua shtronin rrugën me dafina. Ikona paraqet disa fëmijë duke këputur palma dhe disa të tjerë që i shtrojnë rrugën Zotit. Krishti duke përparuar si princ i paqes ecën me guxim e vendosmëri. Ai e di mirë se hyrja e Tij në Jeruzalem nuk bëhet për

tu lavdëruar, por për t’u sakrifikuar më pas në kryq. Jisui vjen në Jeruzalem paqësisht dhe i bindur në dëshirën e Atit, por njerzit që e rrethonin nuk e kuptonin qëllimin e ardhjes. Ai i dinte kërkesat e atyre që thërrisnin “Hosana”. Kjo fjalë nuk përbën vetëm një lavdërim, por ka dhe një kuptim tjetër “Shpëtona”. Krishti e dinte se gjithë këto demonstrime të popullit, ishin të kota dhe sipërfaqësore. Sa ditë kaluan nga e Diela e Dafinave deri tek e Premtja e Zezë? Vetëm pesë ditë. Dhe janë pikërisht ata njerëz që sot brohorasin “Hosana” dhe pas disa ditësh do ta tradhëtojnë e mohojnë atë duke kërkuar prej Pilatit “Kryqëzoje, Kryqëzoje”.

IKONA E KRYQËZIMIT

Në ikonën e kryqëzimit, në qendër shohim Zotin e Kryqëzuar, të mbështjellë me një rrobë të bardhë. Ai paraqitet i pajetë, me sy të byllur dhe me kryet e anuara nga e djathta. Koka e Tij është e kthyer nga ata që gjendeshin në çastin e kryqëzimit, nga ata që e deshën dhe nga ata që thirrën kryqëzoheni.




Sytë e Tij janë të mbyllur dhe gjaku i rrjedh nga balli, nga duart dhe nga brinja e shpuar. Në rrëketë e gjakut të të kryqëzuarit vështrimi ynë dallon Perëndinë Triadike dhe Golgothaja kthehet në Theofani. Rrëketë e gjakut kullojnë nga duart, këmbët më pas njomin drurin e Kryqit. Kryqi i Zotit është vendosur në shkëmbijtë e Golgothasë, ku në një zgavër poshtë tij ikonografi ortodoks na paraqet një kafkë, mbi të cilën pikon gjaku i Krishtit. Është kafka e Adamit, që sipas traditës, vdiq dhe u varros aty. Jisui u vetësakrifikua me dashje. “Sepse Perëndia e deshi aq botën sa, dha Birin e Tij të Vetëmlindur, që kushdo që beson në të të mos humbasë, për këtë jetë të përjetëshme” (Joani 3:16). Duart e tij janë të shtrira në kryq, me pëllëmbët e hapura, si të jetë, duke u lutur. Duket qartë, se me pësimet e Tij, Krishti paqtoi njeriun me Perëndinë. Kryqi përmbledh planin e Perëndisë për barë botën. Me dimensionin vertikal, bashkon tokën me qiellin, ndërsa me atë horizontal përfaqon gjithë njerëzit. Mbishkrimi në tabelën sipër kryqit I.N.B.I do të thotë: “Jisu Nazareti Mbret i Judenjve”.

Majtas Kryqit qëndron Perëndilindësja, së bashku me gratë miraprurëse. Ajo qëndron në këmbë dhe me njëren dorë të mbështetur në faqe. Në anën tjetër të Kryqit vërejmë Joanin. Me kokën e përulur dhe fytyrën e dërrmuar nga dhimbja, merr pjesë në dramën hyjnore të kryqëzimit. Pas Joanit shohim kryeqindëshin Longin me veshje ushtarake, i cili drejtoi kryqëzimin. Prania e tij në ikonë janë mjaft domethënëse. Ai është dëshmitar okular i kryqëzimit. Longini ishte fare pranë kryqit dhe dëgjoi Krishtin të lutet: “O Atë, fali ata, se s’dinë se ç’bëjnë”. Kryeqindëshi pyeti veten: -Unë e kryqëzova dhe ai u lut për mua dhe më fali? Në atë çast, toka u lëkund dhe shkëmbijtë u plasën. Kryeqindëshi dhe ushtarët e tij, kur panë tërmetin, thanë: “Me të vërtetë ky është Biri i Perëndisë” (Mateu 27:51). Por, një tërmet dhe më i fuqishëm tronditi shpirtin e Logonit duke e kthyer në predikues të Krishtit. Në ikonë paraqiten edhe murret e Jeruzalemit. Është Jeruzalemi i Ri, që u ndriçua me dritën e Krishtit, ashtu siç na e paraqisin edhe

Himnet e Pashkës: Ndrìçohu, ndrìçohu, o Jeruzalem i ri, se lavdia e Zotit përmbi ty ka lindur sot...”.¹⁹

IKONA E NGJALLJES

Figura kryesore në Ikonën e Ngjalljes është Krishti, i cili paraqitet veshur me të bardha për të treguar Hyjninë e Tij. Një aureolë e rrethon të tërin, e cila simbolizon dritën e lavdishme. Nën këmbët e tij janë dyert e shkallmuara të hadit, gjithashtu edhe kyçet e thyer të këtyre dyerve. Adami është paraqitur si një plak thinjosh, të cilin Krishti po e nxjerr prej varri duke e tërhequr me dorën e Tij të djathtë, ndërsa me dorën e majtë tërheq Evën.



Himnet e kishës thonë se Eva me anën e mishërimit “u çlirua prej mëkatit” të Edenit. Në anën e majtë të ikonës paraqiten të drejtët e Dhiatës së Vjetër, të cilët jetuan dhe vdiqën përpara mishërimit, Davidi dhe biri i tij Solomoni, ndërsa në të djathtë paraqiten të drejtët e Dhiatës së Re, Joan Pararendësi dhe Josifi.²⁰

¹⁹-Andrea Llukani, Ikona e kryqëzimit, Ngjallja, prill 1999, faqe 8.

²⁰-Ark. Rest. At. Theologos, Ikona, Njohuri dhe shpjegim teologjik, (Dispensë).

Në të Dielën e Pashkës, ikona e Ngjalljes qëndron në mes të kishës dhe tregon Krishtin duke shkatërruar dyert e hadit dhe duke çliruar Adamin dhe Evën prej robërisë së vdekjes. Ajo është imazhi i fitores, “I shkeljes së vdekjes me vdekje”. Pashkë do të thotë kalim. Ky është procesioni i kalimit prej vdekjes në jetë, prej tokës në qiell, prej kësaj jete në atë jetë që do të vijë dhe që është pa mbarim.²¹

IKONA E ANALIPSIT

Në Ikonën e Analipsit figura kryesore është Krishti, i cili paraqitet duke u ngjitur në qiell. Krishti është veshur me të bardha për të treguar dritën e lavdishme të Hyjnisë së Tij. Ai bekon botën dhe premtan se do të dërgojë Ngushëllimtarin, pra Shpirtin e Shenjtë. Figura qendrore në pjesën e poshtme të ikonës është Hyjlindësja e rrethuar nga Dishepujt.²² Zoti ynë Jisu Krishti u shfaq në kohë dhe në vende të ndryshme tek dishepujt e tij, duke i siguruar ata që ishte me të vërtetë i gjallë. Ditën e dyzetë pas Pashkës Jisui u ngjit në qiell, për të qëndruar në të djathtë të Perëndisë. Ngjitja e Krishtit në qiell është plotësimi i misionit të Tij. Analipsi është kthimi tek Ati, që e dërgoi në botë për të kryer veprën që i kishte caktuar. Kremtimi i Analipsit nuk është thjesht një kujtim i një ngjarje të jetës së Krishtit, por Shkrimi i Shenjtë thekson nisjen fizike dhe lavdërimin e Tij me Perëndinë, bashkë me gëzimin e madh të dishepujve kur morën premtimin se do tu dërgonte Shpirtin e Shenjtë, duke i aftësuar që të bëheshin dëshmuesit e Tij deri në skajet e fundit të dheut.²³

²¹-Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vol 2. faqe 150-155.

²²-Ark. Rest. At. Theologos, Ikona, Njohuri dhe shpjegim teologjik, (Dispensë).

²³-Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vol 2. faqe 163-164.

IKONA E PENDIKOSTISË

Tradita e Shenjtë na thotë se në ditën e Pendikostisë, dishepujt qenë mbledhur në të njëjtën dhomë ku hëngrën darkën e fundit me Krishtin. Në fundin e ikonës paraqitet një njeri me kurorë në kokë si simbol i botës. Kjo do të thotë se e gjithë bota e pranon ardhjen e Shpirtit të Shenjtë. Zbritja e Shpirtit të Shenjtë ose Pendikostia festohej pesëdhjetë ditë pas Pashkës. Në ditën e Pendikostisë erdhi Shpirti i Shenjtë, të cilin Krishti ua kishte premtuar dishepujve dhe në mënyrë tradicionale, ky moment është quajtur ditëlindja e Kishës.

Festa e Pendikostisë, nuk është thjesht një ngjarje që ndodhi shumë shekuj më parë. Ajo është kremtimi i asaj që duhet të ndodhi edhe sot. Tek të gjithë ne banon shpirti i shenjtë. Të gjithë ne e kemi marrë shpirtin e shenjtë gjatë misterit të Mirosjes dhe jemi kthyer në tempuj të Shpirtit të Shenjtë. Por ç'përfaqëson shpirti i shenjtë? - Këtë na e thotë tropari; -O Mbret Qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, që ndodhesh kudo..... Është Shpirti i Shenjtë, shpirti i së vërtetës personi i tretë i Trinisë së Shenjtë. Shpirti i Shenjtë i drejton të gjitha, është ai që ka në duar jetën tonë dhe e ka mundësinë të na shpërftyrojë.

FJETJA E HYJLINDESES

Në ikonë, Hyjlindësja paraqitet në qivurin e vdekjes, ndërsa Krishti qëndron mbrapa Hyllindëses dhe ka ardhur që ta marrë shpirtin e saj në qiell. Ai është i veshur me të bardha dhe paraqitet duke mbajtur një fëmijë në dorën e majtë që simbolizon shpirtin e Hyjlindëses. Apostujt qëndrojnë në të dy anët e qivurit, në pjesën e majtë të ikonës qëndrojnë ata që kryesohen nga apostull Petro dhe në të djathtën ata të apostull Pavlit. Ky i fundit paraqitet në fund të qivurit. Sipas Traditës së Shenjtë, tri ditë përpara fjetjes së Hyjlindëses, Krishti dërgoi Kryeengjëllin Gabriel për t'i

komunikuar asaj se do të shkëputej nga jeta e përkohshme në atë të pavdekshme. Sapo mësoi lajmin e Tërëshenjta u ngjit në malin e Ullinjve për t' u lutur dhe për të falënderuar Perëndinë. Pasi u lut e Tërëshenjta u kthye në shtëpi për të përgatitur shtratin e vdekjes, grumbulloi gratë e fisit dhe u tha për fjalët që kishte marë me anën e Kryeengjëllit Gabriel. Gratë menjëherë filluan të vajtonin, por e Tërëshenjta i ngushëllonte ato se që nga qielli do t' u gjendej pranë e do t' i mbronte nga çdo e keqe. Atë çast u dëgjua një bubullimë dhe re të shumta filluan të mbushnin shtëpinë. Menjëherë filluan të shfaqen apostujt dhe vetë Krishti, i cili zbriti nga qielli për të marë shpirtin e së Tërëshenjtës. Apostujt psalën vajtimet dhe e ngritën në shtratin e vdekjes. Duke u paraprirë me lambadha dhe himne u nisën drejt Gjethsemanisë për të kryer varrimin. Si mbëritën në Gjethsemani, apostujt e varrosën me nderime lipsanin e së Tërëshenjtës dhe qëndruan aty për tre ditë duke dëgjuar lavdërimet e ëngjëjve që psalnin papushim. Nga të gjithë apostujt mungonte vetëm Thomai, i cili erdhi ditën e tretë pas fjetjes dhe kërkoi që të shihte edhe ai atë që kishin parë apostujt e tjerë. Atëhere u detyruan që ta hapnin varrin dhe menjëherë të gjithë mbetën të mrekulluar sepse varri ishte i zbrazët. Apostujt menjëherë ranë në gjunjë dhe iu falën varrit të zbrazët të së Tërëshenjtës, e cila ishte ngjitur në qiell.

SKENA NGA DHIATA E VJETËR

- Krijimi i Adamit dhe Evës
- Shkelja e Adamit dhe Evës
- Dëbimi i Adamit
- Të qarat e Adamit dhe Evës
- Adami duke punuar tokën
- Lindja e Kainit
- Lindja e Abelit
- Kaini duke punuar tokën
- Abeli duke kullotur dhentë

- Sakrifica e Kainit dhe Abelit
- Noeja urdhërohet nga Perëndia të bëjë anijen
- Noeja ndërton anijen
- Përmytja
- Sakrifica e Noes
- Noeja mbjell vreshtin
- Noeja i dehur me verë
- Ndërtimi i kullës së Babelit
- Abrahami urdhërohet nga Perëndia që të largohet nga të afërmit
- Abrahami shkon në Egjipt
- Faraoni merr me forcë Sarën, gruan e Abrahamit
- Abrahami pasi mori gruan e tij Sarën të pacënuar nga faraoni shkoi në shkretëtirë
- Abrahami liron Lloin
- Abrahami pritet prej Melkisedekut
- Mikpritja e Abrahamit
- Djegja e qyteteve Sodomit dhe Gomorës
- Sakrifica e Abrahamit
- Isaku duke bekuar Jakobin
- Shkalla e Jakobit
- Ëndrrat e Josifit
- Josifi i shitur nga vëllezërit e tij
- Josifi duke braktisur këmishën iu shmang mëkatit
- Josifi shpjegon dhe sqaron në burg ëndrrat
- Josifi sqaron ëndrrat e faraonit
- Josifi u emërua nga faraoni si zotërues i Egjiptit
- Josifi vizitohet prej vëllezërve të tij
- Josifi u jep të njohur vëllezërve të tij
- Josifi pret babanë e tij Jakov
- Jakovi bekon djemtë e Josifit, Efrain dhe Manasin
- Jakovi bekon dymbëdhjetë djemtë e tij
- Moisiu i gjetur në lumë
- Moisiu duke kullotur dhentë shikon ferën në zjarr

- Moisiu i paralajmëron hebrenjtë për lirim e tyre
- Dhjetë plagët e dërguara mbi Egjiptin
- Moisiu kërkon nga faraoni t'i lerë të lirë hebrenjtë
- Pashka e hebrenjve në Egjipt
- Mbytja e egjiptianëve
- Moisiu ëmbëlson ujra të kripura
- Moisiu me popullin e tij në Athin (vend midis Egjiptit e Izraelit)
- Moisiu duke mundur Amalikun (kryetarin e mohabitëve)
- Moisiu merr në dorë dhjetë porositë e Perëndisë
- Moisiu dhe Aroni meshojnë në çadrën e vajtjes
- Moisiu duke goditur shkëmbin nxjerr ujë
- Balaami kur del të mallkojë hebrenjtë ndalohet prej engjëllit
- Balaami (udhëheqës fetar çifut) duke bekuar hebrenjtë
- Fjetja e Moisiut
- Të dymbëdhjetë priftërinjtë hebrenj që ngritën anijen
- Engjëjt e Zotit përforcojnë Gedeonin kundra Madiamit
- Manoe dhe gruaja e tij paralajmërohen për lindjen e Samsonit
- Manoe duke vrarë një luan
- Samsoni (heroi i izraelitëve) gremis portat e Gazës
- Samsoni verbohët nga armniqtë
- Vdekja e Samsonit
- Profeti Samuil meshon në tempull
- Samueli zbulon zhdukjen e priftit Ili
- Zdukja e Iliut dhe djemve të tij
- Davidi kurorëzohet mbret
- Davidi duke i rënë lirës para Saulit
- Davidi mund Goliadin
- Davidi sjell anijen në Jeruzalem
- Solomoni kurorëzohet mbret i izraelitëve
- Solomoni ndërton tempullin e Perëndisë
- Solomoni ndërton tempujt paganë
- Ilia ushqehet prej gallofit
- Ilia bekon vajin dhe miellin e vejushës

- Ilia ngjall djalin e vejushës
- Ilia i pritur prej Ahaabit
- Ilia djeg me zjarr sakrificën
- Ilia duke vrarë priftërinjtë e turpit
- Ilia ngrihet nga engjëlli që të hajë ushqim
- Ilia kurorëzon Eliseun si profet
- Ilia djeg të dy oficerat
- Ilia me gunën e tij kapërxe Jordanin
- Ngritja në qiell e Ilias
- Eliseu me gunën e Ilias godet ujrat dhe i hap
- Eliseu dizinfekton me kripë ujrat e infektuara
- Eliseu duke bekuar vajin e vejushës
- Eliseu shëron djalin e gruas samaritane
- Nemani duke u larë në Jordan
- Ëndërimi i profetit Isaia
- Profeti Isaia i shëruar
- Jeremian e futin në gropën plot me baltë dhe papastërti
- Zaptimi i dytë i Jeruzalemit
- Danieli dhe tre djemtë e tij duke ngrënë lakra e zarzavate
- Danieli duke shpëtuar Suzanën
- Danieli shpjegon ëndrrën e parë të Nabukodonozorit
- Të tre djemtë në furrën e gëlqeres
- Danieli shpjegon ëndrrën e dytë
- Danieli shpjegon shkronjat
- Ëndërimi i profetit Daniel
- Danieli duke zbuluar mashtrimin e priftërinjve
- Danieli duke vrarë dragoin
- Danieli në gropën e luanëve
- Jona ikën nga fytyra e Zotit
- Jona e nxjerr nga goja peshku
- Jona predikon në Ninivë
- Jona i hidhëruar për kungullin e tharë
- Shenjtorët sipas brezave

VEPRA DHE MREKULLITË E KRISHTIT

- Ungjillëzimi i Hyjlindëses
- Josifi duke parë Hyjlindësen shtatzënë
- Përqafimi i Hyjlindëses me Elisabetën
- Pyetja e magëve
- Lindja e Krishtit
- Falja e magëve
- Përhasja e Krishtit (Ipapandia)
- Josifi me Shën Mërinë shkojnë në Egjipt
- Vrasja e foshnjave
- Krishti duke ndenjur në mes të mësuesve
- Krishti vjen të pagëzohet në Jordan
- Pagëzimi i Krishtit
- Krishti i fton dishepujt në peshkim
- Krishti e kthen ujin në verë
- Krishti i pyetur prej Nikodhimit
- Krishti duke folur me Samaritanen
- Krishti duke lexuar në Sinagogë
- Krishti shëron lebrozin
- Krishti shëron skllavin e centurionit (kryeqindëshit)
- Krishti ngjall djalin e vejushës
- Krishti shëron vjehrën e Petros
- Krishti shëron njerëz me sëmundje të ndryshme
- Krishti qetëson erërat e forta dhe detin
- Krishti shëron të dy të demonizuarit
- Krishti shëron të paralizuarin
- Krishti pranon të hajë me Mateo doganierin
- Krishti duke ngrënë me doganierët
- Krishti shëron një grua nga hemoragjia
- Krishti ngre dhe shpëton nga vdekja vajzën e një mjeku
- Krishti shëron të dy të verbërit
- Krishti duke u pyetur prej dishepujve të Pararendësit

- Krishti duke kaluar përmes arave të mbjella
- Krishti shëron njeriun me dorën e thatë
- Krishti shëron të verbërin
- Krishti i kërkuar prej nënës dhe vëllezërve të tij
- Krishti shëron të paralizuarin
- Krishti bekon pesë bukët
- Krishti duke ecur mbi det
- Krishti shëron shumë të sëmurë vetëm me prekjën e rrobës së tij
- Krishti shëron të bijën e Hamanesë
- Krishti duke bekuar shtatë bukët
- Krishti shëron të verbërin në Bedsaida
- Krishti shpërfytyrohet
- Krishti shëron epileptikun
- Krishti i pritur si mik në shtëpinë e Martës
- Krishti shëron dhjetë lebrozët
- Krishti duke bekuar foshnjat
- Krishti i pyetur prej pasanikut të ri
- Krishti u jep mësim djemve të Zebedeut
- Krishti duke hyrë në qytetin Jeriho, shëron të verbrit
- Krishti i ndjekur me gurë prej judenjve
- Ngjallja e Llazarit
- E diela e dafinave
- Krishti duke i nxjerrë tregtarët jashtë tempullit
- Krishti duke mallkuar fikun
- Krishti duke lavdëruar dy qindarkat e vejushës
- Marëveshja e Judës me judenjtë
- Darka mistike
- Falja e Krishtit
- Tradhëtia e Judës
- Krishti i gjykuar prej Annas e Kajafas
- Tre mohimet e Pjetrit
- Krishti duke u gjykuar prej Pilatit
- Pendimi dhe vetvarja e Judës

- Krishti i gjykuar prej Herodit
- Larja e duarve dhe vendimi i Pilatit
- Krishti rihet me kamxhikun para se të kryqëzohet
- Tallja dhe poshtërimi i Krishtit
- Krishti duke u shpënë te kryqi
- Kryqëzimi i Krishtit
- Josif arimateasi kërkon trupin e Zotit
- Zbërthimi nga kryqi
- Vajtimi dhe qarja para varrimit
- Varrimi i Krishtit
- Roja që ruan varrin
- Zbritja në had
- Ngjallja e Krishtit
- Krishti u shfaqet miroprurëseve
- Pjetri dhe Joani vërtetojnë ngjalljen
- Prekja me dorë e Thomait
- Krishti shikohet prej apostujve mbi detin e Tiberiadës
- Krishti u shfaqet apostujve në malin e Galileës
- Analipsi i Krishtit
- Zbritja e shpirtit të shenjtë

SHEMBËLLTYRAT

- Shembëlltyra e mbjellësit
- Shembëlltyra e intrigave dhe grindjeve
- Shembëlltyra e sinapit
- Shembëlltyra e majasë së brumit
- Shembëlltyra e thesarit
- Shembëlltyra e atij që kërkon margaritare
- Shembëlltyra e rjetës së gjerë
- Shembëlltyra e dhrahmive
- Shembëlltyra e atij që kishte borxh 10 mijë talanta
- Shembëlltyra e punëtorëve të pajtuar

- Shembëlltyra e të dy bijve
- Shembëlltyra e gurit të qoshes, të cilin nuk e pranuan ndërtuesit
- Shembëlltyra e dasmës
- Shembëlltyra e darkës
- Shembëlltyra e tallantave
- Shembëlltyra e atyre, që ngrejnë shtëpitë mbi gur e mbi rërë
- Shembëlltyra e të verbërve
- Shembëlltyra e dhjetë virgjëreshave
- Shembëlltyra e atij që ra në duart e kusarëve
- Shembëlltyra e gjykatësit të padrejtësisë
- Shembëlltyra e dorëlëshuarit dhe shkatërruesit të pasurisë
- Shembëlltyra e pasanikut që pati prodhime të bollshme nga pronat
- Shembëlltyra e pasanikut dhe e Llazarit të varfër
- Shembëlltyra e të fuqishmit
- Shembëlltyra e kandilit
- Shembëlltyra e fikut
- Shembëlltyra e doganierit dhe farisenjtë
- Shembëlltyra e shërbyesve të këqinj
- Shembëlltyra e kripës
- Shembëlltyra e dritës dhe errësirës
- Shembëlltyra e vreshtës
- Shembëlltyra e pemëve të mira dhe të pemëve të kalbura
- Shembëlltyra e portës së ngushtë

SIMBOLE TË KRISHTERA

1-**Peshku** ishte nga temat më të përdorura në shekujt II-VI. Zakonisht ikonizohej nëpër murret e katakombeve. Të krishterët përdornin peshkun si simbol: a) Të Eukaristisë Hyjnore, b) të pagëzimit, c) të besimit. Me pesë shkronjat **ĒÇĒŌŌ** të krishterët tregonin besimin e tyre me simbolikën: “Jisu Krishti, Biri i Perëndisë, Shpëtimtar”.

2-**Bariu i Mirë** ishte paraqitja më e bukur e artit kristian, që buronte nga fjalët e Zotit në Ungjill: “Unë jam Bariu, ju jeni delet...”. Kjo paraqitet me një bari që mban në qafë një qengj të vogël, duke e shpëtuar nga rreziku. Të krishterët e parë e quanin Krishtin “Bari” sic përmendet edhe në librin e një shkrimtari të shekullit të dytë “Bariu i Ermas”. Në disa paraqitje Krishti nuk mban qengjin ndër supe, por një kryq. Paraqitja e Bariut të Mirë mbizotëronte nëpër dhomat e të vdekurve me simbolikën e Shpëtimtarit Krisht, i cili gjatë epokës së përndjekjeve iu jepte guxim të krishterëve. Paraqitja e skenës “Bariu i Mirë” daton që nga shek. I në katakombin e Domitilës në Romë.

3-**Kryqi**, i cili si simbol pikturohej i vetëm. Mësimdhënia e kryqit përbën thelbin e besimit kristian. Shenja e kryqit si simbol i shpëtimit zinte vendin e parë nga të gjitha simbolet kristiane. Ja vlen të përmendim pikturat e katakombeve të Shën Prishillës në Itali, por edhe në Shqipëri kemi disa raste në bazilikat e Ballshit, Linit, Bylisit etj.

4-**Qengji** ikonizohet zakonisht tek sarkofagët. Sipas Zbulesës Krishti quhej Qengji i Perëndisë, që therret për shpëtimin e botës.

SIMBOLE NGA DHIATA E VJETËR

1-**Mëkati dhe rrënia e protoplastëve**. Kjo temë paraqitet vetëm në epokën paleokristiane të shekujve III-V. Adami dhe Eva ikonizohen të zhveshur në Parajsë.

2-**Noe dhe arka.** Janë nga temat më të dashura dhe paraqitet në afro 40 skena.. Noe nuk paraqitet si plak, por si fëmijë brenda në arkën e shpëtimit. Pranë tij paraqitet një pëllumb duke mbajtur në sqep një degë ulliri. Arka e Noes simbolizon kishën, e cila i shpëton njerëzit nga përmbytja shpirtërore.

3-**Sakrifica e Abrahamit.** Isaku , i cili simbolizon Krishtin pikturohet me një tufë dru mbi supet e tij, ndërsa Abrahami i tregon vendin e zjarrit. Nëpër katakombe Sakrifica e Abrahamit paraqitet në 25 raste. Isaku simbolizon Qengjin, prandaj Sakrifica e Abrahamit ka karakter Eukaristik.

4-**Moisiu.** Njeriu besnik dhe udhëheqës i ebrenjve paraqitet në këto skena: a) duke goditur me shkop shkëmbin, prej të cilit doli ujë dhe pinë ebrenjtë e etur. Kjo skenë simbolizon fuqinë shpëtimtare të ujit, prandaj zakonisht pikturohet pas pagëzimit të Krishtit. b) Në skenën e ushqimit të ebrenjve me mana, e cila ka kuptimin e shpëtimit. c) Në skenën e marjes së pllakave të ligjit nga Perëndia. d) Në kalimin e detit të Kuq etj. Të gjitha këto paraqitje kanë kuptim shpëtimtar. Moisiu udhëhoqi popullin e Izraelit në aq rreziqe dhe peripeci kështu do të shpëtohen të gjithë ata që besojnë tek Krishti.

5-**Qëndrimi i Jonas** tre ditë në barkun e balenës simbolizon kalimin e Zotit nga mbretëria e të vdekurve tre ditë përpara ngjalljes së tij. Jonas quhet edhe si pritetipi i varrimit dhe ngjalljes të Krishtit. Kjo tregohet edhe në troparet e Pashkës.

6-**Tre fëmijët** (Anania, Azaria dhe Misaili) zakonisht ikonizohen në dy skena. Në të parën ata kundërshtojnë që t'i falen statujës së Baalit dhe në të dytën paraqiten brenda në furrë. Kjo paraqitje simbolizon fuqinë e lutjes dhe kryesisht shpëtimin.

7-**Ngjitja e Profetit Ilia në qiell** simbolizon hyrjen e shpirtit në Parajsë. Gjithashtu quhet edhe si prototipi i ngjalljes së Krishtit.

SIMBOLE NGA DHIATA E RE

1-**Falja e magëve** është një paraqitje e shpeshtë nëpër katakombe, e cila i përgjigjet 15 shembujve. Zakonisht numëri i magëve shkon nga dy deri në pesë. Më e përdorshmjat janë tre magët, të cilët i sjellin dhurata foshnjës së sapolindur.

2-**Pagëzimi i Krishtit** simbolizon rilindjen dhe shpëtimin, si dhe varrimin dhe ringjalljen. Në disa skena të pagëzimit nëpër katakombe Krishti paraqitet si fëmi. Tek këto paraqitje nuk mungon pëllumbi si simboli i Shpirtit të Shenjtë.

3-**Krishti dhe Samaritania** paraqiten tek burimi i Jakovit dhe simbolizojnë ujin e përjetshëm dhe përjetësinë e Parajsës. Këtë kuptim e japin edhe fjalët e Zotit tek (Joani 4, 13-15).

4-**Mohimi i Petros** simbolizon metaninë. Kjo skenë më tepër përdoret nëpër skulpturat e sarkofagëve.

5-**Paravolia e Dhjetë Virgjëreshave** simbolizon jetën e amëshuar dhe përjetësinë e Parajsës. Kjo skenë gjendet rrallë tek katakombet. Pesë virgjëreshat e zgjuara mbajnë lambadha dhe qëndrojnë njera pas tjetrës.

6-**Krishti dhe Apostujt**. Jisu Krishti ikonizohet në fron duke mbajtur Ungjillin dhe rreth tij paraqiten Apostujt. Kjo skenë simbolizon lavdinë e Krishtit.

SIMBOLE NGA MREKULLITË E KRISHTIT

1-**Mrekullia në Kana**. Krishti ikonizohet përpara tryezës me ravdhinë e Tij që simbolizon fuqinë Hyjnore.

2-**Mrekullia e ushqimit të pesë mijë vetëve**. Krishti ikonizohet me ravdhinë e Tij dhe herë vetëm e herë me dy Apostuj. Para Krishtit ikonizohen shtatë kosha me bukë, të cilat i bekon. Në disa raste paraqitet duke u ofruar bukë dhe peshq Dishepujve të Tij.

3-**Shërimi i paralitikut**. Skenë që ikonizohet shpesh nëpër katakombe. Krishti paraqitet në momentin që i thotë paralitikut:

“Ngrihu e merr shtratin tënd”. Paralitiku ikonizohet duke mbajtur shtratin e tij.

4-**Ngjallja e Llazarit** i përgjigjet 50 shembujve dhe simbolizon ngjalljen e të vdekurve. Paraqitja e ngjalljes së Llazarit ikonizohet deri në ditët tona duke theksuar besimin e të krishterëve në ngjalljen e të vdekurve.

SIMBOLE NGA BOTA E SHPENDËVE DHE KAFSHËVE

1-**Pëllumbi** simbolizon paqen e shpirtit në Parajsë. Quhet si simboli i përjetësisë dhe i pastërtisë, sipas fjalëve të Zotit: “Bëhuni të zgjuar si gjarpërinjtë dhe të pastër si pëllumbat” (Matheu 10,16)

2-**Palloi** ishte tema më e dashur në artin e vjetër grek dhe romak. Në artin kristian simbolizon pavdekshmërinë e shpirtit.

3-**Feniksi**, zogu që vjen nga mitologjia, i cili digjet dhe ringjallet përsëri, duke simbolizuar “Ngjalljen e Krishtit”.

4-**Luani** ka shumë kuptime ndërmjet të cilave veçojmë: a) simboli i fuqisë dhe zotërimit, b) simbol dhe emblemë e Perëndisë, c) simboli i Ungjillor Markut etj.

5-**Dreri** që pi ujë, simbolizon njerëzit që kanë etje shpirtërore. Ata venë për të pirë ujë tek Perëndia që është burimi i pashtershëm.

6-**Gjarpëri** ka disa kuptime, herë simbolizon fuqinë e të ligut dhe herë gjarpërin e bronxtë etj.

SIMBOLE NGA BOTA BIMORE DHE LULEVE

1-**Ulliri** është simboli i paqes. Gjithashtu ulliri i mbushur me kokrra simbolizon njeriun me shume virtyte.

2-**Palma** simbolizon pavdekshmërinë ose fitoren ndaj vdekjes. Gjithashtu është simboli i pemës së Parajsës.

3-**Dafina** është emblema e lavdisë.

4-**Vreshti** simbolizon fjalët e Zotit: “Unë jam vreshti dhe ju hardhia..” Prej vreshtit nxirrej vera, e cila është simboli i gjakut të Krishtit.

5-**Ferra** e zjarrtë që nuk digjej, në të cilën iu shfaq Perëndia Moisiut simbolizon Hyjlindësen, e cila ka mbajtur brenda vetes Zotin dhe nuk u dogj nga zjarri i fuqisë së Tij.

6-**Kurorat** prej çfarëdolloj bime ose lule simbolizojnë fitoren.

SIMBOLE OBJEKTE

1-**Spiranca** është simboli i shpresës dhe i shpëtimit nga rreziqet e jetës. Gjithashtu spiranca simbolizon Krishtin dhe më thellë Kryqin. Pas triumfit të krishtërimin përdorimi i spirancës kufizohet.

2-**Anija** ishte simbol i vjetër i egjyptianëve dhe grekërve. Përfaqësonte udhëtimin e jetës së krishterë ose udhëtimin e shpirtit pas vdekjes. Gjatë viteve kristiane mori një simbolikë edhe më të gjerë. Simbolizon jetën kristiane që ka udhëheqës Krishtin dhe drejtohen me siguri në portin e Parajsës. Simbolizon edhe shpëtimin e besimtarëve në furtunat e ndryshme të jetës. Anija quhet simbol i kishës, ku Krishti është timonieri dhe marinarët janë priftërinjtë.

3-**Fari** është simbol i udhëtimin të mirë ose simbol i shpëtimit nga përmbytjet e jetës.

SIMBOLE NGA MITOLOGJIA

1-**Miti i erosit dhe i shpirtit**. Ky mit përdorej në pikturimet e varreve të krishtera si dhe në gdhendjet e sarkofagëve. Miti ka një kuptim të thellë simbolik. Shpirti ikonizohet me një vajzë me fletë, ndërsa erosi me një djalë. Shpirti ka natyrë hyjnore dhe është i pavdekshëm. Ai është i mbyllur brenda trupit dhe dëshiron bashkimin me erosin në Parajsë. Të dyja këto na kujtojnë dramën e jetës njerëzore dhe shpëtimit. Ashtu si shpirti i mitit bashkohet me erosin kështu edhe shpirti i të krishterëve bashkohet me Krishtin.

2-**Miti i Orfeas** i përket artit kristian të shekullit të III-të e në vijim. Orfea ikonizohet i ulur duke i rënë lirës. Përreth paraqiten kafshë e shpendë që dëgjojnë melodinë e tij. Kështu Orfea quhet një bari i mirë, pra simbol i Krishtit, i cili me mësimdhënien e tij kënaq shpirtrat e besimtarëve. Nga shekulli i V-të paraqitja e Orfeas kufizohet derisa dalëngadalë zhduket.²⁴

EPITAFI I GLLAVENICËS

Fjala epitaf vjen nga greqishtja bizantine dhe do të thotë “përmbi-varr” ose siç mund të thuhet ndryshe “mbulesë-varri”. Në të paraqitet Krishti i shtrirë në varr. Epitafi përdoret në shërbesën e së Premtes së Madhe, ku sipas traditës nxirret përreth kishës në përkujtim të varrimit të Krishtit. Gjatë kësaj shërbese psalten vajtimet “Ti o Krisht o jetë, Ti u vure në varr...”. Epitafi i Gllavenicës daton në vitin 1373 dhe është zbuluar në qilarin e një shtëpie të rënuar në afërsi të Ballshit.



Gjatësia e epitafit është 211 cm, aq sa gjatësia e një varri të zakonshëm, ndërsa gjerësia 114 cm. Epitafi i Gllavenicës është i qëndisur me fije ari në mëndafsh të butë nga dora e murgut Savia me porosi të Gjergj Arianitit. “U plotësua (qëndis) ky aeras (epitaf) i gjithnderuar dhe i hyjshëm i së mbishenjtës Hyjllindëses së patundur, me shpenzimin dhe mundimin e peshkopit të gjithhirshëm

²⁴-Georgiou Antouraki, Xristianiki Zografiki, Despina Mavromati, Athina, 1993, sel. 22-35.

Kalistit të Gllavenicës dhe Beratit, në muajin mars 22, viti 6881(=1373).²⁵ Ky mbishkrim gjendet i qëndisur me ar dhe argjend në dy shtylla, pranë kokës dhe këmbëve të Krishtit, i cili paraqitet i pajetë. Epitafi i përkiste kishës së Gllavenicës (Ballshit të sotëm) dhe në të përshkruheshin kufijtë e Principatës së Gjergj Arianitit. Moikom Zeqo thotë se emërtimi “Epitafi i Gllavenicës” nuk është i saktë. Ky emërtim ka lidhje me juridiksionin e Episkopit Kalist, pra Kalisti i Gllavenicës dhe i Beratit.²⁶ Por si mbërriti ky epitaf deri në ditët tona? Historia e udhëtimit të tij zë fill që nga koha kur u qëndis nga dora e murgut Savia më 1373 për kishën e Gllavenicës, vite më vonë përfundoi në qilarin e një shtëpie në Ballsh, më pas në katedralen “Fjetja e Shën Mërisë” në kalanë e Beratit dhe në vitin 1981 përfundoi në stendat e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë. Në vitin 1994 u vodh dhe u kthye përsëri në Muzeun Historik ku gjendet edhe sot e kësaj dite.²⁷ Duke filluar që nga viti 1974 me studimin e “Epitafit të Gllavenicës” është marrë studiuesi Frederik Stamati. Në fillim epitafi ishte i mbuluar nga njolla dylli prej qirinjve që kishin pikuar mbi të. Kjo ka ngjarë sepse në traditën ortodokse shërbesa e epitafit shoqërohet me lambadha të ndezura. Gjithashtu tymi i qirinjve i kishte dhënë copës një velaturë bezhë, duke zbehur shkëlqimin metalik në dy shkrimet anësore. Dëmtime ka pësuar edhe nga prekjet me duar. Epitafi ruhet në gjendje të mirë, vetëm se nga ana e përparme ka një arnë.²⁸ Me të drejtë nga studiuesi Moikom Zeqo është shtruar problemi se ende mungon studimi historik i mbishkrimit të Epitafit. Gjithashtu mungon edhe studimi kaligrafik krahasues dhe simbolik i mbishkrimit.²⁹

²⁵-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998, nr. 90, faqe 85.

²⁶-Moikom Zeqo, Epitafi i Gllavenicës, emërtimi nuk është i saktë, Shekulli, 5-mars-2005, faqe 18.

²⁷-Sekretet e Epitafit të Gllavenicës, Shekulli, 6 qershor 2000, faqe 20.

²⁸-Frederik Stamati, Mbi restaurimin e Epitafit të Gllavenicës, Monumentet, 2 1990 (40), faqe 121.

²⁹-Moikom Zeqo, Historia e një Epitafi të rrallë, Metropol, 25 shkurt 2005, faqe 22.

ARTI PSALTIK NË SHQIPËRI

Nëpër Kishat Ortodokse ka dy psaltë, i majti dhe i djathti. Ky i fundit quhet protopsalt dhe duhet që të ketë vesh të mirë muzikor, zë kumbues si dhe njohuri të muzikës bizantine. Zakonisht pranë protopsaltit qëndrojnë psaltë të tjerë, të cilët mbajnë iso. Pranë tij qëndron anagnosti, i cili lexon rrjedhshëm dhe qartë uratat e shërbesave kishtarë. Protopsalti Dhimitër Beduli në dorëshkrimin “Kurs i shkurtër për muzikën Bizantine”, Tiranë 1935, ka përmendur disa nga psaltët e kishave të Shqipërisë:

Në **Korçë** protopsalt i Mitropolisë ka qenë Pandi Progri, ndërsa Dhimitër Antoniadhi ka shkruar në vitin 1936 “Librezë muzike kishtarë”, e cila përmbante himnet e Shërbesës së Mëngjesores, lavdërime të Pesëdhjetores etj.³⁰

Jorgji Kroi ka drejtuar korin e Mitropolisë nga vitet 1922-1923. Me origjinë nga Vithkuqi i Korçës Jorgji u rrit duke luajtur në violinë, të cilën nuk e ndau për asnjë moment. Studioi në “Universitetin e Athinës” në vitin 1896. Pas studimeve ka punuar për 18 vjet në “Shkollën Teologjike” të Mitropolisë së Korçës. Kori kishtar i Mitropolisë përbëhej prej nxënësve të qytetit. Jorgji Kroi ka kompozuar edhe shumë këngë karakteristike korçare, prej të cilave mund të veçonim “Burimi i Çardhakut”. Në vitin 1932 kori i kishës së “Shën Gjergjit” është drejtuar nga Ilo Mosko. Pjesëmarrës në këtë kor kishtar kanë qenë: Vangjush Kondi, Loni Sofroni, Dhimitraq Trajçe, Foni Thano, Lisimak Kondi, Angjeli Mite, Vangjo Grabocka, Leksi Thano, Vasil Ballço, Andrea Thano, Pandi Tates, Androkli Kostallari, Llambi Treska, Gaqo Grabocka, Pandi Theodhosi, Maqo Pani, Ilkë Simo. Në vitet 1937-1938 Ilo Mosko ka drejtuar korin kishtar e katedrales “Burimi Jetëdhënës”. Nga pjesëmarrësit mund të veçojmë: Maqo Frashëri, Anesti Kristo, Mishel Cico, Kostaq Osmanlli etj. Kori miks i katedrales “Burimi

³⁰-Kristofor Beduli, Mbi muzikën dhe koret në kishën tonë Ortodokse, Tempulli, Nr.11, Korçë 2005, faqe 13-25.

Jetëdhënës” në vitet 1943-1944 është drejtuar prej Kostaq Oamanlliut. Ky i fundit ka qenë edhe drejtues i korit “Lira” të Korçës. Kori miksi i kishës së “Shën Gjergjit” drejtohej nga Dhimitër Kostandini, ndërsa kori miksi i kishës së “Shën Ilisë” drejtohej prej Spiro Kondrës. Dhimitra Cico ia ka përkushtuar tërë jetën e saj lutjeve dhe himneve drejtuar Perëndisë. Me nismën e saj në vitin 1939 u krijua kori i kishës së “Shën Gjergjit”. Dhimitra bënte pjesë në grupin e të krishterëve të fshehtë, të cilët edhe gjatë diktaturës vazhdonin që të kryenin ceremonitë dhe ritet fetare. Zëri i saj melodioz nuk rreshti së psaluri për Perëndinë. Dhimitra Cico fjeti më 21 shtator të vitit 1996.³¹

Në vitin 1991 Dhimitër Kondakçi krijoi korin kishtar në përbërje të së cilit janë: Mihallaq Zallëmi, Thanas Konini, Koço Grameno, Thanas Bicolli, Nesti Ceci, Guri Kotnani, Ilo Furxhi, Vaskë Pula, Mihallaq Sovjani, Piro Ceta, Tomi Tomço, Gjergj Terezi, Koço Tërova, Vangjo Fara, Nesti Furxhi, Niko Ropi. Në vitin 1997 me nismën e atë Spiro Katundit u krijua kori kishtar me këta anëtarë: Sotiraq Vangjeli, Neli Morava, Anesti Luarasi, Vaso Qirinxhi, Vangjush Sara, Vani Trako, Odhise Polena, Thanas Konini, Llazi Balashi, Koço Grameno, Tomi Tomço, Nesti Ceci, Zhani Nase, Gjergji Terezi, Serafim Xhane, Niko Raci, Ylli Naço. Drejtues i korit është mjeshtri Jorgaq Nano. Në vitin 1999 u krijua kori i kishës së “Shën Thanasit”, të cilin e drejton Vani Trako. Në përbërje të korit janë: Gjergj Peleshi, Ilia Teneqexhi, Aleko Manushi, Thanas Kondili, Aristidh Themeli, Guri Napoloni, Thoma Sterjo, Ilia Vinjau, Ritvan Shëllira, Pandi Luarasi, Mihallaq Kamburi. Gjithashtu në vitin 1999 u krijua kori i kishës katedrale “Ngjallja e Krishtit”, i cili drejtohet nga Mira Mançka.³²

Në Pogradec më 17 prill 1921 u mbajt mesha e parë shqip nga arkimandrit Agathangjel Çamçe dhe ikonom Josif Marko. Në

³¹-Protoprezviter Jani Trebicka, Një jetë e kushtuar Perëndisë, Ngjallja, tetor 1996, faqe 2.

³²-Fori Tërpini, Si e gjeta rrugën e dritës, Kotti, Korçë 2001, faqe 246-250.

meshë psalën Thanas Kenxholli, Dhimitër Tushemishti dhe Llambi Thoma.

Në **Vlorë** kanë qenë psaltë Thimi Opingari dhe Lili Proko. Ky i fundit ka qenë protopsalt pasi kishte mësuar muzikën bizantine duke qëndruar pranë një psalti në Neohor të Kostandinopojës.³³

Në Elbasan protopsalt ka qenë Vladimir Gjini, ndërsa kori mikst i Elbasanit drejtohej nga Fotaq Filipeu. Gjithashtu edhe mësuesit Vangjel Popa dhe Petro Kulino kanë drejtuar korin kishtar. Vladimir Gjini ishte shumë i talentuar dhe njohës i muzikës bizantine. Vladimiri kishte një zë kumbues të mrekullueshëm, sa që nami i tij ishte përhapur deri në Kostandinopojë. Atë e ftuan në kishën patriarkale të “Shën Gjergjit” për t’u bërë protopsalt, por Vladimiri nuk pranoi. Pasi u kthye në qytetin e lindjes në Elbasan i psali Perëndisë deri në momentin e fundit të jetës së tij.

Në **Berat** protopsalt ishte Nasi Papapavli, ndërsa kori drejtohej prej Pandi Bogdanit. Nasi Papapavli ishte nga lagjia Mangalem. Si djalë prifti që ishte çdo të diel shoqëronte të atin kur ngjitej në kala për të meshuar në kishën e “Shën Trinisë”.³⁴

Pandi Bogdani ka drejtuar me mjeshtëri korin mikst në vitet 1937. Me bekimin e Hirësisë së Tij, Agathangjelit, profesori i shquar i muzikës Pandi Bogdani themeloi korin mikst të Beratit. Në përbërje të korit qenë të rinj dhe të reja beratas prej të cilëve mund të përmendim: Dhimitër Sylarin, Koço Korçarin, Zoi Banon, Dhimitraq Zakon, Kristaq Zharën, Sofie Bushin, Marika Melëngun, Violeta dhe Afërdita Sahatçiu, Gaqi Samarxhiun, Toli Drobonikun etj.³⁵ Në Berat ka qenë protopsalt Ilia Thimi Koçi, i cili ka dhuruar shumë libra liturgjike, që i kishte fshehur gjatë viteve të monizmit.

³³-Dhimitër Beduli, Muzika bizantine në Kishën tonë, Ngjallja, shkurt 1997, faqe 10.

³⁴-Teodor Papapavli & Maksim Çuko, Si u zbuluan kodikët e Beratit, Ngjallja, tetor 1999, faqe 9.

³⁵-Ilia Mihal Zaka, Kori kishtar mikst i Beratit, Ngjallja, gusht 2001, faqe 9,10.

Gjithashtu psalti Ilia Koçi ka punuar për përgatitjen e psaltëve të rinj si Edmond Filipi, Theodhor Xhymerteka, Pavli Vishnja etj. Gjithashtu në Berat kanë qenë psaltë: Petro Koçimare, Minella Heqimi, Josif Nushi, Nasi Dyshniku, Sotiraq Tapia, Kozma Shyti, Mihallaq Lapardhaja Niko Mile, Vlash Mile, Vladimir Prendi etj.³⁶

Në **Durrës** kanë qenë psaltë Tod Ziu dhe Sotir Taçi. Protopsaltin e bënte Sotiri, i cili ka pasur zë të mrekullueshëm. Korin miks të Durrësit e ka drejtuar Efthim Dheri. Figura më e shquar ka qenë Aleks Pjetri, i cili ka lindur më 17 mars të vitit 1898 në qytetin e Durrësit. Në vitin 1911 kur Aleks ishte vetëm 13 vjeç u dorëzua në gradën e anagnostit. Aleks filloi të mësonte artin e muzikës bizantine prej kryepsaltit Nako Miho, i cili kishte studiuar në “Konservatorin e Kostandinopojës”. Aleks Pjetri ka krijuar korin e parë kishtar, ka dhënë mësimë fetare etj. Në Krishtlindjet e vitit 1928 kompozoi këngën “Mirmëngjes zonja, zotërinj”, e cila u përhap me shpejtësi në qerthullin ortodoks.³⁷

Në vitin 1929 Aleks Pjetri themeloi korin e kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë, drejtimin e së cilit më vonë e mori profesori rus Evgjeni Kiriev. Aleks ka botuar këta libra: 1-”Psalme dhe hymne” për korin kishtar dhe çdo të krishter Orthodhoks. Tiranë 1929. 2-”Psalme” për koristët e Kishës Orthodhokse. 3-”Dashuria Ungjillore”. Aleks Pjetri vdiq në Durrës më 25 janar të vitit 1962.³⁸

Në **Tiranë** ka pasur psaltë të talentuar si për shembull Vlash Dhora, Dhimitër Beduli, Kostandin Trako, Vlash Nushi, Vlash Semini, Petro Ketri etj.

Dhimitër Beduli është specializuar për muzikë bizantine në Besarabi të Rumanisë. Në prill të vitit 1935 Dhimitër Beduli

³⁶-Ksenofon Ilia, Kishat e Beratit, Ombra GVG, Tiranë 2006, faqe 58.

³⁷-Thoma Qendro, Aleks Pjetri, një jetë për Kishën, Ngjallja, dhjetor 1992, faqe 6.

³⁸-Mihal Kostoli, Aleks Pjetri–një punëtor i palodhur i Kishës, Ngjallja, shkurt 2002, faqe 9.

krijoi korin mik্স të kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë, ndërsa në mars të vitit 1938, organizoi korin e parë kishtar me 20 djem në qytetin e Durrësit. Një pjesë të madhe të tropareve që psalte kori janë kompozuar prej Dhimitër Bedulit, i cili ka lënë në dorëshkrim këto himne kishtarë të shkruara me nota bizantine: 1-”Liturgiker i Vogël”, me këngët e Meshës së Hyjshme. Tiranë 1934, numër faqesh 22. 2-”Fletore e korit”, me Meshën Hyjnore në dy zëra, me numër faqesh 14. 3-”Vajtimet e përmbivarrëshme të Zotit”, me numër faqesh 15. 4-”Himni Akathist”, Tiranë 1935, me numër faqesh 7. 5-”Këngët e Javës së Madhe”, Tiranë 1936, me numër faqesh 99. 6-”O Zot thirra, Çdo frymë”, si dhe këngë të ndryshme në tetë tinguj, Tiranë 1936, me numër faqesh 25. 7-”Himni Keruvik”, Tingulli I, me numër faqesh 2. 8-”Të ndryshme”, me numër faqesh 26. 9-”Fama e Kryepiskopit”, me numër faqesh 1.

Gjithashtu teologu erudit Dhimitër Beduli me qëllim që tradita e muzikës bizantine të transmetohej edhe në brezat pasardhës ka botuar artikuj të shumtë në organet kishtarë: 1-”Himni Akathist”, revista “Jeta Kristiane”, Nr. 1, mars 1940. 2-”Muzika në kishat tona”, revista “Jeta Kristiane”, Nr. 6-7, gusht-shtator 1940. 3-”Himnet e Shenjta të Krishtlindjes”, revista “Jeta Kristiane”, Nr. 10, dhjetor 1940. 4-”Historia e këngës kishtarë”, revista “Jeta Kristiane”, Nr. 2,3,4,5,&8 të vitit 1941. 5-”Joan Kukuzeli nga Durrësi”, gazeta “Ngjallja”, Nr. 2, 1992. 6-”Tropari i Kasianisë”, gazeta “Ngjallja”, Nr. 4, 1995. 7-”Muzika bizantine në Kishën tonë”, revista “Kambanat”, Nr. 10, 2004. Me të drejtë mund të themi që kontributi i Dhimitër Bedulit në fushën e muzikës bizantine është shumë i vyer. Beduli radhitet pas Nolit, përse i përket kompozimeve dhe përkthimeve të himneve kishtarë. Në krishtlindjet e vitit 1996, Dhimitër Beduli psali për herë të fundit në katedralen e “Ungjillëzimit”.

Vlash Nushi ka lindur në Tiranë në vitin 1914. Pasi përfundoi seminarin ka punuar si mësues feje. Gjatë viteve 1954-1959, Vlash Nushi ka punuar si referent i pasurive kishtarë. Vlashi

ka botuar disa artikuj në revistën “Predikimi”. Ai ka qenë psalt në kishën katedrale të Tiranës. Vlash Nushi ka vdekur në vitin 1981.

Vlash Semini ka lindur në qytetin e Kavajës më 1906. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Bukuresht, Vlashi u kthye në Tiranë, ku ka shërbyer si kujdestar dhe psalt në kishën e “Shën Prokopit”. Vlash Semini ka botuar shumë artikuj teologjik në shtypin periodik të K.O.A.Sh-it. Vlashi vdiq më 1989.³⁹

Petro Ketri nga Sinica e Korçës ka qenë nga të parët që ka psalur në kishën e “Ungjillëzimit” në Tiranë pas rihapjes së kishës. Ndonëse në moshë të shkuar Xha Petro vinte rregullisht në kishë gjatë të kremteve, zinte vendin në psaltir dhe i psalte Perëndisë. Këtë punë e bënte falas pa shpërblim nga kisha. Vitet e fundit ka qenë psalt tek kisha e “Shën Prokopit” në Tiranë. Një të dielë marsi të vitit 2002 Petro Ketri erdhi si gjithnjë për të psalur në kishë, lëçiti Apostullin me zërin e tij melodioz, u kungua me trupin dhe gjakun e Krishtit dhe porsa mbërriti në shtëpi, dorëzoi shpirtin tek Perëndia. Të dielën që pasoi mungesa e Petros në psaltir ra në sy të besimtarëve, të cilët kishin mbushur kishën e Shën Prokopit.⁴⁰

Në fund të predikimit ftova besimtarët e pranishëm që të luteshin për shpirtin e Petro Ketrin, i cili i psali Perëndisë deri në momentin e fundit të jetës. Ka qenë diçka shumë mallëngjuese për mua dhe besimtarët e pranishëm. Emocionet që kam përjetur nuk do t’i harroj kurrë, sepse kam pasur respekt për psaltin e urtë Petro, me të cilin më lidhnin kujtimet e ditëve të para të rihapjes së kishës së “Ungjillëzimit”.

Kostandin Trako ka lindur në Boboshticë të Korçës më 10 shkurt të vitit 1919. Gjatë viteve 1931-1936 ndoqi Seminarin “Apostull Pavli”. Në vijim ka studiuar në “Akademine Mbretërore

³⁹-Kristofor Beduli, Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.

⁴⁰-Nasi Hobdari, Nderim për psaltin Petro Ketri, Ngjallja, prill 2002, faqe 2.

të Muzikës” në Bukuresht, ku u specializua për dirizhim koresh. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1942 riorganizoi korin kishtar në Tiranë. Në shtypin kishtar ka shkruar shumë artikuj disa prej të cilëve janë: “Muzika në Kishat Orthodhokse”, “Këngëtorët kishtarë”, “Folklori muzikal i Pashkës”, “Imzot Fan S Noli muzikant-kompozitor” etj. Prof. Kostandin Trako ka përpunuar “Përlëshoret e tetë tingujve”, ka harmonizuar për kor mikst me nota moderne “Liturgjinë e Joan Gojatri” etj. Kostandin Trako fjeti më 12 mars të vitit 1986.⁴¹

Kori i kishës së Ungjillëzimit në Tiranë është krijuar nga Dhimitër Beduli. Anëtarët e korit deri në mars 1967 kur u ndalua besimi qenë: Iri Gjoka, Anthulla Markidhi, Mariana Trebicka, Keti Cico, Gallata Kota, Tefta Kuqi, Enrieta Afezulli, Vasilika Murani, Zana Mata, Marika Simaku, Viollanda Xhometiku, Pandora Karakosta, Leni Dhama, Thanas Shkurti, Kristaq Tasho, Niko Zaharija, Themistokli Bimbli, Themistokli Jorgoni, Andrea Botka, Stavri Kondi, Nonda Rusi, Thoma Frashëri.⁴²

Në qershor 1991 kancelari i kishës së “Shën Gjergjit” në Boston, atë Artur Liolini, i shoqëruar nga dhjakonët Denis Schutte e Viliam Poist vizitoi kishën, ku u pritën nga klerikët dhe besimtarët e pranishëm. Atë Arturit i bëri përshtypje kori i kishës, i cili sapo ishte ngritur me kontributin e Xhorxhi Doçit. Ky i fundit kishte grumbulluar disa këngëtarë nga “Teatri i Operas dhe Baletit” dhe nën drejtimin e dirigjentit Eno Koço kishin filluar të mësonin himnet e “Liturgjisë Hyjnore”. Me largimin e Eno Koços për në Londër, dirigjimin e korit e mori Petrika Trako. Ky i fundit më 2 gusht të vitit 1992 u tërhoq nga drejtimi i korit për t’i lënë vendin Milto Vakos. Kori i katedrales së “Ungjillëzimit” përbëhet nga këngëtarë profesionistë si për shembull: Pandi Zguro, Gjergj Sulioti, Shpresa

⁴¹-Kristofor Beduli, Seminaristi Kostandin Trako, profesor i dirigjentëve korale shqiptarë, Ngjallja, shtator 1999, faqe 9,10.

⁴²-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës, Nereida, Tiranë 2007, faqe 24.

Terezi, Niko Vasili nga artistë veteranë si Drita Papajani, Tefta Kuqi, Kristaq Tasho, Ketii Cico, nga të rinj si Sofika, Majlinda, Ekaterina Bushaka, Romeo etj. Repertori përbëhet nga pjesë kishtarë të kompozitorëve ortodoksë si Çajkovski, Imzot Noli, K. Lara, Th. Gaqi. Këta dy të fundit kanë kompozuar pjesë që këndohen për Pashkë. Disa nga pjesët që këndohen në “Liturgjinë Hyjnore” janë “Himni Keruvik”, “Mëshirë paqeje” etj.⁴³

Milto Vako dirigjenti i korit të kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë ka lindur në Pogradec më 30 mars 1930. Gjatë viteve 1953-1959 ka studiuar në “Konservatorin Çajkovski” të Moskës. Pas studimeve u emërua dirigjent i korit të “Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore”. Në vitin 1975 Milto Vako u arrestua dhe u dënua nga diktatura komuniste me shtatë vjet burg. Pasi doli nga burgu u detyrua të punojë në punë të ndryshme. Me fitoren e demokracisë filloi mësimdhënien në “Akademinë e Arteve”. Tashmë Milto ka marrë titullin “Profesor” dhe është “Artist i Merituar”. Milto Vako ka themeluar korin e vajzave të “Akademisë së Arteve” dhe ka shumë vite që drejton korin e kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë.⁴⁴

Në Tiranë ka vite që zhvillon një veprimtari intensive edhe **kori bizantin Joan Kukuzeli**, i cili përbëhet prej 14 antarësh, ku shumica kanë përfunduar “Akademinë Teologjike” të Shën Vlashit. Prej tyre mund të përmendim: atë Sotir Xhaferin, atë Josif Gjylin, murgun rishtar Joan Mullain, Simon Avdian, Spiro Kostolin, Joan Menin, Harallamb Tereziun, Andrea Rëmbecin, Niko Martikon, Xhorxhi Doçin etj. Kori “Joan Kukuzeli” deri në fundin e vitit 2011 është drejtuar nga arkimandrit Justini. Në vitin 2012 drejtimin e korit bizantin “Joan Kukuzeli” e morri Theodhor Peci. Në përbërje të korit janë Thoma Shkira, Niko Kodheli, murgu Serafim,

⁴³-Kristina Hanxhari, Për mua përsosja do të ishte krijimi i korit me zë engjëllor, Ngjallja, dhjetor 1994, faqe 4.

⁴⁴-Intervistë me dirigjentin e mirënjohur, Artistin e Merituar Prof. Milto Vako, 55, 27 nëntor 2007, faqe 18-19.

Harallamb Meçi, Ervin Mihali etj. Më 1 prill 2012 kori bizantin dha një koncert në Berat, ndërsa më 3 prill 2012 kori bizantin “Joan Kukuzeli” nën drejtimin e profesorit të talentuar të muzikës bizantine Theodhor Peci dha koncertin “Ty të meriton madhështimi”, në kishën e “Ungjillëzimit” në Tiranë.⁴⁵



Theodhor Peci ka lindur në Korçë, më 19 qershor 1984. Pasi kreu “Akademinë Teologjike” në Shën Vlash më 2006 shkoi për studime teologjike në “Univesitetin Kombëtar Kapodistria” të Athinës, të cilat i përfundoi më 2011. Gjithashtu në vitin 2011 mori diplomën e mësuesit të “Muzikës Bizantine” nga “Konservatori i Athinës”, i vlerësuar “shkëlqyeshëm”. Në vitin 2012 u emërua drejtor në “Shkollën e Muzikës Bizantine” në Tiranë. Gjithashtu është kryepsalt i katedrales “Ngjallja e Krishtit” në Tiranë. Theodhor Peci ka shkruar disa artikuj ndër të cilët mund të përmendim: 1-”Joan Kukuzeli, Mjeshtër i madh i Muzikës Bizantine”, *Kërkim 7*, Tiranë 2011, fq.113-128. 2-”Krijimtaria dhe aktiviteti didaktik i Joan Kukuzelit”, *Kërkim 8*, Tiranë 2011, fq. 104-118. 3-”Arti Psaltik dhe mbartësit e tij”, *Kërkim 10*, Tiranë 2012, etj.

⁴⁵-Koncert me muzikë bizantine, Ty të meriton madhështimi, Ngjallja, prill 2012, faqe 9.

BIBLIOGRAFIA

- 1-Akademia e shkencave, Materiale Dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shekullit XVIII- fillimi i shekullit XX, (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), Vëll. II, Tiranë 1981.
- 2-Aleksandër Mexsi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, Uegen, Tiranë 2004.
- 3-Andi Rëmbeci, Sokol Çunga, Kodiku i Korçës Nr. 93, Tiranë 2013.
- 4-Andrea Llukani, Krishterimi në Shqipëri, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 5-Andrea Llukani, Historia e Krishterimit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 6-Andrea Llukani, Historia e Artit Kristian, Tekno Paper, Tiranë 2004.
- 7-Andrea Llukani, Një nga ata, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 8-Andrea Llukani, Nismëtarët, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 9-Andrea Llukani, Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 10-Andrea Llukani, Enciklopedia e krishterë, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 11-Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Neraida, Tiranë 1996.
- 12-Dhimitër Beduli, Kishë dhe kulturë, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006.
- 13-Dhimitër Beduli, Kodiku i kishës së Shën Prokopit të Tiranës, Tiranë 1997.
- 14-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës, Nereida, Tiranë 2007.
- 15-Dhorka Dhamo, Piktura murale e mesjetës në Shqipëri, Tiranë 1974.
- 16-Dhori Falo, Tragjedia e një qyteti, Kotti, Korçë 1998.
- 17-Gazmend Muka, Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, Albas, Tiranë 2013.
- 18-Gazmend Muka, Art' thënia bizantine tek Çetirët, Tiranë 1999.
- 19-Georgiou Antouraki, Xristianiki Zografiki, Despina Mavromati, Athina, 1993.
- 20-Gjergji Gusho, Mbi përhapjen e krishtërimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit, Pogradec 2000.
- 21-Ilia Zaka, Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtare në Berat, Berat 2009.

- 22-Ilirjan Gjika, Bylisi i Ilirisë, Ymeraj, Fier 2011.
- 23-Johan Georg von Hahn, Studime Shqiptare, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë 2007.
- 24-Fori Tërpini, Si e gjeta rrugën e dritës, Kotti, Korçë 2001.
- 25-Kristofor Beduli, At Marko Papajani dhe shënimet e tij, Neraida, Tiranë 2004.
- 26-Ksenofon Ilia, Kishat e Beratit, Ombra GVG, Tiranë 2006.
- 27-Llukan Stavro, Plagët e Krishtit i puth çdo ditë, Gjirokastër 2006.
- 28-Llukan Stavro, Vasil Rrapi, Toponimet e Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2009.
- 29-Maksim Çuko, Qytetërimi dhe krishterimi në Myzeqe, Tekno Peper, Tiranë 2004.
- 30-Mihail G. Triou, H Eklisia sto Anatoliko Iliriko kai tin Albania, Thesaloniki 1999.
- 31-Moikom Zeqo, Mes lakontit dhe Krishtit, Medaur, Tiranë 200.
- 32-Moikom Zeqo, Kulti gnostik i Aparkeas-Abraksas, Albanopol, Tiranë 2009.
- 33-Moikom Zeqo, Onufri, Medaur, Tiranë 1998.
- 34-Moikom Zeqo, Arkeologjia, gramatika e fakteve, Albanopol, Tiranë 2009.
- 35-Moikom Zeqo, Arkeologjia nënujore, Albanopol, Tiranë 2009.
- 36-Moikom Zeqo, Universi i artit bizantin, Arnissa Edition, 2009.
- 37-Moikom Zeqo, Arkeologjia, optika e shekujve, Arnissa Edition, 2009.
- 38-Moikom Zeqo, Gjarpëri kadmik dhe anijet ilire, Arnissa Edition, 2010.
- 39-Moikom Zeqo, Pasaporta arkeologjike e traditave, Arnissa Edition, 2010.
- 40-Moikom Zeqo, Arkeologjia si ekzigjezë, Arnissa Edition, 2010.
- 41-Moikom Zeqo, Arkeologjia dhe hyjnitë ilire, Arnissa Edition, 2011.
- 42-Moikom Zeqo, Kronika shqiptare e arkeologjisë nënujore, Arnissa Edition, 2011.
- 43-Moikom Zeqo, Hyjnesha Dardania dhe hyjni të tjera ilire në Dardani, Arnissa Edition, 2011.
- 44-Moikom Zeqo, Ikonografia, alkimia dhe Gjon Buzuku, Arnissa Edition, 2011.
- 45-Moikom Zeqo, Kulti i Mitras në Durrës dhe në Apoloni, Arnissa Edition, 2011.
- 46-Moikom Zeqo, Hyu ilir Redon, ikonografia e gabuar, Arnissa Edition, 2011.
- 47-Moikom Zeqo, Saga arkeologjike e Dyrrahut, Arnissa Edition, 2012.
- 48-Nasi Hobdari, Llazar Pjeshkazini, Lëkë Tasi, Ringjallja e Kishës së Ungjillëzimit në Tiranë, Maluka, Tiranë 2007.
- 49-Pëllumb Xhufi, Shekulli i Voskopojës, Toena, Tiranë 2010.

- 50-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë 1998.
- 51-Pirro Thomo, Gentian Stratobërdha, Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Tiranë 2005.
- 52-Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vol 2.
- 53-Simo Tyto, Baba Dhame Peshtani, Tema, Tiranë 2001.
- 54-Stilian Adhami, Përmeti dhe përmetarët në faqet e historisë, Tiranë 2001.
- 55-Shaban Sinani, Kështjella e virtytit, Tiranë 2001.
- 56-Shaban Sinani, Beratinus, Argeta-LMG, Tiranë 2004.
- 57-Shaban Sinani, Kodikët e Shqipërisë në kujtesën e botës, Naim, Tiranë 2011.
- 58-Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë 1998.
- 59-Theofan Popa, Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 2006.
- 60-Viktori Puzanova, Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar, 55, Tiranë 2005.
- 61-Uratore e Kishës Ortodokse, e përktheu Imzot Fan S. Noli, Boston, Mass. 1941.

DISPENZA

- 1-Anthim Aleksudhi, Përshkrim i shkurtër historik i Mitropolisë së Shenjtë të Beratit, (Dispensë), Përktheu nga greqishtja Vasil Nika, Korfuz 1868.
- 2-Ark. Rest. At. Theologos, Ikona, Njohuri dhe shpjegim teologjik, (Dispensë).
- 3-Dhimitër Beduli, Leksione nga Historia e Kishës, botim i K.O.A.Sh-it, (Dispensë), Tiranë 1998.
- 4-Ikonat, përkthyer në shqip nga At Joan Pelushi, (dispensë).
- 5-Jorgos Jakumis, Dhio proima metavizantina mnimia kai o zografikos tous dhiakosmoa, (Dispensë), Ionanina 2003-4.
- 6-Jorgos Galitis, Shënimet e Seminarit Teologjik, (Dispensë), Durrës 1992.
- 7-Pjesë nga vepra e Evlogjio Kurillës: Grigor Argjirokastriti dhe Historia e Moskopolit, Përkthyesi anonim, Dispensa është shtypur në Institutin e Monumenteve të Kulturës, (Dispensë).
- 8-Shërbesa e Shejtë e Sh'Jon Vlladimirit, e përkthyme dhe e botume me bekim të Kryepiskopit të gjith Shqipnis krye-Hirsis Tij, Emzot Dr. Visarion-it, Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë 1934.
- 9-Theofan Popa, Pasaporta të kodikëve të fondit 888, dorëshkrim 160 faqe, ruhet pranë AQSh.
- 10-Vasil Kaskadami, Theofan Popa-arkeologji dhe misionarizëm, Athinë 1997.

KOLEKSIONE

- 1-Koleksioni i gazetave “Ngjallja”, botim i K.O.A.Sh-it, (1992-2013)
- 2-Koleksioni i revistave “Jeta Kristiane”, Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë (1940-1944)
- 3-Koleksioni i revistave “Tempulli”, Shtypshkronja Kotti, Korçë (2000-2012)
- 4-Koleksioni i revistave “Kërkim”, Shtypshkronja Ngjallja, Tiranë (2009-2013)
- 5-Koleksioni i revistave “Monumentet”, botim i Institutit të Monmenteve të Kulturës, Tiranë (1980-2002)

ARTIKUJ NË GAZETA DHE REVISTA

- 1-Abedin Kaja, Jorgji Bendi, Shën Nikodhimi, shenjt i Beratit, Ngjallja, qershor 2007, faqe 9, 10.
- 2-Adriana Peçi, Onufri, Dokumentar, Shekulli, 27 shkurt 2002, faqe 21.
- 3-Aleko Papakozma, Manastiri i Shën Pjetër e Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit, Monumentet 1 / 1983 (25), faqe 77-85.
- 4-Aleksandër Meksi, Kishat bizantine të Beratit, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 37-39.
- 5-Alma Gjermani, Dhuruesit korçarë të shek. XIX, Tempulli, Nr. 13, Korçë 2008, faqe 18-20.
- 6-Andrea Llukani, Erion Prifti, Peshtani, rrënjë të thella në traditën ortodokse, Ngjallja, qershor 2001, faqe 10.
- 7-Andrea Llukani, Kronikë Fetare, Rilindja Demokratike, 11 korrik 1992, faqe 2.
- 8-Andrea Llukani, Unë denoncoj, si janë grabitur ikonat, Standard, 16 tetor 2013, faqe 18-19.
- 9-Andrea Llukani, Problematika e grabitjes së ikonave, Telegraf, 15 tetor 2013, faqe 7.
- 10-Andrea Llukani, Kishat monumet kulture pre e grabitjes, Idea, 16 tetor 2013.
- 11-Andrea Llukani, Nikodhimi i Beratit një shenjt shqiptar, Le Radici, anno 11, n. 2, Maggio 2013, pagina 11.
- 12-Andrea Llukani, Shërbesa e Joan Vladimirit, Le Radici, anno 11, n. 3, Giugno 2013, pagina 3.

- 13-Andrea Llukani, Ali Pashai dhe Shën Kozmai, *Le Radici*, anno 11, n. 4, Ottobre 2013, pagina 20.
- 14-Andrea Llukani, *La parola Epitaffio*, *Le Radici*, anno 8, n.1, Gennaio 2010, pagina 8.
- 15-Andrea Llukani, Onufri, *Le Radici*, anno 8, n. 2, Giugno 2010, pagina 11, 20.
- 16-Andrea Llukani, *Traditë e pasur në gdhendjen e ikonastasëve*, Ngjallja, shtator 2002, faqe 10, 11.
- 17-Andrea Llukani, *Ikona e Lindjes*, Ngjallja, dhjetor 1998, faqe 6.
- 18-Andrea Llukani, *Vendi i Hyjlindëses në Kishën Orthodhokse*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 8.
- 19-Andrea Llukani, *Ikona e Kryqëzimit*, Ngjallja, prill 1998, faqe 8.
- 20-Andrea Llukani, *Pagëzimi i Zotit tonë Isu Krisht, Gëzohu*, janar 2000, faqe 6, 7.
- 21-Apostol Kotani, *Ndërtimi i Pallatit të Kulturës me miratimin e mitropolitit të qytetit dhe të këshillit kishtar*, Sot 1 nëntor 2013, faqe 12.
- 22-Arben Gjata, *Mitropolia e Korçës dhe ndërtesa e saj*, Ngjallja, Tetor 2002, faqe 4.
- 23-Arben Gjata, *Kisha e Shën Gjergjit, Tempulli Nr. 8, Korçë* 2003, faqe 10-15.
- 24-Arben Gjata, *Kisha e Profetit Ilia, Tempulli Nr. 10, Korçë* 2005, faqe 14-17.
- 25-Arjan Kaja, *Xovani Shyti, Berati, gur i rëndë në historinë e qytetërimit shqiptar*, Tema, 26 dhjetor 2007, faqe 12-13.
- 26-Avenir Sadikaj, *Onufri dhe shtegëtimi i shpirtit bizantin në Europë*, Gazeta Shqiptare, 25 gusht 2001, faqe 12-13.
- 27-Ben Andoni, *Pronat e klerit. Lista e pasurive të katër komuniteteve fetare*, Java, 7 shtator 2013, faqe 7-9.
- 28-Besim Tabaku, *Ikonombartësi i kishave të Perondisë dhe katedrales së Beratit, vlerat dhe ndërhyrjet restauruese*, Monumentet 2 / 1990 (40), faqe 171.
- 29-Gazmend Muka, *Disa konsiderata për kontributin e Çetirëve në ikonat e katedrales “Fjetja e Shën Mërisë” në Berat*, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 71-75.
- 30-Gazmend Muka, *Bazilika që i dha emrin Sarandës*, Monumentet 2002, faqe 15.
- 31-Gentjan Stratobërdha, *Ndërhyrje të plota restauruese në kishën e manastirit të Shën Prodhromit në Voskopojë të Korçës*, Ngjallja, shtator 2011, faqe 12.

- 32-Gentian Stratobërdha, Restaurohet piktura murale e Manastirit të Shën Gjergjit të Demës, Ngjallja, shkurt 2012, faqe11.
- 33-Gentian Joan Stratobërdha, Shën Joan Vladimiri, një kishë tjetër në restaurim, Ngjallja, nëntor 2004, faqe 5-6.
- 34-Gentian Stratobërdha, Vidhet kisha Fjetja e Hyjlindëses në Zevat, Gjirokastër, Ngjallja, mars 2011, faqe 12.
- 35-Gentian Stratobërdha, Monumentet e kultit orthodhoks pjesë e trashëgimisë sonë kulturore, Kërkim Nr. 8, Tiranë 2012, faqe 96-97.
- 36-Grabitet për të gjashtë herë kisha e Shën Thanasit në Bularat, Ngjallja, dhjetor 2011, faqe 2.
- 37-Gentian Stratobërdha, Pas ikonastaseve dhe ikonave, po grabiten kambanat, Ngjallja, mars 2012, faqe12.
- 38-Gentjan Stratobërdha, Vidhen dhe dëmtohen rëndë pjesë nga afresku i Onufrit në kishën e Shën e Premtes në Valsh të Elbasanit, Ngjallja, janar 2013, faqe 6,8.
- 39-Dashnor Kaloçi, Genta Popa, Viti 1967, kur Tirana zyrtare i shpalli luftë Zotit, Shqip, 9 dhjetor 2007, faqe 18-19.
- 40-Dhimitër Beduli, Shën Nikodhimi i Beratit, Ngjallja, Qershor 1993, faqe 6.
- 41-Dhimitër Beduli, Mitropolia e Durrësit në Shekuj, Ngjallja, qershor 1993, faqe 7.
- 42-Dhimitër Beduli, Dioqeza e Gjirokastrës, Ngjallja, janar 2007, faqe 10.
- 43-Dhimitër Beduli, Muzika bizantine në Kishën tonë, Ngjallja, shkurt 1997, faqe 10.
- 44-Dhimitër Dishnica, Kodikët thesare të vjetra të trashëgimisë bizantine, Ngjallja, mars 1998, faqe 9-10.
- 45-Engjëll Serjani, Ethet mistike të një zbulimi, Shqip, 4 gusht 2007, faqe 42-43.
- 46-Elsa Demo, Çështë ky Qipriot, Shekulli, 15 prill 2004, faqe 18-19.
- 47-Fatbardha Shkupi, Mjeshtër shqiptarë, dekoratorë që kanë opunuar në Bullgari, Maqedoni dhe në Shqipëri, Monumentet 2002, faqe 75.
- 48-Fatbardha Shkupi, Zbukurimorja e ndërtimitarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX, Monumentet 2 / 1983 (26), faqe 124-126.
- 49-Fatmir Thaçi, Adrian Devolli, restaurimi dhe vlerat e pikturës murore të kishës Shën Mëri Vllaherna në berat, Monumentet 2 / 1990 (40), faqe 143.
- 50-Fatmir Thaçi, të dhëna rreth pikturës murale në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” në Sinjë, Monumentet 2/1990 (40), faqe 158.
- 51-Fatos Baxhaku, Në Vithkuq për Shën Gjergj, Shqip, 28 prill 2009, faqe 24-25.

- 52-Fiqiri Sejdiaj, Misioni i vëllait të Ramiz Alisë në Kinë për Kodikët shqiptarë të krishtërimit”, Panorama, 29 dhjetor 2003, faqe 12-13.
- 53-Fiqiri Sejdiaj, Për Kodikët shqiptarë kinezët angazhuan dhjetëra ushtarë të armatosur dhe tren special, Panorama, 30 dhjetor 2003, faqe 12-13.
- 54-Ferdinand Dervishi, Shën Kozmai, Si u zbuluan në Fier eshtrat e shenjtë grek, Gazeta Shqiptare, 10 prill 2007, faqe 20-21.
- 55-Frederik Stamati, Mbi restaurimin e Epitafit të Gllavicës, Monumentet, 2 1990 (40), faqe 121.
- 56-Ilia Mihal Zaka, Kori kishtar miks i Beratit, Ngjallja, gusht 2001, faqe 9,10.
- 57-Ilirjan Gjika, Manastiri i Shën Mërisë së Zvërnecit, Fjala, 23-30 janar 2005, faqe 18.
- 58-Intervistë me dirigjentin e mirënjohur, Artistin e Merituar Prof. Milto Vako, 55, 27 nëntor 2007, faqe 18-19.
- 59-Joan Stratobërdha, Kontribut i madh i Kishës për trashëgiminë kulturore kombëtare, Ngjallja, qershor 2003, faqe 6-7.
- 60-Joan Stratobërdha, Kisha e Manastirit “Fjetja e Hyjlindëses”, në Zvërnec, Ngjallja, maj 2003, faqe 11.
- 61-Jorgos Jakumis, Piktorët Çetiri në Myzeqe, Berat 2003, faqe 15.
- 62-Kliti Kallamata, Rreth tipareve të reja të programit ikonografik në pikturën murale të shek. XVIII, 2000 vjet art dhe kulturë kristiane në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 263.
- 63-Koço Zheku, Besimi i krishterë dhe faltoret e para në Shqipëri, Ngjallja, janar 1994, faqe 4,5.
- 64-Koço Zheku, krishtërimi në Shqipëri gjatë shekujve V-VI, Ngjallja, mars 1994, faqe 9.
- 65-Koço Zheku, Kisha e Shën Marisë në Manastirin e Apolonisë, Ngjallja, mars 1997, faqe 10.
- 66-Kompleksi i Katedrales së re të Tiranës “Ngjallja e Krishtit”, Selia e Sinodit të Shenjtë dhe Qendra Kulturore, Tiranë 2012, faqe 2-3.
- 67-Koncert me muzikë bizantine, Ty të meriton madhështimi, Ngjallja, prill 2012, faqe 9.
- 68-Kosta Naçi, Rreth vendlindjes së dorëshkrimeve mesjetare të Shqipërisë, Shkenca dhe jeta, nr.127, janar 1991, faqe 34-35.
- 69-Kostas Nihoritit, Tradita e kultit të shtatë shenjtoreve, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 87-90.
- 70-Kostandinos Gjakumis, Joan Stratobërdha, Kisha e Lindjes së Hyjlindëses tek Pazari i Përmetit, Tempulli, Nr. 9, Korçë, 2004, faqe 27.

- 71-Kostandinos Jakumis, Veprimtaria e piktorëve nga Linotopi në viset e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 211-212.
- 72-Kristina Hanxhari, Efrosina Noti, Shën Prokopi u përket besimtarëve ortodoks, Ngjallja, mars 1993, faqe 3.
- 73-Kristina Hanxhari, Për mua përsosja do të ishte krijimi i korit me zë engjëllor, Ngjallja, dhjetor 1994, faqe 4.
- 74-Kristofor Beduli, Familja e Agjiografëve Zengo, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9-10.
- 75-Kristofor Beduli, Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.
- 76-Kristofor Beduli, Seminaristi Kostandin Trako, profesor i dirigjentëve korale shqiptarë, Ngjallja, shtator 1999, faqe 9,10.
- 77-Kristofor Beduli, Mbi muzikën dhe koret në kishën tonë Ortodokse, Tempulli, Nr.11, Korçë 2005, faqe 13-25.
- 78-Kristofor Naslazi, Kristaq Balli, Ndhimesa e piktorëve korçarë në artin mesjetar shqiptar, Tempulli, Nr. 2, Korçë 2000, faqe 41.
- 79-Kristaq Balli, Kristofor Naslazi, Gjurmime rreth një plejade piktorësh dardharë të mesjetës së vonë, Monumentet 2 / 1991, faqe 23-24.
- 80-Liljana Bërxolli, Kodikët thesarë të kulturës Shqiptare, Fletëpalosja e Drejtorisë të Përgjithshme të Arkivave, Tiranë 1999.
- 81-Liljana Bërxolli, Vlera e Kodikëve mesjetarë dhe puna për evidentimin e tyre, revista Arkivi Shqiptar 1999, faqe 63-71.
- 82-Leonard Veizi, Projektet anti-Zot të Ramiz Alisë, Dita, 23 mars 2005, faqe 14-15.
- 83-Llukan Stavro, atë Gjergj Suli, martir i Kishës sonë Orthodhokse, Ngjallja, janar 1999, faqe 9.
- 84-Manastiret e Mitropolisë së Hirëshme të Gjirokastrës, Ngjallja, shtator 1993, faqe 4,5.
- 85-Maria Skavara, Cikli ikonografik i jetës së Shën Kollit në Saraqinishtë të Lunxhërisë, botuar në 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 235-239.
- 86-Marita Beci, Disa vrojtime dhe sugjerime mbi gjendjen dhe problemet e ruajtjes së objekteve të restauruar në muzeun “Onufri”, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 109.
- 87-Mihal Kostoli, Aleks Pjetri–një punëtor i palodhur i Kishës, Ngjallja, shkurt 2002, faqe 9.
- 88-Mihal Sonellari, Një traditë, e cila jeton së bashku me qytetin, Ngjallja, mars 2005, faqe 4.

- 89-Moikom Zeqo, Epitafi i Gllavenicës, emërtimi nuk është i saktë, Shekulli, 5-mars-2005, faqe 18.
- 90-Moikom Zeqo, Historia e një Epitafi të rrallë, Metropol, 25 shkurt 2005, faqe 22.
- 91-Mystehak Xhemali, Koka e florinjte e Shën Kozmait në Lushnjë, Albania, 5 maj 2007, faqe 22.
- 92-Nasi Hobdari, Liturgjia e parë Hyjnore, në kishën e shndërruar në palestër, Ngjallja, prill 2006, faqe 9.
- 93-Nasi Hobdari, Lekë Tasi, 5-vjetori i Liturgjisë së parë, Ngjallja, prill 2006, faqe 10.
- 94-Nasi Hobdari, Nderim për psaltin Petro Ketri, Ngjallja, prill 2002, faqe 2.
- 95-Nedai Thëllimi, Tërpo Zografi, Tempulli, Nr. 3, Korçë 2001, faqe 82-83.
- 96-Pan. Monastiret kryesorë të Dhioqezës së Beratit, Koleksioni i revistave "Jeta Kristiane", Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë (1940-1944), faqe 240.
- 97-Petraç Jorgoni, Kremtimi i festës së Shën Vlashit në Durrës, Ngjallja, shkurt 1993, faqe 6.
- 98-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, tetor 1996, faqe 3.
- 99-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.
- 100-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.
- 101-Petrika Shalësi, Dokumente që provojnë pronësi të Kishës, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.
- 102-Protoprezviter Jani Trebicka, Një jetë e kushtuar Perëndisë, Ngjallja, tetor 1996, faqe 2.
- 103-Qeveria jep 460 metra katror tokë për Katedralen e Tiranës, Ngjallja, shkurt 2006, faqe 12.
- 104-Robert Elsie Olzheim, Shenjtorët e krishterë në Shqipëri, Tempulli Nr. 12, Kotti, Korçë 2007, faqe 71-91.
- 105-Sekretet e Epitafit të Gllavenicës, Shekulli, 6 qershor 2000, faqe 20.
- 106-Stilian Adhami, Ansambli historik dhe arkitektonik-artistik i Kolkondasit-Fier, Monumentet, nr. 2 / 1985 (30), faqe 73-76.
- 107-Studio Sinaj, realizim projektim i mozaikëve artistikë.
- 108-Shaban Sinani, Codex Purpureus Beratinus në regjistrin e Memoire du monde, Kërkim, Nr. 4, Tiranë 2010, faqe 39-49.
- 109-Teodor Papapavli & Maksim Çuko, Si u zbuluan kodikët e Beratit, Ngjallja, tetor 1999, faqe 9.

- 110-Të rinjtë ortodoksë kërkojnë kthimin e pronave të kishës, Ngjallja, prill 1993, faqe 6.
- 111-Tiranasit falënderojnë Perëndinë për kishën që iu kthye, Ngjallja, shtator 1993, faqe 3,8.
- 112-Triantafillos Siulis, Ikonostaset e gdhendura në dru në kishat dhe kishëzat e krahinave jugore të kishës ortodokse, botuar në 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë 2003, faqe 309.
- 113-Theofan Popa, Restaurimi i kodikëve të Beratit, Nëntori, nr.4, 1972.
- 114-Theofan Popa, Piktura e vjetër e popullit tonë, Ngjallja, gusht 1995, faqe 10.
- 115-Theofan Popa, Onufri dhe biri i tij Nikolla, Ngjallja, shtator 1995, faqe 9.
- 116-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, tetor 1995, faqe 11.
- 117-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, nëntor 1995, faqe 8.
- 118-Theofan Popa, Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII, Ngjallja, dhjetor 1995, faqe 8.
- 119-Thimi Çollaku, Kodikët shqiptarë-thesare unikalë të kulturës kombëtare, Rilindja javore, 26 janar-2 dhjetor 1995.
- 120-Thimi Çollaku, Kodikët-pronësi e patjetërsueshme kulturore kombëtare, Rilindja Javore,14-26 janar 1996.
- 121-Thoma Dhima, Ligjet parashikojnë qartë se kush janë përgjegjës për ruajtjen e monumenteve, Ngjallja, janar 2012, faqe 8.
- 122-Thoma Qendro, Aleks Pjetri, një jetë për Kishën, Ngjallja, dhjetor 1992, faqe 6.
- 123-Vepror Hasani, Dy lagjet e para Varosh e Kasaba me tetë mëhallat, Metropol, 15 mars 2007, faqe 16.
- 124-Vjedhjet e kishave pa autor dhe heshtja e (pa) autorizuar, Ngjallja, korrik 2012, faqe 9.

BOTIME

Nga Andrea Llukani

LIBRA HISTORIKË

- 1-Krishterimi në Shqipëri, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 2-Historia e Krishterimit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 3-Historia e Artit Kristian, Tekno Paper, Tiranë 2004.
- 4-Një nga ata, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 5-Përndjekjet, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 6-Skizma, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 7-Kisha në diktaturë, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.

LETËRSI E KRISHTERË

- 8-Dostojevski nuk ndihej i vetmuar, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1999.
- 9-Urtësia e shekujve, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2001.
- 10-Antologjia e Letërsisë së krishterë, Tekno Paper, Tiranë 2006.
- 11-Patologjia, Tekno Paper, Tiranë 2007.
- 12-Onomastika e krishterë, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.

LIBRA BIOGRAFIKË

- 13-Xhagjikajt, Tekno Paper, Tiranë 2003.
- 14-Përmes Shkrimeve, Tekno Paper, Tiranë 2004.
- 15-Nuk e humba dashurinë, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 16-Rrëfimet e teologut, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 17-Poeti disident, Trifon Xhagjika, Tekno Paper, Tiranë 2006.
- 18-Biri i Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tekno Paper, Tiranë 2007.
- 19-Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.

LIBRA AGJIOGRAFIKË

- 20-Sinaksari, Pjesa e Parë, Tekno Paper, Tiranë 2003.
- 21-Apostujt, Etërit e Kishës & Shkrimtarët Kishtarë, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 22-Shenjtorët & Perandorët Iliro-Shqiptarë, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 23-Sinaksari, Pjesa e Dytë, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 24-Jetë shenjtorësh, Tekno Paper, Tiranë 2007.

LIBRA LITURGJIKË

- 25-Sinaksari i Madh, Trifon Xhagjika, Tiranë 2013.
- 26-Si kursari thërres, Komenti i Liturgjisë Hyjnore të Joan Gojartit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 27-Shërbesa e Shën Astit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 28-Shërbesa e Joan Vladimirit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 29-Shërbesa e Nikodhimit të Beratit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2013.
- 30-Shërbesa e Kozmait të Etolisë, Trifon Xhagjika, Tiranë 2013.

KOMENTARË

- 31-Djali Plangprishës, Predikime, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 32-Komenti i Ungjillit sipas Matheut, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 33-Sinodet Ekumenike, Tekno Paper, Tiranë 2008.
- 34-Vitet Apostolike, Trifon Xhagjika, Tiranë 2008.
- 35-Anania dhe Safira, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 36-Si duhet të jetë episkopi, Komenti i Letrës së parë të Pavlit drejtuar Timotheut, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 37-Dikush duhet të ndreqë atë që është prishur, Komenti i Letrës së Pavlit drejtuar Titit, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.

BOTIME ENCIKLOPEDIKE

- 38-Enciklopedia e krishterë, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 39-Himnologjia, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 40-Fjalor teologjik, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- 41-Toleranca ndërfaqetare në Shqipëri, Tekno Paper, Tiranë 2006.
- 42-Folklori kristian, Trifon Xhagjika, Tiranë 2013.
- 43-Kanonet dhe Statutet e Kishës Ortodokse, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 44-Concordance e Testamentit të Ri, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- 45-Doganca, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 46-Arti kishtar në Shqipëri, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014.

BOTIMET E PËRMBLEDHURA NË VEPRA

- Vepra I, Toleranca ndërftetare në Shqipëri, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2008.
- Vepra II, Biri i Peshtanit, Përmes shkrimeve, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra III, Patrologjia, Antologjia e letërsisë së krishterë, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra IV, Jetë Shenjtorësh, Himnologjia, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra V, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, nga vitet apostolike deri në ditët tona, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra VI, Folklori Kristian, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra VII, Komenti i Ungjillit sipas Matheut, Vitet Apostolike, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra VIII, Përndjekjet, Sinodet Ekumenike, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra IX, Dostojevski nuk ndihej i vetmuar, Urtësia e shekujve, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra X, Enciklopedia e Krishterë, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- Vepra XI, Skizma, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- Vepra XII, Predikime, Ikonografia, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.

KONTRIBUTI NË BOTIME

- 1-Ahmet Selmani, Profili krijues, moderniteti i Moikom Zeqos, përgatiti Andrea Llukani, Tekno Paper, Tiranë, 2010.
- 2-Atë Stavri Çipi, Pranverës i këndoju, përgatiti për botim Andrea Llukani, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 3-Bajram Paraj, Të parët e Gumenicës, redaktor Andrea Llukani, Vlorë 2007.
- 4-Dostojevski nuk ndihej i vetmuar, përgatiti për botim Andrea Llukani, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1999.
- 5-Lubrifikantet EKO, për botimin e kësaj broshure ndihmuan Ing. Afrim Tonuzi, Andrea Llukani, Ing. Hill Mëhilli, MBA Dritan Spahiu, Tekno Paper, Tiranë, 2006.
- 6-Llukan Stavro, Nderi i Tepelenës, përgatiti për botim Andrea Llukani, Tekno Paper, Tiranë, 2008.

- 7-Makabe Zaharia, Anti-Haiku, përgatiti për botim Andrea Llukani, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 8-Makabe Zaharia, Mjeshtri i labirintit, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 9-Makabe Zaharia, Kentauri fluturues, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 10-Moikom Zeqo, Frymëzimi i mbramë, zgjedhi dhe përgatiti Andrea Llukani, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 11-Moikom Zeqo, Libri Florimontian, zgjedhi dhe përgatiti Andrea Llukani, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 12-Moikom Zeqo, Wind, Poetry, preparation by Andrea Llukani, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 13-Moikom Zeqo, Shkruesi Egjiptian, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 14-Moikom Zeqo, Konceptualiteti i lirisë, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 15-Moikom Zeqo, Mijëvjeçarët në sirtar, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 16-Moikom Zeqo, Hulumtime Arkeologjike, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 17-Moikom Zeqo, Arkeologjia, gramatika e fakteve, përgatiti dhe zgjedhi Albanopol, Tiranë 2009.
- 18-Moikom Zeqo, Buzukiada, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 19-Moikom Zeqo, Herbariumet, përgatiti dhe zgjedhi Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 20-Moikom Zeqo, Arkeologjia nënujore, përgatiti Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 21-Moikom Zeqo, Kulti gnostik i Aparkeas-Abraksas, përgatiti Andrea Llukani, Albanopol, Tiranë 2009.
- 22-Moikom Zeqo, Universi i artit bizantin, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2009.
- 23-Moikom Zeqo, Arkeologjia, optika e shekujve, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2009.
- 24-Moikom Zeqo, Gjarpëri kadmik dhe anijet ilire, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 25-Moikom Zeqo, Pasaporta arkeologjike e traditave, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 26-Moikom Zeqo, Letërkëmbim me Makabe Zaharian, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.

- 27-Moikom Zeqo, Skënderbeiada, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 28-Moikom Zeqo, Arkivi i plagosur, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 29-Moikom Zeqo, Arkeologjia si ekzigjenzë, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 30-Moikom Zeqo, Supriza poetike në Washington D.C, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2010.
- 31-Moikom Zeqo, Arkeologjia si egjiptologji, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 32-Moikom Zeqo, Epistolae in tenebris, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 33-Moikom Zeqo, Arkeologjia dhe hyjnitë ilire, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 34-Moikom Zeqo, Kronika shqiptare e arkeologjisë nënujore, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 35-Moikom Zeqo, Hyjnesha Dardania dhe hyjni të tjera ilire në Dardani, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 36-Moikom Zeqo, Ikonografia, alkimia dhe Gjon Buzuku, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 37-Moikom Zeqo, Kulti i Mitras në Durrës dhe në Apoloni, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 38-Moikom Zeqo, Hyu ilir Redon, ikonografia e gabuar, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2011.
- 39-Moikom Zeqo, Rrëfimet, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 40-Moikom Zeqo, Poezitë e herëshme, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 41-Moikom Zeqo, Saga arkeologjike e Dyrrahut, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 42-Moikom Zeqo, Fosilet poetike, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 43-Moikom Zeqo, Futuristët në mungesë, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 44-Moikom Zeqo, Poezi të Majakovskit futurist, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.
- 45-Moikom Zeqo, Imazhi arkeologjik si retrospektivë, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2013.
- 46-Risvald Kume, Refleksione, tema dhe artikuj të përzgjedhur, redaktor Andrea Llukani, Tekno Paper, Tiranë 2009.

- 47-Shpëtim Sala, Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos, Transliterimi dhe fjalësi shqip, II, korrektor për fjalët greqisht Andrea Llukani, West Print, Tiranë 2013.
- 48-Teodor Papapavli, Gjithmonë për të vërtetën, përgatiti për botim Andrea Llukani, Tekno Paper, Tiranë, 2006.
- 49-Tomor Aliko, Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist, redaktor Andrea Llukani, Maluka, Tiranë 2007.
- 50-Trifon Zyba, Atje ku fillon Dhëmbeli, redaktor Andrea Llukani, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2008.
- 51-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 5, redaktor Andrea Llukani, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 52-Udhëzues për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, për botimin e kësaj broshure ndihmuan Ing. Isa Hoxha, Andrea Llukani, Tiranë, 2008.
- 53-Urtësia e shekujve, zgjedhi dhe shqipëroi Andrea Llukani, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2001.

LIBRA TË FAQOSUR

- 1-Ahmet Selmani, Profili krijues, moderniteti i Moikom Zeqos, Tekno Paper, Tiranë, 2010.
- 2-Atë Stavri Çipi, Pranverës i këndo, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 3-Atë Stavri Çipi, Dielli sonte ku do të flejë, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 4-Atë Stavri Çipi, Shi, o shi bulëflori, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
- 5-Atë Stavri Çipi, Kapedan Petro Petrosi, botimet Trifon Xhagjika, Tiranë 2013.
- 6-Delo Isufi, Ëndërr e grisur, Tekno Paper, Tiranë 2011.
- 7-Dritan Spahiu, Aspekte marketing të sektorit të hidrokarbureve (2001-2005), Tekno Paper, Tiranë 2009.
- 8-Dritan Spahiu, Market research for bitumen & fuel oils in Albania, 1995-2005, Tekno Paper, Tiranë 2009.
- 9-Guri Baze, Kristaq Peshtani, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 10-I.I. Zajkovskij, Kimia Zbavitëse, Tiranë 2013.
- 11-Jani Çango, Peizazhe nga Peshtani, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 12-Jeta Gjergj Suli, Sot jam e lirë, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 13-Jonila Godole, Der kuss des Führes, Tekno Paper, Tirana, 2008.
- 14-Josif Papagjoni, Moikom Zeqo, Who is who, Albanopol, 2009.
- 15-Josif Papagjoni, Drama dhe komedi, Tekno Paper, Tiranë 2009.
- 16-Epidamn Zeqo, Compare and contrast (political essays), Albanopol 2009.

- 17-Fatmir Minguli, Poezia moderne dhe Moikom Zeqo, ELVE, 2007.
- 18-Hill Mëhilli, Fjalë të urta të popullit shqiptar, Tekno Paper, Tiranë 2010.
- 19-Hill Mëhilli, Proverba të famëshme nga Shqipëria dhe bota, Tekno Paper, Tiranë 2011.
- 20-Hill Mëhilli, Proverba nga gjithë bota, Tekno Paper, Tiranë 2012.
- 21-Konstandin Dhamo, Moda e varfërisë, Tekno Paper, Tiranë, 2007.
- 22-Luan Meta, Mëkatar i mirë, Tekno Paper, Tiranë, 2007.
- 23-Lubrifikantet EKO, Tekno Paper, Tiranë, 2006.
- 24-Llukan Stavro, Nderi i Tepelenës, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 25-Llukan Stavro, Vlera e jetës, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 26-Llukan Stavro, Atdhetar që nga buronja, shqip i doje ato shkronja, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 27-Llukan Stavro, Shqiponja e Golikut, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 28-Llukan Stavro, Vasil Rrapi, Toponimet e Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 29-Llukan Stavro, U ndez një yll i ri, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 30-Llukan Stavro, Bukuria e Qiellit, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 31-Llukan Stavro, Koha të ka vënë kurorë, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 32-Llukan Stavro, Ishit të gjithë për heronj, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 33-Llukan Stavro, Zemra ortodokse, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2012.
- 34-Makabe Zaharia, Anti-Haiku, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 35-Makabe Zaharia, Anti-sonete, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 36-Makabe Zaharia, Mjeshtri i labirintit, Arnissa Edition, 2010.
- 37-Makabe Zaharia, Kentauri fluturues, Arnissa Edition, 2010.
- 38-Maksim Çuko, Qytetërimi dhe krishterimi në Myzeqe, Tekno Paper, Tiranë, 2004.
- 39-Maksim Çuko, Përmes Shkrimeve, Tekno Paper, Tiranë, 2005.
- 40-Maksimilian Lambrec, Raport mbi studimet linguistike në Shqipëri, përktheu Shpëtim Sala, Botime Françeskane, Shkodër 2011.
- 41-Margarita Meshini, Për ata ëndërroje, Trifon Xhagjika, 2010.
- 42-Miguel de Unamuno, Abel Sançez, përktheu nga spanjishtja Petrit Mavrovi, Tekno Paper, Tiranë 2011.
- 43-Moikom Zeqo, Il templo della luna, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2006.
- 44-Moikom Zeqo, Frymëzimi i mbramë, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 45-Moikom Zeqo, Libri Florimontian, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 46-Moikom Zeqo, Wind, Poetry, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 47-Moikom Zeqo, Shkruesi Egjiptian, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 48-Moikom Zeqo, Letër Arnisës për Sabat Zevin, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2008.
- 49-Moikom Zeqo, Muzika e Universeve, Albanopol, Tiranë 2008.

- 50-Moikom Zeqo, Libri Mozize, Albanopol, Tiranë 2008.
- 51-Moikom Zeqo, Konceptualiteti i lirisë, Albanopol, Tiranë 2009.
- 52-Moikom Zeqo, Mijëvjeçarët në sirtar, Albanopol, Tiranë 2009.
- 53-Moikom Zeqo, Arkeologjia, gramatika e fakteve, Albanopol, Tiranë 2009.
- 54-Moikom Zeqo, Buzukiada, Albanopol, Tiranë 2009.
- 55-Moikom Zeqo, Herbariumet, Albanopol, Tiranë 2009.
- 56-Moikom Zeqo, Arkeologjia nënujore, Albanopol, Tiranë 2009.
- 57-Moikom Zeqo, Kulti gnostik i Aparkeas-Abraksas, Albanopol, Tiranë 2009.
- 58-Moikom Zeqo, Universi i artit bizantin, Arnissa Edition, 2009.
- 59-Moikom Zeqo, Arkeologjia, optika e shekujve, Arnissa Edition, 2009.
- 60-Moikom Zeqo, Gjarpëri kadmik dhe anijet ilire, Arnissa Edition, 2010.
- 61-Moikom Zeqo, Pasaporta arkeologjike e traditave, Arnissa Edition, 2010.
- 62-Moikom Zeqo, Letërkëmbim me Makabe Zaharian, Arnissa Edition, 2010.
- 63-Moikom Zeqo, Skënderbeiada, Arnissa Edition, 2010.
- 64-Moikom Zeqo, Arkivi i plagosur, Arnissa Edition, 2010.
- 65-Moikom Zeqo, Arkeologjia si ekzigjezë, Arnissa Edition, 2010.
- 66-Moikom Zeqo, Supriza poetike në Washington D.C, Arnissa Edition, 2010.
- 67-Moikom Zeqo, Arkeologjia si egjiptologji, Arnissa Edition, 2011.
- 68-Moikom Zeqo, Epistolae in tenebris, Arnissa Edition, 2011.
- 69-Moikom Zeqo, Arkeologjia dhe hyjnitë ilire, Arnissa Edition, 2011.
- 70-Moikom Zeqo, Kronika shqiptare e arkeologjisë nënujore, Arnissa Edition, 2011.
- 71-Moikom Zeqo, Hyjnesha Dardania dhe hyjni të tjera ilire në Dardani, Arnissa Edition, 2011.
- 72-Moikom Zeqo, Ikonografia, alkimia dhe Gjon Buzuku, Arnissa Edition, 2011.
- 73-Moikom Zeqo, Kulti i Mitras në Durrës dhe në Apoloni, Arnissa Edition, 2011.
- 74-Moikom Zeqo, Hyu ilir Redon, ikonografia e gabuar, Arnissa Edition, 2011.
- 75-Moikom Zeqo, Rrëfimet, Arnissa Edition, 2012.
- 76-Moikom Zeqo, Poezitë e herëshme, Arnissa Edition, 2012.
- 77-Moikom Zeqo, Saga arkeologjike e Dyrrahut, Arnissa Edition, 2012.
- 78-Moikom Zeqo, Fosilet poetike, Arnissa Edition, 2012.
- 79-Moikom Zeqo, Futuristët në mungesë, Arnissa Edition, 2012.
- 80-Moikom Zeqo, Poezi të Majakovskit futurist, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2012.

- 81-Moikom Zeqo, Imazhi arkeologjik si retrospektivë, përgatiti Andrea Llukani, Arnissa Edition, 2013.
- 82-Mozize Zako, Perëndia I, Albanopol, Tiranë 2008.
- 83-Muharrem Gazioni, Lule që fluturojnë, (Haiku) Albanopol, Tiranë 2008.
- 84-Niko Kotherja, Enciklopedi e fotografëve korçarë, Tekno Paper, Tiranë 2010.
- 85-Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Na flet Visarion Xhuvani, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 86-Nuri Plaku, Gjeometria poetike e Moikom Zeqos, Arnissa Edition, 2009.
- 87-Nuri Dragoj, Familja Qerimaj në sfidat e pentagramit, Wesso, Tiranë 2009.
- 88-Robert Xhaxho, Nga dashuria për Atin, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- 89-Risvald Kume, Filozofia klasike greke në patristikën lindore, Tiranë, 2009.
- 90-Risvald Kume, Mendimi filozofik fetar nga Marksi te Kanti, Tekno Paper, Tiranë 2009.
- 91-Risvald Kume, Refleksione, tema dhe artikuj të përzgjedhur, Tekno Paper, Tiranë 2009.
- 92-Reis Hasho, figurë e shquar e nacionalizmit shqiptar, Tekno Paper, Tiranë 2006.
- 93-Shpëtim Sala, Familja Sala, Tekno Paper, Tiranë 2008.
- 94-Shpëtim Sala, Dr. Ibrahim Temoja në fondet e A.Q.Sh 1881-1942, Tekno Paper, Tiranë 2010.
- 95-Shpëtim Sala, Këngë qytetare të kënduara në Shqipërinë e Mesme, botim i QKSh, Tiranë 2011.
- 96-Shpëtim Sala, Bibliografi e materialeve studimore që ndodhen në dosjet e Androkli Kostallarit, botim i QKSh, Tiranë 2011.
- 97-Trifon Zyba, Atje ku fillon Dhëmbeli, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2008.
- 98-Vangjel Vllaho, Përmes Shkrimeve, Tekno Paper, Tiranë, 2006.
- 99-Vangjel Vllaho, Kujtime nga Goliku, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 100-Vangjel Vllaho, 90-vjetori i çeljes së shkollës së parë shqipe në Peshtan, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 101-Vangjel Vllaho, Këngë në vite, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 102-Vangjel Vllaho, Te shkëmbi i Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2012.
- 103-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 1, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 104-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 2, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 105-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 3, Tekno Paper, Tiranë, 2008.

- 106-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 4, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 107-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 5, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 108-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 6, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 109-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 7, Tekno Paper, Tiranë, 2009.
- 110-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 8, Tekno Paper, Tiranë, 2009.
- 111-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 9, Tekno Paper, Tiranë, 2009.
- 112-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 10, Tekno Paper, Tiranë, 2010.
- 113-Vangjo Ilo, Dardha dhe njerëzit e saj, Libri 11, Tekno Paper, Tiranë, 2010.
- 114-Vangjo Ilo, Një nga ata, Libri I, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 115-Vangjo Ilo, Një nga ata, Libri II, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 116-Vangjo Ilo, Një nga ata, Libri III, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 117-Wayne Miller, Çfarë i thotë nata varkës së zbrazët, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2007.
- 118-Visarion Xhuvani, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007.

LIBRA TË SPONSORIZUAR

- 1-Maksim Çuko, Qytetërimi dhe krishterimi në Myzeqe, Tekno Paper, Tiranë, 2004.
- 2-Moikom Zeqo, Il templo della luna, Aparkeas-Abracas, Tiranë 2006.
- 3-Llukan Stavro, Nderi i Tepelenës, Tekno Paper, Tiranë, 2008.
- 4-Llukan Stavro, Vlera e jetës, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2008.
- 5-Llukan Stavro, Atdhetar që nga buronja, shqip i doje ato shkronja, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 6-Llukan Stavro, Shqiponja e Golikut, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 7-Llukan Stavro, Vasil Rrapi, Toponimet e Peshtanit, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2009.
- 8-Llukan Stavro, U ndez një yll i ri, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 9-Llukan Stavro, Bukuria e Qiellit, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
- 10-Llukan Stavro, Koha të ka vënë kurorë, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 11-Llukan Stavro, Ishit të gjithë për heronj, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2011.
- 12-Llukan Stavro, Zemra ortodokse, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2012.

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

KREU I PARË

Mitropolia e Tiranës dhe e Durrësit

Kishat dhe manastiret

Kishat monument kulture

Kishat e Mitropolisë së Tiranës dhe Durrësit

Katedralja Ngjallja e Krishtit, në Tiranë

Kisha e Ungjillëzimit të Hyjlindëses, në Tiranë

Kisha e Shën Prokopit, në Tiranë

Paraklisi i Amfiteatrit të Durrësit

Bazilika e Shën Mëhillit në Arapaj të Durrësit

Kisha e Shën e Premtes në fshatin Çetë të Kavajës

Bazilika e Tepes në Elbasan

Kisha e Shën Mërisë në lagjen Kala të Elbasanit

Kisha e Shën Kollit në Shelcan, Elbasan

Kisha e Shën e Premtes në Valësh, Elbasan

Manastiret e Mitropolisë së Tiranës dhe Durrësit

Manastiri i Shën Joan Vladimirit

Manastiri i Shën Vlashit

KREU I DYTË

Mitropolia e Beratit

Kishat dhe manastiret

Kishat monument kulture

Kishat e Mitropolisë së Beratit

Bazilika B e Bylisit

Bazilika e Shën Mërisë në Ballsh

Kisha e Kostandinit dhe Elenës në kalanë e Beratit

Kisha e Shën Mitrit në lagjen vakëf të Beratit
Kisha e Shën Todrit në kalanë e Beratit
Kisha e Ungjillëzimit në kalanë e Beratit
Kisha e Shën Mërisë Vllahernës në Berat
Kisha e Shën Kollit në kalanë e Beratit
Kisha e Shën Mëhillit në kalanë e Beratit
Kisha Fjetja e Shën Mërisë, Muzeu Onufri, Berat
Kisha e Shën Spiridhonit në lagjen Goricë të Beratit
Kisha e Shën Kollit në Perondi të Beratit
Kisha e Shën Pjetrit dhe Pavlit në Zhymë të Myzeqesë
Kisha e Shën Kollit në Krutjen e Sipërme
Kisha e Shën Thanasit në Karavasta
Kisha Fjetja e Shën Mërisë në Bishtqethëm, Lushnje
Kisha e Shën Gjergjit në Libofshë
Kisha e Shën Kollit në Vanaj të Myzeqesë
Kisha e Shën Gjergjit në Fier
Kisha e Shën Nikollës në Kurjan të Fierit
Kisha e Shën Todrit në Kadipashaj
Kisha e Shën Gjergjit në Strumë të Myzeqesë
Kisha e Shën Kollit në Toshkëz të Myzeqesë
Kisha e Marmiroit në Orikum të Vlorës
Bazilika e Mesaplikut në Vlorë
Manastiret e Mitropolisë së Beratit
Manastiri i Ardenicës
Manastiri i Pojanit
Manastiri i Kolkondasit
Manastiri i Zvërnecit
Manastiri i Shën Trifonit të Sheqishtes

KREU I TRETË

Mitropolia e Korçës

Kishat dhe manastiret

Kishat monument kulture

Kishat e Mitropolisë së Korçës

Kisha e Burimit Jetëdhënës në Korçë
Kisha e Shën Gjergjit në Korçë
Kisha e Profetit Ilia në Korçë
Kisha e Shën e Premtes në Voskopoje
Kisha e Fjetjes së Hyjlindëses në Voskopoje
Kisha e Shën Kollit në Voskopoje
Kisha e Shën Thanasit në Voskopoje
Kisha e Shën Mëhillit në Voskopoje
Kisha e Profetit Ilia në Voskopoje
Kisha e Shën Mërisë në Vithkuq të Korçës
Kisha e Shën Mëhillit në Vithkuq të Korçës
Kisha e anargjendëve Kozma e Damjano në Vithkuq
Kisha e Ungjillëzimit në Vithkuq të Korçës
Kisha e Shën Gjergjit në Vithkuq të Korçës
Kisha e Ristozit në Mborje të Korçës
Kisha e Shën Gjergjit në Dardhë të Korçës
Kisha e Shën Mitrit në Boboshticë të Korçës
Kisha e Shën Mërisë në Lubonjë të Kolonjës
Kisha e Shën Mërisë në Barmash të Kolonjës
Kisha e Shën Kollit në Shalës të Kolonjës
Kisha e Shën Mëhillit në Shalës të Kolonjës
Kisha e Shën Mërisë në Cerckë të Kolonjës
Kisha e Shën Thanasit në Llëngë të Pogradecit
Manastiret e Mitropolisë së Korçës
Manastiri i Shën Prodhromit
Manastiri i Shën Pjetrit dhe Pavlit
Manastiri i Shën Kollit në Boboshticë
Manastiri i Shën Mërisë në Boboshticë
Manastiri i Kamenicës
Manastiri i Shën Elias
Manastiri i Llëngës

KREU I KATËRT

Mitropolia e Gjirokastrës

Kishat dhe manastiret

Kishat monument kulture

Kishat e Mitropolisë së Gjirokastrës

Kisha e Shën Mëhillit në lagjen Varrosh të Gjirokastrës

Kisha e Shën Sotirit në lagjen Pazar i Vjetër në Gjirokastrë

Kisha e Kryeengjëjve në Gjirokastrë

Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit

Kisha Shën Kollit në Saraqinisht të Lunxhërisë.

Kisha e Shën Mëhillit në Mingul të Lunxhërisë.

Kisha e Shën Gjergjit në Leshnicën e Sipërme

Kisha e Shën Mërisë në Vllahogoranxi

Kisha e Shën Mitrit në Poliçan të Pogonit

Kisha e Shën Thanasit të Mazharit në Pogon

Kisha Fjetja e Shën Marisë në Sopik të Pogonit

Kisha e Shën Kollit në Selani të Pogonit

Kisha e Shën e Premtes në Hllomo të Pogonit

Kisha e Lindjes së Shën Marisë në Skore të Pogonit

Kisha e Shën Kollit në Peshtan të Tepelenës

Kisha e Shën Thanasit në Lekël të Tepelenës

Kisha e Shën Mërisë në Kosinë të Përmetit

Kisha e Shën e Premtes në Përmet

Kisha e Shën Mërisë së Pazarit në Përmet

Kisha e Shën Kollit në Përmet

Kisha e Shën Kollit në Lipë të Përmetit

Kisha e Shën Kostandinit dhe Elenës në Ogren të Përmetit

Kisha e Shën Kollit në Argovë të Përmetit

Kisha e Shën Thanasit në Leshnicë të Përmetit

Kisha e Shën Iliut në Buhal të Përmetit

Kisha e Shën Sotirit në Tremisht të Përmetit

Bazilika dhe pagëzimorja e Butrintit

Kisha e Shën Thanasit në Peca të Sarandës

Kisha e Shën Mërisë në Peca të Sarandës
Kisha e Shën Spiridhonit në Vuno
Kisha e Shën Mërisë në Qeparo
Kisha e Shën Mërisë në Malçan
Kisha e Shën Stefanit në Dhërmi
Kisha e Shën Gjergjit të Kudhësit të Himarës
Manastiret e Mitropolisë së Gjirokastrës
Manastiri i Spilesë
Manastiri i Profetit Ilia në Stegopol
Manastiri i Profetit Ilia në Jorgucat
Manastiri i Drianos në Zervat
Manastiri i Pepelit
Manastiri i Koshovicës
Manastiri i Kryeengjëjve
Manastiri i Ravenës
Manastiri i Ungjillëzimit në Vanishtë
Manastiri i Dhuvjanit
Manastiri i Cepas
Manastiri i Shën Thanasit
Manastiri i Shën Sotirit të Çatistës
Manastiri i Shën Sotirit
Manastiri i Demës
Manastiri i Kakomesë
Manastiri i Shën Mërisë në Korëz
Manastiri i Krimanovës
Manastiri i Mesopotamit
Manastiri i Qeparoit
Manastiri i Atales
Manastiri i Shën Athanasit
Manastiri i Panaisë
Manastiri i Agjelastit
Manastiri i Gjermanoit
Manastiri i Joan Teologut

Manastiri i Piruit
Manastiri i 40 shenjtoreve
Manastiri i Shën Todhrit
Manastiri i Dhivrovunit
Manastiri i Dhivrit
Manastiri i Kamenës
Manastiri i Kardhikaqit
Manastiri i Hoshtevës
Manastiri i Hormovës
Manastiri i Tërbuqit
Manastiri i Kodrës
Manastiri i Frashtanit
Manastiri i Konckës
Manastiri i Stavridhit
Manastiri i Zhejit
Manastiri i Shën Janit
Manastiri i Skutarit
Manastiri i Kostarit
Manastiri i Akrorizës
Manastiri i Shën Vasilit
Manastiri i Voloterit
Manastiri i Erindit
Manastiri i Gjatit
Manastiri i Nokovës

KREU I PESTË

Shpellat eremite
Shpella e Shën Mërisë në liqenin e Prespës
Shpella e Ungjillëzimit në liqenin e Prespës
Shpella e Shën Mërisë në Glluboko të Prespës
Shpella e Arangjelit të Trestenikut në Pustec
Shpella e Letmit të Çermenikës
Shpella e Shën Gjergjit në Dhivër të Delvinës
Shpella e Urakës në Qafë Thanë

Shpella e Kalivaçit në Tepelenë

Shpella e Shën Marenës

Shpella e Sinjës në Berat

KREU I GJASHTË

Arti i ikonografisë në Shqipëri

Shkolla e Beratit

Shkolla ikonografike korçare

Ikonografët e familjes Zografi

Kostandin Shpataraku

Ikonografët e familjes Çetiri

Ikonografët dardharë

Ikonografët nga Linotopi

Ikonografë bashkohorë

KREU I SHTATË

Mikrografitë në Shqipëri

Kodikët

Kodiku i purpurt i Beratit

Kodiku i artë

Si u zbuluan kodikët e Beratit

Restaurimi i kodikëve

Çfarë përmbajnë kodikët e Shqipërisë

Kodiku i Madh i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit

Kodiku Nr. 93 i Korçës

Kodiku i manastirit të Shën Prodhromit

KREU I TETË

Ikonostasët

Ikona e Krishtit

Ikona e Hyjlindëses

Ungjillëzimi i Hyjlindëses

Ikona e Lindjes

Ikona e Ipapandisë

Ikona e Pagëzimit

Ikona e Shpërftyrymit

Ngjallja e Llazarit
Hyrtja në Jerusalem
Ikona e Kryqëzimit
Ikona e Ngjalljes
Ikona e Analipsit
Ikona e Pendikostisë
Fjetja e Hyjlindëses
Si paraqiten me piktura çudirat e Dhiatës së Vjetër
Vepra dhe mrekullitë e Krishtit
Shembëlltyrat
Simbole të krishtera
Simbole nga Dhiata e Vjetër
Simbole nga Dhiata e Re
Simbole nga mrekullitë e Krishtit
Simbole nga bota e shpendëve dhe kafshëve
Simbole nga bota bimore dhe luleve
Simbole objekte
Simbole nga mitologjia
Epitafi i Gllavenicës
Arti psaltik në Shqipëri

Bibliografia
Pasqyra e lëndës

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Llukani, Andrea

Redaktor: Shpëtim Sala

Arti kishtar në Shqipëri

Andrea Llukani, Tiranë:

Botimet “Trifon Xhagjika”, 2014

410 f, 20 cm.

ISBN

